VAJZA ANGLEZE

LIVING
ALBANIA

VAJZA ANGLEZE

DANIEL SILVA

PËRKTHEU: ETLEVA HOXHA ÇEPELE

LIVING
ALBANIA

Edhe një herë, për gruan time, Xhemin

dhe fëmijët e mi, Lilin dhe Nikolasin

Titulli i origjinalit:
The English Girl
Titulli i botimit në gjuhën shqipe:
VAJZA ANGLEZE

Copyright 2016 Botimet Living
Tiranë, 2016
Shtypur në Shqipëri
ISBN: 978-9928-216-02-1

Botuese: Ridvana Dulaku

Përktheu: Etleva Hoxha Çepele
Redaktoi: Bledar Çepele
Design & Layout: Dritan Lleshi

Të gjitha të drejtat e këtij libri janë të rezervuara.
Ndalohet kopjimi apo riprodhimi i pjesshëm apo i plotë me çdo lloj mjeti e forme.

BOTIMET LIVING®

Kompleksi "Don Bosko"
Kulla 7, kati II,
Tiranë, Shqipëri
Tel: +35544800008
Fax: +35544800001
email: info@living.al

Living online:
www.living.al
facebook/Living
instagram/Living_Albania
youtube/TringDigital
twitter.com/TringDigital

Kush jeton si imoral, vdes si imoral

- PROVERB KORSIKAN

PJESA E PARË

RRËMBIMI

3rj0n1xx -mundësoi Librin-

1

PIANA, KORSIKË

Atë e rrëmbyen në ishullin e Korsikës, një fundgusht. Orën e saktë ndoshta nuk do të mund ta mësojmë dot kurrë - duhet të ketë qenë diçka mes pasdites a perëndimit të diellit, mundën të hamendësonin ditën tjetër shoqet e saj. Ato e kishin parë për herë të fundit në prag të perëndimit të diellit, teksa largohej nga vila me një motor të kuq të tipit "Skuter", e veshur me një fustan të hollë pambuku që i valëvitej nga shpejtësia e motorit dhe i nxirrte në pah kofshët e nxira mirë nga dielli. Pasdite, kishin vënë re se shtrati i saj ishte bosh; mbi të, kish pasur vetëm një roman të hapur përgjysmë, i cili mbante aromë vaji arre kokosi dhe përreth ndihej edhe një erë e lehtë rumi. Pas njëzet e katër orësh, shoqet e saj njoftuan xhandarmërinë. Ajo verë kish qenë një verë e veçantë dhe Madalena ishte një vajzë e veçantë.

Kishin mbërritur në Korsikë para dy javësh; katër bukuroshe dhe dy bukuroshë, të gjithë shërbyes besnikë ndaj qeverisë britanike ose partisë politike që drejtonte në atë periudhë. Kishin ardhur të gjithë me një makinë qeveritare, një *Renault* që kishte hapësirën e duhur për të mbajtur pa problem pesë veta dhe Skuterin e kuq të Madalenës, të cilin ajo e ngiste me shpejtësinë e erës. Vila e tyre në ngjyrë okre ndodhej në skajin perëndimor të fshatit, sipër një shkëmbi që shikonte nga deti. Ishte një vilë e

bukur dhe e madhe, nga ato që shpesh, agjentët e pasurive të paluajtshme u referohen si "magjepsëse". Kishte edhe pishinë dhe një kopsht të rrethuar, që gëlonte nga rozmarinat dhe pemët. Vetëm disa orë pas mbërritjes, ata rendën të bënin plazh hareshëm, ashtu, gjysmëlakuriq, siç vdesin të bëjnë plazh turistët britanikë, pavarësisht se ku shkojnë. Ndonëse më e reja e grupit, Madalena ishte udhëheqësja e tyre jozyrtare, një barrë që vajza e kishte pranuar pa ngurruar. Kishte qenë Madalena ajo që kishte gjetur vilën me qira, që kishte rezervuar restorantin me dreka të gjata e darka të vona dhe udhëtimet ditore në thellësi të Korsikës, dhe po ajo kishte ecur para me motorin e saj nëpër shtigjet e ngushta e të pabesa, duke u treguar rrugën. As që e kishte marrë mundimin të përdorte ndihmën e hartës. Njohuritë e saj enciklopedike për gjeografinë, historinë, kulturën dhe kuzhinën e ishullit i kishte përftuar gjatë një periudhe studimesh e përgatitjesh të zellshme, disa javë përpara udhëtimit. Dukej, pra, se Madalena nuk i kishte lënë asgjë në dorë rastësisë. Por, në fund të fundit, ajo nuk linte kurrë, asgjë, në dorë të rastësisë.

Ajo kishte shkuar në selinë qendrore të partisë, në Millbank, dy vjet më parë, pas diplomimit në Universitetin e Edinburgut, në degët Ekonomi dhe Politikë Sociale. Pavarësisht se nuk kishte studiuar në shkolla të mira - pjesa më e madhe e kolegëve të saj kishin studiuar në universitete shtetërore elitare dhe në Oksbrixh - ajo ngjiti me shpejtësi disa shkallë para se të emërohej drejtoreshë e Marrëdhënieve me Komunitetin. Puna e saj, sikundër e përshkruante shpesh ajo, ishte të kërkonte vota edhe në atë pjesë të popullsisë britanike që nuk kishte asnjë interes të mbështeste partinë, platformën apo kandidatët e saj. Të gjithë mendonin se ky emërim do t'i shërbente si një katapultë për pozicione më të larta. Madalenën e priste një e ardhme e ndritur, "diellore", do të shprehej Paulina, e cila e kishte vërejtur nga afër ngjitjen e koleges së saj më të re, ndonëse pa kurrfarë zilie. Në parti, qarkullonin fjalë se atë e kish marrë në patronazh dikush me rëndësi. Dikush pranë kryeministrit ose, pse jo, edhe vetë kryeministri.

Me një pamje sikur sapo kishte dalë nga kopertina e një reviste, intelektin e spikatur dhe energjinë e pashtershme, Madalena po përgatitej për të siguruar një vend në parlament e madje të merrte edhe ndonjë ministri.

E gjitha kjo ishte vetëm çështje kohe. Ose të paktën, kështu thoshin. Gjë që e bënte edhe më skeptik faktin që në moshën njëzeteshtatëvjeçare, Madalena Hart nuk përflitej për asnjë lidhje dashurie. Kur e kishin pyetur për gjendjen e saj shterpë në jetën sentimentale, ajo ishte shprehur se ishte tepër e zënë për të pasur të dashur. Fiona, brunia bukuroshe dhe thumbuese e kabinetit qeveritar, tha se ky shpjegim linte vend për dyshime. Për më tepër, ajo mendonte se Madalena po mashtronte - Fiona vetë ishte një mashtruese e lindur, ndaj edhe i kishte hyrë politikës. Për të vërtetuar teorinë e saj, ajo kishte shtuar se Madalena ishte muhabetçie e thekur, por, kur vinte puna te jeta personale, mbyllej menjëherë në guaskë. Po, pat thënë Fiona, ajo nuk e ka aspak problem të flasë herë pas here për fëmijërinë e saj të trishtë, për jetën e tmerrshme në banesat sociale, për babanë, të cilit sot as fytyrën nuk ia sjell dot ndër mend, për vëllanë e alkoolizuar që nuk kishte parë asnjë ditë punë me sy, ama, të tjerat i ruante të kyçura pas një muri të gurtë e të lartë.

- Madalena jonë ose është një vrasëse e pamëshirshme, ose një prostitutë e sërës së lartë, - tha një çast Fiona, - dhe askush nga ne nuk ia hedh dot.

Por Elisona, njëra prej asistenteve në zyrat qendrore, kishte një teori tjetër.

- E gjora ka rënë në dashuri, - tha ajo një pasdite teksa shihte Madalenën që ngrihej nga uji si një perëndeshë, në gjirin e vogël poshtë vilës ku po qëndronin ata. - Vetëm se është një dashuri e pashpërblyer.

- Pse kështu? - e pyeti Fiona e përgjumur, nga poshtë kapelës me strehë të gjerë, që e mbronte nga dielli.

- Ndoshta sepse nuk i lejohet.

- Mos është ndonjë i martuar?

- I martuar po se po!

- I poshtri!

- Pse, ti nuk...

- A kam qenë ndonjëherë e lidhur me një burrë të martuar?

- Po.

- Vetëm dy herë, por them ta provoj edhe një herë të tretë.

- Ti do të digjesh në ferr, Fi.

- Nuk e ke idenë sa ma ka qejfi!

Pikërisht atëherë, pasditen e ditës së shtatë, tri vajzat dhe dy djemtë që shoqëronin Madalena Hartin në vilën me qira pranë Pianës, vendosën t'i gjenin asaj një të dashur. Dhe nuk duhej të ishte një i dashur dosido, pat thënë Paulina. Ai duhej të kishte njëfarë moshe, pamjeje dhe prejardhjeje, e natyrisht, të gëzonte gjendje ekonomike dhe mendore të shkëlqyer, të ishte pa të fshehta dhe pa ndonjë femër tjetër në jetën e tij. Fiona, ekspertja në çështjet e zemrës, e quajti këtë një mision të pamundur.

- Ai nuk ekziston, - shpjegoi ajo, a thua se nuk kishte lënë vend pa e kërkuar. - Por edhe sikur të ekzistojë, ose është i martuar, ose i pëlqen shumë vetja për t'u marrë me Madalenën e gjorë.

Por, pavarësisht nga dyshimet që kishte, Fiona i hyri me kokë asaj sfide, qoftë edhe për t'i shtuar një grimë intrige pushimeve. Për fatin e saj të mirë, lista e kandidatëve të mundshëm ishte e gjatë, pasi dukej se gjysma e Anglisë Jugore kishte braktisur ishullin përvëlues për të shijuar rrezet e Korsikës. Aty kishte zbarkuar një koloni financierësh që kishin marrë me qira vila madhështore në skajin verior të *Golfe de Porto*, një grup artistësh që jetonin si ciganë në një qytezë kodrinore në *Castagniccia*, trupa e aktorëve që ishin vendosur në plazhin e *Campomoro*-s dhe delegacioni i politikanëve të opozitës, që vazhdonin të komplotonin rikthimin në pushtet, në një vilë sipër shkëmbinjve të *Bonifacio*-s. Duke përdorur kabinetin si kartën e saj fituese, Fiona rregulloi shpejt e shpejt një sërë takimesh sociale, kinse të rastësishme. Për çdo rast - qoftë një festë në mbrëmje, një ngjitje në mal apo një festë në plazh pasdite - ajo gjente mashkullin më të përshtatshëm dhe e vendoste në krah të Madalenës. Megjithëkëtë, dukej se asnjë prej tyre nuk arrinte ta shembte murin e saj, madje as aktori i ri simpatik që sapo kishte interpretuar një rol kryesor në muzikalin më të suksesshëm të sezonit.

- Përfundimisht, atë e ka zënë keq qymyri, - tha Fiona teksa kthehesh-in për në vilë një mbrëmje vonë dhe Madalena i udhëhiqte nëpër errësirë me Skuterin e saj të kuq.

- Kush mendon ti se mund të jetë? - pyeti Elisona.

- Nuk e di, - tha Fiona ngadalë dhe me zili, - por me siguri që është një njeri i veçantë.

Atëherë kur nuk kishte mbetur as një javë për t'u kthyer në Londër, Madalena filloi të kalonte më shumë kohë vetëm. Largohej nga vila herët në mëngjes, zakonisht para se të zgjoheshin të tjerët, dhe kthehej në mbrëmje vonë. Kur e pyesnin se ku shkonte, ajo kthente përgjigje të vagullta dhe në mbrëmje rrinte shpesh e ngrysur ose e shqetësuar. Elisona kishte menduar skenarin më të keq, që i dashuri i Madalenës, kushdo të ishte ai, i kishte dërguar fjalë se "nuk kishte më nevojë për shërbimet e saj". Por ditën tjetër, kur u kthyen në vilë pasi kishin dalë për të bërë pazar, Fiona dhe Paulina u kënaqën kur mësuan se Elisona e kishte pasur gabim. Dukej se i dashuri i Madalenës kishte ardhur në Korsikë dhe Fiona kishte fotografitë që e vërtetonin këtë.

Ajo e kish parë Madalenën në orën 14:10, në restorantin "Les Palmiers", në Kalvi. Ishte ulur në një tavolinë në bregdet, me kokën e kthyer lehtë nga deti, thuajse e pavetëdijshme për praninë e njeriut që ishte ulur përballë saj. Sytë i kish fshehur pas një palë syzesh dielli të mëdha dhe fytyrën e pastër pas një kapele të madhe kashte me një fjongo të zezë. Paulina kishte dashur të afrohej te tavolina e tyre, por Fiona e kishte nuhatur që situata atje ishte e nderë dhe kishte sugjeruar të fshiheshin shpejt e shpejt, pa bërë zë. Ajo ishte menduar mirë para se të shkrepte fotografinë inkriminuese me celularin e saj. Madalena dukej se nuk kishte pikasur asgjë, ama, shoqëruesit të saj nuk i shpëtoi. Sapo Fiona shkrepi butonin e kamerës, ai ktheu kokën sakaq, me një instinkt thuajse kafshëror që e paralajmëronte se po e nxirrnin në fotografi.

Pasi u fshehën me vrap në dyqanin më të afërt, Fiona dhe Paulina vëzhguan me vëmendje burrin në fotografi. Flokët i kishte biondë, paksa të thinjur e të shpupuritur nga era, por aspak të rënë. Balluket i binin mbi sy dhe i shtonin hijeshinë një fytyre katrore ku spikaste një gojë e vogël, me një pamje disi të vrazhdë. Veshja i shkonte vendit: pantallona të bardha, këmishë pambuku të bardhë me vija blu, orë e madhe kundër ujit, këpucë verore me shollë që nuk do të linin shenjë as në dekun e një anijeje. Po, nga ajo sërë njerëzish ishte ai, ranë dakord dy vajzat; njeri që nuk lë gjurmë.

Gjithashtu, ato ranë dakord se ai ishte britanik, pavarësisht se fare mirë mund të ishte edhe gjerman ose skandinav, mendoi Paulina, e cila kishte prejardhje polake, nga familjet më fisnike të atij vendi. Që ishte i kamur, dukej ashiqare, pasi në anë të tavolinës, të zinte syri një shportë me akull, në mes të së cilës ndodhej një shishe shampanjë nga më të shtrenjtat. Pasurinë duhej ta kishte fituar, jo trashëguar, menduan ato, madje, me gjasë, jo në rrugë të ligjshme. Ndoshta ishte ndonjë kumarxhi. Ndoshta kishte llogari bankare në Zvicër, udhëtonte në vende të rrezikshme. Ama, nga pamja, dukej shumë misterioz. Punët e tij, ashtu si edhe këpucët, dukej sikur nuk linin asnjë gjurmë.

Por, gjithsesi, ishte imazhi i Madalenës ai që iu bëri më shumë përshtypje atyre. Sikur nuk ishte më ajo vajza që kishin njohur në Londër, as ajo me të cilën kishin ardhur me pushime dhe qëndronin bashkë prej dy javësh. Sikur kishte zhvilluar një sjellje të re. Sikur po aktronte në një film tjetër. Gruaja tjetër! Tani, të përkulura sipër celularit, Fiona e Paulina shkruan dialogët dhe mishëruan personazhet. Në skenarin e tyre, lidhja mes dy të dashuruarve kish zënë fill pas një takimi të rastësishëm në një dyqan në rrugën "Nju-Bond". Ata kishin flirtuar për një kohë dhe ishin menduar mirë para se të lidheshin. Vetëm se fundin e historisë nuk po e stisnin dot, sepse ai nuk kishte ndodhur ende as në jetën e vërtetë. Megjithatë, të dyja vajzat ishin dakord se ai do të ishte tragjik.

- Kështu përfundojnë *gjithnjë* kësi historish, - foli Fiona me një ton prej eksperteje. - Vajza njihet me djalin. Vajza bie në dashuri me djalin. Vajza lëndohet dhe paskëtaj nuk lë gur pa lëvizur për ta shkatërruar djalin.

Fiona kishte shkrepur edhe dy fotografi të tjera të Madalenës dhe të dashurit të saj atë pasdite. Në njërën, ata shfaqeshin duke ecur përgjatë molit, nën rrezet e shndritshme të diellit, duke prekur hera-herës duart, ama, tinëz. Ndërsa në fotografinë e fundit, ata ndahen, pa i dhënë as edhe një puthje njëri-tjetrit. Pastaj, burri i panjohur hipi në një motoskaf dhe mori për nga skela. Madalena hipi në Skuterin e saj të kuq dhe mori rrugën e kthimit për në vilë. Kur mbërriti atje, ajo nuk e kishte më kapelën e diellit me fjongon e zezë. Atë mbrëmje, kur tha se si e kishte kaluar pasditen, ajo nuk e përmendi vizitën në Kalvi, lëre pastaj drekën me pasanikun në "Les Palmiers".

Fionës i la mbresa qëndrimi i saj.

- Madalena jonë është gënjeshtarja më e sofistikuar në rruzullin tokësor, - i tha ajo Paulinës. - Ndoshta e pret vërtet një e ardhme aq e ndritur sa thonë. Kush e di? Ndoshta një ditë na bëhet edhe kryeministre!

Atë natë, katër vajzat bukuroshe dhe dy djemtë e shkathët që kishin marrë me qira vilën, menduan të darkonin në qytetin më të afërt, në Porto. Madalena bëri rezervimin me atë frëngjishten e saj të shkollës së mesme e, madje, arriti ta bindte pronarin e restorantit t'u jepte tavolinën më të mirë, atë në tarracë, që shikonte nga pjesa shkëmbore e gjirit. Thanë të shkonin deri atje me makinën e tyre, por, pak para se të shkonte ora shtatë, Madalena tha se do të shkonte në Kalvi të pinte një gotë me një mik të vjetër nga Edinburgu.

- Takohemi në restorant, - thirri teksa largohej me shpejtësi teposhtë rrugicës, - dhe, për Zotin, përpiquni të jeni një herë të përpiktë.

Me këto fjalë, u zhduk nga sytë. Askush nuk u habit që ajo nuk shkoi në restorant atë natë. As nuk u alarmuan kur u zgjuan mëngjesin tjetër dhe panë se shtrati i saj ishte bosh. Ajo kish qenë një verë e veçantë dhe Madalena ishte një vajzë e veçantë.

2

KORSIKË - LONDËR

Policia e shtetit francez e shpalli zyrtarisht të humbur Madalena Hartin, në orën dy të pasdites, atë të premte të fundit të gushtit. Pas tri ditësh kërkime, nuk arritën të gjenin asnjë gjurmë të saj, përveç motorit të kuq që u gjet i bërë copash në një rrëzimë të izoluar pranë *Monte Cinto*-s. Në fund të javës, policia i kishte humbur shpresat se ajo mund të gjendej më e gjallë. Publikisht, ata u shprehën me bindje se ajo çështje do të mbetej në kuadrin e kërkimit të një turisteje të humbur britanike, por, në fshehtësi, kishin nisur kërkimet për vrasësin e saj.

Nuk kishte të dyshuar të mundshëm, përveç njeriut me të cilin ajo pat drekuar në "Les Palmiers" pasditen para zhdukjes së saj. Por, ashtu si Madalena, dukej se edhe ai ishte zhdukur nga faqja e dheut. Vallë të ishte një i dashur sekret, sikundër dyshonin Fiona dhe të tjerët, apo thjesht një njeri që e kishte njohur së fundmi në Korsikë? Të ishte britanik? Francez? Apo, siç tha një detektiv i lodhur, ishte një jashtëtokësor i ardhur nga një galaktikë tjetër dhe tani ishte bërë pluhur e ishte kthyer në anijen e tij hapësinore? Kamerierja e restorantit "Les Palmiers" nuk i ndihmoi shumë. Ajo mbante mend vetëm që ai i kishte folur anglisht vajzës me kapelën e diellit, por që më pas kishte porositur në frëngjisht, me një frëngjishte të përsosur. Faturën e kishte paguar me para në dorë,

me kartëmonedha akull të reja, që ende kërcisnin ndër gishta, të cilat i pat vendosur mbi tavolinë si të ishte duke vënë një bast të lartë në kazino e madje, kishte lënë edhe bakshish të majmë, gjë që zor se ndodh ditët e sotme në Europë, me krizën ekonomike që ka pllakosur. Gjëja që i kishte mbetur në mendje prej tij, ishin duart: jo shumë leshatore, të pazëna nga dielli, pa shenja dhe thonj të pastër. Dukej që kujdesej mirë për thonjtë dhe asaj i pëlqenin meshkujt e tillë.

Fotografia e tij, e cila qarkulloi në fshehtësi nëpër vendet më të populluara dhe restorantet më të mira të ishullit, nuk solli veçse mbledhje shpatullash, të plogëta. Dukej se askush nuk e kishte parë atë njeri. Ose, edhe nëse e kishin parë, nuk e mbanin mend. Ai ishte vetëm një bukurosh më shumë që vinte të kalonte verën çdo vit në Korsikë: me trup të nxirë mirë, syze të shtrenjta dhe një orë floriri zvicerane që i zbukuronte kyçin e dorës. Ishte një askush me një kartë krediti dhe një bukuroshe të ulur përballë tij. Ai ishte njeriu i mbetur në harresë.

Ndoshta për pronarët e dyqaneve dhe restoranteve të Korsikës po, por jo për policinë franceze. Ata e futën fotografinë e tij në gjithë databejzet kriminale që kishin në arsenalin e tyre, e madje, edhe në disa të tjera. E pasi të gjitha kërkimet nuk i çuan kurrkund, ata diskutuan nëse duhej t'ia dërgonin foton shtypit. Pati disa prej tyre, sidomos ndër rangjet e larta, që e kundërshtuan këtë ide me pretendimin se, në fund të fundit, ndoshta ai i gjorë mund të ishte fajtor vetëm për një tradhti bashkëshortore, gjë që zor se mund të konsiderohej krim në Francë. Por, pasi kaluan edhe shtatëdhjetë e dy orë të tjera dhe hetimet ishin ende në vend numëro, arritën në përfundimin se tanimë nuk iu mbetej veçse të kërkonin ndihmën e publikut. Dy fotografi të zvogëluara me shumë kujdes iu çuan shtypit: njëra ku ai njeri shfaqej i ulur në "Les Palmiers", ndërsa tjetra duke ecur përgjatë molit. Me të rënë mbrëmja, hetuesit morën me qindra të dhëna për të. Pasi eliminuan shpejt e shpejt të dhënat e panevojshme, u përqendruan vetëm në ato pista që mund t'i çonin drejt një rezultati të mundshëm. E megjithëkëtë, as kjo nuk solli fryte. Një javë pas zhdukjes së Madalena Hartit, i dyshuari i vetëm që kishin, ishte ende një burrë pa emër dhe pa kombësi.

Ndonëse policia vazhdonte të mos kishte një pistë premtuese, teoritë

nuk mungonin. Një grup detektivësh mendonin se njeriu i fotografive në "Les Palmiers" ishte thjesht një psikopat, i cili e kishte joshur Madalenën dhe më pas i kishte ngritur kurth. Një grup tjetër mendonte se ai ishte një mjeran që ishte gjendur në vendin e gabuar dhe në kohën e gabuar. Sipas tyre, ai ishte i martuar dhe nuk mund të dilte tani e të bashkëpunonte me policinë. Sa për fatin e Madalenës, ata mendonin se ndoshta bëhej fjalë për një grabitje të shkuar keq; një femër që endet e vetme me motor sigurisht që ishte një pre e lehtë. Por një ditë, trupi i saj do të gjendej. Do ta nxirrte deti, do ta shkelte pa dashje ndonjë këmbësor në kodrat atypari ose do ta gërmonte ndonjë fermer duke pluguar fushën. Kështu ndodhte gjithmonë në ishull. Korsika nuk mbante peng asnjë të vdekur.

Britanikët i shihnin dështimet e policisë franceze si një rast të shkëlqyer për ta goditur atë, por në të vërtetë, edhe gazetat që mbështesnin opozitën e trajtuan zhdukjen e Madalenës si një tragjedi kombëtare. Ngjitja e saj e shpejtë në karrierë nga një këshill në Eseks, u pasqyrua me detaje nga mediet dhe disa nga mendjet më të ndritura të partisë dhanë deklarata ku u shprehën se karriera e saj premtuese u pre në mes. Nëna e saj e përlotur dhe vëllai qullash dhanë vetëm një intervistë në televizion e më pas u zhdukën nga media, qoftë ajo e shkruar apo televizive. Po ashtu, edhe shokët me të cilët ajo po kalonte pushimet në Korsikë. Pasi u kthyen në Britani, ata u shfaqën vetëm një herë të gjithë bashkë në një intervistë në aeroportin "Heathrow", nën syrin vigjilent të një grupi mediesh mbështetëse të partisë së tyre. Paskëtaj, refuzuan çdo kërkesë tjetër për të dhënë intervista, përfshi edhe ato që u ofruan me pagesa të majme. Në gjithë atë mori mbulimesh televizive, nuk u vu re asnjë gjurmë skandali. Nuk u fol për pushime të shthurura, për dehje, skandale seksuale apo shqetësime të pushuesve apo banorëve përreth vilës së tyre, por vetëm klishetë e përhershme mbi rreziqet që i kanosen një femre që del vetëm në shtete të huaja. Në selinë qendrore të partisë, punonjësit e zyrës së shtypit përgëzuan veten në heshtje për trajtimin që i bënë rastit, ndërsa stafi politik vuri re se kryeministri ishte prekur thellë nga kjo çështje. Pas dyerve të mbyllura, ata e quajtën reagimin e tij "Efekti Madalena".

Dalëngadalë, artikujt për fatin e saj kaluan nga faqet e para të gazetave, në faqet e brendshme, derisa në fund të muajit shtator, emri i saj u

zhduk nga faqet e çdo gazete. Kishte ardhur vjeshta dhe, bashkë me të, edhe koha për t'iu rikthyer punës në qeveri. Britaninë e prisnin shumë sfida: një ekonomi në recension, zona e euros që mbahej në fije të perit dhe një sërë problemesh sociale që po u vështirësonin jetën britanikëve e që tanimë prisnin zgjidhje. E sikur të mos mjaftonin këto, në horizont shfaqej edhe mundësia e zgjedhjeve të parakohshme. Kryeministri e kishte hedhur disa herë fjalën se mund të kishte zgjedhje të parakohshme andej nga fundi i vitit. Ai ishte më se i vetëdijshëm për rreziqet politike nëse tërhiqej tani; Xhonatan Lankaster ishte kreu aktual i qeverisë britanike, sepse paraardhësi i tij nuk arriti të kërkonte zgjedhje të parakohshme pas shumë muajsh lojërash në publik. Lankasteri, asokohe lider i opozitës, e pat quajtur atë "Hamleti i Numrit 10", duke i dhënë kështu goditjen fatale.

Kjo shpjegonte më së miri pse Simon Hjuiti, drejtori i Marrëdhënieve Publike në Kryeministri, kishte kohë që nuk e bënte gjumin rehat. Kjo puna e pagjumësisë nuk ndryshonte asnjëherë tek ai. I rraskapitur nga ritmi marramendës i punës së tij, e zinte gjumi sa vinte kokën në jastëk, zakonisht me një dosje që i binte mbi kraharor, për t'u zgjuar vetëm pas dy a tri orësh. Sapo i dilte gjumi, truri niste t'i punonte me shpejtësinë e erës. Pas katër vitesh punë në qeveri, atij tashmë i punonte mendja vetëm për keq. Kështu ishin shumica e atyre që punonin në zyrën e shtypit në *Downing Street*. Në botën e Simon Hjuitit nuk kishte triumfe, por vetëm katastrofa ose rreziqe të mundshme. Si tërmetet, fuqia e tyre varionte nga lëkundje të lehta që thuajse nuk ndiheshin, në tronditje sizmike aq të fuqishme sa mund të shembnin ndërtesa dhe të merrnin jetë. Hjuiti kishte për detyrë t'i parashikonte këto katastrofa dhe nëse ishte e mundur, edhe të parandalonte dëmet. Së fundmi, ai kishte arritur në përfundimin se puna e tij ishte e padurueshme. Në çastet më të vështira, ky përfundim i falte një grimë ngushëllimi.

Dikur, ai kishte qenë njeri që i kishte peshë fjala. Si gazetar i parë i faqeve politike për gazetën "Times", Hjuiti kishte qenë një nga njerëzit më të pushtetshëm në *Whitehall*. Mjaftonin disa rreshta nga pena e tij e artë dhe e mprehtë, që t'i vinte fundi një politike qeveritare apo edhe karrierës politike të një ministri. Pushteti i Hjuitit kishte qenë aq i padiskutueshëm, sa asnjë qeveri nuk guxonte të paraqiste ndonjë iniciativë të

rëndësishme pa e trajtuar më parë ai. Asnjë politikan që ëndërronte një të ardhme të ndritur nuk guxonte të kandidonte për kreun e partisë së tij pa siguruar më parë mbështetjen e Hjuitit. Një prej atyre politikanëve ishte dhe Xhonatan Lankasteri, një ish-jurist në bashki, i cili bënte një jetë të rehatshme në periferi të Londrës. Me ato fillime Hjuiti nuk kishte ndonjë vlerësim të jashtëzakonshëm për Lankasterin; ai ishte shumë i pispillosur, shumë i pashëm dhe tejet i privilegjuar për ta marrë seriozisht. Por me kalimin e kohës, Hjuiti qe bindur se Lankasteri ishte një njeri me ide të ndritura, i zoti dhe donte ta rindërtonte partinë e tij që ishte në grahmat e fundit dhe po ashtu, donte të rindërtonte edhe vendin e tij. Ç'ishte më e çuditshmja, Hjuiti kishte zbuluar se *e pëlqente* Lankasterin dhe kjo nuk është kurrë një shenjë e mirë. Teksa marrëdhënia e tyre përparonte, ata nisën të flisnin gjithnjë e më rrallë për makinacionet politike në *Whitehall* dhe gjithnjë e më shpesh se si të kuronin shoqërinë e plagosur të Britanisë. Mbrëmjen e zgjedhjeve kur Lankasteri fitoi thellë, me mazhorancën më të madhe të parë ndonjëherë në parlament, Hjuiti ishte ndër të parët që Lankasteri telefonoi.

- Simon, - i pat thënë ai me atë zërin e tij joshës, - kam nevojë për ty, Simon. Nuk ia dal dot i vetëm.

Paskëtaj, Hjuiti shkroi me superlativa për mundësitë e Lankasterit për sukses, duke e ditur mirë se pas disa ditësh, ai do të ishte duke punuar për të në *Downing Street*.

Tani, Hjuiti hapi sytë ngadalë dhe ia nguli me përçmim orës në komodinën pranë shtratit. Në errësirën e natës, shkëlqenin vetëm akrepat e saj që shënonin 03:42, sikur ta përqeshnin. Pranë orës gjendeshin tre telefonat e tij celularë, të gjithë të karikuar plotësisht, gati për të përballuar sulmin e furishëm mediatik të ditës së nesërme. Ah, sa do të donte të karikonte kaq lehtësisht edhe bateritë e tij, por në këtë pikë nuk kishte gjumë dhe diell tropikal që t'i bënin derman së keqes që ai i kish bërë trupit të tij. Hodhi sytë nga Ema. Si zakonisht, ajo po bënte një gjumë të paqtë. Dikur, ai mund të gjente një mënyrë epshore për ta zgjuar, por tani shtrati i tyre martesor ngjasonte më shumë me një vatër të ngrirë. Për një kohë, Ema ishte joshur nga shkëlqimi i Hjuitit në *Downing Street*, por më pas ndjeu një neveri të pashoqe për përkushtimin e tij skllavëror

ndaj Lankasterit. Në sytë e saj, kryeministri u kthye në një rival seksual dhe urrejtja e tij për të kishte hedhur rrënjë deri në skutat më të thella të trurit të saj.

- Simon, ti je njëqind herë më i zoti se ai, - i tha ajo një natë më parë, para se t'i jepte një puthje të ftohtë në faqen e squllur. - E megjithatë, një Zot e di pse të duket sikur duhet të jesh qeni i tij roje. Ndoshta një ditë do të ma thuash vetë arsyen.

Hjuiti e dinte që nuk do të mund të vinte më gjumë në sy, jo tani, teksa qëndronte i shtrirë dhe dëgjonte sekuencën e tingujve që jepnin sinjalet e para të një dite të re. Sikur e ndiente zhurmën mbytëse të hedhjes së gazetave të mëngjesit në pragun e portës, gurgullimën e makinerisë automatike të kafesë, frenimin e një *Sedani* qeveritar në rruginën poshtë dritares së tyre. Makineria e kafesë po fërshëllente me turfullimë. Hjuiti bëri gati filxhanin për një kafe turke, që e ndihmonte të mos shtonte shumë në peshë, dhe doli në verandë. Një shkulm ere e priti sapo hapi derën. Pirgu me gazeta ishte futur në një qese plastike dhe ndodhej në rrugicën në prag të portës, pranë një vazoje me barbaroza të vyshkura. Tek u përkul, syri i kapi edhe diçka tjetër: një zarf i verdhë, tetë me dhjetë centimetra, pa shënim dhe i vulosur mirë. Hjuiti e kuptoi sakaq se ai nuk vinte nga *Downing Street*; askush nga stafi i tij nuk do të guxonte të linte qoftë edhe dokumentin më të parëndësishëm jashtë portës së tij. Kësisoj, duhej të ishte ndonjë e papritur. Jo se kjo e fundit ndodhte rrallë, gjithsesi. Ish-kolegët e tij gazetarë e dinin adresën e tij në *Hampsted* dhe i sillnin gjithnjë pako aty. Shpesh, ishin dhurata të vogla për ndonjë informacion të dhënë, fjalime zemërate për ndonjë shpërfillje ose ndonjë thashethem i keq, që konsiderohej tepër i fshehtë për t'u dërguar me mesazh elektronik. Hjuiti nuk linte t'i shpëtonte asnjë thashethem nga *Whitehall*-i. Si ish-gazetar, ai e dinte mirë se ato që thuheshin pas shpine për dikë, shpesh ishin më të rëndësishme sesa ato që shkruheshin për të në faqet e para të gazetave.

E shtyu zarfin lehtë me gishtin e madh, për t'u siguruar që nuk kishte tela apo bateri brenda, pastaj e vendosi mbi gazeta dhe u kthye në kuzhinë. Pasi ndezi televizorin dhe i uli zërin, i nxori gazetat nga qesja mbështjellëse dhe u hodhi një sy të shpejtë faqeve të para. Thuajse në të gjitha flitej për

propozimin e Lankasterit për ta bërë industrinë britanike më konkurruese në treg, duke ulur taksat. Gazetat "The Guardian" dhe "Indipendent" ishin natyrshëm kritike, por falë përpjekjeve të Hjuitit, pjesa më e madhe e artikujve ishin pozitivë. Lajmi tjetër nga *Whitehall*-i, falë Zotit ishte i mirë. Nuk kishte tërmete, as edhe një lëkundje. Pasi pa edhe njoftimet e ashtuquajtura cilësore, Hjuiti lexoi shpejt e shpejt tabloidët, që i konsideronte barometrin më të mirë të mendimit publik në Britani, se çdo sondazh. Pastaj, pasi rimbushi filxhanin me kafe, hapi zarfin anonim. Brenda tij kishte tri gjëra: një DVD, një fletë formati A4 dhe një fotografi.

- Dreqin, - tha Hjuiti nën zë, - dreqin, dreqin, dreqin!

Ajo çka ngjau më pas, do të kthehej në burim për shumë spekulime dhe për Simon Hjuitin, një ish-gazetar i politikës që natyrisht dinte shumë gjëra, jo pak kundërpadi. Sepse në vend që të njoftonte Policinë Metropolitane të Londrës, sikundër udhëzonte ligji britanik, Hjuiti e mori zarfin bashkë me përmbajtjet e tij, në Numrin 12 në *Downing Street*, që ndodhej vetëm dy dyer poshtë rezidencës zyrtare të kryeministrit, në Numrin 10. Pas mbledhjes së përditshme të orës tetë me stafin, në të cilën as që e përmendi zarfin anonim, ai ia tregoi atë Xheremi Falonit, shefit të kabinetit qeveritar të Lankasterit, njëherazi edhe këshilltari i tij politik. Faloni ishte shefi i më i fuqishëm i kabinetit në historinë e Britanisë. Përgjegjësitë e tij zyrtare përfshinin planifikim strategjik dhe koordinim politikash në një sërë departamentesh në qeveri, gjë që e lejonte atë të fuste hundët në çdo çështje që donte. Shpesh, shtypi e kishte quajtur "Trurin e Lankasterit", gjë që e miklonte shumë Falonin, por aspak Lankasterin. Reagimi i Falonit ndryshoi vetëm nga lëshimi i një pasthirrme. Instinkti i tij i parë ishte t'ia çonin menjëherë materialet Lankasterit, por meqenëse ishte e mërkurë, zgjodhi të prisnin derisa Lankasteri t'i mbijetonte përballjes së përjavshme për jetë a vdekje, të njohur si "Pyetjet e kryeministrit". Në asnjë çast, Lankasteri, Hjuiti apo Xheremi Faloni nuk menduan t'ia dorëzonin materialet policisë. Faloni dhe Hjuiti pyetën Lankasterin për të dyshuarit e mundshëm dhe ai u dha vetëm një emër. Bëhej fjalë për

një familjar të largët dhe, ç'është më e rëndësishmja, një borxh të pashlyer. Besnikëria kishte shumë peshë në ditë si këto, tha kryeministri, por më praktike mbetej strategjia. Kështu, pa bërë bujë, në *Downing Street* u thirr Graham Sejmuri, drejtor prej shumë vitesh i Shërbimit Sekret Britanik, njohur ndryshe edhe si MI5. Kohë më vonë, Sejmuri do ta kujtonte takimin e zhvilluar në studion e kryeministrit, në murin e së cilës varej një portret plot dritë i baroneshës Theçer, si takimin më të vështirë të karrierës së tij. Ai pranoi ta ndihmonte kryeministrin pa ngurruar, sepse kjo ishte ajo që bënin njerëz si Graham Sejmuri në rrethana të tilla. Megjithatë, ai i bëri atij të qartë se nëse përfshirja e tij në këtë çështje do të bëhej një ditë publike, ai do t'i shkatërronte shkaktarët. Tani mbetej vetëm identiteti i operativit që do të bënte kërkimet. Ashtu si edhe Lankasteri para tij, edhe Graham Sejmuri kishte vetëm një kandidat. Ai nuk ia tha emrin e tij kryeministrit. Në vend të kësaj, me fonde nga një prej llogarive të shumta për operacionet e fshehta të MI5-s, atë mbrëmje ai rezervoi një biletë për në Tel Aviv, me linjën "British Airways". Teksa avioni ngrihej në fluturim, ai mendonte se si të vepronte në vijim. *Besnikëria kishte shumë peshë në ditë si këto*, mendoi ai, por më praktike mbetej strategjia.

3

JERUSALEM

Në zemër të Jerusalemit, jo shumë larg rrugës "Ben Jehuda", ndodhej një rrugicë e qetë, e mbuluar nga gjethet, e njohur si rruga "Narkiss". Pallati numër 16 ishte vetëm trekatësh dhe qe pjesërisht i fshehur pas një muri të lartë me gurë gëlqerorë dhe një peme gjithaq të lartë eukalipti që rritej në kopshtin para tij. Apartamenti në katin e fundit të tij ndryshonte nga të tjerët në godinë vetëm sepse dikur kishte qenë në pronësi të Shërbimit Sekret Izraelit. Ai kishte një dhomë ndenjjeje të bollshme, një kuzhinë të pastër të mbushur me pajisje moderne, një dhomë ngrënieje të vërtetë dhe dy dhoma gjumi. Dhoma më e vogël e gjumit, ajo që ishte menduar si dhoma e fëmijëve, ishte kthyer në një studio profesionale artistike. Por, Gabrieli gjithsesi vazhdonte të pëlqente të punonte në sallon, ku ajri i freskët që hynte përmes dyerve franceze, e largonte kundërmimin e tretësve të tij. Atë çast, ai po përdorte një solucion me përzierje acetoni, alkooli dhe uji të distiluar, që për herë të parë ia mësoi ta bënte mjeshtri i madh i artit të restaurimit, Umberto Konti, në Venecia. Përzierja ishte aq e fortë sa të shpërbënte papastërtitë në sipërfaqe dhe lustrën e vjetër me llak, pa dëmtuar furçën origjinale të artistit. Gabrieli ngjeu një tampon pambuku të sajuar vetë në atë solucion dhe më pas e rrotulloi butësisht mbi gjoksin e ngritur të Suzanës.

Vështrimi i saj ishte diku larg dhe dukej se nuk e kishte idenë se dy pleq të shthurur, fshatarë, po e shihnin teksa bënte banjë, nga përtej murit me lule. Gabrieli, i cili u dilte gjithnjë në mbrojtje femrave, do të donte të kishte mundësi të ndërhynte dhe t'ia kursente asaj traumën që e priste: akuza të rreme, gjyq dhe dënim me vdekje. Por në vend të kësaj, vazhdoi të pastronte me tampon mbi sipërfaqen e gjoksit të saj dhe të vështronte teksa lëkura e verdhë kthehej në një të bardhë të shndritshme.

Kur tamponi u ndot më shumë nga ç'duhej, Gabrieli e vendosi në një shishe të papërshkueshme nga ajri që të bllokoheshin avujt. Teksa përgatiste një tjetër, sytë e tij kaluan ngadalë mbi sipërfaqen e pikturës. Aktualisht, meritat për të i mbante një pasues i Titanit, por pronari i saj për momentin, agjenti i famshëm i veprave të artit, londinezi Xhulian Isherud, mendonte se ajo pikturë vinte nga studioja e Xhakopo Basanos. Gabrieli u pajtua me mendimin e tij vetëm pas punës që bëri vetë, kur vuri re gjurmë të mjeshtrit të madh, sidomos në figurën e Suzanës. Gabrieli e njihte mirë stilin e Basanos; ai i kishte studiuar intensivisht pikturat e tij gjatë kohës që kishte kryer stazhin dhe dikur kishte kaluar disa muaj në Zyrih duke restauruar një vepër me rëndësi të Basanos për një koleksionist privat. Natën e fundit të qëndrimit të tij atje, ai kishte vrarë një njeri me emrin Ali Abdel Hamidi, ndanë një rrugine të lagësht pranë lumit. Hamidi, një terrorist palestinez që i kishte lyer shumë duart me gjak izraelit, ishte shtirur si dramaturg dhe Gabrieli i kishte falur një vdekje të denjë për shtirjet e tij letrare. E ngjeu tamponin e ri në tretësirë, por para se të rifillonte punën, dëgjoi frenimin e njohur të një makine në rrugë. Një çast më vonë, Ari Shamroni qëndronte mbi një stol druri, përkrah Gabrielit. Ai mbante veshur pantallona kaki, një këmishë të bardhë pambuku dhe një xhaketë lëkure që i ishte shqepur paksa në shpatullën e majtë. Syzet e tij shëmtarake shkëlqenin nën dritën e llambave alogjene me të cilat punonte Gabrieli. Fytyra e tij, me plasat e prerjet e thella, kishte marrë një pamje pakënaqësie të thellë.

- E ndjeva aromën e kimikateve të tua sapo zbrita nga makina, - tha Shamroni. - Nuk dua ta mendoj se sa dëm i ke bërë trupit me ato në gjithë këta vjet punë.

- Të jesh i sigurt se ai dëm nuk është asgjë në krahasim me dëmin që

më ke bërë ti, - ia priti Gabrieli. - Ndonjëherë nuk mund ta besoj se si arrij ende të mbaj furçën në dorë.

Vendosi tamponin e lagur në trupin e Suzanës dhe e rrotulloi ngadalë. Shamroni pa i ngrysur orën e tij, a thua se ajo kishte filluar të mos e tregonte më mirë kohën.

- Ka ndonjë problem? - e pyeti Gabrieli.

- Jo, po mendoja sa kohë të duhet që të më bësh një kafe.

- Ti e di ku janë gjërat. Thuajse jeton këtu.

Shamroni mërmëriti diçka në polonisht në lidhje me fëmijët mosmirënjohës. Pastaj, u ngrit me përtesë nga stoli dhe duke u mbajtur me gjithë peshën në bastunin e tij, shkoi në kuzhinë. Arriti ta mbushte xhezven me ujë, por më pas u hutua nga moria e butonave për t'u shtypur mbi sobë. Ari Shamroni kishte shërbyer për dy mandate si drejtor i Shërbimit Sekret Izraelit dhe para këtij emërimi, kishte qenë një prej oficerëve më të dekoruar në të. Por tani, në moshë të kaluar, nuk kryente dot as nevojat më bazike në kuzhinë. Makineritë e kafesë, grirësit, thekëset e bukës: të gjitha këto ishin si një mister për të. Gilahu, gruaja e tij prej shumë vitesh, shpesh bënte shaka e thoshte se i madhi Ari Shamron do të vdiste për të ngrënë po ta lije vetëm në kuzhinën e mbushur me pajisjet moderne elektroshtëpiake. Shamroni po qëndronte mes dyerve franceze, duke pirë cigare. Kundërmimi i duhanit të tij turk, shumë shpejt e mbyti aromën e athët të tretësirave.

- Nuk rri dot pa pirë duhan? - e pyeti Gabrieli.

- Jo, nuk rri dot, - ia ktheu Shamroni.

- Përse ke ardhur në Jerusalem?

- Më thirri kryeministri.

- Vërtet?

Shamroni e vështroi Gabrielin përmes shtëllungës blu në gri të tymit të duhanit dhe i tha:

- Pse të habit fakti që më ka thirrur kryeministri?

- Sepse...

- Jam plak dhe nuk bëj më punë? - ia preu fjalën Shamroni.

- Ti je i paarsyeshëm, i paduruar e me raste, edhe i padurueshëm.

Shamroni pohoi duke tundur kokën. Mosha e kishte bërë të dinte t'i pranonte të metat e tij, edhe pse tani nuk kishte më kohë për t'i ndrequr.

- Si është ai? - e pyeti Gabrieli.

- Siç mund ta marrësh me mend.

- Përse të thirri?

- Folëm për shumë gjëra dhe me sinqeritet.

- Po thua që i bërtitët njëri-tjetrit?

- Unë i kam bërtitur vetëm një kryeministri.

- Kujt? - e pyeti Gabrieli, që këtë herë u bë vërtet kureshtar.

- Goldës, - u përgjigj Shamroni. - Ditën pas ngjarjes në Mynih. I thashë që duhej të ndryshonim taktikat, që duhej t'i terrorizonim ne terroristët. I dhashë edhe një listë me emra, njerëz që duhej të vdisnin. Por Golda nuk tundej nga e saja.

- Edhe ti i bërtite?

- Nuk është se krenohem për këtë, gjithsesi.

- Po ajo çfarë bëri?

- Më bërtiti edhe ajo, afërmendsh. Por në fund, ama, u pajtua me idetë e mia. Paskëtaj, unë krijova një listë tjetër me emra, emra djemsh të rinj që më duheshin për të kryer operacionin. Të gjithë ata pranuan pa u menduar dy herë, - aty Shamroni heshti një çast e më pas shtoi, - të gjithë, përveç njërit.

Gabrieli vendosi pa zhurmë tamponin e ndotur në shishen e papërshkueshme nga ajri. Aty bllokoheshin avujt helmues të tretësirës, por jo kujtimi i takimit të tij të parë me njeriun që e thërrisnin *Memuneh*, kreun e tyre. Kishte ndodhur vetëm disa qindra metra larg vendit ku ai ndodhej tani, në kampusin e Akademisë së Arteve dhe Dizajnit, "Bezalel". Gabrieli sapo kishte lënë një orë leksioni pikture të Viktor Frankelit, ekspresionistit të famshëm gjerman, që ishte njëherazi edhe kumbari i tij. Shamroni e priste në cepin e një kopshti të rrahur mirë nga dielli, i shoqëruar nga një rresht burrash me syze të zeza dhe dhëmbë si çarqe. Si zakonisht, ai i kishte marrë masat. E dinte që Gabrieli ishte rritur në një zonë bujqësore në Luginën e Jezrelit dhe i urrente me gjithë shpirt fermat. E dinte që nëna e Gabrielit, një artiste e talentuar, ia kishte dalë të mbijetonte në kampin e vdekjes në Birkenau, por nuk i shpëtoi dot kancerit që ia shkatërroi trupin. Dinte gjithashtu se gjuha e parë e Gabrielit ishte gjermanishtja dhe ajo ishte edhe gjuha e ëndrrave të tij. Të gjitha këto të dhëna ishin në dosjen që ai mbante mes gishtave të tij të zverdhur nga nikotina.

- Operacioni do të quhet "Zemërimi i Perëndisë", - i pat thënë ai atë ditë. - Nuk është për drejtësi, por për hakmarrje. Hakmarrje e pastër për njëmbëdhjetë jetët e pafajshme që u humbën në Mynih.

Gabrieli i tha të gjente dikë tjetër.

- Nuk dua askënd tjetër, - ia pat prerë Shamroni. - Të dua ty.

Gjatë tri viteve që pasuan, Gabrieli dhe operativët e tjerë të operacionit "Zemërimi i Perëndisë" i përndoqën pretë e tyre përmes Europës dhe Lindjes së Mesme. I armatosur me një beretë të kalibrit 22, një pistoletë me silenciator, e përshtatshme për vrasjet në afërsi, vetë Gabrieli vrau gjashtë anëtarë të "Shtatorit të Zi". Kur kishte mundësi, i qëllonte njëmbëdhjetë herë, nga një plumb për çdo izraelit të masakruar në Mynih. Kur më në fund u kthye në atdhe, tëmthat i kishin marrë një ngjyrë të hirtë dhe fytyra pamjen e një njeriu njëzet vjet më të madh në moshë. I paaftë për të bërë më punime origjinale, ai shkoi në Venecia dhe studioi artin e restaurimit. Paskëtaj, pasi fitoi njëfarë qetësie, iu kthye punës për Shamronin. Në vitet që pasuan, kreu disa nga operacionet më me famë në historinë e Shërbimit Sekret Izraelit. Tani, pas shumë vjetësh endjesh nëpër shtete, më në fund, ishte kthyer në Jerusalem. Askënd nuk e gëzonte ky fakt më shumë se Shamronin, i cili e donte Gabrielin si ta kishte djalin e tij dhe sillej në apartamentin e tij në rrugën "Narkiss", si ta kishte të vetin. Dikur, Gabrieli mund të acarohej nga prania e vazhdueshme e Shamronit aty, ama, tani, nuk i bënte më përshtypje. Ari Shamroni i madh ishte i përjetshëm, por ena ku banonte shpirti i tij, dukej se nuk do ta kishte të gjatë.

Ajo çka e kish dëmtuar më shumë shëndetin e tij, ishte duhanpirja e pandërprerë, ves që e kishte marrë që në rininë e tij në Poloni dhe që e kishte rënduar edhe më tej pasi kish shkuar në Palestinë për t'iu bashkuar luftës që çoi në pavarësinë e Izraelit. Atë ditë, teksa përshkruante takimin e tij me kryeministrin, ai po luante me çakmakun e tij të lashtë, *Zippo*, me të cilin, pa kaluar shumë, ndezi edhe një cigare tjetër me aromë të tmerrshme.

- Kryeministri ishte i shqetësuar, më shumë se zakonisht, dhe kam frikë se nuk ka faj. Rilindja Arabe e ka zhytur gjithë rajonin në kaos. Iranianët po i afrohen realizimit të ëndrrës së tyre për armët nukleare. Nuk do të vonojë shumë dhe ata do të hyjnë në zonën e imunitetit, duke na i bërë të pamundura veprimtaritë ushtarake pa ndihmën e amerikanëve, - tha Shamroni duke mbyllur vetëtimthi kapakun e çakmakut dhe duke hedhur sytë nga Gabrieli që kishte rinisur punën me pikturën. - Gabriel, ti po më dëgjon?

- Jam i tëri sy e veshë.

- Ma vërteto, atëherë.

Gabrieli përsëriti fjalët e fundit të Shamronit, fjalë për fjalë. Shamroni vuri buzën në gaz. Ai besonte se kujtesa e pagabueshme e Gabrielit ishte një nga arritjet e tij më të mëdha. Nisi të luante me *Zippo*-n e tij, me majat e gishtave. Dy rrotullime djathtas, dy majtas.

- Puna është se presidenti amerikan nuk pranon të vërë kufizime. Thotë se do t'i lejojë iranianët të prodhojnë armë nukleare, por ajo deklaratë nuk ka vlerë nëse iranianët *kanë mundësi* t'i prodhojnë ato brenda një kohe të shkurtër.

- Si japonezët.

- Japonezët nuk i sundojnë mullatë apokaliptikë Shia, - tha Shamroni. - Nëse presidenti amerikan nuk tregohet i kujdesshëm, dy arritjet e tij më të mëdha në politikën e jashtme do të jenë një Iran me armë nukleare dhe restaurimi i kalifatit islamik.

- Mirë se erdhe në botën post-amerikane, Ari.

- Pikërisht prandaj mendoj se nuk duhet të tregohemi mendjelehtë dhe ta lëmë sigurinë tonë në dorën e tyre. Por në fakt, ky nuk është problemi i vetëm i kryeministrit, - shtoi Shamroni. - Gjeneralët nuk janë të sigurt nëse mund të zhdukin aq pjesë të programit sa të bëjnë efektiv një sulm ushtarak. Ata të "Bulevardit Mbreti Saul", nën tutelën e mikut tënd, Uzi Navotit, po i thonë kryeministrit se një luftë e njëanshme me persët do të sillte një katastrofë me përmasa biblike.

Bulevardi "Mbreti Saul", ishte adresa e Shërbimit Sekret Izraelit. Ai kishte një emër të gjatë e të ngatërruar që nuk kishte aspak lidhje me natyrën e vërtetë të veprimtarisë së tyre. Çdo agjent i dalë në pension, si Shamroni, por edhe të tjerë, e quante thjesht Byroja.

- Uzi i takon çdo ditë ata të Shërbimit Sekret, - tha Gabrieli.

- Edhe unë, - shtoi me nxitim Shamroni. - Jo të gjithë, por aq sa për t'u

bindur se llogaritjet e Uzit për kohën që na ka mbetur, nuk janë të sakta.

- Matematika nuk ka qenë asnjëherë pika e fortë e Uzit. Ama, kur ishte në terren, ai nuk gabonte kurrë.

- Po, sepse rrallëherë përfshihej në situata ku mund të gabonte, - tha Shamroi dhe heshti një çast, teksa shihte erën që tunde gjethet e eukaliptit matanë parmakut të tarracës së Gabrielit. - Unë e kam thënë gjithmonë që një karrierë pa polemika, nuk mund të quhet karrierë. Unë kam pasur mjaft, po ashtu edhe ti.

- Unë kam edhe shenjat që e vërtetojnë.

- Edhe tituj, - tha Shamroni. - Kryeministri është i shqetësuar se Byroja tregohet shumë e kujdesshme kur bëhet fjalë për Iranin. Po, kemi futur viruse në kompjuterët e tyre dhe kemi eliminuar shumë prej shkencëtarëve të tyre, por së fundmi asgjë nuk ka bërë bujë. Kryeministri do që Uzi të kryejë një operacion tjetër "Kryevepër".

"Kryevepër" ishte emri në kod për operacionin e përbashkët izraelito-amerikano-britanik, i cili rezultoi në shkatërrimin e katër pajisjeve sekrete iraniane. Atë e kishte organizuar Uzi Navoti, por nëpër korridoret e Byrosë pëshpëritej se ai ishte një ndër operacionet më të mira të Gabrielit.

- Mundësi si ajo e "Kryeveprës" nuk të jepen çdo ditë, Ari.

- Kjo është e vërtetë, - pohoi Shamroni, - por unë gjithnjë kam qenë i mendimit se disa mundësi fitohen, nuk të jepen. Ky është edhe mendimi i kryeministrit.

- Ai e ka humbur besimin tek Uzi?

- Ende jo, por donte të dinte nëse e kisha humbur unë.

- Çfarë i the ti?

- Çfarë t'i thosha? Uzin e rekomandova unë për atë detyrë.

- Pra, i dhe bekimin?

- Po, por me kushte.

- Çne kështu?

- I kujtova kryeministrit se personi që doja *vërtet* ta bënte atë punë, nuk ishte i interesuar, - tha Shamroni dhe tundi kokën ngadalë. - Ti je i pari në historinë e Byrosë që ka refuzuar mundësinë për të qenë drejtori i saj.

- Ka gjithmonë një herë të parë, Ari.

- Po thua se mund ta rimendosh?

- Për këtë ke ardhur ti?

- Jo, thashë se mos të kishte marrë malli për mua, - ia preu Shamroni. - Por unë dhe kryeministri po mendonim nëse mund të ndihmoje njërin prej aleatëve tanë më të ngushtë.

- Kë?

- Graham Sejmuri ka ardhur sot në qytet, pa njoftuar. Do të flasë me ty.

Gabrieli u kthye me fytyrë nga Shamroni dhe pas një çasti, i tha:

- Përse do të flasë me mua?

- Nuk tha gjë, por dukej se ishte urgjente, - tha Shamroni dhe iu afrua këmbalecit, i hodhi një sy kanavacës ku kishte punuar Gabrieli dhe shtoi: - Tani duket sërish si e re.

- Ky ishte qëllimi.

- Mund ta bësh këtë edhe me mua?

- Më vjen keq, Ari, - ia ktheu Gabrieli duke prekur faqen me rrudha të thella të Shamronit, - por kam frikë se ti nuk riparohesh më.

4

HOTELI "MBRETI DAVID", JERUSALEM

Pasditen e 22 korrikut të vitit 1946, grupimi ekstremist zionist, i njohur me emrin "Irgun", hodhi një bombë të madhe në hotelin "Mbreti David", që shërbente asokohe si selia qendrore e të gjitha forcave ushtarake britanike dhe forcave civile palestineze. Në atë sulm, një reprezalje për arrestimin e disa qindra luftëtarëve hebrenj, pati nëntëdhjetë e një të vrarë, mes të cilëve edhe njëzet e tetë qytetarë britanikë të cilët nuk ia vunë veshin një telefonate paralajmëruese për t'u larguar nga hoteli. Ndonëse u dënua nga e gjithë bota, shpejt u vërtetua se ai bombardim ishte një prej akteve më efektive të dhunës politike të kryera ndonjëherë. Brenda dy viteve, britanikët u tërhoqën nga Palestina dhe shteti modern i Izraelit që dikur ishte vetëm një ëndërr e largët zioniste, tanimë ishte realitet.

Mes fatlumëve që i mbijetuan atij bombardimi, ishte edhe një oficer i ri i Shërbimit Sekret Britanik, me emrin Artur Sejmur, pjesëmarrës i programit "Double Cross" në kohën e luftës, i cili ishte transferuar në Palestinë për të spiunuar organizatat e fshehta izraelite. Sejmuri duhej të ishte në zyrën e tij në orën kur shpërtheu bomba, por ishte vonuar pak në një mbledhje me një informator të Qytetit të Vjetër. Shpërthimin e kishte dëgjuar kur po kalonte te "Jaffa Gate" dhe dështmoi i tmerruar se

si u shemb hoteli. Ai imazh do ta përndiqte më pas për gjithë jetën dhe do të formësonte rrugën e karrierës së tij. Një antiizraelit i zjarrtë dhe me një arabishte të rrjedhshme, ai krijoi lidhje të ngushta me shumë prej armiqve të Izraelit. Shkonte rregullisht si mysafir te presidenti egjiptian Gamal Abdel Naseri dhe ishte adhurues i hershëm i një revolucionari palestinez me emrin Jaser Arafat. Pavarësisht ideve të tij pro-arabe, Byroja e konsideronte Artur Sejmurin si një nga gjashtë oficerët më të mirë të MI6-s në Lindjen e Mesme. Kësisoj, kur djali i vetëm i Sejmurit, Grahami, zgjodhi të bënte karrierë në MI5 dhe jo të ndiqte rrugën e lavdishme në Shërbimet Sekrete, ata u habitën shumë. Sejmuri i ri, sikundër njihej në fillimet e karrierës së tij, më herët shërbeu në kundërzbulim, duke punuar kundër KGB-së në Londër. Pastaj, pas rënies së Murit të Berlinit dhe shtimit të fanatikëve islamikë, u emërua në krye të kundërzbulimit. Tani, si zëvendësdrejtor i MI5-ës, e kishin detyruar të përdorte ekspertizën e tij në të dyja disiplinat. Kishte më shumë spiunë rusë që endeshin rrugëve të Londrës këto kohë sesa në kulmin e Luftës së Ftohtë. Falë gabimeve të bëra nga qeveritë britanike që e pasuan atë, Mbretëria e Bashkuar ishte kthyer në strehën e disa mijëra militantëve islamikë nga Azia dhe Arabia Saudite. Sejmuri i referohej Londrës si "Kandahari mbi Tamiz". Në fshehtësi, ai shqetësohej se vendi i tij po i afrohej gjithnjë e më shumë humnerës së qytetërimit. Ndonëse Graham Sejmuri kishte trashëguar pasionin e të atit për spiunazhin e pastër, ai nuk ndante aspak me të idetë për të përçmuar Izraelin. Madje, nën udhëheqjen e tij, MI5-a kishte krijuar lidhje të ngushta me Byronë dhe në veçanti me Gabriel Alonin. Të dy ata e konsideronin veten anëtarë të një vëllazërie të fshehtë që kryente punë të papëlqyeshme që nuk i merrte përsipër kurrkush tjetër, dhe më pas mendonin për pasojat. Ata kishin luftuar për njëri-tjetrin, kishin derdhur gjak për njëri-tjetrin e me raste, edhe kishin vrarë për njëri-tjetrin. Ishin aq të afërt sa mund të ishin dy agjentë të organizatave të ndryshme, pra, nuk i druheshin shumë njëri-tjetrit.

- Ekziston ndonjë në hotel që nuk e di se kush je ti? - pyeti Sejmuri, teksa i shtrëngonte dorën Gabrielit, a thua se po e takonte për herë të parë.

- Recepsionistja më pyeti nëse kisha ardhur për "bar-mitzvah"-un[1] e Grinbergëve.

Sejmuri buzëqeshi lehtë. Me flokët në ngjyrë ari dhe mjekrën e fortë, ai kishte pamjen e prototipit të baronit kolonial britanik, dikujt që merrte vendime të rëndësishme dhe që kishte lindur me shërbyes te koka.

- Brenda apo jashtë? - pyeti Gabrieli.

- Jashtë, - tha Sejmuri.

Zunë vend në një tavolinë në verandën e hotelit, Gabrieli me fytyrë nga hoteli, ndërsa Sejmuri me fytyrë nga muret e Qytetit të Vjetër. Ora shënonte njëmbëdhjetë e pak minuta, pra, as mëngjes dhe as drekë. Gabrieli mori vetëm një kafe, ama, Sejmuri porositi me tepri. Gruaja e tij nuk ia thoshte fare për gatim. Për të, ushqimi i avionit ishte i këndshëm, ndërsa zëmra në një hotel, qoftë kjo edhe nga kuzhina e hotelit "Mbretit David", hynte në rastet e veçanta që duheshin shijuar. Dukej se një prej këtyre rasteve, ishte edhe kundrimi i Qytetit të Vjetër.

- Për ty mund të jetë e pabesueshme, - tha ai duke ngrënë omëletë, - por është hera e parë që shkel në vendin tënd.

- Jo, e di, - ia ktheu Gabrieli. - Kam lexuar gjithë dosjen tënde, ku përmendej edhe ky fakt.

- T'u duk interesant leximi?

- Jam i sigurt se ato nuk ishin asgjë në krahasim me informacionet që ka shërbimi juaj për mua.

- Ç'janë këto që thua? Unë jam vetëm një shërbëtor i përulur i Shërbimit Sekret të Madhërisë së Saj. Ndërsa ti je legjendë! Në fund të fundit, - shtoi Sejmuri duke ulur zërin, - sa oficerë të Shërbimeve Sekrete mund të mburren se e shpëtuan botën nga apokalipsi?

Gabrieli hodhi vështrimin pas shpatullave të tij. Ia nguli sytë Xhamisë së Gurit, vezulluese, faltores së tretë më të shenjtë të islamizmit, e cila shkëlqente nën rrezet e kristalta të diellit të Jerusalemit. Pesë muaj më parë, në një dhomë sekrete pesëdhjetë metra poshtë sipërfaqes së saj, ai zbuloi një bombë që sikur të kishte shpërthyer, do të kishte rrënuar xhaminë me gjithë sheshin atypari. Kishte zbuluar edhe njëzet e dy

[1] Bar mitzvah - ceremoni e traditës hebraike, e cila kryhet kur mashkulli mbush 13 vjeç dhe shënon fillimin e angazhimit të tij fetar.

kolona të Tempullit të Solomonit, duke vërtetuar përfundimisht se faltorja e lashtë hebraike, e cila përshkruhej edhe në librat e Mbretërve dhe Kronikave në Dhiatën e Vjetër, kishte ekzistuar vërtet. Ndonëse emri i Gabrielit nuk u shfaq në asnjë nga mbulimet që mediet i bënë zbulimit madhështor, përfshirja e tij në atë ngjarje u bë e ditur më së miri në ato qarqe të komunitetit perëndimor të Shërbimeve Sekrete, që duhej ta dinin. Gjithashtu, ishte bërë e ditur se miku i tij më i ngushtë, studiuesi i njohur i Biblës dhe njëherazi operativ i Byrosë, Eli Lavoni, për pak kishte humbur jetën në përpjekje për të shpëtuar shkatërrimin e atyre kolonave.

- Pate fat si dreqi që ajo bombë nuk shpërtheu, - i tha Sejmuri. - Të kish shpërthyer, miliona myslimanë do të kishin mbirë këtu për vetëm disa orë. Pastaj... - aty zëri i tij u shua.

- Do të kish plasur bomba edhe në atë që njihet si Shteti Izraelit, - tha Gabrieli, si për të plotësuar idenë e Sejmurit. - Atë donin iranianët dhe miqtë e tyre në Hezbollah.

- E marr me mend se si je ndier kur të dolën para syve për herë të parë ato kolonat.

- Graham, të them të drejtën, nuk pata kohë t'i gëzohesha atij çasti fatlum. E kisha mendjen të mbaja Elin në jetë.

- Si është tani ai?

- Ndenji dy muaj në spital, por tani është bërë si i ri. Madje është kthyer edhe në punë.

- Në Byro?

Gabrieli tundi kokën.

- Po gërmon prapë në tunelin e anës perëndimore. Mund ta rregulloj që të shkosh të hedhësh edhe ti një sy, nëse do. Madje, nëse je vërtet i interesuar, mund të të tregoj korridorin sekret që të çon drejt e në Malin e Tempullit.

- Nuk ma do mendja që qeveria ime ta aprovojë këtë, - tha Sejmuri dhe u krodh në qetësi teksa kamerieri rimbushte filxhanët e çajit. Pastaj, kur mbetën përsëri vetëm, i tha: - Domethënë, qenkan të vërteta ato fjalët.

- Ç'fjalë?

- Ato, sipas së cilave, djali famëkeq është kthyer në shtëpi. Çudi... - shtoi ai duke nënqeshur si me trishtim, - sepse unë gjithnjë kam menduar se ti do ta kaloje jetën duke u endur nëpër shkëmbinjtë e Kornuellit.

- Graham, këtu është bukur, por Anglia është vendi yt, jo imi.

- Ndonjëherë as që më duket si vendi im, - tha Sejmuri. - Kohët e fundit, unë e Helena kemi blerë një vilë në Portugali. Së shpejti edhe unë do të jetoj në ekzil, si ti dikur.

- *Sa* shpejt? - e pyeti Gabrieli?

- Jo nesër, por një ditë edhe gjërave të mira u vjen fundi, - u përgjigj Sejmuri.

- Ti ke bërë karrierë të shkëlqyer, Graham.

- A thua? Zor ta matësh suksesin në botën e Shërbimeve Sekrete, apo jo? Ne na gjykojnë në bazë të gjërave që *nuk* ndodhin, sekreteve që nuk vidhen, godinave që nuk shpërthejnë. Mund të thosha pa frikë se zanati ynë nuk është aspak një mënyrë e bukur për të fituar bukën e gojës.

- Po çfarë do të bësh në Portugali?

- Helena do të tentojë të më helmojë me gatime ekzotike, ndërsa unë do të pikturoj peizazhet e tmerrshme atje me bojëra uji.

- Nuk e dija që ti pikturoje.

- Nuk ke nga ta dish, - tha Sejmuri dhe pa i ngrysur pamjen përballë tij, kinse qe e padenjë për furçën dhe telajon e tij. - Im atë do të përpëlitej në varr sikur ta dinte që kam ardhur këtu.

- Pse ke ardhur, atëherë?

- Desha të di nëse mund të gjesh dikë për një mikun tim.

- Ka emër ky miku?

Sejmuri nuk u përgjigj, por hapi çantën e dokumenteve prej nga nxori një fotografi me përmasa 8 me 10, të cilën ia zgjati Gabrielit. Ishte fotografia e një vajze të re e të bukur që e kishte parë në sy aparatin fotografik në çastin e shkrepjes dhe në dorë mbante një kopje të para tri ditëve të "International Herald Tribune".

- Madalena Hart? - pyeti Gabrieli.

Sejmuri pohoi me kokë, pastaj i zgjati Gabrielit një fletë formati A4, mbi të cilën ishte shkruar një fjali e vetme, me shkrimin *sans serif*:

Keni shtatë ditë kohë, në të kundërt, vajza është e vdekur...

- Dreqin! - tha Gabrieli nën zë.

- Nuk është edhe aq keq.

Rastësisht, menaxheri i "Mbretit David" e kishte vendosur Graham Sejmurin, djalin e vetëm të Artur Sejmurit, në të njëjtin krah të hotelit që ishte shkatërruar në vitin 1946. Në fakt, dhoma e Sejmurit ishte në të njëjtin korridor me dhomën që babai i tij e pat përdorur si zyrë gjatë ditëve të zymta të Mandatit Britanik në Palestinë. Me të mbërritur, ata gjetën tabelën "Mos më shqetësoni" që varej ende në derën e tij, bashkë me tufën e gazetave. Sejmuri e udhëhoqi Gabrielin brenda në dhomë. Aty, i kënaqur që gjatë mungesës së tij në dhomë nuk kishte hyrë askush, futi një DVD në kompjuterin e tij *notebook* dhe shtypi butonin "ndize". Pas disa sekondash, në ekran u shfaq Madalena Harti, qytetarja britanike dhe anëtarja e partisë në pushtet, e shpallur e humbur.

- "Për herë të parë, bëra dashuri me kryeministrin Xhonatan Lankaster, pas një konference të partisë, në tetor të vitit 2012..."

5

HOTELI "MBRETI DAVID", JERUSALEM

Videoja ishte shtatë minuta dhe dymbëdhjetë sekonda e gjatë. Gjatë gjithë regjistrimit, vështrimi i Madalenës ishte i fiksuar në një pikë paksa në të majtë të kamerës, a thua se po u përgjigjej pyetjeve të një gazetari televiziv. Dukej e trembur dhe e rraskapitur teksa përshkruante si e përhumbur se si ishte njohur me kryeministrin gjatë një vizite të tij në zyrat qendrore të partisë në Millbenk. Lankasteri kishte shprehur konsideratë të lartë për punën e Madalenës dhe në dy raste, e kishte ftuar të shkonte ajo vetë në *Downing Street* për ta informuar. Në fund të vizitës së saj të dytë atje, ai kishte pranuar se interesi i tij ndaj Madalenës nuk ishte vetëm profesional. Marrëdhënia e parë seksuale kishte qenë e shkurtër dhe e shpejtë, në një dhomë hoteli në Mançester. Më pas, Madalena shoqërohej nga një mik i kryeministrit në rezidencën në *Downing Street*, sa herë që Diana Lankaster ishte jashtë Londrës.

- Tani, - tha Sejmuri i ngrysur teksa ekrani i kompjuterit fikej, - kryeministrin e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, po e ndëshkojnë për mëkatet e tij me një orvatje të patakt për shantazh.

- Nuk ka asgjë të patakt në këtë mes, Graham. Kushdo qoftë që e ka organizuar këtë, e ka ditur mirë që kryeministri kishte një lidhje

jashtëmartesore dhe arritën ta zhduknin nga Korsika pa lënë gjurmë dashnoren e tij. Afërmendsh, qenkan shumë të sofistikuar.

Sejmuri nxori diskun nga kompjuteri pa bërë zë.

- Kush tjetër është në dijeni për këtë?

Sejmuri shpjegoi se si tri objektet, fotografia, shënimi dhe DVD-ja, ishin shfaqur para portës së Simon Hjuitit mëngjesin e kaluar, se si Hjuiti i çoi në *Downing Street* ku ia tregoi Xheremi Falonit dhe më pas, ai dhe Faloni ishin përballur me Lankasterin në zyrën e tij. Gabrieli, që kishte jetuar së fundmi në Mbretërinë e Bashkuar, i njihte mirë të gjitha këto personazhe. Hjuiti, Faloni dhe Lankasteri ishin trinia e shenjtë e politikës britanike. Hjuiti ishte motori, Faloni strategu dhe intriganti, dhe Lankasteri talenti i lindur për politikë.

- Pse të zgjodhi ty për këtë punë Lankasteri? - pyeti Gabrieli.

- Baballarët tanë kanë punuar bashkë në Shërbimin Sekret.

- Nuk ma do mendja se e ka bërë vetëm për këtë.

- Ja ku është, - tha Sejmuri sikur ta pranonte, - quhet Sidik Husein.

- Kam frikë se nuk më thotë gjë ky emër.

- Nuk habitem, - tha Sejmuri, - sepse falë meje, Sidiku u zhduk nga qarkullimi para disa vjetësh, për të mos u parë apo dëgjuar më kurrë për të.

- Kush ishte ai?

- Sidik Huseini ishte një pakistanez me banim në *Tower Hamlets*, në Londrën Lindore. Ai u shfaq në ekranet e radarëve tanë pas bombardimeve të vitit 2007, kur, më në fund, na erdhën mendtë dhe filluam të kapnim radikalët islamikë nëpër rrugë. Ti i mban mend mirë ato ditë, - tha Sejmuri i hidhëruar, - kur majtistët dhe mediet këmbëngulën që ne të bënim diçka për terroristët që gjendeshin mes nesh.

- Vazhdo, Graham.

- Sidiku shoqërohej me ekstremistë të njohur të xhamisë së Londrës Lindore dhe numri i telefonit të tij celular shfaqej vazhdimisht atje ku nuk duhej. Çova një kopje të dosjes së tij në *Scotland Yard*, por Komanda e Kundërterrorizmit tha se nuk kishte provat e duhura për të ndërmarrë ndonjë veprim kundër tij. Pastaj, Sidiku bëri diçka që më dha mundësi ta zgjidhja vetë atë problem.

- Çfarë bëri?

- Rezervoi një biletë avioni për në Pakistan.

- Gabim trashanik...

- Fatal, thuaj, - tha Sejmuri ende i ngrysur.

- Çfarë ndodhi më pas?

- E ndoqëm deri në aeroportin "Heathrow" dhe u siguruam që ai të fluturonte për në Karaçi. Pastaj, unë i bëra një telefonatë miqësore një miku të vjetër në Lengli, Virxhinia. Ti e merr me mend se kujt i telefonova, apo jo?

- Adrian Karterit.

Sejmuri pohoi me kokë. Adrian Karteri ishte drejtori i Shërbimit Kombëtar për Klandestinët, i CIA-s. Në agjenci, ai i përdorte luftën globale ndaj terrorizmit dhe programet e tij dikur sekrete, për të ndaluar dhe marrë në pyetje operativët me vlera të larta.

- Skuadra e Karterit e ndoqi Sidikun në Karaki për tri ditë, - vazhdoi Sejmuri. - Pastaj i hodhën një thes në kokë dhe e nxorën jashtë shtetit me avionin e parë për të huajt e padëshiruar.

- Ku e çuan?

- Në Kabul.

- Në Gropën e Kripës?

Sejmuri pohoi me kokë ngadalë.

- Sa zgjati atje?

- Varet se kë pyet. Sipas versionit të agjencisë për ngjarjen, Sidiku u gjend i vdekur në qelinë e tij, dhjetë ditë pas mbërritjes në Kabul. Familja e tij ngriti një padi me pretendimin se ai vdiq nga torturat.

- Ç'lidhje ka kjo me kryeministrin?

- Kur avokatët që përfaqësonin familjen e Sidikut kërkuan gjithë dokumentet e MI5-s që kishin lidhje me atë çështje, qeveria e Lankasterit nuk ua dha, me argumentin se kjo mund të dëmtonte sigurinë kombëtare britanike. Ai më shpëtoi karrierën.

- E tani ti do t'i shlyesh borxhin duke u përpjekur t'i shpëtosh lëkurën?

Kur Sejmuri nuk u përgjigj, Gabrieli foli sërish:

- Kjo punë do të përfundojë keq, Graham, dhe kur të ndodhë kjo, emri yt do të shfaqet i pari në hetimin e pashmangshëm.

- Unë e kam sqaruar që nëse ndodh kjo, unë do t'i fundos të gjithë bashkë me veten, edhe Lankasterin.

- Nuk kam menduar asnjëherë se je naiv, Graham.

- Unë mund të jem gjithçka, vetëm naiv jo.

- Atëherë, ik. Kthehu në Londër dhe thuaji kryeministrit të dalë para gjithë kamerave bashkë me të shoqen dhe të bëjë apel publik që rrëmbyesit ta lirojnë vajzën.

- Tanimë është vonë për këtë. Pastaj, - shtoi Sajmuri, - mund të të dukem prapanik, por ti e di si më kërcen damari kur kërcënojnë liderin e vendit tim, apo jo?

- E di lideri i vendit tënd që ti je në Jerusalem?

- Po tallesh tani, me siguri.

- Përse më zgjodhe mua?

- Sepse nëse MI5-a ose ata të Shërbimit Sekret përpiqen ta gjejnë vajzën, informacioni do të rrjedhë, ashtu si ndodhi me Sidik Huseinin. Pastaj, ti je mjeshtër për të gjetur gjëra, - shtoi Sejmuri me qetësi. - Kolonat e lashta, vjedhjet e pikturave të Rembrandtit...

- Më vjen keq, Graham, por unë...

- Natyrisht, edhe sepse i je borxhli Lankasterit, - ia preu fjalën në mes Sejmuri.

- Unë i jam borxhli Lankasterit?

- Kush kujton se të lejoi të fshiheshe në Kornuoll me emër të rremë kur asnjë shtet tjetër nuk të pranonte? Kush të lejoi të rekrutoje një gazetar britanik kur të duhej të depërtoje në rrugën e furnizimeve nukleare të Iranit?

- Nuk e dija që mbaheshin shënim të gjitha.

- Nuk i mbajmë, - tha Sejmuri, - por sikur t'i mbanim, do të na detyroheshe shumë.

Të dy burrat ranë në një heshtje të sikletshme, a thua se i bezdisi kjo kthesë që mori biseda. Sejmuri shikonte tavanin, Gabrieli shënimin: Keni shtatë ditë kohë, në të kundërt, vajza është e vdekur...

- Si i vagullt ky mesazh, apo jo?

- Ndoshta, por na ra në kokë, - tha Sejmuri. - Tërhoqi vëmendjen e Lankasterit.

- Nuk kërkojnë asgjë?

Sejmuri tundi kokën.

- Me siguri që do ta thonë çmimin e tyre në minutën e fundit. Duan që Lankasteri të jetë aq i dëshpëruar për të shpëtuar imazhin e tij politik, sa të jetë i gatshëm të paguajë çdo çmim.

- Sa vlen kryeministri juaj këto kohë?

- Herën e fundit që "i hodha një sy" llogarive të tij bankare, - tha Sejmuri me ton hokatar, - kishte më shumë se njëqind milion.

- Sterlina?

Sejmuri pohoi me kokë.

- Xhonatan Lankasteri bëri miliona në bashki, ka trashëguar miliona nga familja e tij dhe gjithashtu u martua me milionat e Diana Balduinit. Është objektiv i përsosur; një njeri që ka më shumë para nga sa i duhen dhe shumë për të humbur. Diana dhe fëmijët jetojnë të sigurt brenda flluskës së Numrit 10 e kësisoj janë të paprekshëm nga rrëmbyesit, ama, dashnorja e Lankasterit... - aty zëri i Sejmurit u fashit. Pak çaste më pas, ai shtoi: - Dashnorja është tjetër muhabet.

- Nuk ma do mendja se Lankasteri i ka përmendur ndonjë gjë për këtë të shoqes, apo jo?

Sejmuri bëri me dorë një gjest që tregonte se ai nuk merrte pjesë në bisedat e brendshme të martesës së Lankasterit.

- Graham, ti je marrë ndonjëherë me një çështje rrëmbimi?

- Jo që pas asaj që ndodhi në Irlandën e Veriut. Edhe ato kishin të bënin të gjitha me IRA-n.

- Rrëmbimet për shkaqe politike nuk janë si rrëmbimet kriminale, - tha Gabrieli. - Rrëmbyesi juaj është treguar i zgjuar. Kush do që t'i lirohen shokët nga burgu ose që të ndryshojnë politikat, rrëmben ndonjë politikan me rëndësi ose një autobus me fëmijë shkolle dhe i mban ata peng derisa të plotësohen kërkesat e tij. Ndërsa kriminelët duan vetëm para. Edhe kur i paguan, ata kërkojnë *më shumë*. Kështu që ai do të vazhdojë të bëjë shantazh derisa të mendojë se ka zhvatur gjithçka.

- Atëherë besoj se kemi vetëm një zgjidhje.

- Cila është kjo?

- Të gjejmë vajzën.

Gabrieli eci deri te dritarja, hodhi vështrimin drejt Malit të Tempullit e për një çast u rikthye me mendje në shpellën sekrete pesëdhjetë metra poshtë sipërfaqes, me Eli Lavonin në krahë, teksa gjaku i tij vijëzohej në malin e shenjtë. Gjatë netëve të gjata që kaloi duke i ndenjur te koka në spital Lavonit, Gabrieli u betua të mos shkelte më kurrë në fushëbeteja sekrete. Ndërsa tani, një mik i vjetër rishfaqet duke shkundur pluhurin e së kaluarës dhe i kërkon një nder. Edhe një herë, Gabrieli lufton me veten për të gjetur fjalët për ta dëbuar, për ta kthyer mbrapsht duarbosh. Si fëmija i vetëm i mbijetuar i Holokaustit, ai nuk e kishte për zakon t'i zhgënjente të tjerët. I rregullonte në qytet dhe i takonte, por rrallëherë u thoshte jo.

- Edhe sikur ta gjej, - tha ai pas një copë here, - rrëmbyesit do të kenë ende videon ku ajo rrëfehet për lidhjen e saj me kryeministrin.

- Ajo video do të ketë rëndësi tjetër nëse trëndafili i Anglisë kthehet në tokën mëmë.

- Gjithnjë nëse atëherë nuk i teket trëndafilit të Anglisë të flasë.

- Ajo është besnike e partisë. Nuk do ta bënte kurrë këtë!

- Ti as që e ke idenë se ç'i kanë bërë asaj, - u përgjigj Gabrieli. - Tani ajo mund të jetë shndërruar si njeri.

- E drejtë, - tha Sejmuri, - por edhe ne po flasim në tym, më duket. Kjo bisedë është e pakuptimtë nëse ti dhe njerëzit e tu nuk ndërmerrni një operacion për ta gjetur Madalena Hartin për llogarinë time.

- Unë nuk kam autoritet për t'i vënë njerëzit e mi në dispozicionin tënd, Graham. Ky është një vendim që e merr Uzi dhe jo unë.

- Uzi e ka dhënë lejen e tij, - tha Sejmuri shpejt e shpejt. - Po ashtu edhe Shamroni.

Gabrieli e vështroi Sejmurin me habi, por nuk foli.

- Ti vërtet mendon se Ari Shamroni do të kishte lejuar që unë të afrohesha qoftë edhe njëqind metra ty pa qenë ai në dijeni? - pyeti Sejmuri. - Aq merak sa të ka ai ty!

- Ka një mënyrë të çuditshme për të ma vërtetuar këtë, ama! Gjithsesi, kam frikë se në Izrael ekziston dikush që ka më shumë pushtet se Shamroni, të paktën kur bëhet fjalë për mua.

- Gruaja jote?

Gabrieli pohoi me kokë.

- Kemi shtatë ditë kohë, në të kundërt, vajza është e vdekur.

- Gjashtë ditë, - tha Gabrieli. - Vajza mund të jetë në çdo cep të botës dhe nuk kemi ende asnjë pistë.

- Kjo nuk qëndron tërësisht, - tha Sejmuri dhe zgjati dorën në çantën e tij prej nga nxori dy fotografi të Interpolit, ku shfaqej njeriu me të cilin Madalena Harti kishte drekuar ditën e zhdukjes së saj. Njeriu, këpucët e të cilit nuk linin gjurmë. Njeriu i harruar.

- Kush është ky?

- Pyetje me vend, - tha Sejmuri, - por nëse arrin të gjesh se kush është ai, me siguri do të gjesh edhe Madalena Hartin.

6

MUZEU I IZRAELIT, JERUSALEM

Gabrieli mori vetëm një gjë nga Graham Sejmuri, fotografinë e Madalena Hartit, të cilën e mbajti me vete nëpër Jerusalem derisa arriti te muzeu. Pasi la makinën në parking, privilegj që i ishte dhënë vetëm së fundmi, ai eci nëpër hollin e hyrjes me xhama, deri në dhomën ku ndodhej koleksioni i artit europian. Në një qoshe vareshin nëntë piktura të Impresionizmit që dikur kishin qenë në pronësi të një bankieri zviceran me emrin Augustus Rolfe. Një afishe përshkruante rrugëtimin e gjatë që ato piktura kishin bërë nga Parisi e deri aty; si ishin plaçkitur nga nazistët në vitin 1940 dhe si i ishin transferuar më pas Rolfes, në shkëmbim të shërbimeve të kryera ndaj Shërbimit Sekret Gjerman. Afishja nuk e përmendte faktin që Gabrieli dhe vajza e Rolfes, violinistja e re, Ana Rolfe, i kishin zbuluar ato piktura në një kasafortë në Zyrih, as faktin që një shoqatë biznesmenësh zviceranë kishte punësuar një vrasës me pagesë nga Korsika për t'i vrarë ata të dy.

Në galerinë fqinje shihje të varura në mur punimet e artistëve izraelitë. Tre prej tyre ishin të nënës së Gabrielit. Në to përfshihej edhe një pikturë e "Marshimit të vdekjes" në Aushvic, në janar të vitit 1945, të cilën ajo e kishte punuar vetëm duke vënë në punë kujtesën. Gabrieli kaloi disa minuta duke kundruar mjeshtërinë e saj para se të nisej për në kopshtin

e skulpturave. Në skajin më të largët të tij ndodhej "Faltorja e librit" në formë zgjoi bletësh, e cila ruante edhe "Pergamenat e Detit të Vdekur. Pranë tij ndodhej struktura më e re e muzeut, një ndërtesë moderne e bërë prej xhami dhe hekuri, 28 metra e gjatë, 9 metra e gjerë dhe 14 metra e lartë. Për momentin, e gjitha ishte e veshur me një letër katrama të patejdukshme, duke i bërë kësisoj pjesët e brendshme të saj, njëzet e dy kolonat e Tempullit të Solomonit, të padukshme për botën e jashtme. Përgjatë dy anëve të ndërtesës dhe në hyrjen e saj që shihte nga lindja, sikundër edhe Tempulli origjinal i Solomonit, qëndronin roja të armatosura deri në dhëmbë. Vetëm një element i ekspozitës e bënte atë thuajse projektin më kontrovers nga pikëpamja kuratoriale në mbarë botën. Haredimët ultraortodoksë të Izraelit e kishin shpallur atë ekspozitë si një fyerje ndaj Perëndisë, që një ditë mund të shpinte edhe në shkatërrimin e shtetit hebre, ndërsa në Jerusalemin Lindor Arab, ruajtësit e Xhamisë së Gurit i kishin shpallur ato kolona si një rreng të mirëmenduar. "Nuk ka ekzistuar asnjëherë një tempull brenda Malit të Tempullit", pat shkruar kryemyftiu i Jerusalemit në një artikull të botuar në *New York Times*, "dhe nuk ka ekspozitë muzeale që ta ndryshojë këtë fakt". Me gjithë betejat e ashpra fetare e politike që zhvilloheshin për atë ekspozitë, ajo kishte përparuar me hapa galopantë. Vetëm pak javë pas zbulimit të Gabrielit, ishin aprovuar planet arkitekturore, ishin mbledhur fonde dhe ishin hapur themele. Merita ishte kryesisht e drejtoreshës dhe kryeinxhinieres së projektit, me origjinë italiane. Në publik, ajo përmendej me emrin e saj të vajzërisë, Kiara Zolli, por të gjithë pjesëmarrësit e projektit e dinin se emri i saj i vërtetë ishte Kiara Alon. Kolonat ishin vendosur në atë mënyrë që i kishte gjetur Gabrieli: në dy rreshta të drejtë, me një hapësirë prej përafërsisht gjashtë metra nga njëra-tjetra. Njëra prej tyre, ajo më e larta, ishte e nxirë nga flakët e zjarrit që babilonasit ndezën natën kur rrëzuan tempullin dhe që hebrenjtë e lashtë e mendonin si banesën e Zotit në tokë. Ishte kolona pas së cilës ishte kapur Eli Lavon kur po i afronte vdekja dhe pikërisht atje, Gabrieli gjeti Kiarën. Ajo mbante një kapëse letrash në njërën dorë dhe me dorën tjetër tregonte drejt tavanit prej xhami. Kishte veshur xhinse të zbardhura, sandale të sheshta dhe një bluzë të bardhë pa mëngë, e cila i qëndronte ngushtë sipër linjave të saj. Krahët e zhveshur i ishin nxirë nga

dielli i Jerusalemit dhe flokët e gjatë e të lëshuar shkujdesur ishin me fije të panumërta në ngjyrë ari. Gabrieli mendoi se ajo ishte shumë e bukur dhe tepër e re për të qenë bashkëshortja e një ngordhësire si puna e tij.

Sipër, dy teknikë po rregullonin ndriçimin për ekspozitën, ndërsa Kiara i mbikëqyrte nga poshtë. U foli në hebraisht, por me theks italian. Si e bija e kryerabinit në Venecia, ajo e kishte kaluar fëmijërinë në botën mendjengushtë të getos së vjetër[2] prej së cilës u largua kur bëri masterin për Histori Romake, në Universitetin e Padovas. Më pas, u kthye në Venecia pas diplomimit dhe filloi punë në një muze të vogël hebre në geton e re, ku ajo mund të kishte ngecur përfundimisht, po të mos e kishte pikasur një gjetës talentesh gjatë një vizite në Izrael. Ai u prezantua në një kafene në Tel Aviv dhe e pyeti Kiarën nëse ishte e interesuar për të bërë më shumë për hebrenjtë, sesa të punonte në një muze e ta ngryste jetën në atë geto. Pasi kaloi një vit në programin sekret të trajnimit të Byrosë, Kiara u kthye në Venecia, këtë herë si një agjente e Shërbimit Sekret Izraelit. Një ndër detyrat e saj të para ishte të mbronte krahët e një vrasësi kokëkrisur të Byrosë, me emrin Gabriel Alon, i cili kishte shkuar në Venecia për të restauruar kryeveprën e Belinit, Shën Zakarinë. Ajo iu prezantua atij pak kohë më vonë, në Romë, pas një shkëmbimi zjarri me policinë italiane. I mbetur i vetëm me Kiarën në një apartament të Byrosë, Gabrieli ishte ndezur i tëri, qoftë edhe për ta përkëdhelur pak atë. Por kishte pritur derisa ishte zgjidhur çështja në fjalë dhe ishin kthyer në Venecia. Atje, në një shtëpi përgjatë lumit, në Kanarexhio, ata iu dhanë njëri-tjetrit për herë të parë, në një shtrat të përgatitur enkas, me çarçafë të freskët e të bukur. Për Gabrielin, ishte sikur të bënte dashuri me një perëndeshë të pikturuar nga dora e Veroneses.

Tani, perëndesha ktheu kokën dhe, sapo vuri re praninë e Gabrielit, buzëqeshi. Sytë e saj të mëdhenj me forma orientale kishin ngjyrë karamele dhe nuanca të arta, një kombinim që Gabrieli nuk kishte arritur asnjëherë ta hidhte në kanavacë. Kiara kishte rënë dakord prej muajsh të pozonte për të, por ekspozita nuk i kishte lënë shumë kohë. Kjo kishte ndryshuar diçka edhe në martesën e tyre. Përgjithësisht ishte Gabrieli ai

[2] Ghetto di Venezia - ishte një zonë në Venecia ku hebrenjtë venecianë ishin të detyruar të jetonin gjatë periudhës së Republikës së Venecias.

që angazhohej me punë që i merrnin thuajse gjithë kohën, qoftë në lidhje me pikturën, qoftë në lidhje me ndonjë operacion të fshehtë; ama, tani, ishin ndërruar rolet. Kiara, zakonisht një vajzë e organizuar dhe shumë e kujdesshme në çdo aspekt, ishte rrëmbyer nga puna për ekspozitën.

Ajo eci deri te kolona tjetër dhe pa se si binte drita mbi të.

- Nuk ka shumë që telefonova në apartament dhe nuk u përgjigj njeri, - i tha ajo.

- Po haja zëmër me Graham Sejmurin te "Mbreti David".

- Ah, bukuri! - tha ajo me ironi dhe pastaj, ende me sytë nga kolona, e pyeti: - Çfarë ka në atë zarf?

- Një ofertë për punë.

- Me porosi të kujt?

- Nuk e di.

- Për çfarë çështjeje bëhet fjalë?

- Për një vajzë me emrin Madalena Hart.

Gabrieli u kthye në kopshtin e skulpturave dhe u ul në një vend që shihte nga kodrat e pjesës perëndimore të Jerusalemit. Pak minuta më vonë, pranë tij u ul edhe Kiara. Flokët ia ledhatonte një fllad i ëmbël vjeshte. Kaloi pas veshit një tufë që i kishin rënë mbi fytyrë dhe pastaj hodhi njërën këmbë sipër tjetrës, në një mënyrë që njëra sandale i varej nga këmba e nxirë nga rrezet e diellit. Papritur, gjëja e fundit që Gabrieli donte të bënte, ishte të largohej nga Izraeli e të kërkonte një vajzë që as që e njihte.

- Ta sqarojmë edhe një herë këtë punë, - tha ajo më në fund. - Çfarë kishte në atë zarf?

- Një fotografi.

- Çfarë fotografie?

- Një fotografi që vlente si provë që dikush është ende në jetë.

Kiara zgjati dorën. Gabrieli ngurroi ta zgjaste të tijën.

- Je e sigurt?

Kur Kiara pohoi me kokë, Gabrieli i dorëzoi zarfin dhe e pa teksa ajo e hapi dhe nxori prej andej fotografinë. Teksa e shihte me vëmendje,

fytyrën e saj e mbuloi një hije. Ishte hija e një trafikanti armësh rus, me emrin Ivan Karkov. Gabrieli i kish marrë gjithçka Ivanit; biznesin e tij, punën, gruan dhe fëmijët. Pastaj, Ivani ishte kundërpërgjigjur duke i marrë Kiarën. Operacioni për shpëtimin e saj kish qenë më i përgjakshmi në karrierën e gjatë të Gabrielit. Gjatë tij, ai kishte vrarë njëmbëdhjetë nga operativët e Ivanit. Pastaj, në një rrugicë të qetë në San Trope, kishte vrarë edhe Ivanin. Injeksionet me ketaminë që njerëzit e tij i kishin bërë Kiarës, kishin bërë që ajo të dështonte fëmijën që priste dhe jo vetëm kaq, por ishin bërë shkak që ajo të mos mund të mbetej më kurrë shtatzënë. Tani, në heshtje, ajo i kishte humbur shpresat se një ditë mund të bëhej nënë. E futi sërish fotografinë në zarf dhe ia ktheu atë Gabrielit. Pastaj dëgjoi me vëmendje teksa ai i tregoi se si çështja kishte përfunduar deri te Graham Sejmuri e më pas edhe tek ai.

- Domethënë, kryeministri i Britanisë po e detyron Graham Sejmurin të bëjë punët e tij të pista, - tha ajo pasi mbaroi Gabrieli, - dhe Grahami po bën të njëjtën gjë me ty.

- Unë e kam shok Grahamin.

Fytyra e Kiarës nuk shprehte asgjë. Sytë e saj, që zakonisht ishin pasqyrë e pastër e mendimeve të saj, ishin fshehur pas syzeve të diellit.

- Çfarë mendon se duan ata? - pyeti ajo pas një hopi.

- Para, - ia ktheu Gabrieli. - Ata gjithmonë para duan.

- Pothuajse gjithmonë, - tha Kiara. - Sepse ndonjëherë kërkojnë edhe gjëra që zor se gjenden. - Ajo hoqi syzet, i vari në bluzë dhe e pyeti: - Sa kohë ke përpara se ta vrasin?

Kur Gabrieli u përgjigj, ajo tundi kokën ngadalë e tha:

- Më duket e pamundur! Nuk e gjen dot për kaq kohë.

- Shikoje godinën pas shpinës sate dhe pastaj më thuaj prapë që nuk e gjej dot.

Por Kiara nuk ia shqiti sytë fytyrës së Gabrielit.

- Policia franceze ka më se një muaj që e kërkon Madalena Hartin. Pse mendon se ti mund ta gjesh?

- Ndoshta ata nuk kanë kërkuar në vendet e duhura ose nuk kanë pyetur njerëzit e duhur.

- Ti nga do ta nisje kërkimin?

- Unë jam pionier i idesë se hetimi nis nga skena e krimit.

Kiara hoqi syzet nga bluza dhe i pastroi në heshtje mbi pantallonat xhins. Gabrieli e dinte që kjo ishte shenjë e keqe. Kiara e kishte zakon të pastronte diçka sa herë që mërzitej.

- Mjaft se i gërvishte, aq shumë po i fërkon.

- E po, janë bërë shumë pis, - ia ktheu ajo aty për aty.

- Ndoshta duhet të blesh një kuti syzesh, në vend që t'i hedhësh vend e pa vend në çantë.

Ajo nuk u përgjigj.

- Kiara, ti më habit.

- Pse?

- Sepse ti, më shumë se kushdo, e di që Madalena Hart po shikon ferrin me sy, për së gjalli, dhe atje do të mbetet derisa dikush të shkojë e ta shpëtojë.

- Dakord, por do të doja të shkonte dikush tjetër, jo ti.

- E po, nuk ka tjetër.

- Nuk ka tjetër si ty, - tha ajo duke vëzhguar syzet dhe u ngrys.

- Çfarë ke?

- Qenkan gërvishtur vërtet.

- Të thashë.

- Ti ke gjithmonë të drejtë, zemra ime.

Vuri prapë syzet dhe hodhi vështrimin nga qyteti, para se të thoshte:

- Me siguri që Uzi dhe Shamroni ta kanë dhënë bekimin e tyre, apo jo?

- Grahami kishte folur me të dy ata para se të vinte tek unë.

- Djalë i zgjuar tjetri, jo shaka, - tha ajo duke u ngritur në këmbë. - Unë duhet të kthehem tani. Nuk na ka mbetur shumë kohë nga inaugurimi.

- Ke bërë një punë të shkëlqyer, Kiara.

- Shiko se nuk ma prish dot mendjen me këto lajka.

- Thashë ta provoja njëherë.

- Kur do të shihemi?

- Kam vetëm shtatë ditë kohë për ta gjetur.

- Gjashtë, - e korrigjoi ajo. - Gjashtë, në të kundërt, vajza është e vdekur.

Ajo u përkul dhe e puthi lehtë në buzë. Pastaj u kthye dhe eci përgjatë kopshtit të rrahur anembanë nga rrezet e diellit duke lëvizur buzët ngadalë, a thua se po ndiqte një këngë që vetëm ajo mund ta dëgjonte. Gabrieli nuk ia ndau sytë derisa u zhduk brenda godinës së mbuluar me letër katrama. Papritur, gjëja e fundit që donte të bënte ishte të largohej nga Jerusalemi dhe të kërkonte një vajzë që as e njihte.

Gabrieli u kthye në hotelin "Mbreti David", për të marrë pjesën tjetër të gjërave nga Graham Sejmuri: shënimin me kërcënimin, DVD-në me rrëfimin e Madalenës dhe dy fotografitë e burrit në restorantin "Les Palmiers", në Kalvi. Përveç atyre, ai kërkoi edhe një dosje personale të partisë për Madalenën, e cila duhej të dërgohej në një adresë në *Nice*.

- Si shkoi me Kiarën? - e pyeti Sejmuri.

- Në këtë çast, martesa ime është në krizë më të rëndë sesa ajo e Lankasterit.

- Mund të bëj unë ndonjë gjë për të të ndihmuar?

- Po. Largohu sa më parë nga qyteti dhe mos ia zër në gojë emrin tim as kryeministrit tënd dhe as ndonjë tjetri në *Downing Street*.

- Po si do të lidhemi bashkë?

- Do të të sinjalizoj unë sapo të kem ndonjë të re. Deri atëherë, zëre se nuk ekzistoj për ty.

Me këto fjalë, Gabrieli u largua. Kur u kthye në apartamentin në rrugën "Narkiss", mbi tavolinë gjeti një brez parash, në të cilin gjendeshin dyqind mijë dollarë. Pranë tij ndodhej një biletë për fluturimin e orës katër për në Paris. Bileta ishte rezervuar në emrin Johanes Klemp, një ndër pseudonimet e tij të parapëlqyera. Kur hyri në dhomën e gjumit, bëri gati një valixhe të vogël me rrobat gjermane moderne të zotit Klemp, prej të cilave një veshje e la mënjanë: një kostum të zi dhe një pulovër po të zi, për udhëtimin me avion. Pastaj, teksa shihej në pasqyrën e tualetit, bëri disa ndryshime të vogla në paraqitjen e tij të jashtme; shtoi pak nuancë thinjash, vuri një palë syze gjermane dhe një palë lente ngjyrë kafe për të fshehur sytë e tij të shkruar. Brenda pak minutash, as ai vetë nuk po e njihte më fytyrën që e shihte nga pasqyra. Tani, nuk ishte më Gabriel Aloni,

engjëlli hakmarrës i Izraelit. Tani ishte Johanes Klempi nga Mynihu, një burrë më se i gatshëm për të rrezikuar, një pako burrë me një çip të vendosur në mënyrë të dyshimtë në atë pako shpatullën e tij. Pasi u vesh me kostumin e zi të herr Klempit dhe hodhi kolonjën e tij të tmerrshme, u ul në tavolinën e tualetit të Kiarës dhe hapi kutinë e saj të bizhuterive. Një prej bizhuterive nuk ishte në vendin e vet. Ishte një varëse me një rrip të hollë lëkure në të cilën varej një koral i kuq në formën e dorës. Ai e mori dhe e futi në xhep. Pastaj, as vetë nuk e kuptoi pse, por e vari në qafë, duke e futur poshtë pulovrit të herr Klempit.

Poshtë në rrugë e priste një *Sedan Office*. Gabrieli hodhi çantën në ndenjësen e pasme dhe më pas hipi edhe vetë. Pastaj i hodhi një sy orës së dorës, jo për të parë orën, por datën. Ishte data 27 shator. Dikur, kjo ishte dita e tij e parapëlqyer e vitit.

- Si e ke emrin? - e pyeti ai shoferin.

- Lior.

- Nga je, Lior?

- Nga *Beersheba*.

- Ke kaluar fëmijëri të lumtur atje?

- Ka edhe vende më të këqija.

- Sa vjeç je?

- Njëzet e pesë.

Njëzet e pesë, mendoi Gabrieli. Pse dreqin duhej të ishte njëzet e pesë vjeç? Hodhi sërish sytë nga ora e dorës. Jo për të parë orën, por datën.

- Çfarë udhëzimesh ke marrë? - e pyeti ai shoferin, i cili rastësisht na ishte njëzet e pesë vjeç.

- Më kanë thënë të të çoj në aeroportin "Ben Gurion".

- Po tjetër?

- Më thanë se rrugës mund të ndalosh diku.

- Kush të tha? Ata të Uzit?

- Jo, - ia ktheu shoferi. - Më tha plaku.

Pra, ai e mbajtka mend, mendoi Gabrieli. Hodhi sërish sytë nga ora. *Data...*

- Atëherë? - pyeti shoferi.

- Më ço në aeroport, - tha Gabrieli.

- Pa ndalesa?

- Do ta bëjmë një ndalesë.

Shoferi e nisi makinën ngadalë, a thua se ishin në një ceremoni mortore. As që e mori mundimin të pyeste se ku do të shkonin. Data shënonte 27 shtator dhe Shamroni e mbante mend mirë.

Ata kaluan nëpër kopshtin "Gethsemane" dhe më pas ndoqën rruginën e ngushtë që të çonte në malin e Ullinjve. Gabrieli hyri vetëm në varreza dhe eci përmes qivureve të shumta derisa mbërriti tek ai i Daniel Alonit. Lindur më 27 shtator 1988 dhe vdekur më 13 janar 1991. Ai ndërroi jetë një natë me borë në Distriktin e Parë të Vjenës, në një automobil *Mercedes* ngjyrë blu, që u hodh në erë dhe u bë shkrumb e hi. Bomba ishte vendosur nga një terrorist palestinez me emrin Tarik al-Hourani, me urdhër të drejtpërdrejtë të Jaser Arafatit. Nuk kishte qenë Gabrieli objektivi i tyre; ata nuk ishin aq shpirtmirë. Tariku dhe Arafati donin ta ndëshkonin duke e detyruar të shikonte me sytë e tij teksa i vdisnin e shoqja dhe i biri, në mënyrë që ai ta kalonte jetën duke vajtuar për ta, si bënin palestinezët. Vetëm se një element i komplotit, dështoi. Lea i mbijetoi ferrit. Tani ajo jeton në një spital psikiatrik në majë të malit Herzl, e ngujuar në një burg kujtimesh dhe një trup të shkatërruar nga flakët. E prekur nga një sindromë stresi post-traumatik dhe depresioni psikik, shpesh ajo e harron aksidentin, por hera-herës ka edhe çaste kthjellimi. Gjatë një interludi të tillë, ajo i dha leje Gabrielit të martohej me Kiarën. *Shiko si jam katandisur, Gabriel. Nuk ka mbetur më asgjë nga ajo që isha. Asgjë, përveç një kujtimi.*

Gabrieli hodhi sërish sytë nga ora. Këtë herë, jo për datën, por për orën. Kishte kohë për t'u përshëndetur për herë të fundit, për të derdhur edhe një palë lot, për të kërkuar edhe një herë falje që nuk e kontrolloi makinën për ndonjë bombë para se ta lejonte Lean ta ndizte. Pastaj, u kthye duke iu marrë këmbët nëpër korridorin e gurtë, atë ditë që ishte dita e tij e parapëlqyer e vitit, dhe hipi në ndenjësen e pasme të *Sedan*-it që drejtohej nga një njëzetepesëvjeçar. Djaloshi u tregua i matur dhe nuk foli asnjë fjalë rrugës për në aeroport. Gabrieli hyri në terminal si një

udhëtar i zakonshëm, por më pas shkoi në një dhomë të rezervuar vetëm për anëtarët e Byrosë dhe atje priti të jepej njoftimi për fluturimin e tij. Kur u ul në klasin e parë të avionit, sepse pati një dëshirë të ngutshme për t'i telefonuar Kiarës, gjë që nuk ishte aspak profesionale. Vetëm se në vend që të bënte këtë, veproi ashtu si e kish mësuar Shamroni që në rininë e tij: e largoi nga mendja. Tani, nuk ekzistonin më as Kiara dhe as Danieli. Po ashtu, nuk ekzistonte as Lea. Tani ekzistonte vetëm Madalena Hart, dashnorja e kryeministrit britanik Xhonatan Lankaster, të cilën e kishin rrëmbyer. Teksa avioni ngrihej në qiellin e errët, ajo iu shfaq Gabrielit para syve, në një punim vaji në kanavacë, si Suzana që lahej në kopshtin e saj. Sipër saj, mbi mur, ishte një burrë me fytyrë kockëdalë dhe një gojë të vogël e mizore. Ai ishte burri pa emër dhe pa kombësi. Burri i harruar.

7

KORSIKË

Korsikanët thonë se kur i afrohesh ishullit të tyre me anije, aroma e bimësisë së tij unike mund të ndihet kohë përpara se të duket vija e tij e thyer bregdetare, ama, Gabrieli nuk përjetoi asnjë lloj ndjesie të tillë, sepse mbërriti në ishull nga ajri, me avionin e parë nga Orli. Vetëm kur e pa veten pas timonit të një makine të tipit *Peugeot* të marrë më qira, duke shkuar në aeroportin e Ajacios, ia përkëdhelën flegrat aromat e rozmarinës, gjineshtrës, trëndafilit të egër dhe lules së gurit, të kodrave atypari. Korsikanët, këtë aromë e quanin *macchia* dhe me të në mendje gatuanin, ngrohnin shtëpinë e madje edhe gjenin strehë në kohë lufte apo hakmarrjeje. Sipas një legjende korsikane, nëse dikë e ndiqnin, mjaftonte të nuhaste një herë *macchia*-n dhe nuk e gjente dot më askush. Gabrieli e njihte një njeri të tillë. Pikërisht prandaj mbante në qafë një varëse lëkure me një dorë të kuqe korali.

Pasi udhëtoi për ndonja gjysmë ore, Gabrieli e la rrugën e bregut dhe u fut më thellë në ishull. Aty, aroma e *macchia*-s sikur të mbyste, ashtu si edhe qytezat e vogla kodrinore përreth. Korsika, si toka e lashtë e Izraelit, ishte pushtuar shumë herë. Por, pas rënies së Perandorisë Romake, vandalët e plaçkitën aq pa mëshirë Korsikën saqë pjesa më e madhe e banorëve të ishullit morën arratinë dhe u tërhoqën në sigurinë që u ofronin malet.

Madje ata edhe tani u trembeshin të huajve. Në një fshat të izoluar, një plakë e tregoi Gabrielin me gishtin tregues dhe atë të vogël, për të larguar efektin e *occhju*-së, syrit të keq.

Përtej fshatit, rruga ishte diçka më e gjerë se një rrugë me një korsi, e rrethuar nga të dy krahët me *macchia*. Pas afro një kilometri e gjysmë, ai mbërriti para portës së një prone private. Porta ishte e hapur, por në hyrje të saj qëndronte një makinë e parkuar, në të cilën qëndronin disa truproja. Gabrieli fiku makinën, vendosi duart mbi kofanon e saj dhe priti që truprojat të afroheshin. Më në fund, njëri prej tyre doli dhe u afrua pa ndonjë ngut. Mbante një armë në njërën dorë dhe një tjetër të futur në brezin e pantallonave. E pyeti Gabrielin për arsyen e vizitës vetëm duke ngritur një prej vetullave të tij të trasha.

- Kam ardhur të takoj donin, - i tha Gabrieli frëngjisht.

- Ai është shumë i zënë me punë, - ia ktheu truproja në dialektin korsikan.

Gabrieli nxori talismanin nga poshtë pulovrit dhe ia dha atij. Korsikani vuri buzën në gaz dhe tha:

- Të shoh se ç'mund të bëj.

Në ishullin e Korsikës ishte e lehtë t'u hipte gjaku në kokë njerëzve. Mund të ishte një fyerje, një akuzë për mashtrim në biznes, prishja e një marrëveshjeje, prishja e një fejese apo shtatzënia e një vajze të pamartuar. Pas shkëndijës së parë, pasonte zallamahia e madhe. Fillimisht vritej ndonjë dem, pritej një pemë e mirë ulliri a digjej ndonjë shtëpi. Pastaj fillonin vrasjet që do të vazhdonin zinxhir, ndonjëherë edhe për më shumë se një brez, derisa palët në konflikt të zgjidhnin problemin ose të dorëzoheshin prej lodhjes së gjatë.

Shumica e meshkujve korsikanë parapëlqenin t'i bënin vetë vrasjet, por kishte edhe nga ata që pajtonin të tjerë për të marrë gjakun. Këta të fundit ishin kryesisht sëra e lartë, shumë të dobët për t'i ndyrë duart vetë ose që nuk ua mbante të rrezikonin t'i kapte policia apo të jetonin në arrati më pas. Kishte pastaj edhe femra, të cilat nuk mund të bënin

vetë vrasje ose nuk kishin një mashkull që ta bënte këtë punë për to. Pra, njerëz të tillë pajtonin vrasës profesionistë të njohur si *taddunaghiu*. Përgjithësisht, këta njerëz i drejtoheshin për ndihmë klanit Orsati. Ata kishin toka pjellore me shumë ullishte dhe thuhej se bënin vajin e ullirit më të mirë në Korsikë. Por ata nuk ishin vetëm prodhues të vajit të ullirit. Askush nuk e dinte se sa korsikanë kishin dhënë jetë në duart e vrasësve të klanit Orsati ndër vite, por vendasit thoshin se numri i të vrarëve ishte me mijëra e mund të kishte qenë shumë më i madh po të mos ekzistonte shqyrtimi i hollësishëm brenda klanit. Klani i Orsatit vepronte në bazë të një kodi shumë të rreptë. Ata nuk pranonin të kryenin asnjë vrasje pa u bindur më parë se pala që do të godisnin ishte vërtet fajtore dhe duhej të ndëshkohej. Por natyrisht, kishte gjithnjë një përjashtim dhe ky përjashtim shkonte për don Anton Orsatin. Kur ai mori në dorë drejtimin e familjes, policia franceze kishte arritur t'i çrrënjoste armiqësitë dhe hasmëritë në çdo cep të Korsikës, përveç disa xhepave të izoluar të ishullit dhe për pasojë, disa korsikanë mund të kërkonin ende ndihmën e *taddunaghiu*-ve. Pasi kërkesa e vendasve nisi të binte ndjeshëm, Orstatit nuk i mbeti veçse të kërkonte mundësi gjetiu, kryesisht përtej detit, më në qendër të Europës. Tanimë ai pranonte pothuajse çdo punë që i ofrohej, sado e papëlqyeshme të ishte ajo dhe vrasësit e tij njiheshin si më të besuarit dhe më profesionistët në kontinent. Në fakt, Gabrieli ishte një prej vetëm dy njerëzve në botë që i kishin mbijetuar një sulmi nga familja Orsati. Ndonëse Orsati ishte nga një familje korsikane me prejardhje fisnike, për nga pamja nuk dallonte hiç nga fshatari që bënte rojë te porta e pronës së tij. Teksa hynte përmes derës së madhe të studios së tij, Gabrieli e pa të ulur në tryezën e punës. Kishte veshur një këmishë të bardhë disi të zbërdhulur, pantallona të gjera pambuku të zbehtë dhe një palë sandale të mbuluara nga pluhuri që dukeshin sikur ishin blerë në tregun e madh. Ia kishte ngulur sytë një libri të vjetër llogarish dhe dukej tejet i ngrysur. Gabrieli nuk e dinte se nga buronte gjithë kjo pakënaqësi e donit. Shumë kohë më parë, Orsati i kishte shkrirë dy bizneset e tij në një kompani të vetme. *Taddunaghiu*-të e tij të ditëve moderne ishin të gjithë punonjës të fabrikës së vajit të ullirit "Orsati" dhe vrasjet që ata kryenin, porositeshin si kërkesa për vaj ulliri.

Duke u ngritur, Orsati i shtriu Gabrielit dorën e tij si prej graniti, pa asnjë shprehje në fytyrë.

- Është nder t'ju pres ju, *monsieur* Alon, - tha ai frëngjisht. - T'ju them të drejtën, kisha kohë që ju prisja. Ju njiheni si kundërshtar shumë i ashpër.

- Armiqtë e mi ishin bankierët zviceranë që ju pajtuan ju për të më vrarë, don Orsati. Por në vend që të më jepte plumbin kokës, vrasësi juaj më dha këtë, - tha Gabrieli dhe bëri me kokë nga talismani që tanimë qëndronte në tryezën e Orsatit, pranë librit të llogarive. Doni mblodhi vetullat, pastaj e kapi talismanin nga varësja e lëkurtë, duke lejuar që korali i kuq të valëvitej sa para mbrapa, si akrepat e një ore në mur.

- Ishte një pakujdesi e pafalshme, - tha ai më në fund.

- Që la talismanin apo që më la mua gjallë?

Orsati vuri buzën në gaz, pa miratuar as njërën dhe as tjetrën dhe tha:

- Ne në Korsikë kemi një shprehje që thotë: "I solda un venini micca cantendu; nuk fitohen paratë duke kënduar". Pra, paratë fitohen duke punuar dhe këtej nga anët tona punë janë ato kontrata, edhe kur bëhet fjalë për violinistë me famë apo oficerë të Shërbimit Sekret Izraelit.

- Pra, ua kthyet paratë atyre që ju kërkuan të më vrisnit?

- Ata ishin bankierë zviceranë, nuk vuanin për para, - tha Orsati, mbylli librin e llogarive dhe e vendosi talismanin sipër tij. - Sikundër duhet ta kesh marrë me mend, të kam vëzhguar ndër vite. Ke pasur shumë punë qëkurse rrugët tona u ndeshën. Në të vërtetë, disa nga punët më të mira i ke bërë në tokën time.

- Kjo është hera e parë që vij në Korsikë, - e kundërshtoi Gabrieli.

- E kisha fjalën për jugun e Francës, - iu përgjigj Orsati. - E vrave ti atë terroristin saudit, Zizi al-Bakarin, në portin e vjetër të Kanës, apo jo? Pastaj pate atë problemin e vogël me Ivan Karkovin në San Trope para disa vitesh.

- Unë di që Ivanin e vranë ca rusë të tjerë, - u përgjigj Gabrieli.

- Ivanin e vrave *ti*, Alon. E vrave sepse të rrëmbeu gruan.

Gabrieli heshti. Korsikani vuri sërish buzën në gaz, këtë herë me sigurinë e dikujt që e di mirë se goditi në shenjë.

- *Macchia* nuk ka sy, por sheh gjithçka, - tha ai.

- Pikërisht kjo është arsyeja e vizitës sime.

- E mora me mend që do të ishte kjo. Helbete, një burrë si ti sigurisht që nuk vjen të kërkojë vrasës profesionistë këtu. Atë punë e bën vetë më së miri.

Gabrieli nxori nga xhepi një tufë parash dhe i vendosi mbi librin e vdekjeve të Orsatit, pranë talismanit. Doni bëri sikur nuk i pa dhe tha:

- Si mund të të ndihmoj, Alon?

- Kam nevojë për disa informata.

- Në lidhje me çfarë?

Pa thënë asnjë fjalë, Gabrieli vendosi fotografinë e Madalena Hartit pranë tufës së parave.

- Vajza angleze?

- Nuk po më dukeni i habitur, don Orsati.

Korsikani nuk foli.

- E dini se ku ndodhet?

- Jo, - ia ktheu ai. - Por kam një ide se kush mund ta ketë rrëmbyer.

Gabrieli nxori fotografinë e burrit të "Les Palmiers". Orsati tundi një herë kokën dhe Gabrieli e pyeti:

- Kush është ky?

- Nuk e di. E kam takuar vetëm një herë.

- Ku?

- Ja, në këtë zyrë, një javë para zhdukjes së vajzës angleze. Ishte ulur pikërisht në atë karrige ku je ulur edhe ti tani. Por ai kishte më shumë para sesa ti, Alon. Shumë më tepër.

8

KORSIKË

Ishte drekë, koha e parapëlqyer e ditës për don Orsatin. Ata u ulën në tarracën jashtë studios së tij, në një tavolinë të shtruar plot e përplot me bukë korsikane, djathë, perime dhe salsiçe. Dielli shndrinte përtej kodrave dhe përmes një korijeje me pisha, Gabrieli mund të shihte edhe detin blu në të gjelbër, përtej tyre. Aroma e *macchia*-s ndihej ngado. Ajo lodronte në ajrin e freskët dhe ngrihej nga ushqimet. Edhe Orsati vetë sikur e rrezatonte atë. Ai mbushi gotën e Gabrielit me një verë të kuqe si gjaku dhe pastaj preu disa copa nga salsiçet e mëdha korsikane. Gabrieli nuk bëri asnjë pyetje në lidhje se me çfarë mishi bëheshin ato. Sikundër thoshte Shamroni, ndonjëherë është më mirë të mos bëzash.

- E di që më vjen mirë që nuk të vramë? - tha Orsati duke ngritur lehtë gotën.

- Ju siguroj se kjo është reciproke, don Orsati.

- Do më salsiçe?

- Ju lutem.

Orsati preu edhe dy copa të tjera të trasha dhe i vendosi në pjatën e Gabrielit. Pastaj vendosi një palë syze dhe këqyri mirë e mirë fotografinë e burrit në "Les Palmiers".

- Në këtë fotografi duket si ndryshe, por pa dyshim që është ai.

- Si ndryshe?

- Modeli i flokëve, për shembull. Kur erdhi të më takonte mua, i kishte lyer me vaj dhe i mbante të ngjitura pas kokës.

- Jua tha emrin?

- Tha se quhej Pol.

- Po mbiemrin?

- Nuk di më shumë se kaq unë.

- Çfarë gjuhe fliste ky miku ynë, Poli?

- Frëngjisht.

- Si vendasit?

- Jo, se ç'kishte një theks.

- Çfarë theksi?

- Nuk e përcaktova dot, - tha doni duke shtrembëruar vetullat, - por më la përshtypjen sikur e kishte mësuar frëngjishten me kaseta magnetofoni. Fliste saktë, por në të njëjtën kohë edhe nuk ishte në rregull.

- Ma do mendja se nuk e kishte gjetur në numëratorin telefonik emrin tuaj.

- Jo, Alon. Erdhi me rekomandim.

- Çfarë rekomandimi?

- Një emër.

- Emrin e dikujt që ju ka pajtuar më parë se ai?

- Kjo ndodh zakonisht.

- Për çfarë pune ju pajtoi?

- Për një nga ato punët ku hyjnë dy burra në një dhomë, por vetëm njëri prej tyre del dhe mos harxho frymën kot që të më pyesësh për emrin e njeriut që e kishte rekomanduar se nuk ta them, - shtoi Orsati shpejt e shpejt. - Mos harro që po flasim për biznesin tim.

Me një ulje të lehtë të kokës, Gabrieli i la të kuptonte se nuk kishte ndër mend t'i hynte më thellë kësaj pike, të paktën për momentin. Pastaj e pyeti donin përse ai njeri kishte shkuar tek ai.

- Donte një kështillë, - u përgjigj Orsati.

- Çfarë kështille?

- Më tha se kishte një produkt për të transportuar dhe i duhej dikush me një jaht të shpejtë, dikush që i njihte ujërat tona dhe mund të lëvizte

natën. Sigurisht, duhej të ishte dikush që dinte ta mbante gojën mbyllur.

- Produkt?

- Mund të të duket e çuditshme, por nuk hyri në detaje për llojin e produktit.

- Ju menduat se ishte trafikant, - tha Gabrieli, më shumë duke ia bërë fakt të kryer sesa duke e pyetur.

- Korsika është një pikë kyçe e trafikut të heroinës nga Lindja e Mesme për në Europë. Që ta dish, - shtoi ai aty për aty, - Orsatët nuk merren me drogë, paçka se me raste, dihet se kemi eliminuar ndonjë anëtar të shquar të tregtisë së saj.

- Për para, natyrisht.

- Sa më i madh peshku, aq më e madhe gjoba.

- Ai ndenji këtu te ju?

- Po patjetër, - tha doni dhe më pas duke ulur zërin, shtoi: - Ndonjëherë ne edhe mallin tonë e lëvizim natën, Alon.

- Kur thoni mallin tuaj, e keni fjalën për kufoma?

Doni mblodhi supet dhe u orvat të fliste me fjalë të zgjuara:

- Ato janë nënprodukte të pafata të biznesit tonë. Përgjithësisht, ne përpiqemi t'i lëmë atje ku "bien", por ka edhe raste kur klienti paguan një tarifë të caktuar që na detyron t'i zhdukim përgjithmonë. Në këto raste, ne i vendosim në arkivole betoni dhe i dërgojmë në fund të detit. Vetëm Perëndia e di se sa njerëz ka atje poshtë.

- Sa ju pagoi Poli?

- Njëqind mijë.

- Si i ndatë?

- Gjysmën unë dhe gjysmën ai i jahtit.

- Vetëm gjysmën i dhatë atij?

- Aq edhe të më falënderojë madje.

- Po kur dëgjuat që u zhduk vajza angleze?

- Natyrisht që më lindën dyshime. Pastaj, pashë fotografinë e Polit nëpër gazeta... - Aty zëri i donit sikur u shua dhe shtoi: - Dhe më mbeti pak hatri, në fakt. Unë nuk dua andralla. Ato nuk i bëjnë mirë biznesit.

- Ju nuk merreni me rrëmbime vajzash të reja?

- Kam përshtypjen se edhe ti nuk merresh me këso gjërash.

Gabrieli nuk foli.

- Nuk ta kisha me të keq, - i tha doni sinqerisht.

- Nuk ka problem, don Orsati.

Doni mbushi pjatën e tij me speca dhe patëllxhanë të pjekur dhe u hodhi sipër vaj ulliri "Orsati". Gabrieli piu pak verë, e përgëzoi donin për cilësinë e saj dhe pastaj e pyeti për emrin e atij tipit të jahtit të shpejtë, i cili njihte edhe ujërat lokale. Pyetjen e bëri si të ishte pyetja më e zakonshme në botë.

- Po hyjmë në ujëra të rrezikshme, - tha Orsati. - Unë bëj vazhdimisht biznes me këta njerëz dhe nëse mësojnë se i tradhtova te një njeri si ti, më ngatërron keq, Alon.

- Don Orsati, ju siguroj se ata nuk do ta marrin vesh kurrë burimin e informacionit tim.

Orsati nuk dukej aspak i bindur.

- Pse është kjo vajzë kaq e rëndësishme sa e kërkon Gabriel Aloni i madh?

- Le të themi se ajo ka miq të fuqishëm.

- Miq? - tha Orsati dhe tundi kokën me dyshim. - Nëse i ke hyrë ti kësaj pune, ajo ka më shumë se miq të fuqishëm.

- Ju jeni njeri i zgjuar, don Orsati.

- *Macchia* nuk ka sy, - tha doni me një zë misterioz.

- Më duhet medoemos emri i tij, - tha Gabrieli me qetësi. - Ai nuk do ta marrë vesh kurrë se kush ma tha.

Orsati mori gotën e tij me verën e kuqe si gjaku, e ngriti në drejtim të diellit dhe pas pak çastesh, tha:

- Të isha në vendin tënd, do të flisja me një burrë që quhet Marsel Lakrua. Ndoshta ai mund të dijë se ku shkoi vajza pasi u largua nga Korsika.

- Ku mund ta gjej këtë njeri?

- Në Marsejë, - u përgjigj Orsati. - Jahtin e mban në Portin e Vjetër.

- Në cilën anë të tij?

- Në anën jugore, përkundër Galerisë së Artit.

- Si e ka emrin jahti?

- "Vallëzo me Hënën".

- Bukuri! - tha Gabrieli.

- Të siguroj se Marsel Lakruaja nuk ka asgjë të bukur dhe po ashtu, as njerëzit për të cilët punon ai. Të këshilloj të ruash kokën në Marsejë.

- Mund të mos e besoni, don Orsati, por nuk është hera e parë që e bëj këtë punë.

- Këtë e di, por ti do të kishe vdekur me kohë, - tha Orsati dhe i vendosi talismanin në dorë. - Këtë vëre në qafë. Të mbron nga më shumë sesa thjesht syri i keq.

- Në të vërtetë, - ia ktheu Gabrieli, - unë po pyesja veten nëse keni ndonjë gjë më të fuqishme sesa kjo.

- Çfarë, për shembull?

- Ndonjë armë.

Doni vuri buzën në gaz dhe tha:

- Kam diçka edhe më të fuqishme sesa arma.

Gabrieli ndoqi rrugën kryesore derisa mbërriti në një rrugë dytësore gjithë pluhur dhe pastaj eci edhe ca më tej. Dhia plakë ishte pikërisht atje ku i tha don Orsati se do të ishte, pak para kthesës së fortë majtas, nën hijen e tre ullinjve të lashtë. Teksa Gabrieli afrohej, ajo u ngrit nga vendi ku ishte ulur dhe doli në qendër të rruginës së ngushtë, duke ngritur nofullën kryeneçe, a thua se po e sfidonte Gabrielin për të kaluar aty. Ashtu si ai, edhe ajo dukej e rraskapitur nga betejat e vazhdueshme. Ai bëri fare pak përpara me makinë me shpresën se dhia do të dorëzohej pa luftuar, por kafsha nuk tundej nga e saja. Gabrieli hodhi sytë nga arma që i kishte dhënë don Orsati. Ishte një beretë 9mm që ndodhej mbi ndenjësen e përparme, e mbushur plot. Mjaftonte t'i fuste një plumb në lule të ballit dhisë dhe kjo histori mbyllej me kaq, por nuk ishte e mundur; dhia, ashtu si edhe tre ullinjtë e lashtë, i përkisnin don Kasabiankës dhe sikur Gabrieli t'i prekte asaj qoftë edhe një fije floku, aty derdhej gjak. I ra dy herë borisë, por dhia nuk lëvizte nga vendi. Pastaj, doli nga makina duke psherëtirë dhe provoi të arsyetonte me kafshën; fillimisht i foli frëngjisht, pastaj italisht dhe në fund, i dëshpëruar, i foli në gjuhën

hebraike. Dhia reagoi duke ulur kokën dhe duke e drejtuar atë sikur po bëhej gati ta godiste te testikujt. Por Gabrieli, i cili besonte se mbrojtja më e mirë është ajo e duhura, mori fuqi dhe hapi krahët e nisi të ulërinte si ndonjë i çmendur. E befasuar, dhia u kthye në çast dhe u zhduk në një të çarë mes *macchia*-s. Gabrieli u kthye shpejt e shpejt te makina, derën e së cilës e kishte lënë të hapur, por u ndal vrik sapo dëgjoi një tingull që përngjante me kukurisjen e një zogu përqeshës. U kthye dhe ngriti sytë nga vila në ngjyrë okre në anë të kodrës ngjitur. Në tarracën e saj kishte dalë një burrë biond i veshur i tëri në të bardha. Edhe pse nuk mund të ishte i sigurt, Gabrielit iu duk se ai burrë po qeshte si i marrë.

9

KORSIKË

Burri që e priti Gabrielin në vilë nuk ishte korsikan, ose të paktën nuk kishte lindur i tillë. Emri i tij i vërtetë ishte Kristofer Keler dhe ishte rritur në një shtëpi të shtresës së lartë në Kensington, një nga zonat më luksoze të Londrës. Megjithëkëtë, në Korsikë vetëm don Orsati dhe disa nga të tijtë ishin në dijeni të këtij fakti. Për pjesën tjetër të ishullit, Keleri njihej thjesht si anglezi. Historia e Kristofer Kelerit nga Kensingtoni në ishullin e Korsikës, ishte ndër më intrigueset që Gabrieli kishte dëgjuar në jetë dhe kjo besoj se mjafton për ta kuptuar rëndësinë e saj. Ai ishte djali i vetëm i dy mjekëve që punonin në rrugën "Harley" në Londër dhe ua kishte bërë të qartë atyre që në moshë të hershme se nuk kishte ndër mend të ecte në gjurmët e tyre. Ai ishte i pasionuar pas historisë, sidomos asaj ushtarake dhe kishte dëshirë të shkonte ushtar. Prindërit e ndaluan të hynte në ushtri dhe për njëfarë kohe ai ua bëri qejfin. U regjistrua në *Cambridge* dhe nisi të lexonte histori dhe gjuhët orientale. Ishte student i shkëlqyer, por në vitin e dytë filloi të bëhej problematik derisa një mbrëmje u zhduk pa lënë gjurmë. Pak ditë më pas u shfaq në shtëpinë e të atit në Kensington, me kokën qeros dhe i veshur me uniformë ushtarake. Ishte regjistruar në ushtrinë britanike. Pasi përfundoi trajnimin bazë, Keleri iu bashkua një njësie këmbësorie,

por me intelektin, shkathtësinë dhe sjelljen prej ujku të vetmuar, shumë shpejt tërhoqi vëmendjen e Forcave Speciale Ajrore. Vetëm pak ditë pas mbërritjes së tij në shtabin e përgjithshëm të regjimentit, në Hereford, u vu re qartë se Keleri kishte gjetur thirrjen e tij në jetë. Rezultatet e tij në "shtëpinë e vrasjeve", një godinë famëkeqe ku rekrutët praktikonin luftimin me dyer të mbyllura dhe shpëtimin e pengjeve, ishin më të lartat të regjistruara ndonjëherë, ndërsa instruktorët e tij të kursit të luftimit të paarmatosur shënuan se nuk kishin parë kurrë ndonjëherë dikë me një instinkt aq të rrallë për t'i marrë jetën tjetrit. Trajnimi i tij kulmoi me një marshim prej gjashtëdhjetë e pesë kilometrash përmes shqopishtës së njohur me emrin "Brecon Beacons", një sprovë ku kishin humbur jetën shumë veta para tij. I ngarkuar me një çantë shpine që peshonte njëzet e pesë kilogramë dhe një pushkë pesë kilogramë, Keleri theu rekordin me tridhjetë minuta, rekord që mbetet i pathyer edhe sot e kësaj dite. Fillimisht, ai u caktua në një nga skuadrat Sabre, që specializoheshin në betejat në shkretëtirë, por karriera e tij shpejt mori një rrjedhë tjetër kur u njoh me dikë nga Shërbimet Sekrete Ushtarake. Ai njeri ishte në kërkim të një ushtaraku unik, i cili mund të kryente shërbime speciale dhe detyra të tjera në Irlandën e Veriut. Që atë natë Keleri bëri gati valixhen dhe u shpërngul nga Herefordi në një bazë sekrete në malet e Skocisë. Gjatë stërvitjes atje, Keleri nxori në pah edhe një dhunti tjetër të tij. Për vite me radhë, Sigurimi dhe Shërbimi Sekret Anglez kishin luftuar me një sërë komunitetesh në Irlandën e Veriut. Në Ulster, komunitetet në konflikt e identifikonin njëri-tjetrin nga tingulli i zërit dhe mënyra se si pëshpëritnin disa shprehje, për ta mund të bënte ndryshimin mes jetës dhe vdekjes së kobshme. Keleri arriti t'i imitonte më së miri të gjitha ato dialekte. Madje, mundej të kalonte aty për aty nga dialekti i komunitetit katolik në Armagh, nga ai protestant në atë të rrugës "Belfast's Shankill" dhe sërish nga dialekti katolik në atë të banorëve të Bollimërfit. Ai veproi për më shumë se një vit në Belfast, ku gjurmonte anëtarë të njohur të IRA-s duke mbledhur thashetheme nga vendasit. Natyra e punës së tij përfshinte edhe zhdukjen e tij nga vëzhgimi i oficerëve për javë të tëra. Shërbimit të tij në Irlandën e Veriut i erdhi fundi papritmas një mbrëmje, kur e rrëmbyen në Belfastin Perëndimor dhe e çuan në një fermë të izoluar

në kontenë Armagh. Atje, e akuzuan se kishte vrarë një agjent britanik. Keleri e kuptoi se gjendej në një rrugë pa krye dhe vendosi të luftonte për të shpëtuar lëkurën. Kur arriti të arratisej nga ferma, la pas katër terroristë të armatosur rëndë të Ushtrisë Republikane Provizore Irlandeze, dy prej të cilëve ishin bërë copë e çikë. Keleri u kthye në Hereford me mendimin se do të bënte një pushim të gjatë dhe do të punonte ca kohë si instruktor, por qëndrimit atje i erdhi fundi në gusht të vitit 1990, kur Sadam Huseini pushtoi Kuvajtin. Keleri iu bashkua menjëherë skuadrës së vjetër Sabre dhe në janar të vitit 1991 ai ndodhej në shkretëtirën perëndimore të Irakut, duke kërkuar raketahedhësit Skud që po bënin terror në Tel Aviv. Natën e 28 janarit, Keleri dhe skuadra e tij lokalizuan një raketë afro njëqind e gjashtëdhjetë kilometra në veriperëndim të Bagdadit dhe ua dërguan menjëherë koordinatat komandantëve të tyre në Arabinë Saudite. Nëntëdhjetë minuta më pas, një formacion i koalicionit të avionëve luftarakë u vendos në qiellin mbi shkretëtirë, por gjatë sulmit, ata goditën një skuadrilje të Forcave Speciale Ajrore në vend që të godisnin raketahedhësit Skud. Zyrtarët britanikë arritën në përfundimin se i gjithë njësiti kishte humbur jetën, përfshi këtu edhe Kelerin. Në nekrologjitë që u shkruan për të nuk u përmend asnjëherë fakti që ai kishte punuar për Shërbimin Sekret në Irlandën e Veriut apo që kishte masakruar katër terroristë të IRA-s në fermën në kontenë Armagh. Megjithatë, zyrtarët e lartë të ushtrisë britanike nuk e dinin që Keleri kishte shpëtuar pa asnjë gërvishtje. Fillimisht, ai mendoi të njoftonte me radio bazën dhe eprorët e tij për t'u kërkuar ta merrnin prej atje, por në fund, i zemëruar nga paaftësia e eprorëve të tij, nisi të ecte në këmbë. I fshehur nën petkat e një veshjeje tipike arabe dhe i stërvitur mirë në artin e lëvizjeve klandestine, Keleri arriti të depërtonte forcat e koalicionit dhe të kalonte pa u diktuar në Siri. Mandej, eci drejt perëndimit përmes Turqisë, Greqisë dhe Italisë, derisa më në fund doli në brigjet e Korsikës ku don Orsati e priti krahëhapur. Ai i dha Kelerit një vilë dhe një femër për të shëruar plagët e tij të shumta. Pastaj, pasi Keleri ishte çlodhur e rehatuar, i dha edhe punë. Me pamjen e tij perëndimore dhe stërvitjen në Forcat Speciale Ajrore, Keleri i bëri don Orsatit punë që *taddunaghiu*-të e tij korsikanë as që e çonin nëpër mend t'i bënin. Një prej atyre punëve ishte edhe ajo me emrat e Ana Rolfit dhe

Gabriel Alonit. Për arsye që kishin lidhje me ndërgjegjen, Keleri nuk e kreu dot atë detyrë, por krenaria profesionale e detyroi të linte pas talismanin e tij, talismanin që tani Gabrieli e mbante në pëllëmbën e dorës.

Për fat të mirë, Gabrieli dhe Keleri ishin takuar një herë më parë, para shumë vitesh, kur Keleri dhe disa oficerë të tjerë të Forcave Speciale Ajrore kishin shkuar në Izrael për t'u stërvitur në disa teknika antiterrorizmi. Në ditën e fundit të qëndrimit atje, Gabrieli më në fund kishte pranuar t'u mbante leksion për një nga operacionet e tij më të vështira - vrasjen e Abu Xhihadit në vitin 1988, numrit dy të Organizatës Çlirimtare Palestineze, në shtëpinë e tij në Tuniz. Keleri kishte zënë vend në rreshtin e parë dhe dëgjonte me ëndje çdo fjalë të Gabrielit dhe më pas, teksa bënin disa fotografi në grup, ai ishte vendosur në krah të tij. Gabrieli kishte vënë syze dielli dhe kapelë për t'u maskuar deri diku, por Keleri e kishte parë kamerën në sy. Ajo ishte një ndër fotografitë e fundit të dokumentuara për Kelerin.

Tani, teksa Gabrieli zbriste nga makina e marrë me qira, njeriu që ia kurseu njëherë jetën qëndronte në portën e folesë së tij korsikane. Ai ishte një kokë më i gjatë se Gabrieli dhe shumë më i gjerë në kraharor dhe në shpatulla. Njëzet vite nën diellin e Korsikës e kishin ndryshuar edhe më tej paraqitjen e tij të jashtme. Lëkura tanimë i kish marrë një ngjyrë më të pjekur dhe flokët sikur i ishin zbardhur edhe më nga uji i detit. Vetëm sytë blu dukej se i kishin shpëtuar ndryshimit. Ishin po ata sy që dikur e kishin parë Gabrielin me aq zjarr teksa rrëfente për vdekjen e Abu Xhihadit; po ata sy që e kishin mëshiruar atë natë me shi në Venecia.

- Do të të ftoja për drekë, - i tha Keleri me një theks anglez, - por më thanë që të mbajti don Orsati.

Kur Keleri i zgjati dorën Gabrielit, poshtë pulovrit të bardhë u formuan shenjat e muskujve të krahëve të tij. Gabrieli ngurroi për një çast para se t'ia shtrëngonte. Gjithçka e Kristofer Kelerit, që nga duart e tij si darë dhe deri te këmbët e gjata e të fuqishme, dukej se ishin krijuar me qëllimin e vetëm për të vrarë.

- Sa të tregoi don Orsati? - e pyeti Gabrieli.

- Aq sa më duhet për të të thënë se nuk duhet t'i afrohesh një njeriu si Marsel Lakruaja, pa një mbështetje.

- Domethënë, ti e njeh atë?

- Më ka bërë dikur një xhiro me makinë.

- Para apo pas?

- Edhe para, edhe pas, - tha Keleri. - Lakruaja ka qenë në ushtrinë franceze. Ka bërë edhe burg në disa nga burgjet më të vështira në vend.

- Këto fakte duhet të më bëjnë përshtypje?

- Kur njeh mirë armikun dhe veten, mund të fitosh njëqind beteja pa pësuar asnjë humbje.

- Sun Tzu, - tha Gabrieli.

- Këtë e the edhe në leksionin që mbajte në Tel Aviv.

- Domethënë, më paske dëgjuar.

Me këto fjalë, Gabrieli e kaloi Kelerin dhe hyri në sallonin madhështor të vilës. Mobiliet ishin të stilit rustik dhe ashtu si Keleri, ishin mbuluar me një cohë të bardhë. Mbi çdo sipërfaqe të sheshtë ishin vendosur tufa me libra dhe në mure vareshin disa piktura cilësore, ku përfshiheshin edhe punime më pak të shtrenjta nga *Cezane, Matis dhe Monet*.

- Nuk ke sistem alarmi? - e pyeti Gabrieli duke hedhur sytë rrotull.

- Nuk ka ç'më duhet.

Gabrieli iu afrua njërës prej pikturave të Cezanesë, një peizazh i kodrave pranë *Aix-en-Provence*, dhe kaloi gishtat butësisht sipër saj.

- E mban mirë veten, Keler.

- E po, faturat e mia i paguaj vetë.

Gabrieli nuk foli.

- Nuk je dakord me mënyrën se si e fitoj unë jetesën?

- Ti e fiton jetesën duke vrarë njerëz.

- Ashtu si edhe ti.

- Unë vras për vendin tim, - ia ktheu Gabrieli, - dhe vetëm kur është vërtet e pashmangshme.

- Prandaj ia hodhe trutë në erë Ivan Karkovit në rrugët e San Tropesë? Për vendin tënd?

Gabrieli e la kundrimin e Cezanesë dhe e pa Kelerin drejt e në sy. Kushdo tjetër do të ishte dridhur nga vështrimi i ngulët i Gabrielit, por Keleri jo. Ai mbështolli krahët e fuqishëm rreth kraharorit dhe ngriti njërin cep të buzëve në një gjysmëbuzëqeshje.

- Ndoshta nuk bëra mirë që erdha këtu, - i tha Gabrieli.

- Unë i njoh mirë si lojtarët, ashtu edhe terrenin e kësaj loje. Vetëm po të ishe budalla nuk do të më drejtoheshe mua në një rast të tillë.

Gabrieli nuk u përgjigj. Keleri kishte të drejtë; ai ishte udhërrëfyesi i duhur për në botën e krimit francez. Aftësitë e tij fizike dhe taktike me siguri që do të ishin të vyera në këtë operacion.

- Nuk kam para që të të paguaj, - i tha Gabrieli.

- Nuk më duhen para, - ia ktheu Keleri duke parë rrotull vilës së tij të bukur, - por dua të më japësh disa përgjigje para se të nisemi.

- Kemi pesë ditë kohë për ta gjetur, në të kundërt, ajo është e vdekur.

- Pesë ditë janë shumë për njerëz si ne.

- Po të dëgjoj.

- Për kë po punon këtë herë?

- Për kryeministrin britanik.

- Nuk e dija që kishe lidhje me ata.

- Me mua u lidh një person i Shërbimit Sekret Britanik.

- Në emër të kryeministrit erdhi ai?

Gabrieli pohoi me kokë.

- Ç'lidhje ka kryeministri me këtë vajzë?

- Po ja, si thua ti, ç'lidhje ka?

- O Zot i madh!

- Zoti nuk ka asnjë lidhje me kësi punësh.

- Kush ishte ky miku i kryeministrit në Shërbimin Sekret Britanik?

Gabrieli ngurroi për një çast, por pastaj u përgjigj duke thënë të vërtetën. Keleri vuri buzën në gaz dhe tha:

- Kam punuar me Grahamin në Irlandën e Veriut. Është njeri i mirë, por si të gjithë të tjerët në Angli, - shtoi aty për aty, - edhe ai mendon se unë kam vdekur. Pra, ai nuk duhet ta marrë vesh në asnjë mënyrë që unë punoj me ty.

- Për këtë të jap fjalën.

- Dua edhe diçka tjetër prej teje, - tha Keleri dhe zgjati dorën.

Gabrieli i zgjati talismanin.

- Habitem që e paske ruajtur.

- Kishte vlerë sentimentale.

Keleri e vari talismanin në qafë dhe tha buzagaz:

- Shkojmë. E di unë se ku mund të marrim një tjetër.

Signadora jetonte në një shtëpi thuajse të rrënuar në qendër të fshatit, jo shumë larg kishës. Keleri shkoi pa e njoftuar, por plaka nuk u duk aspak e befasuar kur e pa. Ajo kishte veshur një fustan të zi dhe mbante shami të zezë në kokë. E përkëdheli Kelerin në faqe me një buzëqeshje që mbartte edhe shqetësim e më pas, duke kaluar ndër gishta kryqin e rëndë që mbante në qafë, hodhi sytë nga Gabrieli. Ajo kishte për detyrë të mbronte njerëzit nga syri i keq dhe dukej e sigurt se tanimë mendonte se Keleri kishte sjellë mishërimin e djallit në shtëpinë e saj.

- Kush është ky burrë? - pyeti ajo.

- Një mik, - ia ktheu Keleri.

- Është besimtar?

- Jo si ne.

- Më thuaj si quhet, Kristofer. Më thuaj emrin e tij *të vërtetë*.

- Ai quhet Gabriel.

- Si kryeengjëlli?

- Po, - tha Keleri.

Ajo studioi me vëmendje fytyrën e Gabrielit dhe tha:

- Është nga Izraeli, apo jo?

Kur Keleri pohoi me kokë, plaka ngrysi vetullat. Nga doktrina, ajo i konsideronte hebrenjtë si heretikë, por nuk kishte asgjë personale me ta. I hapi këmishën në kraharor Kelerit dhe preku talismanin që ai kishte varur në qafë.

- Nuk është ky ai që humbe para ca vjetësh ti?

- Po, ai është.

- Ku e gjete?

- Në fund të një sirtari të mbushur me rrangulla.

Signadora tundi kokën me qortim dhe i tha:

- Po më gënjen, Kristofer. Kur do ta mësosh që unë të dalloj gjithmonë kur gënjen?

Keleri buzëqeshi, por nuk nxori asnjë fjalë nga goja. Plaka e lëshoi nga duart talismanin dhe e preku sërish Kelerin në faqe.

- Kristofer, po largohesh nga ishulli?

- Po, sonte.

Signadora nuk e pyeti pse po largohej; ajo e dinte mirë se si e fitonte bukën e gojës Keleri. Madje, dikur ajo vetë kishte pajtuar një *taddunahgiu* të ri me emrin Anton Orsati, për të marrë hak për vrasjen e të shoqit. Me një lëvizje të dorës, ajo i ftoi Kelerin dhe Gabrielin të uleshin në një tavolinë të vogël prej druri që ndodhej në sallonin e saj. Atje, u vuri përpara një pjatë të mbushur me ujë dhe një enë me vaj ulliri. Keleri zhyti gishtin tregues në enën me vaj, pastaj e mbajti mbi pjatë dhe la të binin në të tri pika vaji. Sipas ligjeve të fizikës, vaji duhej të mblidhej në një pikë të vetme, por ai u nda në mijëra copëza dhe pas pak u zhduk fare.

- Djalli është kthyer, Kristofer.

- Kam përshtypjen se është rrezik kalimtar.

- Mos u tall, i shtrenjti im. Rreziku është konkret.

- Çfarë shikon?

Ajo pa ngultas masën e lëngshme, sikur të ishte në gjendje transi. Pas pak çastesh, pyeti në qetësi:

- Ti kërkon vajzën angleze?

Keleri pohoi me kokë dhe pastaj e pyeti:

- Është gjallë?

- Po, - u përgjigj plaka, - gjallë është.

- Ku ndodhet?

- Nuk kam fuqi për të ta thënë këtë.

- A do ta gjejmë?

- Pasi të ketë vdekur, - ia ktheu plaka. - Atëherë do ta mësoni të vërtetën.

- Çfarë shikon ti?

Ajo mbylli sytë.

- Ujë... male... një armik të vjetër.

- Armiku im është?

- Jo, - tha ajo dhe hapi sytë dhe pa Gabrielin në sy. - Është armiku i këtij.

Pa thënë asnjë fjalë më tepër, ajo e mori anglezin për dore dhe nisi të lutej. Pas pak nisi të qante, shenjë kjo që djalli kishte kaluar nga trupi i Kelerit tek i saji. Pastaj i mbylli sytë dhe u duk sikur ta kishte kotur gjumi.

Kur i hapi sërish i tha Kelerit të përsëriste provën e vajit me ujin. Këtë herë, vaji u mblodh në një pikë të vetme.

- Djalli iku nga shpirti yt, Kristofer, - tha ajo dhe u kthye nga Gabrieli. - Tani e ka radhën ai.

- Unë nuk besoj në kësi gjërash, - tha Gabrieli.

- Të lutem, - i tha plaka. - Nëse nuk do ta bësh për vete, bëje për Kristoferin.

Gabrieli zhyti gishtin në vaj si me përtesë dhe pastaj la të binin tri pika në sipërfaqen e ujit. Kur vaji u shpërbë në mijëra copëza, plaka mbylli sytë dhe nisi të dridhej.

- Çfarë shikon? - e pyeti Gabrieli.

- Zjarr, - tha ajo qetësisht, - shoh zjarr.

Në orën pesë kishte një traget nga Ajacio. Gabrieli futi *Peugeot*-in e tij në hambarin e makinave në orën katër e gjysmë dhe dhjetë minuta më pas, pa të vinte edhe Keleri me *Renault*-in e tij pa portobagazh. Dhomat i kishin marrë në të njëjtën kuvertë, menjëherë sapo kaloje korridorin e madh. Dhoma e Gabrielit ishte si qeli burgu, si nga madhësia, ashtu edhe nga mobilimi. La çantën mbi krevatin e tmerrshëm dhe u ngjit në lokalin e tragetit. Kur mbërriti ai, Keleri ishte ulur në një tavolinë pranë dritares dhe po pinte birrë dhe cigare. Gabrieli tundi kokën ngadalë. Dyzet e tetë orë më parë, ai kishte qenë para një kanavace në Jerusalem, ndërsa tani ishte në kërkim të një gruaje që as e njihte, në shoqërinë e një burri që dikur kishte pranuar para për ta vrarë.

Porositi një kafe turke te banaku dhe doli në kuvertë. Trageti tanimë ishte larguar nga skela dhe ajri i mbrëmjes papritmas iu duk më i ftohtë. Gabrieli ngriti jakën e xhaketës dhe mblodhi duart rreth ngrohtësisë së filxhanit të kafesë. Yjet e lindjes shkëlqenin në qiellin pa re dhe deti që pak më parë kishte ngjyrë të bruztë, tanimë kish marrë ngjyrën e bojës së zezë. Gabrieli mendoi se mund ta ndiente aromën e *macchia*-s nën flladin e erës. Pastaj, pas një hopi, dëgjoi zërin e *signadora*-s: "Vetëm kur ajo të vdesë, do ta merrni vesh të vërtetën".

10

MARSEJË

Kur Gabrieli dhe Keleri mbërritën në Marsejë, mëngjesin tjetër, "Vallëzo me Hënën", një jaht i madh dhe i shpejtë, ishte ankoruar në vendin e zakonshëm në Portin e Vjetër. Vetëm se pronari i tij nuk dukej kurrkund. Keleri kishte krijuar një pikë vrojtimi statike në anën veriore, ndërsa Gabrieli në atë lindore, jashtë një picerie që çuditërisht mbante emrin e një lagjeje moderne në Manhatan. Ata lëvizën në pozicione të reja çdo fillim dhe fund ore, por Lakruaja nuk u duk deri pasdite vonë. Më në fund, i dëshpëruar nga ideja se humbi një ditë kot, Gabrieli doli pak nga skela, kaloi lokalet e peshkatarëve dhe iu bashkua Kelerit në *Renault*-in e tij. Moti premtonte të keqësohej; qielli ishte nxirë nga re të zeza dhe nga kodrat dëgjohej një fishkëllimë ere e ftohtë. Filloi të binte shi. Keleri nuk i fikte për asnjë çast fshirëset e xhamave, që të shikonte mirë rrugën.

- Je i sigurt që ai nuk ka apartament në qytet? - pyeti Gabrieli.

- Ai jeton në jaht.

- Po ndonjë femër nuk ka?

- Ka disa, por asnjëra nuk e mban gjatë pranë vetes.

Keleri pastroi xhamin e përparmë me kurrizin e dorës dhe shtoi:

- Unë them të marrim ndonjë dhomë hoteli më mirë.

- Nuk të duket shpejt për të marrë dhomë hoteli? Ne sapo jemi njohur.

- E ke zakon të bësh komente idiote gjatë operacioneve ti, apo si e ke hallin?

- Jo, them se është përplasje kulturash.

- Puna e komenteve idiote apo e operacioneve?

- Të dyja.

Keleri nxori një kartëpecetë nga kutia dhe bëri çmos për të zgjidhur lëmshin që bëri pak më parë në xhamin e përparmë.

- Gjyshja ime ishte hebraike, - tha ai si rastësisht, a thua se po pranonte që gjyshja e tij dikur kishte luajtur brixh.

- Urime!

- Ky ishte një tjetër koment idiot?

- E po, ç'duhet të them unë?

- Nuk të duket interesant fakti që unë kam prejardhje hebraike?

- Nga eksperienca, duhet të të them se shumica e europianëve e kanë nga një rrënjë hebraike të fshehur diku.

- Kjo e imja ishte në dritën e diellit.

- Ku kishte lindur gjyshja jote?

- Në Gjermani.

- Shkoi në Britani gjatë luftës?

- Pak përpara saj, - tha Keleri. - Shkoi te një ungj i largët, i cili nuk e konsideronte më veten hebre. Ai i dha një emër të krishterë dhe e dërgoi në kishë. Ime më vetëm pasi i kaloi të tridhjetat e mori vesh që kishte prejardhje hebraike.

- Shiko, unë nuk para kam qejf të jap lajme të këqija, por nga sa po më thua, ti nuk ke prejardhje hebraike, por je hebre.

- Të them të drejtën, gjithmonë e kam ndier veten pak hebre.

- Nuk ndien neveri nga gocat e detit dhe opera gjermane?

- E kisha fjalën në kuptimin shpirtëror.

- Ti je vrasës profesionist, Keler. Ç'më thua?

- Kjo nuk do të thotë që nuk besoj në Zot, - protestoi Keleri. - Madje pretendoj të di më shumë sesa ti për historinë dhe shkrimet tuaja të shenjta.

- Atëherë ç'do që rri me atë plakën e çmendur?

- Ajo nuk është e çmendur.

- E po, mos më thuaj që i beson ato pallavra!

- Më fal, por nga e dinte ajo që ne po kërkojmë vajzën angleze?

- Ndoshta ia ka thënë don Orsati.

- Jo, - tha Keleri duke tundur kokën. - Ajo e pa atje. Ajo shikon gjithçka.

- Edhe ujin dhe malet?

- Po.

- Keler, jemi në jug të Francës. Edhe unë shoh ujë dhe male. Madje, i shoh ngado që shkoj.

- Ty të vjen inat se të përmendi atë armikun e vjetër.

- Mua nuk më vjen inat, - tha Gabrieli. - Dhe sa për armiqtë e vjetër, mos ki merak, se e has nga një prej tyre sa dal nga porta e shtëpisë.

- E po, dil nga dera e pasme, më mirë.

- Proverb korsikan ishte ky?

- Jo, ishte këshillë miqësore.

- Ne nuk jemi akoma miq.

Keleri ngriti supet e tij katrore si për të thënë se nuk i prishej terezia nga ky koment dhe pas një copë here në heshtje, tha:

- Ç'e bëre talismanin që të dha ajo?

Gabrieli i ra gjoksit për të treguar se talismanin, i cili ishte identik me atë të Kelerit, e kishte në qafë.

- Po nëse nuk beson, pse e mban në qafë, atëherë?

- Sepse më shkon me rrobat.

- Dëgjo, të lutem, mos e hiq për asnjë arsye nga qafa. Mban larg të keqen.

- Ka disa njerëz në jetën time që do të doja t'i mbaja larg.

- Si Ari Shamronin, për shembull?

Gabrieli arriti ta fshihte mirë habinë pas kësaj fjalie dhe thjesht e pyeti:

- Nga e di ti për Shamronin?

- E kam takuar kur erdha në Izrael me tren. Pastaj, - shtoi Keleri aty për aty, - ku ka njeri në fushën tonë që nuk e njeh Shamronin? E gjithashtu, të gjithë e dinë që ai donte të bëheshe ti drejtor dhe jo Uzi Navoti.

- Keler, mos i beso të gjitha ato që lexon nëpër gazeta.

- Unë kam burime të sigurta, - tha Keleri, - dhe ato më kanë thënë edhe se ty t'u ofrua ai pozicion dhe e refuzove.

- Mund të të duket e pabesueshme, - tha Gabrieli, duke e parë ngultas përmes syzeve të tij të lagura nga shiu, - por nuk jam në humor për të gërmuar kujtimet me ty tani.

- Unë thjesht po përpiqesha të gjeja një mënyrë për të kaluar kohën.

- E po, ndoshta e kalojmë më mirë në heshtje.

- Një koment tjetër idiot ky?

- Po të ishe hebre, do ta kuptoje.

- Teknikisht, unë jam hebre.

- Kush të pëlqen më shumë, Puçini apo Vagneri?

- Vagneri, natyrisht.

- Atëherë mos thuaj më që je hebre.

Keleri ndezi një cigare dhe e fiku shkrepësen duke e tundur në ajër. Një shkulm ere solli shi me vrull mbi xhamin e makinës dhe e fshehu për një çast pamjen e skelës. Gabrieli uli pak xhamin e dritares që të dilte tymi i cigares së Kelerit.

- Ndoshta ke të drejtë, - tha ai. - Ndoshta është më mirë të marrim një dhomë në hotel.

- Nuk besoj se do të na duhet.

- Pse jo?

Keleri pastroi sërish xhamin me fshirëset e makinës, bëri me gisht në rrugë dhe tha:

- Sepse po vjen Marsel Lakruaja.

Ai kishte veshur rroba sporti të zeza dhe atlete të verdha dhe kishte një çantë *Puma* të hedhur në njërën shpatull. Dukej se kishte kaluar një pjesë të mirë të pasdites në palestër, pavarësisht se nuk dukej se ia kishte shumë nevojën asaj; Lakruaja ishte të paktën 1.85 metra i gjatë dhe peshonte më shumë se nëntëdhjetë kilogramë. Flokët e errët i kishte vajosur dhe mbledhur pas koke me një bisht të vogël. Kishte vëthë në të dy veshët dhe në qafën e trashë i dukeshin copëza

tatuazhesh me shkronja kineze, që tregonte se kishte studiuar artet marciale aziatike. Sytë nuk i reshtnin së lëvizuri edhe pse nuk i panë dot dy burrat që qëndronin në makinën e tipit *Renault* me dritare të mbuluara nga mjegulla. Gabrieli psherëtiu lehtë teksa e shihte. Lakruaja me siguri që ishte një kundërshtar i denjë, sidomos në muret e ngushta të "Vallëzo me Hënën". Pavarësisht nga gjithçka, përmasat kanë rëndësinë e tyre.

- Hë, nuk po na bën më si i zgjuar tani? - pyeti Keleri.

- Ja, se po mendohem.

- Pse nuk ma lë mua këtë punë?

- Sepse kam një parandjenjë që nuk është ide e mirë.

- Pse?

- Sepse ai e di që ti punon për donin dhe nëse shkon e i bën pyetje për Madalena Hartin, me siguri që do ta kuptojë që doni e ka tradhtuar dhe kjo shkel interesat e donit.

- Më lejo të shqetësohem unë për interesat e donit.

- Prandaj ke ardhur ti, Keler?

- Unë erdha të sigurohem që ti të mos përfundosh në ndonjë arkivol çimentoje në fund të Detit Mesdhe.

- Ka edhe vende më të këqija ku mund të të varrosin.

- Ligji hebre nuk e lejon varrosjen në det.

Keleri heshti kur Lakruaja shkeli në dok e nisi të ecte drejt jahtit "Vallëzo me Hënën". Gabrieli pa mënyrën se si rrinte nga mbrapa bluza e sportit të francezit e pastaj pa edhe çantën sportive që kishte varur në shpatull.

- Çfarë po mendon? - e pyeti Keleri.

- Që ai ka një armë në çantë.

- E vure re edhe ti?

- Mua nuk më shpëton asgjë.

- Si do t'ia bësh?

- Do ta zgjidh me qetësi.

- Çfarë të bëj unë?

- Ti rri e më prit këtu, - i tha Gabrieli duke hapur derën e makinës, - dhe po të deshi qejfi, përpiqu të mos vrasësh njeri sa të vij unë.

Në Byro kishin një rregull të thjeshtë në lidhje me përdorimin e duhur operacional të armëve të zjarrit. Ishte një doktrinë që Ari Shamronit ia kishte dhënë Zoti - të paktën kështu thoshin - dhe Shamroni nga ana e tij, ua kishte dhënë të gjithë atyre që dilnin tinëz natën për të plotësuar dëshirat e tij. Ndonëse nuk gjendej e shkruar askund, të gjithë oficerët në detyrë e dinin përmendësh dhe ishin gati ta thoshin njësoj si kur recitonin bekimin e qiririt ditën e Sabatit. "Një agjent i Byrosë e përdor armën vetëm për një arsye! Ai nuk krekoset me të si rrugaçët e rrugës për të bërë kërcënime të ulëta! Ai e nxjerr armën vetëm për ta shkrepur dhe nuk e heq dorën nga këmbëza deri sa personi të cilit ia ka drejtuar, të mos jetë më në mes të të gjallëve. Amen!" Me këto fjalë të Shamronit që i kumbonin në vesh, Gabrieli hodhi hapat e fundit drejt jahtit "Vallëzo me Hënën". Para se të hynte, ngurroi për një çast; edhe një njeri me trup hollak si të tijin do ta tundte paksa jahtin kur të shkelte në të. Kësisoj, shpejtësia dhe vetëbesimi ishin dy tiparet kyçe të këtij operacioni.

Gabrieli i hodhi sytë për herë të fundit pas shpatullës së tij të djathtë dhe pa Kelerin që e shihte me vëmendje nga vendi i shoferit të *Renault*-it. Pastaj, shkeli në jaht dhe kaloi me shpejtësi përmes pupës deri te dera e kabinës kryesore. Lakruaja kishte dalë në korridor kur mbërriti Gabrieli. Në hapësirat e ngushta të atij jahti, francezi dukej edhe më trupmadh sesa në rrugë.

- Ç'dreqin do ti në jahtin tim? - e pyeti ai.

- Më fal, - i tha Gabrieli, duke ngritur duart në shenjë dorëzimi. - Kujtova se të kishin thënë që do të vija.

- Kush të më thoshte?

- Poli, natyrisht. Nuk të tha që do të vija të të takoja?

- Poli?

- Po, Poli, - i tha Gabrieli i vendosur. - Njeriu që të pajtoi për t'i nxjerrë një pako nga Korsika. Më tha se ishe më i miri për këtë punë dhe se nëse ndonjëherë do të më duhej dikush për të transportuar ndonjë mall me vlerë, vetëm ti mund të më mbaroje punë.

Në fytyrën e francezit, Gabrieli pa disa reagime; hutim, aprovim dhe natyrisht, lakmi. Në fund, duket se fitoi lakmia. Ai bëri mënjanë dhe me një lëvizje të syve, e ftoi Gabrielin të hynte brenda. Gabrieli bëri dy hapa të ngadaltë përpara teksa skanonte brendinë e kabinës në kërkim të çantës së shpinës së Lakruasë. Ajo ndodhej mbi një tavolinë, pranë një shisheje *Pernod*.

- A mundem? - pyeti Gabrieli duke bërë me kokë nga dera e hapur. - Nuk është nga ato tema që do të doja ta ndaja me fqinjët.

Lakruaja ngurroi për një çast, pastaj shkoi te dera dhe e mbylli. Gabrieli zuri vend pranë tavolinës ku ishte edhe çanta e palestrës.

- Për çfarë pune bëhet fjalë? - e pyeti Lakruaja duke u kthyer nga ai.

- Është një punë shumë e thjeshtë. Në fakt, do të të marrë vetëm disa minuta kohë.

- Sa?

- Çfarë do të thuash? - e pyeti Gabrieli gjoja i habitur.

- Sa më paguan, them? - e pyeti Lakruaja duke fërkuar dy gishtat e parë te gishti i madh.

- Unë të ofroj diçka më me vlerë sesa paratë.

- E ç'na qenka kjo?

- Jeta jote, - i tha Gabrieli. - Marsel, tani do të më thuash çfarë bëri miku yt me vajzën angleze. Nëse nuk më tregon, do të të ndaj në njëqind copa dhe do të bëj ushqim për peshqit.

Disiplina e artit marcial izraelit, e njohur si Krav Maga, nuk shquhet për mirësi, por as për estetikë mendore. Qëllimi i vetëm i saj është të shkatërrojë ose të vrasë armikun sa më shpejt të jetë e mundur. Ndryshe nga shumë disiplina lindore, kjo disiplinë nuk përdor hedhjen e objekteve të rënda ndaj kundërshtarit me përmasa më të mëdha trupore. Në fakt, instruktorët i këshillojnë nxënësit e tyre të përdorin çfarëdolloj objekti që iu del përpara për t'u mbrojtur. Atyre u pëlqen të përdorin shprehjen "Davidi nuk u përfyt me Goliatin, por e goditi atë me një gur dhe vetëm atëherë ia preu kokën".

Gabrieli nuk zgjodhi një gur, por shishen *Pernod*, të cilën e kapi nga

gryka, e rrotulloi si të ishte thikë dhe e hodhi drejt figurës së Marsel Lakruasë që po tërbohej. Për fat, shishja e goditi mu në lule të ballit, duke i hapur një goxha të çarë horizontale sipër vetullës. Ndryshe nga Goliati, i cili ra me kokë, Lakruaja arriti të mbahej ende në këmbë për disa çaste. Gabrieli u lëshua para dhe e goditi francezin me gju te testikujt. Mandej, vazhdoi ta godiste dhunshëm edhe më lart para se t'i thyente nofullën me një goditje të saktë me bërryl. Goditja e radhës në tëmth e hodhi Lakruanë përtokë. Gabrieli u zgjat dhe preku qafën e francezit për t'u siguruar që ishte ende gjallë. Pastaj, ngriti kokën dhe pa Kelerin në derë, duke buzëqeshur.

- Mbresëlënëse, - i tha ai. - I bukur ai numri me Pernodin!

11

LARG NGA MARSEJA

Shiu pushoi menjëherë pasi perëndoi dielli, por era e ftohtë e veriut fryu pa mëshirë deri në mbrëmje vonë. Ajo fishkëllente nëpër litarët e anijeve të ankoruara në Portin e Vjetër dhe në kuvertën e jahtit "Vallëzo me Hënën" teksa Keleri e nisi atë me mjeshtëri drejt detit. Gabrieli ndenji pranë tij derisa lanë pas molin, pastaj zbriti në sallonin e jahtit ku gjendej Marsel Lakruaja, me fytyrë nga dyshemeja, i lidhur, dhe me gojën e sytë të zënë me shirit ngjitës. Gabrieli e ktheu francezin me kurriz dhe ia hoqi shiritin e syve me një lëvizje të vetme e të shpejtë. Lakruaja ishte përmendur, por në sytë e tij nuk kishte shenja frike, por zemërimi. Keleri kishte pasur të drejtë. Francezi nuk trembej kollaj. Gabrieli ia ngjiti sërish shiritin te sytë dhe nisi një kërkim të hollësishëm në të gjithë jahtin, duke nisur nga salloni dhe deri te dhoma e gjumit të Lakruasë. Si rezultat, gjeti një vend të fshehtë me lëndë narkotike të paligjshme, afro gjashtëdhjetë mijë euro para të thata, pasaporta të rreme dhe patenta në katër emra të ndryshëm, njëqind karta krediti të vjedhura, nëntë celularë në gjendje pune, një koleksion të gjerë materialesh pornografike të shtypura dhe elektronike, si dhe një faturë pas së cilës ishte shënuar një numër telefoni. Fatura ishte marrë në një vend të quajtur "Bar du Haut", në bulevardin "Jean Jaures", në Ronjak, një qytet i banuar kryesisht nga klasa punëtore, në veri të Marsejës,

jo shumë larg nga aeroporti. Ronjaku ishte si një qytet ndërlidhës. Gabrieli pa datën e faturës, pastaj kontrolloi telefonatat e bëra në të nëntë celularët, se mos gjente ndonjë telefonatë nga ai numër. E gjeti në tre prej telefonave. Në fakt, Lakruaja e kishte telefonuar dy herë, nga dy telefona të ndryshëm atë mëngjes.

Gabrieli futi celularët, faturën dhe paratë në çantën e shpinës dhe u kthye në sallon. Ia hoqi edhe një herë shiritin ngjitës nga sytë Lakruasë, por këtë herë i hoqi edhe shiritin me të cilin i kishte mbyllur gojën. Fytyra e Lakruasë tani ishte shpërfytyruar nga ënjtja që i ishte shkaktuar nga nofulla e thyer. Gabrieli ia kapi dhe e shtrëngoi fort atë duke e parë ngultas në sy.

- Do të të bëj disa pyetje, Marsel. Ke vetëm një mundësi për të më thënë të vërtetën, more vesh? - i tha Gabrieli duke e shtrënguar edhe një herë. - Vetëm një mundësi.

Lakruaja nuk dha asnjë përgjigje përveçse lëshoi një klithmë nga dhimbja.

- Ke vetëm një mundësi, - i tha prapë Gabrieli, duke ngritur gishtin tregues për ta përforcuar idenë. - Po më dëgjon, apo jo?

Lakruaja nuk nxori zë.

- Po e marr këtë si një "po", - tha Gabrieli. - Tani, më thuaj emrat e atyre që kanë vajzën. Pastaj më thuaj se ku mund t'i gjej.

- Nuk di asgjë për ndonjë vajzë.

- Marsel, mos më gënje.

- Jo, unë...

Para se Lakruaja të nxirrte ndonjë fjalë tjetër, Gabrieli ia mbylli gojën sërish. Pastaj ia lidhi gjithë kokën dhe fytyrën me shirit ngjitës derisa i dukeshin vetëm flegrat e hundës. Shkoi dhe mori një litar najloni në një depo poshtë kuvertës dhe pastaj u ngjit në kabinë, ku Keleri mbante timonin me të dyja duart dhe picërronte sytë përtej xhamit, drejt ujërave të trazuara.

- Si po shkon aty poshtë? - e pyeti ai.

- Çuditërisht, nuk e binda dot të bashkëpunonte.

- Po atë litar ç'e do?

- Për të përforcuar punën bindëse.

- Mund të të ndihmoj?

- Ul shpejtësinë dhe vëre jahtin në autopilot.

Keleri bëri si iu tha dhe e ndoqi Gabrielin për në sallon. Atje gjetën Lakruanë në vështirësi të madhe, që përpëlitej e nuk merrte dot frymë nga ngjitëset e shumta në fytyrë. Gabrieli e ktheu përmbys dhe i lidhi edhe këmbët dhe kyçet me litar. Pasi e lidhi mirë, e tërhoqi në kuvertën e pasme si të ishte një balenë e sapozënë në rrjetë. Pastaj, me ndihmën e Kelerit, e zbriti nga shkallët dhe e hodhi në ujë. Lakruaja ra rëndë në ujin e errët dhe nisi të përpëlitej në përpjekje për të mbajtur kokën në sipërfaqe. Gabrieli e pa për një çast dhe pastaj hodhi sytë në horizont, nga të gjitha drejtimet. Nuk dukej asnjë dritë, a thua se ata ishin tre njerëzit e fundit të mbetur mbi tokë.

- Si do ta kuptosh që mjafton? - e pyeti Keleri teksa shihte Lakruanë që luftonte për jetën.

- Kur të fillojë të fundoset, - ia ktheu Gabrieli me qetësi.

- Më kujto të mos jem kurrë kundër teje.

- Mos ji kurrë kundër meje.

Pas dyzet e pesë sekondash në ujë, Lakruaja papritur reshti së luftuari. Gabrieli dhe Keleri e nxorën shpejt e shpejt dhe ia hoqën shiritin ngjitës nga goja. Për disa minuta francezi nuk mundi të fliste dhe mezi arrinte të mbushej me frymë teksa kollitej dhe nxirrte ujë deti nga goja. Kur u qetësua disi, Gabrieli e kapi nga nofulla e thyer dhe ia shtrëngoi fort.

- Ndoshta tani nuk e kupton dot, - i tha ai, - por duhet ta dish që kjo është dita jote më me fat, Marsel. Tani, fillojmë edhe një herë nga e para. Më thuaj se ku ta gjej vajzën.

- Nuk e di.

- Mos gënje, Marsel.

- Jo, - tha Lakruaja duke tundur kokën nga të dy anët. - Po ju them të vërtetën. Nuk e di se ku është ajo.

- Por njeh një nga njerëzit që e mbajnë, ama. Ke pirë me të në një lokal në Ronjak, vetëm një javë pas zhdukjes së saj. Që prej asaj dite, i ke ruajtur lidhjet me të.

Lakruaja ra në heshtje. Gabrieli ia shtrëngoi edhe më fort nofullën.

- Emrin, Marsel! Më thuaj si quhet ai njeri!

- Brosard, - tha Lakrua dhe rënkoi në dhimbje. - Ai quhet Rëne Brosard.

Gabrieli pa Kelerin, i cili pohoi me kokë.

- Shumë mirë, - i tha ai Lakruasë duke e lëshuar. - Tani vazhdo të flasësh dhe mos e ço nëpër mend të më gënjesh. Po më gënjeve, e ke prapë vendin në det, por këtë herë, përgjithmonë.

12

LARG NGA MARSEJA

Në kuvertën e pasme ishin dy karrige të vendosura përballë njëratjetrës. Gabrieli siguroi Lakruanë në një prej tyre dhe vetë u ul në tjetrin. Lakruaja vazhdonte të ishte me sy të mbyllur dhe tani rrobat sportive i ishin bërë qull nga zhytja në ujë. Duke u dridhur pa pushim, ai u lut ta lejonin të ndërronte rrobat ose t'i jepnin një batanije. Kur e pa që nuk mori asnjë përgjigje, filloi të rrëfente për atë mbrëmje të nxehtë gushti, kur në jahtin "Vallëzo me Hënën" mbërriti një i paftuar, ashtu si edhe Gabrieli më herët atë pasdite.

- Poli ishte ai? - e pyeti Gabrieli.

- Po, ai ishte.

- E kishe takuar ndonjëherë më parë ti atë?

- Jo, por e kisha parë.

- Ku e kishe parë?

- Në Kanë.

- Kur?

- E kisha parë në Festivalin e Filmit.

- Këtë vit?

- Po, në muajin maj.

- Ti ke qenë në Festivalin e Filmit në Kanë?

- Nuk isha në listën e të ftuarve, nëse e ke fjalën për këtë, por isha me punë.

- Çfarë pune?

- Si thua ti?

- Vidhje aktorët dhe njerëzit e bukur në përgjithësi?

- Është një nga javët me më shumë lëvizje të vitit, një javë që rrit ekonominë vendase dhe ata të Hollivudit janë shumë idiotë. Ne i vjedhim sa herë që vijnë dhe ata asnjëherë nuk e vënë re.

- Po Poli çfarë donte atje?

- Ai rrinte me ata njerëzit e bukur. Madje, një herë më duket se e pashë të shkonte të shihte edhe disa prej filmave.

- Të duket?

- Po, sepse ai ndryshon shpesh pamje dhe nuk mund të jesh i sigurt.

- Mendon se ia merrte ndonjërit kalanë nga brenda në Kanë ai?

- Për këtë duhet të pyesni atë. Nuk folëm për gjëra të tilla kur erdhi të më takonte. Folëm vetëm për punën.

- Ai donte të të pajtonte për ta larguar vajzën nga Korsika me jahtin tënd?

- Jo, - tha Lakruaja duke tundur kokën i dëshpëruar. - Ai nuk më tha se bëhej fjalë për një vajzë.

- Po çfarë të tha?

- Më tha se duhej të dorëzoja një mall.

- Ti nuk e pyete se për çfarë malli bëhej fjalë?

- Jo.

- Kështu bashkëpunon gjithmonë ti?

- Varet.

- Nga se varet.

- Varet nga sa më paguajnë.

- Sa të pagoi ai?

- Pesëdhjetë mijë.

- Kjo është një pagesë e mirë për ty?

- Shumë e mirë.

- Të tha se kush e kështilloi të lidhej me ty?

- Emrin tim ia kishte dhënë doni.

- Cili don?

- Don Orsati, korsikani.

- Çfarë pune bën ky doni?

- Ai merret me gjithçka, - u përgjigj Lakruaja, - por kryesisht me vrasje. Ndonjëherë unë i ndihmoj njerëzit e tij të lëvizin me jahtin tim, ndonjëherë i ndihmoj të zhdukin "ndonjë gjë".

Pyetjet e Gabrielit për donin kishin dy qëllime; të provonte vërtetësinë e fjalëve të Lakruasë dhe njëherazi të mbulonte gjurmët e tij. Tani Lakruaja mendonte se Gabrieli nuk kishte pasur kurrë nderin të njihte një vrasës korsikan me emrin Orsati. Dhe, të paktën për momentin, po u përgjigjej me sinqeritet pyetjeve të Gabrielit.

- Të tha Poli se kur do të kryhej puna?

- Jo, - u përgjigj Lakruaja duke tundur kokën. - Më tha se do të më njoftonte njëzet e katër orë para dhe se ndoshta mund të lidhej me mua pas një jave ose maksimumi pas dhjetë ditësh.

- Të tha se si do të lidhej me ty?

- Do të më merrte në telefon.

- E ke ende telefonin me të cilin fole me të?

- Lakruaja pohoi me kokë dhe tha përmendësh numrin e celularit.

- Dhe ai të telefonoi ashtu siç tha?

- Po, pas tetë ditësh më mori në telefon.

- Çfarë të tha?

- Më tha se donte të shkoja ta merrja te limani në jug të *Capo di Feno*.

- Në çfarë ore?

- Në orën tre të mëngjesit.

- Si do të kryhej puna?

- Ai donte që të lija një gomone në plazh dhe ta prisja në breg.

Gabrieli ngriti sytë dhe pa nga vendi ku qëndronte dhe ndiqte bisedën Keleri. Anglezi pohoi me kokë, si për të thënë se kishte vërtet një liman të volitshëm në *Capo di Feno* dhe se skenari i paraqitur nga Lakruaja dukej tërësisht i besueshëm.

- Kur mbërrite në Korsikë ti? - e pyeti Gabrieli.

- Disa minuta pas mesnate.

- Vetëm ishe?

- Po.
- Je i sigurt?
- Po, të betohem!
- Në çfarë ore e le gomonen në plazh?
- Në orën dy.
- Si u ktheve në jahtin tënd?
- Në këmbë, - deshi të bënte lojë fjalësh Lakruaja, - si Jezusi.

Gabrieli bëri pak përpara dhe i zhvati Lakruasë vëthin e veshit të majtë.

- Bëra shaka, - ulëriu francezi teksa gjaku i vërshoi poshtë veshit.

- Të isha në vendin tënd, nuk do të bëja shaka për Zotin në një çast si ky. Madje, do të bëja çmos për të qenë sa më në rregull me të.

Gabrieli hodhi prapë sytë nga vendi ku qëndronte Keleri dhe e pa atë të përpiqej të mbante të qeshurën. Pastaj i tha Lakruasë të përshkruante vijimësinë e ngjarjeve. Sipas francezit, Poli kishte mbërritur në orar, fiks në orën tre. Lakruaja kishte parë vetëm një automjet, një makinë të vogël që zbriste nga e tatëpjeta e keqe për në liman, vetëm me dritat e bllokazhit ndezur. Pastaj kishte dëgjuar zhurmën e gomones që largohej nëpër ujë. Pastaj, kur gomonia kishte kaluar në krah të jahtit të tij "Vallëzo me Hënën", ai kishte parë vajzën.

- Poli ishte me të?
- Po.
- Po njeri tjetër kishte?
- Jo, ishte vetëm Poli.
- Ajo ishte e vetëdijshme?
- Ja, ashtu.
- Çfarë kishte veshur?
- Fustan të bardhë, por i kishin vënë kapuç të zi në kokë.
- Ia pe fytyrën?
- Asnjëherë.
- Dukej e rrahur ose e plagosur?
- Gjunjët i kishte të gjakosur dhe krahët të gërvishtur gjithandej. Kishte edhe shenja të zeza.
- E kishin lidhur?
- Vetëm duart.

- Përpara apo mbrapa?
- Mbrapa.
- Me se ia kishin lidhur?
- Me fasheta plastike, shumë profesionale.
- Vazhdo.
- Poli e vendosi vajzën në një kolltuk në sallonin e jahtit dhe i dha diçka për të pirë që të heshtte. Pastaj, erdhi në kabinën e timonit dhe më tha se ku duhej të shkoja.
- Ku?
- Te gjiri i baticës në perëndim të "Shën Maria e Detit". Atje është një port i vogël që unë e kisha përdorur edhe më parë. Është vend i shkëlqyer. Me siguri që Poli i kishte bërë mirë detyrat e shtëpisë para se të vinte.

Gabrieli hodhi sërish sytë nga Keleri, i cili pohoi sërish me kokë.

- Ti shkove drejt e atje?
- Jo, - u përgjigj Lakruaja. - Po të isha nisur menjëherë do të duhej të kthehesha me ditë, kështu që e kaluam ditën në det të hapur dhe shkuam atje rreth orës njëmbëdhjetë të mbrëmjes.
- Poli e mbajti vajzën gjatë gjithë natës në sallon?
- E nxori një herë në kuvertë, por...
- Por çfarë?
- Ajo ishte e droguar.
- Me ketaminë?
- Nuk e di, unë nuk jam doktor.
- Ashtu?
- Më bëre një pyetje, t'u përgjigja.
- Me gomone e nxori në breg ai?
- Jo. Unë shkova menjëherë te porti i vogël. Ai është nga ato vende ku mund ta parkosh makinën ku të duash. Polin e priste një makinë, një *Mercedes* i zi.
- Çfarë lloji ishte?
- *E-Class*.
- Me çfarë targash?
- Franceze.
- Bosh ishte?

- Jo, ishin dy burra në të. Njëri ishte mbështetur te kofano kur mbërritëm ne, ndërsa tjetri ishte në timon.

- E njihje ti atë që ishte mbështetur te kofano?

- Nuk e kisha parë kurrë në jetën time.

- Por kjo nuk vlen për atë që ishte në timon, apo jo, Marsel?

- Jo, - u përgjigj Lakruaja, - në timon ishte Rëne Brosardi.

Rëne Brosardi ishte ushtar në një nga familjet mafioze të Marsejës, e cila kishte edhe lidhje ndërkombëtare. Ai ishte i specializuar kryesisht në punë të fortësh ku përfshiheshin mbledhje borxhesh, përforcime dhe punë sigurie. Kur kishte kohë të lirë, ai punonte si truprojë në një klub nate pranë Portit të Vjetër, më shumë sepse i pëlqenin vajzat që shkonin atje. Lakruaja e kishe njohur në lagje, i kishte edhe numrin e telefonit.

- Kur e more në telefon? - e pyeti Gabrieli.

- Disa ditë pasi lexova artikullin e parë në gazetë për vajzën angleze e cila kishte ardhur për pushime në Korsikë dhe një ditë ishte zhdukur sikur ta kishte përpirë dheu. Bëra llogaritë dhe kuptova se bëhej fjalë për vajzën që kisha lënë unë në portin e vogël të "Shën Maria e Detit".

- Qenke edhe gjeni matematike kështu?

- E po, ca mbledhje di t'i bëj, - ia ktheu Lakruaja.

- Kështu, e kuptove që Poli kishte marrë një fetë të majme të tortës dhe doje edhe ti më shumë, hë?

- Ai më gënjeu për llojin e punës që do të bëja, - tha Lakruaja. - Unë nuk do të kisha pranuar kurrë të merrja pjesë në një rrëmbim të përmasave të tilla për pesëdhjetë mijë.

- Sa i kërkove ti?

- Në punën time, përpiqem të mos e bëj zakon t'i vendos unë kushtet.

- Djalë i zgjuar qenke! - tha Gabrieli dhe pastaj e pyeti Lakruanë se pas sa kohësh ia ktheu telefonatën Brosardi.

- Pas dy ditësh.

- Hytë shumë në detaje kur folët në telefon?

- Aq sa për t'i lënë të kuptonte se sa para doja unë. Brosardi më telefonoi pas disa orësh dhe më tha të shkoja në lokalin "Bar du Haut" ditën tjetër pasdite, në orën katër.

- Ke bërë një gomarllëk me brirë, Marsel.

- Pse?

- Sepse mund të kishte qenë Poli në vend të Brosardit dhe do të të kishte dhënë një plumb në lule të ballit që u përpoqe të kërkoje më shumë para.

- Unë jam i zoti i vetes.

- Lëre se e pashë sa i zoti je, - i tha Gabrieli. - Të ishte ashtu si thua, nuk do të ishe i lidhur pas asaj karrigeje dhe në jahtin tënd. Por nejse, po më flisje për bisedën që bëre me Rëne Brosardin.

- Ai tha se Poli donte të tregohej i arsyeshëm. Më pas, hymë në negociata.

- Negociata?

- Po, për çmimin e bashkëpunimit tim. Poli bëri një ofertë dhe unë bëra një kundërofertë. Dhamë e morëm disa herë.

- Të gjitha këto me telefon?

Lakruaja pohoi me kokë.

- Cili ishte roli i Brosardit në operacion?

- Ai qëndron në shtëpinë ku mbajnë vajzën.

- Poli është atje me të?

- Nuk kam pyetur kurrë për këtë.

- Sa të tjerë rrinë atje?

- Nuk e di. Unë di vetëm që atje është edhe një grua tjetër që të duket sikur janë një familje.

- Ta ka përmendur ndonjëherë vajzën angleze Brosardi?

- Më ka thënë se është gjallë.

- Vetëm kaq?

- Vetëm kaq.

- Në ç'pikë janë tani negociatat e tua me Polin dhe Brosardin?

- Sot në mëngjes ramë dakord.

- Sa munde t'u zhvatje?

- Edhe njëqind mijë të tjera.

- Kur e latë të bëhej dorëzimi i parave?

- Nesër pasdite.

- Ku?

- Në *Aix*.
- Në ç'vend në *Aix*?
- Në një kafe pranë "Place du General de Gaulle".
- Si e ka emrin kafeneja?
- "Le Provence". Do të dish gjë tjetër?
- Si do ta bëjnë dorëzimin ata?
- Brosardi do të mbërrijë i pari, në orën pesë e dhjetë. Unë duhet të shkoj pas pesë e njëzetës.
- Ku do të jetë ulur ai?
- Në një tavolinë jashtë.
- Po paratë ku do t'i ketë?
- Brosardi më tha se do të jenë në një çantë diplomatike metalike.
- Sa ide e mirë!
- Ishte ideja e tij dhe jo imja.
- Ka ndonjë plan B nëse ndonjëri prej jush nuk paraqitet në takim?
- Po, te "Le Cezanne", në krye të rrugës.
- Sa do të të presë ai atje?
- Dhjetë minuta.
- Po nëse ti nuk shkon as atje?
- Atëherë marrëveshja prishet.
- More ndonjë udhëzim tjetër?
- Po, që nuk duhet t'i marr më në telefon sepse Poli po bezdiset nga telefonatat.
- Me siguri.

Gabrieli ngriti për të disatën herë sytë nga vendi ku ndodhej Keleri, por këtë herë ai qëndronte pa lëvizur, si një figurë e zezë përkundër një qielli po aq të zi dhe mbante një armë në dorë. Një gjuajtje e vetme, që nuk u ndje nga arma me silenciator, hapi një gropë në syrin e majtë të Lakruasë. Gabrieli e mbajti francezin nga shpatullat kur dha shpirt. Pastaj u kthye si i tërbuar dhe i drejtoi Kelerit armën e tij.

- Ule atë para se të vritet ndonjë, - i tha anglezi me qetësi.
- Pse dreqin e bëre atë?
- Sepse më ngriti nervat. Pastaj, - tha Keleri teksa fuste armën në brezin e pantallonave, - nuk është se na hynte më në punë.

13

COTE D'AZUR, FRANCË

Atë e degdisën në fund të ujërave të thella matanë "Dolfe du Lion" dhe pastaj u nisën për në Marsejë. Ishte ende errësirë kur u ndalën në Portin e Vjetër; dolën nga jahti "Vallëzo me Hënën" me disa minuta distancë nga njëri-tjetri, hipën në makina të ndryshme dhe morën rrugën e bregut për në Tulon. Pak para se të mbërrinin në qytetin Bandol, Gabrieli ndaloi në anë të rrugës dhe liroi disa kabllo të motorit. Pastaj i telefonoi kompanisë së cilës i kishte marrë makinën me qira dhe me zërin histerik të herr Klempit la një mesazh ku thoshte se makina "e prishur" mund të gjendej në atë vend. Pasi fshiu shenjat e gishtërinjve nga timoni, hipi në makinën e Kelerit dhe së bashku u nisën drejt diellit, në lindje të *Nice*-s. Në rrugën "Verdi" ishte një pallat i vjetër, i bardhë si një kockë, ku Byroja kishte një nga bazat e saj të shumta. Gabrieli hyri vetëm në apartament dhe ndenji atje aq sa ishte e nevojshme për të marrë postën, që përfshinte një kopje të dosjes personale të Madalena Hartit në partinë e saj, të cilën ai ia kishte kërkuar Graham Sejmurit. E lexoi teksa Keleri ecte drejt *Aix*-it, përgjatë autostradës A8.

- Hë, ç'thotë? - e pyeti anglezi pas një heshtjeje prej disa minutash.
- Thotë që Madalena Hart është e përsosur. A thua se na tha ndonjë gjë të re!

- Edhe unë kam qenë i përsosur dikur dhe shiko si u bëra.

- Ti ke qenë gjithnjë horr, Keler, por e kuptove vetëm atë natë në Irak.

- Humba tetë shokë duke u përpjekur të mbronin vendin tënd nga Skudët e Sadamit, - tha Keleri.

- Dhe ne ju jemi borxhlinj përgjithmonë.

I zbutur, Keleri ndezi radion dhe e çoi në një kanal anglishtfolës të Monakos, që transmetonte për komunitetin britanik që jetonte në jug të Francës.

- Të ka marrë malli për shtëpinë?

- Me raste edhe më merr. Atëherë, dëgjoj muzikën e vendit tim.

- Nuk je kthyer më kurrë atje?

- Në Angli?

Gabrieli pohoi me kokë.

- Kurrë, - u përgjigj Keleri. - Refuzoj të punoj atje dhe nuk kam pranuar kurrë punë me qytetarë britanikë.

- U treguake shumë fisnik!

- E po, njeriu ka rregulla.

- Prindërit e tu nuk e dinë që ti je gjallë?

- As që e kanë idenë.

- Atëherë ti nuk mund të jesh hebre, - e qortoi Gabrieli. - Asnjë fëmijë hebre nuk do të lejonte që nëna e tij ta dinte për të vdekur. Në asnjë mënyrë!

Gabrieli iu kthye paragrafit për Madalena Hartin e kohëve të fundit dhe e lexoi në heshtje teksa Keleri i jepte makinës. Në fakt, ishte kopja e një letre që Xheremi Falon ia kishte dërguar kryetarit të partisë, ku i sugjeronte që Madalena të promovohej në një post fillestar në ministri dhe të përgatitej për më tej. Pastaj pa fotografinë e Madalenës të ulur jashtë një kafeneje me njeriun që ata e njihnin si Polin. Keleri e pa dhe tha:

- Çfarë po mendon?

- Po mendoj pse një yll në ngritje në partinë në pushtet në Britani, do të pinte një shishe shampanjë me një mashtrues të klasit të parë si miku ynë, Poli.

- Sepse ai e dinte që ajo ishte e lidhur me kryeministrin britanik dhe po përgatitej për ta rrëmbyer.

- Nga e dinte ai?

- E kam një ide për këtë.

- A mbështetet nga ndonjë fakt ajo ide?

- Mbështetet nga disa fakte.

- Atëherë është vetëm një ide.

- Por të paktën të ndihmon të kalosh kohën.

Gabrieli mbylli dosjen, si për t'i thënë se ishte sy e veshë tek ai. Keleri fiku radion.

- Njerëzit si Xhonatan Lankasteri bëjnë të njëjtin gabim kur zënë dashnore, - nisi ai. - Mendojnë se truprojat e tyre nuk do të flasin, gjë që nuk është aspak e vërtetë. Ata flasin me njëri-tjetrin, me gratë dhe me dashnoret e tyre dhe po ashtu edhe me ish-miqtë e vjetër, të cilët kanë gjetur punë në industrinë e sigurimit privat në Londër. Nuk kalon shumë kohë dhe fjalët shkojnë edhe në veshin e ndonjërit si Poli.

- Ti mendon se Poli ka lidhje me industrinë e sigurimit në Londër?

- Ndoshta, ose njeh ndonjë që ka lidhje. Sido që të ketë shkuar, - shtoi Keleri, - një informacion si ai është i paçmueshëm për njerëz si Poli. Ai mund të ketë nisur ta vëzhgonte Madalenën që në Londër, t'i ketë përgjuar celularin dhe adresat elektronike. Me siguri kështu ka zbuluar edhe se ajo do të vinte me pushime në Korsikë dhe kur ajo mbërriti, ai ishte duke e pritur.

- Por përse duhej të drekonte me të? Përse të rrezikonte të shfaqte fytyrën?

- Sepse i duhej ta gjente vetëm për ta pasur më të lehtë bindjen.

- Mendon se ai e ka joshur?

- Ai është mjeshtër i joshjes.

- Nuk besoj të jetë kështu, - tha Gabrieli pasi u mendua një hop.

- Përse jo?

- Sepse në kohën e rrëmbimit, Madalena ishte e lidhur me kryeministrin britanik dhe nuk mund të tërhiqej nga dikush si Poli.

- Madalena ishte dashnorja e kryeministrit, - tha Keleri, - që do të thotë se ka pasur pak romancë në lidhjen e tyre. Me siguri ajo ndihej shumë e vetmuar.

Gabrieli pa sërish foton. Jo Madalenën, por Polin, dhe tha:

- Kush dreqin të jetë ky?

- Amator nuk është njëherë, kjo është e sigurt. Vetëm profesionistët e njohin donin dhe vetëm një profesionist do të guxonte të trokiste për ndihmë në derën e tij.

- Po të ishte kaq profesionist sa thua ti, përse do të përdorte një rrugaç vendas për të mbaruar punën?

- Ti po pyet përse nuk kishte bandën e tij?

- Them se po.

- Ndoshta i ka bërë mirë llogaritë matematikore, - u përgjigj Keleri. - Mbajtja e një bande mund ta ndërlikonte operacionin, pa llogaritur edhe problemet personale. Kur nuk ka shumë punë, ai mërzitet, por kur vjen ndonjë punë e madhe, do ta marrë të gjithë tortën për vete.

- Prandaj përdor elektrone të lira që i paguan në vend me para në dorë, për të shmangur ndarjen e fitimit.

- Në rivalitetin e ashpër të biznesit të ditëve të sotme, këtë bëjnë të gjithë.

- Por jo doni.

- Doni është ndryshe. Ne jemi një familje, një klan dhe ti ke të drejtë për diçka. Marsel Lakruaja ishte me fat që Poli nuk e vrau. Po të guxonte t'i kërkonte më shumë para donit pas përfundimit të punës, do të përfundonte në fund të Mesdheut me arkivol çimentoje.

- Atje ku është tani.

- Por pa çimenton, ama.

Gabrieli e pa Kelerin me qortim, por nuk foli.

- Ti ia shqeve veshin.

- Shqyerja e veshit është siklet i përkohshëm, ndërsa plumbi në sy, i përhershëm.

- Pse, ti çfarë do t'i bëje atij?

- Mund ta kthenim në Korsikë dhe t'ia linim donit.

- Gabriel, më beso që nuk do ta kishte pasur të gjatë. Orsati nuk i ka qejf andrallat.

- Dhe siç do të thoshte Stalini: "Vdekja i zgjidh të gjitha andrallat".

- Po vdiq, njeriu nuk hap më andralla, - e përfundoi frazën Keleri.

- Po sikur ai të na ketë gënjyer?

- Nuk kishte arsye të gënjente.

- Pse?

- Sepse e dinte që nuk do të dilte i gjallë nga jahti, - tha Keleri dhe pasi e uli pak zërin, shtoi, - ai shpresonte vetëm që t'i falnim një vdekje pa vuajtje në vend që ta mbysnim në det.

- Kjo është një tjetër nga teoritë e tua?

- Ky është një nga rregullat e Marsejës, - ia ktheu Keleri. - Këtu, po mori puna të tatëpjetën, nuk ka më kthim pas.

- Po sikur Rëne Brosardi të mos jetë duke na pritur me çantën e diplomatit te kafeneja në orën pesë? Çfarë do të bëjmë pastaj?

- Atje do të jetë.

Gabrieli do të donte të kishte bindjen e Kelerit, por zëri i eksperiencës nuk ia lejonte këtë. Ai pa orën e dorës dhe llogariti se sa kohë u kishte mbetur për ta gjetur vajzën.

- Sikur të shfaqet Brosardi, - tha ai, - ndoshta do të jetë më mirë të mos e vrasim pa na çuar në shtëpinë ku mbajnë Madalenën.

- Po pastaj?

Vdekja i zgjidh të gjitha andrallat, mendoi Gabrieli. Po vdiq, njeriu nuk hap më andralla.

14

AIX-EN-PROVENCE, FRANCË

Qyteti i lashtë *Aix-En-Provence*, i themeluar nga romakët, i pushtuar nga vizigotët dhe i zbukuruar nga mbretër, kishte shumë pak të përbashkëta me Marsejën, fqinjin e tij ranor në jug. Në Marsejë kishte drogë, krim dhe një lagje arabe ku flitej pak frëngjisht; *Aix*-i kishte muze, dyqane të mira dhe një nga universitetet më të mira në vend. Ata që ishin nga *Aix*-i e mbanin zakonisht kokën ulur në Marsejë, shkonin rrallë atje, kryesisht për të përdorur aeroportin dhe pastaj ia mbathnin sa më shpejt të mundeshin, mundësisht sa pa iu zhvatur ndonjë gjë nga duart a nga çantat. Rrugëkalimi kryesor në *Aix* ishte "Cours Mirabeau", një bulevard i gjatë, anash të cilit rreshtoheshin një pafundësi kafenesh mbi të cilat bënin hije dy vargje paralele pemësh plot gjelbërim. Në veri të tij hapeshin një sërë rruginash të ngushta dhe sheshesh të vogla të njohura si "Quartier Ancien". Ishte kryesisht lagje këmbësorësh, pothuajse të gjitha rrugët e saj ishin të ndaluara për automjetet, përveç motorëve. Gabrieli bëri disa manovra të vjetra për të parë nëse po e ndiqnin. Pastaj, kur u bind se ishte vetëm, u nis drejt sheshit të vogël që gëlonte nga njerëzit, përgjatë rrugës "Espariat". Në qendër të sheshit ndodhej një kolonë e lashtë në majë të së cilës ishte një kapitel romak; ndërsa në qoshen juglindore që pjesërisht zihej nga pemë

të larta, ndodhej kafeneja "Le Provence". Kishte disa tavolina në shesh dhe më shumë në rrugën "Espariat", ku ishin ulur dy pleq dhe shikonin kuturu në hapësirë, me një shishe likeri *Pastis* para. Duket si një vend më i përshtatshëm për vendasit, sesa për turistët, mendoi Gabrieli. Një vend ku dikush si Rëne Brosardi do të ndihej shumë rehat. Kur hyri, Gabrieli shkoi te banaku dhe kërkoi një paketë cigare "Gauloises" dhe një meny e teksa priste kusurin, vëzhgoi me kujdes pjesën e brendshme të kafenesë për t'u siguruar se kishte vetëm një mënyrë për të hyrë e për të dalë prej aty. Pastaj doli jashtë për të gjetur një pikë vrojtimi fikse prej nga mund të shihte të dyja anët e tavolinave nga jashtë. Ndërsa peshonte mundësitë, u afruan disa adoleshentë japonezë që me një frëngjishte të çalë e pyetën nëse mund t'i nxirrte në fotografi. Gabrieli bëri sikur nuk i kuptoi e pastaj u kthye dhe eci përgjatë rrugës "Espariat", kaloi dy pleqtë që vazhdonin të shikonin kuturu dhe doli në "Place du General de Gaulle". Gumëzhima e borive të makinave në trafik dukej sikur buçiste pas qetësisë së "Quartier Ancien". Kishte mundësi që Brosardi të largohej nga qyteti i *Aix*-it nga ndonjë rrugë tjetër, por Gabrieli kishte dyshimet e tij për këtë. Asnjë makinë nuk mund t'i afrohej kafenesë "Le Provence" më shumë sesa deri në "Place du General de Gaulle". Ai mendoi se gjërat do të rridhnin shpejt e shpejt dhe nëse nuk përgatiteshin mirë, edhe mund ta humbnin atë. Pa gjethet e pemëve që binin poshtë "Cours Mirabeau" dhe llogariti numrin e operativëve dhe automjeteve që do të duheshin për ta bërë punën për së mbari. Duheshin të paktën dymbëdhjetë operativë dhe katër makina për të shmangur ndjekjen rrugës për në pronën e izoluar ku mbahej vajza. Pasi tundi kokën ngadalë, ai u nis drejt një kafeneje në anë të trafikut, ku Keleri po pinte kafe vetëm.

- Hë? - e pyeti anglezi.

- Na duhet një motoçikletë.

- Ku i ke paratë që i more Lakruasë para se unë ta vrisja?

Duke u ngrysur, Gabrieli bëri me shenjë nga të brendshmet e tij. Keleri la disa euro mbi tavolinë dhe u ngrit në këmbë.

Jo shumë larg prej aty, në bulevardin "De la Republique", ishte një vend ku shiteshin motorë. Pasi u mor disa minuta me inspektimin e mallit, Gabrieli zgjodhi një Skuter *Peugeot Satelis 500 Premium*, për të cilin Keleri pagoi me para në dorë dhe e regjistroi në një nga identitetet e tij të rreme korsikane. Kur shitësi po merrej me dokumentacionin, Gabrieli kaloi rrugën dhe hyri në një dyqan me rroba për meshkuj, ku bleu një xhaketë lëkure, xhinse të zeza dhe një palë çizme lëkure. U ndërrua në një nga dhomat e zhveshjes dhe rrobat e vjetra i vendosi në valixhen e vogël në anë të motorit. Pastaj, pasi vendosi kaskën e zezë në kokë, hipi në motor dhe e ndoqi Kelerin nëpër bulevard, drejt "Place du General de Gaulle".

Po shkonte ora pesë. Gabrieli e la motoçikletën në rrugën "Espariat" dhe me kaskën nën sqetull, eci nëpër rrugën e ngushtë deri në sheshin e vogël me kolonën romake në qendër. Dy pleqtë nuk kishin lëvizur ende nga tavolina e tyre. Gabrieli zuri një tavolinë në pabin irlandez matanë rrugës dhe i tha kamerieres t'i sillte një birrë. Për një hop, pyeti veten se pse dikush duhej të vinte në një pab irlandez në jug të Francës. Mendimet iu prenë në mes nga pamja e një burri trupmadh që po ngjitej në rrugicë, hijeve, me një çantë diplomatike prej metali në dorën e djathtë. Burri hyri në "La Provence" dhe doli sërish pas pak, me një makiato dhe një pije në dorë. Teksa zinte njërën prej tavolinave bosh, përshkoi njëherë me sy sheshin. Vështrimi i tij u ndal për një çast te Gabrieli, pastaj shkoi gjetiu. Gabrieli pa orën. Ishte fiks pesë e dhjetë. Nxori celularin dhe i telefonoi menjëherë Kelerit.

- Të thashë që do të vinte, - i tha anglezi.
- Me çfarë erdhi?
- Me një *Mercedes* të zi.
- Të çfarë lloji?
- *E-Class*.
- Targa?
- Merre me mend.
- E njëjta makinë që po priste te porti i vogël?
- Këtë do ta mësojmë shumë shpejt.
- Kush e ngiste?
- Një femër mbi njëzet vjeçe, ndoshta sapo i kishte mbushur tridhjetë.

- Franceze ishte?
- Ndoshta, s'e di, por mund ta pyes nëse të intereson.
- Ku është ajo tani?
- Po bën xhiro.
- Po ti ku je?
- Dy makina mbrapa saj.

Gabrieli e ndërpreu telefonatën dhe e futi sërish celularin në xhepin e xhaketës. Pastaj, nga xhepi tjetër i saj nxori njërin prej telefonave që e kishte marrë në jahtin e Marsel Lakruasë. Gjithçka duhej të merrte fund aty për aty, mendoi ai edhe një herë, përndryshe do ta humbnin. Që puna të kryhej me efikasitet i duheshin dymbëdhjetë operativë dhe katër automjete. Ndërkohë, ai kishte vetëm dy makina dhe shok skuadre kishte vetëm një vrasës profesionist, i cili dikur kishte pasur detyrë të vriste edhe atë. Piu një gllënjkë birrë, pastaj i hodhi sytë telefonit të të ndjerit dhe vuri re se si minutat kalonin ngadalë.

15

AIX-EN-PROVENCE, FRANCË

Në orën 5:18, u duk sikur koha u ndal. Gumëzhima e largët e trafikut u fashit, siluetat në sheshin e vogël ngrinë, si të ishin figura vaji mbi një prej kanavacave të Renuarit. Gabrieli, restauruesi, po i ekzaminonte për kënaqësinë e tij: katër gjermanë ekstravagantë po shikonin menynë në njërin prej lokaleve, dy vajza skandinave të veshura me sandale po shikonin të hutuara një hartë rruge prej letre. Një grua simpatike ishte ulur te këmbët e kolonës dhe mbante në prehër një vogëlush që mund të ishte rreth tre vjeç, ndërsa një burrë ishte ulur në kafenenë me emrin "La Provence", nën shoqërinë e vetëm një çante diplomatike metalike të mbushur me njëqind mijë euro. Njëqind mijë euro që ishin sjellë nga një njeri pa vendlindje, me emrin Pol. Gabrieli pa gruan me fëmijën në këmbët e kolonës dhe për një çast, i doli para syve një skenë e përgjakur. Pastaj hodhi sërish vështrimin nga burri i ulur vetëm në kafenenë "La Provence". Tanimë, ora kishte shkuar 5:20. Kur ora e Gabrielit shënoi 5:21, ai burrë u ngrit në këmbë, rrëmbeu çantën diplomatike dhe u nis.

– *Ka ndonjë plan B nëse ndonjëri prej jush nuk paraqitet në takim?*

– *Po, ai do të shkojë te "Le Cezzanne", në krye të rrugës.*

– *Sa kohë do të presë atje?*

– *Dhjetë minuta.*

– *Po sikur ti të mos shkosh as atje?*

– *Atëherë nuk ka më marrëveshje.*

Por pse një vrasës profesionist të mos shkonte të merrte një shpërblim të majmë prej njëqind mijë eurosh? Sepse ai kriminel tani ndodhej në fundin e detit Mesdhe, katërmbëdhjetë kilometra në jug të Marsejës, me një plumb në kokë. Rëne Brosardi nuk kishte se nga ta dinte këtë, natyrisht, andaj edhe Gabrieli mbante në dorë, gati për ta përdorur, celularin e të ndjerit. Ai e vështroi Brosardin teksa u nis ngadalë nëpër rrugët me hije, gjithmonë me çantën diplomatike në dorë. Pastaj pa gjermanët, vajzat skandinave dhe nënën që mbante në prehër fëmijën, i cili i ngjallte kujtimet më të zjarrta në thellësitë e errëta të kujtesës së tij. Ora kishte shkuar 5:22. Tetë minuta, mendoi ai dhe do të niste kërkimin. Mjaftonte një gabim, vetëm një gabim dhe Madalena Hart ishte e vdekur. Ai vuri prapë birrën në buzë, por pas përjetimeve të fundit, shija e saj iu duk e neveritshme. Pa prapë gruan me djaloshin, këtë herë i pashpresë, teksa flakët gllabëronin trupat e tyre.

Në orën 5:25, i telefonoi sërish Kelerit.

- Ku është ajo?

- Vazhdon të bëjë xhiro.

- Shiko se mos po luan me ty, mos ka ndonjë makinë tjetër.

- Gjithnjë kaq pesimist je ti?

- Vetëm kur rrezikohet jeta e një femre.

Keleri nuk foli.

- Ku është tani?

- Nëse jam i saktë, duhet të jetë nisur për aty ku je ti.

Gabrieli e ndërpreu telefonatën dhe mori celularin tjetër. I ra numrit të Brosardit, vuri gishtin fort te mikrofoni dhe e afroi telefonin në vesh. Zilja ra dy herë. Pastaj u dëgjua zëri i Brosardit.

- Ku dreqin je?

Gabrieli e shtrëngoi edhe më fort gishtin te mikrofoni dhe nuk foli.

- Marsel, ti je? Ku je?

Gabrieli e largoi celularin nga veshi dhe shtypi butonin që mbyllte telefonatën pa thënë asnjë fjalë. Pas tridhjetë sekondash, i ra prapë. Përsëri e mbuloi mikrofonin me gishtin e madh dhe nuk foli. Brosardi e ngriti që në zilen e parë.

- Marsel? Marsel? Të kisha thënë të mos më merrje më në telefon. Ke edhe tri minuta kohë, ndryshe ika!

Këtë herë ishte Brosardi ai që e mbylli telefonin. Gabrieli e futi celularin në xhep dhe pastaj i telefonoi sërish Kelerit.

- Si shkoi? - e pyeti anglezi.

- Ai mendon se Lakruaja është gjallë, shëndoshë e mirë dhe në një vend ku nuk i kap mirë celulari.

- Shumë keq.

- Ku është ajo tani?

- Po i afrohet "Place du General de Gaulle".

Gabrieli e ndërpreu telefonatën dhe pa orën. Brosardi do të nisej pas tri minutash. Do të ishte nervoz dhe i hutuar. Mund ta dallonte që po e ndiqte një burrë në këmbë, sidomos nëse ai burri kishte qenë duke pirë birrë në pabin irlandez kur Brosardi ishte te "Le Provence". Por nëse Brosardi kalonte pranë atij njeriu kur të shkonte te makina, ndoshta kishte më pak gjasa që të dyshonte për të. Ky ishte një nga rregullat e arta të Shamronit për mbikëqyrjen fizike. Ndonjëherë, thoshte ai, puna bëhet më mirë kur i del objektivit para syve sesa kur i rri nga mbrapa.

Gabrieli pa orën. Pastaj, sapo ajo shënoi 5:28, u ngrit nga tavolina e pabit dhe mori për nga rruga "Espariat", me kaskën nën sqetull. "Le Cezanne" ishte lokali i fundit në të djathtë, atje ku rruga merrte për në "Place du General de Gaulle". Brosardi ishte ulur në një tavolinë jashtë. Kur i kaloi pranë, Gabrieli i ndjeu sytë e francezit ta shihnin nga pas, por e shtrëngoi veten dhe nuk u kthye të shikonte. Motori ishte atje ku e kish lënë, i parkuar pranë disa motorëve të tjerë, poshtë një peme që sapo kishte nisur të rrëzonte gjethet. Tri prej tyre kishin gjetur vend në shalën e motorit. Gabrieli i largoi me dorë, pastaj hipi dhe vuri kaskën.

Nga pasqyra e pasme, pa se si Brosardi u ngrit nga tavolina e tij dhe u nis për nga rruga e ngushtë. Disa sekonda më pas, francezi kaloi jo më larg se disa centimetra larg shpatullës së Gabrielit. Aq afër, sa Gabrieli i ndjeu edhe aromën e kolonjës. Aq afër, sa sikur pak fare të zgjatej, mund edhe t'ia kishte rrëmbyer fluturimthi çantën diplomatike nga dora e majtë. Më parë Brosardi e kishte mbajtur atë në dorën e djathtë, por tani nuk mundej sepse të djathtën e kishte të zënë me celularin, të cilin e kishte mbështetur fort pas veshit.

Gabrieli ndezi motorin kur Brosardi hyri në sheshin "Place du General de Gaulle", duke kthyer kokën sa nga njëra anë në tjetrën, si gryka e një tanku në kërkim të një objektivi për të asgjësuar. Në shesh kishin filluar shëtitjet e pasdites së vonë. Kishte aq njerëz saqë ai me siguri do ta kishte humbur nga sytë po të mos qe për çantën diplomatike, e cila shkëlqente si një monedhë e sapodalë nga fabrika në muzgun e herët. Kur iu afrua grupit të njerëzve, Brosardi e kishte futur sërish në xhep celularin dhe po hapte derën e përparme të *Mercedes*-it të zi *E-Class*, i cili ishte parkuar në një cep. Teksa ulej në ndenjëse, një *Renault* bishtprerë i kaloi anash dhe më pas u kthye në bulevardin "La Republique". Të njëjtën gjë bëri edhe *Mercedes*-i pas dhjetë sekondash. Teksa e shihte këtë, Gabrieli vuri buzën në gaz nga kënaqësia që iu kishte shkuar kaq mbarë. Ndonjëherë, mendoi ai, më mirë t'i dalësh përballë atij që gjurmon, sesa t'i rrish nga pas. Ndezi motorin dhe kaloi lehtë përmes trafikut, pa ia ndarë sytë dritave të pasme të *Mercedes*-it. Mjaftonte vetëm një gabim. Vetëm një dhe vajza ishte e vdekur.

Ata ecën nëpër bulevardin "La Republique", për në rrugën "d'Avignon" e më pas morën për nga veriu. Për ndonja dy kilometra, sytë i zunë vetëm dyqane dhe semaforë, por dalëngadalë dyqanet u zëvendësuan nga blloqe pallatesh dhe shtëpi e pa kaluar shumë, e panë veten duke udhëtuar përmes një rruge me katër korsi. Pas një kilometri e gjysmë majtas tyre u shfaq një pikë karburanti. Keleri uli shpejtësinë dhe ndezi sinjalin, e *Mercedes*-i e parakaloi menjëherë. Pastaj korsitë u reduktuan në dy. Gabrieli iu afrua *Mercedes*-it me afro pesëdhjetë metra dhe Keleri vinte menjëherë pas tij.

Deri atëherë dielli kishte perënduar dhe mbrëmja e vjeshtës po binte me shpejtësinë e siparit që mbyll një shfaqje. Qiparisat dhe pishat përgjatë

rrugës u kthyen nga të gjelbra në të zeza e më pas i përpiu plotësisht errësira. Teksa peizazhin e mbulonte terri, bota e Gabrielit u tkurr; ajo kishte vetëm drita të bardha të përparme, drita të kuqe të pasme, gurgullimën e motorit të tij dhe fërshëllimën e *Renault*-it të Kelerit disa metra pas tij. Sytë ia kishte ngulur *Mercedes*-it të Rëne Brosardit, por me mendje po shihte një hartë të Francës. Në këtë pjesë të *Provence*-s, qytezat e fshatrat ishin thuajse të ngjitura me njëri-tjetrin, si një kolanë perlash. Por nëse vazhdonin në atë drejtim, ata do të kalonin në *Vaucluse*. Atje, në *Luberon*, fshatrat do të rralloheshin dhe terreni ishte më i ashpër. *Ndoshta atje e mbanin*, mendoi ai. Në ndonjë vend të izoluar, në ndonjë vend ku të çonte vetëm një rruginë e ngushtë. Kështu do ta kishin shumë të thjeshtë të vëzhgonin çdo lëvizje, këdo që mund të shkelte atypari.

Kaluan në rrethinat e një qyteze me emrin *Lignane*. Aty, *Mercedes*-i u ndal në një parking të shkretuar ku shiteshin edhe poçari qeramike për kopshte. Gabrieli dhe Keleri u detyruan ta parakalonin. Rreth dyqind metra më tutje ishte një rrethrrotullim. Një rrugë të çonte në *Saint-Cannat*, një tjetër, më e vogël, në *Rognes*. Gabrieli i bëri shenjë me dorë Kelerit që të merrte për në *Saint-Cannat*. Pastaj, ai vetë u nis drejt *Rognes*-it dhe kërkoi menjëherë strehë në hijen e një muri me blloqe. Vetëm një çast më pas u ndje zhurma e *Mercedes*-it nga pas, vetëm se këtë herë në timonin e tij ishte Brosardi dhe gruaja, të cilën Gabrieli për herë të parë po e shquante mirë, po shihte me qëllim nga pasqyra e krahut të pasagjerit. I telefonoi menjëherë Kelerit dhe e vuri në dijeni. E detyroi veten të numëronte ngadalë deri në dhjetë dhe pas kësaj hyri prapë në rrugë me motorin e tij.

Rrugës për në *Rognes*, koha dukej sikur nuk kalonte fare. Rruga u ngushtua, terri i natës u thellua dhe ajri sa vinte e bëhej më i ftohtë, kurse rruga më e përpjetë sa më shumë i afroheshin rrëzës së Alpeve. Një hënë treçerekëshe përvidhej hera-herës mes reve, duke e ndriçuar peizazhin për një çast e duke e kredhur në errësirë vetëm një çast më pas. Të dyja anët e rrugës ishin mbushur me vreshta të rregullt e të pastër, si ushtarë

të nisur për në luftë. Përveç tyre, nuk shihje asnjë gjurmë tjetër jete. Nuk të zinte syri një dritë dhe rruga ishte e shkretë, përveç *Mercedes*-it të zi *E-Class*. Gabrieli dhe Keleri ruanin një largësi që u lejonte të mos i pikaste Brosardi. Sa herë që i jepej mundësia, Gabrieli udhëtonte duke e fikur dritën e përparme të motorit. Me erën që i përplasej në fytyrë duke e penguar në njëfarë mënyre edhe të shihte mirë, atij i dukej sikur po udhëtonte me shpejtësinë e tingullit.

Teksa i afroheshin rrethinave të *Rognes*-it, më në fund u dukën disa makina e kamionë. Në qendër të qytezës, *Mercedes*-i bëri ndalesën e dytë, jashtë një dyqani me produkte mishi pranë të cilit ndodhej edhe një pastiçeri. Keleri parakaloi sërish me shpejtësi ndërsa Gabrieli arriti të fshihej nën strehën e një kishe të vjetër. Atje, pa sesi gruaja doli nga makina dhe hyri vetëm në dyqan. Doli pak minuta më pas, me disa qese plastike në dorë, të mbushura me ushqim që sipas Gabrielit, dukej se mjaftonte për të ushqyer një familje të tërë dhe për t'i lënë ndonjë kockë edhe ndonjë pengu. Fakti që ndaluan për t'u furnizuar, tregonte se Brosardi nuk dyshonte që po e ndiqnin dhe gjithashtu se ata po i afroheshin vendit për ku ishin nisur.

Gruaja i futi qeset me ushqim në bagazh dhe pasi hodhi një herë sytë në rrugën e qetë, zuri vend sërish në ndenjësen e përparme. Brosardi e nisi makinën para se ajo ta mbyllte derën. Eci me shpejtësi nëpër rrugët e *Centro Ville* dhe më pas u kthyen në D543, një rrugë me dy korsi, e cila kalonte nga *Rognes*-i për në rezervuarin në *Saint-Christophe*. Matanë rezervuarit kalonte lumi *Durance*. Brosardi e kaloi urën sipër tij në orën gjashtë e gjysmë dhe më pas hyri në *Vaucluse*. Vazhduan në veri, mes fshatrave piktoreske *Cadenet* dhe *Lourmarin*, para se të zbrisnin shpatet jugore të *Massif du Luberon*. Në rrafshnaltat e luginës përgjatë lumit, Gabrieli mbeti një kilometër ose diçka më shumë mbrapa Brosardit. Por në ato rrugë me erë, i duhej të ngushtonte distancën dhe të mos e humbiste nga sytë. Teksa kalonte nëpër fshatin e vogël të *Buoux*-it, seç e kapi një frikë se mos Brosardi më në fund e kishte kuptuar që po e ndiqnin, por, kur *Mercedes*-i vazhdoi pa e prishur terezinë edhe për ndonja dhjetë kilometra të tjerë, frika e tij u shua. Vazhdoi të udhëtonte nëpër natë, duke kaluar mure të gurta dhe fusha të mbjella që shndrinin nën dritën e hënës, pa ia

ndarë sytë për asnjë çast dritave të kuqe të pasme të *Mercedes*-it dhe pa shqitur nga mendja një vajzë të panjohur.

Më në fund, Brosardi u fut në një të çarë mes pemëve dhe u zhduk. Gabrieli nuk guxoi ta ndiqte menjëherë, kështu që vazhdoi edhe një kilometër më tutje e pastaj u kthye mbrapsht. Rruga të cilën kishte marrë Brosardi, ishte e pashtruar mirë dhe me zor mund t'i mbante dy makina. Ajo e nxori Gabrielin në një luginë të vogël me fusha të kultivuara, të cilat ndaheshin nga gardhe me shkurre dhe rreshta pemësh. Në luginë të zinte syri tri vila. Dy në skajin perëndimor dhe një në atë lindor, pas një vargu me qiparisa. *Mercedes*-i nuk dukej kurrkund. Gabrieli përllogariti kohën që i ishte dashur për të mbërritur deri aty pasi e humbi nga sytë Brosardin dhe sa kohë do t'i ishte dashur atij për të mbërritur në secilën prej vilave. Pastaj, qëndroi në anë të motorit duke i hedhur sytë sa në njërën anë të luginës në tjetrën, duke menduar se Brosardi duhej të ndalonte patjetër diku aty dhe kur të ndalonte, do të dallohej menjëherë nga dritat e frenave. Dhjetë sekonda më pas, Gabrieli nuk pa më nga vilat në perëndim, të cilat ishin më pranë tij, dhe e përqendroi vështrimin në vilën lindore, që ndodhej më larg. Atëherë e pa: një dritë e kuqe që shndriu si drita e një shkrepëseje. Aty për aty, u duk sikur ajo pluskoi mbi qiparisat. Pastaj, u shua dhe lugina u krodh edhe një herë në errësirë.

16

LUBERON, FRANCË

Fshati më i afërt kishte vetëm një motel të frikshëm, kështu që ata udhëtuan deri në *Apt*, ku u regjistruan në një hotel të vogël në zonën e qendrës së vjetër. Restoranti i tij ishte bosh dhe shërbente vetëm një kamerier i moshuar. Ata hëngrën në tavolina të veçanta dhe pastaj ecën nëpër rrugët e qeta e të errëta që të çonin në bazilikën e vjetër të Shën Anës.

Bazilika mbante erë qiriri të djegur dhe pak erë myku. Me kokën të ngritur lehtë nga njëra anë, Gabrieli studioi altarin kryesor dhe pastaj u ul pranë Kelerit, para një rreshti qirinjsh që digjeshin ngadalë. Anglezi kishte vendosur duart para fytyrës në shenjë lutjeje dhe, kur foli, tingulli i zërit të tij doli më shumë si jehona e një pëshpërime.

- Ajo kishte të drejtë.

- Kush?

- *Signadora*.

- Mund ta kem gabim, - i tha Gabrieli duke ngritur sytë nga kupola, - por sikur nuk mbaj mend që *Signadora* të përmendte ndonjë vilë në një fushë agrikulturore në Luberon.

- Ama, përmendi detin dhe malet.

- E pastaj?

- Ata e kanë sjellë atë nga deti dhe tani po e fshehin në male.

- Ndoshta, - ia ktheu Gabrieli, - sepse mundet edhe ta kenë shpërngulur në ndonjë vend tjetër. Ose mund ta kenë vrarë fare.

- O Zot! - pëshpëriti Keleri. - Pse duhet të jesh gjithmonë kaq pesimist ti?

- Mos harro se ku je, Kristofer.

Keleri u ngrit në këmbë, eci deri te qirinjtë e pandezur dhe ndezi një prej tyre. Ishte gati të kthehej, kur pa Gabrielin që ia kishte ngulur sytë kutisë së ndihmave. Nxori disa monedha nga xhepi dhe i hodhi një nga një në kuti. Tingulli i tyre jehoi nëpër gjithë kupolën edhe pasi ai u ul në vend.

- Kalon shumë kohë në kishat katolike? - e pyeti.

- Më shumë nga ç'mendon ti.

Keleri rimori pozicionin e lutjes. Gota e kuqe e qirinjve kushtimorë lëshoi një hije ngjyrë rozë në fytyrën e tij.

- Le ta zëmë, - tha ai pas pak, - se ndoshta vajza është diku tjetër. Por të mos harrojmë edhe se të gjitha faktet na sjellin vetëm këtu. Përndryshe, as Brosardi nuk do të kishte ardhur këtu, por do të ishte në Marsejë, duke pritur prenë e radhës.

- E vetmja gjë që e shqetëson atë tani, është përse nuk u shfaq Lakruaja në vendin e takimit për të marrë paratë e tij dhe kur t'i thotë Polit atë që ka ndodhur, Poli do të nxehet.

- Më duket se ti nuk rri shumë me kriminelë, apo jo?

- Rri më shumë nga ç'mendon ti, - ia ktheu Gabrieli për herë të dytë.

- Brosardi nuk do t'i tregojë Polit asgjë për atë që ndodhi sot në *Aix*. Do t'i thotë se gjithçka shkoi sipas planit dhe do t'i mbajë për vete ato para. Nejse, jo të gjitha, sepse ma do mendja se do t'i japë një pjesë asaj femrës që ka me vete.

Gabrieli pohoi me kokë ngadalë, sikur Keleri të kishte thënë fjalë të shenjta, pastaj ktheu lehtë kokën dhe pa një grua që po ngjitej në qendër të anijatës. Ajo kishte flokë të errët, të krehur drejt, ballë të lartë dhe kishte veshur një pardesy sintetike me rrip në mes. Takat e saj, ashtu si monedhat e Kelerit, bënin jehonë në hollin e madh të kishës. Kur ndaloi përpara altarit kryesor, ajo bëri kryqin sipas traditës - ballë, zemër, shpatulla e majtë, shpatulla e djathtë - u ul në anën tjetër të anijatës dhe e nguli vështrimin te kryqi.

- Mënyra e vetme për të mësuar nëse ajo është atje apo jo, - foli pas një hopi Gabrieli, - është ta vëzhgojmë vilën për një kohë të gjatë. Por këtë nuk e bëjmë dot pa gjetur një vend të mirë vrojtimi.

Keleri u ngrys në shenjë mohimi.

- Tani fole si agjent i vërtetë, - i tha.

- Çfarë do të thuash me këtë?

- Që ti dhe ata të sërës sate nuk bëni dot punë në terren pa ju siguruar njeri katin më të mirë të një hoteli me pesë yje.

- Hebrenjtë nuk bëjnë kamping, Keler. Herën e fundit që e provuan, u endën për dyzet vjet nëpër shkretëtirë.

- Mojsiu do ta kishte gjetur më shpejt Tokën e Premtuar, sikur ta kishin udhëhequr disa djem nga regjimenti.

Gabrieli hodhi sytë nga gruaja me pardesynë sintetike. Ajo vazhdonte t'ia ngulte sytë kryqit pa asnjë shprehje në fytyrë. Pastaj pa nga Keleri dhe e pyeti:

- Si do t'ia bëjmë?

- Jo si do t'ia bëjmë, - ia ktheu Keleri, - por si do t'ia bëj unë sepse do të veproj i vetëm. Si atëherë kur isha në Irlandën e Veriut. Do të gjej një vend dhe do të fshihem vetëm, me një palë dylbi dhe një çantë. Si dikur.

- Po sikur të të kapë ndonjë fshatar që punon tokat?

- Fshatarët nuk e dallojnë dot një njeri të SAS-it edhe sikur t'u dalë para syve, jo më kur është i fshehur, - tha Keleri dhe pa një çast nga qirinjtë. - Njëherë ndenja dy javë në një papafingo të Londrës. Ruaja një të dyshuar si terrorist i IRA-s, i cili banonte në rrugicën përballë. Familja katolike poshtë meje nuk e mori vesh asnjëherë që unë jetoja një kat sipër tyre. Nuk e morën vesh as kur u largova prej atje.

- Ç'u bë me atë terroristin?

- Ai pësoi një aksident. Më erdhi keq. Ishte pishtar i vërtetë i llojit të tij.

Gabrieli ndjeu hapa dhe, kur u kthye, pa gruan me pardesy të dilte nga kisha.

- Sa gjatë mund të qëndrosh në atë luginë?

- Nëse kam ujë dhe ushqime sa duhet, mund të rri edhe një muaj, por them se dyzet e tetë orë duhet të më mjaftojnë për të zbuluar nëse e mbajnë atje vajzën apo jo.

- Ato janë dyzet e tetë orë që nuk na vijnë më.

- Mos ki merak, do t'i përdor si duhet.

- Çfarë të duhet prej meje?

- Po të më çoje deri atje, nuk bën keq. Ama, sa të vë këmbë atje, harromë.

- Atëherë nuk e ke problem nëse shkoj për disa orë në Paris?

- Ç'dreqin kërkon ti në Paris tani?

- Ndoshta ka ardhur koha të flas me Graham Sejmurin.

Keleri nuk u përgjigj.

- Ke ndonjë problem, Kristofer?

- Jo, po mendoja që unë do të rrezikoj kokën për dy ditë ndërsa ti e ke mendjen të shkosh në Paris.

- Po deshe, e rrezikoj unë kokën këtu dhe shko takoje ti Grahamin.

- Jo, - tha Keleri, duke i rënë Gabrielit shpatullave. - Shko ti në Paris. Është vendi i duhur për agjentët spitullaqë.

Kishin kohë pa vënë mirë gjumë në sy, kështu që u kthyen në hotel dhjetë minuta njëri pas tjetrit dhe u vendosën në dhomat përkatëse. Gabrielin e zuri gjumi top për dhjetë minuta dhe kur u zgjua, në dhomë kishin rënë rrezet e para të diellit. Kur zbriti në restorant, Kelerin e gjeti atje, të krehur e të rruar dhe dukej që kish bërë gjumë të mirë. U përshëndetën me kokë, si dy të panjohur. Mes tyre qëndronte një rresht tavolinash të shtruara me mbulesa të bardha. Ata hëngrën mëngjes në heshtje të plotë. Më pas, u kthyen në qendrën e vjetër të qytezës, këtë herë për të bërë ca blerje të vogla. Keleri bleu një pallto, një bluzë leshi në ngjyrë të errët, një çantë shpine dhe dy mushama rezistente ndaj ujit. Bleu edhe ujë, mjaftueshëm, ushqim të konservuar dhe çanta plastike nga ato që mbyllen me zinxhir. Me pak fjalë, gjëra që do ta ndihmonin të mbijetonte për dyzet e tetë orë. Pas blerjeve, hëngrën bashkë një drekë të bollshme, por Keleri nuk vuri verë në buzë. Ai

u ndërrua kur Gabrieli po kthehej përmes maleve, buzë luginës së vogël me tri vilat e saj dhe nuk foli asnjë fjalë teksa ai u largua, si një dre kur ndien erën e gjahtarit. Deri atëherë, dielli kishte perënduar. Gabrieli i telefonoi Graham Sejmurit në Londër, përmendi emrin e një vendi në Paris dhe e mbylli telefonin. Atë natë, Zoti, në urtësinë e tij të pamatë, e pa të udhës të dërgonte një stuhi vjeshte në *Luberon*. Gabrieli ishte shtrirë në dhomën e hotelit duke dëgjuar shiun që përplasej mbi xhamat e dritares dhe mendonte për Kelerin që gjendej i vetëm në mes të baltës, në luginën me tri vilat. Mëngjesin tjetër ai hëngri në restorantin e hotelit nën shoqërinë e gazetave dhe kamerierit thinjosh. Pastaj shkoi në *Avignon*, ku bleu një biletë treni për në Paris.

17

PARIS

Kisha filluar të mendoja se nuk do të merrja asnjë lajm prej teje.

- Kanë kaluar vetëm pesë ditë, Sejmur.

- Pesë ditë mund të jenë një përjetësi kur të rri kryeministri te koka.

Ata po ecnin përgjatë *Quai de Montebello*-s, pranë *Bouquinistes*-it. Gabrieli kishte veshur një palë xhinse *Denim* dhe xhaketë lëkure, ndërsa Sejmuri një pallto *Chesterfield* dhe një palë këpucë të bëra me porosi që dukeshin sikur nuk kishin shkelur kurrë në tokë, por vetëm në tapetet e zyrës së tij dhe ato të zyrës së kryeministrit.

Pavarësisht nga rrethanat ku ndodheshin, ai dukej në qejf. Kishte kohë që nuk ecte rrugëve pa truprojat e tij, qoftë në Paris apo kudo tjetër.

- Ti ke komunikim të drejtpërdrejtë me të? - pyeti Gabrieli.

- Me Lankasterin?

Gabrieli pohoi me kokë.

- Jo më, - ia ktheu Sejmuri. - Tani ka caktuar Xheremi Falonin si sufler.

- Po me atë si komunikon?

- Drejtpërsëdrejti dhe me shumë dashuri.

- E di njeri tjetër për përfshirjen tënde në këtë çështje?

Sejmuri tundi kokën.

- Në lidhje me këtë çështje, veproj vetëm në kohën e lirë. Kur nuk duhet të merrem me njëzet mijë xhihadistët, të cilët e konsiderojnë ishullin tonë të bekuar si shtëpinë e tyre.

- Si po ia del?

- Shefi im dyshon se jam duke u shitur informata sekrete armiqve tanë, ndërsa gruaja është e bindur që kam dashnore. Përveç këtyre, gjithçka tjetër shkon mbroth.

Sejmuri u ndal në një nga tavolinat e *Bouquinestes*-it dhe hodhi një sy përreth. Me kurriz, Gabrieli përshkoi me sy picërrues rrugën, se mos po i vëzhgonte njeri, se mos shihte ndonjë pozicion të dyshimtë a ndonjë fytyrë që mund t'i dukej e njohur. Era kishte nisur të krijonte valëzime të lehta në sipërfaqen e ujit të lumit. Kur u kthye, ai e pa Sejmurin me një kopje të vjetër të librit "Konti i Monte Kristos" në dorë.

- Si mendon? - e pyeti Sejmuri.

- Historia klasike e dashurisë; gënjeshtra dhe tradhti, - ia ktheu Gabrieli.

- Të pyeta nëse mendon se po na vëzhgojnë.

- Kam përshtypjen se të dy ia dolëm të vinim në Paris pa tërhequr vëmendjen e miqve tanë të përbashkët të Shërbimit Sekret Francez.

Sejmuri e ktheu vëllimin e Dumasë në vendin e tij në stendë. Pastaj, teksa nisën të ecnin sërish, futi dorën në xhepin e brendshëm të palltos *Chesterfield* dhe nxori një zarf.

- Këtë e kishin lënë mbrëmë poshtë një stoli në *Hampstead Heath*, - tha ai duke ia zgjatur zarfin Gabrielit. - Edhe dy ditë kohë, në të kundërt, vajza është e vdekur.

- Akoma nuk kanë kërkuar gjë?

- Po, - tha Sejmuri, - nuk kanë kërkuar gjë, por kanë sjellë një fotografi tjetër, e cila vërteton se vajza është gjallë.

- Si jua bënë me dije se ku ndodhej zarfi?

- I telefonuan Simon Hjuitit në celularin e tij. Kishin përdorur një pajisje për ndryshimin e zërit. Hjuiti e mori zarfin kur po bënte vrapin e mëngjesit, herën e tij të parë dhe të vetme që bënte vrap në mëngjes. Mua ma dha Xheremi Faloni sot në mëngjes. Nuk besoj se është nevoja të ta them që situata në kryeministri është shumë e nderë në këto çaste.

- Dhe do të përkeqësohet, besoj.

- Ti nuk ke bërë asnjë përparim?

- Në fakt, - tha Gabrieli, - unë kam përshtypjen që e kam gjetur, por pyetja ime është: Çfarë do të bëjmë tani?

Kaluan urën *Petit Pont* dhe nisën të ecnin nëpër shëtitoren jashtë *Notre Dame*. Gabrieli tregonte me qetësi se si kishin shkuar gjërat deri më atëherë. I tregoi se njeriu me të cilin kishte drekuar Madalena Hart ditën kur u zhduk, i ishte prezantuar asaj me emrin Pol, se Poli më pas kishte pajtuar një kriminel francez me emrin Marsel Lakrua për ta kaluar Madalenën nga Korsika për në stere, se Lakruaja kishte negociuar për të marrë edhe njëqind mijë euro për shërbimin e tij, para që do t'i dorëzoheshin nga një njeri me emrin Rëne Brosard në qytetin francez të *Aix*-it. Gjithashtu, i tha Sejmurit se Brosardi, pasi nuk kishte mundur të bënte dorëzimin e parave, ishte nisur menjëherë për në malet e Luberonit, në një luginë të izoluar bujqësore, ku ndodheshin tri vila.

- Ti mendon se Madalena gjendet në një prej atyre tri vilave?

- Rëne Brosardi është emër i njohur në botën e krimit në Marsejë. Nëse nuk i ka shkrepur në kokë të prodhojë verë, ka vetëm një arsye që mund ta ketë çuar atë atje.

Sejmuri tundi kokën.

- Policia franceze ka më se një muaj që e kërkon Madalenën, - tha ai pas pak, - kurse ti e gjen për pesë ditë.

- E po, unë jam më i zoti se policia franceze.

- Prandaj edhe unë t'u drejtova ty.

Para tyre, një grup të rinjsh nga Europa Lindore po pozonin për të bërë një fotografi me katedralen në sfond. Gabrieli mendoi se mund të ishin çekë ose sllovakë, por nuk ishte i sigurt. Nuk i kuptonte dot mirë gjuhët sllave. E drejtoi Sejmurin majtas dhe ecën përgjatë kafeneve me turistë që përshkonin rrugën "d'Arcole".

- Nuk besoj se të vjen keq nëse të bëj disa pyetje, apo jo? - e pyeti Sejmuri.

- Graham, sa më pak të dish, aq më mirë është. Më beso.

- Sa për muhabet.

- E po, meqë po ngul këmbë...

- Si e more vesh për Polin?

- Këtë nuk ta them dot.

- Ku është Marsel Lakruaja?

- Këtë më mirë të mos e dish.

- Kush po e vëzhgon vilën?

- Një bashkëpunëtor.

- Nga Byroja?

- Jo tamam.

- E po, më informove sa më s'ka.

Gabrieli nuk foli.

- Sa di ti për Polin?

- Flet rrjedhshëm frëngjisht, por ka theks, e ndryshon pamjen sipas rastit dhe duket se i ka qejf filmat.

- Çfarë po përpiqesh të më thuash?

Gabrieli i shpjegoi se Marsel Lakruaja e kishte parë Polin në festivalin e filmit në Kanë dhe për plumbin që Kristofer Keleri, një renegat i SAS-it, të cilin qeveria britanike e dinte të vdekur, i kishte dhënë Lakruasë.

- Ky Poli më duket si profesionist.

- Profesionist është, - tha Gabrieli.

- Ishte miqësuar me Madalenën para se ta vriste? Kjo është teoria jote?

- Është e qartë që ata janë njohur ditën kur ajo u zhduk, - tha Gabrieli. - Nëse gjatë atyre orëve u bënë shokë, dashnorë apo ku ta di unë se çfarë, kjo mund të hajë diskutim. Por them se mënyra e vetme për ta mësuar saktë, është që të pyesim Madalenën.

- Sa kohë ke që e vëzhgon vilën?

- Më pak se njëzet e katër orë.

- Sa kohë ju duhet për të vendosur nëse ajo është atje, apo jo?

- Këtë mund të mos e mësojmë dot kurrë, Graham.

- Sa kohë ju duhet? - nuk u dorëzua Sejmuri.

- Edhe njëzet e katër orë të tjera.

- Kështu na mbetet vetëm një ditë deri në përfundim të kohës që kemi në dispozicion.

- Kështu, e vetmja rrugë që të mbetet, është t'ia japësh informacionin tim autoriteteve franceze.

- E si t'u përgjigjem kur të më pyesin si e mora këtë informacion? - pyeti Sejmuri.

- Thuaju që ta tha një zog në vesh. Sajo ndonjë histori bindëse për ndonjë informator ose ndonjë përgjim bisedash telefonike. Graham, më beso, nuk kanë për të të bërë presion për burimin.

- Ta zëmë se ata do ta shpëtojnë. Ç'do të ndodhë pastaj? - pyeti Sejmuri e aty për aty iu përgjigj vetë pyetjes së tij: - Atëherë do të zbulohet se ajo ka pasur një lidhje me kryeministrin. E më pas, si francezë që janë, do t'ia përplasin Lankasterit në fytyrë e do ta bëjnë publike.

- Mund edhe të mos e bëjnë.

- Por Lankasteri nuk mund të rrezikojë.

- Ti më kërkove ta gjeja dhe unë besoj se e kam gjetur, - tha Gabrieli.

- Tani po të kërkoj ta shpëtosh.

- Po shkova unë atje, do të ketë të vdekur.

- Francezët do të mendojnë se ishte një larje hesapesh mes bandash. Gjëra që ndodhin shpesh në këto anë, - tha Sejmuri dhe pasi ndaloi për pak, shtoi: - Sidomos nëse je ti këtu.

Gabrieli bëri sikur nuk e dëgjoi fjalinë e fundit dhe tha:

- Po nëse arrij ta shpëtoj? Çfarë të bëj me të? Ku ta çoj?

- Sille në Britani se atje merremi ne me të.

- Po si do ta mbuloni historinë e rishfaqjes së saj?

- Njerëzit zhduken dhe rishfaqen prapë gjatë gjithë kohës.

- Po sikur ajo video të bëhet publike?

- Nëse vajza nuk është më e zhdukur, nuk ka skandal.

- Do t'i duhet një pasaportë.

- Kam frikë se nuk të ndihmoj dot për këtë.

- Pse jo?

- Sepse unë nuk mund të nxjerr pasaportë të re për të, me fotografinë e saj, pa ngjallur dyshime. Pastaj, - shtoi Sejmuri, - ti dhe ata shokët e tu sikur jeni më të zotë për të bërë pasaporta false.

- Ne e kemi për detyrë të jemi të zotë.

Për një çast ecën pa folur nëpër rrugën gjithaq të heshtur. Gabrieli nuk kishte më kundërshtime, as pyetje. Mund të thoshte vetëm "jo", gjë për të cilën nuk ishte përgatitur.

- Ndoshta ajo mund të mos jetë në gjendje ta përballojë udhëtimin, - e theu heshtjen Gabrieli. - Madje, për shumë kohë mund të mos jetë në gjendje për asgjë.

- Ç'mendon ti të bëjmë?

- Nëse ajo është vërtet në vilë, - nisi Gabrieli, - dhe nëse ne arrijmë ta nxjerrim prej atje, do të na duhet ta çojmë në një nga bazat tona në Francë dhe ta lajmë, ta rregullojmë. Unë do të sjell edhe një skuadër me mjekë dhe disa vajza të mira që t'i bëjnë shoqëri.

- Po kur ajo të jetë gati për të lëvizur?

- Atëherë do t'i ndryshojmë pamjen, do t'i bëjmë fotografi dhe do t'i përgatisim një pasaportë izraelite. Vetëm atëherë do ta kalojmë përmes Kanalit[3] dhe atëherë merruni vetë me të.

Kishin mbërritur në fund të rrugës, e cila i kishte kthyer në anë të *Notre Dame*. Sejmuri rregulloi shallin dhe bëri sikur po admironte harqet e tij të thyera.

- Nuk ma tregove vendndodhjen e asaj vilës, - tha ai me indiferencë.

- Do ta marrësh vesh së shpejti.

- Po Marsel Lakruaja?

- Ai vdiq, - tha Gabrieli.

Sejmuri u kthye nga ai dhe i zgjati dorën.

- Mund të bëj ndonjë gjë për ty?

- Po. Shko në "Gare du Nord" dhe prej atje merr trenin e parë për në Londër.

- Po është gati dy kilometra larg që këtu.

- Do të të bëjë mirë të ecësh pak. Graham, mos ma merr për ters, por dukesh për faqe të zezë.

---

[3] Channel - I referohet tunelit La Manche

Por doli se Sejmuri nuk e mbante mend rrugën e kthimit për në "Gare du Nord". Ai ishte nga MI5-a, pra, vinte në Paris vetëm për konferenca, për pushime ose për të gjetur dashnoren e rrëmbyer të kryeministrit të tij. Gabrieli ia dha udhëzimet duke i pëshpëritur në vesh dhe pastaj e ndoqi deri në hyrjen e stacionit, ku Sejmuri u zhduk mes një morie lypësish, shpërndarësish droge dhe shoferësh taksie afrikanë.

Kur mbeti sërish vetëm, Gabrieli përshkoi sheshin "*De la Concorde*" me motor dhe më pas eci në këmbë deri në ambasadën e Izraelit në rrugën "Rabelais". Pasi i bëri një telefonatë kortezie shefit të tij, ai u lidh me zyrën operative në "Bulevardin Mbreti Saul", për t'u kërkuar një vendstrehim në Francë dhe krijimin e një grupi për pritjen e pengut. Pas pesë minutash, ata e telefonuan vetë dhe i thanë se një grup prej tri vetash do të ishte gati për njëzet e katër orë.

- Po vendstrehimin e sigurt?

- Kemi marrë një pronë të re në Normandi, jo shumë larg nga stacioni i trageteve në *Cherbourg*.

- Çfarë prone është?

- Ka katër dhoma gjumi, një kuzhinë dhe pamje të mrekullueshme të Kanalit. Po të duash, të sjellim edhe punëtore shtëpie.

Gabrieli e mbylli telefonin dhe mori çelësat e shtëpisë, që ndodheshin aty. Ora po shkonte katër e një çerek. Mund të mbërrinte në kohë për të marrë trenin e orës pesë për në *Avignon*. Kur mbërriti, ishte errësuar dhe ai u kthye në hotelin e tij në *Apt*. Atë mbrëmje nuk binte shi, vetëm se shkulme të forta ere rrihnin rrugët e ngushta të qendrës së vjetër të qytetit. Gabrieli u shtri në shtrat pa u ndërruar, si për t'u solidarizuar me Kelerin. Mëngjesin e ditës tjetër, piu kafe më shumë se zakonisht.

- Nuk keni fjetur mirë, zotëri? - e pyeti kamerieri i moshuar.

- Nga era, - ia ktheu Gabrieli.

- Po, fryu erë e tmerrshme, - pohoi kamerieri.

Tabela në hyrje lexonte "Agjencia Imobiliare e Luberonit". Duke marrë sjelljen skeptike të herr Johanes Klempit, para se të hynte Gabrieli

kaloi një çast duke parë me vëmendje fotografitë e pronës, të cilat vareshin në dritaret e saj. Një grua, ndoshta te të tridhjetepestat, e përshëndeti. Ajo kishte veshur një këmishë në ngjyrë të errët dhe bluzë të bardhë të lirshme. Dukej se nuk i pëlqeu mënyra fjalëpakë e herr Klempit. Në fakt, pak gra e pëlqenin atë. Ai i tha se i kishte pëlqyer shumë prona dhe do të kthehej për të qëndruar më gjatë aty. *Nuk rrihet në hotel*, kishte përfunduar. Për ta shijuar *vërtet* Luberonin, ai do të merrte me qira një vilë dhe jo një vilë dosido. Duhej të ishte një vilë madhështore, në një zonë pak të rrahur nga turistët. Herr Klempi nuk ishte turist, por udhëtar.

- Ky është ndryshim domethënës, - kishte këmbëngulur ai, edhe pse gruaja as që mund ta kuptonte këtë.

Diçka në sjelljen e herr Klempit, e bëri atë të mendonte se kjo do të ishte një përvojë e gjatë. Eh, sa kishte parë ajo si ai! Me siguri do t'i shikonte të gjitha pronat dhe si përfundim nuk do të pëlqente asnjë. Megjithatë, kjo ishte puna e vetme që ajo mund të gjente në këtë vend që la pa mend herr Klempin, kështu që i ofroi atij një kafe nga makineria dhe i tregoi të gjitha broshurat, me gjithë entuziazmin që mundi. Ishte një vilë shumë e bukur në veri të *Apt*-it, por që atij iu duk si zonë këmbësorësh. I tregoi edhe një vilë të porsamobiluar në *Menerbes*, por kopshti i saj ishte shumë i vogël dhe mobilet tepër moderne për shijet e tij. Pastaj i tregoi edhe një pronë të madhe në periferi të *Lacoste*-s, e cila kishte edhe një fushë tenisi dhe pishinë të brendshme, por këto lukse dukej se fyenin prirjet social-demokrate të herr Klempit. Kështu, ajo vazhdoi t'i tregonte atij vilë pas vile, qytet pas qyteti, derisa mbeti veç një pronë në jug të *Apt*-it, në një luginë të vogël bujqësore, me një tokë të mbjellë me vreshta dhe trumza rrotull saj.

- Kjo më duket e mrekullueshme, - tha herr Klempi.

- Por është pak e izoluar.

- Më pëlqen kështu.

Kjo i pëlqente edhe asaj gruaje. Madje, sikur të kishte mundësi, ajo do ta kyçte herr Klempin në pronën më të izoluar të Francës e do t'i hidhte çelësat në det. Megjithatë, nuk e shprehu zemëratën dhe i tregoi çdo dhomë të shtëpisë. Nuk e di pse, por iu duk se atij i interesonte më shumë hyrja e saj, edhe pse ajo nuk kishte asgjë interesante. Ishte veçse

një portë e rëndë prej druri, pas së cilës të zinte syri një tavolinë të vogël dekorative dhe dy palë shkallë me gur gëlqeror, njëra prej të cilave të çonte në katin e dytë të shtëpisë, e tjetra në bodrum.

- Ka ndonjë mënyrë tjetër për të zbritur në bodrum, përveçse me anë të shkallëve?

- Jo.

- As ndonjë hyrje nga jashtë për në bodrum?

- Jo, - përsëriti gruaja. - Nëse do të ftoni mysafirë dhe t'i vini për të fjetur në katin e poshtëm, do t'ju duhet të përdorni këto shkallë.

- Keni fotografi të katit të poshtëm?

- Kam frikë se nuk ka shumë për të parë atje. Është vetëm një dhomë dhe lavanderia.

- Vetëm kaq?

- Është edhe një depo, por nuk ofrohet për qiramarrësit. Pronarët kanë kyçur gjërat personale atje.

- Po ndërtesa të tjera ka në këtë pronë?

- Ka pasur dikur, - tha ajo, - por u prishën gjatë rinovimeve të fundit që u bënë.

Ai vuri buzën në gaz, mbylli broshurën dhe e kaloi përmes tavolinës, drejt gruas.

- Them se e gjeta atë që më duhet.

- Kur keni ndër mend ta merrni?

- Pranverën që vjen. Por nëse është e mundur, - shtoi pas pak, - do të doja ta shikoja që tani.

- Kam frikë se tani është e zënë.

- Vërtet? Deri kur?

- Qiramarrësit kanë thënë se do të largohen që aty pas tri ditësh.

- Kam frikë se deri atëherë unë do të kem ikur nga *Provence*.

- Më vjen keq, - tha gruaja.

Gabrieli e kaloi pjesën tjetër të pasdites duke u shtirur si klient i interesuar për të marrë me qira një vilë në *Luberon*, duke u endur me

motorin e tij deri në perëndim, kur e parkoi atë në një vend të izoluar në buzë të luginës me tri vilat. Keleri duhej të vinte aty në orën gjashtë fiks, por kaluan dhjetë minuta dhe nuk po dukej kurrkund. Atëherë, Gabrieli ndjeu praninë e dikujt pas shpine. U kthye beftas dhe pa anglezin që qëndronte në errësirë, i ngurtë si një statujë.

- Sa kohë ke që qëndron aty? - e pyeti Gabrieli.

- Dhjetë minuta, - ia ktheu Keleri.

Gabrieli ndezi motorin dhe u nisën.

18

APT, FRANCË

Keleri i tha portierit se kishte ecur nëpër male, prandaj i kishte faqet dhe shpatullat me pluhur, e rrobat i mbanin gjithashtu atë aromë. Kur hyri në dhomën e tij, u rrojt me kujdes dhe ndezi cigaren e parë në dy ditë. Pastaj zbriti në restorant, ku hëngri një vakt të bollshëm dhe piu një shishe të shtrenjtë vere *Bordeaux*, të cilën e kishte marrë në qilarin e Marsel Lakruasë. I kënaqur, më pas, eci rrugëve të heshtura të qytetit të vjetër, deri në bazilikë. Anijata ishte zhytur në errësirë dhe dukej e shkretuar, përveç pranisë së Gabrielit, i cili ishte ulur para rreshtave me qirinj të ndezur.

- A je i sigurt? - e pyeti ai Kelerin kur iu afrua.

- Po, - ia ktheu Keleri duke pohuar ngadalë.

- Ti e pe atë?

- Jo.

- Atëherë nga e di që është atje?

- E di, sepse i dalloj veprimet kriminale, - tha Keleri i bindur. - Atje ose ka një laborator metamfetamine, ose po shpikin ndonjë bombë, ose mbajnë një vajzë angleze të rrëmbyer. Unë jam i sigurt për këtë të fundit.

- Sa veta ishin në atë shtëpi?

- Brosardi, një grua dhe dy marsejezë të tjerë. Djemtë nuk dalin gjatë

ditës, por natën dalin për të pirë cigare dhe për të marrë ajër të pastër.

- Shkojnë vizitorë?

Keleri tundi kokën dhe tha:

- Gruaja del një herë në ditë për të bërë psonisje dhe për të përshëndetur fqinjët. Lëvizje të tjera nuk ka.

- Sa vonohet ajo kur del?

- Ditën e parë u vonua një orë e njëzet e tetë minuta, ndërsa ditën e dytë dy orë e njëzet minuta.

- E adhuroj saktësinë tënde.

- Se mos kisha punë tjetër!

Gabrieli e pyeti se si e kalonte ditën Brosardi.

- Ai shtiret sikur është me pushime, - shpjegoi Keleri, - por bën edhe ndonjë xhiro rreth e rrotull vilës për të hedhur ndonjë sy. Madje, nja dy herë për pak jemi përplasur.

- Çfarë bëjnë natën?

- Njëri rri gjithmonë zgjuar. Shikojnë televizor në dhomën e ndenjjes ose dalin në kopsht.

- Nga e dallon ti që shikojnë televizor?

- Ndriçimi i televizorit dallohet nga dritaret. Meqë ra fjala, - shtoi ai, - dritaret nuk hapen kurrë. Asnjëherë.

- Po ndonjë dritë tjetër rri ndezur natën?

- Brenda jo, - tha Keleri, - por jashtë dritat rrinë të ndezura si për Krishtlindje.

Gabrieli u ngrys. Kelerit iu hap goja dhe më pas e pyeti për Parisin.

- Ishte i ftohtë.

- Parisi apo takimi?

- Të dyja, - ia ktheu Gabrieli. - Sidomos kur unë sugjerova të merreshin autoritetet franceze me shpëtimin.

- Pse duhet ta bëjmë këtë?

- Kështu tha edhe Grahami.

- Më habite.

- Ti mendon njësoj si ata në *Downing Street*.

Keleri bëri sikur nuk e dëgjoi këtë. Gabrieli pa dritën e valëvitur të qirinjve para se t'i tregonte Kelerit se si shkoi pjesa tjetër e takimit me

Graham Sejmurin, për vendstrehimin e sigurt të Byrosë në *Cherbourg*, për komitetin e pritjes që do të ngrinte Byroja dhe për kthimin e tij të qetë në Angli, me një pasaportë false të siguruar po nga Byroja. Gjithçka ishte llogaritur, përveç një gjëje. Ata duhej ta nxirrnin Madalenën nga ajo vilë shpejt dhe pa bërë bujë. Pa të shtëna armësh dhe pa ndjekje me makinë.

- Të shtënat e armëve janë për kaubojt, - tha Keleri, - ndërsa ndjekjet me makina njerëzit i shohin vetëm nëpër filma.

- Si do të kalojmë në hapësirën e ndriçuar pa na vënë re rojat?

- Nuk do të kalojmë.

- Ma shpjego pak këtë.

Keleri ia shpjegoi.

- Po sikur të zbresë Brosardi apo ndonjë nga të tjerët?

- Atëherë ai që do të zbresë, mund të hajë ndonjë plumb.

- Jo mundet, por do ta hajë se s'bën, - shtoi Gabrieli dhe pa me seriozitet Kelerin për një çast. - E ke idenë se çfarë mund të ndodhë kur policia të zbulojë kufomat e tyre? Do të fillojnë të pyesin banorët rreth e rrotull dhe nuk do të kalojë shumë derisa të krijojnë identikitin e një ishanëtari të SAS-it, i cili duhej të kishte humbur jetën në Irak. Mos harro edhe pamjet e kamerave të sigurisë në hotel.

- Me atë punë do të merret *macchia*.

- Ç'do të thuash me këtë?

- Që unë do të shkoj në Korsikë dhe do ta zgjidh prej atje këtë punë.

- Mund të kalojë kohë e gjatë para se të mund të dalësh më këtej rrotull, - tha Gabrieli. - Shumë kohë.

- Do ta bëj edhe këtë sakrificë.

- Për mbretëreshën dhe atdheun tënd?

- Për vajzën.

Gabrieli e pa Kelerin në heshtje për një hop.

- Më duket se i paske zët ata që lëndojnë femra të pafajshme, apo jo?

Keleri pohoi me kokë ngadalë.

- Do të më tregosh ndonjë gjë?

- Mund të të duket e pabesueshme, - tha Keleri, - por nuk jam në humor për të hapur librin e kujtimeve me ty.

Gabrieli buzëqeshi.

- Paska shpresë edhe për ty, domethënë, Keler.

- Një fije, - ia ktheu anglezi.

Gabrieli ndjeu zhurmë hapash në kishë dhe kur u kthye, pa prapë gruan me mushamanë e shiut, tek ecte ngadalë drejt anijatës. Sërish, ajo u ndal për një çast para altarit kryesor dhe bëri kryqin me kujdes duke vënë dorën nga balli në zemër, e pastaj në shpatullën e majtë dhe në të djathtën.

- Afati i fundit është nesër, - tha Gabrieli. - Pra, ne duhet të mësyjmë sonte.

- Sa më shpejt, aq më mirë.

- Na duhen më shumë forca që të mbarojmë punë shpejt, - tha Gabrieli zymtë.

- E di.

- Mund të shkojnë keq shumë gjëra.

- E di edhe këtë.

- Nuk e dimë as nëse ajo është në gjendje të ecë.

- Po nuk qe, do ta marrim në krahë, - tha Keleri. - Nuk do të ishte hera e parë për mua. Kam mbajtur shumë shokë në krahë në fushëbetejë.

Gabrieli pa gruan me mushamanë e errët që i kishte ngulur sytë në hapësirë, e më pas flakën e qirinjve që valëvitej ngadalë.

- Kush mendon ti se është? - pyeti pas pak.

- Kush?

- Poli.

- Nuk e di, - tha Keleri duke u ngritur, - por dije që po e kapa, është i vdekur.

Kur dolën nga kisha, Gabrieli u kthye në hotel, ku njoftoi menaxherin se do të largohej prej aty. E siguroi se nuk kishte ndonjë gjë serioze. Ishte thjesht një krizë e vogël familjare, të cilën vetëm ai, herr Johanes Klempi që s'e kishte shokun, mund ta zgjidhte. Menaxheri buzëqeshi me keqardhje, por në të vërtetë, ishte i kënaqur që ai do të largohej nga hoteli. Pastrueset e dhomave e kishin cilësuar atë haptazi si klientin më

të mërzitshëm të sezonit, madje Mafuzi, portieri i hotelit, nuk donte ta shikonte me sy fare.

Por pikërisht ai, Mafuzi, i cili qëndronte si shtyllë te porta e hotelit, e përshëndeti me mirësjellje kur doli prej atje. Gabrieli erdhi rrotull rrugëve të qytetit për disa minuta, për t'u siguruar që nuk po e ndiqnin. Pastaj, me dritën e përparme të fikur, u ra përmes rrugëve të ngushta me pluhur e zhavorr përgjatë luginës me tri vilat. Njëra prej tyre, ajo në lindje, ishte e ndriçuar si për ndonjë rast të veçantë. Keleri po e priste mes një korijeje me pisha, me sytë gjithë vëmendje nga vila. Gabrieli iu afrua dhe filloi të shihte edhe ai andej. Disa minuta më pas, në kopsht u shfaq hija e dikujt dhe u ndez një dritë tjetër. Keleri zgjati krahun dhe pëshpëriti:

- Bam, bam, bam, je i vdekur!

Ata ndenjën poshtë pishave derisa "hija" u kthye në vilë. Pastaj u ulën në *Renault*-in e Kelerit dhe rrahën detajet e fundit të mësymjes së tyre, folën për pozicionet, drejtimin nga do të qëllonin dhe se si do të vepronin kur të hynin në vilë. Pas njëzet minutash diskutimesh, e vetmja gjë që kishte mbetur për t'u vendosur, ishte se cili do të qëllonte i pari. Gabrieli këmbënguli të ishte ai, por Keleri nuk pranoi. I kujtoi se ai kishte arritur numrin më të lartë të vrasjeve në Hereford.

- Ato kanë qenë prova, - tha Gabrieli pa i kushtuar rëndësi faktit.

- Prova me plumba të vërtetë, - i kujtoi Keleri.

- Prapë prova mbeten.

- Ore, ku do të dalësh ti?

- Unë kam qëlluar njëherë një terrorist palestinez në lule të ballit, edhe pse isha duke ecur me motor.

- E çfarë pastaj?

- Terroristi ishte ulur në një kafene të mbushur me njerëz në bulevardin "Saint Germain", në Paris.

- Po, - tha Keleri gjoja i mërzitur, - më duket se kam lexuar diçka për këtë në librat e mi të historisë.

Përfundimisht, e lanë ta vendosnin kokë a pilë.

- Kujdes se mos humbet, - tha Gabrieli.

- Unë nuk humbas kurrë.

Ndërkohë, ora po shkonte tetë. Ishte ende herët. Keleri mbylli sytë dhe mori një sy gjumë, ndërsa Gabrieli nuk ia ndante sytë vilës në lindje të luginës. Ai imagjinoi një dhomë të vogël në katin e poshtëm ku ndodhej një shtrat portativ, një kapuç, një kovë që shërbente si tualet, mure me sfungjer për të mbytur të bërtiturat dhe një femër që nuk ishte më në vete. Për një çast, e imagjinoi veten duke ecur në dëborë në malet e Rusisë, drejt një *dacha*[4]-je, përgjatë një pylli me mështekna. Por shumë shpejt e largoi atë mendim dhe kaloi gishtat nëpër koralin e kuq që i varej në qafë. *Pasi të vdesë ajo*, kujtoi ai, *ti do ta mësosh të vërtetën*.

Katër orë më pas, ai e shkundi lehtë Kelerin nga shpatullat. Keleri u ngrit sakaq, doli nga makina e nxori çantën e shpinës nga bagazhi. Nxori prej saj dy rrotulla me shirit ngjitës, një palë darë të mëdha dhe dy silenciatorë, një për pistoletën e vet HK45 dhe tjetrin për beretën e Gabrielit. Gabrieli e vidhosi silenciatorin në tytën e beretës, pastaj hodhi çantën në shpinë dhe ndoqi Kelerin përmes pishave e përgjatë buzës së luginës. Ishte një natë pa yje, pa hënë dhe pa një puhizë ere. Keleri lëvizte në qetësi përmes shkurreve dhe formacioneve shkëmbore, ngadalë, sikur të ishte nën ujë. Çdo disa hapa ngrinte dorën e djathtë dhe Gabrieli pas tij, ndalej sakaq. Ky ishte komunikimi i vetëm që bënë atë copë rrugë. Nuk ishte nevoja për më shumë. Çdo hap, çdo lëvizje, ishte diskutuar paraprakisht.

Kur mbërritën në rrëzë të kodrës, u ndanë. Keleri mori për nga ana jugore e vilës dhe u vendos në një kanal drenazhimi, ndërsa Gabrieli për nga ana lindore derisa u fsheh në një shqopishtë. Pozicioni i tij ishte pesëmbëdhjetë metra përtej vijës ku ndriçimi i jashtëm i vilës nuk mbërrinte dhe mbretëronte errësira. Përballë tij, ishte një portë franceze që të çonte nga kopshti i vilës në dhomën e ndenjjes. Nga grilat, ai pa dritën e televizorit dhe iu duk se pikasi edhe hijen e një femre.

Pa orën. Kishte shkuar 2:37 pas mesnate. U mbeteshin edhe tri orë errësirë e pastaj do të zbardhte dita. Nëse ai tipi i cili dilte ndonjëherë në kopsht për të marrë ajër të pastër, nuk dilte gjatë kësaj kohe, nuk do të

[4] Kështu quhen shtëpitë e dyta të banorëve të Rusisë dhe atyre të ish-Bashkimit Sovjetik, të ndërtuara kryesisht në fshat.

dilte më. Me siguri që do të dilte, ndonëse ishte një natë pa hënë dhe pa erë. E kur të dilte, nga kanali i drenazhimit në pjesën jugore të vilës, do të vinte një plumb i vetëm. Atëherë do të niste: krevati portativ, prangat, kova që shërbente si tualet dhe vajza që nuk ishte më në vete.

Pa sërish orën. Kishin kaluar vetëm dy minuta. Ai dridhej nga të ftohtët. Ndoshta nuk e kishte pasur keq Keleri kur i tha se ai ishte agjent i mësuar të vepronte nga zyra dhe jo në terren. Për të kaluar disi koha, imagjinoi sikur nuk ishte në një shqopishtë, por para një kanavace, para pikturës që kishte lënë përgjysmë në Jerusalem, Suzanës duke u larë në kopshtin e saj para syve të më të moçmëve të fshatit. Sërish, vuri Madalenën në rolin e Suzanës, ndonëse plagët që po i shëronte tani nuk ia hapte më koha, por robërimi. Po punonte ngadalë, por me përqendrim të lartë, duke i riparuar plagët në kyçet e duarve, duke i shtuar mish shpatullave të atrofizuara dhe ngjyrë faqeve të zbehura. Gjatë gjithë kohës, vëzhgonte kalimin e minutave dhe nuk ia ndante sytë vilës, e cila i shfaqej në sfondin e pikturës. Për dy orë nuk pati asnjë lëvizje. Pastaj, sapo në qiell u hap rrezja e parë e dritës, një nga dyert franceze u hap ngadalë dhe prej saj doli në kopsht një burrë. Ai hapi krahët, hodhi sytë majtas, pastaj djathtas dhe sërish majtas. Me kërkesën e Madalenës, Gabrieli e përfundoi shpejt e shpejt restaurimin dhe kur pa një dritë nga ana jugore, u ngrit me armën në dorë dhe nisi të vraponte.

19

LUBERON, FRANCË

Në kohën kur shkeli kufijtë e dritës, Gabrieli pa Kelerin duke mësyrë me shpejtësi përmes kopshtit. Anglezi mbërriti te dyert e hapura franceze dhe zuri pozicion në të majtë të tyre. Gabrieli shkoi në të djathtë dhe i hodhi një sy të shpejtë njeriut, i cili disa sekonda më parë kishte dalë në kopsht për të marrë pak ajër të pastër. Nuk ishte nevoja t'i maste pulsin sepse sakaq, pistoleta e kalibrit 45 e Kelerit, qëlloi duke i përshkuar kafkën atij. Ai as që e mori vesh se nga i erdhi dhe ndoshta vdiq që para se të binte përtokë. Gabrieli mendoi se kjo ishte një mënyrë e denjë për t'u larguar nga kjo botë. Qoftë për një kriminel, ushtar apo këdo tjetër.

Hodhi sytë nga Keleri. Pozicionet e tyre ishin identike; me një shpatull të mbështetur në pjesën e jashtme të vilës, dy duart e mbërthyera pas armës me tytën e drejtuar përtokë. Pas disa sekondash, Keleri ia bëri me kokë. Pastaj, ngriti pistoletën HK para syve dhe hyri në vilë në heshtje. Gabrieli e ndoqi duke mbuluar djathtas teksa Keleri vëzhgonte pjesën e majtë të dhomës. Nuk kishte asnjë lëvizje dhe asnjë tingull tjetër veç atij të televizorit, ku Xhimi Stjuart po tërhiqte Kim Novakun nga ujërat e gjirit të San Franciskos. Në dhomë ndihej aroma e ushqimit të prishur, e duhanit dhe e verës së derdhur. Ngado të zinte syri kuti kartoni bosh. *Një*

muaj në Provence, mendoi Gabrieli, *jetë sipas stilit të kriminelëve francezë*.

Keleri bëri disa hapa para përmes dritës së televizorit, pa e ulur pistoletën, në vigjilencë të plotë. Gabrieli qëndronte gjysmë hapi mbrapa tij, me armën e drejtuar në krahun e kundërt me të, por me lëvizje të njëjta. Kështu mbërritën në një mur të harkuar, i cili ndante dhomën e ndenjjes me atë të ngrënies. Gabrieli hodhi një sy brenda saj duke drejtuar armën në të gjitha drejtimet, pastaj pa edhe nga ana e Kelerit. Në hyrje të kuzhinës, përsëriti të njëjtat lëvizje. Doli se të dyja dhomat ishin bosh, të mbushura vetëm me pjata të palara dhe kuti kartoni sipër njëra-tjetrës. Pisllëku i atij vendi bëri që Gabrielit t'i vlonte gjaku nga inati. Dihej se kriminelët që jetonin si derra, i trajtonin shumë keq pengjet.

Në fund, mbërritën te porta e vilës. Ishte vendi i vetëm në vilë, që ngjante me fotografitë që kishte parë Gabrieli në zyrat e Agjencisë Imobiliare të Luberonit. Porta e rëndë prej druri, tavolina e vogël dekorative, dy palë shkallët me gur gëlqeror, njëra prej të cilave të çonte në katin e dytë, ndërsa tjetra në bodrum. Të dyja ato, tani ishin zhytur në errësirë.

Keleri zuri pozicion mes dy palë shkallëve teksa Gabrieli nxori një elektrik dore nga xhepi, por nuk e ndezi dhe zbriti verbazi e ngadalë një, dy, tri, katër shkallë. Kur arriti në gjysmë të tyre, dëgjoi një tingull nga sipër. Ishin zhurmë hapash të shpejtë. Pastaj dëgjoi dy tinguj të mbytur, njëri ishte tingulli i një HK45-she, që bëri shpejt e shpejt dy goditje të njëpasnjëshme.

Dikush kishte zbritur poshtë.

Dikush ishte përplasur me njeriun që kishte arritur numrin më të lartë të vrasjeve në Hereford.

Dikush kishte vdekur.

Gabrieli ndezi elektrikun e dorës dhe i zbriti shkallët si era, dy e nga dy.

Në fund të tyre ndodhej një holl me një dysheme të shtruar me pllaka dhe dyer në të tri muret. Depoja e pronarit ishte në të majtë. Nën ndriçimin e elektrikut të dorës, dryni i saj shkëlqeu, shenjë që tregonte edhe se ishte ende i ri. Gabrieli lëshoi çantën nga shpina, nxori darët, i

shtrëngoi dhe i rrotulloi disa herë rreth drynit derisa e hapi duke e shpartalluar dhe e hodhi derën përtokë, fuqishëm. Aroma brenda depos i bëri përshtypje sakaq. Erë djerse që t'i sillte zorrët në fyt. Ishte era e një njeriu të mbajtur peng. Kaloi elektrikun nëpër gjithë hapësirën. Aty pa krevatin portativ, prangat, kapuçin, kovën që shërbente si tualet dhe muret me sfungjer për të mbytur klithmat.

Por Madalena nuk ishte aty.

Sipër u dëgjuan edhe dy zhurma të mbytura nga silenciatori HK i Kelerit.

Pastaj edhe dy të tjera.

Trupi i parë ishte në korridor, në rrëzë të shkallëve që të çonin në katin e sipërm. Ishte një nga rojat që nuk dilte nga vila. Tani, falë dy shkrepjeve të pistoletës me kalibër 45, ai ishte bërë fërtele. E njëjta gjë vlente edhe për Rëne Brosardin, i cili ishte shtrirë sa gjatë gjerë pranë tij, me armën që nuk mundi ta shkrehte, në dorë. Në sheshpushimin e katit të dytë gjendej gruaja. Keleri nuk kishte dashur ta qëllonte atë, por kishte qenë i detyruar. Ajo i kishte drejtuar armën dhe dukej që e kishte seriozisht. Megjithatë, ai nuk e kishte qëlluar në fytyrë, por dy herë në pjesën e sipërme të trupit. Për pasojë, ajo ishte e vetmja ndër të tre, ende gjallë. Gabrieli ra në gjunjë pranë saj dhe i mbajti dorën. Kur e preku, ishte e ftohtë.

- Do të vdes? - e pyeti ajo.

- Jo, - ia ktheu ai duke ia shtrënguar lehtë dorën. - Nuk do të vdesësh.

- Më ndihmo, - i tha ajo. - Më ndihmo, të lutem.

- Do të të ndihmoj, - iu përgjigj Gabrieli. - Por edhe ti duhet të më ndihmosh mua. Më thuaj ku mund ta gjej vajzën.

- Ajo nuk është këtu.

- Po ku është?

Gruaja u përpoq të nxirrte disa fjalë nga goja, por nuk mundi.

- Ku është? - e përsëriti pyetjen Gabrieli.

- Të betohem që nuk e di, - u përgjigj ajo duke u dridhur dhe sytë e saj po e humbisnin përqendrimin. - Të lutem, - pëshpëriti, - më ndihmo.

- Kur ka qenë këtu për herë të fundit?
- Para dy ditësh. Jo, para tri ditësh.
- Kur?
- Nuk e kujtoj mirë. Të lutem, të lutem, më ndih...
- Ajo ishte këtu para apo pasi ti dhe Brosardi shkuat në *Aix*?
- Nga e di ti që ne shkuam atje?
- Përgjigju, - i tha Gabrieli duke ia shtrënguar sërish dorën. - Përpara apo pas?
- Atë natë erdhi.
- Kush e mori?
- Poli.
- Vetëm Poli?
- Po.
- Ku e çoi?
- Në vendstrehimin tjetër.
- Kështu e quajti ai, vendstrehimin tjetër?
- Po.
- Ku ndodhet ai vend?
- Nuk e di.
- Ma thuaj, - i përsëriti Gabrieli.
- Poli nuk na e tregoi vendin, por e quajti sigurimi operativ.
- Pikërisht këto fjalë përdori? Sigurimi operativ?
Ajo pohoi me kokë.
- Sa vendstrehime të sigurta ka atje?
- Nuk e di.
- Dy, tre?
- Poli nuk na e tha këtë.
- Sa kohë ka qëndruar ajo atje?
- Që në fillim ka qenë atje, - tha gruaja dhe pastaj dha shpirt.

Ata i shtrinë të katra kufomat në dyshemenë e depos dhe i mbuluan me çarçafë të bardhë, të pastër. Nuk kishin ç'të bënin për gjakun

nëpër shtëpi, por kur dolën jashtë, Gabrieli u dha një zorrë shpejt e shpejt gurëve të kopshtit për të fshirë gjurmët e asaj që kishte ndodhur atje. Mendoi se kishin dyzet e tetë orë kohë para se punonjësja e Agjencisë Imobiliare të Luberonit të vinte për të marrë çelësat e klientëve, të cilët do të largoheshin, dhe të merrej me pastrimin. Pasi të zbulonte gjakun, ajo do të njoftonte menjëherë xhandarmërinë, që më pas do të zbulonte edhe katër kufomat në depon e pronarëve të vilës - një depo e boshatisur dhe e kthyer në qeli për viktimën e rrëmbyer. *Dyzet e tetë orë*, mendoi Gabrieli. *Ndoshta edhe diçka më shumë, por jo shumë*.

Kur ata u larguan nga lugina dhe u kthyen në vendin ku kishin lënë motorin dhe *Renault*-in e vjetër të Kelerit, kishte nisur të zbardhte dita. Gabrieli u ndal të hidhte edhe një sy të fundit; e vetmja gjë që lëvizte në luginën poshtë tyre ishte figura e një bujku nëpër vreshta. Futën çantat e shpinës në bagazhin e makinës së Kelerit dhe udhëtuan veçmas për në *Buoux*, ku ndaluan për një briosh dhe makiato në një kafene të mbushur me vendas faqekuqë. Aroma e bukës së sapopjekur, papritmas e bëri Gabrielin të ndihej keq. I telefonoi Graham Sejmurit në Londër dhe në një gjuhë të koduar i raportoi se, misioni kishte dështuar, Madalena kishte qenë në atë vilë më parë, por e kishin shpërngulur para afro shtatëdhjetë e dy orësh.

Pista e tyre kishte dalë e pavlefshme, i tha ai para se ta mbyllte. Tani nuk u mbetej veçse të prisnin që Poli të bënte kërkesat e radhës.

- Po sikur ai të mendojë se është shumë e rrezikshme të paraqesë kërkesa të tjera tani? - pyeti Keleri. - Po sikur ta vrasë?
- Pse je gjithmonë kaq pesimist ti?
- Më duket se ke filluar të ma nxjerrësh mua inatin.

Ata u larguan nga *Luberoni* nga e njëjta rrugë që kishin marrë atë natë që kishin ndjekur Rëne Brosardin dhe gruan nga *Aix*-i; poshtë shpatit të masivit, përgjatë lumit *Durance*, lanë pas bregun e rezervuarit në Shën Kristof derisa në fund, mbërritën në Marsejë. Në drekë nisej një traget për në Korsikë. Blenë secili nga një biletë dhe më pas u ulën në tavolina të veçanta, por pranë njëri-tjetrit, në një kafe në port. Gabrieli piu çaj, ndërsa Keleri birrë. Ai dukej që ishte i ngrysur. Nuk i ndodhte shpesh të kthehej në Korsikë pa e përmbushur misionin e tij.

- Nuk ishte faji yt, - i tha Gabrieli.

- Unë të thashë që ajo ishte atje, - u përgjigj ai. - Por ajo nuk ishte.

- Por të gjitha shenjat *tregonin* se do të ishte.

- Pse? - pyeti Keleri. - Pse bënin rojë me turne kur Madalena ishte larguar që aty?

Atë çast, celulari i Gabrielit u drodh. Ai e ngriti ngadalë te veshi, e dëgjoi në qetësi dhe pastaj e vendosi mbi tavolinë.

- Grahami ishte? - e pyeti Keleri.

Gabrieli pohoi me kokë.

- Dikush kishte lënë një telefon të ngjitur poshtë një stoli në parkun "Hyde" mbrëmë.

- Ku është ai telefon tani?

- Në *Downing Street*.

- Kur duhet të telefonojë ai?

- Pas pesë minutash.

Keleri përfundoi birrën dhe porositi sakaq një tjetër. Kaluan pesë minuta, pastaj edhe pesë të tjera. Nga jashtë u dëgjua një njoftim që këshillonte pasagjerët e tragetit për në Korsikë të bëheshin gati. Zëri i megafonit thuajse e mbyti zhurmën e celularit të Gabrielit që ra sërish. Ai e ngriti, e vuri ngadalë te veshi dhe sërish e dëgjoi në heshtje.

- Hë? - e pyeti Keleri pasi ai futi celularin në xhep.

- Poli e ka bërë kërkesën e tij.

- Sa kërkon?

- Dhjetë milionë euro.

- Vetëm kaq?

- Jo, - tha Gabrieli. - Kryeministri do të flasë me mua.

Jashtë, një varg makinash po futeshin në traget. Keleri u ngrit në këmbë dhe Gabrieli e përcolli me sy teksa largohej.

20

MARSEJË - LONDËR

Fluturimi i radhës për në aeroportin "Heathrow" ishte në orën pesë të pasdites. Gabrieli bleu një palë rroba të reja në një dyqan pranë *Old Port*-it dhe u regjistrua në një hotel pranë stacionit të trenit sa për t'u larë dhe ndërruar. Rrobat e vjetra i futi në një kosh mbeturinash mbrapa një restoranti, ndërsa motorin e la në një vend ku ishte i sigurt se do ta vidhnin sapo të binte nata dhe pastaj mori një taksi për në aeroport. Terminali kryesor dukej si i shkretuar nga një betejë e ashpër. Gabrieli lexoi portalet kryesore të lajmeve franceze për të parë se mos kishin shkruar gjë për katër trupa të gjetur në një luginë të qetë me emrin Luberon, pastaj bleu një biletë të klasit të parë për në Londër në emrin e Johanes Klempit. Gjatë fluturimit ai refuzoi ushqimin e avionit dhe gjithë përpjekjet për të hyrë në bisedë të bankierit zviceran që ishte ulur pranë tij. I mbajti sytë në dritare gjatë gjithë kohës, ndonëse atë mbrëmje nuk kishte shumë për të parë. Një shtresë e dendur reje kishte mbuluar thuajse gjithë Europën Veriore. Vetëm kur avioni ishte disa mijëra metra mbi tokë, llambushkat e verdha të Londrës Veriore e çanë disi zymtësinë. Gabrielit ato iu dukën si një det qirinjsh kushtimorë. Ai mbylli sytë dhe në mendimet e tij pa një grua të mbështjellë me mushama shiu, e cila qëndronte para altarit të një kishe të lashtë të kredhur në errësirë dhe bënte kryqin pa parë se ç'bëhej rreth e rrotull saj.

Kur po dilte nga avioni, iu bashkua një rreshti udhëtarësh që mbanin radhë te kontrolli i pasaportave. Oficeri i doganës, një *sikh*[5] mjekrosh, i cili kishte vënë në kokë një dastar[6] mbretëror në ngjyrë blu, e këqyri pasaportën me gjithë skepticizmin që meritonte dhe pastaj, pasi e vulosi me një të goditur të fuqishme, i uroi mirëseardhjen në Britaninë e Madhe. Gabrieli e ktheu pasaportën në vendin e vet në xhepin e palltos dhe mori për nga holli i mbërritjeve, ku i vetëm, në mes të turmës dhe me një tabelë ku lexonte "Zoti Bejkër" në dorë, e priste një operativ i MI5-s me emrin Nigel Uajtkomb. Ai ishte ndihmësi i Graham Sejmurit dhe njeriu që i kryente atij të gjitha punët personale. Ishte në mesin e të tridhjetave, por kishte pamjen e një adoleshenti të rritur. Faqet i kishte të kuqe, nuk kishte flokë dhe buzëqeshja që i dha Gabrielit teksa i shtrëngonte dorën, ishte aq e pafajshme sa edhe ajo e një pastori. Pamja e tij kaq e paqtë e dashamirëse i kishte shërbyer shumë MI5-s. Ajo arrinte të fshihte një mendje djallëzore dhe dhelpërake, më keq se të një terroristi apo krimineli.

Për shkak të natyrës së fshehtë të vizitës së Gabrielit, Uajtkombi kishte ardhur me makinën e tij personale në aeroportin "Heathrow", një makinë e tipit *Vauxhall Astra*. Rrugës së kthimit nga aeroporti, ai eci me shpejtësinë e erës, a thua se e kalonte fundjavën duke garuar me makina sportive. Vetëm kur mbërritën në rrugën "West Cromwell", shigjeta e shpejtësisë ra nën tetëdhjetë kilometra.

- Mirë që jemi pranë një spitali, - tha Gabrieli.

- Pse?

- Sepse po të mos e kishe ngadalësuar tani, mund të na duhej.

Uajtkombi e hoqi pak këmbën nga gazi, por vetëm pak.

- A mund të ndalojmë për ndonjë çaj te "Harrods"?

- Mua më kanë dhënë urdhër të të çoj menjëherë atje.

- Bëra shaka, Nigel.

- E dija, e dija.

- Ti e di pse kam ardhur unë?

[5] Një fe monoteiste, e cila e ka zanafillën në fillim te shekullit 15, në Azinë Jugore.

[6] Çallma e besimit sikh, me rëndësi të veçantë në kulturën e kësaj feje.

- Jo, - u përgjigj Uajtkombi, - por duhet të jetë me rëndësi të veçantë. Nuk e kisha parë Grahamin kështu, që kur... - dhe sakaq i iku zëri.

- Që kur? - e pyeti Gabrieli.

- Që atë ditë kur ai kamikazi i Al Kaedës hodhi veten në erë në *Covent Garden*.

- Kohë të mira ato, - tha Gabrieli i ngrysur.

- Ai ishte një nga operacionet tona më të mira, nuk je dakord për këtë?

- Po, përveç pjesës së fundit.

- Le të shpresojmë që të mos shkojë edhe ky kështu.

- Të shpresojmë, - tha Gabrieli.

Pasi depërtuan me zotësi nëpër trafikun e parkut "Hyde", Uajtkombi kaloi me vështirësi pranë Pallatit Bakingam, për në "Bircage Walk". Kur po kalonin në "Wellington Baracks", ai shtypi një buton në celularin e tij, seç mërmëriti diçka për dorëzimin e një pakoje dhe pastaj e mbylli papritur. Dy minuta më pas, në rrugën "Old Queen", parkoi pas një limuzine *Jaguar*. Në ndenjëset e pasme të saj, me një pamje të vrerosur, ndodhej Graham Sejmuri.

- Ti nuk ke ndonjë kostum serioz? - e pyeti ai Gabrielin kur rrëshqiti në ndenjësen pranë tij.

- Kisha, në fakt, por ata të *British Airways*-it më humbën valixhen, - ia ktheu Gabrieli.

Sejmuri u ngrys, pa nga shoferi i tij dhe tha:

- Te Numri 10.

Numri 10 në *Downing Street*, me siguri ishte një ndër adresat më të famshme të botës, e cila dikur ruhej nga dy policë të zakonshëm londinezë, njëri prej të cilëve bënte rojë jashtë derës së zezë e të zymtë, ndërsa tjetri qëndronte i ulur në hollin e madh, në një karrige të rehatshme prej lëkure. Por e gjitha kjo ndryshoi pas sulmit të IRA-s në *Downing Street* në shkurt të vitit 1991. Në hyrje të rrugës u ngritën gardhe sigurie dhe vendin e dy policëve të thjeshtë londinezë e zunë forca të armatosura rëndë të grupit diplomatik të *Scotland Yard*-it. *Downing Street*, ashtu si

edhe Shtëpia e Bardhë, tani ishte kthyer në një vendfushim të fortifikuar, të dukshëm vetëm përmes hekurave të kangjellave.

Dikur, Numri 10 nuk kishte qenë një, por tri shtëpi; një shtëpi qyteti, një shtëpi fshati dhe një vilë e madhe e shekullit 16, e quajtur "Shtëpia e Pasme", e cila shërbente si rezidencë për familjen mbretërore. Në vitin 1732, mbreti Xhorxhi II ia ofroi pronën Sër Robert Walpole-it, kryeministrit të parë britanik, të cilit i vlente vetëm titulli dhe asgjë tjetër, dhe ai vendosi t'i bashkonte të tria shtëpitë në një. Kjo rezultoi në atë që Uilliam Pit e quajti "një shtëpi të madhe e të plogësht", e cila ishte gati të shembej dhe pak kryeministra britanikë zgjodhën të jetonin aty. Aty nga fundi i shekullit 18, ajo shtëpi ishte kandisur aq keq sa autoritetet e Thesarit të Shtetit rekomanduan që të shembej dhe, pas Luftës së Dytë Botërore, ajo ishte dëmtuar aq shumë, sa të paktë ishin ata që guxonin të shkelnin në katet e sipërme të saj, nga frika se mos shembej papritur dhe i zinte brenda. Më në fund, në fund të viteve 1950, qeveria ndërmori një iniciativë të pakthyeshme për ta rimëkëmbur. Pas një vonese për shkak të grevave të punës dhe zbulimit të artefakteve mesjetare poshtë themeleve të saj, u deshën tri vjet që projekti të përfundohej dhe kësisoj, edhe kostoja për rinovimin e saj u trefishua. *Harold Macmillan*, kryeministri i atëhershëm, jetoi në *Admiralty House* gjatë asaj kohe. Pjesa më e madhe e vizitorëve të *Downing Street*, hynin nga porta e sigurisë në *White Hall* dhe mandej në Numrin 10 përmes derës së zezë. Megjithëkëtë, atë mbrëmje, Graham Sejmuri dhe Gabrieli hynë nga rruga "Horse Guards" e më pas për në rezidencë nga një portë franceze që shihte nga kopshti i rrethuar me mur. Në holl i priste një nga sekretaret e zyrës private të Lankasterit, një grua e kallkanosur, e cila mbante para vetes një dosje lëkure, si ta kishte mburojë. Ajo përshëndeti me kokë Sejmurin dhe shmangu kontaktin me sy me Gabrielin. Pastaj, u kthye dhe i udhëhoqi nëpër një korridor të gjatë elegant derisa mbërritën para një dere të mbyllur, në të cilën trokiti lehtë.

- Hyr! - tha zëri i dytë më i famshëm në Britani dhe sekretarja e ngrirë i udhëhoqi brenda.

21

DOWNING STREET

Pas kaq vitesh punë në Shërbimet Sekrete, Gabrieli nuk e mbante më mend se sa herë kishte hyrë në një dhomë të mbushur me mister. Pavarësisht nga natyra dhe kushtet e ngjarjes, ishte gjithmonë njësoj. Një burrë bënte ecejake nëpër tapet, një tjetër i kishte ngulur sytë jashtë dritares, ndërsa një i tretë përpiqej dëshpërimisht të dukej i qetë dhe sikur e kishte situatën në kontroll, edhe pse nuk ishte aspak kështu. Në këtë rast, dhoma ishte salla e bardhë e pikturës në Numrin 10. Njeriu që bënte ecejake nëpër tapet ishte Simon Hjuiti, ai që i kishte ngulur sytë kuturu përjashta ishte Xheremi Faloni, ndërsa ai që përpiqej të ruante qetësinë ishte kryeministri Xhonatan Lankaster. Ky i fundit ishte ulur në një nga dy kolltukët e vendosur përballë njëri-tjetrit para oxhakut. Në tavolinën e ulët drejtkëndore para tij, ndodhej një celular - celulari që kishin lënë në parkun "Hyde" mbrëmjen e kaluar. Lankasteri ia kishte ngulur sytë aparatit, a thua se ishte ai dhe jo Madalena Harti, burimi i kësaj andralle.

Ai u ngrit në këmbë dhe iu afrua Gabrielit dhe Sejmurit me aq kujdes, a thua se po kalonte në kuvertën e një anijeje në det të ashpër. Ishte më i gjatë nga sa e kishte imagjinuar Gabrieli dhe pavarësisht nga sforcimi për shkak të situatës, edhe më i pashëm.

- Unë jam Xhonatan Lankaster, - tha ai tërësisht pa vend, teksa i zgjaste dorën Gabrielit. - Besoj se kishte ardhur koha të takoheshim. Pavarësisht se do të doja të ishim takuar në rrethana të tjera.

- Gjithashtu, kryeministër.

Gabrieli nuk ia tha me të keq, por mënyra se si Lankasteri i rrudhi vetullat, tregoi se ai e mori si mallkim për situatën në të cilën ndodhej. E lëshoi menjëherë dorën e Gabrielit dhe më pas tregoi me dorë nga dy figurat e tjera në dhomë.

- Besoj se i njeh këta dy zotërinj, - tha pasi e rimori veten. - Ai që po e bën tapetin gropa-gropa është Simoni, zëdhënësi im i shtypit, ndërsa tjetri është Xheremi Faloni. Xheremi është truri im, nëse do t'i besonit ato që shkruajnë gazetat.

Simon Hjuiti i ndali ecejaket dhe i dha Gabrielit një përshëndetje të vagullt me kokë. I veshur pa xhaketë, me mëngët e këmishës të përthyera deri te bërryli dhe me kollaren e liruar, dukej si një reporter i cili për dy minuta do të bëjë lidhjen direkte, por nuk ka mundur të mbledhë asnjë fakt për ngjarjen. Xheremi Faloni, i cili nuk kishte lëvizur nga vendi i tij pranë dritares, ishte i gjithë i kollarisur dhe i mbërthyer mirë. Gabrieli kishte lexuar se Faloni e mendonte veten si kryeministër deri në çastin kur shihej në pasqyrë. Por me mjekër të vogël, flokë të drejtë dhe lëkurë të verdhë, ai dukej më i përshtatshëm për të bërë politikë në *Netherworld*[7].

Mbeti vetëm celulari. Pa thënë asnjë fjalë, Gabrieli e mori nga tavolina dhe kontrolloi telefonatat e bëra. Doli se në atë celular ishte bërë vetëm një telefonatë, dhe ajo gjatë kohës kur Gabrieli dhe Keleri ishin në terminalin e trageteve në Marsejë.

- Kush foli me të?

- Unë, - u përgjigj Faloni.

- Si e kishte zërin?

- Nuk ishte zëri i tij i vërtetë.

- Ishte i regjistruar me kompjuter?

Faloni pohoi me kokë.

- Kur do të telefonojë prapë?

- Në mesnatë.

[7] Është titulli i një seriali horror.

Gabrieli e fiku telefonin, i hoqi baterinë dhe kartën SIM, të cilat i vendosi mbi tavolinë dhe tha:

- Çfarë do të ndodhë në mesnatë?

Këtë herë u përgjigj Lankasteri.

- Ai pret një përgjigje "po" ose "jo". Nëse them "po", do të thotë se pranoj të paguaj dhjetë milionë euro para të thata, në shkëmbim të Madalenës dhe të premtimit se videoja nuk do të bëhet kurrë publike. Nëse them "jo", Madalena vdes dhe gjithçka do të dalë në dritë. Natyrisht, - shtoi duke psherëtirë, - unë jam i detyruar të pranoj kërkesat e tij.

- Ky do të ishte gabimi më i madh i jetës suaj, kryeministër.

- Gabimi i dytë më i madh.

Lankasteri trupgjatë u ul në kolltuk dhe mbuloi fytyrën e tij të famshme me duar. Gabrieli mendoi për njerëzit që pa atë mbrëmje nëpër rrugët e Londrës; ata ecnin të qetë, në punët e tyre, pa qenë në dijeni se kryeministri i tyre atë çast ishte i paralizuar nga frika e një skandali.

- Kam zgjidhje tjetër? - e pyeti Lankasteri pas pak.

- Mund ta denonconi në polici.

- Është vonë për këtë.

- Atëherë duhet të negocioni.

- Ai tha se nuk pranonte negociata. Tha se do ta vriste nëse nuk bie dakord që të paguaj dhjetë milionë.

- Ata ashtu thonë gjithmonë, por më besoni, kryeministër, nëse ju pranoni, ai do të zemërohet.

- Me mua?

- Jo, me veten. Do mendojë se bëri gabim që kërkoi vetëm dhjetë milionë dhe do ta rrisë shifrën. Nëse ju do të pranoni edhe për atë shumë, ai do të kërkojë më tepër derisa t'ju zhvatë deri në qindarkën e fundit, milion pas milioni.

- Çfarë më këshillon ti?

- Të presim të bjerë telefoni njëherë. Kur të marrë, do t'i themi se mund të paguajmë vetëm një milion dollarë, asnjë qindarkë më shumë. Duhet të silleni edhe ju si ai. Trajtojeni këtë çështje si çdo negociatë tjetër. Nuk ka rrugë të mesme, duhet ta vini përpara faktit. Tregohuni i duruar, kjo është mënyra e vetme që keni për ta rifituar atë vajzë.

Në dhomë pasoi një heshtje e rëndë. Xheremi Faloni e kishte braktisur tashmë vendin e tij pranë dritares dhe po vëzhgonte një pikturë, një peizazh të Londrës nga Tërneri, a thua se po e shikonte për herë të parë. Graham Sejmuri ia kishte ngulur sytë tapetit dhe nuk ia shqiste.

- Faleminderit për këshillën, - tha Lankasteri pasi u mendua një hop, - por ne... - u ndal pak aty dhe pastaj tha me bindje, - unë kam vendosur t'u jap atë çka duan. Madalena u rrëmbye për shkak të sjelljes sime të shkujdesur. E kam për detyrë ta kthej shëndoshë e mirë në shtëpi. Më takon ta bëj, për të mirën e saj dhe të kësaj zyre.

Fjalia e fundit tingëlloi sikur ta kishte shkruar Xheremi Faloni dhe kjo dukej edhe nga pamja që mori fytyra e tij e pafat.

- Juve mund t'ju takojë vërtet ta bëni, por nuk është veprim i zgjuar, - tha Gabrieli.

- Unë nuk jam dakord, - tha Lankasteri, - po ashtu, edhe Xheremi.

- Me gjithë respektin, - tha Gabrieli duke u kthyer nga Faloni, - por kur ka qenë hera e fundit që keni negociuar me sukses për lirimin e një pengu?

- Them se edhe ju do të jeni dakord, - u përgjigj Faloni, - se nuk bëhet fjalë për një rrëmbim të zakonshëm. Objektivi i zhvatjes është kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar dhe nuk kam ndër mend të lejoj që figura e tij të dëmtohet në një negociatë të gjatë dhe dërrmuese.

Faloni foli me qetësi dhe me vetëbesimin e tepruar të dikujt që është mësuar t'i pështëritë urdhra në vesh njërit prej njerëzve më me rëndësi të botës. Ky imazh ishte pasqyruar shpesh nga mediet britanike. Kjo ishte edhe arsyeja pse karikaturistët shpesh e paraqitnin Falonin si një aktor shfaqjesh me kukulla, duke mbajtur fillin në fund të të cilit spërdridhej marioneta e Xhonatan Lankasterit.

- Ku mendoni t'i gjeni paratë? - e pyeti Gabrieli.

- Disa miq të kryeministrit kanë rënë dakord t'i japin atij një hua, të cilën ai do ta kthejë sapo t'i jepet mundësia.

- Sa mirë kur ke miq të tillë, - tha Gabrieli duke u ngritur. - E po, duket se ju paskeni gjithçka në kontroll. Tani ju duhet vetëm dikush që të dorëzojë paratë. Vetëm sigurohuni që të gjeni një njeri të zotë, përndryshe, pas disa ditësh do ta gjeni prapë veten në këtë dhomë, duke pritur që të bjerë telefoni.

- Keni ndonjë kandidat ju? - pyeti Lankasteri.

- Vetëm një, - ia ktheu Gabrieli, - por kam frikë se ai është i zënë.

- Pse?

- Sepse duhet të kapë një avion.

- Kur është fluturimi i radhës për në aeroportin "Ben Gurion"?

- Në orën tetë të mëngjesit.

- Atëherë besoj se nuk e keni problem të qëndroni edhe pak këtu, apo jo?

Gabrieli ngurroi për një çast, pastaj tha:

- Jo, kryeministër, nuk besoj se ka problem.

Në atë çast, ora shënonte dhjetë e pak minuta. Gabrielit nuk ia kishte aspak ënda t'i kalonte dy orët në vijim i ngujuar në një dhomë me një politikan, karriera e të cilit ishte në buzë të greminës, kështu që zbriti në kuzhinë për të "bastisur" frigoriferin e kryeministrisë. Kuzhinierja e turnit të natës, një grua topolake rreth të pesëdhjetave, me fytyrë engjëllore, i përgatiti një pjatë me sanduiçë dhe një filxhan çaj, e më pas ia nguli sytë teksa hante, a thua se iu duk si një njeri i kequshqyer. Ajo ishte aq e zgjuar sa të mos e pyeste për arsyen e vizitës së tij. Pakkush ndodhte të vinte në atë orë të natës në Numrin 10, i veshur me rroba të zakonshme, të blera në një dyqan të çfarëdoshëm në Marsejë.

Në orën 11:00, Graham Sejmuri zbriti në kuzhinë me një pamje të lodhur dhe të ngrysur. E refuzoi ofertën e kuzhinieres për të ngrënë diçka, por pastaj përpiu gjithë ç'kishte lënë Gabrieli nga pjata e tij.

Paskëtaj, të dy dolën në kopshtin e rrethuar me mur. Gjithandej mbretëronte heshtja, përveç ndonjë zhurme radioje policie tek-tuk dhe zhurmës së trafikut përgjatë rrugës "Horse Guards". Sejmuri nxori një paketë cigaresh nga xhepi i palltos dhe e ndezi një, i trishtuar.

- Nuk e dija që e pije, - i tha Gabrieli.

- Helena më detyroi ta lija para disa vjetësh. Edhe unë u përpoqa ta detyroja të linte gatimin, por nuk ma vuri veshin.

- Më duket se ajo ditka të bëka negociata. Ndoshta nuk do të ishte keq të linim atë të negocionte me Polin.

- Ai nuk do të lëshonte pe, gjithsesi, - tha Sejmuri duke nxjerrë një shtëllungë tymi nga goja, me sytë nga qielli pa yje i asaj nate. - Unë them se ti e ke gabim. Me gjasë, gjithçka do të shkojë vaj dhe Madalena do të kthehet në shtëpi nesër mbrëma.

- Nëse flasim me gjasa, ka gjasë edhe që një ditë Britania të rimarrë kontrollin e kolonive amerikane, - tha Gabrieli, - por këto mbeten gjasa, jo siguri.

- E po, edhe dhjetë milionë euro nuk janë pak para.

- Dorëzimi i parave është pjesa më e lehtë e kësaj gjëegjëze. Kthimi shëndoshë e mirë i pengut në shtëpi, është një gjë krejt tjetër. Paratë duhet të dorëzohen me çdo kusht nga një profesionist dhe ai duhet të jetë i përgatitur që të mos i dorëzojë paratë në rast se pikas që rrëmbyesit mund të jenë duke i bërë hile, - tha Gabrieli dhe heshti për një çast para se të shtonte: - Dhe mos harroni se kjo nuk është punë për njerëz të dobët.

- Ka ndonjë mundësi që të pranosh ta marrësh ti përsipër këtë?

- Në këto rrethana, absolutisht që jo!

- Thashë të të pyesja njëherë.

- Kush të tha të më pyesje?

- Si thua ti, kush më tha?

- Lankasteri.

- Në fakt, ishte Xheremi Faloni. I kishe bërë shumë përshtypje.

- Por jo aq sa ta bindja për variantin tim.

- Mos ia vër re se është në situatë shumë delikate.

- Pikërisht për këtë arsye nuk duhet t'i afrohet atij telefoni.

Sejmuri e hodhi cigaren në barin e lagur dhe e shtypi me shuallin e këpucës, pastaj e udhëhoqi Gabrielin për brenda, drejt dhomës së pikturës. Asgjë nuk kishte ndryshuar. Sërish, një burrë bënte ecejake nëpër tapet, tjetri i kishte ngulur sytë kuturu jashtë dritares dhe një i tretë orvatej të dukej i qetë dhe sikur e kishte situatën në kontroll, edhe pse kjo nuk qe aspak e vërtetë. Telefoni qëndronte ende në pjesë në mes të tavolinës. Gabrieli i vuri prapë baterinë dhe kartën SIM dhe e ndezi. Pastaj, u ul në kolltukun përballë Lankasterit dhe priti të binte zilja.

Telefonata erdhi saktësisht në mesnatë. Faloni kishte ngritur zërin e ziles në maksimum dhe e kishte vënë edhe me dridhje, prandaj telefoni rrëshqiti e u drodh paksa përmes tavolinës si një tërmet i vogël, kur ra. Ai u afrua ta kapte në çast, por Gabrieli zgjati dorën dhe i bëri me shenjë të mos e prekte për afro dhjetë sekonda të kobshme para se ta ngrinte. Faloni e kapi dhe e afroi menjëherë në vesh. Pastaj, pa ia shqitur sytë Lankasterit, tha:

- I pranoj kushtet tuaja.

Gabrielit i pëlqeu shumë përzgjedhja e fjalëve të Falonit. Telefonata me siguri që po regjistrohej nga GCHQ-ja, shërbimi i përgjimit britanik dhe do të futej në dosjet e tyre. Gjatë dyzet e pesë sekondave që pasuan, Faloni nuk foli. Në vend të fjalëve, pa e hequr ende vështrimin nga Lankasteri, nxori një stilograf nga xhepi i xhaketës dhe shkarraviti disa rreshta të palexueshëm në një bllok. Gabrieli dëgjonte tingullin që vinte nga celulari, i dobët, i pajetë dhe duke theksuar të gjitha fjalët e gabuara.

- Jo, - tha në fund Faloni, - nuk do të jetë nevoja për këtë. - Pastaj, duke iu përgjigjur një pyetjeje tjetër, shtoi: - Po, patjetër. Jua premtojmë këtë.

Pastaj pasoi sërish një pauzë gjatë së cilës ai i hoqi sytë nga Lankasteri, i kaloi te Gabrieli dhe pastaj sërish te Lankasteri dhe tha me kujdes:

- Këtë ndoshta nuk e realizojmë dot. Duhet të pyes njëherë.

Aty telefonata u ndërpre. Faloni e fiku telefonin.

- Atëherë? - e pyeti Lankasteri.

- Do që t'i vendosim paratë në dy valixhe të zeza me rrota. Të mos jenë me gjurmues, as të shënjuara dhe nuk duhet të përfshijmë policinë. Do të na telefonojë sërish nesër paradite për të na thënë se çfarë duhet të bëjmë më pas.

- Nuk i kërkove një provë që vajza është ende gjallë, - i tha Gabrieli.

- Nuk më dha mundësi.

- Bëri kërkesa të tjera?

- Po, një, - tha Faloni. - Do që paratë t'i dorëzosh ti. Pa Gabrielin, nuk ka vajzë, tha.

22

LONDËR

Kishin kaluar vetëm disa minuta nga ora një e mesnatës kur Gabrieli më në fund u largua nga *Downing Street*. Graham Sejmuri i tha se mund ta shoqëronte, por ai donte të ecte. U bënë muaj pa ardhur në Londër dhe mendoi se ajri i lagësht i natës do t'i bënte mirë. Doli nga porta e sigurimit, kaloi përgjatë rrugës "Horse Guards" dhe mori për nga perëndimi përmes parqeve të boshatisura për në *Knightsbridge*. Paskëtaj, kaloi nëpër rrugën "Brompton", për në *South Kesington*. Numri i rrugës ku do të shkonte ai ndodhej i gdhendur në sirtarët e kujtesës së tij të pashoqe: rruga "Viktoria", nr.59. Kjo ishte adresa e fundit e njohur e një dezertori të SAS-it dhe e një vrasësi profesionist të quajtur Kristofer Keler. Ishte një shtëpi e vogël, por në dukje e fortë, me portë hekuri të farkëtuar dhe shkallë të bukura që të çonin para një dere të bardhë. Në kopshtin e pastër përpara shtëpisë kishte lule pa fund, dhe në dritaren e dhomës së pikturës ndriçonte një dritë e vetme. Perdja ishte pakëz e hapur dhe përmes asaj hapësire Gabrieli shqoi një burrë, dr. Robert Kelerin, i cili ishte ulur në një karrige lëkundëse, duke lexuar ose ndoshta edhe i kotur. Këtë nuk e përcaktonte dot. Dukej pak më i ri se Shamroni, por gjithsesi, që më shumë ditë kishte kaluar sesa do të kalonte. Për njëzet e pesë vjet ai kishte vuajtur nga ideja se i biri kishte ndërruar jetë dhe kjo

ishte një dhimbje që Gabrieli e njihte mirë. Ajo çka Keleri u kishte bërë prindërve të tij, ishte më shumë se mizore, por nuk i takonte Gabrielit ta zgjidhte. Kështu, ai ndenji i vetëm në rrugën e braktisur, me shpresën se plaku ndoshta mund ta ndiente praninë e tij. Me mendje, ai i tha se djali i tij ishte një njeri jo i mirë, i cili kishte bërë shumë të këqija për të fituar ca para më shumë, por që dinte të ishte edhe i mirë dhe i nderuar kur donte, e se mbi të gjitha, ishte gjallë.

Pasi kaluan disa çaste, drita u shua dhe babai i Kelerit u zhduk nga sytë. Gabrieli u kthye dhe u nis për në rrugën "Kesington". Kur po i afrohej *Queens Gate*, në të majtë të tij kaloi një motor. Atë motor e kishte parë edhe disa minuta më parë, teksa kalonte rrugën "Sloane" dhe kur po dilte nga *Downing Street*. Kur e pa për herë të parë, mendoi se do të ishte ndonjë rojë i MI5-ës, por tani, teksa vëzhgoi me detaje shpinën dhe kofshët e personit që e ngiste, ndryshoi mendim.

Vazhdoi të ecte përgjatë buzës së parkut "Hyde", teksa shihte se dritat e pasme të motorit sa vinte e zvogëloheshin, i bindur që do ta shihte prapë pas pak. Nuk u desh të priste shumë, vetëm dy minuta a ndoshta më pak, kur e pa të vinte sërish drejt tij. Këtë herë, në vend që t'i kalonte pranë, motori mori një kthesë në formë U-je rreth një koni trafiku dhe ndaloi. Gabrieli kaloi këmbën lirshëm mbi shalën e tij dhe mbështolli krahët rreth belit të ngushtë. Teksa motori bënte përpara, ai nuhati aromën e njohur të vaniljes dhe shtrëngoi lehtë pjesën e poshtme të gjoksit të vogël, por të plotë. Mbylli sytë i qetë për herë të parë pas shtatë ditësh.

Apartamenti ndodhej në një ndërtesë të shëmtuar të pasluftës, në rrugën "Bayswater". Dikur kishte qenë vendstrehim i Byrosë, por në "Bulevardin Mbreti Saul" dhe për MI5-n, tani njihej si apartamenti i Gabriel Alonit në Londër.

Kur hynë, ai vari çelësin në grepin e vogël në derën e kuzhinës dhe hapi frigoriferin. Brenda tij ishte një karton me qumësht të freskët dhe një kuti me vezë, një copë djathi *Parmigiano*, kërpudha, erëza dhe një shishe me verën e parapëlqyer të Gabrielit *Pinot Grigio*.

- Dollapi ishte bosh kur erdha unë, - i tha Kiara, - kështu që mora disa gjëra nga supermarketi i lagjes. Thashë mos hanim darkë bashkë.

- Kur erdhe ti?

- Afro një orë pas teje.

- Si ia bëre?

- Isha këtu në lagje dhe thashë të vija.

Gabrieli e pa seriozisht dhe i tha:

- Në cilën lagje?

- Në Francë, - ia ktheu ajo pa iu dridhur qerpiku. - Në një fermë jo shumë larg *Cherbourg*-ut, për të qenë më e saktë. Në një shtëpi me katër dhoma, kuzhinë dhe një pamje të mrekullueshme të Kanalit.

- Hyre në grupin e pritjes?

- Jo tamam.

- Po si?

- Ari më bëri një nder.

- Kujt i lindi ideja fillimisht?

- Atij.

- Ashtu, hë?

- Ai mendonte se isha njeriu i duhur për atë punë dhe unë nuk e kundërshtova. Fundja, unë e di mirë se ç'do të thotë të të rrëmbejnë dhe të të mbajnë peng për haraç.

- Pikërisht për këtë arsye nuk do të doja të përfshiheshe në këtë çështje.

- Zemër, ka kaluar shumë kohë që atëherë.

- Jo edhe shumë, do të thosha.

- Mua më duket sikur ka ndodhur në një jetë tjetër. Madje, ndonjëherë më duket sikur nuk ka ndodhur fare.

Ajo mbylli frigoriferin dhe e puthi ëmbëlsisht. Xhaketa e saj e lëkurës bartte ende të ftohin e natës londineze, por buzët i kishte të ngrohta.

- Të pritëm gjithë ditën, - i tha teksa i jepte një puthje tjetër. - Pastaj, më në fund ata të zyrës operative dërguan një mesazh ku thuhej se do të vije me një avion të linjës *British Airways* nga Marseja për në Londër.

- Çudi, nuk mbaj mend t'ia kem komentuar zyrës operative planin tim të udhëtimit.

- Zemër, ata kontrollojnë kartat e tua të kreditit, ti e di. Dërguan një skuadër londineze të të priste në aeroportin e "Heathrow"-t. Të panë kur u largove me Nigel Uajtkombin, të panë edhe kur hyre në *Downing Street* nga dera e pasme.

- U zhgënjeva pak që nuk hyra nga dera e përparme, por në ato rrethana, ndoshta ishte më mirë ashtu.

- Çfarë ndodhi në Francë?

- Gjërat nuk shkuan sipas planit.

- Po tani?

- Kryeministri i Britanisë do të bëjë të pasur një njeri.

- Sa të pasur?

- Të pasur me dhjetë milionë euro.

- Domethënë, kriminelët bëjnë para.

- Zakonisht, po. Prandaj ka shumë kriminelë.

Kiara u tërhoq nga Gabrieli dhe hoqi xhaketën. Kishte veshur një bluzë të zezë të ngushtë me jakë të rrumbullakët. Flokët i kishte kapur që t'i fuste brenda kasketës. Tani, teksa ia kishte ngulur sytë me vëmendje Gabrielit, hoqi disa kapëse dhe karfica nga flokët, që i ranë mbi shpatullat e drejta, si re në ngjyrë gështenjë të kuqërreme.

- Domethënë, ti mbarove punë? Mund të kthehemi në shtëpi tani? - e pyeti ajo.

- Nuk do të thosha kështu.

- Çfarë do të thuash?

- Dua të them se duhet dikush për të dorëzuar paratë, - tha ai, ndaloi pak dhe shtoi:- E pastaj edhe dikush për të marrë vajzën.

Kiara picërroi sytë që i morën një ngjyrë më të errët dhe kjo nuk ishte asnjëherë shenjë e mirë.

- Jam e sigurt se kryeministri mund të gjejë dikë tjetër në vendin tënd, - i tha ajo.

- Edhe unë kështu mendoj, por kam frikë se kjo nuk është në dorën e tij.

- Pse kështu?

- Sepse rrëmbyesit bënë një kërkesë të fundit.

- Të duan ty?!

Gabrieli pohoi me kokë.

- Pa Gabrielin, harrojeni vajzën, kishin thënë.

Edhe pse ishte mesi i natës, Kiara deshi të gatuante. Gabrieli u ul në tavolinën e vogël në kuzhinë me një gotë verë përpara dhe kujtoi udhëtimin që kishte bërë, që pasi ishte larguar nga Jerusalemi. Në çdo martesë tjetër, gruaja do të kishte reaguar me mosbesim dhe habi ndaj fjalëve të tilla, por Kiara dukej më e shqetësuar për përgatitjen e perimeve. Vetëm një herë e ngriti kokën nga puna e saj, kur Gabrieli i tha për depon bosh në vilën në Luberon dhe gruan që kishte dhënë jetë në krahët e tij. Kur ai përfundoi, ajo mbushi dorën me kripë, hodhi një sasi të vogël në lavaman dhe tjetrën në një tenxhere të vogël ku po ziente ujë.

- E pas gjithë këtyre, zotrote ta kishte ënda të shëtisje nëpër *South Kesington*?!

- Në fakt, mendova të bëja një budallallëk.

- A ka budallallëk më të madh se të pranosh t'u dorëzosh dhjetë milionë euro rrëmbyesve të dashnores së kryeministrit britanik?

Gabrieli nuk foli.

- Kush jeton në shtëpinë me numër 59 në rrugën "Viktoria"?

- Zoti Robert Keler dhe zonja e tij.

Kiara u bë gati ta pyeste pse kishte shkuar atje, por pastaj e kuptoi.

- Çfarë mendoje t'u thoshe atyre?

- Pikërisht ky është problemi. Çfarë t'u thosha?

Kiara vendosi disa kërpudha në qendër të dërrasës për prerjen e perimeve dhe filloi t'i priste me saktësi.

- Më mirë le të mendojnë se ka vdekur, - tha pas pak me qetësi.

- Do të thoshe kështu sikur të bëhej fjalë për djalin tënd? Nuk do të doje ta dije të vërtetën?

- Nëse po më pyet a do të doja ta dija nëse im bir e fiton jetesën duke marrë jetë njerëzish, përgjigjja ime është jo.

Mes tyre për një çast ra heshtja.

- Më fal, - i tha Kiara pas pak, - nuk e kisha në atë kuptim.

- E di.

Kiara vendosi kërpudhat në një tigan dhe u hodhi kripë e piper.

- E dinte ajo?

- Nëna ime?

Kiara pohoi me kokë.

- Jo, - tha Gabrieli. - Nuk e mori vesh kurrë.

- Nuk dyshoi asnjëherë? - pyeti Kiara. - Ti u zhduke për tre vjet.

- E dinte që isha përfshirë në një punë sekrete dhe që kishte lidhje me Mynihun, por nuk i thashë kurrë që vrasjen e kreva unë.

- Nuk ishte kureshtare ta dinte ajo?

- Jo.

- Përse jo?

- Sepse Mynihu u kthye në traumë për gjithë vendin, - ia ktheu Gabrieli, - por më të vështirë e patën ata si puna e nënës sime, hebrenjtë gjermanë të cilët mbijetuan nga kampet e përqendrimit. Ajo nuk shikonte dot funerale as në gazeta dhe televizion. Kyçej në studio dhe pikturonte për orë të tëra.

- Po kur u ktheve në shtëpi pas "Zemërimit të Perëndisë"?

- Ajo pa vdekje në sytë e mi, - tha ai, heshti një hop e më pas shtoi, - por fundja, ajo e njihte mirë vdekjen.

- Ju nuk keni folur kurrë për atë?

- Kurrë, - i tha Gabrieli duke tundur kokën ngadalë. - Ajo nuk më tregoi kurrë se ç'i ngjau gjatë Holokaustit dhe as unë nuk i tregova kurrë se çfarë bëra në Europë.

- Mendon se do të kishte qenë dakord?

- Për mua nuk kishte rëndësi se ç'mendonte ajo.

- Por duhej të kishte, Gabriel. Ti nuk je aq fatalist. Po të ishe, nuk do të kishe shkuar në shtëpinë e Kelerit në mes të natës e t'ia ngulje sytë babait të tij nga dritarja.

Gabrieli nuk foli asnjë fjalë. Kiara hodhi një pako makaronash petë në tenxheren me ujin e valuar dhe i trazoi një herë me një lugë druri.

- Si ishte ai? - pyeti ajo.

- Keleri?

Ajo pohoi me kokë.

- Shumë i zoti, i pamëshirshëm dhe pa pikë ndërgjegjeje.

- Më duket personi i duhur për të dorëzuar dhjetë milionë eurot e haraçit te rrëmbyesit e Madalena Hartit.

- Qeveria britanike e di të vdekur. Pastaj, mos harro që rrëmbyesit më kërkuan pikërisht mua për atë punë.

- Pikërisht për këtë ti nuk duhet të ngatërrohesh.

Gabrieli nuk u përgjigj.

- Po ata nga e morën vesh përfshirjen tënde?

- Duhet të më kenë parë në Marsejë ose në *Aix*.

- E pse do të kërkonin t'ua dorëzonte paratë një profesionist dhe jo një humbameno i *Downing Street*-it, të cilin mund ta manipulojnë si të duan?

- Me siguri ua ka qejfi të mendojnë se mund të më vrasin, por nuk ma do mendja t'ia dalin dot.

- Pse?

- Sepse unë do të kem në dorë dhjetë milionë eurot për të cilat atyre po u shkon goja lëng, kështu që e kemi ne në dorë situatën.

- Ne?

- Nuk besoj se po mendon se unë do ta bëj i vetëm këtë punë. Do të kem një njeri që do të më ruajë shpatullat.

- Kë?

- Një njeri shumë të zotin, të pamëshirshëm dhe pa pikë ndërgjegjeje.

- Kujtoja se ai ishte në Korsikë.

- Atje është, - tha Gabrieli, - por do të marrë një telefonatë të papritur.

- Po unë?

- Ti kthehu në shtëpinë në *Cherbourg*. Do ta sjell Madalenën atje pasi të paguaj haraçin. Kur të jetë gati të lëvizë, do ta kthejmë në Britani dhe pastaj ne të dy do të kthehemi në shtëpi.

Kiara nuk foli për pak.

- Ti e thua sikur të ishte kaq e thjeshtë, - tha më në fund.

- Nëse gjithçka shkon ashtu si mendoj unë, e thjeshtë do të jetë.

Kiara vuri një pjatë me makarona të ngrohta dhe kërpudhat në mes të tavolinës dhe u ul përballë Gabrielit.

- Nuk ke më pyetje? - i tha ai.

- Vetëm një, - tha ajo. - Çfarë pa ajo plaka në Korsikë kur hodhe vajin në ujë?

Kur përfunduan së ngrëni, ora kishte shkuar pothuajse katër e mëngjesit, pra, pothuajse pesë në Korsikë. Megjithëkëtë, Keleri u duk i zgjuar dhe vigjilent kur ngriti telefonin. Me një gjuhë të koduar, Gabrieli i shpjegoi çfarë kishte ndodhur në *Downing Street* dhe se çfarë pritej të ndodhte ditën tjetër.

- E kap dot avionin e parë për në Orli? - e pyeti ai.

- Pa problem.

- Merr një makinë në aeroport dhe shko në bregdet. Unë do të të telefonoj sapo të kem të reja.

- Pa problem.

Gabrieli u shtri në shtrat pranë Kiarës dhe u orvat të flinte, por më kot. Sa herë që mbyllte sytë, i shfaqej gruaja që dha shpirt në krahët e tij në Luberon, në luginën e tri vilave. Kështu, ndenji shtrirë duke dëgjuar frymëmarrjen e Kiarës dhe fishkëllimën e trafikut në rrugën "Bayswater", teksa një rreze drite gri londineze ra dalëngadalë në dhomë.

E zgjoi Kiarën me një kafe të sapobërë në orën nëntë dhe bëri një dush. Kur doli nga banja, pa Xhonatan Lankasterin në televizor, duke folur për iniciativën shumë të kushtueshme që do të ndërmerrte për të ndihmuar familjet britanike në nevojë. Kryeministri po interpretonte në mënyrë të shkëlqyer. Dukej shumë autoritar dhe i patundur edhe tani që karriera e tij varej në fije të perit. Në fund të fjalës së tij, edhe Gabrielit "iu mbush mendja" se shpenzimi i disa miliona sterlinave nga taksapaguesit do ta zgjidhte problemin me të cilin përballej tani klasa e ulët britanike. Kronika e radhës fliste për një firmë energjetike ruse e cila kërkonte leje për të nxjerrë naftë në hapësirën ujore britanike në Detin e Veriut. Gabrieli fiku televizorin, u vesh dhe nxori pistoletën e tij beretë nëntëmilimetërshe nga dyshemeja. Në timonin e *Vauxhall Astra*-s e priste Nigel Uajtkombi. Ai e bëri rrugën për te Numri 10 në kohë rekord dhe e la Gabrielin në hyrjen e portës së pasme, në buzë të rrugës "Horse Guards".

- Të shpresojmë që këtë herë të mos shkojë si herën e fundit, - tha ai me një hare të rreme.

- Të shpresojmë, - ia ktheu Gabrieli dhe u largua.

23

DOWNING STREET

Xheremi Faloni ishte ulur në fund të hollit të Numrit 10. Ai i zgjati Gabrielit një dorë të ngrohtë e disi të lagësht dhe pa thënë asnjë fjalë, e udhëhoqi për në dhomën e pikturës. Këtë herë, ajo ishte bosh. Gabrieli u ul pa pritur t'i thoshin, por Faloni ndenji në këmbë. Futi dorën në xhep dhe nxori prej andej çelësat e një makine të marrë me qira.

- Është një *Passat Saloon*, siç e kërkove. Do të të isha shumë mirënjohës sikur ta ktheje të padëmtuar. Unë nuk jam aq i kamur sa kryeministri.

Faloni vuri buzën në gaz edhe vetë me shakanë e tij. Dukej ashiqare që nuk ishte tip që qeshte shpesh. Dhëmbët i kishte si peshk barrakudë.

I dorëzoi Gabrielit çelësat bashkë me një biletë parkimi.

- Është në një park makinash në stacionin "Viktoria". Hyrja është...

- Në rrugën "Eccleston".

- Më fal, - tha Faloni me sinqeritet. - Ndonjëherë, harroj se me kë kam të bëj.

- Ndërsa unë asnjëherë.

Faloni heshti.

- Çfarë ngjyre ka makina?

- Gri ishulli.

- Ç'dreqin është kjo ngjyrë gri ishulli?

- Ishulli duhet të jetë ngjyrë e bukur, sepse makina është shumë e errët, në fakt.

- Po paratë?

- Janë në bagazh. Dy valixhe, siç i kërkuan ata.

- Sa kohë kanë atje?

- Që sot në mëngjes. I vendosa vetë.

- Le të shpresojmë që janë ende atje.

- Paratë apo makina?

- Të dyja.

- Shaka ishte kjo?

- Jo, - ia ktheu Gabrieli.

Duke u ngrysur, Faloni u ul në kolltukun përballë Gabrielit dhe nisi të luante me thonjtë, me atë pako gjë që kishte mbetur prej tyre këto ditë.

- Duhet të të kërkoj ndjesë për sjelljen time të mbrëmshme, - tha ai pas një pushimi të shkurtër. - Gjithçka që thashë, e bëra duke menduar më të mirën për interesat e kryeministrit tim.

- Edhe unë, - u përgjigj Gabrieli.

Faloni u zu në befasi. Si shumë njerëz të fuqishëm, ai nuk ishte mësuar që njerëzit t'i flisnin me sinqeritet.

- Graham Sejmuri më paralajmëroi për përgjigjet e tua flakë për flakë me raste.

- E bëj këtë vetëm kur rrezikohen jetë njerëzish. Pasi të hipi në atë makinë, në këtë rast, rrezikohet edhe jeta ime. Pra, nga ky çast, vendimet i marr unë.

- Nuk besoj se është nevoja të të paralajmëroj se kjo çështje duhet të mbyllet pa bujë.

- Nuk është nevoja, por nëse nuk ndodh kjo, i vetmi që do të paguajë është kryeministri, ta dish!

Faloni nuk u përgjigj, por hodhi sytë nga ora. Ishte 11:40, njëzet minuta para se të binte telefoni. U ngrit vetëtimthi, a thua se kishte ditë që nuk flinte mirë.

- Kryeministri është në kabinet, ka një takim me Sekretarin e Punëve të Jashtme. Pas disa minutash do të shkoj edhe unë atje dhe do ta nxjerr kur të jetë koha për të folur në telefon.

- Cila është tema e bisedimeve të tyre?

- Politikat britanike në lidhje me konfliktin Izrael-Palestinë.

- Mos harroni se kush po i dorëzon paratë.

Faloni dha një buzëqeshje tjetër të tmerrshme dhe u nis me ngut drejt derës.

- E dije ti? - pyeti Gabrieli.

Faloni u kthye ngadalë.

- Çfarë?

- Që Lankasteri dhe Madalena kishin një lidhje.

Faloni ngurroi një çast, para se të përgjigjej:

- Jo, nuk e dija. Nuk e kisha menduar kurrë se ai mund të bënte diçka që do të rrezikonte atë për çka kemi punuar aq shumë. Por ironia më e madhe është, - shtoi, - se unë i kam prezantuar.

- Pse i prezantove?

- Sepse Madalena ishte pjesë integrale e politikës sonë dhe sepse ishte një vajzë shumë e zonja, e mençur dhe me një të ardhme të ndritur.

Gabrielit i bëri përshtypje që ai foli në kohën e shkuar për një kolege të zhdukur. Edhe Faloni e pikasi këtë.

- Nuk e kisha në atë kuptim, - tha ai.

- Po në ç'kuptim e kishe?

- Nuk jam i sigurt, - u përgjigj ai. Këto ishin tri fjalë që ai nuk i përdorte shpesh. - Por them se ajo nuk do të jetë më si më parë pas kësaj që ndodhi, apo jo?

- Njerëzit janë më të fortë nga sa mendon ti, sidomos femrat. Nëse i jepet ndihma e duhur, ajo mund t'i rikthehet jetës si më parë. Por për diçka ke të drejtë, - shtoi Gabrieli, - ajo nuk do të jetë më kurrë si më parë.

Faloni u bë gati të hapte derën dhe pyeti pa kthyer kokën:

- Ke nevojë për ndonjë gjë tjetër?

- Disa orë gjumë nuk do të më bënin keq.

- Si i do?

- Me qumësht, pa sheqer.

Faloni hapi derën dhe e mbylli lehtë pas vetes. Gabrieli u ngrit, iu afrua peizazhit të Tërnerit dhe qëndroi përpara tij me njërën dorë në mjekër dhe kokën pak mënjanë. Ora shënonte 11:43, donte edhe shtatëmbëdhjetë minuta që të binte telefoni.

Faloni u kthye pak minuta para se të shkonte ora 12:00, i shoqëruar nga Xhonatan Lankasteri. Pamja e kryeministrit kishte ndryshuar ndjeshëm. Lankasteri plot vetëbesim, politikani që premtonte të zgjidhte hallet e britanikëve, ai që pa Gabrieli në televizor, nuk dukej kurrkund. Vendin e tij e kishte zënë njeriu karriera e të cilit varej në fije të perit dhe rrezikonte të plaste skandalin më të madh politik në historinë e Britanisë. Dukej sikur nuk do të mund të duronte gjatë.

- Jeni i sigurt se mund të qëndroni këtu gjatë telefonatës? - e pyeti Gabrieli duke i shtrënguar dorën.

- Përse të mos jem?

- Sepse mund të mos ju pëlqejë gjithçka që do të dëgjoni.

Lankasteri u ul, si për të konfirmuar se nuk kishte ndër mend të lëvizte prej aty. Faloni nxori telefonin nga xhepi i xhaketës dhe e vendosi mbi tavolinë. Gabrieli i hoqi shpejt e shpejt baterinë, pa numrin serial brenda pajisjes dhe i bëri një fotografi me *Blackberry*-n e tij.

- Çfarë bën? - e pyeti Lankasteri.

- Ka shumë gjasë që rrëmbyesit të më thonë ta lë telefonin diku dhe s'kemi për ta gjetur më.

- Po ti pse i bën fotografi?

- Për t'u siguruar.

E futi prapë në xhep *Blackberry*-n e tij dhe ndezi telefonin e rrëmbyesve. Ora shënonte 11:57 minuta. Nuk mbetej veçse të prisnin. Gabrieli shquhej për të pritur. Sipas llogarive të tij, ai kishte kaluar më shumë se gjysmën e jetës në pritje. Herë duke pritur një tren ose një avion, një informator, lindjen e diellit pas një nate kur kishte bërë një vrasje, duke pritur që mjekët t'i thoshin nëse gruaja e tij do të mbijetonte ose jo... Ai kishte shpresuar që sjellja e tij gjakftohtë ta qetësonte Lankasterin, por kjo sikur pati efektin e kundërt. Kryeministri ia kishte ngulur sytë i tmerruar ekranit të celularit. Ora shkoi 12:03 minuta dhe ai ende nuk kishte rënë.

- Çfarë dreqin po ndodh kështu? - pyeti më në fund, i dëshpëruar.

- Duan t'ju bëjnë nervoz.

- Dhe po ia dalin mbanë më së miri!

Kaloi edhe një minutë dhe hiç! Pastaj, sapo ora shënoi 12:05, telefoni ra dhe nisi të kërcente e të dridhej mbi tavolinë. Gabrieli e ngriti dhe pa numrin që telefononte, teksa ai vazhdonte të dridhej. Ishte ashtu si e kishte parashikuar ai, ata po përdornin një numër tjetër. Hapi kapakun ngadalë dhe pyeti me qetësi:

- Si mund t'ju ndihmoj?

Pasoi një heshtje gjatë së cilës Gabrieli dëgjoi zhurmën e tastierës së një kompjuteri, e më pas dëgjoi një zë robotik:

- Kush jeni ju?

- Ti e di shumë mirë kush jam, - ia ktheu Gabrieli. - Kështu që fol. Vajza ime ka kohë që e pret këtë ditë. Dua ta mbyllim sa më parë çështjen.

Përsëri heshtje dhe shtypje tastesh mbi tastierë. Pastaj zëri pyeti:

- I keni gati paratë?

- I kam para syve, - u përgjigj Gabrieli. - Dhjetë milionë euro, të pashënuara, jo kokë më kokë, pa përgjues, pa bojë, gjithçka është si kërkove ti. Uroj të kesh gjetur ndonjë bankë të korruptuar që të mund t'i pranojë, sepse do të të duhet.

I hodhi një vështrim të shpejtë Lankasterit, që dukej sikur po përtypte diçka në pjesën e brendshme të faqes. Faloni dukej sikur kishte mbetur pa frymë.

- Je gati për të marrë udhëzimet? - pyeti zëri pas disa të rrahurash të tjera në tastierë.

- Unë kam disa minuta që rri gati.

- Ke me se të shkruash?

- Fol, - i tha Gabrieli i paduruar.

- Në Londër je?

- Po.

- Merr tragetin e orës 4:40 nga Doveri për në Kale. Dyzet minuta pas nisjes, hidhe telefonin në Kanal. Kur të mbërrish në Kale, shko në parkun në rrugën "Richelieu". E di ku është?

- Po, e di.

- Në qoshen verilindore të rrugës është një kosh mbeturinash, në fund të tij do të gjesh telefonin e ri. Pasi ta marrësh, kthehu në makinë. Atje do të të telefonojmë dhe të të themi se ku të shkosh më pas.

- Ndonjë gjë tjetër?

- Eja vetëm, pa përforcime dhe pa polici. Kujdes të mos e humbasësh tragetin e orës 4:40, në të kundërt, vajza është e vdekur.

- Mbarove?

Nga ana tjetër ra heshtja, nuk kishte më as zë dhe as rrahje në tastierë.

- Po e marr këtë si një "po", - tha Gabrieli. - Tani më dëgjo me kujdes sepse nuk flas dy herë. Kjo është dita jote me fat. Je përpjekur shumë për ta arritur dhe pothuajse i erdhi fundi. Mos e prish duke bërë ndonjë marrëzi. Unë dua vetëm ta kthej vajzën shëndoshë e mirë në shtëpi. Ky është biznes, asgjë më shumë. Le të sillemi si zotërinj.

- Pa polici, - tha zëri pas disa sekondash vonesë.

- Pa polici, - tha edhe Gabrieli, - por dëgjo edhe diçka të fundit. Nëse përpiqesh t'i bësh keq Madalenës apo edhe mua, shërbimet e mia do të të gjejnë dhe do të të vrasin, more vesh?

Këtë herë nuk pati asnjë përgjigje.

- Ah, se harrova, - tha Gabrieli. - Mos më lër të pres më pesë minuta për një telefonatë. Përndryshe, nuk ka marrëveshje.

Pas këtyre fjalëve, ai e ndërpreu komunikimin dhe hodhi vështrimin nga Xhonatan Lankasteri.

- Unë mendoj se shkoi mirë. Si mendoni, kryeministër?

Rrallë ndodh të shohësh dikë të dalë nga dera e përparme e Numrit 10 në *Downing Street*, i veshur me xhinse dhe xhaketë lëkure, por pikërisht kjo ndodhi në orën 12:17 minuta, një ditë me shi, atë fillimtetori. Kishin kaluar pesë javë nga zhdukja e Madalena Hartit në ishullin e Korsikës, tetë ditë pasi fotografia me një video të sajën ishin lënë në portën e shtëpisë së Simon Hjuitit dhe dymbëdhjetë orë pasi kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe të Irlandës së Veriut pranoi të paguante dhjetë milionë euro haraç që ajo të kthehej e sigurt në shtëpi. Por natyrisht që polici, i cili bënte rojë në hyrje të hollit, nuk dinte asgjë nga këto. Po ashtu, as që e kuptoi se njeriu i veshur në mënyrë të pazakontë për atë vend, ishte agjenti dhe vrasësi izraelit Gabriel Alon, apo që poshtë

xhaketës së tij të zezë prej lëkure fshihej një beretë gjysmautomatike, e mbushur. Si rrjedhojë, ai e përshëndeti Gabrielin, i uroi ditën e mirë dhe e pa teksa largohej përgjatë *Downing Street*-it. Kur kaloi portën e sigurisë, një kamera e fotografoi. Ishte ora 12:19.

Xheremi Faloni e kishte lënë *Passat*-in në pjesën e pambuluar të parkimit në stacionin "Viktoria". Gabrieli iu afrua siç iu afrohej gjithnjë makinave që nuk i përkitnin atij, ngadalë dhe me një parandjenjë të tmerrshme. I erdhi njëherë rrotull, sikur ta kontrollonte për ndonjë gërvishtje dhe pastaj i hodhi me qëllim çelësat përtokë. Kur u përkul për t'i marrë, i hodhi një sy shpejt e shpejt pjesës së poshtme të makinës. Pasi nuk vuri re asgjë të pazakontë, u ngrit dhe shtypi butonin që hap bagazhin. Kapaku i tij u ngrit ngadalë duke shfaqur dy valixhe nga ato të lirat. Hapi zinxhirin e njërës prej tyre, hodhi një sy brenda dhe pa një rresht kartëmonedhash qindëshe euro, të ngjeshura pas njëra-tjetrës.

Sipas standardeve londineze, në atë orë trafiku ishte pak katastrofik. Gabrieli kaloi urën e *Chelsea*-s në orën një dhe në një e gjysmë i la pas lagjet jugore të Londrës dhe rriti shpejtësinë në autostradën M25. Në orën 2:00 të drekës, ndezi Radio Katrën për të dëgjuar lajmet. Nuk kishte shumë ndryshime nga mëngjesi. Xhonatan Lankasteri vazhdonte të fliste për ndryshimin e situatës për shtresat në nevojë dhe një kompani nafte ruse vazhdonte të kërkonte leje për të hapur puse në Detin e Veriut. Askund nuk u përmend Madalena Harti apo një burrë me xhinse dhe xhaketë lëkure, i cili do t'u paguante dhjetë milionë euro rrëmbyesve të saj. Dëgjoi buletinin e motit dhe mësoi se ai do të përkeqësohej ndjeshëm gjatë pasdites, me shira të dendura dhe erëra të forta përgjatë bregut të Kanalit. Pastaj e fiku radion dhe preku përhumbshëm talismanin korsikan rreth qafës. *Pasi të vdesë ajo*, i erdhën në vesh fjalët e plakës. *Vetëm atëherë do ta mësosh të vërtetën*.

23

DOVER, ANGLI

Kur Gabrieli mori kthesën për në autostradën M20, po binte shi me gjyma. Kaloi me shpejtësi nëpër *Maidstone, Lenham, Heath* dhe *Ashford* derisa mbërriti në portin *Folkstone* në orën tre e gjysmë. Paskëtaj, u kthye në segmentin A20 dhe vazhdoi në lindje, përmes asaj që dukej si një fushë e paanë me gjelbërimin më të madh që i kishin zënë sytë ndonjëherë. Më në fund, mbërriti pranë një kodre të ulët dhe u shfaq deti, që dukej i errët dhe i mbuluar nga një cipë e bardhë. Kalimi nëpër të dukej se nuk do të ishte aspak i këndshëm.

Teksa rruga vinte duke zbritur në bregdetin e Doverit, Gabrieli vuri re për herë të parë një pjesë të shkëmbinjve të bardhë përkundër një reje gri të errët. Rruga për në terminalin e trageteve gjendej lehtësisht. Hyri në biletari dhe konfirmoi rezervimin e tij, pa ia hequr sytë për asnjë çast *Passat*-it. Pastaj, me biletën në dorë, hipi sërish në makinë dhe iu bashkua radhës së gjatë të makinave që prisnin të hipnin në traget. *Bëj kujdes të mos e humbasësh tragetin e orës 4:40, në të kundërt, vajza është e vdekur...* Gabrieli mendoi se kishte vetëm një arsye për ta thënë këtë. Rrëmbyesit ishin duke e vëzhguar tani.

Pasagjerët nuk lejoheshin të qëndronin në makinë gjatë kalimit në Kanal. Gabrieli mendoi për një çast t'i merrte valixhet me vete, por kjo

do të ngjallte shumë dyshime. Kështu, e kyçi mirë makinën, kontrolloi edhe një herë bagazhin dhe katër dyert dhe pasi u sigurua se ishin mbyllur mirë, shkoi në hollin e pasagjerëve. Kur trageti doli nga terminali, shkoi në kafene dhe porositi çaj dhe kulaç. Jashtë, qielli nxinte dhe në orën 5:15 deti as që dukej më. Gabrieli ndenji edhe pesë minuta në ndenjësen e tij, pastaj u ngrit dhe shkoi në një qoshe të kuvertës. Asnjë pasagjer tjetër nuk i shkoi pas, kështu që askush nuk e pa që hodhi një celular në det.

Ai as e pa dhe as e dëgjoi zhurmën e celularit teksa u përplas me dallgët. Qëndroi edhe dy minuta te parmaku para se të kthehej në vendin e tij. Ndenji atje, duke vëzhguar me kujdes të gjitha fytyrat që e rrethonin, derisa buçiti njoftimi që pasagjerët duhej të shkonin sërish te makinat e tyre. Njoftimi u dha në fillim anglisht dhe pastaj frëngjisht. Gabrieli mbërriti i pari te makina e tij. Hapi bagazhin e *Passat*-it, pa që dy valixhet ishin ende në vend dhe paratë gjithashtu. Pastaj hipi në vendin e shoferit dhe pa pasagjerët e tjerë të mbushnin dalëngadalë të gjitha makinat e tjera. Në rreshtin tjetër pa një grua që po hapte derën e një *Peugeot*-i të vogël. Ajo kishte flokë të shkurtër biondë, pothuajse si mashkull dhe një fytyrë në formë zemre. Po Gabrielit i bëri përshtypje diçka tjetër: ajo ishte pasagjerja e vetme në traget që kishte vënë dorashka. Ai i mbajti sytë përpara, me duart në timon.

Ishte ajo. Ai ishte i sigurt për këtë.

Kaleja ishte një qytet bregdetar i shëmtuar, gjysmanglez dhe gjysmëgjerman, aspak francez. Rruga "Richelieu" ishte afro një kilometër nga terminali i trageteve, në lagjen e njohur si *Calais-Nord*, një ishull artificial i rrethuar nga kanale dhe mole. Gabrieli parkoi jashtë një blloku shtëpish me tarracë me stuko dhe mori për nga parku, nën vëzhgimin e tre afganëve të veshur me pallto të mëdha dhe kapela tradicionale *pakul*. Me siguri ishin emigrantë ekonomikë, të cilët prisnin rastin të kalonin në mënyrë të paligjshme Kanalin për në Britani. Dikur kishte qenë një kamp i madh në dunat me rërë përgjatë plazhit, aty ku në ditë të kthjellëta mund të shihje Shkëmbinjtë e Bardhë të Doverit, teksa shkëlqenin nga ana tjetër e Kanalit. Qytetarët e mirë të Kalesë, fortesë e Partisë Socialiste, e quanin atë kamp

"xhungla" dhe e kishin përgëzuar policinë franceze kur më në fund e mbylli.

Kazani i mbeturinave ishte në të djathtë të një rrugice që të çonte në park. Ishte dy metra i lartë, i lyer në ngjyrë të gjelbër. Pranë tij ishte një shënim ku vizitorëve u kërkohej të mos shkelnin barin dhe lulet. Nuk thuhej të mos kontrollonin poshtë kazanit për të gjetur një celular. Këtë bëri Gabrieli pasi hodhi biletën e tragetit. E gjeti përnjëherë; ishte vendosur me kujdes pas fundit të kazanit të mbeturinave, në një pako të ngjitur mirë. E hapi në çast dhe e futi në xhepin e xhaketës para se të ngrihej e të drejtohej për nga *Passat*-i. Kur ndezi motorin, po binte zilja e telefonit.

- Shumë mirë, - tha zëri kompjuterik. - Tani dëgjo me kujdes.

Ai i tha të shkonte drejt e në hotelin "Me pamje nga deti", në qytetin *Grand-Fort-Philippe*. Atje ishte bërë një rezervim me emrin Aneta Rikard. Gabrieli duhej të regjistrohej me kartën e tij të kreditit dhe t'u shpjegonte atyre se zonjusha Rikard do të shkonte atje në mbrëmje. Gabrieli nuk kishte dëgjuar kurrë për atë hotel dhe as për qytetin ku ai ndodhej, por e gjeti me anë të internetit në celularin e tij. *Grand-Fort-Philippe* ndodhej në perëndim të plazhit të *Dunkirk*-ut, skena e betejave më të mëdha ushtarake në historinë e Britanisë. Në pranverën e vitit 1940, nga plazhi i *Dunkirk*-ut u evakuuan më shumë se treqind mijë anëtarë të Forcave Speciale Britanike, kur Franca po pushtohej nga gjermania naziste. Nga nxitimi, forcat britanike u detyruan të braktisnin materiale sa për të pajisur dhjetë divizione. Gabrieli mendoi se rrëmbyesit e Madalenës nuk e kishin ditur këtë kur kishin bërë përzgjedhjen e hotelit.

Hoteli "Me pamje nga deti", në fakt nuk ndodhej fare buzë detit. I vogël, i pastër dhe i lyer i tëri në të bardhë, ai ishte me pamje nga lumi, i cili e ndante qytetin në dy pjesë. Gabrieli kaloi me qëllim tri herë para hyrjes së tij, para se të parkonte qetësisht në parkingun përgjatë molit. Askush nga personeli i hotelit nuk erdhi që ta ndihmonte; nuk ishte nga ato lloj hotelesh. Priti të kalonte një makinë para se të fikte motorin. Pastaj, pasi i zhyti çelësat në xhepin e përparmë të xhinseve, doli menjëherë jashtë. Sikur të mos e dinte se ç'kishte brenda, do të mendonte se Xheremi Faloni e kishte mbushur me plumba. Pulëbardhat fluturonin ngadalë sipër kokës së tij, sikur të shpresonin se ai do të binte nga pesha që po mbante në dorë.

Hoteli nuk kishte holl të mirëfilltë, vetëm një sallë të vogël, ku pas një banaku qëndronte një recepsionist tullac dhe imcak. Pavarësisht se kishin vetëm tetë dhoma, ai u vonua pak për të gjetur rezervimin. Gabrieli pagoi me para në dorë, duke shkelur një nga rregullat e rrëmbyesve dhe la një bakshish të majmë.

- Keni çelës të dytë për dhomën? - pyeti ai.

- Patjetër.

- Mund të ma jepni, ju lutem?

- Po kur të vijë zonjusha Rikard?

- Do të dal ta pres unë.

Recepsionisti ngrysi vetullat si për ta kundërshtuar teksa i zgjati çelësat.

- Nuk ka të tjerë? Vetëm ky është? - pyeti Gabrieli.

- Ka edhe pastruesja një çelës rezervë, natyrisht. Po ashtu edhe unë.

- Jeni i sigurt se nuk ka njeri në këtë dhomë?

- Jam më se i sigurt, - tha recepsionisti. - Sapo isha atje për të parë nëse gjithçka ishte gati.

Për këtë gjest dashamirës Gabrieli i zgjati një dhjetëshe euro tjetër, të cilën tullaci e mori me dorën e tij imcake dhe e zhduku aty për aty në xhepin e xhaketës që i rrinte shumë keq.

- Doni t'ju ndihmojmë për bagazhet? - e pyeti ai, a thua se kjo ishte gjëja më e rëndësishme për Gabrielin atë mbrëmje.

- Jo, ju faleminderit, - tha Gabrieli gëzueshëm. - I marr vetë.

Ai i mori valixhet me rrota nëpër dyshemenë prej linoleumi dhe pastaj u shtir sikur ishin të lehta kur i ngriti për të ngjitur shkallët e ngushta. Dhoma e tij ishte në katin e tretë, në fund të një korridori të pandriçuar mirë. Gabrieli futi çelësin në bravë, me kujdes, si një mjek kur fut sondën në trupin e pacientit. Kur hyri brenda, vuri re se dhoma ishte bosh, përveç një drite të vetme që ndriçonte dobët mbi një komodinë. I la valixhet në anë të murit. Pastaj, pasi mbylli derën dhe nxori beretën e tij, kontrolloi shpejt e shpejt dollapin dhe banjën. Më në fund, kur u sigurua se ishte vetëm, kyçi derën, i vuri gjithë mobiliet e dhomës nga pas dhe vendosi valixhet poshtë krevatit. Kur u ngrit, telefoni që mori në Kale ra për herë të dytë.

- Shumë mirë, - u dëgjua sërish zëri kompjuterik. - Tani dëgjo me kujdes.

Këtë herë kishte Gabrieli disa kërkesa. Ajo duhej të vinte vetëm, pa përforcime dhe e paarmatosur. Gabrieli kishte të drejtë ta kontrollonte në çdo pjesë të trupit, pa përjashtim, kështu që nuk duhej të kishte keqkuptime. Më pas, ajo mund të merrte gjithë kohën e duhur për të vërtetuar se kartëmonedhat nuk ishin false dhe t'i numëronte, t'i nuhaste apo edhe të bënte seks me paratë. Këto nuk kishin rëndësi për Gabrielin, mjafton që të mos i vidhte. Sepse nëse orvatej të bënte ndonjë gabim, atë e pinte e zeza dhe ata ta harronin marrëveshjen.

- Mos guxoni të bëni kërcënime idiote se do të vrisni Madalenën, - tha ai. - Me këto e fyeni inteligjencën time.

- Ke një orë kohë, - tha zëri kompjuterik dhe e mbylli telefonin.

Gabrieli mori një karrige nga barrikada pas dere dhe e vendosi në këndin e ngushtë pranë dritares. Ndenji i ulur atje për gjashtëdhjetë e shtatë minutat që pasuan, me sytë nga rruga. Pas dyzet minutash, pranë hotelit kaloi një burrë me ombrellë, i cili ndaloi vetëm një çast pranë derës së pasagjerit të *Passat*-it. Më pas, nuk u duk më njeri, as makina, përveç pulëbardhave dhe një tufe macesh rruge që u ngutën të festonin në kazanin e plehrave me mbeturinat e restorantit që ndodhej aty pranë. *Pritja*, mendoi ai, *pritja e përhershme e tij*.

Pasi kaluan gjashtëdhjetë minuta dhe ajo nuk po dukej askund, Gabrieli ndjeu një krizë paniku, panik që shtohej nga minuta në minutë. Pastaj, më në fund, në vendin bosh pranë makinës së tij, parkoi një *BMW* me portobagazh. U hap dera dhe u shfaq një çizme moderne e më pas një këmbë e gjatë, me xhinse. Ishte këmba e një gruaje me flokët e zinj pisë që i binin mbi shpatulla dhe fytyrë, duke ia bërë të pamundur Gabrielit që ta shihte mirë. E pa teksa kalonte rrugën në shi, vëzhgoi ritmin e hapit të saj, edhe përthyerjen e gjunjëve. Çudi, ajo ecje... ishte si një gjurmë gishtërinjsh a një skanim retine. Fytyra ndryshohet kollaj fare, por ecjen nuk e ndryshonin dot as oficerët e shërbimeve sekrete. Gabrieli kuptoi se e kishte parë edhe më parë atë ecje; ishte ajo, gruaja e tragetit. Ishte i bindur për këtë.

25

GRAND-FORT-PHILIPPE

Asaj iu desh më pak se një minutë për të kaluar rrugën e për të mbërritur në katin e tretë të hotelit. Gabrielit iu desh e njëjta kohë për të hequr barrikadën nga dera e dhomës. Pastaj, vuri veshin te dera dhe dëgjoi kërcitjen e takave të saj nëpër tapetin e korridorit. Dera ishte e mirë, e fortë dhe e trashë, mjaftonte për ta ngadalësuar plumbin, por jo për të mos e lejuar të depërtonte. Gruaja trokiti lehtë, sikur të mendonte se brenda kishte fëmijë në gjumë.

- Vetëm je? - e pyeti Gabrieli frëngjisht.

- Po, - u përgjigj ajo.

- Ke armë me vete?

- Jo.

- E di çfarë ndodh nëse zbuloj që ke armë?

- Marrëveshja anulohet.

Gabrieli e hapi derën disa centimetra, pa e hequr çengelin.

- Fute dorën, - i tha.

Ajo ngurroi për një hop, pastaj u bind. Dorën e kishte të gjatë e të zbehtë. Kishte vënë vetëm një unazë, një byzylyk të argjendtë dhe kishte një tatuazh të vogël me diell në hapësirën mes gishtit të madh dhe atij tregues. Gabrieli e kapi nga kyçi dhe ia përdrodhi fort. Në

pjesën e poshtme të kyçit ishin shenjat e një tentative më të hershme për vetëvrasje.

- Nëse do t'i përdorësh më këto duar, duhet të më bindesh, - i tha ai. - More vesh?

- Po, - tha ajo duke gulçuar nga dhimbja.

- Hidhe çantën përtokë dhe shtyje drejt meje me këmbë.

Ajo u bind sërish. Duke vazhduar t'ia mbante kyçin të shtrënguar me dorën e majtë, Gabrieli u afrua dhe e boshatisi çantën në dysheme. Kishte ato gjëra që gjithkush mund të mendonte se do të gjente në çantën e një femre franceze, me dy përjashtime: një lupë argjendarie dhe një elektrik me rreze infra të kuqe. Gabrieli hoqi çengelin nga dera dhe duke ia spërdredhur sërish kyçin e dorës derisa për pak ia theu, e tërhoqi gruan brenda në dhomë. Derën e mbylli me këmbë. Pastaj e përplasi me fytyrë nga muri dhe sikundër kishte thënë, e kontrolloi në çdo vend, pa pasur as dyshimin më të vogël se nuk ishte as i pari dhe as i fundit që e bënte.

- Po kënaqesh? - e pyeti ajo.

- Po, - tha Gabrieli ngadalë, - nuk kisha bërë kaq qejf që kur hoqa një plumb nga trupi për herë të fundit.

- Do Zoti të të ketë dhembur.

Ai i hoqi parukën me flokë të errët dhe kaloi duart nëpër flokët e saj biondë, të shkurtër.

- Mbarove? - e pyeti ajo.

- Rrotullohu.

Ajo u rrotullua duke u përballur për herë të parë me të. Ishte e gjatë dhe e dobët, me gjymtyrë të gjatë dhe gjoks shumë të vogël. Fytyrën në formë zemre e kishte edhe dhelpërake, edhe të pafajshme dhe në buzë i përvijohej një buzëqeshje ironike thuajse e padukshme. Ata të Byrosë vdisnin për fytyra të tilla. Gabrieli mendoi se sa pasuri ishin humbur për to.

- Çfarë do të bëjmë tani? - pyeti ajo.

- Atë që bëhet zakonisht, - iu përgjigj Gabrieli. - Ti do të kontrollosh paratë dhe unë do të të mbaj pistoletën te koka. Po guxove të bësh ndonjë veprim që më ngre nervat do të t'i hedh trutë në erë në vend.

- Gjithnjë kaq magjepsës je ti?

- Jo, vetëm me vajzat që më pëlqejnë shumë.
- Ku janë paratë?
- Poshtë krevatit.
- Do t'i marrësh pak?
- Harroje!

Ajo psherëtiu rëndë, u ul në gjunjë dhe nxori valixhen e parë. E hapi dhe numëroi tufat me para horizontalisht dhe vertikalisht. Pastaj mori një tufë nga mesi, si një klimatologe që kontrollon akullin, dhe i numëroi.

- Mbarove? - pyeti Gabrieli me tallje.
- Sapo fillova.

Zgjodhi gjashtë tufa me kartëmonedha nga gjashtë vende të ndryshme në valixhe dhe i numëroi, pastaj mori nga një kartëmonedhë nga çdo tufë dhe e la mënjanë. I numëroi shpejt, sikur të punonte në bankë apo në kazino. *Ose ishte mësuar të numëronte para të vjedhura*, mendoi Gabrieli.

- Tani më duhen gjërat e mia, - tha ajo.
- Ti vërtet mendon se unë mund të të kthej kurrizin ty?

Ajo i la gjashtë kartëmonedhat njëqindeuroshe mbi krevat dhe shkoi në hyrje të dhomës të merrte lupën dhe elektrikun me rreze infra të kuqe. Kur u kthye, u ul në buzë të krevatit dhe e përdori lupën për të kontrolluar me kujdes çdo kartëmonedhë, në kërkim të diçkaje që mund tregonte se ishin false: një imazh të printuar keq, një numër apo shkronjë që mungonte ose ndonjë hologram apo vijë që nuk dukej origjinale. Ekzaminimi i çdo kartëmonedhe zgjaste më shumë se një minutë. Kur më në fund mbaroi, e uli lupën dhe ngriti elektrikun.

- Duhet të fik dritat e dhomës.
- Ndiz atë njëherë, - tha Gabrieli duke bërë me shenjë nga elektriku.

Ajo e ndezi. Gabrieli eci përgjatë dhomës dhe fiku dritën. Mbeti vetëm drita e kuqërreme e elektrikut, të cilin ajo gjithashtu e përdori për të ekzaminuar gjashtë kartëmonedhat. Vizat e vërtetësisë shkëlqyen në një ngjyrë të gjelbër të zbehtë.

- Shumë mirë, - tha ajo.
- Nuk e ke idenë sa i lumtur jam që u kënaqe, - tha Gabrieli duke ndezur dritën e dhomës. - Tani kam unë një kërkesë. Thuaji Polit të më telefonojë brenda një ore, ndryshe ta harrojë marrëveshjen.

- Atij nuk do t'i pëlqejë kjo.
- Thuaji për paratë dhe do t'i kalojë.

Gruaja rivendosi parukën, mblodhi gjërat e saj dhe u nis pa thënë asnjë fjalë më shumë. Gabrieli e pa të largohej nga vendi i tij pranë dritares. Nuk lëvizi që aty dhe nuk ia ndau sytë rrugës së lagur, ndërsa priste të binte telefoni. Telefonata erdhi në orën 9:15, një orë pas largimit të saj. Pasi dëgjoi zhurmën tanimë karakteristike të kompjuterit, Gabrieli bëri me qetësi kërkesën e tij. Pasoi një heshtje, një shpërthim rrahjesh në tastierë dhe pastaj erdhi zëri; i hollë, i pajetë dhe duke theksuar çdo fjalë të gabuar.

- Kushtet i vendos unë dhe jo ti, - u dëgjua.
- E kuptoj, - tha Gabrieli, sërish shumë i qetë, - por ky është vetëm një transaksion biznesi, asgjë më shumë. Paratë për mallin dhe do të më vinte shumë keq sikur të mos e bëja si duhej pjesën time.

Prapë heshtje, më shumë rrahje në tastierë, pastaj zëri:

- Kjo telefonatë u zgjat shumë. Mbylle dhe prit të të marrim ne.

Gabrieli bëri si i thanë. Pas një minute, mbërriti një telefonatë nga një numër tjetër. Zëri dha disa udhëzime të detajuara, të cilat Gabrieli i kopjoi në një faqe të bllokut të hotelit "Me pamje nga deti".

- Kur? - pyeti ai.
- Pas një ore, - tha zëri.

Pastaj u ndërpre. Gabrieli mbylli telefonin dhe rilexoi udhëzimet për t'u siguruar që i kishte shkruar si duhej.

Kishte vetëm një problem.

Paratë.

Gjatë pesë minutave që pasuan, Gabrieli bëri tri telefonata me shpejtësinë e erës. Dy të parat i kreu me telefonin e dhomës; herën e parë i telefonoi dhomës ngjitur me të tijën, ku nuk u përgjigj njeri dhe telefonatën e dytë ia bëri recepsionistit humbameno në katin e parë, i cili ia konfirmoi se ajo dhomë ishte bosh. Gabrieli e rezervoi për atë natë duke i premtuar se do ta paguante brenda një ore. Pastaj, nga celulari i tij, i telefonoi Kristofer Kelerit.

- Ku je? - e pyeti ai.

- Në *Boulogne*, - u përgjigj Keleri.

- Dua të vish në hotelin "Me pamje nga deti", në *Grand-Fort-Philippe* pas pesëdhjetë e pesë minutash.

- Pse kështu?

- Sepse kam një punë dhe dua të sigurohem që nuk do të m'i vjedhë askush bagazhet sa të kthehem.

- Ku i ke bagazhet?

- Poshtë krevatit, në dhomën ngjitur.

- Ku do të shkosh ti?

- Nuk e kam idenë.

Edhe një orë, prapë në pritje. Gabrieli e shfrytëzoi atë kohë për të vënë rregull në dhomë dhe për të përgatitur *Nescafe*-në ndoshta më të fortë që kishte pirë ndonjëherë. Po i afrohej natës së tretë pa vënë gjumë në sy - një në Luberon, një në *Downing Street* dhe tani kjo. Po afronte, ai e ndiente. *Pas disa orësh*, mendoi, teksa gjerbte lëngun e hidhur. *Pastaj do të flinte një muaj*.

Në orën dhjetë e dhjetë, zbriti në holl, ku i tha recepsionistit të turnit të natës se njëfarë zoti Duval do të mbërrinte së shpejti. Pagoi edhe dhomën ngjitur me para në dorë dhe la një zarf për "zotin Duval". Pastaj doli dhe hipi te *Passat*-i. Kur po largohej, pa nga pasqyra e pasme e makinës Kelerin teksa hynte në hotel, në kohë. Këtë herë ata nuk i kishin dhënë vetëm një adresë, por i kishin treguar edhe se si të shkonte atje. Rruga e çoi përmes fushave me mullinj ere, më pas pranë ca pusesh nafte në rafineri dhe më në fund, në stacionin hekurudhor të *Dunkirk*-ut. Para tij u ngrit një vargmal zhavorri, si një version në miniaturë i Alpeve. Ai kaloi me shpejtësi përmes tij, mes një reje pluhuri dhe u kthye në një rrugicë të ngushtë që kalonte sipër një valëpritësi të gjatë. Në të djathtë ishin kranet e skelës së *Dunkirk*-ut, në të majtë deti. Ai e shënoi fillimin e rrugës duke ndezur rrugëmatësin; pastaj, pikërisht pas një kilometri e gjysmë, parkoi dhe e fiku motorin. Makina u godit nga një erë e fortë dhe

e lagësht. Gabrieli doli nga makina dhe u nis për në plazh. Kishte ardhur batica; rëra ishte e fortë dhe e sheshuar, si një parking. Ai ndaloi buzë ujit dhe e hodhi beretën në ujë. *Ishte një vend i bukur për t'i dhënë fund armës së një ushtari*, mendoi ai teksa kthehej në makinë. Në fund të detit, në plazhin e *Dunkirk*-ut. Kur mbërriti në fund të rrugës, pa nga të dyja anët, në lindje, në perëndim dhe pastaj prapë në lindje. Nuk kishte njerëz, as drita që afroheshin. Dukeshin vetëm dritat e kraneve dhe shkëlqimi i largët i puseve të naftës në rafineri. Gabrieli hapi bagazhin dhe e la çelësin në tokë, nga ana e brendshme e rrotës së pasme të majtë. Pastaj u fut në bagazh, mblodhi disi trupin e tij mesatar në pozicion fetusi dhe e mbylli bagazhin. Pas disa sekondash, ra zilja e telefonit.

- Aty je? - pyeti zëri.

- Po, hyra.

- Pesë minuta, - tha zëri.

Doli se Gabrielit iu desh të priste thuajse dhjetë minuta para se të dëgjonte një makinë të parkonte pranë së tijës. Dëgjoi derën që u hap dhe u mbyll dhe u pasua nga kërcitja e takave të çizmeve në asfalt. *Ishte ajo*, mendoi ai kur makina u nis. Ishte i sigurt. Sapo doli nga *Dunkirk*-u, ajo eci shumë shpejt për më shumë se një orë, duke ndaluar vetëm dy herë. Pastaj u kthye në një rrugë të keqe dhe vazhdoi po me shpejtësi, sikur të donte ta ndëshkonte Gabrielin për këmbënguljen e tij kur i bëri kontrollin për armë para se t'i tregonte dhjetë milionë eurot. Dikur, *Passat*-i ndërroi rrugë dhe kaloi një gropë të fuqishme. Gabrielit iu duk sikur u përplasën me një ajsberg.

Rruga e keqe shpejt ia la vendin një zhavorri më të butë, derisa ai ndjeu shtresën e betonit të një garazhi. Gabrieli e kuptoi sepse kur makina frenoi, zhurma e motorit jehoi nga muret. Pas pak ra qetësi dhe gruaja doli nga makina. Takat e saj jehonin në hapësirë. Bagazhi u hap disa centimetra dhe dora e gjatë dhe e zbehtë futi një leckë të cilën Gabrieli e hodhi menjëherë në kokë.

- Je gati? - e pyeti ajo.

- Po.

- E di se ç'do të ndodhë po e hoqe kapuçin?

- Vajza është e vdekur.

Gabrieli dëgjoi kapakun e bagazhit të ngrihej. E kapën dy palë krahë, natyrisht krahë meshkujsh; një palë nga shpatullat dhe pala tjetër nga këmbët. E nxorën, e lanë në këmbë, çuditërisht me kujdes, dhe u siguruan që mund të qëndronte vetë para se t'ia lidhnin duart pas kurrizit me një palë pranga. Pastaj e kapën nga bërrylat dhe e shtynë duke e ndihmuar të ngjiste disa shkallë përmes një dere.

Dyshemeja e vendit ku hyri ishte e drunjtë dhe jo e njëtrajtshme, si dyshemetë e shtëpive të vjetra. Pasi morën disa kthesa të shpejta. Gabrielit iu duk sikur po e udhëhiqte një njeri me autoritet. Zbritën disa shkallë dhe mbërritën në një qilar të ftohtë që mbante erë gëlqere dhe lagështirë. Një palë duar e shtynë disa metra përpara, pranë një krevati. Gabrieli dëgjoi me vëmendje hapat e disa vetave që largoheshin, duke u përpjekur të kuptonte se sa mund të ishin. Pastaj, një derë e rëndë u përplas me forcë dhe paskëtaj, nuk bëzajti më asgjë. Ndihej vetëm një erë e rëndë që t'i sillte zorrët në fyt. Era e një njeriu që mbahej rob.

Gabrieli qëndroi në heshtje dhe pa lëvizur, i bindur se tashmë ishte vetëm në dhomë, por pas disa sekondash, një dorë i hoqi kapuçin nga koka. Ishte dora e një femre të zbehtë si limoni, por shumë e bukur.

- Unë jam Madalena Hart, - i tha ajo. - Po ti kush je?

26

FRANCA VERIORE

Gabrieli kishte nëntë ditë që përpiqej të pikturonte qartë me mendje fytyrën e saj. Ajo ishte kthyer për të në një skicë me laps, një emër në një dosje me rëndësi të veçantë, një nder për një mik të vjetër. Tani, më në fund e kishte përballë. Ajo, robina për të cilën ai ishte torturuar dhe kishte marrë jetë njerëzish, qëndronte para tij duke pozuar si për portret. Kishte veshur një kostum sportiv në ngjyrë të errët dhe këpucë lëkure pa lidhëse. Ishte më e dobët sesa në regjistrimin në video, më e dobët edhe se në fotografinë e fundit që vërtetonte se ajo ishte gjallë dhe flokët i ishin rritur të paktën tre centimetra që pas zhdukjes. I kishte krehur drejt dhe i vareshin lehtë deri në mesin e kurrizit. Në fytyrë kishte shenja të zeza, sikur ta kishin rrahur, dhe kishte vënë qese poshtë syve të kaltër në gri. Duart i mbante të kryqëzuara në prehër. Kyçet e tyre ishin aq të dobëta dhe thonjtë dukej sikur i kishte ngrënë. Megjithëkëtë, arrinte të ruante një lloj dinjiteti dhe autoriteti. Gabrieli kuptoi pse Xheremi Faloni kishte thënë se ajo duhej të hynte në parlament një ditë dhe pse Xhonatan Lankasteri kishte rrezikuar gjithçka për të. Atë çast, kuptoi se edhe ai kishte rrezikuar gjithçka për të.

- Unë kam ardhur të të marr, Madalena, - i tha ai duke iu përgjigjur më në fund pyetjes së saj. - Jemi në fund të lojës tashmë.

- Doje të vërtetoje që jam gjallë?

Ai ngurroi për një çast, pastaj pohoi me kokë.

- Mirë, ja ku jam, e gjallë, - tha ajo. - Të paktën, mendoj se jam ende gjallë. Ndonjëherë nuk jam edhe aq e sigurt. Nuk di as sa është ora, as se ç'ditë e javës është apo në ç'muaj jemi. Nuk e di as se ku ndodhem.

- Mendoj se je në Francë, - tha Gabrieli. - Diku në veri të saj.

- A thua?

- Mua më sollën këtu në bagazhin e një makine.

- Unë kam kaluar shumë kohë në bagazh makine, - tha ajo si për ta ngushëlluar. - Më duket se isha edhe në një anije disa orë pasi më rrëmbyen, por nuk jam shumë e sigurt. Seç më dhanë për të pirë dhe pastaj nuk mbaj mend më asgjë.

Gabrieli mendoi se biseda e tyre po përgjohej dhe nuk i tha Madalenës se e kishin sjellë nga Korsika në bordin e një jahti me emrin "Vallëzo me Hënën", që drejtohej nga gangsteri që quhej Marsel Lakrua dhe njeriu me të cilin ajo kishte drekuar atë pasdite në "Les Palmiers". Gabrieli kishte shumë pyetje për t'i bërë për njeriun, të cilin ai e njihte vetëm si Poli. Kur e kishte njohur? Nga e kishte njohur? Por në vend të këtyre, e pyeti nëse e mbante mend se si e kishin rrëmbyer.

- Ndodhi në rrugën mes Pianës dhe Kalvit, - tha ajo dhe u ndal për një hop. - Ke qenë ndonjëherë atje? - e pyeti.

- Në Korsikë?

- Po.

- Nuk kam qenë asnjëherë.

- Është vend shumë i bukur, vërtet, - tha ajo në një mënyrë tipike angleze. - Gjithsesi, unë po e ngisja motorin pak më shpejt nga sa lejohej. Ashtu e ngas përgjithësisht, në fakt. Nejse, pas një kthese më doli përpara një makinë. Me zor frenova, por prapëseprapë e godita pjesën anësore të makinës. U desh kohë ta merrja veten, - tha ajo duke fërkuar kurrizin e njërës dorë me dorën tjetër. - Sa kohë ka kaluar? Prej sa kohësh më mbajnë këta?

- Prej pesë javësh.

- Kaq pak? Kisha idenë se kishte më shumë.

- Të kanë trajtuar mirë?

- Të duket sikur më kanë trajtuar mirë?

Ai nuk u përgjigj.

- Për të ngrënë më japin vetëm bukë me djathë dhe perime të konservuara. Vetëm një herë më dhanë pak mish pule, por më bëri dëm dhe nuk më dhanë më. U kërkova një radio, por nuk pranuan të ma jepnin. U kërkova ndonjë libër a gazetë që të merrja vesh se ç'bëhet nëpër botë, edhe atë ma refuzuan.

- Nuk kanë dashur të lexoje lajmet për ty.

- Çfarë di bota për mua?

- Që je zhdukur, vetëm kaq.

- Po për atë videon e tmerrshme që më detyruan të regjistroja?

- Atë nuk e ka parë askush, - tha ai. - Kuptohet, përveç kryeministrit dhe njerëzve të tij më të ngushtë.

- Xheremi e ka parë?

- Po.

- Po Simoni?

Gabrieli pohoi me kokë.

- Po ti? Ma do mendja se edhe ti e ke parë.

Gabrieli nuk foli. Madalena po e fërkonte më me ngulm kurrizin e dorës, sikur donte të ndëshkonte veten. Gabrieli donte ta ndalte, por nuk mundej sepse i kishte duart të lidhura mbrapa.

- Më detyruan ta regjistroja atë video, - tha ajo më në fund.

- E di.

- Thanë që nëse nuk e bëja, do të më vrisnin.

- E di.

- Unë u përpoqa t'i gënjeja, më beso. U thashë që mes meje dhe Xhonatanit nuk ka asgjë, por ata dinin vërtet gjithçka. Dinin oraret, data, vende... *gjithçka*.

Ajo ndaloi së foluri dhe e pa me dyshim Gabrielin.

- Ti nuk je anglez.

- Më fal për këtë, - i tha Gabrieli.

- Polic je?

- Jam një mik i kryeministrit.

- Domethënë, je agjent.

- Diçka e ngjashme.

Ajo vuri pak buzën në gaz. Tek ajo vuri re gjurmët e një buzëqeshjeje të bukur, por të vyshkur tanimë. Gabrieli mendoi se do ta merrte veten, gjithsesi, por kjo do të zgjaste në kohë.

- Madalena, mos e bëj atë, të lutem.

- Çfarë?

- Mos i ngacmo duart ashtu.

Ajo uli sytë dhe i pa, i kishte kruar sa u kishte dalë gjak.

- Më fal, - tha duke u bindur dhe i mblodhi duart e i shtrëngoi aq fort sa iu zbardhën krejt. - Përse ma bënë këtë?

- Për para, - iu përgjigj Gabrieli.

- Po i bëjnë shantazh Xhonatanit?

Ai pohoi me kokë.

- Sa kërkojnë?

- Nuk ka rëndësi.

- Sa? - këmbënguli ajo.

- Dhjetë milionë.

- O Zot! - pëshpëriti ajo. - Ai ka pranuar t'i paguajë?

- Pa e menduar dy herë, madje.

- Po tani çfarë do të ndodhë?

- Do të gjejmë një zgjidhje për ta bërë shkëmbim në mënyrë të kënaqshme për të dyja palët.

- Kur do të marrë fund?

- Drejt fundit jemi.

- Kur do të marrë fund? - pyeti ajo sërish.

- Unë do të bëj të pamundurën që të të largoj prej këtu nesër në mëngjes.

- Kam frikë se kjo nuk bën për mua.

- Edhe disa orë janë.

- Po pastaj?

- Pastaj do të të çoj në një vend të sigurt ku do të pastrohesh dhe do të pushosh pak. Më pas, do të kthehesh në shtëpi.

- Por në fund të fundit, pse të kthehem? Jeta ime është shkatërruar dhe e gjitha kjo për shkak të një marrëzie.

- Askush nuk ka për ta mësuar as për haraçin që do të paguhet dhe as për lidhjen tënde me kryeministrin. Do të harrohet gjithçka.

- Posi, derisa ta marrë vesh shtypi dhe të më marrë shpirtin. E kanë zakon ata, me *këtë punë* merren.

Gabrieli u bë gati të përgjigjej, por u dëgjua një e trokitur në derë; dy goditje të fuqishme me çekiç. Ajo ia mbuloi menjëherë kokën me kapuçin e zi. Atij iu duk se ajo mbuloi edhe kokën e saj, por nuk ishte i sigurt për këtë. Kapuçi i tij ishte tërësisht i patejdukshëm.

- Nuk më the si quheshe.

- Nuk ka rëndësi emri im.

- Duhet ta dish që unë e desha atë. E desha shumë.

- E di.

- Nuk duroj dot më kështu.

- E di edhe këtë.

- Duhet të më largosh prej këtu.

- Do ta bëj, rri e qetë.

- Kur?

- Shumë shpejt, - i tha ai.

Para se ta fusnin prapë në bagazh dhe të udhëtonin nëpër rrugën gjithë pluhur e me gropa, ata ia hoqën prangat. Rrugës, makina ra prapë në të njëjtën gropë ku kishte rënë edhe në rrugën e vajtjes, derisa morën një rrugë të shtruar. Duhej të kishte rënë shumë shi, sepse Gabrieli ndiente spërkla uji e balte të përplaseshin pareshtur në rrotat e pasme. Zhurma e tyre u kthye në ninullë dhe Gabrieli u kot për pak. Pa në ëndërr sikur Madalena kruante kurrizin e dorës deri në kockë.

– *Nuk duroj dot më kështu. Duhet të më largosh prej këtu.*

– *Do ta bëj, rri e qetë.*

Dhjetë minuta pasi u zgjua, më në fund makina u ndal. U fik motori, u hap një derë, u dëgjua një kërcitje takash në rrugë dhe më pas heshtje. Paskëtaj, ndihej vetëm shiu dhe fishkëllima e largët e një sërfisti. Për një çast Gabrieli pati frikë se do ta linin të vdiste, sikur do ta varrosnin për së gjalli, por nuk kaloi shumë dhe ra zilja e celularit që mbante në xhepin e xhaketës.

- Të thamë që nuk duhej të kishe përforcime, - tha zëri.

- Vërtet kujtuat se do të lija dhjetë milionë euro ashtu në hotel?

- Tani e tutje bëj si të themi ne, në të kundërt, vajza është e vdekur!

- Ju jap fjalën për këtë, - tha Gabrieli.

Pasoi një heshtje, pastaj prapë rrahje në tastierë.

- Çelësi rezervë është ngjitur në derën e bagazhit, sipër kokës sate. Kthehu në dhomë dhe prit të të telefonojmë.

- Sa do të vonoheni?

Linja u ndërpre. Gabrieli zgjati dorën dhe mori çelësin, pastaj hapi bagazhin dhe shiu iu përplas fuqishëm në fytyrë.

27

GRAND-FORT-PHILIPPE, FRANCË

Kur hyri në dhomën e hotelit "Me pamje nga deti", Gabrieli gjeti Kelerin të ulur mbi krevat, me cigare në dorë, që ia kishte ngulur sytë televizorit. Po shihte ritransmetimin e një ndeshjeje të Premier Ligës Angleze, Fulham-Arsenal, pa zë.

- Qenke rehatuar? - e pyeti Gabrieli.

- Të pashë kur erdhe, - tha Keleri duke fikur televizorin me telekomandë. - Hë?

- Ishte gjallë.

- Ishte shumë keq?

- Po.

- Çfarë do të bëjmë tani?

- Do të presim të bjerë telefoni.

Keleri ndezi televizorin dhe më pas një cigare.

Këtë herë Gabrielin e braktisi vetëpërmbajtja e zakonshme. U orvat të shpërqendrohej duke parë ndeshjen e futbollit, por pamja e atyre burrave me pantallona të shkurtra që rendnin pas një topi futbolli, iu duk

sikur e fyeu inteligjencën e tij. Më në fund, gjerbi një *Nescafe* dopio në vendin e tij pranë dritares. Në vend të baticës kishte ardhur zbatica. Ai pa orën e dorës. Nuk kishte lëvizur që kur e pa për herë të fundit: 3:22 e pasdites. *Kjo tregonte se asgjë e mirë nuk mund të ndodhte ndonjëherë në atë orë*, mendoi.

- Nuk kanë për të telefonuar, - tha ai, por u duk sikur më shumë ia tha vetes sesa Kelerit.

- Do të telefonojnë patjetër.

- Pse je kaq i sigurt?

- Sepse nuk do ta çojnë dëm atë që kanë bërë deri tani dhe mos harro se tani ata duan ta heqin qafe Madalenën, po aq sa edhe ti do që ta marrësh.

- Kësaj ia kam frikën më shumë.

Keleri e pa me seriozitet dhe i tha:

- Kur ke fjetur për herë të fundit?

- Në shtator.

- Ka ndonjë mundësi të më lejosh mua t'i dorëzoj paratë?

- Harroje!

- Mirë, një pyetje të bëra.

- Faleminderit.

Keleri ktheu sytë nga televizori, i ngrysur. Me sa dukej, njëra nga skuadrat kishte shënuar sepse ata burrat me pantallona të shkurtra po hidheshin përpjetë si fëmijë në këndin e lojërave. Por Gabrieli jo; ai ua kish ngulur sytë ujërave të baticës dhe po mendonte për Madalenën që kruante dorën deri në kockë. Aq i përhumbur ishte, sa kur më në fund ra telefoni në orën 3:48, u tmerrua sepse iu duk si ulërimë gruaje. Zëri i foli sërish: i hollë, i pajetë dhe duke theksuar të gjitha fjalët e gabuara. Pas disa sekondash, ai pa nga Keleri dhe tundi një herë kokën.

Kishte ardhur koha.

Recepsionisti i turnit të natës nuk dukej kurrkund. Gabrieli i la të dy çelësat në raftin e çelësave dhe i tërhoqi dy valixhet me rrota e doli në rrugën e lagur. Motori i *Passat*-it punonte pak rëndë nga rruga e fundit që kishte bërë. Kur po mbyllte derën, filloi të binte telefoni. Ai e kaloi menjëherë celularin në opsionin me zë, sipas udhëzimit.

- Shko në autostradën 16 dhe merr për nga Kaleja, - i tha zëri. - Mos e mbyll telefonin në asnjë mënyrë. Po u ndërpre telefonata, vajza është e vdekur.

- Po nëse ikën sinjali?

- Nuk duhet të ikë, - tha zëri.

Autostrada 16 kishte katër korsi dhe kalonte përgjatë një rreshti pafund dritash rruge nga njëra anë dhe fushash bujqësore nga ana tjetër. Gabrieli ruajti shpejtësinë prej nëntëdhjetë kilometrash në orë që i kishin thënë, pavarësisht se rruga ishte pothuajse bosh. Me njërën dorë mbante timonin, ndërsa me tjetrën telefonin dhe ndërkohë shikonte me vëmendje fuqinë e sinjalit. Në pjesën më të madhe të kohës ishin pesë vija, por për disa sekonda të ankthshme ra në tre.

- Ku je? - e pyeti zëri më në fund.

- Po i afrohem daljes D219.

- Vazhdo përpara.

Ai vazhdoi. Rruga vazhdonte pak a shumë njësoj: toka bujqësore dhe drita, pak trafik dhe tela energjie elektrike që ndërhynin në sinjalin e celularit.

Herën tjetër kur foli, zëri doli më autoritar se më parë:

- Ku je?

- Po i afrohem D940-ës.

- Vazhdo!

Pas pak, sinjali erdhi sërish i qartë.

- Ku je?

- Po i afrohem A216-s.

- Vazhdo.

Kur u dukën dritat e Kalesë, Gabrieli nuk priti më pyetje, por u tha vetë se ku ndodhej, qoftë edhe për të thyer monotoninë e akullt të asaj marrjeje në pyetje. Nga ana tjetër pati heshtje derisa Gabrieli tha se po i afrohej seksionit D243.

- Aty hyr, - i tha zëri, me një ton që tingëlloi më shumë si pyetje sesa si urdhër.

- Cilin drejtim të marr?

Përgjigjja erdhi disa sekonda më pas. Ata donin të shkonte në veri, drejt detit.

Qyteti i radhës ishte ai i *Sanggatte*-s, një qytet i vogël me shtëpiza që dukej sikur ishin marrë nga një fshat anglez dhe ishin vendosur në Francë. Mandej ishin dërguar edhe më larg, në perëndim, përgjatë bregdetit të Kanalit, në fshatrat *Escalles*, *Wissant* dhe *Taedinghen*. Kaluan disa hapësira prej disa minutash pa marrë asnjë udhëzim. Në anën tjetër të telefonit, Gabrieli nuk dëgjonte asgjë, por kishte një parandjenjë se po i afrohej fundit. Vendosi të guxonte.

- Kemi edhe shumë rrugë? - pyeti.

- Edhe pak.

- Ku është ajo?

- Në një vend të sigurt.

- Shumë u zgjat kjo punë, - ia priti Gabrieli. - Paratë i patë, e dini që nuk më ndjek njeri. T'i japim fund kësaj pune dhe vajza të kthehet në shtëpi.

Heshtje nga ana tjetër e telefonit. Pastaj zëri pyeti:

- Ku je ti?

- Po kaloj mespërmes Audinghenit.

- E shikon rrethrrotullimin?

- Prit, - tha Gabrieli teksa merrte një kthesë. - Po, tani e shikoj.

- Futu në rrethrrotullim, merr daljen e dytë dhe ec pesëdhjetë metra.

- Po pastaj?

- Aty ndalo.

- Aty është vajza?

- Ti bëj si të themi!

Gabrieli u bind. Në rrugë nuk kishte asnjë vend për të ndaluar, kështu që ai mori një kthesë të vogël dhe parkoi në rrugën e asfaltuar të këmbësorëve. Para tij u shfaq një ndërtesë industriale e gjatë dhe e ulët, me oxhakë në të dyja skajet e çatisë me tulla të kuqe. Në të djathtë të tij, shtrihej një fushë me grurë, kallinjtë e të cilit valëviteshin lehtë nga shiu dhe era. Përtej fushës, shihej deti.

- Ku je? - e pyeti zëri.

- Pesëdhjetë metra poshtë rrethrrotullimit.

- Shumë mirë. Tani fike makinën dhe dëgjo me vëmendje.

Dukej që udhëzimet ishin hedhur paraprakisht në kompjuter sepse vërshuan lumë. Gabrieli duhej të hapte bagazhin e makinës dhe ta hidhte çelësin në fushën në të djathtë të tij. Madalena ishte afro tre kilometra më poshtë, në pjesën e pasme të një *Citroën*-i C4, në ngjyrë blu të errët. Çelësi i *Citroën*-it ndodhej i fshehur në një kuti magnetike në rrotën e majtë të përparme. Gabrieli nuk duhej ta fikte ende telefonin, që ata ta dëgjonin. Nuk duhej të kishte polici, përforcime dhe as të tentonte të bënte ndonjë prapësi.

- Nuk më pëlqen kjo, - tha ai.

- Ke pesëmbëdhjetë minuta kohë.

- Përndryshe?

- Mos e ço dëm kohën.

Në mendjen e Gabrielit u shfaq një imazh: Madalena në qelinë e saj, duke kruar trupin derisa i dilte gjak.

- *Nuk duroj dot më kështu.*

- *Duhet të më largosh prej këtu.*

- *Do ta bëj, rri e qetë.*

Gabrieli doli nga makina dhe e hodhi çelësin aq fuqishëm sa iu duk sikur ra në Kanal. Pastaj shënoi kohën në celularin e tij dhe ia dha vrapit.

- U nise? - e pyeti zëri.

- Po, u nisa, - tha Gabrieli.

- Nxito, - tha zëri. - Ke vetëm pesëmbëdhjetë minuta kohë, në të kundërt, vajza është e vdekur.

28

PAS-DE-KALE, FRANCË

Tre kilometra janë diçka më pak se dy milje ose shtatë xhiro e gjysmë në një pistë ovale prej katërqind metrash. *Një atlet profesionist mund ta përshkonte atë distancë në më pak se tetë minuta, një vrapues i mirë, një që vrapon rregullisht, do ta përshkonte në dymbëdhjetë minuta, ndërsa një mesoburrë i veshur me xhinse dhe këpucë në vend të atleteve, i cili ishte plagosur dy herë në kraharor, do të ishte me fat nëse e bënte për pesëmbëdhjetë minuta,* mendoi ai. Sikur të kish qenë disa qindra metra më e gjatë, ai kufi kohor mund të ishte i tepërt për fizikun e tij. Për fat të mirë, rruga ishte e sheshtë. Madje, meqë Gabrieli po vraponte drejt detit, vende-vende ishte dhe pak e tatëpjetë, pavarësisht vështirësisë që i shkaktonte era që i përplasej furishëm në fytyrë. I nxitur nga një shkulm adrenaline dhe zemërimi, ai nisi të vraponte si maniak, por pas ndonja njëqind metrash, e uli disi ritmin. Telefonin e mbante fort në dorën e djathtë, teksa të majtën e mbante të lirë dhe të qetë. Frymëmarrjen fillimisht e pati të qetë, por sa vinte dhe i dilte më e zemëruar dhe fytin e ndiente si të ndryshkur. *Ai Shamroni e ka fajin,* mendoi me inat teksa gulçonte duke vrapuar me shiun që i binte në fytyrë. *Shamroni dhe ato dreq cigaresh të tij*! Përtej ndërtesës industriale nuk të zinte më syri asgjë. Nuk kishte më as shtëpiza, as drita rruge, por vetëm fusha të zeza, djerrina, përgjatë rrugës

me vija të bardha që kishte ndjekur Gabrieli në errësirë. Hapësirat mes vijave të bardha ishin të baraslarguara edhe nga vetë ajo, nga dy hapa për çdo vijë dhe nga dy hapa për çdo hapësirë. Gabrieli i përdori ato vija për të ruajtur edhe ritmin e lëvizjeve të tij. Dy hapa për çdo vijë dhe dy hapa për çdo hapësirë. Pesëmbëdhjetë minuta për të përshkuar tre kilometra.

– *Përndryshe?*

– *Mos e ço kohën dëm.*

Pas pesë minutash nuk po i ndiente më këmbët dhe ishte mbytur në djersë poshtë xhaketës prej lëkure. U përpoq ta hiqte xhaketën duke vrapuar, por nuk mundi dhe u ndal pak sa për ta hequr dhe për ta hedhur në një fushë bujqësore. Kur nisi të vraponte sërish, pa një dritë të verdhë të zbehtë në horizont. Mandej dy llamba, llambat e dritave të një makine të parkuar, që u shfaqën befas dhe automjeti u nis drejt tij me shpejtësi të madhe. Ishte një kamion i vogël, në ngjyrë gri të zbehtë, i vjetruar sa më s'ka. Kur kaloi pranë tij me shpejtësinë e erës, Gabrieli vuri re se shoferi dhe pasagjeri ishin me maska të zeza. *Rrëmbyesit erdhën të marrin paratë*, mendoi. Nuk e mori mundimin të kthehej për t'i parë më tej, por u përqendrua të hiqte mendjen nga dhimbja e pulpave të këmbëve dhe shiu që i përplasej në fytyrë. Dy hapa për çdo vijë dhe dy hapa për çdo hapësirë. Pesëmbëdhjetë minuta për të përshkuar tre kilometra.

Vetëm pasi ajo të vdesë do ta marrësh vesh të vërtetën...

Gabrieli pastroi fytyrën me dorë dhe sakaq pa disa drita që shkëlqenin në largësi. Mendoi se ishin dritat e *Audresselles*-it, fshatit të vogël bregdetar që ndodhej në jug të *Cap Gris Nez*-it. Pa orën në celularin e tij. Kishin kaluar tetë minuta, mbeteshin edhe shtatë. Ndihej i rraskapitur dhe qafa i kishte ngrirë. U pendua që nuk ishte kujdesur më mirë për trupin e tij, por më shumë i erdhi ndër mend Vjena; një makinë e parkuar ndanë një sheshi të mbuluar nga bora, një motor që nuk donte e nuk donte të ndizej sepse fuqinë e baterisë e kishte marrë një bombë e vendosur në të. Pa sërish celularin. Kishin kaluar nëntë minuta, mbeteshin edhe gjashtë. Dy hapa për çdo vijë, dy vija për çdo hapësirë.

E ngriti telefonin deri te goja dhe tha:

- I morët paratë?

Zëri u përgjigj disa sekonda më pas.

- Po. Faleminderit shumë.

Si gjithmonë, zëri erdhi i hollë, i pajetë dhe duke theksuar fjalët e gabuara. Megjithëkëtë, Gabrieli e ndjeu që ishte shend e verë.

- Duhet të më japësh më shumë kohë, - bërtiti ai. - Nuk mundem. Nuk ia dal dot.

- Përpiqu më shumë.

Ai pa orën. Kishin kaluar dhjetë minuta, mbeteshin edhe pesë. Tre hapa për çdo vijë, tre hapa për çdo hapësirë.

- Po vij të të marr, Lea! - thirri ai përkundër erës. - Mos e rrotullo më çelësin. Mos e rrotullo!

Kaloi me vrap ndanë një vile të rrethuar me lulëzim, e cila ishte e re, por e ndërtuar me një arkitekturë të tillë që të dukej si e vjetër, dhe e ndjeu sakaq aromën e detit. Rruga sikur zhytej drejt tij dhe merrte edhe ajo aromën e peshqve dhe kripës në gojën e Gabrielit. Një shenjë e materializuar nga errësira tregonte se dyqind metra përpara ndodhej një plazh. Pastaj Gabrieli vuri re *Citroën*-in, që priste në një parking me rërë, me dritat e tij që e shikonin drejt e në sy teksa rendte drejt tij si i marrë. Pa orën në celularin e tij. Kishin kaluar trembëdhjetë minuta, mbeteshin edhe dy. Do të mbërrinte patjetër, madje mund edhe t'i mbeteshin disa sekonda kohë. Megjithatë, u sforcua ta çonte garën deri në fund, duke u mëshuar këmbëve mbi asfalt, duke tundur krahët, derisa iu duk se do t'i shpërthente zemra nga kraharori. Në mungesë të oksigjenit, filloi t'i bënte lojëra dhe mendja. *Citroën*-i i parkuar në plazh, iu duk se ishte një *Mercedes Sedan*, në një shesh të mbuluar nga bora në Vjenë. Ishte i bindur që dëgjoi zhurmën e motorit në tentativë për t'u ndezur dhe më pas u kujtua se thirri diçka para se të verbohej nga drita e një shpërthimi. Vala e flakës e goditi si të ishte një makinë duke ecur si rrufeja dhe e hodhi përtokë. E pa veten të shtrirë në asfaltin e ftohtë për disa minuta, duke u përpjekur të mbushej me frymë dhe duke u rrekur të kuptonte nëse e gjitha kjo ishte e vërtetë apo ishte në ëndërr.

PJESA E DYTË

AGJENTI

29

AUDRESSELLES, PAS-DE-CALAIS

Ora ishte e herët dhe vendi i largët e, për pasojë, edhe reagimi ishte i ngadaltë. Shumë kohë më vonë, një komision i posaçëm do ta kritikonte shefin e xhandarmërisë lokale dhe do të nxirrte një rregullore që kryesisht nuk do të respektohej, sepse në qytetin e vogël peshkatar të *Audresselles*-it, nuk i binte njeriu në mend për drejtësi. Për shumë muaj më pas, ende të tronditur, banorët e tij do të vazhdonin të flisnin me zymtësi për atë mëngjes. Një grua, një tetëdhjetëvjeçare familja e së cilës kishte jetuar në fshat qëkur atë e sundonte një mbret anglez, do ta përshkruante incidentin në plazh si gjënë më të keqe që i kishin zënë sytë që pasi nazistët ngritën kryqin mbi hotelin e fshatit. Askush nuk ua vuri veshin fjalëve të saj, ndonëse disave iu duk një deklaratë e fryrë. Natyrisht që fshati *Audresselles* kishte parë shumë ditë të zeza në jetën e tij, thanë ata, pavarësisht se po t'i pyesje për një shembull, askush nuk dinte të ta jepte. Komuna e *Audresselles*-it ka një sipërfaqe prej vetëm dy mijë akrash dhe vala e shpërthimit shpartalloi dritaret tejpërtej saj. Disa banorë të tmerruar njoftuan menjëherë xhandarmërinë, ndonëse do të duhej të kalonin njëzet minuta të mira para se në makinën e parkuar pranë plazhit të mbërrinte njësia e parë e forcave policore. Atje, ata zbuluan një *Citroën* C4 të përfshirë në një zjarr aq të madh sa askush nuk

mund t'i afrohej më shumë se tridhjetë metra. Zjarrfikësit erdhën pas dhjetë minutash të tjera. Kur ata më në fund arritën t'i shuanin flakët, *Citroën*-i ishte shndërruar në një guaskë të zezë. Për arsye të cilat nuk u bënë kurrë të qarta, një prej zjarrfikësve vendosi të hapte bagazhin e makinës me mendjen e tij. Papritmas, ra në gjunjë dhe volli keqas. Po kështu, edhe xhandari i parë që iu afrua bagazhit. Por xhandari i dytë, një xhandar me eksperiencë prej më se njëzet vjetësh, e mbajti veten dhe konfirmoi se ajo çka ata kishin dëshmuar, ishin mbetjet e një qenieje njerëzore. Mandej njoftoi me radio oficerin rojë në rajonin *Pas-de-Calais* dhe raportoi se shpërthimi i makinës në plazhin e *Audresselles*-it ishte kthyer në një çështje që do të shqyrtohej për vrasje, për një vrasje të lemerishme.

Sapo ra dita, më shumë se dhjetë detektivë dhe ekspertë mjekoligjorë po punonin në vendngjarje, nën sytë e thuajse gjysmës së fshatit. Vetëm një banor i *Audresselles*-it kishte diçka me vlerë për t'u thënë: Leon Banvili, pronari i një vile të ndërtuar rishtazi në periferi të qytetit. Doli se zoti Banvili kishte qenë zgjuar në orën 5:09 të mëngjesit, kur një burrë i veshur me rroba të zakonshme kishte kaluar me vrap pranë dritares së tij duke thirrur në një gjuhë të panjohur për të. Policia bëri menjëherë një kontroll të zonës dhe gjetën një xhaketë lëkure që dukej sikur i kishte përkitur një burri me trup mesatar. Nuk u gjet asgjë tjetër që mund t'i ndihmonte, as çelësi që burri, i cili kishte qenë duke vrapuar, kishte hedhur në fushën me grurë dhe as *Volskvagen*-i të cilit ai i përkiste. Makina u zhduk pa lënë gjurmë, bashkë me dhjetë milionë eurot e fshehur në dy valixhet në bagazhin e saj.

Nxehtësia e madhe e flakëve e kishte dëmtuar rëndë trupin brenda në *Citroën*, por gjithsesi jo tërësisht. Si rrjedhojë, ekspertët mjekoligjorë mundën të përcaktonin se bëhej fjalë për një vajzë të re, ndoshta në fund të të njëzetave ose në fillim të të tridhjetave, përafërsisht 1.76 metër e gjatë. Përshkrimi dukej se i afrohej shumë atij të Madalena Hartit, vajzës angleze e cila ishte zhdukur në Korsikë në fund të muajit gusht. Policia franceze u lidh menjëherë, por pa bujë, me homologët përtej Kanalit dhe brenda dyzet e tetë orësh mbërriti një kampion i ADN-së së zonjushë Hartit, i marrë në apartamentin e saj në Londër. Doli se ishte i njëjtë me kampionin e marrë nga kufoma në makinë. Ministri i Brendshëm francez

dërgoi menjëherë fjalë në *Home Office* në Londër para se ta bënte lajmin publik në një deklaratë për shtyp. Madalena Harti kishte vdekur, por kush ia kishte marrë jetën dhe pse?

Funerali i saj u mbajt në kishën "Shën Andrea", në Basildon, në fund të rrugës së shtëpisë ku ajo ishte rritur. Kryeministri Xhonatan Lankaster nuk ishte i pranishëm - nuk ia lejonte axhenda qeveritare, të paktën kështu u shpreh zëdhënësi i tij i shtypit, Simon Hjuiti. Pothuajse i gjithë stafi i partisë ishte i pranishëm, po ashtu edhe Xheremi Faloni, i cili qau haptazi pranë varrit të saj, gjë që frymëzoi një reporter të shkruante se ndoshta edhe ai njeri e kishte një zemër. Më pas, ai foli shkurtimisht me nënën dhe vëllanë e Madalenës, të cilët dukej sikur nuk përkisnin mes gjithë atyre njerëzve të pispillosur.

- Më vjen shumë keq, - u dëgjua të thoshte ai. - Më vjen vërtet shumë keq.

Edhe një herë, ekipi i partisë vuri re një rritje të numrit të aprovimeve të Lankasterit, ndonëse këtë herë ata patën mirësinë të mos ia përmendnin emrin e Madalenës. Me popullaritetin e tij gjithnjë në rritje, kryeministri shpalli një program gjithëpërfshirës për një qeveri më efikase dhe më pas u nis për një udhëtim të rëndësishëm në Moskë, prej nga premtoi një erë të re të marrëdhënieve ruso-britanike, veçanërisht në fushat e antiterrorizmit, financave dhe energjisë. Disa konservatorë e kritikuan lehtë Lankasterin për faktin që nuk u takua me përfaqësues të lëvizjes prodemokratike ruse gjatë qëndrimit të tij në Moskë, por kryesisht shtypi britanik e pasqyroi me nota pozitive vizitën e tij në Rusi. Ata shkruan se meqë ekonomia vendase po kalonte një kohë disi të vështirë, Britanisë nuk i duhej një luftë tjetër e ftohtë me Rusinë. Kur u kthye në Londër, Lankasterin e pyetën nëse do të kandidonte sërish. Për dhjetë ditë ai luajti me shtypin, ndërsa Simon Hjuiti orkestronte një sërë rrjedhjesh informacioni, të cilat e bënin të qartë se shumë shpejt ai do të fliste hapur. Kështu, kur më në fund Lankasteri u ngrit në "Commons" për të shpallur vendimin e tij për të kandiduar për një mandat të ri, nuk u habit askush. Lajmi i vërtetë ishte ai që kishte të

bënte me të ardhmen e Xheremi Falonit, i cili kishte ndër mend ta linte pozicionin e tij të mirë në *Downing Street*, për të kandiduar për një vend në parlament. Pasuan shumë deklarata për shtyp, të gjitha të pakonfirmuara, që sikur Lankasteri të fitonte një mandat tjetër si kryeministër, Faloni do të emërohej ministër Financash. Faloni i mohoi prerazi këto deklarata, madje shkoi deri atje sa të deklaronte se ai dhe kryeministri nuk kishin diskutuar fare për të ardhmen e tij. Asnjë përfaqësues i shtypit për *Whitehall*-in nuk e besoi dhe më pas nisi fushata dhe emri i Madalena Hartit u zhduk nga vëmendja e publikut. Kjo erdhi si një bekim për policinë franceze, sepse e lejoi atë të vazhdonte hetimet pa kokëçarje nga shtypi britanik. Ndër zhvillimet më të rëndësishme që pati hetimi i tyre ishte zbulimi i katër trupave në një vilë të izoluar në Luberon. Të katër ishin të njohur si pjesë e një prej bandave kriminale të Marsejës. Tre ishin vrarë në mënyrë profesionale në kokë, ndërsa kufoma e katërt, ajo e një gruaje, ishte qëlluar dy herë në pjesën e sipërme të trupit. Por ç'është më e rëndësishmja, ishte zbuluar edhe një bodrum i ndërtuar enkas në katin përdhes të vilës. Ishte e qartë se atje ishte mbajtur Madalena Harti pas rrëmbimit në Korsikë dhe me sa dukej, ishte mbajtur gjatë. Mund të kishte rënë viktimë e një shfrytëzimi seksual, por nga të dhënat e katër kufomave, kjo dukej paksa e pamundur. Ata nuk ishin grabitqarë seksualë, por kriminelë të regjur, të cilëve u interesonin vetëm paratë. Të gjitha këto bënë që policia të arrinte në përfundimin se Madalena Hart ishte mbajtur peng për të marrë një shpërblim - skemë për të cilën nuk po e kuptonin pse nuk ishte bërë asnjë denoncim në polici. Por pse duhej të rrëmbenin një vajzë nga një familje e klasës punëtore, e cila ishte rritur në një shtëpi të dhënë nga shteti, në Eseks? Pastaj, kush i kishte vrarë katër kriminelët marsejezë në vilën në Luberon? Këto ishin vetëm dy nga pyetjet të cilave policia franceze nuk po arrinte t'u jepte një përgjigje edhe një muaj pas vdekjes së tmerrshme të Madalena Hartit, në plazhin e *Audresselles*-it. Nuk kishin asnjë pistë as për identitetin e personit që ishte parë të kalonte me vrap pranë shtëpisë së zotit Banvil, në orën 5:09 të mëngjesit, vetëm disa minuta përpara se të shpërthente makina. Megjithatë, një prej veteranëve që kishte punuar me shumë raste rrëmbimi, e kishte një teori.

- Ai i gjori duhet të ketë qenë dorëzuesi i parave, - u tha ai me bindje kolegëve të tij. - Diku, gjatë rrugës, duhet të ketë bërë ndonjë gabim dhe vajza vdiq për mëkatet e tij.

Po ku ishte tani ai njeri? Ata arritën në përfundimin se ndoshta fshihej diku, duke e vrarë ndërgjegjja dhe duke u përpjekur të gjente se çfarë nuk shkoi mirë. Ndonëse policia franceze nuk do ta merrte vesh kurrë se ata e kishin tërësisht gabim.

Por gjithsesi, kishte shumë gjëra që policia franceze as në ëndërr nuk mund t'i shihte e jo më t'i dinte për personin që ishte parë duke vrapuar. Për shembull, ata nuk do ta merrnin vesh kurrë se ai ishte Gabriel Aloni, agjenti dhe vrasësi legjendar izraelit, i cili kishte vepruar nën hundën e francezëve qëkurse ishte vetëm një djaloshar njëzetedyvjeçar, as që njeriu që e ndihmoi atë pas shpërthimit të bombës ishte Kristofer Keleri, dora vetë, vrasësi që jetonte në Korsikë, për të cilin policia franceze kishte vite që dëgjonte fjalë, dhe as se ata të dy, dikur rivalë të ashpër, kishin shkuar në një vilë pranë *Cherbourg*-ut ku i priste një ekip operativësh izraelitë. Keleri kishte qëndruar vetëm pak orë në atë vilë, para se të kthehej në Korsikë, por Gabrieli dhe Kiara kishin ndenjur atje një javë, derisa ishin shëruar disa prerje të vogla në fytyrën e Gabrielit. Mëngjesin e funeralit të Madalena Hartit, ata udhëtuan me makinë për në aeroportin "Charles de Gaulle", prej nga morën një avion të linjës *El Al* për në Tel Aviv. Kur ra mbrëmja e asaj dite, ata ishin sërish në apartamentin e tyre në rrugën "Narkiss".

Gjatë mungesës së Gabrielit, Kiara i kishte zhvendosur pikturën dhe pajisjet e tij në dhomën që ai përdorte si studio. Por mëngjesin që pasoi, pasi ajo u nis për në punë në muze, ai i çoi menjëherë gjërat e tij në dhomën e ndenjjes. Për tri ditë rresht qëndroi para kanavacës pa pushuar pothuajse për asnjë çast, nga mëngjesi deri pasdite vonë, kur Kiara kthehej në shtëpi. U përpoq t'i mbante larg kujtimet e makthit që përjetoi në Francë, por subjekti i pikturës, një vajzë e re dhe e bukur që bënte banjë në kopshtin e saj, nuk e linin ta bënte këtë. Nuk e hiqte dot mendjen nga Madalena, sidomos në ditën e katërt kur nisi të punonte me duart e Suzanës. Atje pa shumë gjurmë të punës me furçë të Basanos. Gabrieli

e imitoi aq mirë sa ishte e pamundur të dalloje punimin origjinal nga i tiji. Në të vërtetë, sipas mendimit modest të Gabrielit, ai ia kishte kaluar edhe vetë mjeshtrit të madh në disa vende. Do të donte të merrte meritat për cilësinë e lartë të punës së tij, por kjo ishte e pamundur. Gjithë frymëzimin e kishte marrë nga Madalena.

Me zor i mbushi mendjen vetes të bënte një pushim të shkurtër pasdite, por prapëseprapë hëngri para kompjuterit, kur kërkoi nëpër internet lajme për ecurinë e hetimeve të policisë franceze për zhdukjen e Madalenës. Dukej se policia nuk kishte dijeni për përfshirjen e tij në atë çështje. Nuk gjeti as gjurmë të shtypit britanik që mund të hidhnin dyshime për një lidhje të mundshme të Xhonatan Lankasterit me zhdukjen dhe vdekjen e saj. Me sa dukej, Lankasteri dhe Faloni kishin bërë të pamundurën dhe tani, sipas sondazheve, i priste një fitore e thellë. Nuk është nevoja të themi se asnjëri prej tyre nuk kërkoi të lidhej më me Gabrielin. Madje edhe Graham Sejmuri priti tri javë të gjata për ta telefonuar. Nga zhurma në anën tjetër të telefonit, Gabrieli kuptoi se po i telefononte nga një telefon publik në stacionin "Pedington".

- Miku ynë i përbashkët të dërgon të fala, - tha Sejmuri me qetësi. - Pyet nëse të nevojitet ndonjë gjë tjetër.

- Një xhaketë e re lëkure nuk do të më bënte keq, - tha Gabrieli me më shumë nota humori nga sa ndiente në të vërtetë.

- Çfarë mase?

- Të mesme, - u përgjigj Gabrieli, - me një vend të fshehtë për një pasaportë false dhe një pistoletë.

- Do të ma thuash ndonjëherë se si ia dole të largoheshe nga ai vend pa të arrestuar?

- Do të ta them ndonjë ditë, Graham.

Sejmuri ra në heshtje, ndërsa u dëgjua një njoftim për pasagjerët e trenit për në Oksford.

- Ai të është mirënjohës, - tha më në fund ai, duke iu referuar Lankasterit. - E di që ti bëre çmos për ta shpëtuar.

- Por nuk mjaftoi.

- E ke menduar që ndoshta ata nuk kanë pasur asnjëherë ndër mend ta linin të lirë?

- Po, e kam menduar, - tha Gabrieli, - por të betohem që nuk e kuptoj pse.

- Dëshiron t'i them ndonjë gjë tjetër atij?

- Ndoshta nuk do të bëje keq t'i kujtoje që rrëmbyesit kanë ende videon ku ajo rrëfehej për lidhjen me të.

- Pa vajzën, nuk ka më histori.

Nëse Sejmuri kishte pasur si qëllim t'i ngrinte humorin Gabrielit me telefonatën e tij, ndodhi krejtësisht e kundërta. Edhe ditë pas asaj telefonate, humori i Gabrielit sa vinte e binte. Gjumin ia prishnin ëndrra të këqija, ëndrra ku ai vraponte drejt një makine, e cila i largohej gjithnjë e më shumë pas çdo hapi që ai bënte drejt saj, ëndrra me gjak dhe flakë. Në pavetëdijen e tij, Madalena dhe Lea bëheshin një; dy gra, njërën prej të cilave e kishte dashuruar dhe tjetrën nuk mundi ta mbronte, të dyja të djegura. E kishte kapluar brenga. Por më shumë se gjithçka, e kishte kapluar një ndjesi e fortë dështimi. I kishte premtuar Madalenës se do ta shpëtonte, por ajo kishte pësuar një vdekje të kobshme, e lidhur, me gojën të mbyllur, në një arkivol zjarri. Tanimë ai shpresonte vetëm që rrëmbyesit t'i kishin dhënë qetësues që të paktën të mos kishte qenë e vetëdijshme për dhimbjet dhe tmerrin që përjetoi.

Por përse e kishin vrarë xhanëm? Mos vallë Gabrieli kishte bërë ndonjë gabim që i kushtoi asaj jetën? Apo ata kishin pasur qëllim ta vrisnin para syve të tij, kur ai të mos kishte zgjidhje tjetër veçse të dëshmonte shkrumbimin e saj? Kjo ishte një pyetje që ia kishte shtruar Kiara një mbrëmje, teksa shëtisnin në rrugën "Ben Yehuda". Gabrieli iu përgjigj pyetjes së saj duke i folur për vizionin e *signadora*-s, e cila kishte parë një armik të vjetër kur kishte vështruar lëngun magjik të vajit të ullirit dhe ujit. Nuk kishte folur për një armik të Kelerit, por të Gabrielit.

- Nuk e dija që kishe armiq në botën e kriminelëve të Marsejës.

- Nuk kam, - ia ktheu Gabrieli. - Të paktën unë nuk di të kem, por ndoshta rrëmbyesit e Madalenës merrnin urdhra nga dikush tjetër.

- Nga kush, për shembull?

- Nga dikush që ndoshta ka dashur të më ndëshkojë për diçka që mund të kem bërë në të shkuarën. Dikush që ka dashur të më poshtërojë.

- Mos ajo *signadora* të ka thënë ndonjë gjë tjetër dhe e ke harruar?

- Tha që vetëm pasi vajza të ketë vdekur, do ta mësoj të vërtetën.

Kur u kthyen në rrugën "Narkiss", ora kishte kaluar disa minuta nga nëntë, megjithatë Gabrieli vendosi të kalonte edhe pak kohë te këmbaleci. Futi një kopje të "La Boheme" në magnetofonin portativ, ia uli zërin derisa të dilte si pëshpërimë dhe punoi shumë i përqendruar, veti që e kishte pasur që pasi u kthye në Jerusalem. Nuk e mori vesh kur operës i erdhi fundi dhe as nuk e vuri re qiellin që nisi të ndriçohej pak nga pak pas shpinës së tij. Më në fund, ndaj të gdhirë, e uli furçën dhe qëndroi pa lëvizur para pikturës me dorën në mjekër dhe kokën e kthyer pak nga njëra anë.

- Mbaroi? - e pyeti Kiara duke e parë në sy.

- Jo, - ia ktheu Gabrieli pa ia hequr sytë pikturës. - Përkundrazi, sapo ka filluar.

30

TIBERIAS, IZRAEL

A të mbrëmje ishte Sabat. Shamroni i kishte ftuar për darkë në shtëpinë e tij në Tiberias. Në të vërtetë, nuk mund të quhej ftesë, sepse ftesat mund edhe t'i refuzosh me delikatesë. Ishte një urdhër, madje një urdhër i prerë. Gabrieli e kaloi mëngjesin duke bërë gati pikturën për t'ia dërguar Xhulian Ishërudit, në Londër. Pastaj shkoi në Muzeun e Izraelit të merrte Kiarën nga puna. Teksa kalonin me shpejtësi teposhtë "Baba al-Wad"-it, grykës që përngjante me një palë shkallë dhe lidhte Jerusalemin me Rrafshinën Bregdetare, militantë palestinezë në Rripin e Gazës hodhën një sërë raketash që ranë në veri të Ashdodit. Nga sulmi pati vetëm disa të plagosur lehtë, por shkaktoi shumë trafik në atë pjesë të ngushtë të vendit, teksa mijëra udhëtarë nguteshin të ktheheshin në shtëpi për Sabat. *Vetëm në Izrael ndodh kjo*, mendoi Gabrieli teksa priti një orë në trafikun e rënduar.

Pasi më në fund mbërritën në Rrafshinën Bregdetare, morën në veri për nga Galileu e më pas në lindje përmes një sërë qytetesh dhe fshatrash arabe që të çonin në Tiberias. Vila në ngjyrë mjalti e Shamronit ishte disa kilometra në të dalë të qytetit, në një rrëpirë që shikonte nga liqeni. Kur hynë Gabrieli dhe Kiara, i priti Gila. Shamroni ishte përpara televizorit me telefonin në vesh. Syzet e tij të shëmtuara me skelet metali i kishte hedhur mbi

kokë dhe po kruante kurrizin e hundës. *Sikur në një të ardhme atij t'i ngrinin ndonjë statujë, nuk mund të gjenin pozicion më të mirë,* mendoi Gabrieli.

- Me kë po flet? - e pyeti Gabrieli Gilën.

- Me kë thua ti?

- Me kryeministrin?

Gila pohoi me kokë.

- Ari mendon se duhet të kundërpërgjigjemi, por kryeministri nuk është i sigurt.

Gabrieli i dha Gilës një shishe verë *Bordeaux* të kuqe, nga *Judean Hills* dhe e puthi në faqen e saj të butë si kadife që mbante aromë jargavani.

- Gabriel, thuaji ta lërë atë telefon. Ndoshta ty të dëgjon.

- Më mirë të më godasë ndonjë raketë palestineze.

Gila vuri buzën në gaz dhe i drejtoi për në kuzhinë. Banaku ishte plot me pjata të mbushura me ushqim që të ndillnin oreksin. Me siguri Gila e kishte kaluar gjithë ditën duke gatuar. Gabrieli u orvat të merrte një copë nga patëllxhanët me piper maroken që ajo i qante, por ajo e qëlloi me shaka mbi duar.

- Sa veta ke ndër mend të ushqesh sonte? - e pyeti ai.

- Do të vinte Jonatani bashkë me familjen, por nuk u largua dot nga puna për shkak të sulmit.

Jonatani ishte djali i madh i Shamronit. Ai ishte gjeneral në IDF[8] dhe kishte fjalë se mund të kandidonte për Shef Shtabi në zgjedhjet e radhës.

- Pas pak do të ulemi të hamë, - tha Gila. - Ti shko rri pak me të. E ka marrë malli shumë për ty.

- Dy javë ika, Gila.

- Në atë moshë, dy javë janë shumë.

Gabrieli hapi verën, mbushi dy gota dhe i çoi në dhomën tjetër. Shamroni nuk po fliste më në telefon, por ia kishte ngulur sytë televizorit.

- Sapo hodhën një barazh tjetër, - tha ai.

- Do të ketë kundërpërgjigje?

- Hëpërhë, jo. Por nëse vazhdojnë kështu, do të na duhet të veprojmë me çdo kusht. Puna është si do të reagojë Egjipti tani që sulmohet nga

[8] Israel Defence Forces - Forcat e Armatosura Izraelite

Vëllazëria Myslimane. Vallë do të qëndrojë duarkryq teksa ne sulmojmë hamasët, që gjithsesi mbeten degëzim i vëllazërisë së tyre?

A do të qëndrojë më traktati për paqe i "Camp David"?

- Çfarë thotë Uzi?

- Për momentin Byroja nuk mund të parashikojë me siguri se si do të reagojë udhëheqja egjiptiane nëse ne hyjmë në Gazë. Andaj edhe kryeministri, të paktën hëpërhë nuk do të veprojë teksa mbi popullin e tij bien raketat.

Gabrieli hodhi sytë nga ekrani i televizorit; raketat po binin. Pastaj e fiku televizorin dhe bashkë me Shamronin dolën në tarracë. Ishte më ngrohtë aty sesa në Jerusalem dhe një fllad i butë nga gryka e Golanit frynte mbi sipërfaqen e argjendtë të liqenit. Shamroni zuri vend në një prej karrigeve të hekurta përgjatë parmakut dhe ndezi menjëherë një nga cigaret e tij me aromë të neveritshme.

Gabrieli i zgjati një gotë verë dhe u ul pranë tij.

- Nuk më bën gjë për zemrën, - tha Shamroni pasi piu pak verë, - por më ka hyrë në qejf tani në pleqëri. Kam përshtypjen se më kujton të gjitha ato gjëra për të cilat nuk kam pasur kohë kur isha i ri: vera, fëmijët, pushimet, - u ndal pak dhe shtoi: - Jeta...

- Ke ende kohë, Ari.

- Lëri këto gjepura, të lutem, - tha Shamroni. - Koha më është kthyer në armik tani, bir.

- Atëherë pse harxhon kohë dhe merresh akoma me politikë?

- Ka ndryshim mes politikës dhe sigurimit.

- Sigurimi është thjesht një degëzim i politikës, Ari.

- Po sikur të duhej ty të këshilloje kryeministrin për çështjen e raketave, ç'do të bëje?

- Kjo punë i takon Uzit, jo mua.

Shamroni e la për një çast atë temë, e tha:

- I kam ndjekur me interes lajmet nga Londra. Më duket se miku yt, Xhonatan Lankasteri, po shkon i sigurt drejt fitores.

- Më duket se ai është politikani më fatlum në planet.

- Fati ka rëndësi në jetë. Unë nuk kam pasur shumë fat. As ti, po qe për atë punë.

Gabrieli nuk foli.

- Nuk besoj se është nevoja ta them, - vazhdoi Shamroni, - se ne të dy shpresojmë që zgjedhjet aktuale të vazhdojnë kështu dhe Lankasteri të kryesojë. Nëse ai fiton, me siguri do të jetë politikani britanik më prozionist që pas kohës së Artur Balfourit.

- Ti je shumë i poshtër.

- E po, dikush duhet të jetë edhe kështu, - tha Shamroni duke e parë seriozisht për një çast Gabrielin. - Më fal që të përfshiva edhe ty në këto punë.

- Ti arrite atë që doje, - tha Gabrieli. - Lankasteri mund të paguhet nga Byroja. Ai është një udhëheqës i keq. Është i kompromentuar.

- Nuk ia kemi ne fajin për këtë.

- Kjo është e vërtetë, - tha Gabrieli, - por çmimin për këtë e pagoi Madalena Harti.

- Bën mirë ta harrosh atë.

- Kam frikë se ka diçka te rrëmbyesit e saj që nuk më lejon ta harroj.

- I kërcënove se do t'i vrisje nëse i bënin keq asaj?

Gabrieli pohoi me kokë.

- Kërcënimet me vdekje janë si betimet për dashuri të përjetshme të pëshpëritura nën epshin e pasionit. Bëhen kollaj dhe harrohen shpejt.

- Por jo kur i bëj unë.

Shamroni fiku cigaren mendueshëm dhe tha:

- Ti më habit mua, bir, por jo Uzin. Ai e parashikoi që ti do t'u bije pas atyre dhe u tërhoq.

- Atëherë do ta bëj pa mbështetjen e tij.

- Kjo do të thotë që do të duhet të veprosh i vetëm, pa burimet e Byrosë dhe pa mbrojtjen e saj.

Gabrieli heshti.

- Po sikur unë të të ndaloj të shkosh? Do të më bindeshe mua?

- Po, Aba.

- Vërtet? - pyeti Shamroni i befasuar.

Gabrieli pohoi me kokë.

- Po sikur të të lejoj t'i gjesh ata njerëz dhe t'u japësh atë që meritojnë çfarë marr në shkëmbim?

- Ty duhet gjithmonë të të japësh për të marrë diçka në shkëmbim?

- Po.

- Çfarë do?

- Ti e di çfarë dua unë, - tha Shamroni, heshti një hop dhe pastaj shtoi: - Është ajo që do edhe kryeministri.

Shamroni piu pak verë dhe ndezi një cigare tjetër.

- Po kalojmë kohë të vështira dhe sfidat sa vijnë e shtohen. Vendimet që do të marrim në muajt dhe vitet në vijim do të përcaktojnë nëse sipërmarrja jonë do të dalë me sukses ose do të dështojë. A mund ta lësh të të ikë nga duart mundësia për të hyrë në histori?

- Unë kam hyrë shumë herë në histori, Ari. Shumë, shumë herë.

- Atëherë fute armën në një sirtar dhe përdor trurin për të mposhtur armiqtë. Vidhu sekretet atyre. Rekruto agjentët dhe gjeneralët e tyre si agjentët e tu. Hutoji, shpërqendroji. Lufto duke mashtruar, bir.

Gabrieli ra në heshtje. Qielli sipër malit Golan po merrte një ngjyrë blu në të zezë me ardhjen e mbrëmjes dhe liqeni pothuajse nuk dukej më. Shamroni e adhuronte atë pamje ngase e ndihmonte të ishte vigjilent ndaj armiqve të largët, ndërsa Gabrieli e adhuronte ngase e kishte shijuar teksa thoshte betimet e martesës me Kiarën. Tani do të bënte një betim tjetër, një betim që do të lumturonte një plak.

- Ta dish që nuk bëhem palë e asnjë lloj grushti shteti kundër Pallatit, - tha Gabrieli më në fund. - Uzi dhe unë kemi pasur mosmarrëveshjet tona ndër vite, por tani jemi bërë miq.

Shamroni ishte aq i zgjuar sa të mos fliste. Ai kishte dhuntinë e heshtjes.

- Nëse kryeministri vendos të mos e emërojë Uzin edhe për një mandat tjetër, - vazhdoi Gabrieli, - mund ta marr në konsideratë propozimin për t'u bërë drejtor i Byrosë.

- Më duhet diçka më bindëse.

- Më bindëse se kaq nuk kam ç'të të ofroj.

- Rrezikove që negociove me rrëmbyesit.

- Po, e di.

- Nga mendon t'ia nisësh?

- Nuk e kam vendosur ende.

- Si do t'ia bësh për para?
- Gjeta disa mijëra euro në një jaht në Marsejë.
- Kush i kishte?
- Një kontrabandist që quhej Marsel Lakrua.
- Ku është ai tani?

Gabrieli i tregoi.

- I gjori!
- Por nuk mbaron me kaq.
- Vetëm sigurohu që të mos bëhesh edhe ti si ata. Kam plane për ty.
- Të thashë që do ta mendoj, Ari. Nuk është se pranova.
- E di, - tha Shamroni. - Por di edhe që ti nuk do të më gënjeje kurrë për të siguruar diçka që do. Ti nuk je si unë, ke ndërgjegje.
- Edhe ti ke ndërgjegje, Ari, prandaj nuk të zë gjumi natën.
- Diçka më thotë se sonte do ta bëj gjumin top.
- Mos u gëzo para kohe, - tha Gabrieli. - Nuk kam folur ende me Kiarën.

Shamroni buzëqeshi.

- Çfarë ka për të qeshur?
- Kush mendon ti se e pati këtë ide?
- Sa i poshtër je!
- E po, dikush duhet të jetë edhe i tillë.

Por nga t'i niste kërkimet për vrasësit e Madalenës? Vendi ideal do të ishte mes organizatave kriminale të Marsejës. Atje mund të gjente bashkëpunëtorë të Marsel Lakruasë dhe Rëne Brosardit, t'i vëzhgonte, t'u jepte bakshish, t'i merrte në pyetje, edhe t'i rrihte nëse lindte nevoja, derisa të mësonte identitetin e njeriut që ishte prezantuar si Poli: njeriu që e kishte nxjerrë Madalenën për drekë te "Les Palmiers" ditën e zhdukjes së saj, njeriu që kishte folur frëngjisht sikur ta kishte mësuar atë gjuhë me kaseta magnetofoni. Por ky plan kishte një problem. Nëse Gabrieli shkonte në Marsejë, me siguri do të përplasej diku me policinë franceze. Pastaj mendoi se njeriu i njohur si Poli ndoshta ishte larguar me kohë prej atje. Kështu, vendosi të mos i niste kërkimet nga ata që kishin kryer krimin, por nga dy viktimat. Dikush e kishte ditur për lidhjen e Xhonatan Lankasterit dhe Madalena Hartit dhe ia kishte kaluar informacionin njeriut të njohur si Poli. Gabrieli mendoi se po të gjente atë njeri, do të gjente edhe Polin.

Megjithëkëtë, hëpërhë, duhej të gjente dikë tjetër më parë. Dikë që kishte ndjekur karrierën e Lankasterit. Dikë që njihte dinamikën e tij me Xheremi Falonin. Dikë që e dinte se ku ishin varrosur kufomat. Atë person e gjeti mëngjesin tjetër teksa lexonte për fushatën e zgjedhjeve në Britaninë e Madhe. Do të ishte e vështirë, madje e rrezikshme. Por nëse i siguronte informacionin që do ta çonte te vrasësit e Madalenës, ia vlente edhe të rrezikonte jetën.

Pjesën tjetër të mëngjesit, e kaloi duke përgatitur një dosje të detajuar. Pastaj bëri gati një çantë të vogël me dy palë rroba për t'u ndërruar dhe dy pasaporta false. Atë mbrëmje mori avionin nga aeroporti "Ben Gurion" për në Paris dhe pasditen e së nesërmes ndodhej sërish në ishullin e Korsikës. I duhej edhe diçka para se të niste kërkimet. I duhej një bashkëpunëtor. Një njeri shumë i zoti, i pamëshirshëm dhe pa pikë ndërgjegjeje. I duhej Kristofer Keleri.

31

KORSIKË

Ishulli kishte ndryshuar shumë që prej vizitës së fundit të Gabrielit. Plazhet ishin shkretuar, njerëzit frekuentonin restorante më të mira dhe tregjet në natyrë ishin boshatisur nga vendasit gjysmëlakuriq që shikonin si guhakë, porse rrallëherë fusnin dorën në xhep. Korsika ishte sërish e korsikanëve dhe për këtë ishte mirënjohës edhe banori më i pakënaqur i ishullit.

Por kishte edhe shumë gjëra, të cilat nuk kishin ndryshuar. Aroma e pakrahasueshme e *macchia*-s e përshëndeti Gabrielin sapo hyri në tokën korsikane. Ishte edhe ajo plaka që e kish treguar me gisht teksa udhëtonte me makinë nëpër qytetin e izoluar kodrinor dhe po ato roja që e përshëndetën ftohtë me kokë kur hyri në pronën e don Anton Orsatit.

E ndoqi rrugën deri ku mbaronte asfalti dhe pastaj vazhdoi edhe pak më tej. Kur mori kthesën e fortë majtas pranë tre ullinjve të lashtë, dhia kryeneçe e don Kasabiankës ia kishte zënë prapë rrugën. Kur pa Gabrielin, u duk sikur u ngrys, sikur iu kujtua hera tjetër kur ishin ndeshur dhe po planifikonte t'ia kthente me të njëjtën monedhë. Nga xhami i hapur i dritares, Gabrieli i kërkoi me dashamirësi t'ia lironte rrugën. Kur dhia ngriti nofullën me kryeneçësi Gabrieli doli nga makina, u afrua tek ajo dhe i pëshpëriti në vesh një kërcënim të ngjashëm me atë që u kish bërë

rrëmbyesve të Madalena Hartit. Dhia u kthye fluturimthi dhe u zhduk nëpër *macchia*. Edhe ajo ishte frikacake, si shumica e tiranëve.

Gabrieli hipi prapë në makinë dhe vazhdoi rrugën për te vila e Kelerit. Parkoi në rrugicën e saj, nën hijen e një pishe dhe thirri drejt tarracës, por nuk u përgjigj askush.

Dera nuk ishte e kyçur dhe Gabrieli shëtiti sa nga një dhomë e bukur në bardhësinë e saj te tjetra, por të gjitha ishin bosh. Nuk kishte as qumësht, as mish dhe as vezë. Gjeti vetëm disa birra, një vazo mustardë dhe një shishe verë *Sancerre* të mirë. Gabrieli e hapi dhe i telefonoi don Orsatit.

Keleri ishte larguar nga Korsika për një punë. Kishte shkuar në një vend tjetër të Europës, jo në Francë. Kaq i tha doni. Nëse gjithçka shkonte sipas planit, Keleri duhej të kthehej në Korsikë atë mbrëmje ose maksimumi të nesërmen në mëngjes. Doni i tha Gabrielit të qëndronte në vilën e Kelerit si në shtëpinë e tij. I tha gjithashtu se i kishte ardhur keq për atë që kishte ndodhur "në veri". Pa dyshim që Keleri i kishte treguar gjithçka.

- Ç'e mirë të solli sërish në Korsikë?

- Pagova një shumë të mirë parash dhe ata nuk e respektuan marrëveshjen.

- Shumë e madhe ishte! - ra dakord edhe doni.

- Çfarë do të bënit ju po të ishit në vendin tim?

- Pikësëpari, unë nuk do të kisha pranuar kurrë t'i vija në ndihmë një njeriu si Xhonatan Lankasteri.

- Bota është e ndërlikuar, don Orsati.

- Ashtu, vërtet, - tha doni me një pamje prej filozofi. - Sa për atë punën tënde, ke dy zgjedhje. Mund ta harrosh atë që i ndodhi vajzës angleze ose të ndëshkosh fajtorët.

- Ju çfarë do të bënit?

- Ne në Korsikë kemi një fjalë të urtë që thotë: i krishteri fal, idioti harron.

- Unë nuk jam idiot.

- Por nuk je as i krishterë, - tha Orsati, - por nuk ta thashë me të keq këtë.

Doni i tha Gabrielit të qëndronte në linjë sa të zgjidhte një problem të vogël. Dukej se kishte humbur një sasi e madhe vaji, e cila duhej të mbërrinte në një restorant në Zyrih. Gabrieli e dëgjonte donin të bërtiste me një theks karakteristik të Korsikës. I thoshte dikujt të gjente vajin, ndryshe do ta paguanin me kokën e tyre. Në çdo kompani tjetër, një kërcënim i tillë do të merrej thjesht si një shpërthim i shefit, por në kompaninë e vajit të ullirit "Orsati" ndryshonte puna.

- Ku e lamë? - e pyeti doni pasi iu kthye telefonatës së tyre.

- Po thoshit diçka për të krishterët dhe idiotët dhe gjithashtu thatë se kërkoni një shumë të majme për ta lejuar Kelerin të më ndihmonte.

- Ai *është* punonjësi im më i vyer.

- Për arsye që i kuptoj shumë mirë.

Doni heshti për një çast. Gabrieli e dëgjonte teksa gjerbte kafenë.

- Është e rëndësishme të më thuash se nuk po e bën vetëm për hakmarrje këtë punë, - tha ai pas pak. - Duhet të rimarrësh edhe paratë.

- Po nëse i marr?

- Nëse i merr nuk do të ishte keq t'i jepje diçka në shenjë mirënjohjeje edhe kumbarit tënd meksikan.

- Sa nënkuptoni me "diçka"?

- Një milion do të mjaftonte.

- Nuk ju duket e tepërt, don Orsati?

- Unë do të kërkoja pesë, në një rast tjetër.

Gabrieli u mendua pak dhe më në fund i pranoi kushtet e plakut.

- Por vetëm nëse i marr paratë, ama, - theksoi ai. - Përndryshe mund ta përdor sa të dua Kelerin, pa pagesë.

- U tha, u bë, - tha Orsati. - Vetëm se dua ta ruash Kelerin me jetë. Mos harro, paratë nuk të trokasin vetë në portë.

Gabrieli u ul në tarracë me shishen e verës *Sancerre* dhe dosjen e trashë me informacion nga *Downing Street* për Xhonatan Lankasterin. Nuk kaloi një orë dhe nuk po gjente rehat, kështu që i telefonoi sërish don Orsatit dhe i kërkoi leje të bënte një shëtitje. Doni i dha bekimin e tij dhe

i tha edhe se ku mund të gjente një prej armëve të Kelerit. Ishte një pistoletë e mirë HK nëntëmilimetërshe dhe ndodhej në sirtarin e një tavoline shkrimi të bukur franceze, menjëherë poshtë pikturës së Cezanesë.

- Vetëm bëj kujdes, - e këshilloi doni, - Kristoferi e lë pistoletën pa siguresë. Është tip shumë i ndjeshëm.

Gabrieli e futi armën në brezin e xhinseve dhe u nis nëpër rruginën e ngushtë, drejt ullinjve të vjetër. Për fat, dhia nuk ishte kthyer ende në vendin e saj, gjë që tregonte se Gabrieli mund të shkonte i qetë në fshat. Portat e shtëpive ishin të mbyllura e rrugët ishin boshatisur, me përjashtim të ndonjë maceje apo ndonjë grupi të rastësishëm fëmijësh që luanin ende. Ata e panë me habi Gabrielin teksa ecte nëpër sheshin kryesor të fshatit. Nga të tria anët e tij kishte kafene dhe dyqane, ndërsa në anën e katërt ishte kisha. Gabrieli i bleu Kiarës një shall në një prej dyqaneve dhe pastaj zuri një tavolinë në një prej lokaleve që binin më pak në sy. Piu një kafe të fortë për të ekuilibruar efektet e verës dhe mandej, kur qielli u errësua pak dhe nisi një erë e ftohtë, piu verë të fortë të kuqe korsikane për ta ekuilibruar efektin e kafesë. Portat e kishës u hapën tejpërtej. Nga brenda u dëgjua pëshpërima e një lutjeje.

Pak nga pak, sheshi nisi të mbushej me banorët e fshatit. Djem adoleshentë mbushën trotuaret jashtë një dyqani akulloresh, një grup burrash nisën një lojë të fortë *boules*[9] në qendër të shëtitores së pluhurosur. Pak pasi ora shënoi gjashtë, rreth njëzet veta, kryesisht plaka, mbushën shkallët e kishës. Mes tyre ishte edhe *signadora*. Vështrimi i saj kaloi lehtë mbi Gabrielin, mosbesuesin. Sakaq erdhën dhe e thirrën dy gra, një vejushë plakë e veshur kokë e këmbë në të zeza dhe një vajzë e shpërqendruar në mes të të njëzetave, e cila pa dyshim që po vuante pasojat e rënda të *occhju*-së[10].

Dy gratë u rishfaqën pas gjysmë ore, këtë herë bashkë me një djalë rreth dhjetë vjeç, me flokë të gjatë kaçurrelë. Gruaja mori për nga dyqani i akulloreve, por djali, pasi ndaloi për një çast për të ndjekur lojën *boules*, u ul në të njëjtën kafene ku ishte ulur edhe Gabrieli. Në dorë mbante një copë letër në ngjyrë blu të zbehtë, të palosur në katërsh. E vendosi në

---

9 Lojë me top shumë e përhapur në Francë

10 Syri i keq

tavolinë para Gabrielit dhe pastaj ia dha vrapit a thua se kishte frikë se mos e kapnin. Gabrieli e hapi letrën nën dritën e zbehtë dhe lexoi rreshtin e vetëm që ishte shkruar në të: *Duhet të të takoj, menjëherë*!

Gabrieli e futi letrën në xhepin e xhaketës dhe ndenji edhe disa minuta pa ditur se çfarë të bënte. Pastaj la disa monedha mbi tavolinë dhe mori për nga sheshi.

Kur trokiti në portën e saj, një zë që dukej sikur e kish pritur, e ftoi të hynte. Ajo ishte ulur si e përgjumur në një karrige të vjetër lëkundëse, me kokën të varur nga njëra anë, sikur të vuante nga efekti i djallit që kishte infektuar vizitorët e saj të mëparshëm. Pavarësisht nga kundërshtimet e Gabrielit, ajo nguli këmbë të ngrihej për ta takuar. Këtë herë nuk vuri re asnjë shenjë ashpërsie në pritjen e saj. Ajo i preku lehtë faqen dhe e pa drejt e në sy.

- Sa të gjelbër i ke sytë! I ke ngjarë nënës, apo jo?

- Po, - ia ktheu Gabrieli.

- Ajo ka vuajtur shumë gjatë luftës, apo jo?

- Keleri ta ka thënë këtë?

- Nuk kam folur kurrë me Kristoferin për nënën tënde.

- Po, - tha Gabrieli pas pak, - nëna ime ka vuajtur shumë gjatë luftës.

- Në Poloni?

- Po, në Poloni.

Signadora mori njërën dorë të Gabrielit në të sajën dhe tha:

- Je shumë i ngrohtë. Mos ke gjë temperaturë?

- Jo, - ia ktheu Gabrieli.

Ajo mbylli sytë.

- Edhe nëna jote piktore ka qenë?

- Po.

- Ka qenë në kampet e përqendrimit të nazistëve? Në atë që kishte atë emrin e pemëve?

- Po, atje.

- Shoh një rrugë me dëborë, një rresht të gjatë grash të veshura me rroba gri dhe një burrë me armë në dorë.

Gabrieli e tërhoqi dorën menjëherë dhe sytë e plakës u hapën sakaq.

- Më fal. Nuk doja të të shqetësoja.

- Përse më thirre?

- Unë e di pse je kthyer.

- E pastaj?

- Dua të të ndihmoj.

- Pse?

- Sepse nuk dua të të ndodhë asgjë e keqe në ditët në vijim. Plaku ka nevojë për ty. Po ashtu edhe gruaja jote.

- Unë nuk jam i martuar.

- Ajo quhet Klara, apo jo?

- Jo, - i tha Gabrieli buzagaz, - quhet Kiara.

- Italiane është?

- Po.

- Atëherë do të lutem për ty, - tha ajo dhe bëri me kokë nga një tavolinë ku ndodhej një pjatë me ujë dhe një enë me vaj pranë disa qirinjve të ndezur. - Do të ulesh?

- Do të preferoja të rrija në këmbë.

- Ti akoma nuk beson, apo jo?

- Besoj, besoj.

- Atëherë përse nuk ulesh? Me siguri nuk ke frikë. Kot nuk ta ka vënë emrin Gabriel nëna jote. Ti ke fuqinë e Zotit.

Gabrielit iu duk sikur i vunë një gur në zemër. Deshi të ikte aty për aty, por kureshtja e shtyu të qëndronte. Pasi e ndihmoi plakën të ulej në karrigen e saj, u ul përballë saj dhe zhyti gishtin në vaj. Sapo preku sipërfaqen e ujit, tri pika u shpërbënë në mijëra para se të zhdukeshin fare. Plaka tundi kokën, sikur të kishte vërtetuar frikën e saj më të madhe. Pastaj, për herë të dytë, mori dorën e Gabrielit në të sajën.

- Ti po digjesh, - i tha. - Je i sigurt që nuk je i sëmurë?

- Isha në diell, prandaj.

- Në shtëpinë e Kristoferit, - tha ajo me bindje. - Ke pirë nga vera e tij dhe ke armën e tij në brez.

- Vazhdo.

- Ti po kërkon dikë, atë që vrau vajzën angleze.

- E di ti se kush është ai?

- Jo, - i tha ajo, - por e di se *ku* është. Fshihet në lindje, në një qytet heretikësh. Me siguri ti nuk ke qenë kurrë atje. Nëse shkon, - shtoi ajo, - do të vdesësh.

Ajo mbylli sytë dhe pas pak nisi të derdhte lot, shenjë që djalli kishte dalë nga trupi i Gabrielit dhe kishte hyrë në të sajin. Pastaj, duke bërë një lëvizje me kokë, e udhëzoi Gabrielin të përsëriste provën me vajin dhe ujin. Këtë herë vaji ra vetëm në një pikë. Plaka buzëqeshi në një mënyrë që Gabrieli nuk e kishte parë kurrë më parë.

- Çfarë shikon? - e pyeti ai.

- Je i sigurt që do ta dish?

- Po, patjetër.

- Shoh një fëmijë, - u përgjigj ajo pa ngurruar.

- I kujt është ai fëmijë?

Ajo i ra dorës së Gabrielit dhe tha:

- Kthehu në vilë. Miku yt, Kristoferi, është kthyer në Korsikë.

Kur Gabrieli mbërriti në vilë, e gjeti Kelerin para frigoriferit të hapur. Kishte veshur një kostum ngjyrë gri të errët, të zhubravitur nga udhëtimi dhe një këmishë të bardhë të hapur te qafa. Ai mori shishen e pirë përgjysmë të verës *Sancarre*, e tundi mirë dhe pastaj hodhi pak në një gotë.

- U lodhe shumë në zyrë sot, "zemër"?

- Tmerrësisht, - tha ai me shishen në dorë. - Po ti?

- Sa të duash.

- Duket.

- Si të shkoi rruga?

- Rruga ma shpifi, por gjithçka tjetër shkoi mirë, - tha Keleri.

- Kush ishte ai?

Keleri piu pak verë pa iu përgjigjur dhe e pyeti Gabrielin se ku kishte qenë. Kur i tha se kishte takuar *Signadora*-n, Keleri buzëqeshi.

- Do të bëjmë edhe ty korsikan, më duket.

- Nuk shkova vetë ta takoja, - i shpjegoi Gabrieli.

- Çfarë donte të të thoshte?

Gabrieli nuk u përgjigj, por vuri pistoletën e Kelerit me kujdes mbi banak.

- Me sa kam marrë vesh, - i tha Keleri, - do të të duhet ajo.

- Çfarë ke marrë vesh ti?

- Që ke dalë për gjah, për shembull.

- Do të më ndihmosh?

- Të them të vërtetën, - i tha Keleri duke ngritur në dritë gotën e tij, - unë të prisja prej kohësh.

- E po, më duhej të mbaroja një pikturë.

- E kujt ishte?

- E Basanos.

- E studios "Basano" apo e vetë atij?

- Pak nga të dyja.

- Bukuri! - tha Keleri.

- Sa shpejt je gati të lëvizësh?

- Duhet të shoh programin, por them se mund të jem gati nesër në mëngjes. Vetëm se ta dish që Marseja gëlon nga policët tani dhe gjysma e tyre na kërkojnë ne të dyve.

- Prandaj nuk do t'i afrohemi fare Marsejës, të paktën hëpërhë.

- Atëherë ku do të shkojmë?

Gabrieli vuri buzën në gaz dhe tha:

- Do të kthehemi në shtëpi.

32

KORSIKË - LONDËR

Pasi darkuan në fshat, u kthyen në vilë ku Gabrieli u vendos në një nga dhomat për miqtë në katin e parë. Muret ishin të bardha, nënkresat të bardha, ndërsa kolltuku dhe pupa ishin mbuluar me një mbulesë të mëndafshtë. Atë natë, kur pa Madalenën në ëndërr, po vraponte përmes një fushe të mbuluar tejetej me dëborë dhe kur ajo kroi kurrizin e dorës, gjaku që rrodhi nga plaga ishte në ngjyrë kremi.

Në mëngjes, morën avionin e parë për në Paris dhe më pas fluturuan për në aeroportin e "Heathrow"-t. Keleri e kaloi doganën me një pasaportë franceze dhe Gabrieli, i cili po e priste në hollin e pritjes, mendoi se kjo ishte mënyra më e ulët për një anglez për t'u kthyer në vendlindje. Pasi dolën nga aeroporti, pritën njëzet minuta për taksi. Qendra e Londrës gëlonte nga trafiku për shkak të shiut të dendur.

- E kupton tani pse nuk jetoj më këtu unë? - tha Keleri qetësisht në frëngjisht teksa nuk ia ndante sytë lagjeve ngjyrë gri të Londrës, përmes xhamit të mbuluar nga shiu.

- Lagështia do të të bëjë shumë mirë për lëkurën, - ia ktheu Gabrieli në të njëjtën gjuhë. - Të është bërë si shollë.

Taksia i la në "Marble Arch". Gabrieli dhe Keleri ecën pak përgjatë rrugës "Bayswater" dhe shkuan në apartamentin në parkun "Hyde".

Apartamenti ishte ashtu siç e kishte lënë Gabrieli mëngjesin kur u nis për të dorëzuar paratë në Francë; madje pjatat me të cilat Kiara kishte ngrënë mëngjes, ishin ende në lavaman. Gabrieli lëshoi çantën në dhomën kryesore të gjumit dhe mori armën nga kasaforta në dysheme. Kur u kthye në sallon, Kelerin e gjeti në dritare.

- Mund të rrish disa orë vetëm? - e pyeti Gabrieli.

- Pa merak.

- Ke ndonjë plan?

- Them të bëj një shëtitje me varkë në Serpentine dhe pastaj të bëj ca pazar në "Covent Garden".

- Unë them se është më mirë që të qëndrosh këtu. Ku i dihet se kë mund të ndeshësh rrugës.

- Unë di ç'bëj, vëlla.

Pas atyre fjalëve, Keleri nuk foli më; nuk ishte nevoja. Ai ishte anëtar i SAS-it, kështu që po të donte mund të hynte edhe në një dhomë ku gjendeshin miqtë e tij më të ngushtë dhe asnjëri prej tyre të mos e njihte.

Gabrieli mori teposhtë rrugicës dhe thirri një taksi. Njëzet minuta më pas, kaloi para portës së *Downing Street*, drejt Parlamentit. Në xhep kishte vetëm një faqe nga dosja që kishte përgatitur. Ishte një artikull i gjatë i gazetës londineze "Daily Telegraph" me titullin: "Madalena Hart - Pyetjet pa përgjigje". Artikullin e kishte shkruar gazetarja Samanta Kuk, korrespondentja e gazetës për *Whitehall*-in dhe një nga gazetaret më të mira angleze. Ajo e kishte ndjekur Lankasterin që në fillimet e saj si gazetare dhe e kishte përmbledhur karrierën e tij në një biografi të titulluar "Rruga drejt pushtetit". Pavarësisht nga titulli bombastik i librit, ai ishte pritur mirë edhe nga rivalët e saj, të cilët ishin bërë xhelozë për parapagimin që i kishte bërë asaj shtëpia botuese që botoi librin. Samanta Kuk ishte nga ato gazetare, e cila dinte shumë më tepër nga sa hidhte në letër dhe pikërisht për këtë arsye, Gabrieli donte të fliste njëherë me të.

I telefonoi gazetës dhe kërkoi ta lidhnin me zyrën e saj. Operativi e lidhi pa e mbajtur gjatë në linjë dhe pas disa sekondash Samanta Kuk e ngriti telefonin. Gabrieli dyshoi se ajo po fliste nga celulari sepse dëgjoi hapa dhe disa zëra baritonë në një sallë me tavan të lartë; ndoshta ishte në hollin e Parlamentit, i cili ndodhej matanë rrugës nga kafeneja ku ishte ulur

Gabrieli. Ai tha se donte ta takonte dhe të flisnin për disa minuta. I premtoi se do t'ia vlente. Nuk i tha se kush ishte.

- E dini ju se sa telefonata të tilla marr unë në ditë? - i tha ajo me mosbesim.

- Zonjushë Kuk, ju siguroj se nuk keni marrë kurrë më parë një telefonatë të tillë.

Nga ana tjetër e telefonit, ra heshtja. Ajo ishte befasuar.

- Përse doni të më flisni?

- Nuk dua të flas në telefon për këtë.

- Jo, natyrisht.

- E kuptoj që jeni mosbesuese.

- Natyrisht.

- E keni telefonin të lidhur me internetin?

- Patjetër.

- Para disa vjetësh, një oficer i Shërbimit Sekret Izraelit u kap nga terroristët islamikë dhe e morën në pyetje duke e regjistruar me kamera. Donin ta vrisnin, por nuk u eci. Ajo video regjistrimi gjendet edhe sot e kësaj dite në internet. Shikojeni dhe më telefononi.

Ai i dha asaj një numër telefoni dhe e mbylli. Ajo e mori pas dy minutash.

- Dua të takohemi.

- E dija që ju jeni vajzë e zgjuar, zonjushë Kuk.

- Ju lutem, zoti Alon, mund të takohemi?

- Vetëm nëse më kërkoni ndjesë që më trajtuat aq ashpër pak më parë.

- Ju kërkoj ndjesë të thellë dhe shpresoj që në zemrën tuaj të ketë vend për falje.

- Ju kam falur.

- Ku jeni?

- Në rrugën "Brigde", në kafenenë "Nero".

- Për fat të keq e njoh mirë atë zonë.

- Për sa kohë mund të vini këtu?

- Për dhjetë minuta.

- Mos u vononi, - tha Gabrieli dhe e mbylli telefonatën.

Zonjusha Kuk *u vonua* gjashtë minuta, prandaj hyri duke turfulluar në derën e lokalit, me telefonin në vesh dhe çadrën në dorën tjetër. Shumica e klientëve në lokal ishin turistë, por kishte edhe tre anëtarë të rinj të Parlamentit të cilët po pinin kafe në fund të lokalit. Samanta Kuk ndaloi dhe foli pak me ta para se të nisej për nga tavolina e Gabrielit. Flokët i kishte biondë, të prerë deri te shpatullat, ndërsa sytë në ngjyrë blu të çelur dhe për disa sekonda nuk ia ndau fytyrës së Gabrielit.

- O Zot! - tha ajo. - Qenkeni vërtet ju.

- Pse, çfarë prisnit ju?

- Një mashtrues, natyrisht.

- Të paktën jeni e sinqertë.

- Kjo është një prej të metave të mia.

- Pse, keni të tjera?

- Jam shumë kureshtare, - tha ajo.

- Atëherë keni ardhur në vendin e duhur. Çfarë do të merrni për të pirë?

- Në fakt, - tha ajo duke hedhur sytë nëpër sallë, - unë them se është më mirë të shëtisim pak.

Gabrieli u ngrit dhe veshi xhaketën.

U nisën për nga *Tower Bridge* dhe pastaj morën një kthesë të shpejtë për në *Victoria Embankment*. Trafiku i pasdites lëvizte ngadalë në rrugë, por turmat e njerëzve që zakonisht mbushnin rrugën përgjatë lumit ishin pakësuar nga shiu. Gabrieli pa pas për t'u siguruar që nuk i kishin ndjekur nga lokali. Kur ktheu kokën para, vuri re se Samanta po e vëzhgonte nga poshtë çadrës së shiut, sikur ai të ishte në listën e specieve në zhdukje.

- Dukeni shumë më mirë se në atë video, - tha ajo pas pak.

- Atje kisha bërë makijazh.

Ajo vuri buzën në gaz dhe pyeti:

- Ndiheni më mirë tani?

- Kur bëhen shaka të tilla?

Ajo pohoi me kokë.

- Po, - tha ai. - Ndihem më mirë.

- Unë e kisha takuar një herë atë.

- Kë?

- Nadia al-Bakarin. E takova kur ishte ende e panjohur, thjesht një anëtare e Partisë Saudite, vajza e përkëdhelur e Abdul al-Bakarit, financuesit të terrorizmit islamik, - tha ajo, pa fytyrën e Gabrielit për të pikasur një reagim të tijin dhe sikur u zhgënjye kur nuk vuri re asgjë të ngjashme. - Është e vërtetë që atë e vratë ju?

- Zizi al-Bakari u vra gjatë operacionit të iniciuar nga amerikanët dhe aleatët e tyre në luftën globale kundër terrorizmit.

- Por këmbëzën e tërhoqët ju, ama, apo jo? Ishit ju ai që e vratë në Kanë, në sy të Nadias. Pastaj e rekrutuat Nadian në rrjetin terrorist të Rashid al-Huseinit. Brilante, - tha ajo, - vërtet brilante!

- Po të ishte aq brilante, Nadia do të ishte gjallë sot.

- Por vdekja e saj ndryshoi botën. Ajo ndihmoi ardhjen e demokracisë në botën arabe.

- Posi! Dhe shiko sa mirë po shkon ajo punë! - tha Gabrieli i ngrysur.

Kaluan poshtë urës "Hungerford", teksa një tren po kalonte në "Charing Cross". Shiu kishte pushuar. Samanta Kuk e mbylli çadrën dhe e futi në çantë.

- Ndihem e nderuar që kërkuat të më takonit mua, - tha ajo, - por Lindja e Mesme nuk është pika ime e fortë.

- Nuk ju kërkova për të folur për Lindjen e Mesme, por për Xhonatan Lankasterin.

Ajo ngriti kokën fluturimthi.

- Përse një operativ i Shërbimit Sekret Izraelit vjen në Londër dhe takon një gazetare për të marrë informata për kryeministrin?

- E po, me siguri për një çështje të rëndësishme, - tha Gabrieli. - Përndryshe, operativi i Shërbimit Sekret Izraelit nuk i hynte fare kësaj çështjeje.

- Jam dakord për këtë, - tha ajo, - por me siguri që operativi me famë duhet të ketë shumë informata për Lankasterin. Përse erdhët tek unë?

- Sepse përkundër reputacionit tim, ne nuk mbajmë dosje personale për miqtë.

- Gjepura!

Gabrieli ngurroi për një çast, pastaj tha:

- Zonjushë Kuk, kjo çështje është shumë personale. Nuk ka lidhje me organizatën ku unë punoj.

- Çfarë ndodh nëse unë pranoj t'ju ndihmoj?

- Natyrisht që do t'ju jepja diçka në shkëmbim.

- Një histori për faqe të parë?

Gabrieli pohoi me kokë.

- Por nuk mund të ma thoni tani përse bëhet fjalë.

- Jo, ende jo.

- Sidoqoftë, bën mirë t'ia vlejë e të jetë diçka e madhe.

- Unë jam Gabriel Aloni. Vetëm gjëra të mëdha bëj.

- Kjo është e vërtetë.

Ajo ndali hapat dhe pa Syrin e Londrës teksa kthehej ngadalë në anën e kundërt të lumit.

- Dakord, zoti Alon, pranoj. Por tani më thoni përse bëhet fjalë.

Gabrieli nxori artikullin e gazetës "Telegraph" nga xhepi i xhaketës dhe e mbajti para fytyrës së saj. Samanta Kuk vuri buzën në gaz.

- Nga t'ia nis?

Gabrieli e futi sërish artikullin në xhep, pastaj e pyeti për Xheremi Falonin.

33

LONDËR

Ajo ishte gazetare e mirë dhe si e tillë, dinte të krijonte atmosferën e duhur që fjalët e saj të kishin peshën e duhur. Një pjesë të mirë të atyre që ajo po thoshte, Gabrieli i dinte gjithsesi, pasi kishte jetuar dikur në Londër. Për shembull, e dinte që Xheremi Faloni kishte kryer studimet në "University College" të Londrës dhe që kishte punuar si skenarist reklamash para se të angazhohej politikisht. Në parti ai mësoi se atje kishte një organizim të vjetruar për sa i përkiste fushatave për të shitur vetëm një produkt, të cilin askush, aq më pak votuesit britanikë, nuk donin ta blinin. Kështu, prioriteti i tij u bë ndryshimi i mënyrës se si partia bënte sondazhet. Faloni nuk pyeste se cilën parti donte një votues, ai donte të dinte se ku bënin pazar votuesit, çfarë programesh televizive ndiqnin dhe çfarë pritshmërish kishin për fëmijët. Por mbi të gjitha, Faloni donte të dinte se ç'pritshmëri kishin votuesit për qeverinë e tyre. Ai punoi qetësisht pa rënë në sy dhe arriti që politikat bazë të partisë të përkonin me nevojat për një elektorat britanik modern. Pastaj kërkoi njeriun e duhur për ta nxjerrë në treg produktin e tij. Atë njeri e gjeti te Xhonatan Lankasteri. Me ndihmën e Falonit, Lankasteri sfidoi me sukses udhëheqësin e atëhershëm të partisë. Pastaj, gjashtë muaj më pas, ai mbërriti në *Downing Street*.

- Si shpërblim, Xheremi fitoi punën e ëndrrave, - tha Samanta Kuk.

- Xhonatani e emëroi Shef të Kabinetit Qeveritar dhe i dha më shumë pushtet se kushdo që e kishte mbajtur atë post, në historinë e Britanisë. Xheremi është krahu i djathtë i Lankasterit, zëvendësministër në çdo kuptim, vetëm se jo zyrtarisht. Dikur, Lankasteri më tha se ai ishte gabimi më i madh i jetës së tij.

- Për ta botuar?

- Jo, ma tha në mirëbesim, - tha ajo. - Shumë në mirëbesim, madje.

- Përse e bëri atë Lankasteri kur e dinte se po gabonte?

- Sepse pa Xheremin partia do të endej edhe sot në errësirën politike proverbiale dhe Xhonatan Lankasteri do të vazhdonte të ishte një deputet i thjeshtë në përpjekje për t'u ndier një herë në javë, gjatë seancave parlamentare. Pastaj, - shtoi ajo, - Xheremi i qëndron shumë besnik Lankasterit. Jam e bindur se për të është i aftë edhe të vrasë.

Gabrieli do të donte t'i thoshte se kishte të drejtë, por eci në heshtje dhe priti fjalinë përmbyllëse të saj.

- Por marrëdhënia e tyre ishte më shumë sesa thjesht një detyrim dhe besnikëri. Lankasteri *kishte nevojë* për Xheremin. Ai është i bindur se nuk mund ta drejtojë vendin pa atë në krah.

- Domethënë, është e vërtetë?

- Çfarë?

- Që Xheremi Falon është truri i Lankasterit.

- Në fakt, kjo nuk është aspak e vërtetë, pavarësisht se kështu thonë të gjithë. Edhe sondazhet ndërkombëtare të partisë treguan se shumica e britanikëve mendojnë se qeverinë në të vërtetë e drejton Faloni, - aty ajo ndaloi dhe po mendohej. - Prandaj u habita kur e pashë Xheremin në krah të Lankasterit ditën kur ai shpalli zgjedhjet.

- U habite?

- Jo shumë kohë më parë në *Whitehall* qarkullonin zëra sikur Lankasteri kishte ndër mend ta largonte Xheremin nga *Downing Street*.

- Sepse ai ishte kthyer në person kyç për zgjedhjet?

Samanta Kuk tundi kokën dhe tha:

- Edhe sepse ishte aq i padëshirueshëm në parti saqë askush nuk donte të punonte për të.

- Përse nuk shkrove ti për këtë?

- Sepse nuk kisha burim të sigurt, - u përgjigj ajo.

- Disa nga ne kanë standarde, e di?

- Ti mendon se ato fjalë i kanë shkuar në vesh edhe Xheremi Falonit?

- Nuk e mendoj dot që të mos i kenë shkuar.

- Foli ndonjëherë Lankasteri me të për këtë çështje?

- Nuk munda ta konfirmoja asnjëherë, prandaj edhe nuk shkrova për këtë. Falë Zotit që nuk munda! - shtoi ajo. - Se do të kisha dalë si idiote.

Kishin mbërritur në urën "Waterloo". Gabrieli e kapi për krahu dhe e drejtoi për nga "Strand".

- Sa mendon se e njeh ti atë? - e pyeti ai.

- Xheremin?

Gabrieli pohoi me kokë.

- Nuk jam e sigurt nëse ka njeri që e njeh mirë Xheremi Falonin. Unë e njoh nga ana profesionale, pra, ai më tregon vetëm ato gjëra të cilat do që t'i botoj. Është shumë manipulues, prandaj edhe u soll ashtu në funeralin e Madalena Hartit. Nuk e prisja kurrë që ai njeri të kishte lot, - aty u ndal pak dhe pastaj shtoi: - Por mendoj se është e vërtetë.

- Çfarë?

- Që Xheremi e dashuronte atë.

Gabrieli ndali hapat dhe u kthye me fytyrë nga Samanta Kuk.

- Ti po më thua se Xheremi dhe Madalena Hart ishin të lidhur?

- Madalenës nuk i interesonte Xheremi si mashkull, - u përgjigj ajo duke tundur kokën. - Por kjo nuk e ndaloi ta përdorte atë për të bërë karrierë. Për mendimin tim ajo i ngjiti shumë shpejt shkallët në parti dhe dyshoj se e gjitha kjo është meritë e Xheremit.

Mes tyre pllakosi heshtja. Po qëndronin në trotuarin jashtë galerisë "Courtauld". Samanta Kuk po shikonte trafikun përgjatë "Strand"-it, ndërsa Gabrieli po mendonte se pse Xheremi Falon ia kishte prezantuar vajzën që dashuronte Xhonatan Lankasterit. Ndoshta kishte dashur të përfitonte ende nga njeriu që ishte në fund të karrierës së tij politike.

- Je e sigurt? - e pyeti ai pas pak.

- Që Xheremi donte Madalenën?

Gabrieli pohoi me kokë.

- Jam aq e sigurt sa mund të jetë njeriu për diçka të tillë.

- Çfarë do të thuash?

- Kam informacion nga disa burime të besueshme. Xheremi përdorte justifikime nga më të rëndomtat për t'u takuar me të. Ishte shumë patetike.

- Përse nuk e raportuat zhdukjen e saj?

- Sepse nuk m'u duk gjëja e duhur në ato çaste. Tani që ajo vdiq...

Zëri i saj u shua në fjalët e fundit. Ata hynë në galeri, blenë dy bileta dhe ngjitën shkallët në sallat e ekspozitave. Si zakonisht, ato ishin plot me vizitorë. Në sallën 7 ndaluan para një kornize bosh, një përkujtimoreje të vjedhjes së kryeveprës së "*Courtauld*"-it: "Autoportret me vesh të fashuar", e Vinsent van Gogut.

- Sa keq! - tha Samanta Kuk.

- Po, - ia ktheu Gabrieli dhe e udhëhoqi për te piktura "Nevermore" e Gauguinit dhe e pyeti nëse ajo vetë e kishte takuar ndonjëherë Madalena Hartin.

- Vetëm një herë, - u përgjigj ajo duke treguar me gisht nga gruaja në kanavacë, a thua se e kishte fjalën për të dhe jo për një grua që kishte vdekur para pak kohësh. - Do të shkruaja një artikull për përpjekjet e partisë së tyre për të fituar votat e minoriteteve. Xheremi më dërgoi te Madalena. Kur e pashë, mendova se të qenët aq e bukur nuk do t'i bënte mirë, megjithatë ishte vajzë e zgjuar. Ndonjëherë dukej sikur po më intervistonte ajo mua dhe jo unë atë. M'u duk vetja si... - aty heshti sikur nuk po gjente dot fjalën e duhur, pastaj tha: - M'u duk sikur po më rekrutonin për diçka që nuk e dija.

Kur tingulli i fjalëve të saj u shua, Gabrieli dëgjoi hapa, u kthye dhe pa një çift në moshë të mesme të hynte në sallë. Burri kishte vënë syze optike me ngjyrë dhe ishte qeros, përveç një tonsure si prej murgu. Gruaja ishte disa vjet më e re se ai dhe mbante në dorë një udhëzues muzeu, të cilin e kishte hapur në faqen e gabuar. Ata kaluan nga njëra pikturë në tjetrën pa folur, duke u ndalur para secilës për vetëm disa sekonda para se të kalonin mekanikisht te tjetra. Gabrieli e ndoqi çiftin me sy teksa hynte në sallën tjetër të ekspozitës. Pastaj ai e udhëhoqi Samanta Kukun në oborrin e brendshëm madhështor në qendër të ndërtesës. Kur moti ishte i ngrohtë, muzeu shërbente si një vend për t'u mbledhur për londinezët, të

cilët punonin në godinat e mbushura me zyra përgjatë "Strand"-it, por në atë ditë me shi, tavolinat e metalta ishin bosh dhe uji i shatërvanit binte trishtueshëm, si tringëllima e lodrave në një kopsht pa fëmijë.

- Ti shkrove mirë për Madalenën pas zhdukjes së saj, - i tha Gabrieli teksa ecnin serbes-serbes ndanë perimetrit të oborrit.

- Isha shumë e sinqertë në çdo fjalë që shkrova. Ajo ishte shumë e bukur dhe me vetëbesim për një njeri që ishte rritur ashtu si qe rritur ajo. Nuk e kuptova asnjëherë sjelljen e nënës së saj disa ditë pas zhdukjes të së bijës. Shumica e prindërve që u zhduken fëmijët, mbajnë kontakte të vazhdueshme me shtypin, ndërsa ajo nuk e bëri këtë. Nuk i dilte fjalë nga goja, ndërsa tani duket sikur është zhdukur nga faqja e dheut. Po ashtu edhe vëllai i Madalenës.

- Çfarë do të thuash me këtë?

- Kur u përpoqa të lidhesha me të për të shkruar artikullin, - tha ajo duke bërë me kokë nga gazeta që ndodhej në xhepin e Gabrielit, - në shtëpinë e tyre nuk u përgjigj askush. *Asnjëherë*. Më në fund vendosa të shkoja vetë në Eseks dhe trokita në derën e shtëpisë së tyre. Një fqinj më tha se nuk i kishin parë më familjarët e Madalenës që pas funeralit të saj.

Gabrieli nuk foli, por po llogariste me mend kohën që duhej për të shkuar me makinë nga qendra e Londrës në Basildon, Eseks, në pikun e trafikut të mbrëmjes.

- Më duket se unë fola shumë, - po thoshte Samanta Kuk. - Tani është radha jote. Pse interesohet kaq shumë i madhi Gabriel Alon për vdekjen e një vajze angleze?

- Kam frikë se këtë nuk ta them dot akoma.

- A do të ma thuash ndonjëherë?

- Varet.

- E di, - i tha ajo duke e provokuar, - edhe fakti që ti ke ardhur në Londër dhe po bën pyetje, mjafton për të shkruar një artikull.

- E di, - pranoi Gabrieli, - por ti nuk do të guxoje kurrë ta shkruaje atë dhe as të flisje me dikë për bisedën tonë.

- Pse kështu?

- Sepse kështu e privon veten nga mundësia për të siguruar një histori më të mirë në të ardhmen.

Samanta Kuk buzëqeshi dhe pa orën e dorës.

- Unë me kënaqësi do të kaloja një javë duke folur me ju, por tani duhet të shkoj. Kam për të shkruar artikullin për nesër.

- Përse do të shkruash?

- Për kompaninë e naftës dhe të gazit "Volgatek".

- Kompaninë ruse?

- Ti nuk resht së më habituri, zoti Alon.

- Më pëlqen të jem i mirinformuar. Më ndihmon për punën time.

- Nuk e vë në dyshim.

- Çfarë do të shkruash për ta?

- Ambientalistët dhe ata të ngrohjes globale i shqetëson kjo çështje. Parashikojnë katastrofat e zakonshme; derdhje në sasi të naftës, shkrirje të akullnajave, gjëra të këtilla. Nuk e llogarisin fare që kjo marrëveshje do të sjellë miliarda dollarë dhe do të sigurojë mijëra vende pune aq të nevojshme për skocezët në këto kohë.

- Pra, artikulli yt do të jetë i ekuilibruar?

- Kështu janë të gjithë artikujt e mi, - ia ktheu ajo duke buzëqeshur. - Sipas burimeve të mia, ajo marrëveshje u ideua nga Xheremi dhe ishte iniciativa e tij e fundit para se të linte *Downing Street* dhe të kandidonte për në Parlament. Unë tentova të flisja me të, por më tha vetëm tri fjalë. Tri fjalë që nuk i kisha dëgjuar kurrë më parë nga goja e tij.

- Cilat ishin ato fjalë?

- Nuk kam koment.

Me ato fjalë ajo i dha atij edhe një kartëvizitë, i shtrëngoi dorën dhe u zhduk nëpër kalimin me harqe që lidhte oborrin me "Strand"-in. Gabrieli priti pesë minuta para se të largohej. Kur doli në rrugë, pa çiftin që kishte parë në galeri, teksa përpiqeshin të kapnin ndonjë taksi. Kaloi pranë tyre pa ua hedhur sytë dhe vazhdoi në sheshin "Trafalgar" ku mijëra protestues po marshonin për fushatën "Dy minuta urrejtje" kundër shtetit të Izraelit. Gabrieli hyri mes tyre dhe depërtoi ngadalë, duke u ndalur herë pas here për të parë nëse po e ndiqnin. Më në fund nisi një shi i dendur, sikur ta kishte dërguar Perëndia, që e shpërndau turmën. Gabrieli rastisi me një trupë artistësh dhe aktorësh propalestinezë, të cilët ishin nisur për në lokalet e Sohos, por në rrugën "Charing Cross" u nda prej tyre dhe u fut

në stacionin e metrosë në sheshin "Leicester". Kur po zbriste shkallët e metrosë, i telefonoi Kelerit.

- Na duhet një makinë, - i tha me një frëngjishte të shpejtë.
- Ku do të shkojmë?
- Në Basildon.
- Përse?
- Ta them rrugës.

34

BASILDON, ESEKS

Basildoni ishte ngritur pas Luftës së Dytë Botërore si pjesë e një plani madhështor për të reduktuar mbipopullimin në lagjet e varfra e të shkatërruara nga bombardimi në *East End* të Londrës. U ndërtua diçka të cilën planifikuesit e quajtën Qyteti i Ri - një qytet pa histori, pa shpirt dhe pa qëllim tjetër veç atij të strehimit të një popullate nga klasa punëtore. Qendra tregtare e tij, në sheshin kryesor të Basildonit, ishte një kryevepër e arkitekturës neosovjetike. Po ashtu edhe godina e bashkisë që përvijohej kërcënueshëm nga njëra anë, si një fetë gjigante tosti e djegur.

Afro një kilometër më tutje të zinte syri një bllok pallatesh në pikë të hallit dhe shtëpi me tarraca që njiheshin si "Lichfields". Rrugët kishin emra të pranueshëm, si rruga "Avon", shëtitorja "Norwich", rruga "Southwark", veçse kishin aq gropa nëpër të sa ishin mbushur me barëra të këqija dhe ishin bërë si kopshte me lule. Një pjesë e vogël e shtëpive kishin një kopsht të vogël përpara, por grupi i vogël i tyre që gjendej në fund të rrugës "Blackwater" kishte vetëm një rrugë të prishur ku zakonisht parkonte ndonjë makinë e vjetruar. Nga jashtë shtëpitë ishin me mure të suvatuara në katin e parë dhe me tulla në ngjyrë kafe në katin e dytë, kishin nga tri dritare të vogla, të gjitha me perde të errëta. Pas derës aspak mikpritëse të tyre, nuk dukej asnjë dritë e ndezur.

- Punojnë këta njerëz? - pyeti Keleri teksa kaluan për herë të dytë pranë shtëpisë.

- Nëna e saj punon disa orë në javë në farmacinë "Boots", - iu përgjigj Gabrieli. - Ndërsa vëllai e fiton jetesën "duke u bërë tapë" çdo ditë.

- Je i sigurt se nuk ka njeri në shtëpi?

- Ty të duket sikur aty banon dikush?

- Ndoshta u pëlqen të rrinë në errësirë.

- Jo po se mos janë vampirë.

Gabrieli e futi makinën në një parking në qoshe të rrugës dhe atje e fiku. Pas dritares nga ana e Kelerit të zinte syri një tabelë që tregonte se e gjithë zona mbikëqyrej me kamera gjatë gjithë kohës.

- Seç kam një parandjenjë të keqe.

- Ti sapo vrave një njeri për para.

- Por jo nën vëzhgimin e kamerave.

Gabrieli nuk foli.

- Sa ke ndër mend të rrish këtu? - e pyeti Keleri.

- Sa të jetë nevoja.

- Po sikur të vijë policia?

- Po erdhën, bën mirë të më njoftosh.

- Po sikur të më kapin?

- Tregoju pasaportën franceze dhe thuaju që ke humbur rrugën.

Pa thënë asnjë fjalë më shumë, Gabrieli hapi derën e makinës dhe doli. Sapo doli në rrugë, diku rrotull nisi të lehte një qen. Në fakt, duhej të ishin një tufë qensh, sepse pas pak të lehurat e tyre jehuan nëpër fasadat e shkretuara të pallateve, si gjyle topi. Për një çast, Gabrieli mendoi të kthehej në makinë, por pastaj vazhdoi të ecte qetësisht në oborrin prej betoni të shtëpisë së Hartit dhe sakaq u shfaq para derës së saj.

Nuk kishte as strehë dhe as ulluqe që të prisnin shiun. Gabrieli rrotulloi dorezën dhe siç pritej, ishte e kyçur. Pastaj nxori një pajisje të vogël nga xhepi dhe e futi në bravë. U deshën vetëm disa sekonda, madje nëse do të kalonte dikush do të mendonte se e hapi me çelës. Kur e rrotulloi dorezën për herë të dytë, u hap menjëherë. Ai hyri në errësirë dhe e mbylli derën shpejt. Jashtë qentë lehën edhe një herë fuqishëm para se më në fund të binin në qetësi. Gabrieli e futi sërish pajisjen në xhep, nxori një elektrik dore të vogël dhe e ndezi. E pa veten në një sallon të vogël e të varfër. Dyshemeja prej linoleumi ishte prishur në shumë vende dhe në të djathtë të tij, në një portmonto vareshin disa pallto e xhaketa të lira. Gabrieli boshatisi xhepat nga shkrepëset, faturat dhe kartëvizitat para se të shkonte në dhomën e ndenjjes. Ajo ishte një hapësirë e vogël që sikur të zinte frymën, me përmasa rreth 2.4 me 3 metër, ku rreth një televizori ishin vendosur tre kolltukë të vjetër. Në qendër të dhomës ishte një tavolinë e ulët mbi të cilën ndodheshin dy tavlla të tejmbushura me bishta cigaresh, ndërsa në mur vareshin korniza me fotografi të Madalenës. Në njërën prej tyre ishte Madalena e vogël duke ndjekur një top futbolli nëpër një fushë të ndriçuar me diell, në një tjetër duke marrë diplomën nga Universiteti i Edinburgut, ndërsa në një tjetër kishte dalë me kryeministrin Xhonatan Lankaster në *Downing Street*. Ishte edhe një fotografi e gjithë familjes Hart teksa qëndronin të ngrysur në një bregdet ngjyrë gri. Gabrieli vështroi tiparet e gjera dhe pa formë të prindërve të Madalenës dhe u përpoq të mendonte se si ishin kombinuar ato për të sjellë në jetë një fytyrë aq të bukur sa e saja. Mendoi se ajo ishte një gabim i natyrës. Ishte fëmijë i një Zoti tjetër.

E la dhomën e ndenjjes dhe pasi kaloi nëpër një dhomë të vogël ngrënieje, hyri në kuzhinë. Pirgje me pjata të palara kishin mbushur banakun dhe lavamani ishte me yndyrë. Ajri ishte i rëndë nga era e ushqimit të prishur. Gabrieli hapi një nga dollapët e poshtëm të kondrabufesë ku ndodhej një kosh mbeturinash i mbushur plot e përplot. Edhe frigoriferi ishte plot me mbetje ushqimesh. Gabrieli pyeti veten se çfarë mund t'i kishte detyruar ata ta braktisnin shtëpinë me ngut dhe ta linin aq rrëmujë.

U kthye në korridor dhe ngjiti shkallët e ngushta që të çonin në katin e dytë. Atje kishte tri dhoma gjumi; dy si qeli të vogla në të majtë dhe një dhomë më të madhe në të djathtë, ku ai hyri në fillim. Ishte dhoma e nënës së Madalenës. Krevati dopio ishte lënë i parregulluar dhe një erë e ftohtë hynte nga një dritare e lënë hapur, e cila shikonte në kopshtin e pasmë të shtëpisë, që ishte një katrahurë e vërtetë. Gabrieli hapi derën e hollë të dollapit të rrobave dhe drejtoi elektrikun në brendësi të tij.

Gardëroba ishte e mbushur nga njëri skaj në tjetrin dhe rafti sipër saj ishte gjithashtu plot e përplot. Sipër tij ishin rafte të tjera të mbushura plot, përveç atij të fundit për të cilin Gabrieli mendoi se ishte ai që mbajnë zakonisht gratë për dokumentet dhe sendet personale. Drejtoi elektrikun poshtë krevatit por atje kishte vetëm pluhur, me shumicë. Pastaj shkoi te telefoni, pranë njërës prej komodinave ndanë krevatit, pas një gote bosh. Ngriti receptorin në vesh, por nuk kishte sinjal. Pastaj shtypi butonin e kthimit pas të sekretarisë telefonike. Nuk kishte asnjë mesazh.

Doli prej aty dhe futi kokën në një nga dhomat e vogla. Dukej sikur aty kishte rënë bomba. Vetëm muret ishin të paprekura. Ato ishin mbushur me postera futbollistësh të famshëm, fotomodelesh dhe makinash, të cilat i zoti i asaj dhome nuk do t'i kishte dot kurrë. Në ajër ndihej një aromë e keqe djerse mashkulli, që për fat, Gabrieli nuk e kishte ndier më që pas lirimit nga ushtria. E kontrolloi dhomën shpejt e shpejt, por nuk gjeti asgjë të pazakontë.

Dhoma e fundit në të cilën hyri ishte ajo e Madalenës. Nuk ishte dhoma e Madalenës që kishte pasur një lidhje dashurie me Xhonatan Lankasterin, as e asaj Madalene që kujtonte Gabrieli nga Franca, por e një Madalene, e cila i kishte mbijetuar jetës në këtë shtëpizë të trishtë. Gabrieli mendoi se ajo i kishte mbijetuar këtij ambienti ashtu si edhe një muaji në robëri, me pastërti dhe rregull. Krevati ishte i rregulluar mirë, tavolina e vogël e studimit gjithashtu. Mbi të qëndronte një pirg librash të letërsisë klasike angleze nga Dikensi, Ostini, Forsteri dhe Lorensi. Vëllimet dukeshin sikur ishin lexuar dhe rilexuar shumë herë dhe faqet e tyre ishin plot nënvizime dhe shënime në anë, me një shkrim të rregullt dhe pa gabime. Gabrieli ishte gati të merrte njërin prej tyre, "Mos e lufto pranverën", nga Forsteri, kur ndjeu dridhjen e lehtë të celularit. E ngriti dhe e afroi telefonin në vesh.

- Kemi shoqëri, - tha Keleri.

- Sa janë?

- Më duket se vetëm një, por nuk jam i sigurt.

Gabrieli hapi pakëz perdet e lehta të dritares së dhomës së Madalenës dhe pa një grua duke ecur përgjatë "Blackwater bay", nën strehën e një ombrelle. Teksa kalonte mes një rreshti dritash rruge, ai e pa pak fytyrën

e saj dhe e kuptoi sakaq se e kishte parë edhe diku tjetër. Përgjigjja i erdhi menjëherë kur ajo hyri në oborrin e shtëpisë. E kishte parë në kishën e vjetër në malet e Luberonit. Ishte gruaja, e cila lëvizte brenda kishës sikur të mos e njihte mirë atë. Kushedi përse tani ajo po fuste një çelës në derën e përparme të shtëpisë së Madalenës. Gabrieli fiku telefonin dhe nxori armën nga brezi. Mendoi njëherë të zbriste shkallët dhe të përballej me të aty për aty, por pastaj vendosi të priste. *Fundja*, mendoi, *ajo do t'ia thoshte se kush ishte dhe pse ndodhej aty edhe pa e kuptuar se po e bënte këtë.* Kjo ishte mënyra më e mirë për të marrë informata - pa e mësuar objektivi. Sikundër predikonte gjithmonë Shamroni, agjenti i fshehtë më mirë të jetë hajdut sesa vrasës. Kështu, Gabrieli qëndroi pa lëvizur në dhomën e fëmijërisë së Madalena Hartit, me tytën e armës të mbështetur në faqe, teksa gruaja e panjohur po hynte në korridor dhe më pas e mbylli derën me qetësi. Tha vetëm një fjali të cilën Gabrieli nuk e kuptoi. Paskëtaj pasoi një zhurmë që tregonte se po kontrollonte dhe merrte gjëra dhe i fuste në një çantë plastike. Pastaj shkoi në dhomën e ndenjjes, ku ndenji afro dy minuta, më pas hyri në kuzhinë dhe pështpëriti sërish diçka në atë gjuhën e pakuptueshme për Gabrielin. Gabrieli dyshoi se ajo foli në zhargonin e një gjuhe që nuk ishte anglisht, hebraike, frëngjisht, italisht dhe as gjermanisht. Por dyshoi edhe diçka tjetër. Kushdo që të ishte, ajo po kontrollonte shtëpinë ashtu si edhe Gabrieli pak para se të vinte ajo.

Kur hapat e saj mbërritën në rrëzë të shkallëve, Gabrielin e kapi një çast pavendosmërie. Nëse kishte të drejtë për qëllimet e asaj gruaje, që ajo po kërkonte diçka, me siguri që do të ngjitej në dhomën e Madalenës. Hodhi sytë përreth për të gjetur një vend ku të fshihej, por nuk i zuri syri asgjë të përshtatshme. Dhoma ishte vetëm pak më e madhe sesa qelia ku kishin mbajtur Madalenën në Francë. Teksa hapat e gruas bëheshin gjithnjë e më të qartë, Gabrieli vendosi se duhej të largohej. Po ku dhe si? Banja ishte në korridor. Hyri aty pa bërë zhurmë dhe mendoi se çfarë mund të thoshte Shamroni po të shihte drejtorin e ardhshëm të Shërbimit Sekret Izraelit në atë çast. *Do të ishte dakord me të*, mendoi Gabrieli. Madje ishte i sigurt se i madhi Ari Shamron për shkak të punës ishte futur në vende shumë më të rëndomta se një banjë e degraduar në një shtëpi shteti në Basildon.

E la derën paksa të hapur, jo më shumë se dy centimetra dhe e mbajti

armën të drejtuar nga gruaja teksa ajo përfundonte ngjitjen e shkallëve. Fillimisht hyri në dhomën e madhe të gjumit dhe duke gjykuar nga tingulli i sirtarëve që hapeshin dhe dyerve që përplaseshin, dukej se po e kontrollonte mirë. Pesë minuta më pas kaloi pranë banjës pa ndaluar aty dhe pa e kuptuar se i ishte drejtuar një armë. Kishte veshur të njëjtën pardesy që mbante edhe në Francë, vetëm flokët i kishte rregulluar ndryshe. Në dorën e majtë mbante një çantë dore në ngjyrë të gjelbër nga *Marks & Spenser*, ku dukej se nuk kishte futur pak gjëra. Kur hyri në dhomën e Madalenës, kërkimi i saj papritmas u bë më i dhunshëm. *Ishte një kontroll profesional*, mendoi Gabrieli. Nxirrte rroba me furi nga dollapi, tërhiqte me forcë çarçafët e krevatit dhe hidhte përtokë gjithçka që kishte nëpër sirtarë. Më në fund, u dëgjua një kërcitje e beftë, sikur u ça ndonjë dru, që u pasua nga një heshtje e rëndë, që u thye pak çaste më pas nga tingulli i zërit të saj. Ai erdhi i butë dhe i qetë, sikundër ndodh rëndom që dikush t'i japë informata një eprori me anë të një pajisjeje që transmetonte sinjal me valë ajrore të hapura. Gabrieli nuk e kuptoi se çfarë thoshte sepse nuk i njihte gjuhët sllave, por për një gjë ishte i sigurt; ajo po fliste rusisht.

35

BASILDON, ESEKS

Makina e saj, një *Volvo Sedan* e vjetër, ishte parkuar matanë rrugës. Ajo shkoi drejt e atje me ombrellën në dorën e djathtë dhe çantën *Marks & Spenser* në dorën tjetër. *Ombrellën me siguri që po e mbante për të mos rënë në sy, sepse shiu kishte pushuar,* mendoi Gabrieli duke parë nga dritarja e Madalenës. Çanta e saj dukej e rëndë. Pasi hapi derën e makinës, ajo e vendosi atë në ndenjësen e parë dhe pastaj hipi edhe vetë, pa e mbyllur ombrellën derisa hyri mirë brenda. Motori i makinës mezi u ndez. Ajo priti derisa e kaloi shtëpinë pastaj ndezi dritat e makinës. Ecte shpejt, por qetë, si profesioniste.

Gabrieli i hodhi edhe një sy të fundit rrëmujës që kishte lënë gruaja në dhomën e Madalenës dhe zbriti shkallët me nxitim. Kur mbërriti te dera e jashtme, Keleri e kishte afruar makinën dhe po e priste. Gabrieli hipi shpejt dhe i bëri me kokë të ndiqnin gruan.

- Vetëm kujdes, - i tha. - Ajo është e zonja.

- Sa e zonja?

- Aq sa është çdo anëtar i Qendrës së Moskës.

- Çfarë thua, more?

- Mund ta kem gabim, - tha Gabrieli, - por mendoj se gruaja që po nget atë makinë, është e KGB-së.

Teknikisht nuk kishte më KGB, natyrisht. Ajo ishte shpërbërë jo shumë kohë pas rënies së Bashkimit Sovjetik. Federata ruse tani kishte dy Shërbime Sekrete: FSB-në dhe SVR-në. FSB-ja trajtonte çështjet brenda kufijve të Rusisë; kundërzbulimin, antiterrorizmin, mafien dhe aktivistët prodemokratë, të cilit ishin aq të fortë ose budallenj sa të sfidonin njeriun që tashmë sundonte Rusinë nga brenda mureve të Kremlinit. Ndërsa SVR-ja ishte Shërbimi Sekret i Rusisë për çështjet e jashtme. Ajo drejtonte rrjetin e saj global të agjentëve nga i njëjti kamp i izoluar në Jasenevo, i cili kishte shërbyer si zyrat qendrore të KGB-së. Oficerët e SVR-së e quanin ende atë godinë Qendrën e Moskës dhe nuk ishte aspak për t'u habitur që edhe vetë qytetarët e Rusisë i referoheshin SVR-së si KGB. Kremlini kishte arsye të forta për t'ia ndryshuar emrin Shërbimit Sekret Rus, por misioni i SVR-së vazhdonte të ishte i njëjti, penetrimi dhe dobësimi i vendeve të Aleancës Atlantike, me Shtetet e Bashkuara dhe Britaninë e Madhe në krye të listës.

Por pse vallë një operative e SVR-së kishte ndjekur Gabrielin dhe Kelerin në një kishë të vjetër në malet e Luberonit dhe përse po ajo operative kishte kontrolluar shtëpinë e familjes së një vajze të vdekur angleze me emrin Madalena Hart, një vajzë e cila kishte qenë e dashura e kryeministrit të Anglisë, një vajzë të cilën e kishin rrëmbyer teksa shijonte pushimet në ishullin e Korsikës dhe për të cilën kishin kërkuar një haraç, një vajzë e cila ishte djegur për vdekje në bagazhin e një *Citroëni C4*, në plazhin e *Audreselle*-s?

- Të mos nxitohemi, - tha Keleri.

- Unë e dëgjova, po të them, - u përgjigj Gabrieli.

- Dëgjove një grua të fliste rusisht.

- Jo, - ia priti Gabrieli, - dëgjova një agjente ruse që ktheu përmbys një dhomë.

Ata ishin nisur nga perëndimi në autostradën A127. Ora po shkonte tetë. Korsitë në lindje ishin ende plot e përplot me makina nga trafiku i mbrëmjes londineze, por nga perëndimi mund të ecje me shpejtësi. Rusja ndodhej afro dyqind metra para tyre. Keleri nuk e kishte aspak problem ta ndiqte *Volvo*-n.

- Ta zëmë se ke të drejtë, - tha ai pa ia shqitur sytë rrugës. - Ta zëmë se KGB-ja ose SVR-ja, quaje si të duash, ka lidhje me rrëmbimin e Madalena Hartit...

- Unë do ta thosha se tani nuk ka më, "ta zëmë, të mos e zëmë". Ajo punë është vulosur.

- E kuptova, - tha Keleri. - Po ç'lidhje të ketë vallë?

- Atë po përpiqem të kuptoj. Por nëse do të hamendësoja, do të thosha se operacioni ka qenë i iniciuar prej tyre që në fillim.

- Operacioni? - pyeti Keleri i shastisur. - Ti po thua se të dashurën e kryeministrit britanik e kishin rrëmbyer rusët?

Gabrieli nuk u përgjigj. As vetë nuk ishte ende i bindur për këtë.

- Më lejon të të kujtoj disa fakte me rëndësi? - e pyeti Keleri.

- Të lutem.

- Marsel Lakruaja dhe Rëne Brosardi nuk ishin rusë dhe nuk punonin për SVR-në. Të dy ishin eksponentë të krimit të organizuar francez, me precedentë të shumtë penalë në Marsejë dhe në jug të Francës.

- Ndoshta ata nuk e dinin se për kë punonin.

- Po Poli?

- Për të nuk dimë asgjë tjetër përveç faktit që e fliste frëngjishten sikur ta kishte mësuar me magnetofon, ose të paktën kështu u shpreh i madhi don Orsati i Korsikës.

- Që iu bëftë dita një mijë!

Gabrieli tregoi me gisht përpara dhe tha:

- Shiko se t'u largua shumë.

- Po e ndjek, mos u shqetëso.

- Ngushtoje pak distancën.

Keleri e rriti shpejtësinë për disa sekonda dhe pastaj e uli paksa.

- Ti mendon se Poli është rus? - e pyeti ai.

- Kjo mund të shpjegonte faktin pse policia franceze nuk i vuri dot kurrë një emër fytyrës së tij.

- Po përse do të pajtonte kriminelë francezë për të rrëmbyer Madalenën në vend që ta mbaronte punën vetë?

- Ke dëgjuar ndonjëherë për operacionin "Flamuri i rremë"? - e pyeti Gabrieli. - Shërbimet Sekrete shpesh kryejnë operacione që mund

të shkaktonin incidente diplomatike ose politike sikur të ekspozoheshin. Kështu që ata i veshin ato operacione me veprimtari nën flamuj të rremë. Ndonjëherë shtiren si operativë të shërbimeve sekrete të vendeve të tjera, ndonjëherë si diçka krejt tjetër.

- Si për shembull, si kriminelë francezë?

- Mos u habit.

- Vetëm se teoria jote ka një të metë.

- Vetëm një?

- SVR-ja nuk ka nevojë për para.

- Nuk besoj se kjo punë është bërë për para.

- Ti u dhe atyre dy valixhe me dhjetë milionë euro.

- E di.

- Po të mos e kishin bërë për para, përse do t'i kërkonin ato?

- Kanë luajtur lojën e flamurit të rremë deri në fund, - tha Gabrieli.

Keleri heshti për një çast. Pastaj, më në fund pyeti:

- Po pse ta vrisnin Madalenën?

- Këtë nuk e di.

- Ku është tani familja e saj?

- Nuk e di.

- Si e zbuluan rusët për Madalenën dhe Lankasterin?

- As këtë nuk e di.

- Është dikush që mund ta dijë.

- Kush?

- Gruaja që po nget atë makinën? - tha Keleri duke bërë me gisht drejt dritave të *Volvo*-s.

- Më mirë të jesh hajdut, sesa vrasës.

- Çfarë do të thotë kjo?

- Afroju! - tha Gabrieli. - T'u largua shumë.

Ajo kaloi poshtë unazës M25, eci me shpejtësi përmes një peizazhi me ferma dhe fusha dhe më pas hyri në lagjet e metropolitanit të Londrës. Tridhjetë minuta më pas ato lagje ia lanë vendin lagjeve të *East End*-it dhe

më në fund kullave të qendrës. Prej atje, ajo mori për nga Holborni dhe Soho, në *Mayfair*, ku hyri në një seksion të ngarkuar të rrugës "Duke", në jug të rrugës "Oksford". Pasi ndezi dritat e bllokazhit, ajo doli nga *Volvo* dhe e çoi çantën *Marks & Spenser* në një *Mercedes Sedan* që ishte parkuar disa metra më larg. Kur iu afrua makinës, bagazhi i saj u hap automatikisht, edhe pse Gabrieli nuk vuri re që ta hapte ajo. E futi çantën brenda tij, e mbylli dhe u kthye te *Volvo*. Dhjetë sekonda më pas, u nis me qetësi nëpër rrugën "Oksford".

- Çfarë të bëj? - pyeti Keleri.

- Lëre të ikë.

- Pse?

- Sepse personi që hapi bagazhin e *Mercedes*-it po shikon nëse atë do ta ndjekë dikush.

Keleri hodhi sytë në rrugë. Po ashtu edhe Gabrieli. Të dyja anët e saj përvijoheshin nga restorante të cilat gatuanin ushqim për turistë dhe trotuaret ishin të mbushura me këmbësorë. Kushdo prej tyre mund ta kishte çelësin e *Mercedes*-it.

- Çfarë të bëjmë tani? - pyeti Keleri.

- Do të presim.

- Çfarë?

- Këtë do të ta them kur ta shoh.

- Hajdutë dhe vrasës?

- Diçka e tillë.

Keleri nuk ia ndante sytë *Mercedes*-it, ndërsa Gabrieli makthit të kulinarisë që ndodhte në rrugën "Duke"; *Pizza Hut, Garfunkel's*, diçka e quajtur *Pure Waffle* a si e kishte emrin. Klasi i rrugës ishte *Bella Italia*, një rrjet restorantesh me pika të shpërndara në të gjithë qytetin dhe pikërisht aty ngeci vështrimi i Gabrelit më në fund. Një burrë dhe një grua me diferencë në moshë po dilnin nga dera e restorantit, pasi supozohej të kishin darkuar. Më herët atë ditë, në sallat e ekspozitës në galerinë "Courtauld" ajo kishte pasur në dorë një udhëzues të hapur në faqen e gabuar, ndërsa ai kishte pasur syze optike me ngjyrë. Tani i kishte hequr syzet. Pasi i hapi gruas derën e *Mercedes*-it, ai shkoi nga ana e shoferit dhe zuri vend në timon. Kur u ndez motori, u duk sikur u drodh rruga. Pastaj makina u nis

me shpejtësi duke xhiruar rrotat nëpër rrugën "Oksford" sapo semafori u bë i kuq.

- Bukur! - tha Keleri.

- Po, - ia ktheu Gabrieli.

- Të përpiqem ta ndaloj?

Gabrieli tundi kokën ngadalë. *Ata janë të zotë,* mendoi. *Aq të zotë sa janë ata të Qendrës së Moskës.*

"Grand Hotel Berkshire" nuk ishte ndonjë hotel madhështor dhe nuk gëzonte ndonjë reputacion kushedi në kontenë angleze të *Berkshire*-it. Ndodhej në fundin e një tarrace me shtëpi eduardiane në rrugën "West Cromwell", me një dyqan pajisjesh elektronike nga njëri krah dhe një internet-kafe të dyshimtë nga ana tjetër. Gabrieli dhe Keleri mbërritën atje në mesnatë. Nuk kishin bërë rezervim dhe nuk kishin bagazhe me vete; ato ishin të sigurta në bazën në *Bayswater*, që sipas Gabrielit tani duhej të ruhej nga Shërbimi Sekret rus. Pagoi me para në dorë për dy net dhe i tha sportelistit se ai dhe shoku i tij nuk prisnin të tjerë dhe nuk donin t'i ndërpriste njeri për asnjë lloj arsyeje, as nga shërbimi në dhomë. Recepsionistit të turnit të natës nuk iu duk aspak e pazakontë kërkesa e Gabrielit. "Grand Hotel Berkshire", ose GHB-ja, i pëlqente klientët që kërkonin privatësi.

Dhoma e tyre ishte në katin e katërt dhe të fundit dhe kishte pamje shumë të mirë nga rruga. Gabrieli këmbënguli që të flinte Keleri i pari. Pastaj zuri vend pranë dritares me armën në prehër, këmbët në parvaz dhe pesë mendime që i rrihnin si çekan në kokë. Si mund të tregohej Shërbimi Sekret Rus aq i shkujdesur sa të rrëmbente të dashurën e kryeministrit anglez? Pse kishin kërkuar para kur rusët nuk kanë nevojë për para? Pse e kishin vrarë Madalenën? Ku ndodhej tani familja e saj? Sa nga këto dinin Xhonatan Lankasteri dhe Xheremi Faloni? Për të gjitha këto pyetje nuk gjente dot asnjë përgjigje të pranueshme. Mund të bënte hamendësime intelektuale, mund të dyshonte, por vetëm kaq. I duhej të vidhte më shumë informacione dhe nëse ishte nevoja, mund të bënte dhe

ndonjë vrasje, ose edhe dy. Po pastaj? Iu kujtua *signadora* plakë dhe profecitë e saj për një armik të vjetër në qytetin e heretikëve në lindje.

Nuk duhet të shkelësh kurrë atje, ndryshe të pret vdekja.

Pikërisht atëherë, një kamionçinë që shpërndante gazeta, ndaloi me vrull jashtë "Tesco Express" në anën tjetër të rrugës. Gabrieli pa orën e dorës. Po shkonte katër, koha për të zgjuar Kelerin dhe për të fjetur edhe vetë disa orë. Por në vend që të zgjonte atë, mori librin "Mos e lufto pranverën" të E. M Forsterit, që e kishte marrë në dhomën e Madalenës, e hapi në një faqe çfarëdo dhe nisi të lexonte: "Gjatë pasdites ishte luajtur një lojë shumë e koklavitur në kodër. Se si zhvillohej ajo dhe se si ishin ndarë lojtarët e skuadrave, Lusi nuk po e kuptonte..."

Gabrieli e mbylli librin dhe pa kamionçinën teksa largohej nëpër rrugën e lagur dhe të errët. Atëherë e kuptoi. Por si ta vërtetonte?

I duhej ndihma e dikujt që njihte botën e errët të biznesit dhe politikës ruse. Dikush që ishte po aq i pamëshirshëm sa edhe ata të Kremlinit.

I duhej Viktor Orlovi.

36

CHELSEA, LONDËR

Viktor Orlovi kishte qenë gjithmonë i zoti me shifrat. Ai kishte lindur në Moskë gjatë ditëve të zymta të Luftës së Ftohtë, kishte studiuar në institutin prestigjioz të Precizionit, Mekanikës dhe Optikës në Leningrad dhe kishte punuar si fizikan në programin për armët nukleare sovjetike. Me sugjerim të eprorëve më pas iu bashkua Partisë Komuniste, ndonëse shumë vjet më vonë, në një intervistë të dhënë për një gazetë britanike, ishte shprehur se nuk kishte besuar kurrë vërtet në kauzën e komunizmit.

- Hyra në parti, - pat thënë ai pa asnjë shenjë pendese, - sepse ishte e vetmja mënyrë për të bërë karrierë asokohe. Mund të isha bërë edhe disident, por nuk para e kisha qejf Gulagun[11].

Kur Bashkimi Sovjetik dha frymën e fundit, Orlovi nuk derdhi asnjë pikë lot. Madje shkoi dhe u bë tapë me vodka të lirë sovjetike dhe rendi nëpër rrugët e Moskës duke thirrur: "Mbreti vdiq". Mëngjesin e së nesërmes, ndonëse me një dhimbje koke të tmerrshme nga pija, ai e hodhi teserën e Partisë Komuniste, dha dorëheqjen nga programi sovjetik për armët nukleare dhe u betua të bëhej i pasur. Brenda pak viteve, Orlovi

[11] Kampet e përqendrimit në ish-Bashkimin Sovjetik nga viti 1930 - 1955, ku humbën jetën shumë persona.

u pasurua duke importuar kompjuterë, pajisje elektronike dhe mallra të tjera perëndimore për tregun e ri rus. Më pas e përdori atë pasuri për të blerë metalurgjikun më të madh shtetëror rus dhe gjigantin e naftës siberiane "Ruzoilin", me çmime të papërfillshme për vlerën e tyre të vërtetë. Viktor Orlovi, një ish-fizikan i qeverisë, i cili dikur jetonte në një apartament bashkë me dy familje të tjera sovjetike, tanimë ishte miliarder dhe njeriu më i pasur në Rusi. Ishte ndër oligarkët e parë, një baron i ditëve moderne, i cili e kishte ngritur perandorinë e tij duke plaçkitur gurët e çmuar të kurorës së shtetit sovjetik. Ai nuk shprehte asnjë grimë pendese për mënyrën se si ishte pasuruar.

- Sikur të kisha lindur anglez, - i tha ai dikur një gazetari britanik, - me siguri do të isha pasuruar në mënyra të ligjshme, por ja që linda në Rusi dhe e bëra pasurinë në mënyrën ruse.

Por në Rusinë postsovjetike, një tokë pa ligje dhe ku gëlonin krimi e korrupsioni, pasuria e Orlovit i kishte dhënë famë atij. U kishte mbijetuar të paktën tri atentateve dhe flitej se kishte urdhëruar vrasjen e tre burrave për t'u hakmarrë. Por kërcënimin më të madh Orlovi e kishte marrë nga njeriu që pasoi Boris Jelcinin si president i Rusisë. Ai mendonte se Viktor Orlovi dhe oligarkët e tjerë i kishin vjedhur Rusisë gjërat më të çmuara dhe ai kishte në plan t'ua rimerrte. Pasi u vendos në Kremlin, presidenti i ri e thirri Orlovin dhe i kërkoi dy gjëra: metalurgjikun dhe Ruzoilin. "Dhe mos i fut hundët në politikë", kishte shtuar me egërsi, "përndryshe ta hoqa kokën".

Orlovi kishte rënë dakord të dorëzonte metalurgjikun, por kurrsesi Ruzoilin. Presidenti nuk kishte mbetur i kënaqur. Ai kishte urdhëruar menjëherë ekzekutuesit e tij të hapnin një hetim për mashtrim dhe ryshfete dhe brenda një jave nxori mandatin e arrestit. Orlovi u tregua i zgjuar dhe mori avionin për në Londër, ku u bë një prej kritikëve të betuar të presidentit rus. Për disa vjet, Ruzoili mbeti ligjërisht pezull, pa qenë as i Orlovit dhe as i zotërinjve të rinj të Kremlinit. Më në fund, Orlovi u bind ta dorëzonte edhe atë, si pjesë e një marrëveshjeje të fshehtë për të siguruar lirimin e katër personave të marrë peng nga një trafikant rus armësh me emrin Ivan Karkov. Në këmbim, britanikët e shpërblyen Orlovin duke e bërë shtetas të mbretërisë dhe duke i siguruar edhe një takim të shkurtër

privat me madhërinë e saj, mbretëreshën e Anglisë. Byroja izarealite i dërgoi një letër falënderimi të diktuar nga Kiara e të shkruar nga Gabrieli. Ari Shamroni ia dorëzoi letrën në dorë dhe e dogji pasi Orlovi e lexoi.

- A do të kem ndonjëherë nderin ta takoj personalisht atë njeri të madh? - e kishte pyetur Orlovi.

- Jo, - ia pat kthyer Shamroni.

Pa iu trembur syri, Orlovi i kishte dhënë Shamronit numrin e tij privat, të cilin Shamroni ia kishte dhënë më pas Gabrielit. Ai e telefonoi më vonë atë mëngjes nga një telefon publik pranë "Grand Hotel Berkshire"-it dhe u habit kur në telefon u përgjigj vetë Orlovi.

- Jam një prej njerëzve që ju shpëtuat kur hoqët dorë nga Ruzoili, - i tha Gabrieli pa përmendur emrin e tij. - Ai i cili ju shkroi letrën që plaku e dogji sapo ju e përfunduat së lexuari.

- Ai ishte një nga njerëzit më të çuditshëm që kam njohur.

- Prisni se nuk e njihni akoma mirë.

Orlovi lëshoi një të qeshur të vogël e të thatë dhe tha:

- Çfarë ju detyrohem për këtë nder?

- Kam nevojë për ndihmën tuaj.

- Herën e fundit që patët nevojë për ndihmën time, më kushtoi kompaninë e naftës dhe të paktën gjashtë miliardë dollarë.

- Këtë herë nuk do t'ju kushtojë asgjë.

- Në orën dy të pasdites jam i lirë.

- Ku?

- Në numrin 43, - tha Orlovi dhe e ndërpreu telefonatën.

Numri 43 ishte adresa e rrugës ku jetonte Viktor Orlovi, vila e tij me tulla të kuqe në "Cheyne Walk", në *Chelsea*. Gabrieli shkoi në këmbë deri atje. Keleri luante rolin e kundërzbuluesit afro njëqind metra pas tij. Shtëpia ishte e lartë, e ngushtë dhe e mbuluar me lule zvarritëse. Ashtu si fqinjët e saj, ishte e vendosur pak larg nga rruga, pas një gardhi prej hekuri. Jashtë qëndronte një limuzinë *Bently* e blinduar, me shoferin në timon. Menjëherë pas saj ishte një *Range Rover* i zi, ku qëndronin katër truproja

të Orlovit. Të gjithë ishin ish-anëtarë të regjimentit të vjetër të Orlovit; elita e Forcave Ajrore Speciale.

Truprojat e panë natyrshëm me kureshtje Gabrielin teksa i ngjitej rrugicës dhe u prezantua në portën e vilës. Kur ajo u hap, para Gabrielit u shfaq një shërbyese me uniformë bardhë e zi. Pasi verifikoi identitetin e Gabrielit ajo e udhëhoqi nëpër një palë shkallë të gjera dhe elegante që të çonin në zyrën e Orlovit. Ajo ishte si kopje e gjallë e studios private të mbretëreshës në Pallatin e Bakingamit - gjithçka ishte identike, përveç televizorit të madh plazma që ishte vendosur në një kanal me lajme për financat dhe të dhëna për tregun në mbarë botën. Kur hyri Gabrieli, Orlovi ia kishte ngulur sytë, si në ekstazë. Si zakonisht, kishte veshur një kostum të errët italian dhe kravatë luksoze në ngjyrë rozë. Flokët e rrallë e të thinjur i kishte lyer me xhel. Mbante syze optike tejet moderne. Nuk i lëvizte asnjë muskul përveç syrit të majtë, i cili i dridhej nga nervozizmi.

- Sa fitove sot, Viktor?

- Në fakt, - ia ktheu Orlovi, pa ia shqitur sytë ekranit, - më duket se kam humbur dhjetë ose njëzet milionë.

- Më vjen keq.

- Nejse, nesër ditë e re, nafakë e re.

Orlovi u kthye dhe e këqyri një copë herë të mirë Gabrielin përpara se t'i zgjaste dorën me gishtat e lyer me manikyr. Lëkurën e kishte shumë të freskët dhe të butë, sikur të shtrëngoje dorën e një fëmije.

- Si rus që jam, - tha ai, - nuk para befasohem lehtë, por duhet ta pranoj se habitem që të shoh në studion time. Nuk e prisja të takoheshim ndonjëherë.

- Më fal, Viktor. Duhej të kisha ardhur kohë më parë.

- Por unë e kuptoj përse nuk e ke bërë, - tha Orlovi dhe buzëqeshi me trishtim. - Ne të dy kemi diçka të përbashkët. Kremlini na do të dy të vdekur, por ia kemi hedhur deri tani.

- Disa prej nesh ia kanë hedhur më mirë se disa të tjerë, - tha Gabrieli duke hedhur sytë nëpër dhomën luksoze.

- Unë kam pasur fat, por edhe qeveria britanike është treguar bujare me mua, - shtoi Orlovi qëllimisht, - prandaj nuk dua të bëj asgjë që mund të shqetësojë *Whitehall*-in.

- Interesat tona janë të njëjta.

- Gëzohem që e dëgjoj këtë. Atëherë, zoti Alon, përse nuk më thua pse ke ardhur?

- Për kompaninë e gazit dhe të naftës "Volgatek".

Orlovi vuri buzën në gaz.

- E po, - tha ai, - gëzohem që *më në fund* dikush e vuri re.

37

CHEYNE WALK, CHELSEA

Viktor Orlovi nuk e kishte pasur kurrë problem të fliste për paratë. Në fakt, ai rrallëherë fliste për tjetër gjë. Krenohej se i blinte kostumet nga dhjetë mijë dollarë dhe se ora e tij e dorës prej floriri dhe me diamante, ishte ndër më të shtrenjtat. Ajo që mbante tani në dorë ishte mishërimi i së parës, të cilën ai e kishte prishur në mënyrë spetkakolare në Zvicër ku kishte shkuar për të bërë ski dhe ishte përplasur me një pishë.

- Nuk e di ku e pata mendjen, - ishte shprehur ai për një tabloid britanik pas përplasjes që i kushtoi miliona dollarë, - harrova ta hiqja atë dreq ore para se të dilja.

Vera e tij e parapëlqyer ishte *Chaetau Petrus*, Pomeroli i famshëm, të cilën e pinte si të ishte *Evian*. Ishte ende pasdite, edhe për Orlovin, kështu që pinë çaj. Orlovi e piu të tijin si të gjithë rusët, me një sheqer. Krahun e kishte hedhur mbi shpinën e një kolltuku elegant dhe hera-herës luante me bishtat e syzeve të shtrenjta, gjë që e bënte gjithmonë kur fliste për Rusinë.

Nuk ishte më Rusia e fëmijërisë së tij, as Rusia së cilës i kishte shërbyer si fizikan për armët bërthamore, por Rusia që përpiqej ende të gjente veten pas rënies së Bashkimit Sovjetik. Ishte Rusia pa ligje, Rusia e dehur, e llahtarisur dhe e përhumbur. Popullit të saj të traumatizuar i ishte

premtuar siguri nga lindja deri në vdekje. Tani, papritmas, ata duhej t'ia dilnin mbanë vetë. Ishte darvinizmi social. Të fortët sundonin të dobëtit, të dobëtit vuanin nga uria dhe oligarkët mbretëronin të qetë. Ata ishin kthyer në carët e rinj të Rusisë, komisarët e rinj. Ishin ata që kapardiseshin nëpër Moskë me karvanë makinash të blinduara dhe njerëz të armatosur deri në fyt. Natën, ata që i ruanin, bënin si të fortë rrugëve.

- Si në perëndimin e egër, - tha Orlovi mendueshëm. - Ishte një çmenduri e vërtetë.

- Por ty të pëlqente, ama.

- Përse të mos më pëlqente? Ne u bëmë si Perëndi.

Në fillimet e tij si kapitalist, Orlovi e kishte drejtuar i vetëm dhe me grusht të hekurt perandorinë e tij, por pasi i morën Ruzoilin, e kuptoi se i duhej një krah i djathtë.

Atë e gjeti te Genadi Lazarevi, një matematikan i shkëlqyer, me të cilin kishte punuar në programin për armët bërthamore sovjetike. Lazarevi nuk e kishte haberin e kapitalizmit, por ashtu si Orlovi, edhe ai ishte shumë i zoti me shifrat. Lazarevi mësoi gjithçka për biznesin dhe pastaj Orlovi e vendosi të drejtonte punimet e përditshme të Ruzoilit. Orlovi tha se ky ishte gabimi më i madh që kishte bërë.

- Pse? - e pyeti Gabrieli.

- Sepse Genadi Lazarev ishte i KGB-së, - u përgjigj Orlovi, - ishte i KGB-së kur punonim për programin e armëve bërthamore dhe vazhdonte t'i shërbente KGB-së edhe kur i lashë në dorë Ruzoilin.

- Ti nuk dyshove kurrë?

Orlovi tundi kokën.

- Ai ishte shumë i zoti dhe besnik ndaj shpatës dhe mburojës, siç u pëlqen të quhen të gjithë zhvatësit e KGB-së. Nuk besoj se është nevoja ta them, - shtoi ai, - që Lazarevi më tradhtoi. Ai i dha Kremlinit një mal me dokumente që më pas prokurorët i përdorën për të ngritur çështjen kundër meje. Kur unë u arratisa, Lazarevi e drejtoi Ruzoilin sikur ta kishte të vetën.

- Të bëri daljen ty?

- Absolutisht.

- Po kur ti pranove të dorëzoje Ruzoilin që të na nxirrnin ne nga Rusia?

- Lazarevi atëherë kishte ikur. Duket se presidenti rus ia kishte vënë syrin për vete asaj kompanie. E quajti kompania e naftës dhe e gazit "Volgatek". Në Kremlin qarkullonte një barsoletë sikur presidenti deshi ta quante kompania e naftës dhe e gazit të KGB-së, por pati frikë se mos nuk ia pëlqente perëndimi.

Sipas Orlovit, Volgateku nuk duhej të luante rol në prodhimin rus të naftës, por qëllimi i vetëm ishte që të zgjeronte shitjet e naftës dhe gazit rus në mbarë botën për të rritur pushtetin global të Kremlinit. Me paratë e Kremlinit, Volgateku bëri shumë pazare në Europë. Bleu një rrjet rafinerish nafte në Poloni, Lituani dhe Hungari. Pastaj, nga kundërshtimet e Amerikës, firmosi një kontratë marramendëse për kërkime nafte në Republikën Islamike të Iranit. Firmosi edhe kontrata me Kubën, Venezuelën dhe Sirinë.

- Të thotë gjë kjo? - pyeti Orlovi.

- Volgateku i lidhi të gjitha kontratat me vende të ish-perandorisë sovjetike ose në vende që kishin marrëdhënie armiqësore me Shtetet e Bashkuara.

- Pikërisht, - tha Orlovi.

Por Volgateku nuk kënaqej me aq, shtoi ai më pas. Ai e zgjeroi aktivitetin në Europën Perëndimore duke firmosur kontrata shpërndarjeje dhe rafinerish në Greqi, Danimarkë dhe Holandë. Pastaj i hodhi sytë nga Deti i Veriut, ku donte të hapte puse nafte në dy fushat e sapozbuluara të ishujve perëndimorë të Skocisë. Gjeologët e Volgatekut vlerësuan se prodhimi i tyre mund të arrinte në njëqind mijë fuçi në ditë, shumica e të ardhurave të të cilave do të përfundonin në xhepat e Kremlinit. Kompania bëri një kërkesë për leje në Departamentin Anglez të Energjetikës dhe Ndryshimeve Atmosferike. Më pas, Sekretari i Shtetit për Energjinë i kërkoi Viktor Orlovit të shkonte për bisedimet në zyrën e tij.

- Çfarë mendon ti se i thashë unë atij?

- Që Volgateku i përkiste Kremlinit, sepse drejtohej nga një ish-anëtar i tij.

- Dhe çfarë mendon ti se bëri Sekretari i Shtetit për Energjinë me kërkesën e Volgatekut për të hapur puse nafte në ujërat territoriale të Anglisë?

- E hodhi në kosh.

- Para syve të mi madje! - shtoi Orlovi duke qeshur. - Nuk e ke idenë se sa m'u bë qejfi!

- E mori vesh Kremlini që atë marrëveshje e minove ti?

- Me sa di unë, jo, - u përgjigj Orlovi, - por nuk ma do mendja që Lazarevi dhe presidenti i Rusisë të mos kenë menduar se unë kisha gisht në atë punë. Ata gjithmonë kanë menduar keq për mua.

- Po pastaj ç'ndodhi?

- Kompania Volgatek priti një vit dhe pastaj aplikoi prapë për leje për të hapur puset. Vetëm se këtë herë kishin ndryshuar gjërat. Kishin gjetur një mik në *Downing Street,* i cili kishte një vit që përgatiste ujërat.

- Kë?

- Këtë do të preferoja të mos e thosha.

- Mirë, - ia ktheu Gabrieli. - Po e them unë për ty. Njeriu i Volgatekut në *Downing Street* ishte Xheremi Faloni, kreu i kabinetit qeveritar më i fuqishëm në historinë e Britanisë.

Orlovi vuri buzën në gaz dhe tha:

- Unë them ta hapim një shishe *Petrus*.

Kishin lundruar në ujëra të rrezikshme. Gabrieli e dinte mirë këtë. Me siguri që edhe Orlovi e dinte, sepse syri i majtë po i dridhej pa pushim. Kur ishte i vogël, e kishin tallur dhe ngacmuar shumë për atë dridhje syri. Kjo e kishte bërë të tërbohej nga inati dhe ai inat e kishte çuar drejt suksesit. Viktor Orlovi donte të mposhtte këdo dhe e gjitha kjo, kishte marrë shkas nga ajo dridhje syri. Tani, ai sy po shikonte një gotë vere *Pomerol,* të kuqe të errët, të cilën nuk e kishte pirë ende. As pyetjes së drejtpërdrejtë të Gabrielit nuk i qe përgjigjur ende.

Pse Xheremi Falonin?

- Përse *jo* Xheremi Falonin? - tha më në fund rusi. - Ai ishte truri i Lankasterit. Gjithçka drejtohej nga ai. Faloni kërkonte diçka dhe Lankasteri e bënte menjëherë. Por kishte edhe ai një pikë të dobët.

- Çfarë?

- Nuk kishte asnjë kacidhe. Ishte shumë i varfër.

- Kush e pati idenë për t'ia hedhur grepat atij?

- Më kanë thënë se ishte ide e *rezidenturës* së SVR-së këtu në Londër.

Rezidentura ishte fjala që përdorte SVR-ja për t'iu referuar operacioneve të saj brenda ambasadave të një shteti. Rezidenti ishte ambasadori dhe rezidentura ambasada. Ky term kishte mbijetuar që nga koha e KGB-së, ashtu si shumica e gjërave në SVR.

- Si ia dolën?

- Lazarevi dhe Faloni filluan të rastisnin në vendet më të gabuara: festa, restorante, konferenca, pushime. Thonë se Faloni kaloi një fundjavë të tërë në shtëpinë e Lazarevit në Gestad dhe lundroi nëpër ishujt e Greqisë me jahtin e Lazarevit. Më kanë thënë se shkonin shumë mirë bashkë, por kjo nuk më habit. Genadi mund të jetë shumë i mirë kur do, dreqi!

- Por nuk besoj se Genadi e arriti këtë vetëm me sharmin e tij, apo jo, Orlov? Kishte më shumë se kaq.

- Shumë më tepër.

- Sa shumë?

- Pesë milionë euro që i kaluan në një llogari bankare në Zvicër nga ana e Kremlinit. Me gjithçka u mor SVR-ja.

- Kush ta tha ty këtë?

- Nuk ta them se kush.

- Viktor, të lutem.

- Ti me siguri ke burimet e tua, Alon. Unë kam të miat.

- Të paktën më jep një pistë.

- Nga Lindja, - tha Orlovi, duke lënë të nënkuptohej se ia kishte thënë një prej burimeve të tij në Moskë.

- Vazhdo.

Orlovi shijoi verën para se të niste të fliste. Pastaj i shpjegoi se si Volgateku bëri edhe një kërkesë tjetër për të hapur puse nafte në Detin e Veriut, por këtë herë me mbështetjen e njeriut të dytë më të fuqishëm në *Whitehall*. Por kryeministri vazhdonte të ishte ambivalent dhe Sekretari i Shtetit për Energjinë ishte kundër. Faloni ruajti avantazh ndaj Sekretarit që kërkesa të mos refuzohej menjëherë. Rreziku ishte ende i konsiderueshëm.

- Pastaj, - tha Orlovi duke ngritur njërin krah drejt tavanit, - Sekretari i Shtetit e aprovoi papritmas lejen, Xhonatan Lankasteri i hipi avionit për në Moskë dhe festoi me shampanjë në Kremlin, ndërsa njeriu që mori pesë milionë eurot në para ruse, tani do të bëhet ministri i ri i Financave.

- Dua të di se kush ta tha për pesë milionët.

- Më pyete dhe t'u përgjigja, - ia preu shkurt rusi.

Gabrieli ndërroi temë.

- Çfarë marrëdhëniesh ka sot Volgateku me bizneset e tua këtu në Londër?

- Sikundër mund ta marrësh me mend, jemi si në gjendje lufte. Si Lufta e Ftohtë, e pashpallur, por e ashpër.

- Pse?

- Lazarevi ma ka kaluar në disa blerje. Ai e ka të lehtë, - shtoi Orlovi me përbuzje, - se mos po luan me paratë e tij. Gjithashtu, ia ka qejfi të më marrë punonjësit më të mirë. U hedh para këmbëve një thes me para, natyrisht që janë para të Kremlinit, dhe ata nisen për në kullota më të gjelbra.

- Keni komunikim ju?

- Nuk mund ta them këtë, - tha Orlovi, - Kur ndeshemi në publik, e përshëndetim njëri-tjetrin me kokë dhe shkëmbejmë buzëqeshje të ngrira. Lufta jonë zhvillohet tërësisht në hije. Duhet ta pranoj se kohët e fundit Genadi ka qenë më i zoti se unë. Tani do të hapë puse nafte edhe në një vend që mua më pëlqen shumë. Vetëm kur e mendoj, bëhem keq.

- Përse nuk bën diçka për ta ndaluar?

- Çfarë të bëj?

- Më ndihmo mua ta prish atë marrëveshje.

Orlovi e la lojën me syzet dhe e pa Gabrielin në sy për një çast, para se më në fund të thoshte.

- Po ti ç'lidhje ke me këtë?

- Është çështje personale.

- Ç'punë ka një njeri si *ti* se ku hap puse nafte një kompani ruse?

- Është muhabet i gjatë.

- Nëse je përfshirë ti, nuk e vë në dyshim që kështu duhet të jetë.

Gabrieli vuri buzën në gaz dhe pastaj tha me qetësi:

- Besoj se Kremlini i ka bërë shantazh Xhonatan Lankasterit për t'ia dhënë Volgatekut të drejtën për të nxjerrë naftë atje.

- Si the?!

Gabrieli nuk foli.

- Unë hoqa dorë nga një kompani me vlerë gjashtëmbëdhjetë miliardë dollarë që ti dhe gruaja jote të dilnit të gjallë nga Rusia, - tha Orlovi, - dhe besoj se kjo e drejtë më takon mua. Po si ia bënë?

- Rrëmbyen të dashurën e Lankasterit në ishullin e Korsikës.

Orlovit nuk i lëvizte më asnjë muskul.

- E po, - tha pas një copë here, - më bëhet qejfi që më në fund *dikush* e kuptoi.

Ata folën derisa dritaret e studios plot shkëlqim të Viktor Orlovit i përpiu errësira, pastaj ndenjën edhe pak. Aty nga fundi i bisedës, Gabrieli ishte i bindur se ia kishte bërë të qartë Orlovit se ç'lojë ishte luajtur, vetëm se nuk dinte ende se si do të përfundonte. Por për diçka ishte i sigurt; kishte ardhur koha të bisedonte kokë më kokë me Graham Sejmurin. Atij i telefonoi nga një telefon publik në *Sloan Square* dhe i tha se kishte ardhur përsëri në Angli. I kërkoi të takoheshin. Sejmuri tha vendin dhe orën dhe e mbylli pa asnjë fjalë më shumë. Gabrieli uli receptorin dhe nisi të ecte. Kristofer Keleri vazhdonte rolin e kundërzbuluesit nga njëqind metra mbrapa.

38

HAMPESTEAD HEATH, LONDËR

Ecën në këmbë deri në qoshen e parkut "Hyde", pastaj morën një tren të linjës *Picadally* për në sheshin "Leicester" dhe pastaj udhëtuan me makinë deri në zonën e *Hampstead*-it. Keleri hyri në një kafene të vogël në *High Street* dhe priti atje deri sa Gabrieli u kthye vetëm në *South End Road*. Hyri në shqopishtat e fushës *Pryors,* kaloi brigjet e liqeneve të *Hampstead*-it dhe pastaj ngjiti të tatëpjetën e vogël të Kodrës së Parlamentit. Nga larg, nën velin e mjegullës dhe të një reje të ulët, shkëlqenin dritat e qytetit të Londrës. Graham Sejmuri po e admironte pamjen i ulur në një stol prej druri në park. Ishte vetëm, me përjashtim të truprojave të veshura me mushama shiu, që qëndronin pa lëvizur, si statuja, në rruginën pas tij. Ata kthyen sytë sapo shquan Gabrielin të kalonte ndanë tyre pa thënë asnjë fjalë dhe më pas të ulej pranë Sejmurit. Njeriu i MI5-s nuk dha asnjë shenjë se e ndjeu praninë e Gabrielit. Sërish, ai po pinte cigare.

- Duhet ta lësh atë, - i tha Gabrieli.

- Edhe *ti* duhej të më kishe thënë që po vije në Angli, - ia ktheu Sejmuri. - Të kisha dërguar njerëz të të prisnin.

- Nuk kam nevojë të më presë njeri, Graham.

- E po, doemos!

Sejmuri fliste pa ia ndarë sytë dritave të qendrës së Londrës.

- Sa kohë ke në Londër?

- Erdha dje pasdite.

- Pse?

- Kisha lënë një punë pezull.

- *Pse*? - e pyeti sërish Sejmuri.

- Për Madalenën, - ia ktheu Gabrieli. - U ktheva për Madalenën.

Për herë të parë, Sejmuri ktheu kokën dhe e pa Gabrielin në sy.

- Po Madalena ka vdekur, - tha ai ngadalë.

- E di që ka vdekur, Graham. E pashë me sytë e mi teksa vdiste.

- Më vjen keq, - tha Sejmuri pas pak. - Nuk duhej ta kisha...

- Nuk ka problem, - tha Gabrieli.

Mes dy burrave ra një heshtje e nderë. Gabrieli mendoi se ishte për shkak të natyrës fatkeqe të bisedës. Ata të dy i kishin hyrë botës së Shërbimeve Sekrete për të mbrojtur vendet dhe bashkëqytetarët e tyre, jo politikanët.

- Duhet të kesh zbuluar ndonjë gjë me rëndësi, përndryshe nuk do të më kishe telefonuar, - tha më në fund Sejmuri.

- Ti ke qenë gjithmonë i zgjuar, Graham.

- Por jo aq sa të të ndaloj ty të hysh e të dalësh kur të duash në vendin tim.

Gabrieli nuk foli.

- Çfarë ke zbuluar?

- Mendoj se e di se kush e rrëmbeu Madalena Hartin dhe ç'është më e rëndësishmja, - shtoi ai, - di edhe *përse* e rrëmbyen.

- Kush ishin ata?

- Një kompani gazi dhe nafte e KGB-së, - u përgjigj Gabrieli.

Sejmuri ktheu kokën në të qindtën e sekondës.

- Çfarë thua?!

- E bënë për kontratën e Volgatekut, Graham. Madalena u rrëmbye që rusët të marrin naftën tuaj.

Nuk ka ndjesi më të keqe për një agjent sekret, sesa kur një agjent i një

shteti tjetër i thotë diçka që ai duhej ta kishte zbuluar vetë i pari. Graham Sejmuri e priti sa më denjësisht që mundi këtë turp, me kokën lart. Pastaj, pasi e peshoi mirë e mirë në mendje, i kërkoi atij një shpjegim. Gabrieli e nisi duke i folur për ato që kishte mësuar për Xheremi Falonin. I tha edhe që Faloni kishte qenë i dashuruar me Madalena Hartin, që i kishte ditët të numëruara në *Downing Street*, deri para zgjedhjeve të ardhshme, që kishte pranuar një ryshfet prej pesë milionë eurosh nga Genadi Lazarev dhe që e kishte përdorur pushtetin e tij për të bindur Sekretarin e Shtetit për Energjinë që të hiqte dorë nga kundërshtimet e tij ndaj Volgatekut. Në fund, i tha Sejmurit edhe për gruan ruse, të cilën e kishte parë njëherë në një kishë të vjetër në Luberon dhe më pas në një shtëpi të braktisur në Basildon.

- Kush të tha për Xheremi Falonin dhe ryshfetin prej pesë milionë eurosh? - e pyeti Sejmuri.

- Do të parapëlqeja që kjo informatë të mbetej vetëm tek unë, nëse nuk të vjen keq.

- E di që kjo të volitet ty, por unë dua ta di.

Gabrieli tha të vërtetën dhe Sejmuri tundi kokën ngadalë.

- Viktor Orlovi nuk është tip i besueshëm, e ka gënjeshtrën në gjak, - tha ai. - Ai i jep gjithnjë gjoja informata MI6-s, por asgjë nuk del ashtu si thotë ai.

- Unë dhe Kiara jemi gjallë vetëm falë Orlovit, - ia ktheu Gabrieli.

- Kjo nuk do të thotë se gjithçka që thotë ai është e vërtetë.

- Askush në botë nuk di më shumë se ai për sa i përket prapaskenave të industrisë ruse të naftës.

Sejmuri nuk e kundërshtoi këtë konstatim.

- Je i sigurt për gruan dhe burrin që u larguan me *Mercedes*-in? - pyeti ai. - Je i sigurt që ishin ata që të ndoqën edhe te galeria?

- Graham... - tha Gabrieli me seriozitet.

- Mos ma merr për ters, të gjithëve na ndodh të gabohemi.

- Disave prej nesh më shumë se të tjerëve.

Sejmuri nxori tymin e cigares në errësirë me zemërim.

- Po unë pse e marr vesh vetëm tani këtë? Pse nuk më telefonove mbrëmë teksa ruaje ata?

- Pse, çfarë do të kishe bërë ti? Do të kishe njoftuar shefin e divizionit

të kundërzbulimit rus? Apo drejtorin tënd? - pyeti Gabrieli dhe heshti një hop para se të shtonte: - Po të të kisha njoftuar mbrëmë, mund të kishin ndodhur një sërë ngjarjesh që do të shkatërronin Xhonatan Lankasterin dhe qeverinë e tij.

- Atëherë përse erdhe tani?

Gabrieli nuk u përgjigj. Sejmuri bëri të ndizte një cigare tjetër, pastaj u ndal dhe tha:

- Nuk të duket ironike?

- Çfarë?

- Unë të kërkova ty ta gjeje Madalena Hartin sepse doja të mbroja kryeministrin tim nga një skandal dhe ti tani vjen e më jep informacion që mund ta shkatërrojë atë.

- Nuk ishte ky qëllimi im.

- E ke idenë që nuk mund të vërtetosh asgjë nga këto që po thua? Asgjë!

- E di.

Sejmuri psherëtiu thellë.

- Unë jam zëvendësdrejtori i Shërbimit Sekret të Britanisë së Madhe, - tha ai më shumë sikur po ia thoshte vetes, sesa Gabrielit. - Një zëvendës-drejtor i MI5-s nuk mund ta rrëzojë qeverinë britanike. Përkundrazi, ai ka për detyrë ta mbrojë vendin nga armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm.

- Po në rastet kur qeveria është e korruptuar?

- Më thuaj një qeveri që nuk është e korruptuar, - u përgjigj Sejmuri aty për aty.

Gabrieli nuk u përgjigj. Nuk ishte në humor për debate relative për etikën në politikë.

- Po sikur unë të të thosha të kthehesh në Izrael dhe ta fshije nga kujtesa këtë histori? - i tha Sejmuri. - Çfarë do të bëje ti?

- Do të të bindesha dhe do të kthehesha në Jerusalem.

- Po pastaj?

- Shamroni ka plane për mua.

- Do të m'i thuash edhe mua?

- Ende jo.

Sejmuri u duk i intriguar nga fjalët e Gabrielit, por gjithsesi nuk e

zgjati atë temë, por pyeti:

- Çfarë do të mendoje ti për mua pastaj?

- Ç'rëndësi ka se çfarë do të mendoja unë?

- Ka rëndësi për mua, - i tha Sejmuri me sinqeritet.

Gabrieli u mendua pak dhe pastaj foli:

- Mendoj se ti do ta kaloje pjesën tjetër të jetës duke vrarë mendjen se çfarë do të bënte SVR-ja me gjithë ato para që do të fitonte në Detin e Veriut dhe do të të brente ndjenja e fajit që nuk bëre asgjë për t'i ndaluar.

Sejmuri nuk bëri zë.

- Graham, ne kemi një shprehje në Izrael, e cila thotë: Nuk ka karrierë pa skandale.

- E po, ne jemi britanikë, - u përgjigj Sejmuri. - Nuk kemi kësi shprehjesh dhe nuk i pëlqejmë skandalet. Madje, jetojmë me frikë për të mos hedhur as edhe një hap të gabuar.

- Për këtë më ke mua.

Sejmuri e pa Gabrielin me seriozitet për një çast.

- Çfarë po përpiqesh të më thuash?

- Më lër mua ta bëj luftën kundër Volgatekut. Do të gjej prova që ata e kanë vjedhur naftën tuaj.

- Po pastaj?

- Unë do t'jua rimarr atyre.

Gabrieli dhe Sejmuri i kaluan tridhjetë minutat në vijim duke diskutuar për detajet e asaj që ndoshta mund të përbënte marrëveshjen operative më antiortodokse të arritur ndonjëherë mes dy agjencive aleate të Shërbimeve Sekrete. Më pas, ajo do të njihej si Marrëveshja e Kodrës së Parlamentit, paçka se disa anëtarë të Shërbimit Sekret Britanik do t'i referoheshin si Marrëveshja e Kodrës së Balonës, siç njihej ndryshe kodrina në skajin jugor të *Hampstead Heath*-it. Bazuar në kushtet e asaj marrëveshjeje, Sejmuri e lejoi Gabrielin të vepronte si ta shihte të arsyeshme në tokën britanike, me kusht që të mos përdorte dhunë dhe pa kërcënuar për asnjë çast sigurinë e kombit britanik. Nga ana e tij, Gabrieli kërkoi që çdo informatë e përftuar nga operacioni i tij t'i shkonte Sejmurit dhe vetëm ai do të vendoste se si t'i përdorte ato. Marrëveshja u vulos me një shtrëngim duarsh. Pastaj Sejmuri u largua, i ndjekur nga truprojat e tij.

Gabrieli qëndroi edhe për dhjetë minuta në *Heath* para se të kthehej në qendër të *Hampstead*-it për të marrë Kelerin. Bashkë, ata morën metronë për në Kesington dhe prej atje shkuan në këmbë në ambasadën e Izraelit. Zyra e pritjes ishte thuajse bosh, përveç një nëpunësi të nivelit të ulët, i cili kërceu menjëherë në këmbë kur njeriu legjendë u shfaq befas në derë. Gabrieli la Kelerin në paradhomë dhe mori për nga zyra e komunikimit të sigurt, të cilën veteranët si ai e quanin "E Shenjta mbi të Shenjtat". Numri i shtëpisë së Shamronit në Tiberias ishte ende në numëratorin e urgjencave. Ai u përgjigj që pas ziles së parë, a thua se ishte duke pritur ndanë telefonit.

Ndonëse telefonata ishte teknikisht e papërgjueshme, të dy burrat folën në gjuhën e koduar të Byrosë, gjuhë të cilën nuk kishte përkthyes apo makineri që ta deshifronte. Gabrieli i shpjegoi shpejt e shpejt ato që kishte zbuluar, çfarë kishte ndër mend të bënte në vijimësi dhe çfarë i duhej për këtë. Burimet për një operacion të tillë nuk i jepte Shamroni dhe ai e zyra e tij nuk kishin as të drejtë për ta aprovuar zyrtarisht. Këtë mund ta bënte vetëm Uzi Navoti, edhe ai pasi të merrte bekimin e vetë kryeministrit.

Kështu, u hodhën themelet e një plani që do të njihej si një ndër më të këqijtë në historinë e Byrosë. Ai nisi në orën 10:18 me orën e Izraelit, kur Shamroni i telefonoi Navotit në shtëpi dhe i tha se Gabrieli e kishte ndarë mendjen t'i hapte luftë kompanisë së gazit dhe naftës së KGB-së dhe se ai e aprovonte këtë. Navoti ia bëri të qartë se nuk kishte të drejtë vendimmarrjeje për sipërmarrje të tilla, as në atë kohë dhe në asnjë rast tjetër! Shamroni e mbylli telefonin pa thënë asnjë fjalë më shumë dhe i telefonoi kryeministrit para se ta bënte Navoti.

- Pse duhet që unë t'i hap luftë presidentit rus? - e pyeti kryeministri. - Naftë është, për Zotin!

- Për Gabrielin nuk bëhet fjalë *vetëm* për naftë, - ia ktheu Shamroni, - pastaj, ju doni që ta bëjmë Gabrielin drejtor të Byrosë, apo jo?

- Ari, ti e di që e dua atë njeri në krye të Byrosë.

- Atëherë lejojeni të hakmerret ndaj rusëve, - tha Shamroni, - dhe

pastaj është i tëri juaji.

- Kush do t'ia thotë Uzit këtë?

- Kam frikë se kjo nuk më takon mua.

Kështu, kryeministri i Izraelit, në emër të Ari Shamronit, i telefonoi drejtorit të Shërbimit Sekret dhe e urdhëroi të aprovonte një operacion. Kohë më pas, dështmitarë do të vërtetonin se pati ngritje zëri, madje u përfol edhe se Navoti kërcënoi të jepte dorëheqjen. Por këto mbetën vetëm në kuadrin e thashethemeve, sepse Navoti e donte postin e tij po aq sa e kishte dashur edhe Shamroni. Megjithëkëtë, nuk pranoi t'i telefononte personalisht Gabrielit në Londër për t'i dhënë bekimin e tij, duke ia lënë këtë detyrë një nëpunësi të nivelit të ulët. Gabrielit i shkoi çarteri për operacionin pak pas mesnate me orën e Londrës, gjë që iu njoftua me një telefonatë, e cila zgjati vetëm pak sekonda. Pasi mbylli telefonin, ai dhe Keleri dolën nga ambasada e Izraelit dhe u nisën nëpër rrugët e qeta të Londrës, drejt "Grand Hotel Berkshire"-it.

- Po unë? - pyeti Keleri. - Duhet të vij apo të marr avionin e parë për në Korsikë?

- Ti bëj si të duash.

- Mendoj të vij.

- Të siguroj se nuk do të zhgënjehesh.

- Por unë nuk flas hebraisht.

- Më mirë.

- Pse?

- Që të tallemi me ty dhe ti të mos marrësh vesh asnjë fjalë.

- Si do të të shërbej unë?

- Ti e flet frëngjishten si francezët, ke disa pasaporta të ndryshme dhe je i zoti me armën. Me siguri do të na hysh në punë.

- Mund të të jap një këshillë?

- Vetëm një.

- Do të të duhet edhe një rus.

- Mos u shqetëso. E kam gjetur.

39

GRAYSWOOD, SURREY

Shtëpia e stilit tudor ndodhej një kilometër e gjysmë larg kishës së famullisë *Grayswood*, në skaj të *Knobby Copse*. Rruga përvijohej nga ahe të dendura sa më s'ka. Kishte një kopsht ku mund të reflektoje i zhytur në mendime, tetë akra private ku të luftoje djajtë e tu dhe një liqen artificial, ku kishte vite që nuk peshkonte njeri. Levrekët që notonin në ujërat e tij të errëta tanimë ishin rritur e bërë si peshkaqenë. Sektori i Mirëmbajtjes, divizioni i Byrosë që merrej me sigurimin dhe mirëmbajtjen e pronave, e quante atë *Loch Ness*.

Gabrieli dhe Keleri mbërritën atje pak pas dreke, të nesërmen, me një *Land Rover* që ua kishte siguruar Sektori i Transportit. Në ndenjëset e pasme të tij ndodheshin dy arka hekuri të mbushura me pajisje për komunikim të sigurt, të cilat i kishin marrë në kasafortën e ambasadës. Gjithashtu ndodheshin edhe disa çanta me ushqime që i kishin blerë në supermarketin "Sainsbury" në *Guildford*. Pasi çuan ushqimet në dollap, ata hoqën mbulesat nga mobiliet, pastruan tavanet nga merimangat dhe e kontrolluan shtëpinë e vjetër cep më cep për përgjues. Pastaj shkuan në kopsht dhe qëndruan pranë buzës së liqenit. Në sipërfaqen e tij të errët gëlonin krahë peshqish.

- Nuk na paskan gënjyer, - tha Keleri.

- Po, - tha Gabrieli.

- Çfarë hanë ata?

- Po ja, herën e fundit që isha këtu, përlanë një nga oficerët e mi më të mirë.

- A ka ndonjë pajisje për t'i kapur?

- Po, në depo.

Keleri hyri brenda dhe gjeti dy kallamë të varur në një cep, pranë një rreme të vjetruar. Kur po kërkonte karrema, dëgjoi një zhurmë mbytëse, si ajo e një peme kur rrëzohet. Doli jashtë dhe ndjeu aromën e pangatërrueshme të barutit. Pastaj pa Gabrielin teksa ngjitej në rruginën e kopshtit, me një silenciator bereta në njërën dorë dhe një peshk afro gjashtëdhjetë centimetra në dorën tjetër.

- Kjo mënyrë nuk është shumë sportive, - tha Keleri.

- Nuk kam kohë për sport unë, - ia pat Gabrieli. - Më duhet të gjej një mënyrë për të infiltruar një agjent në kompaninë ruse të naftës dhe kam shumë gojë për të ushqyer.

Më vonë atë pasdite, teksa ahet zhdukeshin nëpër errësirë dhe ajri të thante nga i ftohti, në shtëpinë e izoluar të stilit tudor në periferi të *Knobby Copse*-it, mbërriti një karvan prej tri makinash. Ato ishin nga modele dhe prodhime të ndryshme, ashtu si edhe tri operativet që dolën prej tyre, të lodhura nga një ditë e gjatë udhëtimi klandestin. Brenda korridoreve dhe sallave të konferencave në "Bulevardin Mbreti Saul", ato operative njiheshin me emrin Barak, që në hebraisht do të thotë "vetëtima", për shkak të aftësive të tyre për t'u grumbulluar dhe për të goditur në befasi. Amerikanët, nga xhelozia për unitetin e tyre të pashoq dhe arritjeve të shumta operative, i quanin "Skuadra e Perëndive". Kiara hyri në shtëpi e para, e ndjekur nga Rimona Stern dhe Dina Saridi. Trupvogël dhe ezmere, Dina ishte analistja më e mirë për terrorizmin në Byro dhe mendja e saj brilante analitike e kishte bërë një aset të paçmueshëm për çdolloj operacioni. Rimona, një topolake me flokë në ngjyrë rëre, e kishte nisur karrierën në Shërbimin Sekret Ushtarak, por tani ishte

pjesë e njësitit të Byrosë që përqendrohej ekskluzivisht në programin për armë bërthamore të Iranit. Ajo ishte mbesa e Shamronit. Kujtimet më të dashura për Rimonën Gabrieli i kishte kur ajo ishte ende e vogël, një vajzë sypatrembur që vraponte nëpër rrugët rrotull shtëpisë së xhaxhait të saj të famshëm në Tiberias.

Pastaj erdhi një çift operativësh shumë të zotë, Odeda dhe Mordekai, dhe pas tyre edhe Jakov Rosmani dhe Josi Gavishi. Jakovi ishte një trupmadh me flokë të zinj dhe fytyrë me vraja. Ishte ndër agjentët më të shpejtë dhe ishte i specializuar në rekrutimin dhe ruajtjen e agjentëve arabë. Josi ishte agjent i vjetër i Sektorit të Kërkimeve, divizionit analitik të Byrosë. I lindur në Londër dhe i shkolluar në Oksford, ai fliste shumë mirë gjuhën hebraike, pavarësisht se me theks anglez.

Nga makina e fundit dolën dy burra; njëri ishte nga fundi i moshës së mesme ndërsa tjetri në lule të jetës. Ai më i madhi nga të dy ishte Eli Lavoni, dora vetë; arkeologu me famë, gjahtari i kokave të kriminelëve të Luftës Naziste, i mbijetuari i Holokaustit dhe agjenti i pashoq i vëzhgimit. Si zakonisht, Lavoni kishte veshur një mal me rroba pa asnjë lidhje me njëra-tjetrën. Flokët i kishte të rrallë dhe të shpupuritur dhe sytë vigjilentë si të një qeni të racës Terrier. Këpucët prej mokasine nuk u ndien teksa kaluan nëpër korridor dhe ai hyri në sallon duke e përqafuar Gabrielin me dashuri. Eli Lavoni rrallë ndihej kur bënte ndonjë gjë. Dikur, Shamroni pat thënë se vëzhguesi legjendar i Byrosë mund edhe të zhdukej duke të shtrënguar dorën.

- Je i sigurt që do të marrësh pjesë? - e pyeti Gabrieli.

- Nuk do ta humbisja për asgjë në botë këtë operacion! Pastaj, - shtoi Lavoni, - ky djali më tha se nuk u afrohej rusëve pa qenë me mua.

Gabrieli hodhi sytë nga njeriu i gjatë që qëndronte pas shpatullës së vogël të Lavonit. Ai quhej Mikail Abramov. Hollak, me fytyrë të ëmbël dhe sy të akullt, ai kishte emigruar nga Izraeli në Rusi që adoleshent dhe ishte bashkuar me *Sayeret Matkalin*, njësinë speciale operative të IDF-së. Dikur, Shamroni e kishte cilësuar atë si "Gabrieli pa ndërgjegje". Ai vetë kishte vrarë disa nga terroristët me nam nga Hamasi dhe xhihadistë islamikë nga Palestina. Tani kryente misione të ngjashme në emër të Byrosë, ndonëse talentet e tij të shumta shkonin përtej përdorimit efikas të armëve.

Kishte qenë Mikaeli ai që në bashkëpunim me një oficere të CIA-s me emrin Sara Bankrof, ishte infiltruar në rrethin shoqëror të Ivan Karkovit për të nisur një luftë të gjatë e të përgjakshme mes Byrosë dhe ushtrisë private të Ivanit. Sikur Viktor Orlovi të mos i kishte dorëzuar Kremlinit Ruzoilin, Mikaili do të kishte vdekur në Rusi bashkë me Gabrielin dhe Kiarën. Mikaili kishte ende një shenjë të thellë në faqe nga goditja me vare e Ivanit.

- Nuk je i detyruar ta bësh këtë, - i tha Gabrieli duke i prekur shenjën. - Mund të të zëvendësojmë me dikë tjetër.

- Me kë? - e pyeti Mikaili duke hedhur sytë rreth e rrotull dhomës.

- Mund të të zëvendësojë Josi.

- Josi flet katër gjuhë, - tha Mikaili, - por jo rusisht. Ata mund të flasin se si do t'ia presin fytin dhe ai do të mendojë se po porositin pulën Kiev.

Anëtarët e skuadrës legjendare të Gabrielit kishin qenë edhe më parë në atë shtëpi, kështu që u vendosën pa bërë bujë në dhomat e mëparshme teksa Kiara shkoi në kuzhinë të përgatiste një vakt të ngrohtë me rastin e takimit. Pjata kryesore ishte levreku i stërmadh, të cilin ajo e poqi me verë të bardhë dhe erëza. Gjatë darkës, Gabrieli e vendosi Kelerin të ulej në të djathtë të tij, që të tjerët të kuptonin se të paktën për momentin anglezi duhej trajtuar si i shtëpisë. Në fillim ata nuk u ndien rehat në praninë e tij, por pak nga pak u mësuan. Në shenjë respekti ndaj tij, gjatë më të shumtës së kohës kur darkuan, u fol anglisht, por kur folën për operacionin e fundit, e kthyen bisedën në gjuhën hebraike.

- Përse po flasin? - e pyeti Keleri qetësisht Gabrielin.

- Për një emision të ri televiziv që sapo ka nisur të transmetohet në Izrael.

- Po më thua të vërtetën?

- Jo.

Atë mbrëmje ishin më pak në humor se zakonisht, sepse mbi ta varej hija e Ivanit. Gjatë darkës nuk ia përmendën emrin. Folën për *matsay*-n, për situatën. Josi, i cili kishte lexuar shumë libra klasikë dhe historikë, mbante fjalën. Sipas tij, ky mision ishte tejet i rrezikshëm. Sipas tij, premtimet e Zgjimit të Madh Arab ishin ekspozuar si të rreme dhe shumë shpejt islami radikal do t'i zgjaste kthetrat nga Afrika Veriore në Azinë Qendrore.

Amerika kishte falimentuar, ishte e rraskapitur dhe nuk ishte më e zonja të udhëhiqte. Me gjasë, ky çrregullim i ri i botës do të sillte një vijë qendrore të shekullit 21, të udhëhequr nga Kina, Irani dhe natyrisht, edhe Rusia. I vetëm dhe i rrethuar nga një det me armiq, do të mbetej Izraeli dhe bashkë me të, edhe Byroja.

Duke folur për këto, ata ngritën pjatat dhe rregulluan dhomën e ndenjjes ku Gabrieli më në fund shpjegoi arsyen përse i kishte mbledhur të gjithë ata në Angli. Copëza të idesë ata i kishin krijuar edhe vetë. Atë çast, teksa qëndronte para tyre me një zjarr bubulak pas shpine, Gabrieli e përfundoi shpejt e shpejt tablonë. U tha gjithçka që kishte kaluar, duke e nisur nga kërkimi i dëshpëruar për Madalena Hartin në Francë dhe duke e përfunduar me marrëveshjen e bërë me Graham Sejmurin një mbrëmje më parë në *Hampstead Heath*. Megjithatë, një aspekt të çështjes, ai e anashkaloi. Bëhej fjalë për takimin e tij të shkurtër me Madalenën, në orët e fundit të jetës së saj. Ai i kishte dhënë fjalën se do ta kthente shëndoshë e mirë në shtëpi, por pas dështimit të tij, tani donte t'ia shpërblente njëfarësoj duke e shkatërruar operacionin rus. Ai tha se për ta arritur këtë do të infiltronin Mikailin në kompaninë e gazit dhe të naftës së KGB-së. Mandej do të gjenin provat se vrasja e Madalena Hartit ishte pjesë e një komploti rus për të vjedhur naftën britanike në Detin e Veriut.

- Po si? - pyeti Eli Lavoni, i habitur, pasi Gabrieli mbaroi së foluri. - Si do ta infiltrojmë Mikailin brenda një kompanie gazi dhe nafte të Kremlinit që drejtohet nga Shërbimi Sekret Rus?

- Do ta gjejmë një mënyrë, - tha Gabrieli. - Si gjithmonë.

Puna e vërtetë nisi mëngjesin tjetër, kur anëtarët e skuadrës së Gabrielit filluan të kërkonin me ngulm për kompaninë shtetërore ruse të energjisë, të njohur si kompania e gazit dhe e naftës Volgatek. Materialet e shumta u morën nga faqe interneti të lira si gazeta biznesi, konferenca për shtyp dhe shkrime akademike nga ekspertë të industrisë së naftës në Rusinë e korkolepsur. Përveç kësaj, Gabrieli kërkoi ndihmë edhe nga Njësia 1400, shërbimi i përgjimit elektronik izraelit.

Sikundër pritej, njësia zbuloi se rrjetet kompjuterike dhe ato të komunikimit të Volgatekut, në Moskë, mbroheshin nga sisteme të sigurisë së lartë ruse, çuditërisht, po ato sisteme që përdornin edhe Kremlini, ushtria ruse dhe SVR-ja. Megjithatë, më vonë atë ditë njësia arriti të hynte në mënyrë pirate në kompjuterët e zyrave qendrore të Volgatekut në Gdansk, ku kompania kishte një rafineri të rëndësishme nafte, e cila prodhonte pjesën më të madhe të gazolinës në Poloni. Materiali iu dërgua menjëherë bazës në *Surrey*. Mikaili dhe Eli Lavoni, anëtarët e vetëm të skuadrës që flisnin rusisht, u morën me përkthimin. Mikaili nuk kishte shumë besim, por Lavoni ishte më optimist. Ai tha se po të futnin një këmbë në Gdansk, do të mësonin shumë për Volgatekun dhe mënyrën se si ajo vepronte jashtë kufijve të Rusisë mëmë.

Instinktivisht, ata iu referuan objektivit të tyre si të ishte një organizatë terroriste dhe Dina iu kujtoi se sa herë që përballeshin me një grup apo celulë të re terroriste, detyra e parë ishte që të identifikonin strukturën dhe personelin kyç të saj. Duhej të përqendroheshin tek ata që qëndronin në krye të zinxhirit, pavarësisht se menaxherët e nivelit të mesëm, nëpunësit e thjeshtë dhe shoferët ishin ata që zakonisht rezultonin më të frytshëm në fund. Ata ishin të neglizhuarit, të harruarit. Ishin të mbushur me mllef, inate dhe shpesh shpenzonin më shumë nga sa fitonin. Kjo i bënte pre më të lehta për t'u rekrutuar sesa ata që tashmë kishin blerë avionë privatë, pinin shampanjë dhe shëtisnin botën cep më cep me një tufë prostitutash ruse me vete.

Në krye të organizatës qëndronte Genadi Lazarev, ish-shkencëtari rus i programit të armëve bërthamore dhe informatori i KGB-së, i cili kishte qenë zëvendësi i Viktor Orlovit te Ruzoili. Krahu i djathtë i Lazarevit ishte Dimitri Bershov dhe kreu i operacioneve në Europë ishte Aleksei Voronin. Të dy ishin ish-oficerë të KGB-së, ndonëse Voronini ishte shumë më i përgatitur se dy të tjerët. Ai fliste rrjedhshëm disa gjuhë europiane, përfshi anglishten, të cilën e kishte mësuar duke punuar për rezidenturën e KGB-së në Londër gjatë ditëve të fundit të Luftës së Ftohtë.

Pjesa tjetër e hierarkisë së Volgatekut rezultoi më e vështirë për t'u identifikuar dhe kjo nuk ishte aspak e rastësishme. Jakovit i pëlqeu më shumë profili i kompanisë ruse sesa ai i së tyres. Emri i shefit të rusëve

dihej nga të gjithë, ndërsa emrat dhe detyrat kryesore të ndihmësve të tij mbaheshin sekret ose fshiheshin nën skema mashtrimi për të mos u bërë të ditura. Fatmirësisht, trafiku i mesazheve elektronike nga zyra në Gdansk i dha mundësi skuadrës të identifikonte disa nga aktorët kyç brenda kompanisë, përfshi shefin e sigurisë, Pavel Zhirovin. Emri i tij nuk shfaqej në asnjë dokument zyrtar dhe të gjitha përpjekjet për të gjetur ndonjë fotografi të tij, shkuan dëm. Në organigramën e skuadrës, Zhirovi ishte një njeri pa fytyrë.

Me kalimin e ditëve, skuadra mësoi se kompania që mbronte Zhirovi nuk merrej vetëm me naftë. Ajo ishte pjesë e një manovre më të thellë të Kremlinit për ta kthyer Rusinë në një superfuqi botërore energjetike, në një Arabi Saudite Euroaziatike dhe në ringjalljen e perandorisë ruse nga rrënojat e ish-Bashkimit Sovjetik, Europa Lindore dhe ajo Perëndimore që tani vareshin kryesisht nga Rusia për gazin natyral. Misioni i Volgatekut ishte të zgjeronte sundimin e Rusisë në tregun e energjisë në Europë me anë të blerjeve të rafinerive të naftës. Tani, falë Xheremi Falonit, ata kishin futur një këmbë edhe në Detin e Veriut që me gjasë do t'u siguronte miliarda nga nafta, para që pa dyshim që do të përfundonin në xhepat e Kremlinit. Po, kompania e naftës dhe gazit "Volgatek" përfaqësonte makutërinë e Rusisë. Ky ishte përfundimi në të cilin arriti skuadra e Gabrielit me unanimitet. Por si ta infiltronin një agjent në një organizatë si ajo? Eli Lavoni parashtroi një mundësi, të cilën ia shpjegoi Gabrielit teksa shëtisnin në kopshtin si labirint të shtëpisë ku po qëndronin. Ai i tha se pasi bleu rafinerinë në Gdansk, Volgateku kishte punësuar një polak si drejtor të saj. Praktikisht, polaku nuk kishte asnjë lidhje me veprimtarinë e përditshme të rafinerisë. Ai ishte thjesht një manekin, një buqetë me lule për të zbutur pak ndjenjat e polakëve ndaj Rusisë. Madje, shpjegoi Lavoni, Polonia nuk ishte vendi i vetëm ku rusët punësonin edhe vendas. Ata e kishin bërë këtë edhe në Hungari, Lituani dhe në Kubë. Të gjithë menaxherët vendas të punësuar sa për sy e faqe ishin njësoj; nuk i llogariste askush.

- Nuk shërbejnë për asgjë, - tha Lavoni.

- Pra, nuk kanë asnjë akses në informacionet konfidenciale që na nevojiten ne, - tha Gabrieli.

- Po, - tha Lavoni, - por nëse ndonjë prej atyre vendasve ndodh të ketë lindur në Rusi ose të ketë prejardhje ruse, qendra e Volgatekut mund ta marrë më me sy të mirë, veçanërisht nëse ndodh të jetë edhe mendjendritur. Në një rast të tillë, mund t'i japin përgjegjësi. Kush e di? Ndoshta i japin edhe akses në vendin më të shenjtë të Moskës.

- Eli, kjo është ide brilante!

- Ashtu është, - pohoi Lavoni, - por e ka edhe kjo një kleçkë.

- Cila është ajo?

- Si t'ia bëjmë që Volgateku ta punësojë atë?

- Kjo është e lehtë fare.

- Vërtet?

- Po, - tha Gabrieli duke vënë buzën në gaz, - vërtet.

Gabrieli nuk mori pjesë në vaktin familjar atë natë. Ai shkoi në *Cheyne Walk, Chelsea,* ku darkoi vetëm për vetëm me Viktor Orlovin. Rusi nuk pati asnjë kundërshtim për planin e tij ende fetus; madje Orlovi ofroi disa sugjerime për ta përmirësuar atë. Në fund të darkës, Gabrieli i dorëzoi Orlovit dokumentin me planin që u dorëzohej të gjithë individëve të cilët nuk i përkisnin Byrosë, por merrnin pjesë në operacionet e saj. Atje thuhej se Orlovi përjashtohej nga çdo pjesëmarrje në operacion nëse demaskohej, dhe asnjë biznes i tij nuk do të dëmtohej, në asnjë mënyrë. Orlovi nuk pranoi ta firmoste, gjithsesi, Gabrieli e kishte parashikuar këtë. Pasi u largua nga vila e Orlovit, udhëtoi me makinë për në *Hampstead* dhe pastaj shkoi në këmbë në Kodrën e Parlamentit. Graham Sejmuri po e priste te stoli, me dy truprojat në krah. Ata u larguan sa për të mos dëgjuar bisedën e tyre teksa Gabrieli fliste për operacionin që do të organizonte dhe ndihmën që i nevojitej, jozyrtarisht, nga ana e britanikëve. Teksa e dëgjonte, Sejmuri nuk e mbajti dot përvijimin e një buzëqeshjeje në fytyrë. Asgjë nuk tingëllonte qoftë edhe pak normale, por shumica e operacioneve të Byrosë kështu ishin, sidomos kur organizoheshin nga Gabrieli dhe ekipi i tij.

- E di? - tha Sejmuri. - Them se mund të funksionojë.

- Do të funksionojë se s'bën, Graham. Puna është, - shtoi ai, - a do ti që unë të vazhdoj, apo jo?

Sejmuri heshti për një çast. Pastaj u ngrit në këmbë dhe i ktheu shpinën dritave të Londrës.

- Ti më sill prova që rusët janë përgjegjës për rrëmbimin dhe vrasjen e Madalenës, - tha ai me qetësi, - dhe unë do të sigurohem që ata maskarenjtë e Kremlinit të mos shohin me sy asnjë pikë nafte nga ne!

- Ma lër mua në dorë, Graham. Kështu ti nuk do të...

- Këtë mund ta bëj vetëm unë, - tha Sejmuri. - Pastaj, dikur një njeri me mend më ka thënë se nuk ka karrierë pa skandale.

- Provo të shkruash emrin tim në *Google* dhe pastaj eja të më thuash prapë nëse mendon se jam njeri me mend.

Sejmuri buzëqeshi.

- Mos më thuaj që po pendohesh.

- As që bëhet fjalë, - ia ktheu Gabrieli.

- Ashtu, djalë i mbarë, - tha Sejmuri. - Vetëm mos harro diçka.

- Çfarë?

- Për ty mund të jetë e lehtë të infiltrosh Mikailin te Volgateku, por nuk besoj të jetë po aq e lehtë ta nxjerrësh prej andej.

Pas atyre fjalëve, Sejmuri iu kthye shoqërisë së truprojave të tij dhe humbi në errësirë. Gabrieli ndenji edhe pesë minuta i ulur në stol, pastaj shkoi në këmbë deri te makina e tij dhe u kthye në shtëpinë në skaj të *Knobby Copse*.

40

GRAYSWOOD, SURREY

Trajnimi i Mikail Abramovit, punonjësit të ardhshëm të kompanisë energjetike ruse të njohur si kompania e naftës dhe e gazit "Volgatek", nisi të nesërmen në mëngjes, në orën 09:00. Tutori i tij i parë ishte Viktor Orlovi, dora vetë. Pavarësisht nga kundërshtimet e Gabrielit, Orlovi nguli këmbë të udhëtonte për në *Surrey* me limuzinën e tij *Mercedes Maybach,* të ndjekur nga një *Land Rover* i mbushur me truproja. Autokolona e vogël shkaktoi pak rrëmujë në *Grayswood* dhe në pjesën tjetër të ditës në fshat u fol se në atë autokolonë kishte udhëtuar vetë kryeministri. Por Xhonatan Lankasterit as që i binte ndër mend për *Surrey*-n. Atë mëngjes ai ishte në fushatë në *Sheffield*. Sondazhet e fundit e kishin nxjerrë kryesues ndaj kandidatit të opozitës. Analisti më i famshëm i politikës në Britani, tani fliste për një fitore të thellë të tij.

Mëngjesin tjetër Orlovi erdhi sërish në bazën e izraelitëve, edhe mëngjesin që pasoi. Leksionet e tij pasqyronin më së miri personalitetin e tij unik; brilant, arrogant, shpërfillës. Ai i foli Mikailit kryesisht anglisht, me ndonjë kalim sporadik në rusisht, që vetëm Eli Lavoni mund ta kuptonte. Ndonjëherë i përziente gjuhët në mënyrë aq të çuditshme sa ekipi i Gabrielit e cilësoi si "rusglisht". Ai ishte i palodhur, acarues dhe ishte e pamundur të mos e pëlqeje. Ishte si një burim i pashtershëm. Ishte Orlovi në mision.

Ai e nisi mësimdhënien e tij me një mësim historik; jeta në komunizmin sovjetik, rënia e perandorisë dhe era e paligjshmërisë dhe oligarkëve. Për habinë e të gjithëve, Orlovi pranoi se ai dhe baronët e tij plaçkitës të Rusisë kishin mbjellë farën e shkatërrimit të tyre duke u pasuruar shumë shpejt. Më pas shtoi se duke bërë këtë, ata ndihmuan në krijimin e rrethanave të përsosura që çuan në rikthimin e autoritarizmit. Presidenti aktual i Rusisë ishte një njeri pa ideologji dhe besim tjetër përveç asaj të ushtrimit të pushtetit absolut.

- Ai vetëm emrin nuk ka fashist, - tha Orlovi, - dhe atë njeri e kam bërë unë.

Faza e radhës e edukimit shpejt e shpejt të Mikailit nisi ditën e katërt, kur ai zhvilloi atë që Eli Lavoni e quajti si programin më të shkurtër të masterit në histori. Mësuesi ishte nga Tel Avivi, por kishte studiuar në *Wharton School of Business* dhe kishte punuar për një kohë të shkurtër për "ExxonMobil" përpara se të kthehej në Izrael. Përgjatë shtatë ditëve dhe netëve të gjata, ai i mësoi Mikailit bazat e administrimit të biznesit; financë, statistika, marketing, financë korporatash, menaxhim risku. Mikaili tregoi se mund të mësonte shumë shpejt dhe kjo nuk ishte shumë e habitshme nëse dije që prindërit e tij kishin qenë akademikë të shkëlqyer sovjetikë. Në fund të kursit parapërgatitor profesori u shpreh se Mikailin e priste një e ardhme e ndritur, paçka se nuk e dinte se çfarë sillte e ardhmja. Pastaj firmosi me kënaqësi formularin e konfidencialitetit të Gabrielit dhe mori avionin për t'u kthyer në Izrael.

Teksa Mikaili studionte leksionet e marra, pjesa tjetër e skuadrës punonte me zell për identitetin e tij të rremë. Ata e krijuan atë si një shkrimtar krijon personazhin kryesor të romanit; i dhanë paraardhës dhe arsim, të dashura dhe dështime, triumfe dhe zhgënjime. U menduan disa ditë për emrin, në fakt, sepse duhej të ishte emri i një njeriu me një këmbë në Perëndim dhe tjetrën ende të ngulur mirë në Lindje. Ishte Gabrieli ai që më në fund zgjodhi emrin Nikolas Avedon, një perversitet anglez i emrit Nikolai Avdonin. Me bekimin e Graham Sejmurit, i nxorën një pasaportë të rreme britanike me shumë vula dhe i përgatitën edhe një jetëshkrim të detajuar. Pastaj, pasi Mikaili përfundoi së studiuari gjithçka, e çuan të bënte shëtitjen e një jete të cilën ai nuk e kishte jetuar kurrë. Kishte një shtëpi në

një lagje periferike londineze ku ai nuk kishte hyrë kurrë, kishte studiuar në Oksford edhe pse s'kishte qenë kurrë atje dhe kishte punuar në një kompani për hapjen e puseve të naftës në Aberden, ku nuk kishte firmosur kurrë. Madje e dërguan edhe në Amerikë që të kujtonte rrugët e Kembrixhit pasditeve të freskëta vjeshtore, ndonëse ai nuk kishte shkelur kurrë më parë në Kembrixh, as në vjeshtë dhe as në ndonjë kohë tjetër të vitit.

Tani mbetej vetëm pamja e jashtme e Mikailit. Ajo duhej ndryshuar tërësisht. Në të kundërt, miqtë e Volgatekut në SVR do ta kujtonin nga operacionet e kaluara. Nuk bëhej fjalë për ndonjë operacion plastik sepse periudha e shërimit zgjaste, pa llogaritur që Mikaili nuk lejonte askënd t'i afrohej fytyrës së tij me bisturi në dorë. Kiara dha një alternativë të mundshme, të cilën ia demonstroi në një prej kompjuterëve. Në ekran ishte fotografia që ajo i kishte bërë Mikailit për pasaportën e rreme britanike. Ajo shtypi vetëm një buton dhe fotografia u rishfaq me një ndryshim thelbësor.

- As unë nuk e njoha.

- Por a do ta pranojë ai?

- Do t'ia bëj të qartë që nuk ka zgjedhje tjetër.

Atë mbrëmje, në praninë e të gjithë skuadrës Mikaili e rroi kokën qeros. E bënë edhe Jakovi, Odeda dhe Mordekai në shenjë solidariteti, por Gabrieli nuk pranoi. Ai tha se përkushtimi i tij ndaj unitetit të skuadrës nuk shkonte deri aty. Të nesërmen në mëngjes, Odeda e çoi Mikailin në Londër dhe bënë disa blerje që ngrysën ca vetulla në departamentin e financës në "Bulevardin Mbreti Saul". Kur u kthyen në *Grayswood* gjetën Viktor Orlovin duke pritur t'i jepte Mikailit disa udhëzime të fundit, të cilat ai i përftoi menjëherë. Për të festuar, Viktori hapi disa shishe nga vera e tij e dashur *Chateau Petrus*. Teksa po ngrinte gotën për nder të studentit të tij, nga kopshti u dëgjua një tingull mbytës.

- Çfarë ishte kjo? - pyeti Orlovi.

- Më duket se do të hamë peshk për darkë, - ia ktheu Mikaili.

- Po pse nuk më thatë? - tha Orlovi. - Po ta dija, do të kisha sjellë një *Sancerre* të mirë.

Pak kohë pasi kishte marrë pasaportën britanike, Orlovi kishte blerë aksionet e një gazete që po falimentonte, gazetës *Financial Journal* të Londrës, me qëllimin për të përmirësuar imazhin e tij ndër njerëzit më të zgjuar të qytetit. Disa anëtarë të stafit, përfshi edhe gazetaren investigative Zoi Rid, dhanë dorëheqjen në shenjë proteste, por pjesa më e madhe e tyre qëndruan, pjesërisht sepse nuk kishin se ku të shkonin tjetër. Një nga kushtet e kontratës me gazetën ishte që Orlovi të mos ndërhynte në përmbajtjen editoriale të saj dhe ai pranoi. Ai e respektoi deri diku këtë kusht, pavarësisht nga dëshira e tij e ethshme për ta përdorur gazetën si vegël për të mposhtur armiqtë e tij në Kremlin. Megjithëkëtë, herë pas here Orlovi i thërriste redaktorët e rubrikave për t'u dhënë ndonjë lajm, veçanërisht kur bëhej fjalë për bizneset e tij. Kështu, tri ditë më pas, në gazetë doli një artikull i shkurtër që bënte me dije se pjesë e stafit të kompanisë "Investimet Viktor Orlov", tanimë ishte bërë edhe një djalë i ri. Orlovi e konfirmoi lajmin në një konferencë për shtyp më vonë atë mëngjes, duke thënë se një intelektual tridhjetepesëvjeçar, që quhej Nikolas Avedon, do të merrte në kontroll portofolin energjetik të IVO-së. Pa kaluar as disa minuta, interneti gëlonte nga fjalët se Orlovi kishte zgjedhur një pasues dhe po përgatitej të tërhiqej nga aktiviteti i përditshëm i kompanisë së tij. Atë mbrëmje, lajmi kishte qarkulluar gjithandej dhe Orlovi u detyrua që si rrallëherë, të dilte në stacionin televiziv CNBC për të mohuar thashethemet. Fjalimi i tij nuk dukej shumë bindës, aq sa një komentator i njohur u shpreh se me atë fjalim, ai ngriti më shumë pikëpyetje sesa dha përgjigje.

Askush në qarqet financiare të Londrës nuk do ta mësonte ndonjëherë se kjo parapërgatitje për të dalë në pension e Orlovit ishte ideuar nga një skuadër burrash dhe grash, të cilët punonin në një shtëpi të izoluar në *Surrey* dhe as që ky lumë thashethemesh po vërshonte edhe në komunitetin e biznesit moskovit dhe po arrinte edhe në majat më të larta të hierarkisë së kompanisë shtetërore energjetike të njohur si kompania e naftës dhe e gazit "Volgatek". Gabrieli dhe skuadra e tij i dinin të gjitha këto sepse i dëgjuan në një mesazh elektronik me përmbajtje të zemëruar, që Aleksei Voronin, shefi i punimeve për Europën ia kishte dërguar kreut të zyrës në Gdansk. Eli Lavoni e printoi mesazhin elektronik dhe ia dha

Gabrielit të përkthyer atë mbrëmje. Gabrieli reagoi duke hapur një shishe vere *Chateau Petrus* që kishte mbetur dhe u mbushi nga një gotë të gjithë anëtarëve të skuadrës. Duhej thënë se ky ishte një fillim i mbarë. Mikaili tashmë ishte kthyer në trashëgimtarin e mundshëm të Viktor Orlovit dhe kompania e naftës dhe e gazit të KGB-së ishte e gjitha sy e veshë.

41

MAYFAIR, LONDËR

Zyrat qendrore të kompanisë "Investimet Viktor Orlov", zinin katër katet e një blloku luksoz zyrash në *Mayfair*, jo shumë larg ambasadës amerikane. Atë mëngjes herët kur Nikolas Avedon mbërriti atje, i gjithë stafi i drejtuesve po e priste në sallën kryesore të konferencave për t'i uruar mirëseardhjen. Orlovi mbajti një fjalim të shkurtër dhe dha disa udhëzime të shpejta, të cilat as që ishin të nevojshme sepse Mikaili i kishte mësuar përmendësh emrat dhe fytyrat e skuadrës së Orlovit gjatë parapërgatitjes në bazën e tyre në *Surrey*.

Ata gaboheshin nëse mendonin se Mikailit do t'i duhej kohë për të mësuar gjithçka për punën në atë kompani, sepse vetëm disa orë pasi u vendos në zyrën e tij të re me pamje nga sheshi "Hanover", ai bëri një rishikim të thellë të investimeve luksoze të IVO-s në fushën e energjetikës. Nuk është nevoja të themi se ky rishikim ishte bërë që brenda mureve të bazës në *Surrey* dhe as që të dhënat ia kishte ofruar vetë Viktor Orlovi. Ai rishikim e sinjalizoi stafin e kompanisë se Nikolas Avedoni nuk ishte një njeri dosido, por kishte ardhur në IVO për të punuar seriozisht dhe Zoti i ndihmoftë ata që do të provonin ta pengonin ta kryente atë.

Ditët e tij të mëpasme u kthyen shpejt në një rutinë strikte. Mbërrinte herët në punë, lexonte të gjitha gazetat e biznesit, kontrollonte tregun

aziatik dhe pastaj kalonte ndonja dy orë mes dokumentacioneve para se të niste mbledhja me drejtuesit e kompanisë, e cila zhvillohej gjithmonë në zyrën e madhe të Orlovit. Ai e merrte fjalën rrallë gjatë mbledhjes, por kur fliste, fjala e tij vendoste standarde të reja. Shumicën e ditëve, drekonte vetëm dhe pastaj punonte në zyrë deri në orën shtatë ose tetë të mbrëmjes, derisa kthehej në apartamentin e madh që i kishte marrë me qira Gabrieli në *Maida Vale*. Pjesa tjetër e skuadrës kishte marrë me qira një apartament tjetër në pallatin përballë tij dhe kur Mikaili ndodhej në shtëpi, një anëtar i saj e vëzhgonte çdo çast. Kur ai ishte në punë, në vend të tyre e ruante një kamera me rezolucion të lartë dhe transmetues të sigurt.

Shumë shpejt u zbulua se atë e vëzhgonte edhe Volgateku. Gabrieli dhe skuadra e tij e mësuan këtë, sepse Njësia 1400 më në fund arriti të depërtonte në rrjetin kompjuterik të Volgatekut dhe tani i lexonin pothuajse në kohë reale mesazhet elektronike të drejtuesve të saj. Emri Nikolas Avedon u shfaq në disa prej tyre, përfshi edhe një, të cilin Genadi Lazarev ia kishte dërguar Pavel Zhirovit, shefit të pafytyrë të sigurisë së Volgatekut, ku i kërkonte të bënte një kontroll të jetës së Nikolasit. Nikolas Avedoni tani kishte hyrë në radarët e Volgatekut dhe Gabrieli tha se kishte ardhur koha ta nxirrnin më në dritë.

Të nesërmen në mëngjes, Nikolas Avedoni i paraqiti Viktor Orlovit dhe gjithë ekipit drejtues të IVO-s ato që kishte zbuluar. Orlovi tha se zbulimet e tij ishin brilante, gjë që nuk është për t'u habitur, pasi ai i kishte shkruar vetë një për një. Gjatë ditëve në vazhdim, ai bëri disa lëvizje të guximshme në tregun e bursës, të gjitha pjesë e planit të menduar mirë, të cilat ndryshuan në mënyrë radikale pozitat e IVO-s në sektorin global të energjisë. Gjatë një vale intervistash televizive dhe nëpër gazeta, Orlovi e quajti këtë "energji për shekullin 22 dhe më tej" dhe nuk humbiste asnjëherë rastin për t'i dhënë meritat arkitektit mendjendritur Nikolas Avedon. Pasanikët e Londrës e ndiqnin me vëmendje ecurinë e të përkëdhelurit të Orlovit dhe po ashtu edhe ata në kompaninë e gazit dhe të naftës së KGB-së. Kishte ardhur koha që Viktor Orlovi të tregonte se sa i rëndësishëm ishte Nikolas Avedoni për të. Genadi Lazarevi do të përpiqej ta blinte Nikolasin për një arsye të vetme - që të sabotonte ish-këshilltarin dhe ortakun e tij.

Kështu, mori rrugë ajo çka skuadra e quajti "Marrëzia Viktor & Nikolas". Për dy javët në vijim ata u bënë të pandarë. Drekonin bashkë, darkonin bashkë dhe sa herë që Viktori dilte në publik, Nikolasi ishte në krah të tij. Ai u pa në disa raste të dilte nga vila e Orlovit në *Cheyne Walk* mbrëmjeve vonë dhe fundjavat i kalonte duke u qetësuar në pronën e mrekullueshme të Orlovit në *Berkshire*, privilegj që nuk e kishte asnjë punonjës tjetër i kompanisë. Teksa marrëdhënia e tyre forcohej, në zyrat qendrore të IVO-s në *Mayfair* u shtuan tensionet. Shefave të divizioneve të tjera nuk u pëlqente aspak fakti që Nikolas Avedoni filloi të merrte pjesë në ato që zakonisht për ta ishin takimet kokë më kokë me shefin e madh dhe as që Avedoni shpesh i çuçuriste këshilla në vesh Orlovit. Disa kolegë i shpallën luftë të hapur, por pjesa më e madhe zgjodhën ta mbanin mirë me të. Avedoni lundronte mes ftesash për të pirë ndonjë gotë pas pune ose për darka. Ai i refuzoi të gjitha ato. Tha se duhej të përqendrohej vetëm te Viktori. Më pas, të dy bashkë bënë një udhëtim nëpër kontinent. Në Paris zhvillohej forumi i bizneseve, ku prania e tyre ra shumë në sy. Pastaj ishte mbledhja e bankierëve zviceranë në Gjenevë, ku nuk duhej të gabonin kurrsesi. Hapi i radhës ishte një takim i rëndësishëm në Madrid me drejtorin ekzekutiv të njërës prej kompanive të naftës së Orlovit, të cilit i ishin dhënë gjashtë muaj kohë për të shtuar fitimet, ndryshe do ta pushonin nga puna atë dhe të gjithë spanjollët që punonin në kompani.

Në fund, fluturuan për në Budapest për një mbledhje me biznesmenë dhe qeveritarë të të ashtuquajturave tregje në zhvillim të Europës Lindore. Gazpromi, gjiganti rus i gazit, dërgoi një përfaqësues për t'i siguruar të pranishmit se ata nuk i trembeshin varësisë së tyre nga prodhimi rus dhe se Kremlini nuk duhej as ta çonte nëpër mend që mund të bënte si të donte në tokat e humbura të ish-perandorisë së tij. Atë mbrëmje u organizua një koktej buzë Danubit, përfaqësuesi i Gazpromit u prezantua me Nikolas Avedonin dhe u habit pa masë kur pa se ai fliste rrjedhshëm rusisht. Ishte më se e qartë që përfaqësuesi i Gazpromit mbeti pa fjalë nga ato që dëgjoi, sepse disa minuta pas takimit të tyre, në postën elektronike të Genadi Lazarevit mbërriti një mesazh.

Gabrieli dhe skuadra e tij e lexuan atë mesazh para se Lazarevi ta hapte. Dukej se Nikolas Avedoni kishte hyrë në lojë. "Duhet ta marrësh

patjetër në punë atë njeri", shkruante përfaqësuesi i Gazpromit. "Po nuk e more ti, do ta marrim ne".

Por si mund të arrihej kjo? Duke qenë se nuk ishte nga ata që presin me padurim pranë telefonit, Gabrieli donte ta përshpejtonte çështjen duke afruar Mikailin me Lazarevin, në një vend ku të dy mund të flisnin disa minuta privatisht. Kjo mundësi u dha kur Njësia 1400 kapi një mesazh elektronik që i dërgonte Lazarevit sekretarja e tij. Ajo i fliste për itinerarin e tij në Forumin e Energjisë Globale që po afronte dhe për bienalen e diçkaje që quhej Shoqata Ndërkombëtare e Prodhuesve të Naftës. Gabrieli qeshi kur e lexoi. Dy të marrët do të shkonin në Kopenhagen. Bashkë me ta, edhe Byroja.

42

KOPENHAGEN, DANIMARKË

Pesë ditë të ethshme më pas, lordët e naftës nisën të mbushnin Kopenhagenin nga të katër cepat e botës; Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara, azerët dhe kazakët, brazilianët dhe venezuelasit, amerikanët dhe kanadezët. Aktivistët e ngrohjes globale u indinjuan shumë nga një mbledhje e tillë, madje një grup ngriti edhe pretendimin histerik se karboni i çliruar nga ajo konferencë do të bënte që oqeanet të përpinin një fshat në Bangladesh. Megjithëkëtë, delegatët nuk ua vunë veshin. Ata mbërritën në Kopenhagen me avionë privatë dhe u endën nëpër rrugët e çuditshme të qytetit me limuzina të blinduara, me motorë me djegie të brendshme. Ndoshta një ditë nafta do të mbaronte dhe planeti do të bëhej aq i nxehtë sa njeriu të mos jetonte dot në të, por hëpërhë, bosët e lëndëve djegëse fosile sundonin me pushtet të plotë.

Në Kopenhagen kishte shumë dyndje në atë kohë. Me zor mund të gjeje tavolina të pazëna nëpër restorante për darkë dhe hoteli "D'Angleterre", një hotel i bardhë luksoz me pamje nga sheshi "King's New", ishte mbushur përplot. Viktor Orlovi dhe Mikaili mbërritën në hyrjen e tij të magjishme mes një stuhie bore verbuese dhe menaxheri i shoqëroi në dy suita ngjitur me njëra-tjetrën në një prej kateve të sipërme. Suita e Mikailit kishte disa sende tradicionale daneze, si edhe një shishe *Dom Perignon* brenda një

kove me akull. Herën e fundit që kishte ndenjur në një hotel kur e kishte dërguar Byroja me shërbim, ai e kishte përdorur shampanjën e dhomës për të kuruar një plagë të marrë në gju. Atë çast, mendoi se për të qenë sa më bindës në rolin e tij, ia vlente të kthente një ose dy gota. Kur po i hiqte tapën, dëgjoi një trokitje të lehtë në derë. Ai u habit sepse kishte varur edhe tabelën "Mos më shqetësoni" para se t'i jepte bakshish portierit. E hapi derën ngadalë dhe përmes zinxhirit të sigurisë pa një njeri me trup të mesëm që qëndronte në korridor. Kishte veshur një trekuart të leshtë me jakë të stilit gjerman dhe një kapelë alpine. Flokët i kishte të dendur dhe të thinjur, sytë kafë dhe me syze. Në dorën e djathtë mbante një çantë lëkure si të vjetër.

- Si mund t'ju ndihmoj? - pyeti Mikaili.

- Duke hapur derën, - i tha Gabrieli qetësisht.

Mikaili e hoqi çengelin e zinxhirit dhe bëri një hap mënjanë që të hynte Gabrieli, pastaj e mbylli derën menjëherë. Kur u kthye, pa Gabrielin teksa lëvizte ngadalë nëpër dhomën e hotelit me telefonin *BlackBerry* në dorën e djathtë. Pas pak, ai i pohoi me kokë si për t'i thënë se nuk kishte asnjë përgjues. Mikaili shkoi te kova e shampanjës dhe mbushi një gotë *Dom Perignon*.

- Ti do? - e pyeti ai duke tundur shishen.

- Jo, më bën me dhembje koke.

- Edhe mua.

Mikaili uli trupin e tij hollak në kolltuk dhe i hodhi këmbët mbi tavolinën e mesit, i lodhur nga një ditë e ngarkuar me udhëtime dhe takime. Gabrieli hodhi sytë përreth suitës luksoze dhe tundi kokën.

- Mirë që po e paguan Viktori faturën për këtë. Uzi më hëngri veshët për shpenzimet.

- Thuaji Uzit që duhet të më mbajë me stilin që jam mësuar.

- Mirë që nuk je dehur nga suksesi ti.

Mikaili piu pak shampanjë, pa folur.

- Duhet të rruhesh.

- Në mëngjes u rrojta, - tha Mikaili duke prekur mjekrën.

- Nuk e kisha fjalën për atë, - ia ktheu Gabrieli.

Mikaili kaloi dorën mbi kokën që i shkëlqente.

- E di që po mësohem me këtë tani? Madje mendoj ta ruaj këtë pamje edhe për kur të mbarojë operacioni.

- Mikail, e kupton që dukesh si alien?

- Më mirë si një alien, sesa si personazh i *The Sound of Music*.

Mikaili rrëmbeu një sanduiç të vogël me karkaleca nga pjatanca që e përlau në çast.

- Që kur ke filluar të hash prodhime deti ti?

- Qëkur u bëra anglez me prejardhje ruse dhe punoj për një kompani investimesh në pronësi të një oligarku me emrin Viktor Orlov.

- Me pak fat, - tha Gabrieli, - kjo do të jetë vetëm një tullë në ndërtimin e diçkaje të madhe.

- *Ishallah*! - tha Mikaili duke ngritur gotën e shampanjës gjoja si për të ngritur dolli. - A mbërritën nëpunësit e mi të ardhshëm?

Gabrieli u përkul mbi çantën e vjetër prej nga nxori një dosje të verdhë. Brenda saj ndodheshin tri fotografi me ngjyra, të sapolara, të cilat ai i vendosi mbi tavolinë, para Mikailit. Në to paraqiteshin tre burra që zbrisnin shkallët e një avioni privat e më pas hipnin në një limuzinë. Fotografitë ishin bërë nga një distancë e konsiderueshme, me aparat me lente të gjata. Imazhi ishte turbulluar disi gjithsesi, nga bora që binte.

- Kush i ka bërë këto fotografi? - pyeti Mikaili.

- Josi.

- Si hyri në pistë ai?

- Me një fletëhyrje gazetari, - ia ktheu Gabrieli. - Ai dhe Rimona e mbajnë gjithnjë me vete një të tillë.

- Për kë punojnë këta?

- Për një revistë periodike me emrin "Energy Times".

- Nuk më thotë gjë ky emër.

- Është e re.

Mikaili mori fotografinë e parë buzagaz. Ishte ajo ku tri figurat zbrisnin shkallët e avionit në rresht për një. I pari ishte Genadi Lazarevi, në pamjen e të cilit nuk kishte mbetur asnjë gjurmë nga matematikani intelektual që kish qenë dikur. Një hap pas tij ishte Dimtri Bershov, zëvendësdrejtori ekzekutiv i Volgatekut dhe pas Bershovit ndodhej një njeri trupvogël, por i lidhur, fytyra e të cilit nuk dukej nga streha e një kapele *fedora*.

- Kush është ai? - pyeti Mikaili.

- Nuk e dimë ende.

Mikaili mori fotografinë e dytë, pastaj të tretën. Fytyra e tij nuk duket në asnjërën prej tyre.

- Qenka i zoti, - tha Mikaili.

- E vure re edhe ti, hë?

- Si të mos e vë re! Duket që e ka ditur ku ishin aparatet fotografike dhe është siguruar të mos e kapnin, - tha Mikaili duke i lëshuar fotografitë mbi tavolinën e mesit. - Përse mendon se e ka bërë këtë zgjedhje?

- Për atë arsye që e bëjmë edhe unë e ti.

- A thua punon për Byronë?

- Është profesionist, Mikail. Është profesionist i vërtetë. Ndoshta është ndonjë nga veteranët në pension të SVR-së dhe e bën sepse i është bërë zakon, por mua më duket sikur është ende i aktivizuar.

- Ku është ai tani?

- Në hotelin "Imperial", bashkë me të tjerët. Genadit nuk i kishte pëlqyer aspak pritja.

- Nga e di ti këtë?

- E di, sepse Mordekai dhe Odedi bënë një vizitë në dhomën e tij një orë para se të ulej avioni i Volgatekut dhe i lanë diçka poshtë komodinës.

- Nga e dinit ju se cila ishte dhoma e Lazarevit?

- Njësia jonë hyri në sistemin e rezervimit të hotelit.

- Po derën si e hapët?

- Mordekai ka një kartë të re magjike. Dera zëre se u hap vetë, - tha Gabrieli dhe i rivendosi fotografitë në dosje dhe dosjen në çantën e lëkurës. - Por besoj se e merr me mend se ai nuk ka folur vetëm për kushtet e dhomës, - shtoi pas pak. - Mezi po pret të takohet me ty.

- Ke ndonjë ide se kur mund ta bëjë lëvizjen?

- Jo, - tha Gabrieli duke tundur kokën, - por me siguri që do të bëjë një lëvizje të menduar mirë.

- E njoh unë atë?

- Ti i di vetëm emrin, - tha Gabrieli, - nuk e njeh si fytyrë.

- Po sikur ai të vijë vetë tek unë?

- Unë kam qenë gjithmonë i mendimit se duhet luajtur fuqishëm.

- Po pra, prandaj ia arrite kësaj dite, - tha Mikaili duke hedhur edhe një herë shampanjë në gotën e tij, por pa folur më gjatë.

- Mikail, mos do të më thuash ndonjë gjë?

- Besoj se pret urime.

- Çfarë urimesh?

- Gabriel, mos më detyro ta them.

- Çfarë të thuash?

- Gabriel, njerëzit flasin në përgjithësi, jo më kur janë mes agjentësh sekretë, dhe në "Bulevardin Mbreti Saul" kanë dalë fjalë se ti do të jesh drejtori i ardhshëm i Byrosë.

- Unë nuk kam pranuar asgjë.

- Mua nuk më kanë thënë kështu, - tha Mikaili. - Unë di që ka mbaruar ajo punë.

- Nuk është e vërtetë.

- Si të urdhëroni, shef.

Gabrieli mori frymë thellë dhe tha:

- Sa di Uzi për këtë punë?

- Uzi e dinte që kur u emërua në atë detyrë që qëndronte gjithnjë pas teje.

- Ta dish që unë nuk e kërkova atë punë.

- E di dhe besoj se e di edhe Uzi, - tha Mikaili e pastaj shtoi, - megjithatë kjo nuk do ta lehtësojë aspak situatën kur kryeministri t'i thotë se nuk do të jetë më në krye të Byrosë.

Mikaili ngriti gotën nën dritën e abazhurit dhe pa flluskat që dilnin në sipërfaqe të shampanjës.

- Përse po mendon? - e pyeti Gabrieli.

- E mban mend kur ishim në Zyrih, në atë kafenenë e vogël pranë *Paradeplatz*-it? Kur po përpiqeshim të rimerrnim Kiarën nga kthetrat e Ivanit. E mban mend atë vend, Gabriel? E mban mend se çfarë më the atë pasdite?

- Ndoshta të kam thënë që të martoheshe me Sara Bankroftin dhe ta braktisje Byronë.

- Paske kujtesë të mirë.

- Çfarë do të thuash?

- Jo, po mendoja, a je ende me idenë se unë duhet të heq dorë nga Byroja?

Gabrieli ngurroi për pak para se më në fund të përgjigjej: - Unë nuk do ta bëja, po të isha në vendin tënd.

- Përse jo?

- Sepse, po u bëra unë drejtor, të pret një e ardhme e ndritur, Mikail. Shumë e ndritur.

Mikaili kroi kokën.

- Më duhet të rruhem, - tha ai.

- Po, duhet të rruhesh.

- Je i sigurt që nuk do pak shampanjë?

- Jo, më bën me dhembje koke.

- Edhe mua, - tha Mikaili dhe mbushi edhe një gotë tjetër.

Para se të largohej nga suita e hotelit, Gabrieli i instaloi Mikailit një pajisje të Byrosë në celular, e cila transmetonte gjithçka dhe kalonte të gjitha telefonatat, "e-mail"-et dhe mesazhet në kompjuterët e skuadrës. Pastaj zbriti në holl dhe kaloi disa minuta duke kërkuar ndonjë fytyrë të njohur mes turmës së burrave të pispillosur. Jashtë, stuhia e borës së pasdites kishte mbaruar, por në dritat e rrugës valëviteshin ende me përtesë flokë të dendur dëbore. Gabrieli u nis përmes qytetit, përgjatë një rruge me dyqane prestigjioze të njohur si rruga "Stroget", derisa mbërriti në "Radhuspladsen". Kambanat në kullën e sahatit sapo shënuan orën gjashtë. Mendoi të shkonte njëherë nga hoteli "Imperial", i cili nuk ndodhej shumë larg nga sheshi, pranë Kopshteve Tivoli, por pastaj shkoi në një pallat në dukje të vjetër, në një rrugë me një emër që vetëm një danez mund ta shqiptonte. Kur hyri në apartamentin e vogël të katit të dytë, gjeti Kelerin dhe Eli Lavonin sipër një laptopi "notebook". Prej tij vinin zërat e tre burrave që bisedonin qetësisht në rusisht.

- E zbuluat se kush është ai? - pyeti Gabrieli.

Lavoni tundi kokën.

- Është e habitshme, - tha ai, - por këta të Volgatekut nuk para përmendin emra.

- Mos more!

Lavoni u bë gati t'ia kthente, por u ndal nga një zë. Ai fliste duke

pëshpëritur ngadalë, sikur të ishte në funeral.

- Ky është njeriu ynë, - tha Lavoni. - Kështu flet gjithmonë. Sikur të mendojë se e përgjojnë.

- Në fakt, *po* e përgjojnë.

Lavoni vuri buzën në gaz dhe tha:

- Dërgova një regjistrim të zërit të tij në "Bulevardin Mbreti Saul" dhe u thashë ta kontrollonin në kompjuter.

- Edhe?

- Nuk përputhej me asnjë.

- Dërgojani njëherë Adrian Karterit në Lengli.

- Po sikur ai të kërkojë ndonjë shpjegim?

- Gënjejeni.

Pikërisht atëherë, tre bosët rusë të naftës ia dhanë një të qeshure të hareshme. Kur Lavoni u përkul përpara për të dëgjuar më mirë, Gabrieli shkoi ngadalë te dritarja dhe hodhi një sy në rrugë. Ajo ishte bosh, me përjashtim të një vajze që po ecte në trotuarin e mbuluar nga bora. Ngjashmëria ishte aq e madhe, sa për një çast, Gabrieli desh iu vu pas. Kishte fytyrën si prej alabastri të Madalenës dhe faqet e saj. Rusët vazhdonin të qeshnin. *Me siguri po qeshin me të*, mendoi ai. Mori frymë thellë për të ekuilibruar rrahjet e zemrës dhe priti t'i kalonte zemërimi për Madalenën. Paskëtaj, ajo humbi në errësirë.

43

KOPENHAGEN, DANIMARKË

Forumi u mbajt në qendrën "Bella", një godinë e stërmadhe prej xhami e çeliku, e cila dukej si një serrë gjigante nga jashtë. Një tufë reporterësh kishin mbushur hyrjen, pas një shiriti të verdhë. Shumica e ekzekutivëve që mbërritën, u treguan të zgjuar dhe i shmangën pyetjet e tyre të shumta, por Orlovi jo. Ai ndaloi dhe iu përgjigj disa pyetjeve për rritjen e papritur të çmimit të naftës në botë dhe përfitoi nga kjo për të folur edhe për tema si zgjedhjet në Britani dhe lëvizjen prodemokratike ruse. Gabrieli dhe skuadra e tij dëgjuan çdo fjalë të Orlovit, sepse Mikaili qëndronte në krah të tij, para kamerave, dhe celularin e mbajti gjithë kohën në dorë. Në fakt, ishte pikërisht Mikaili ai që i dha fund fjalimit të Orlovit duke e kapur nga mënga e palltos dhe duke e shtyrë lehtësisht drejt derës së përparme të godinës. Më pas, një reportere angleze do të vinte në dukje se kjo ishte hera e parë që kishte parë dikë të prekte me dorë Orlovin.

Sapo hynë brenda, Orlovi u bë erë. Mori pjesë në të gjitha debatet e mëngjesit në panel, vizitoi të gjitha ekspozitat dhe nuk la dorë pa shtrënguar, përfshirë edhe atë të ndonjërit që e përçmonte.

- Ky është Nikolas Avedoni, - u thoshte të gjithëve me gojën plot. - Është krahu im i djathtë dhe i majtë. Nikolasi është ylli im i veriut.

Gjatë drekës ai ishte në qendër të vëmendjes. Nuk u shërbye alkool dhe as mish derri, për të respektuar delegatët e shumtë nga bota myslimane. Orlovi dhe Mikaili nuk futën asnjë kafshatë në gojë dhe më pas kaluan në panelin e parë të pasdites, një diskutim sipërfaqësor mbi mësimet e marra nga katastrofa e Petrolit Britanik në Gjirin e Meksikës. I pranishëm ishte edhe Genadi Lazarevi, i cili ishte ulur dy radhë pas Orlovit, në të djathtën e tij.

- Si vrasësit, - i pëshpëriti Orlovi Mikailit. - Zëre sikur e ka nxjerrë armën.

Komenti i tij u dëgjua qartazi në apartamentin e vogël ku ndodhej skuadra e Gabrielit. Në fakt, falë aparatit fotografik që Josi nuk e hiqte nga qafa, ata bënë edhe fotografi. Gjatë forumit mëngjesor, Lazarevi ruajti distancën, por me afrimin e pasdites, po i afrohej gjithnjë e më shumë objektivit.

- Ai po pret çastin e duhur, - tha Eli Lavoni.

- Sikur pret që dikush t'ia aprovojë goditjen.

- Nuk ma do mendja t'ia dalë dot, - ia ktheu Gabrieli.

- Ku pret ti të na hapet ndonjë dritare?

- Këtu, - tha Gabrieli duke vendosur gishtin në ngjarjen e fundit të programuar për ditën e parë të Orlovit në Kopenhagen.

- Pikërisht këtu do të veprojmë.

Me ato fjalë, Gabrieli tregoi se skuadrës do t'i duhej të duronte edhe dy orë të tjera të asaj që Kristofer Keleri e përshkroi si "dërdëllitjet për naftën". Ishte një fjalim i mërzitshëm sa më s'ka i një ministri të qeverisë indiane për të ardhmen e fushës së energjetikës dhe nevojat e kombit të dytë me popullsinë më të madhe në botë. Më pas ishte radha e leksionit të presidentit të ri francez mbi taksat, fitimet dhe përgjegjësinë sociale. Më në fund, u zhvillua një diskutim i sinqertë për rreziqet që i kanosen mjedisit nga teknikat e ekstraktimit, të njohura ndryshe si "frakturat hidraulike". Nuk ishte aspak për t'u habitur që Genadi Lazarev nuk mori pjesë në të.

Si rregull, kompanitë ruse të naftës mendonin se mjedisi është bërë për t'u shfrytëzuar dhe jo për t'u mbrojtur.

Pas atij diskutimi, delegatët u nisën në grupe drejt galerisë në katin e fundit, për një pritje të organizuar nga qendra.

Genadi Lazarevi kishte mbërritur aty më herët dhe po fliste me disa ekzekutivë iranianë të naftës në një qoshe të largët të sallës.

Orlovi dhe Mikaili morën nga një gotë shampanjë nga kamerierët që shkonin e vinin dhe zunë vend mes një grupi të hareshëm sipërmarrësish brazilianë. Orlovi i kishte kthyer shpinën Lazarevit, por Mikaili i qëndronte përballë dhe nuk ia shqiste sytë. Ishte pikërisht ai që e pa rusin të ndahej nga grupi i iranianëve dhe të nisej të ecte ngadalë përmes sallës.

- Tani mund të bësh edhe ti një shëtitje, Orlov.

- Ku të shkoj?

- Në Finlandë.

Si një mjeshtër aktrimi, Orlovi nxori celularin nga xhepi i xhaketës së kostumit dhe e afroi në vesh. Pastaj, duke u ngrysur, a thua se nuk arrinte të dëgjonte qartë, u largua enkas në kërkim të një vendi më të qetë për të folur. Gjatë mungesës së Orlovit, Mikaili i ktheu shpinën ish-grupit të Lazarevit dhe nisi të fliste me një prej brazilianëve për mundësitë për të investuar në Amerikën Latine. Por pa kaluar as dy minuta nga biseda, kuptoi se pas tij po qëndronte një burrë. E pikasi nga aroma e fortë e kolonjës që i mbyti të gjitha aromat e tjera përreth, por edhe nga vështrimi i brazilianit. Kur u kthye, u gjend ballë për ballë me fytyrën që kishte mbushur të gjitha muret e selisë së tyre në *Grayswood*. Trajnimi dhe eksperienca bënë që atij të mos i dridhej qerpiku nga kjo përballje.

- Më falni që ju ndërpres, - tha njeriu përballë tij me një anglishte me theks rus, - por desha të prezantohesha para se të rikthehet Viktori. Unë quhem Genadi Lazarev, përfaqësoj kompaninë e gazit dhe të naftës "Volgatek".

- Unë quhem Nikolas, - tha Mikaili duke zgjatur dorën. - Nikolas Avedon.

- E di se kush je, - tha Lazarevi duke vënë buzën në gaz. - Në fakt, unë di gjithçka për ty.

Biseda që pasoi zgjati një minutë e njëzet e shtatë sekonda. Cilësia e regjistrimit ishte shumë e mirë, nëse përjashtoje zhurmat e zërave përreth

dhe një ding-dong të vazhdueshëm, të cilin skuadra e cilësoi si rrahjet e zemrës së Mikailit. Në fakt, edhe zemra e Gabrielit po rrihte fuqishëm teksa dëgjonte bisedën e tyre nga fillimi deri në fund. Kur shtypi butonin "luaj" dhe e dëgjoi bisedën për herë të gjashtë, atij sikur i kishte ikur fare pulsi.

- Unë e di se kush je. Në fakt, unë di gjithçka për ty.

- Ashtu? Si është e mundur?

- Ne kemi ndjekur me vëmendje disa lëvizje që ke bërë me portofolin e Viktorit dhe na ke lënë mbresa.

- Ju?

- Volgatekut, pa dyshim. Natyrisht që e kisha fjalën për kompaninë "Volgatek".

- Klima e biznesit në Rusi ndryshon shumë nga ajo në Perëndim. Përemrat vetorë mund edhe të keqkuptohen nganjëherë.

- Qenke shumë diplomat.

- Duhet të jem medoemos. Unë punoj për Viktor Orlovin.

- Ndonjëherë duket sikur punon Viktori për ty.

- E po, pamja të gënjen, zoti Lazarev.

- Domethënë, thashethemet që qarkullojnë për ty nuk janë të vërteta?

- Cilat thashetheme?

- Ato që thonë se ke marrë në kontroll punët e Orlovit. Ato që thonë se Viktori është kthyer në një manekin në duart e tua.

- Viktori është ende strategu i gjithçkaje. Unë jam vetëm njeriu që shtyp butonat dhe tërheq levat.

- Qenke besnik, Nikolas.

- Po, kjo është e vërtetë.

- Më pëlqejnë njerëzit besnikë. Edhe unë jam besnik.

- Por nuk u treguat besnik ndaj Viktorit.

- Kuptoj se Viktori të paska folur për mua.

- Vetëm në një rast.

- Nuk besoj se do ketë folur për mirë.

- Tha që jeni shumë i zgjuar.

- Si kompliment e tha?

- Jo.

– Nuk e mohoj që unë dhe Viktori kemi pasur mosmarrëveshje, por ato kanë kaluar tashmë. Unë e kam respektuar gjithmonë mendimin e tij, sidomos kur bëhet fjalë për zgjedhjen e njerëzve që mban pranë. Ai ka nuhatje për talentet, prandaj kisha dëshirë të njihesha me ty. Do të doja shumë të bisedonim pak.

– Po ia them Viktorit këtë.

– Nuk e kisha fjalën për Viktorin, por për ty.

– Unë jam punonjës i "Investimeve Viktor Orlov", zoti Lazarev. Nuk ka Nikolas Avedon, të paktën jo kur bëhet fjalë për paratë e Viktor Orlovit.

– Ajo për çka dua të flasim nuk ka lidhje me paratë e Viktorit, por me të ardhmen tënde. Mund të më falësh vetëm disa minuta nga koha jote para se të largohesh nga Kopenhageni?

– Kam frikë se e kam programin shumë të ngjeshur.

– Mbaje njëherë kartëvizitën time, Nikolas. Pas saj ndodhet numri im personal i celularit. Të premtoj se nuk do të pendohesh. Mos më zhgënje. Nuk para kam qejf kur më zhgënjejnë.

Gabrieli shtypi butonin "ndalo" dhe pa nga Eli Lavoni.

- Më duket se e kemi shtënë në dorë, - tha Lavoni.

- Ndoshta, - ia ktheu Gabrieli, - ose ndoshta na ka shtënë Genadi ne në dorë.

- Fundja, takimi me të nuk na sjell asnjë të keqe.

- Nuk i dihet, - tha Gabrieli. - Mund të na sjellë edhe ndonjë të keqe të madhe.

Gabrieli shtypi butonin e kthimit pas dhe e çoi në fillim.

– Unë e di se kush je. Në fakt, unë di gjithçka për ty.

Shtypi butonin "ndalo".

- Kjo është vetëm një figurë letrare, - tha Lavoni, - asgjë më shumë.

- Je i sigurt për këtë, Eli? Je njëqind për qind i sigurt?

- Jam shumë i sigurt dhe kam shumë besim se Mikailin nuk ka për ta gjetur asgjë nëse pi një gotë me Genadi Lazarevin.

- Patjetër, nuk do ta gjejë gjë nëse Lazarevi nuk i hedh bar miu në gotë.

Gabrieli mori mausin e kompjuterit, por Lavoni zgjati dorën dhe i tha:

- Mos harro që erdhëm në Kopenhagen vetëm për të siguruar këtë takim. Mos u tërhiq tani.

Gabrieli mori telefonin dhe i ra numrit të celularit të Mikailit.

Në dhomë u përhap tingulli i ziles së Mikailit, i cili përcillej ngase telefoni i tij përgjohej prej aty.

- Lëre për nesër mbrëma, - tha Gabrieli. - Shiko të zgjedhësh një vend të volitshëm, që të mos kemi surpriza.

Gabrieli e mbylli pa thënë asnjë fjalë më shumë dhe dëgjoi teksa Mikaili formonte numrin e Genadi Lazarevit, i cili u përgjigj menjëherë.

- Gëzohem që telefonuat.

- Si mund t'ju ndihmoj, zoti Lazarev?

- Duke darkuar me mua nesër mbrëma.

- Nesër mbrëma e kam lënë me Viktorin.

- Sajoni ndonjë justifikim.

- Ku?

- Do ta gjej unë një vend larg prej këtu.

- Jo *shumë* larg prej këtu, zoti Lazarev. Nuk mund të largohem nga vëmendja e tij për më shumë se një orë.

- Si thoni për në orën shtatë të mbrëmjes?

- Dakord.

- Po ju dërgoj një makinë.

- Unë jam në hotelin "D'Angleterre".

- Po, e di, - tha Lazarevi para se ta shkëputse lidhjen telefonike.

Gabrieli fiku aparatin e regjistrimit të celularit të Mikailit dhe e kaloi në dhomën e Genadi Lazarevit në hotelin "Imperial". Tre rusët po qeshnin si të marrë. *Me siguri po qeshin me atë*, mendoi Gabrieli.

44

KOPENHAGEN, DANIMARKË

Dita e dytë e forumit ishte si një ritransmetim i lodhur i së parës. Mikaili vazhdoi t'i qëndronte Orlovit në krah të djathtë gjatë gjithë kohës, me buzagazin e një njeriu që është gati të kryejë tradhti bashkëshortore. Gjatë koktejit të ceremonisë së pritjes, ai ndenji prapë me grupin e brazilianëve të hareshëm, të cilët u ndien shumë keq kur ai refuzoi ftesën e tyre për të kaluar disa orë të gëzueshme nëpër klubet e natës gjatë mbrëmjes. Pasi kërkoi leje të largohej, ai e largoi Viktorin nga kthetrat e ministrit të Naftës të Kazakut dhe u nisën drejt daljes së pasme ku i priste limuzina e tyre. Priti derisa ishin disa blloqe larg hotelit "D'Angleterre" para se t'i thoshte se nuk kishte fuqi të dilte për darkë atë natë. Foli me aq zë të lartë sa mundej, në mënyrë që fjalët e tij të kapeshin nga çdo përgjues rus që mund të ishte atypari.

- Si quhet ajo? - e pyeti Orlovi, i cili kishte dijeni më së miri për planin e Mikailit.

- Nuk është ashtu, Viktor.

- Po çfarë ke, atëherë?

- Më ka kapur një dhimbje kokë e tmerrshme.

- Shpresoj të jetë diçka kalimtare.

- Me siguri nuk është asgjë më shumë se një tumor në tru.

Kur u ngjit në dhomën e tij, Mikaili bëri edhe disa telefonata në Londër, duke qenë i bindur se po e përgjonin dhe i dërgoi një "e-mail" të mërzitshëm sekretares së tij, që piratët kompjuterikë të Qendrës së Moskës të mendonin se fundja, edhe ai njeri ishte.

Pastaj bëri dush dhe nxori kostumin për mbrëmjen, i cili do të ishte më sfidues nga sa mendonte ai. *Si duhet të vishet dikush që po tradhton punëdhënësin e tij duke u takuar me drejtuesin e një kompanie nafte në pronësi të Shërbimit Sekret Rus*, mendoi ai. Në fund, e mblodhi mendjen për një kostum të thjeshtë, në ngjyrën gri të sovjetikëve dhe një këmishë të bardhë me mansheta franceze. Vendosi të mos vinte kravatë për të mos u dukur sikur e kishte me shumë qejf atë takim. Pastaj, nëse ata kishin në plan ta vrisnin, nuk donte të vishte diçka që mund të shërbente edhe si armë.

Sipas udhëzimeve të Gabrielit, i la të gjitha dritat e dhomës të ndezura dhe vuri shënimin "Mos më shqetësoni" në derë para se të nisej për te ashensori. Holli ishte mbushur me delegatë. Kur u nis të dilte nga hoteli, pa Josin, reporterin e ri të "Energy Times" që as nuk ekzistonte, duke intervistuar njërin prej iranianëve. Jashtë, një borë e dendur binte sikur të paralajmëronte një stuhi nëpër gjithë sheshin "King's New". Një *Mercedes* i zi *S-Class*, e priste te kthesa. Pranë tij, gati për t'i hapur derën, priste një rus më shumë se dy metra i gjatë. Edhe nëse nuk e kishte emrin Igor, i shkonte shumë për shtat ai emër.

- Ku do të shkojmë? - e pyeti Mikaili kur makina u nis përpara me shpejtësi.

- Për të ngrënë darkë, - ia ktheu shofer Igori.

- Mirë, - i tha Mikaili qetësisht, - faleminderit që më sqarove.

Shoferi rus nuk e dëgjoi komentin e Mikailit, por Gabrielit nuk i shpëtoi asnjë fjalë. Ai ishte në timonin e një *Audi Sedan*-i, të parkuar në anë të një rruge në qoshe të hotelit. Keleri ishte pranë tij, me një kompjuter tablet në prehër. Në ekranin e tij ishte hapur një hartë e Kopenhagenit, në të cilën pozicioni i Mikailit pulsonte me ngjyrë blu. Atë çast, drita po

ecte me shpejtësi drejt sheshit "King's New" e më pas mori për nga një zonë e Kopenhganit që nuk shquhej për restorantet e saj. Gabrieli ndezi makinën qetësisht, pastaj pa dritën blu dhe ndoqi udhëzimet që ajo jepte.

Nuk kaloi shumë për të kuptuar se Mikaili dhe Genadi Lazarev nuk do të darkonin në Kopenhagen atë mbrëmje, sepse disa minuta pasi u largua nga hoteli, *Mercedes*-i i zi doli jashtë qytetit me një shpejtësi që tregonte se Igori ishte mësuar të udhëtonte në stuhi dëbore. Gabrieli nuk kishte nevojë të matej me shpejtësinë skëterrë të asaj makine. Drita blu në ekranin e kompjuterit të Kelerit i tregonte gjithçka për të cilën kishte nevojë.

Pasi kaloi periferinë jugore të Kopenhagenit, drita kaloi në autostradën E20, në rajonin e Danimarkës që njihej me emrin Ziland. Kur autostrada përfundoi dhe dolën në rrugë dytësore, drejt qytetit të vjetër tregtar të Ringstedit, drita u shkëput dhe mori për nga bregdeti. Gabrieli dhe Keleri vazhduan andej dhe pa kaluar shumë e panë veten në një rrugë të ngushtë me dy korsi, në të majtë të së cilës shiheshin ujërat e zeza të "Koge Bay", ndërsa në të djathtë përvijoheshin fusha të mbuluara me borë. Ecën përgjatë asaj rruge për disa kilometra derisa mbërritën në një kompleks vilash të mbledhura ndanë një plazhi shkëmbor të rrahur nga era. Pikërisht aty, drita u ndal. Gabrieli parkoi në anë të rrugës dhe ngriti zërin e kufjeve që kishte në vesh. Dëgjoi që u hap një derë, disa hapa shkelën në rrugicën e gurtë të mbuluar nga bora dhe rrahjet e qeta të zemrës së Mikailit.

Ajo vilë ishte ndër më të bukurat e kompleksit. Kishte një rrugicë në formë U-je, një garazh me çati me tulla të kuqe dhe një kopsht të përparmë të rrethuar nga gardhe me tulla të vogla ngjyra-ngjyra. Dymbëdhjetë shkallë të çonin në një verandë me parmakë të bardhë.

Në të dyja anët e derës së përparme qëndronin dy pemë të vogla të mbjella në vazo, si dy shtylla. Kur u afrua Mikaili, dera u hap dhe prej saj

doli Genadi Lazarevi. Ai kishte veshur një pulovër me golf dhe një xhaketë të trashë të stilit nordik.

- Nikolas! - thirri ai fort, sikur të kishte përballë një njeri të shurdhër. - Eja brenda sa pa marrë ndonjë plevit. Më fal që të solla deri këtu, por nuk para ma ka qejfi të flas për biznes nëpër restorante dhe hotele, - tha ai, i zgjati dorën Mikailit dhe e tërhoqi të kalonte pragun e derës, sikur të ishte duke nxjerrë ndonjë të mbytur nga deti.

Pastaj, pasi e mbylli derën shpejt, i hoqi Mikailit pallton dhe kaloi një çast duke shijuar pamjen e tij, si të ishte një trofe. Pavarësisht nga pasuritë e tij të pamata, Lazarevi kishte ende pamjen e një shkencëtari. Mbante syze optike të rrumbullakëta dhe dukej sikur e kalonte kohën vetëm duke zgjidhur ekuacione matematikore.

- E pate të vështirë t'i përvidheshe Viktorit? - e pyeti ai.

- Aspak, - ia ktheu Mikaili. - Madje, jam i lumtur që e hoqa qafe për disa orë.

- Më duket se ju të dy shkoni mirë me njëri-tjetrin.

- Ashtu është.

- Gjithsesi, ti pranove të vije këtu, - vuri në dukje Lazarevi.

- Ndjeva se duhej të vija.

- Pse?

- Sepse kur të fton një njeri si Genadi Lazarev, bën mirë të pranosh.

U duk qartazi që fjalët e Mikailit ia përkëdhelën sedrën Lazarevit. Kjo tregonte se rusët nuk ishin imunë ndaj miklimeve.

- Nuk i the se ku do të shkoje?

- Natyrisht që jo.

- Shumë mirë, - tha Lazarevi duke i rënë shpatullave Mikailit. - Eja të pimë nga një gotë tani. Kështu njihesh edhe me të tjerët.

Lazarevi e shoqëroi Mikailin në një dhomë të madhe me pamje nga deti. Atje e prisnin dy burra të tjerë, në një heshtje të nderë, nga ato që të bëjnë të mendosh se pas pak mund të plasë sherri. Njëri po mbushte një gotë në banak dhe tjetri po ngrohej pranë oxhakut. Ai që ishte te banaku kishte një mjekër të dendur dhe flokë gjithaq të dendur dhe të thinjur, të krehur pas koke. Burri te zjarri nuk dukej mirë sepse i kishte kthyer shpinën derës.

- Ky është Dimitri Bershov, - tha Lazarevi duke bërë me dorë nga njeriu te banaku. - Me siguri e ke dëgjuar emrin e tij. Dimitri është i dyti pas meje.

- Po, patjetër, - ia ktheu Mikaili duke shtrënguar dorën që zgjati ai. - Gëzohem që ju njoh.

- Gjithashtu, - ia ktheu Bershovi.

- Ndërsa ai atje, - tha Lazarevi duke treguar nga burri pranë oxhakut, - është Pavel Zhirovi. Paveli merret me sigurinë dhe punët e tjera të pista që duhen bërë. Apo jo, Pavel?

Burri pranë oxhakut u kthye ngadalë dhe e pa Mikailin drejt e në sy. Kishte veshur një triko leshi të zezë dhe pantallona ngjyrë kaki. Flokët biondë i kishte të prerë shkurt, fytyrën katrore dhe një gojë të vogël në dukje mizore, që i binte shumë në sy.

Mikaili e kuptoi sakaq që e kishte parë diku atë fytyrë. Po, e kishte parë në fotografinë e bërë në restorantin në Korsikë, disa orë para zhdukjes së Madalena Hartit. Tani, fytyra e tij e ndriçuar nga flakët e zjarrit, u bë edhe më e qartë.

- Mos jemi takuar ndonjëherë ne? - e pyeti Zhirovi teksa i shtrëngonte dorën.

- Nuk ma do mendja.

- Më dukeni fytyrë e njohur.

- Ma thonë shpesh këtë.

Buzëqeshja e Zhirovit u shua dhe picërroi sytë për një hop, para se ta pyeste.

- Keni telefon me vete?

- Unë nuk e ndaj telefonin as kur bëj dush.

- Ju vjen keq ta fikni, ju lutem?

- Është e domosdoshme?

- Po, - ia ktheu ai, - hiqni edhe baterinë. Kujdesi nuk është asnjëherë i tepërt këto kohë.

Tridhjetë sekonda më pas, drita blu në ekranin e tabletit, u shua. Gabrieli hoqi kufjen nga veshi dhe u ngrys.

- Çfarë ndodhi? - pyeti Keleri.

- Mikaili u zhduk.

- Çfarë do të thuash me këtë?

Gabrieli i shpjegoi ato që dëgjoi, pastaj nxori celularin nga xhepi i xhaketës dhe i telefonoi Eli Lavonit. Folën për pak sekonda në hebraisht dhe me gjuhë të koduar.

- Si është puna? - pyeti Keleri pasi Gabrieli mbylli telefonatën.

- Disa tipa të SVR-së nga *rezidentura* e Kopenhagenit po kontrollojnë dhomën e Mikailit në hotelin "D'Angleterre".

- Gjë e mirë është kjo?

- Shumë e mirë.

- Je i sigurt?

- Jo.

Gabrieli e futi sërish telefonin në xhep dhe hodhi sytë nga dritarja, drejt plazhit të ngrirë. *Pritja*, mendoi. *Kjo pritje e përhershme*.

45

ZEALAND, DANIMARKË

Tavolina ishte mbushur me gostitje tipike ruse. Një Zot e di se kush e kishte përgatitur ushqimin, sepse në shtëpi nuk dukej asnjë gjurmë e ndonjë njeriu tjetër përveç tre rusëve. Mikaili mendoi se si kishin arritur ta blinin atë vilë në një kohë aq të shkurtër. *Jo*, mendoi përfundimisht. *Me siguri ajo duhej të ishte ndonjë prej celulave të Volgatekut ose të SVR-së. Ose mund ta kishin blerë prej kohësh*. Për momentin, ushqimi shërbente vetëm si dekorim në dhomë. Mikaili mbante në dorë një pije, - vodka, natyrisht, - dhe për ta nderuar i kishin ofruar një karrige me pamje nga deti. Dimitri Bershov, atleti i Lazarevit, bënte ecejake të ngadalta, por me vendosmëri, nëpër dhomë. Pavel Zhirovi, ruajtësi i sekreteve të Volgatekut dhe rrëmbyesi i Madalenës, ia kishte ngulur sytë tavanit, a thua se po llogariste me mend se sa litar duhej për të varur Mikailin. Në fund, vështrimi i ngultë i Zhirovit ra mbi Genadi Lazarevin, i cili kishte zënë vend pranë oxhakut dhe ia kishte ngulur sytë flakëve të zjarrit duke menduar se ç'përgjigje t'i jepte pyetjes që i kish bërë Mikaili disa çaste më parë: "Përse më keni thirrur?".

- Përse *të kemi* thirrur? - u përgjigj rusi më në fund.

- Po, unë erdha sepse më thirrët ju.

- Ti i pranon gjithmonë ftesat e armiqve të njeriut që të mban me

bukë? - pyeti Lazarevi duke u kthyer ngadalë për të dëgjuar përgjigjen e Mikailit.

- Për këtë më thirrët? - ia ktheu Mikaili pas pak. - Doni të më punësoni për të spiunuar Viktorin?

- Më dukesh shumë i familjarizuar me gjuhën e spiunazhit, Nikolas.

- Më pëlqen të lexoj.

- Çfarë librash lexon ti?

Mikaili e uli gotën në tavolinë qëllimisht.

- Ky takim më duket se po merr trajtën e një pyetësori, - tha ai qetësisht. - Nëse nuk ju vjen keq, do të doja të kthehesha në hotelin tim tani.

- Ky do të ishte një gabim nga ana jote, - ia ktheu Lazarevi.

- Përse?

- Sepse do të ikje pa dëgjuar ofertën time.

Duke buzëqeshur, Lazarevi mori gotën e panisur të Mikailit dhe e ktheu për t'u freskuar në kovën me akull. Mikaili pa nga Pavel Zhirovi. Me sytë e imagjinatës, ai e pa atë me kostumin e lehtë veror, të cilin e kishte veshur për të drekuar në restorantin "Les Palmiers" në *Kalvi*. Kur i rikthyen gotën, Mikaili e fshiu atë imazh nga mendja siç fshihet shkrimi me shkumës në tabelën e zezë dhe pa vetëm nga Lazarevi. Ai kishte mbledhur vetullat, sikur të ishte duke zgjidhur një ekuacion të vështirë.

- Të vjen keq nëse e zhvillojmë pjesën tjetër të bisedës në rusisht? - e pyeti ai më në fund. - Një zog më pëshpëriti se njohuritë e tua në rusisht janë të shkëlqyera.

- Çfarë zogu ishte ai?

- Një mik nga Gazpromi, - tha të vërtetën Lazarovi. - Ai kishte biseduar pak me ty në Pragë, kur shkove atje me Viktorin.

- Sa shpejt fluturuakan fjalët mes jush, si zogjtë.

- Nikolas, në Moskë nuk ka sekrete.

- Më kanë thënë.

- Në shkollë e ke mësuar rusishten?

- Jo.

- Domethënë, e ke mësuar në shtëpi.

- Me siguri.

- I ke prindërit rusë?

- Edhe gjyshërit, - ia ktheu Mikaili.

- Po si përfundoi familja jote në Angli?

- Si të gjithë të tjerët.

- Çfarë do të thuash me këtë?

- Ata u larguan nga Rusia pas rënies së carit dhe u shpërngulën në Paris. Më pas, në Londër.

- Borgjezë ishin të parët e tu?

- Nuk ishin bolshevikë, nëse doje të dije këtë.

- Po, atë doja të dija.

Mikaili i peshoi mirë fjalët që pasuan:

- Stërgjyshi im ishte një biznesmen deri diku i suksesshëm, i cili nuk donte të jetonte në sistemin komunist.

- Si quhej ai?

- Mbiemri i familjes sime ka qenë Avdonin, por më pas e ndërruan dhe e bënë Avedon.

- Pra, emri yt i vërtetë duhej të ishte Nikita Avdonin, - tha Lazarevi.

- Nikolai, - e korrigjoi Mikaili.

- Mund të të thërras Nikolai?

- Po, nëse do, - u përgjigj Mikaili.

Më pas, Lazarevi e pyeti rusisht:

- A ke qenë ndonjëherë në Moskë?

- Jo, - ia ktheu Mikaili në gjuhën e tij.

- Përse jo?

- Nuk kam pasur arsye për të shkuar.

- Nuk ke qenë asnjëherë kureshtar ta njohësh atdheun tënd?

- Atdheu im është Anglia, - tha Mikaili. - Rusia është vendi të cilin familja ime e braktisi.

- Ti ke qenë kundër Bashkimit Sovjetik?

- Unë isha shumë i vogël për gjëra të tilla.

- Po për qeverinë e tanishme ç'mendim ke?

- Çfarë doni të dini?

- Je edhe ti si Viktor Orlovi, që mendon se presidenti është një kleptokrat?

- Mund të mos e besoni, zoti Lazarev, por unë dhe Viktori nuk flasim asnjëherë për politikë.

- Jo, të besoj për këtë.

Mikaili nuk foli më dhe Lazarevi nuk e ngacmoi më tej, por në vend të kësaj, hodhi sytë nga Bershovi dhe Zhirovi para se të kthehej sërish nga Mikaili, këtë herë për t'i folur anglisht.

- Me siguri ke lexuar për marrëveshjen e Rusisë me qeverinë angleze për të marrë leje për të hapur puse nafte në Detin e Veriut.

- Në dy zonat naftëmbajtëse të sapozbuluara në Ishujt Perëndimorë, - tha Mikaili sikur të lexonte lajmet, - të cilat parashikohet të nxjerrin me përafërsi njëqind mijë fuçi naftë në ditë.

- Mbresëlënëse!

- Kjo është puna ime, zoti Lazarev.

- Jo, në fakt, është puna *ime*, - tha Lazarevi, heshti pak e më pas shtoi: - por unë do të doja të ishe *ti* në krye të saj.

- Në krye të projektit të Ishujve Perëndimorë?

Lazarevi pohoi me kokë.

- Më vjen keq, zoti Lazarev, - tha Mikaili me mospërfillje, - por unë nuk jam menaxher projektesh.

- Ke bërë të njëjtën gjë me naftën e KBS-së në Detin e Veriut, apo jo?

- Pikërisht për këtë arsye nuk dua ta bëj më. Pastaj, aktualisht kam një kontratë me Viktorin, - tha Mikaili duke u ngritur në këmbë. - Të më falni nëse nuk mund të qëndroj për darkë, zoti Lazarev, por më duhet të kthehem.

- Pa e dëgjuar të plotë ofertën time?

- Nëse ka lidhje me këtë që sapo dëgjova, - tha Mikaili me seriozitet, - nuk jam i interesuar.

Lazarevi bëri sikur nuk i dëgjoi fjalët e tij dhe vazhdoi:

- Nikolai, sikundër je në dijeni, Volgateku po zgjeron veprimtarinë e tij në Europë e më gjerë. Për ta realizuar këtë me sukses, na nevojiten njerëz të talentuar si ti. Njerëz që arrijnë të kuptojnë Perëndimin *dhe* Rusinë.

- Kjo ishte oferta juaj?

Lazarevi bëri një hap përpara dhe i hodhi krahun Mikailit.

- Ishujt Perëndimorë janë vetëm fillimi, - tha ai, sikur në dhomë të ishin vetëm ata të dy. - Dua të më ndihmosh të ngre një kompani nafte me kapacitet global. Do të të bëj të pasur, Nikolai Avdonin, aq të pasur sa nuk e ke parë as në ëndërr.

- Unë jam i kënaqur me ato që kam.

- Unë e njoh Viktorin. Me siguri ai të jep vetëm thërrime nga fitimet e tij, - tha Lazarevi duke vënë buzën në gaz. - Eja në Volgatek, Nikolai. Kthehu në vendin tënd.

Skaji jugor i "Koge Bay"-t nuk është nga ato vende ku dy burra mund të qëndrojnë gjatë pa rënë në sy, me një makinë të parkuar në një cep, kështu që Gabrieli dhe Keleri udhëtuan deri në qytetin më të afërt dhe u ulën në një prej restoranteve të vogla e të ngrohta ku shërbehej ushqim italian dhe kinez. Keleri hëngri sa për të dy, ndërsa Gabrieli mori vetëm një çaj të zi. Kufja në veshin e tij vazhdonte të ishte në heshtje dhe në mendjen e tij endej imazhi i Mikailit duke marshuar drejt vdekjes nëpër një pyll mështeknash të mbuluar nga bora. Nga frika dhe meraku, dy herë u mat të ngrihej, por të dyja herët Keleri i tha të ulej e të priste.

- Ti e bëre punën tënde, - i tha Keleri qetësisht, me një buzëqeshje të shtirur në fytyrën e tij të nxirë mirë nga dielli. - Tani duhet të presësh.

Më në fund, një orë e tridhjetë e tre minuta pasi Mikaili kishte hyrë në vilën në buzë të detit, Gabrieli dëgjoi një kërcitje të mprehtë elektronike në vesh, që u pasua nga një zhurmë ere - e njëjta që kishte dëgjuar edhe në xhamat e ngrirë të dritares së makinës së tij. Pastaj, dëgjoi zërin e Mikailit, të hollë si thëllima e erës:

- Do të mendohem, Genadi. Do ta mendoj seriozisht.

- Mos u mendo gjatë, Nikolai, sepse oferta ime skadon shpejt.

- Sa kohë kam në dispozicion?

- Do të preferoja të më ktheje një përgjigje brenda javës. Përndryshe më duhet të kërkoj dikë tjetër.

- Po nëse pranoj?

- Do të të marr në Moskë për disa ditë që të njihesh me pjesën tjetër të skuadrës. Nëse mbetemi të dy të kënaqur, kalojmë në hapin e radhës. Në të kundërt, vazhdo me Viktorin dhe zëre sikur nuk jemi takuar kurrë bashkë.

- Po pse duhet të vij në Moskë?

- Ke frikë të vish në Moskë, Nikolai?

- Natyrisht që jo.

- Nuk duhet të kesh. Paveli do të kujdeset për ty atje.

Ato ishin fjalët që mbyllën bisedën mes tyre. Paskëtaj, u dëgjua një përplasje dere, ndezja e një motori makine dhe drita blu në tabletin e Gabrielit nisi të lëvizte. Kur iu afrua koordinatave të restorantit, Gabrieli ktheu kokën dhe pa një *Mercedes* të zi të kalonte si era para syve të tyre. Mikaili kishte mbijetuar. Tani duhej vetëm të largohej nga deti dhe të kthehej në shtëpi.

Rruga e kthimit për në Kopenhagen zgjati dyzet e pesë minuta dhe gjatë saj nuk ndodhi asgjë, saqë Gabrieli u mërzit. Ai la Kelerin në timon që të përqendrohej për të dëgjuar kufjen që kishte në vesh. Nuk ndihej asnjë tingull vjetër veç zhurmës së motorit të *Mercedes*-it dhe një trokitjeje monotone. Në fillim Gabrieli kujtoi se ishte ndonjë defekt i makinës, pastaj e kuptoi se ishte Mikaili, i cili po trokiste gishtin në mbështetëse, gjë që e bënte gjithmonë kur ishte i sëkëlldisur.

Megjithëkëtë, kur doli nga makina para hotelit "D'Angleterre", Mikaili dukej si njeriu më moskokëçarës në botë. Kur hyri në holl, pa grupin e brazilianëve duke pirë në bar dhe vendosi t'u bashkohej që pastaj ta zinte gjumi rehat. Paskëtaj, u ngjit në dhomën e tij ku nuk vuri re asnjë gjurmë të kontrollit profesionist që ishte kryer gjatë mungesës së tij. Edhe laptopi i tij, i cili iu nënshtrua një kontrolli të imtësishëm dixhital, ishte ashtu siç e kishte lënë. Ai e përdori për t'i dërguar një përmbledhje të shkurtër skuadrës. Kur Gabrieli dhe Keleri u kthyen në celulën e tyre në rrugën me emër të pashqiptueshëm, Eli Lavoni e kishte printuar atë dhe e mbante në dorë.

- Ia dole, - tha Lavoni. - E kape!

- Kë? - pyeti Gabrieli.

- Polin, - ia ktheu Lavoni buzagaz. - Pavel Zhirovi i kompanisë së naftës dhe gazit "Volgatek" është *Poli*.

Debati që pasoi ishte ndër më të ashprit në historinë e skuadrës së Gabrielit, megjithatë u mbyll aq qetësisht sa Keleri zor se e kuptoi që ndodhi. Si rrallëherë, grupi u nda në dy dyshe, me Jakovin që kryesonte dyshen rebele. Çështja e tij ishte e thjeshtë dhe e mbrojtur me shumë pasion. Ata kishin pranuar të bëheshin pjesë e operacionit vetëm për një arsye: për të gjetur prova se rusët kishin rrëmbyer Madalena Hartin si pjesë e komplotit të tyre për të marrë naftën e britanikëve. Tani që ajo provë gjendej në dhomën e hotelit "Imperial" dhe mbante emrin Pavel Zhirov, shefi i sigurisë së Volgatekut dhe një prej kriminelëve të Qendrës së Moskës, gjithnjë nëse ajo ekzistonte vërtet. Sipas Jakovit, nuk u mbetej veçse të vepronin me shpejtësi, përndryshe Zhirovi do t'u rrëshqiste nga duart përgjithmonë.

Për fatin e keq të Jakovit lideri i grupit tjetër ishte drejtori i ardhshëm i Byrosë, Gabriel Aloni dora vetë, i cili me qetësi i shpjegoi të gjitha arsyet pse Pavel Zhirovi do të largohej nga Kopenhageni sipas programit të tij, mëngjesin tjetër. Ai i tha se nuk kishin kohë të mjaftueshme për të planifikuar një operacion të mirëfilltë dhe as të gjenin një mundësi të pastër për ta kapur aty për aty Zhirovin. Operacionet e menjëhershme ishin gjithnjë me rrezik dhe një operacion i menjëhershëm dhe i paplanifikuar ishte si një recetë shkatërrimi, të cilën Byroja nuk mund t'ia lejonte vetes në atë çast. Pavel Zhirovi duhej lënë të largohej dhe nëse lindte nevoja, Byroja do t'i mbante edhe valixhet.

Kështu, në orën dhjetë të mëngjesit tjetër, Pavel Zhirovi, ose Poli, doli nga porta e hotelit "Imperial" në shoqërinë e Genadi Lazarevit dhe Dimitri Bershovit. Ata shkuan bashkë në aeroportin e Kopenhagenit, me një limuzinë dhe më pas hipën në një avion privat për në Moskë. Josi bëri një fotografi të fundit gjatë nisjes, fotografi për një gazetë që nuk ekzistonte dhe më pas u nis edhe ai për në Londër. Atë mbrëmje ai dhe anëtarët e tjerë të skuadrës u mblodhën sërish rreth Gabrielit në bazën e tyre në *Grayswood*. Ai tha se Nikolai Avdonini do të shkonte në qytetin e heretikëve për një intervistë pune. Skuadra do të shkonte bashkë me të.

46

GRAYSWOOD, SURREY

Telefonata mbërriti me anë të linjës së sigurt atë pasdite vonë. Gabrieli mendoi njëherë ta injoronte, por mesazhi ishte i qartë. Nëse nuk shkonte, do t'i hiqej automatikisht e drejta e veprimit. Kështu, në orën gjashtë të po asaj mbrëmjeje ai u nis me përtesë drejt qendrës së Londrës dhe hyri në ambasadën e Izraelit nga porta e pasme. Ambasadori, një karrierist me emrin Natan, po e priste me padurim në holl. Ai e shoqëroi Gabrielin poshtë shkallëve për te E Shenjta e të Shenjtave dhe më pas u largua fluturimthi, sikur të ndiente t'i kanosej një rrezik i madh. Dhoma ishte bosh, por mbi tavolinë ishte një tabaka e mbushur me antipasta dhe ëmbëlsira me gjalpë vjenez. Ishte edhe një shishe me ujë pa gaz, të cilën Gabrieli e kyçi në një dollap aty pranë. E bëri këtë nga forca e zakonit. Rregullorja e Byrosë e përcaktonte qartë se vendtakimet duheshin spastruar nga çdo objekt që mund të shërbente si armë.

Kaluan njëzet minuta dhe askush nuk hyri në dhomë. Pastaj, më në fund, u shfaq një burrë me fizikun e një mundësi. Kishte veshur një kostum të errët që dukej sikur e kishte një masë më të vogël nga sa duhej për trupin e tij dhe një këmishë me jakë të lartë që e bënte të dukej sikur ia kishin ngulur kokën në qafë. Flokët duhej t'i kish pasur dikur në ngjyrë

të çelur, por tanimë shkëlqenin nga thinjat e argjendta dhe i kishte të prera shkurt, si për të fshehur faktin se koha e tij po skadonte me shpejtësi marramendëse. Ai ia nguli sytë për një çast Gabrielit përmes syzeve të vogla, a thua se po mendonte ta vriste në vend apo të priste edhe pak, pastaj eci deri te tabakaja e ushqimeve dhe tundi kokën ngadalë.

- A thua ta dinë armiqtë e mi?

- Çfarë, Uzi?

- Që unë nuk i rezistoj dot ushqimit të mirë, sidomos kur është kështu, - tha Navoti duke marrë një biskotë me gjalpë nga tabakaja.

- Kam përshtypjen se kjo punë është gjenetike. Edhe gjyshi im vdiste për biskota me gjalpë dhe i shoqëronte gjithmonë me një filxhan kafeje të mirë vjeneze.

- Më mirë të kesh merak ëmbëlsirat sesa bixhozin ose femrat.

- Posi, një fjalë goje është! - u përgjigj Navoti me keqardhje. - Edhe ti je si Shamroni. Nuk keni asnjë dobësi. Nuk ke ku t'ju kapësh, - tha ai, heshti pak dhe pastaj shtoi: - Ti je i patëmetë, Gabriel.

Gabrieli e kuptoi sakaq se ku donte të dilte Navoti dhe heshti teksa ai kundronte biskotën me gjalpë sikur ajo të ishte zgjidhja e të gjitha problemeve të tij.

- Por ma do mendja se edhe ti *duhet ta kesh një* pikë të dobët, - tha Navoti më në fund. - Fundja, ke qenë gjithnjë sentimental dhe kjo ka ndikuar edhe në vendimet që ke marrë. Duhet të heqësh dorë nga kjo kur të marrësh drejtimin e Byrosë.

- Kjo nuk është çështje personale, Uzi.

Navoti i dha një buzëqeshje nga ato të shtirurat e tij dhe tha:

- Pra, nuk do ta mohosh që Shamroni të ka premtuar se do të të bëjë drejtor të Byrosë?

- Jo, - ia ktheu Gabrieli, - nuk e mohoj.

Navotit nuk i ishte shuar ende buzëqeshja nga buzët.

- Ke edhe një pikë tjetër të dobët ti, Gabriel. Je njeri i ndershëm. Më shumë nga ç'duhet. Je shumë i ndershëm për të qenë agjent sekret.

Më në fund, Navoti u ul dhe vendosi krahët e tij të mëdhenj mbi tavolinën e mesit. Sipërfaqja e saj u duk sikur do të shembej nën peshën e tij. Kur e pa, Gabrielit i erdhi ndër mend një pasdite e pakëndshme e shumë

vjetëve më parë, kur ishte takuar me Navotin për një seancë trajnimi për vrasjet me silenciator. Atë pasdite Gabrielit i kishte ikur ngjyra e fytyrës me dhjetëra herë.

- Sa kohë më ka mbetur mua? - e pyeti Navoti.

- Uzi, të lutem. Të mos flasim për këtë.

- Pse jo?

- Sepse asnjëri nga ne nuk do të ndihet mirë.

- Me sa po kuptoj, ti ndihesh fajtor.

- Jo, aspak.

- Sa kohë ke që planifikon të më zësh vendin?

- Uzi, ti më njeh dhe e di mirë që unë nuk e bëj këtë.

- Kujtoja se të njihja.

Navoti shtyu tabakanë me ushqime dhe hodhi sytë rrotull dhomës.

- Po këta, as një shishe ujë nuk vendosnin dot?

- E kishin sjellë, por e kyça unë në dollap.

- Pse?

- Sepse nuk doja që ti të më gjuaje me atë.

Navoti vuri dorën mbi krahun e Gabrielit dhe ia shtrëngoi fort. Gabrielit iu mpi dora në vend.

- Ma merr pak, të lutem, - tha Navoti. - Është më e pakta që mund të bësh.

Gabrieli u ngrit në këmbë dhe shkoi të merrte shishen. Kur u ul përsëri, Navotit dukej sikur i kishte rënë pak inati, por vetëm pak, ama. Ai hoqi tapën prej alumini duke përdorur vetëm gishtin e madh dhe atë tregues dhe mbushi ngadalë përgjysmë një gotë plastike. Gabrielit nuk i mbushi.

- Çfarë kam bërë për ta merituar këtë? - pyeti ai, më shumë sikur i drejtohej vetes sesa Gabrielit. - Unë kam qenë drejtor i mirë, madje shumë i mirë! I kam çuar përpara me dinjitet të gjitha çështjet e Byrosë dhe e kam shpëtuar kombin tim nga shumë ngatërresa të të huajve. A munda ta mbyllja programin e armëve nukleare të Iranit? Jo, nuk munda, ama, as nuk e çova vendin drejt katastrofës dhe ky është objektivi kryesor i një njeriu si unë: duhet të sigurohet që kryeministri të mos e humbasë toruan dhe të mos e çojë vendin drejt konflikteve të panevojshme. Por nejse, ti do t'i mësosh të gjitha këto kur të zësh karrigen time.

Kur pa se Gabrieli nuk ktheu përgjigje, Navoti piu edhe pak ujë, me etjen e një deveje në shkretëtirë. Ai kishte të drejtë për diçka, kishte qenë vërtet një drejtor i mirë. Por mjerisht për të, të gjitha sukseset gjatë mandatit të tij, ia kishte siguruar Gabrieli.

- Ka edhe diçka tjetër që do ta mësosh shumë shpejt, - rimori fjalën ai. - Nuk është e lehtë të drejtosh Shërbimin Sekret të vendit me Shamronin që të rri si çekan mbi kokë.

- Ai e ka për detyrë ta bëjë atë. Ishte Shamroni ai që e ngriti Shërbimin Sekret dhe e bëri atë që është sot.

- Plaku është ai që është... asgjë më shumë se një plak. Bota ka ndryshuar shumë që kur Shamroni u largua nga detyra e kreut të Byrosë.

- Uzi, nuk besoj se po i thua seriozisht këto.

- Më fal, Gabriel, por nuk kam ndër mend të tregoj mëshirë ndaj Shamronit në këto momente. As ndaj teje, për atë punë.

Pas atyre fjalëve, Navoti ra në heshtje. Natani, ambasadori, me sytë të picërruar pas xhamave të zyrës, pa dy burra që e shikonin njëri-tjetrin në sy nga dy anët e tavolinës.

- Edhe sa kohë më ka mbetur?

- Uzi...

- Do të më lejoni ta mbyll mandatin?

- Natyrisht.

- Mos e thuaj sikur nuk mund të më lejoni ta çoj deri në fund, Gabriel, sepse nëse i sheh gjërat me syrin tim tani, gjithçka mund të ndodhë.

- Ti ke qenë drejtor i mirë, Uzi. Më i miri pas Shamronit.

- Po, dhe si po shpërblehem? Duke dalë në pension para kohe? Sepse të gjithë e dimë që brenda "Bulevardit Mbreti Saul" nuk mund të ketë dy drejtorë dhe as zëvendësdrejtor.

- Përse jo?

- Sepse nuk ka ndodhur kurrë më parë.

- Asgjë nga këto nuk ka ndodhur kurrë më parë.

- Më fal, Gabriel, por nuk dua ta mbyll karrierën time me mëshirë.

- Mos ia bëj vetes këtë, Uzi.

- Po më flet si ime më tani!

- Si është ajo, me që ra fjala?

- Mbahet.

- Mund të të ndihmoj për ndonjë gjë?

- Mund të shkosh ta takosh kur të kthehesh. Ajo të ka dashur gjithmonë, Gabriel. Të gjithë të duan ty.

Navoti mori edhe një biskotë. Pastaj edhe një tjetër.

- Sipas llogarive të mia, - tha ai duke e thërrmuar biskotën ndër gishtat e tij, - kanë mbetur edhe katërmbëdhjetë muaj deri në fund të mandatit. Pra, është në dorën time të vendos nëse mund të shkojnë katër nga njerëzit tanë më të mirë në qytetin më të rrezikshëm të botës.

- Ti më dhe leje ta drejtoj unë këtë operacion.

- Natyrisht, më kishin vënë pistoletën në kokë.

- Ende aty e ke.

- E di, prandaj nuk dua të nxitohem. Kështu që po të kërkoj të marrësh frymë thellë e ta mendosh mirë këtë punë.

Në heshtjen që pasoi, Navoti u përkul mbi tavolinë dhe e pa drejt e në sy Gabrielin. Zemërimi në sytë e tij ishte shuar.

- E mban mend çfarë ndodhi herën e fundit që ishim në Moskë, Gabriel, apo e ke harruar?

- I mbaj mend të gjitha, Uzi.

- Edhe unë, - u përgjigj Navoti aty për aty. - Ishte dita më e keqe e jetës sime.

- Edhe e jetës sime.

Navoti picërroi sytë sikur të ishte hutuar vërtet nga fjalët e Gabrielit.

- Atëherë pse dreqin do të kthehesh atje?

Pasi Gabrieli nuk u përgjigj, Navoti hoqi syzet mendueshëm dhe fërkoi lëkurën mbi hundë ku ato i kishin krijuar një si hendek. Syzet, si gjithçka tjetër në trupin e tij, ia kishte zgjedhur gruaja e tij e sertë, Bela. Ajo kishte punuar për pak kohë në Byro, si analiste për Sirinë, dhe e kishte marrë shumë për zemër pushtetin që i dha statusi i së shoqes së drejtorit. Gabrieli kishte dyshuar gjithmonë se ndikimi i saj te i shoqi shkonte përtej zgjedhjes së gardërobës.

- Ka marrë fund, - tha Navoti. - Ti e munde atë, fitove.

- Kë munda?

- Ivanin, - ia ktheu Navoti.

- Kjo nuk ka lidhje me Ivanin.

- Natyrisht që ka. Nëse nuk e kupton këtë, ndoshta nuk duhet ta drejtosh fare këtë operacion.

- Atëherë ma hiq të drejtën.

- Nuk e ke idenë se sa do të doja ta bëja, por kështu do të hapja një luftë që me gjasë e kam të humbur, - tha Navoti, vuri prapë syzet dhe buzëqeshi. - Kjo është diçka tjetër që do të duhet ta mësosh kur të drejtosh Byronë, Gabriel. Duhet të dish kur të hapësh luftë dhe kur jo.

- Unë e kam hapur luftën tanimë.

- Meqenëse unë do të jem drejtori në fuqi edhe për katërmbëdhjetë muaj, e ke bezdi të më tregosh pak planin e kësaj sipërmarrjeje?

- Do ta marr Pavel Zhirovin mënjanë për t'i thënë dy fjalë. Ai do të më tregojë përse rrëmbeu dhe më pas vrau një vajzë të pafajshme për hir të Volgatekut. Gjithashtu, do të më thotë edhe pse Volgateku është fasada e KGB-së. Pastaj do t'i bëj shkrumb e hi, Uzi. Do t'i tregoj botës së civilizuar se kasta aktuale e Kremlinit nuk është aspak më e mirë se ajo e mëparshmja.

- Do të të them një sekret, Gabriel. Bota e civilizuar e di mirë këtë, por nuk i plas fare! Madje është aq e frikësuar për të ardhmen sa do t'i lejojë ata mullatët të realizojnë edhe ëndrrat e tyre nukleare.

Gabrieli nuk foli. Navoti mori frymë thellë i dëshpëruar.

- Ti po thua që do ta detyrosh të rrëfehet?

- Do ta regjistroj madje, - shtoi Gabrieli. - Do ta regjistroj ashtu si regjistroi ai Madalenën para se ta vriste.

- Po sikur të mos flasë?

- Të gjithë flasin, Uzi.

- Po me Kelerin çfarë do të bësh?

- Do ta marr me vete.

- Ai është një vrasës profesionist, i cili dikur deshi të të vriste.

- I kemi lënë pas krahëve ato, Uzi. Pastaj, kam nevojë për ndihmë.

- Çfarë të nevojitet tjetër?

- Pasaporta, viza, rezervime, të zakonshmet, Uzi. Dua gjithashtu që ambasada jonë në Moskë ta vëzhgojë njëzet e katër orë në njëzet e katër Pavel Zhirovin.

- Vetëm kaq?

- Jo, - tha Gabrieli. - Më duhesh edhe ti.

Navoti heshti.

- Këtë nuk e kërkova unë, Uzi.

- E di, - ia ktheu Navoti, - gjithsesi, kjo nuk e lehtëson situatën.

Kur Gabrieli u kthye në bazën në *Grayswood* ishte thuajse mesnatë. Kur hyri në dhomën e tij dhe të Kiarës e gjeti atë të ulur mbi shtrat, me një filxhan çaj mbi komodinë dhe një tufë revistash mode në prehër. Flokët i kishte kapur bisht, por aq shkujdesur sa i vareshin shumë tufa flokësh pas koke dhe kishte vënë syzet e reja moderne që i kishte blerë për të lexuar. Asaj i shkonin syzet, por Gabrielit i pëlqenin më shumë sepse pamja e saj me syze i shtonte shpresat se një ditë mund dukej më pak si e bija dhe më shumë si gruaja e tij.

- Si shkoi? - pyeti ajo pa e ngritur kokën.

- Nëse pushoj pak dhe e marr veten mirë, edhe mund ta rifitoj lëvizshmërinë e dorës së majtë.

- Kaq keq?

- Ai ishte i zemëruar dhe nuk ka faj.

Gabrieli hoqi xhaketën dhe e vendosi në krahët e një karrigeje. Kiara e pa me qortim, pastaj lëpiu gishtin dhe ktheu faqen e revistës.

- Do t'i kalojë, - tha ajo.

- Kjo nuk është nga ato gjëra që kalojnë kollaj, Kiara, dhe as që do të kishte ndodhur sikur ti dhe Shamroni të mos kishit komplotuar pas shpinës sime.

- Nuk shkoi pikërisht kështu, zemër.

- Po si shkoi?

- Kur ti kërkoje Madalenën në Francë, Shamroni erdhi të më takonte. Tha se donte të bisedonte edhe një herë me ty se mos të bindte të pranoje postin e drejtorit të Byrosë dhe më pyeti nëse unë isha dakord për këtë.

- Qenka treguar i sjellshëm.

- Gabriel, mos u zemëro. Ai e dëshiron me shpirt këtë, - tha ajo, u ndal për një çast dhe pastaj shtoi: - Edhe unë.

- Ti? - e pyeti Gabrieli i habitur. - E ke idenë se çfarë do të ndodhë pasi unë të bëj betimin?

- Ne sot jetojmë në një bazë bashkë me tetë njerëz të tjerë, ndër të cilët është edhe dikush që dikur deshi të të vriste. Ma do mendja se mund ta përballoj jetën me ty si drejtor i Byrosë.

Gabrieli u afrua te shtrati dhe shfletoi shkujdesur tufën e revistave të përhapura pranë Kiarës. Njëra prej tyre ishte për gratë shtatzëna. Ai e ngriti, e mbajti para fytyrës së saj dhe i tha:

- Mos do të më thuash ndonjë gjë?

Ajo ia rrëmbeu revistën nga dora pa iu përgjigjur. Gabrieli e pa ngultas për një çast, me dorën në mjekër.

- Mos më shiko ashtu, - i tha ajo.

- Si?

- Sikur të jem pikturë.

- Nuk kam çfarë të bëj.

Ajo buzëqeshi dhe e pyeti:

- Çfarë po mendon?

- Po mendoj që do të doja të ishim vetëm dhe jo në një bazë të fshehtë dhe me tetë persona të tjerë.

- Ndër të cilët edhe dikush që dikur deshi të të vriste, - shtoi ajo. - Por çfarë po mendoje *në të vërtetë*?

- Po mendoja përse nuk më ke thënë ende të mos shkoj në Moskë.

- Edhe unë.

- Përse?

- Sepse ata e mbyllën atë në një makinë dhe e lanë të digjej atje.

- Nuk ka ndonjë arsye tjetër?

- Jo, - ia ktheu ajo. - Nëse po mendon a dua të vij edhe unë me ju në Moskë, përgjigjja ime është "jo". Kam frikë se nuk e përballoj dot të shkoj sërish në atë vend. Mund të bëj ndonjë gabim.

Pa thënë asnjë fjalë, Gabrieli u shtri në shtrat dhe e vendosi kokën në barkun e Kiarës.

- Nuk do të ndërrohesh? - e pyeti ajo.

- Nuk kam fuqi të ndërrohem.

- E ke bezdi nëse unë lexoj edhe pak?

- Mund të bësh çfarë të duash.

Gabrieli mbylli sytë. Tingulli i shfletimit të revistës iu duk si ninullë dhe po e zinte gjumi.

- Të zuri gjumi? - e pyeti dikur ajo.

- Jo, - pëshpëriti ai.

- Gabriel, e dinte ajo se kjo punë do të shkonte deri në Moskë?

- Kush?

- Ajo plaka në Korsikë.

- Po, - tha Gabrieli. - Ma do mendja se po.

- Të paralajmëroi të mos shkosh?

- Jo, - tha Gabrieli dhe brejtja e fajit iu ngul si thikë në zemër. - Më tha se nuk do të më ndodhte gjë atje.

- Pa ndonjë gjë tjetër ajo?

- Po, pa një fëmijë.

- I kujt ishte ai fëmijë? - pyeti Kiara, por Gabrieli nuk e dëgjoi. Atë çast ai po vraponte drejt një gruaje përmes një fushe të mbuluar nga bora. Gruaja po digjej. Dëbora ishte e njollosur me gjak.

47

GRAYSWOOD, SURREY

Uzi Navoti, drejtori i Shërbimit Sekret Izraelit, mbërriti në bazën në *Grayswood* në orën 07:20 të mëngjesit, teksa drita e një mëngjesi gri dhjetori sapo kishte rënë mbi pemët e *Knobby Corpse-it*. Personi i parë me të cilin u ndesh ishte Kristofer Keleri, i cili po ndiqte një top ping-pongu që sapo e kishte gjuajtur Jakovi. Rezultati i lojës ishte tetë me pesë. Kryesonte Jakovi, por Keleri po e ngushtonte ndjeshëm rezultatin.

- Kush je ti? - e pyeti Keleri fytyrën e ngrysur, me syze, që qëndronte në korridor.

- Nuk ka ç'të duhet ty, - ia ktheu Navoti.

- Emër i çuditshëm! Hebraik është?

Navoti u ngrys edhe më shumë.

- Ti duhet të jesh Keleri, - i tha.

- Ai duhet të jem.

- Ku është Gabrieli?

- Shkoi me Kiarën në Gilldford.

- Pse?

- Sepse ne e kishim ngrënë të gjithë peshkun e liqenit.

- Kush mban përgjegjësi për punët këtu tani?

- Pjesa tjetër e skuadrës.

Navoti buzëqeshi me ironi dhe tha:

- E po, tani jo më.

Me mbërritjen e pazakontë të Navotit, në skuadrën e Gabrielit plasi lufta. Ishte një luftë e pashpallur, si të gjitha konfliktet e tyre dhe do të zhvillohej në fushë armiqësore dhe kundër një armiku më të madh në numër dhe më të stërvitur.

Byroja e Izraelit njihej si një prej Shërbimeve Sekrete më të mira në botë, e megjithëkëtë nuk mund të matej me Vëllazërinë e Shpatës dhe Mburojës. Shërbimi Sekret Rus trashëgonte një traditë të hershme vrasjesh të panumërta. Për më shumë se shtatëdhjetë vjet, KGB-ja e kishte mbrojtur komunizmin sovjetik nga armiqtë e vërtetë dhe nga ata imagjinarë, pa pikë mëshirë për askënd, dhe duke mbjellë mijëra agjentë të fshehtë në mbarë botën. Pushteti i tyre nuk njihte kufij dhe KGB-ja vepronte si një shtet virtual brenda shtetit. Me rënien e Bashkimit Sovjetik, ishte ajo shteti. Volgateku ishte kompania e saj e naftës dhe e gazit. Këtë lidhje mes Volgatekut dhe SVR-së Gabrieli nuk reshtte së ia theksuari skuadrës së tij kur ata nisën nga puna. Sipas tij, kompania e naftës dhe e gazit dhe Shërbimi Sekret i Rusisë ishin një dhe kjo tregonte se Mikaili ishte në duart e armikut që në çastin kur u nis nga Londra. Identiteti i tij i rremë kishte qenë aq bindës sa për t'ia hedhur Genadi Lazarevit, por mund të mos e kishte të gjatë në dhomat e hetimit të Lubjankës. Po ashtu edhe Mikaili. Lubjanka është vendi prej nga nuk kthehesh më pas, i paralajmëroi Gabrieli. Lubjanka është fundi.

Gjatë pjesës më të madhe të kohës, Gabrieli mendonte për Pavel Zhirovin, kreun e sigurisë në Volgatek dhe trurin e operacionit për marrjen e naftës në territorin britanik të Detit të Veriut. Brenda njëzet e katër orëve pas mbërritjes së Navotit në bazën në *Grayswood*, ambasada e Izraelit në Moskë dërgoi informatën se Zhirovi jetonte në një apartament të fortifikuar në *Sparrow Hills*, periferinë luksoze të Moskës, përgjatë buzës së lumit të qytetit. Një ditë normale e tij niste në zyrat e kompanisë

Volgatek që ndodheshin në rrugën "Tverskaya", ndërsa pasditen e kalonte në Qendrën e Moskës, në godinën e SVR-së në Jasenevo. Skuadra e vëzhgimit në Moskë kishte arritur t'i bënte Zhirovit disa fotografi duke hyrë dhe duke dalë nga limuzina e tij, por në asnjërën nuk i dukej qartë fytyra. Gabrielit i bëri shumë përshtypje profesionalizmi i rusëve. Ai kishte vërtetuar se ishte një kundërshtar i denjë me operacionin "flamuri i rremë" i rrëmbimit të Madalena Hartit. Gabrieli tha se të kapje atë në rrugët e Moskës do të thoshte të përpiloje një plan po aq të denjë.

- Por me dy ndryshime thelbësore, - shtoi Eli Lavoni, - Moska nuk është Korsika, Pavel Zhirovi nuk do të jetë duke ngarë një motor në një rrugë të izoluar dhe as do të ketë veshur fustan.

- Atëherë besoj se do të na duhet të gjejmë një mënyrë për ta futur Mikailin në makinën e Zhirovit, - ia ktheu Gabrieli, - dhe të ketë pistoletë me vete, natyrisht.

- Si ke ndër mend ta arrish këtë?

- Kështu, - tha Gabrieli, zuri vend në njërin prej kompjuterëve dhe shtypi butonin "luaj" për të dëgjuar fjalët e fundit që Genadi Lazarevi i tha Mikailit në Danimarkë.

- Do të të marr në Moskë për disa ditë që të njihesh me pjesën tjetër të skuadrës. Nëse mbetemi të dy të kënaqur, kalojmë në hapin e radhës. Në të kundërt, vazhdo me Viktorin dhe zëre sikur nuk jemi takuar kurrë bashkë.

- Po pse duhet të vij në Moskë?

- Ke frikë të vish në Moskë, Nikolai?

- Natyrisht që jo.

- Nuk duhet të kesh. Paveli do të kujdeset për ty atje.

Gabrieli shtypin butonin "ndalo" dhe hodhi sytë nga Lavoni.

- Ndoshta e kam gabim, - tha ai, - por dyshoj se mbërritja e Nikolas Avedonit në Rusi nuk do të kalojë pa probleme.

- Çfarë problemesh mund të ketë?

- Nga ato që vetëm Paveli mund t'i zgjidhë.

- Po kur Mikaili të jetë në makinë me të?

- Atje do t'i lërë Pavelit vetëm një zgjedhje.

- Do t'i duhet të zgjedhë mes pranimit me qetësi dhe hedhjes së truve në erë brenda *Mercedes*-it të tij të bukur?

- Diçka e ngjashme.

- Ku shkoi rregulli i artë i Shamronit?

- Cili?

- Ai sipas të cilit nuk duhet të tundim armët në publik.

- Çdo rregull e ka një përjashtim dhe rasti i Pavelit vlen si i tillë.

Lavoni heshti një hop mendueshëm dhe pastaj tha:

- Do të na duhet të marrim edhe shoferin. Përndryshe do të na vihet pas gjithë policia e Rusisë.

- Po, Eli, e di edhe këtë.

- Ku mendon ta marrësh në pyetje atë?

- Këtu, - tha Gabrieli duke shtypur prapë tastierën.

- Bukuri! - tha Lavoni duke parë në ekran. - E kujt është kjo?

- E një biznesmeni rus, të cilit nuk i rrihet më në Rusi.

- Ku jeton ai tani?

- Në një lagje me Shamronin.

Me një të klikuar të mausit Gabrieli e hoqi imazhin nga ekrani.

- Tani na mbetet vetëm një hallkë, - tha Lavoni.

- Si do ta nxjerrim Mikailin nga Rusia?

Lavoni pohoi me kokë.

- Ai do të largohet nga Rusia si një person me identitet tjetër, jo atë të Nikolas Avedonit.

- Po si do t'ia bëjmë?

- Ashtu si bëmë me Eihmanin kur e nxorëm nga Argjentina.

- Me kompaninë ajrore "El Al"?

Gabrieli pohoi me kokë.

- Ç'je një ti! - tha Lavoni.

- Posi! - ia ktheu Gabrieli buzagaz. - Prit se ky është vetëm fillimi!

Navoti e aprovoi menjëherë planin e Gabrielit. Paskëtaj, skuadrës i mbeteshin pesë ditë derisa Mikaili t'i kthente përgjigje Lazarevit nëse do të shkonte në Moskë, apo jo. Kishin pesë ditë kohë për të rishikuar mijëra detaje të mëdha e të vogla, ose, siç tha Lavoni, "pesë ditë për të vendosur

nëse vizita e radhës e Nikolasit në Moskë, do të ishte më e suksesshme se ajo e fundit". Pasaportat, vizat, letërnjoftimet, biletat e avionit dhe planet rezervë duheshin siguruar sa më shpejt. Pastaj duheshin siguruar vendstrehimet, planet B dhe planet B për planet B. Do t'ju duhej të improvizonin në një qytet që përgjatë gjithë historisë së tij të përgjakshme, nuk qe treguar ndonjëherë dashamirës ndaj shpirtrave të lirë.

Gabrieli e mundoi shumë skuadrën e tij gjatë atyre ditëve e netëve të gjata dhe sapo ai kthente shpinën, Navoti e mundonte edhe më shumë. Mes tij dhe Navotit nuk shfaqej ndonjë tension i dukshëm, asnjë gjurmë që njëri ishte në rënie e tjetri në ngritje. Madje disa nga anëtarët e skuadrës mendonin se po dëshmonin një dualitet që mund të mbijetonte kohë pasi Gabrieli të merrte detyrën e drejtorit të Byrosë, që i takonte me të drejtë. Jakovi, më fatalisti i grupit, u tall me situatën duke thënë:

- Është njësoj sikur gruaja e re t'i thotë të vjetrës që nuk ka ndër mend t'ia zërë dhomën. Me pak fjalë, kjo nuk ka gjasë të ndodhë.

Por Eli Lavoni nuk ishte kaq i sigurt. I vetmi aty që besonte se paraardhësi i tij do t'ia lironte lehtë karrigen, ishte Gabrieli. Sipas Lavonit, nëse Gabrieli arriti të pajtohej me Kristofer Kelerin, mund të bënte ndonjë marrëveshje edhe me Navotin.

Fjalët për të ardhmen e Gabrielit reshtën sapo në dhomë hyri Kiara. Fillimisht ajo u orvat të punonte përkrah të tjerëve, por bisedat pa fund për Rusinë ia prishën humorin. Ajo ishte ende gjallë sepse dikur shokët e saj të skuadrës rrezikuan kokën e tyre për të shpëtuar të sajën. Tani, teksa ata diskutonin strategjitë e planit, ajo vendosi të kujdesej për ta. Me gjithë tensionin në shtëpi, ajo u përpoq të sillte pak hare. Çdo mbrëmje përgatiste vakte të mira dhe ngulte këmbë që gjatë darkës të mos flisnin për operacionin, por për ndonjë libër, film a për të ardhmen e vendit të tyre të trazuar. Pastaj, pas ndonjë ore, Gabrieli dhe Navoti ngriheshin në këmbë dhe niste sërish puna. Kiara merrej me kënaqësi edhe me larjen e enëve. E vetme pranë lavamanit, këndonte nën zë për të mbytur zërat e bisedës nga dhoma tjetër. Më pas, i thoshte Gabrielit se vetëm kur dëgjonte fjalën "Rusi", i bëhej një si boshllëk në stomak.

Nikolas Avedoni, njeriu që ishte në qendër të operacionit dukej i pavëmendshëm ndaj përpjekjeve të skuadrës, ose të paktën këtë përshtypje u la të gjithë atyre që e takuan pas mbërritjes së tij në Londër. Ai sillej si një njeri që nuk donte ta fshihte se po shkonte drejt një vendi që shumë të tjerë vetëm e ëndërronin. Orlovi iu përkushtua atij si të ishte djali që nuk e pati kurrë dhe me kalimin e ditëve dukej sikur nuk bënte dot pa të. Përemri "ne" hyri për herë të parë në fjalorin e tij kur foli për një çështje biznesi dhe kjo nuk kaloi pa u vënë re. Ai njoftoi stafin se pjesën më të madhe të muajit janar do ta kalonte në Karaibe.

- Kam nevojë për ca pushime të gjata, - u tha. - Tani që kam Nikolasin, më në fund mund t'ia lejoj vetes.

Kur u pa se Orlovi po tërhiqej, u përhap fjala se tani kompaninë e tij e drejtonte Nikolas Avedoni. Ai u bë shumë i rëndësishëm dhe i pakapshëm, por kur mori një telefonatë nga Xhonatan Ollbrajti i një kompanie me emrin "Markham Capital Advisers", pranoi të shkonte menjëherë. Takimi u zhvillua në zyrat e tij me pamje nga sheshi "Hanover", ndonëse tema e bisedës nuk kishte asnjë lidhje me biznes apo investime. Në mbyllje të takimit, ai i telefonoi një numri në Moskë. Telefonata zgjati tri minuta dhe u duk se u mbyll me lajme të mira. Pastaj ai e shoqëroi zotin Ollbrajt deri te ashensori me një pamje plot vetëbesim.

- Do t'ia them Viktorit, - tha ai me zë të lartë që ta dëgjonin të gjithë, - por nuk besoj të realizohet.

Atë natë, jashtë pallatit të Mikailit në "Maida Vale" u shfaq një makinë. Më pas, Graham Sejmuri e identifikoi shoferin e makinës si njeri të SVR-së nga rezidentura e Londrës. Ai mori pasaportën e rreme të Mikailit dhe e çoi në ambasadën ruse në "Kesington Gardens". Pas një ore, kur ia ktheu, pasaporta ishte vulosur me një vizë ruse. Brenda saj ishte edhe një biletë për të fluturuar me linjën "British Airways" për në Moskë, me nisje nga aeroporti "Heathrow" në orën 10:00 të mëngjesit të së nesërmes.

Mikaili futi biletën dhe pasaportën në çantë, pastaj i telefonoi Orlovit për t'i thënë se duhej të merrte disa ditë pushim.

- Më fal, Viktor, - i tha ai, - por ndihem i rraskapitur. Të lutem, nuk

dua as të më telefononi dhe as të më dërgoni mesazhe elektronike. Dua të mos më shqetësojë askush.

- Sa do të rrish?
- Deri të mërkurën. Maksimumi të enjten.
- Merre më mirë të gjithë javën pushim.
- Je i sigurt?
- Po, të premtoj që nuk do të bëj asnjë gabim gjatë mungesës tënde.
- Faleminderit, Viktor. Je i madh!

Atë natë Mikaili u përpoq të flinte, por më kot. Asnjëherë nuk e zinte gjumi natën para një operacioni. Kështu, pak pasi kishte kaluar ora katër e mëngjesit, ai u ngrit nga shtrati dhe u vesh me petkun e Nikolas Avedonit ose Nikolai Avdoninit, dhe priti. Në orën gjashtë, poshtë pallatit të tij u shfaq një makinë, e cila e shoqëroi për në aeroport ku kaloi kontrollin pa asnjë problem. Kristofer Keleri dhe Dina Saridi i rrinin pas. Kur hyri në portën e nisjes, pa figurën e sëkëlldisur të Gabrielit duke lexuar një kopje te revistës "The Economist", kinse i humbur në të. Mikaili kaloi pranë tij pa ia hedhur sytë dhe më pas hipi në avion, por Gabrieli priti deri pak para se dyert të mbylleshin, pastaj hipi edhe ai dhe shkoi në klasin e parë. Në orën 10:30 avioni hyri në hapësirën ajrore ndërkombëtare. Mikaili luante gishtat me nervozizëm. Tani ai ishte në duart e armikut. Po ashtu edhe drejtori i ardhshëm i Shërbimit Sekret Izraelit.

48

MOSKË

Protestuesit ishin mbledhur në Sheshin e Kuq në grupe të vogla, në mënyrë që të mos i vinin re milicia e Moskës dhe banditët me xhaketa lëkure të FSB-së. Ata ishin artistë, shkrimtarë, gazetarë, këngëtarë, por kishte edhe disa babushka,[12] të cilat ëndërronin t'i kalonin vitet e fundit të jetës në një vend të lirë. Pasdite, turma e njerëzve kishte shkuar në disa qindra vetë e tanimë zor se mund të fshiheshin në petkun e rastësisë. Dikush kishte nxjerrë një pankartë, dikush tjetër një megafon dhe nisi të fliste me akuza, të cilat akuzonin presidentin rus se kishte manipuluar zgjedhjet e fundit. Kjo në fakt, ishte e vërtetë. Më pas, njeriu me megafon bëri shaka me të gjitha gjërat e tjera që besonte se presidenti rus i kishte vjedhur popullit, vetëm se drejtuesit të banditëve me xhaketa lëkure të FSB-së nuk iu duk aspak për të qeshur. Me një lëvizje të lehtë të kokës, ai lëshoi milicinë, njerëzit e së cilës u lëshuan duke rrahur ç'u dilte përpara, përfshi edhe disa nga krerët e lëvizjes. Më keq e pa ai tipi i megafonit. Kur u pa për herë të fundit, ishte i larë në gjak, gjysmë i vetëdijshëm në sediljen e pasme të një furgoni policie. Më pas Kremlini bëri me dije se ai do të akuzohej

[12] Nga rusishtja: gjyshe ose plakë

për shkaktim trazirash, akuzë për të cilën mund të dënoheshe me deri në dhjetë vjet burg në neo-gulag[13].

Shtypi i nënshtruar rus i etiketoi protestuesit si huliganë, etiketim që regjimi sovjetik vinte për të gjithë kundërshtarët e tij. Asnjë gazetar nuk guxoi të kritikonte sjelljen e ashpër të policisë. Ata do të faleshin për heshtjen e tyre. Gazetarët që e mërzisnin Kremlinin ato ditë, përfundonin të gjithë të vdekur.

Mikaili zbriti nga avioni në aeroportin "Sheremetyevo" të Moskës. Tridhjetë sekonda pas tij zbriti edhe Gabrieli. Teksa i afroheshin kontrollit të pasaportave, Gabrieli vuri re një burrë me kostum që qëndronte pranë një polici thatanik me uniformë më të madhe se trupi i tij. Njeriu me kostum mbante në dorë një fotografi, të cilën e pa dy herë derisa u afrua Mikaili. Pastaj i shkoi pranë atij dhe i tha diçka në rusisht, që Gabrieli nuk e kuptoi. Mikaili buzëqeshi dhe i shtrëngoi dorën para se ta ndiqte përmes një dere pa emër.

I vetëm, Gabrieli shkoi drejt sektorit të kontrollit të pasaportave ku e priti një grua fytyrëngrysur, e cila nuk e vulosi pasaportën e tij pa e parë një copë herë të mirë. Pastaj e vulosi fuqishëm dhe ia tundi në fytyrë. *Me siguri kjo do të thotë "Mirë se vjen në Rusi"*, mendoi Gabrieli me ironi e më pas hyri në hollin e mbërritjeve. U ndje mirë që ndodhej sërish aty. Kur doli jashtë aeroportit thithi menjëherë një valë tymi cigareje dhe nafte që ia sollën mendjen vërdallë. Qielli i mbrëmjes ishte i pastër, ajri i ftohtë. Kur hodhi sytë majtas, pa Mikailin dhe eskortën e tij të Volgatekut të rehatoheshin në një *Mercedes* luksoz. Ai u drejtua për nga taksitë. I ftohti i betonit i depërtoi në këpucë dhe kur më në fund hipi në sediljen e pasme të një makine rrangallë të tipit *Lada*, nofulla i kishte ngrirë aq shumë sa nuk mund të fliste. Kur shoferi e pyeti se ku do të shkonte, me zor ia tha emrin e hotelit.

Pasi u larguan nga aeroporti, shoferi u nis për në bulevardin "Leningradsky Prospekt" dhe udhëtoi ngadalë nëpër qendrën e Moskës.

[13] Kampet e të burgosurve politikë në Rusi

Ora kishte kaluar disa minuta nga shtatë dhe qyteti vrasës gëlonte ende nga njerëzit që me gjithë të ftohtin e acartë, ecnin ngadalë. Shoferi u orvat të hynte në bisedë me Gabrielin, por anglishtja e tij ishte aq e rëndë sa edhe trafiku në rrugë. Gabrieli vështronte nga dritarja ndërtesat e epokës sovjetike, të cilat shtriheshin përgjatë bulevardit. Tani, ato ishin thuajse të rrënuara. Në çdo qoshe rruge apo tarracë pallati shihje tabela të mbushura me premtime për luks dhe të ardhme më të mirë. *Ky ishte makthi i komunizmit i veshur me një kapotë të re kapitalizmi,* mendoi Gabrieli.

Më në fund, kaluan "Garden Ring"-un dhe bulevardi "Prospekt" ia la vendin rrugës "Tverskaja", versionit moskovit të bulevardit "Madison". Pastaj morën teposhtë një kodre të gjatë, kaluan zyrat qendrore të Volgatekut që shndrisnin për së largu, e më pas ndanë mureve me tulla të kuqe të Kremlinit, në rrugën "Okhotny". Paskëtaj u kthyen majtas, kaluan me shpejtësi përgjatë "Russian Dumma" dhe teatrit "Bolshoi". Por Gabrieli nuk i kushtoi rëndësi asnjërës prej tyre. Ai kishte sy vetëm për ndërtesën e verdhë që ngrihej në lartësinë e sheshit "Lubjanka".

- KBG-ja, - i tha shoferi, duke treguar me gisht andej.

- Nuk ka më KBG, - ia ktheu në çast Gabrieli. - KGB-ja i përket së shkuarës.

Shoferi diç mërmëriti për naivitetin e të huajve e vazhdoi drejt hyrjes së hotelit "Metropol". Holli i tij ishte restauruar duke ruajtur origjinalitetin, por mesogruaja e recepsionit nuk kishte ndryshuar aspak. Ajo e priti Gabrielin me një buzëqeshje të ngrirë, bëri disa pyetje për natyrën e udhëtimit të tij dhe pastaj i zgjati formularin e regjistrimit, një kopje e të cilit do t'i dërgohej autoriteteve përkatëse. Gabrieli e plotësoi shpejt e shpejt, si Xhonatan Ollbrajti i kompanisë "Markham Capital Advisers" dhe mori çelësin e dhomës së tij. Një portier i tha ta ndihmonte me çantën, por u ndje i lehtësuar kur Gabrieli i tha se mund ta mbante edhe vetë. Megjithëkëtë, ai i dha një bakshish të mirë për mundimin, por kur pa shprehjen në fytyrën e tij pasi ia dha, kuptoi se nuk e njihte mirë valutën ruse.

Dhoma e tij ishte në katin e katërt, me pamje nga bulevardi "Teatranly" me dhjetë korsi. Gabrieli e mori me mend se dhoma përgjohej dhe as që e mori mundimin të kërkonte për përgjues. Në vend të kësaj, u telefonoi

dy klientëve, të cilët në fakt as që ishin klientët e tij, e më pas kontrolloi postën elektronike që ishte mbushur plot gjatë kohës që ai ishte në fluturim. Një mesazh e kishte dërguar një avokat nga Nju Jorku. Ai fliste për taksat e një investimi me ligjshmëri të dyshimtë. Në të vërtetë, atë e kishte dërguar Eli Lavoni, që ndodhej vetëm një kat më poshtë në po atë hotel dhe përmbajtja e vërtetë e tij u shfaq vetëm pasi Gabrieli futi fjalëkalimin e duhur. Me sa dukej, Genadi Lazarevi e kishte çuar kandidatin e tij për punonjës në "O2 Lounge", në "Ritz" për të pirë e për të ngrënë diçka të lehtë. Të pranishëm ishin edhe Genadi Lazarevi, Pavel Zhirovi dhe katër bukuroshe ruse. Fotografitë që shoqëronin mesazhin, i kishin realizuar Jakovi dhe Dina, të cilët ndodheshin në dhomën ngjitur me të tijën.

Gabrieli rifuti fjalëkalimin dhe mesazhi mori formën e tij origjinale. Pastaj vuri një palë kufje dhe hyri në një linjë të sigurt për të përgjuar telefonin celular të Mikailit. Dëgjoi një trokitje gote, të qeshura dhe kakarisjet e bukurosheve ruse, të cilat dukeshin aq të pamenda, edhe pse në një gjuhë që ai nuk e kuptonte. Pastaj dëgjoi zërin e njohur të Genadi Lazarevit t'i pëshpëriste Mikailit në vesh:

- Pusho mirë sonte. Nesër kemi plane të mëdha për ty.

Ata ndenjën në sallon deri në orën njëmbëdhjetë, kur Mikaili u rikthye në suitën e tij luksoze në "Ritz", me një dhimbje koke të tmerrshme. Pavarësisht nga këshilla e Lazarevit, ai nuk vuri dot gjumë në sy atë natë. Në mendjen e tij endeshin vorbulla operacionesh të mëparshme, të lidhura me njëra-tjetrën si në një edicion të jashtëzakonshëm televiziv mbi ngjarjet më katastrofike të shekullit. Donte të bënte diçka, të bënte ndonjë lëvizje, por me siguri që brenda në dhomë kishte kamera të fshehta sigurie dhe nuk lëvizi nga vendi. Ndenji në shtrat, si kufomë, deri në orën 07:00 të mëngjesit, kur më në fund e ngriti zilja.

Kafeja mbërriti disa minuta më pas dhe ai e piu teksa shihte lajmet e biznesit për Londrën. Pastaj u nis për në palestër ku bëri një paraqitje mbresëlënëse nën vëzhgimin e një agjenti të Shërbimit Sekret Rus. Kur u kthye në dhomën e tij, bëri një dush me ujë të ftohtë për t'i kujtuar vetes

se ishte ende gjallë. Pastaj veshi kostumin klasik ngjyrë gri, atë që i kishte zgjedhur Dina te dyqani "Antoni Sinkler" në rrugën "Savile Row". Atë e pa pesëmbëdhjetë minuta më pas kur hëngrën mëngjes në restorant. Ia kishte ngulur sytë Kristofer Kelerit, sikur në ta të fshihej sekreti i lumturisë së përjetshme. Pak tavolina më tutje, Josi po kthente vezët e rrahura duke thënë:

- Unë nuk i kërkova kështu.

Vërejtja e tij e vuri shumë në siklet kamerierin, i cili tha sakaq:

- Jua sjellim në çast si t'i dëshironi, zotëri. Ju kërkoj ndjesë.

Në orën 09:00 fiks, pasi lexoi gazetat e mëngjesit dhe mbylli disa punë me "e-mail", Mikaili shkoi në hollin modern të "Ritz"-it. Atje e priste i dërguari i Volgatekut, i cili e kishte pritur te kontrolli i pasaportave në aeroportin "Sheremetyevo" mbrëmjen e kaluar. Ai ishte i gjithi buzagaz.

- Uroj të keni fjetur mirë, zoti Avedon.

- Nuk kisha fjetur asnjëherë më mirë, - gënjeu Mikaili gjithë seriozitet.

- Zyra jonë është këtu pranë. Nuk besoj se ju vjen keq nëse shkojmë në këmbë.

- Je i sigurt që nuk vdesim rrugës?

- Gjasat janë për mirë, por në Moskë nuk i dihet asnjëherë.

Me ato fjalë, i dërguari u kthye dhe e udhëhoqi Mikailin drejt rrugës "Tverskaja". Teksa ngjiteshin nëpër kodrën e ulët, me erën e acartë që u përplasej në fytyrë, ai kuptoi se topi i leshit dhe gëzofit që ecte dy hapa pas tij ishte Eli Lavoni, që e shoqëroi në heshtje deri te porta e përparme e Voglatekut, si për t'i kujtuar Mikailit se nuk ishte i vetëm. Pastaj, u zhduk nën diellin moskovit të mëngjesit.

Nëse kishe ndonjë dyshim për misionin e vërtetë të kompanisë Volgatek, ai shuhej kur shihje skulpturën e madhe prej metali në hollin e zyrave të saj qendrore në rrugën "Tverskaja". Ajo paraqiste tokën dhe Rusinë në një pozicion dominues duke çuar energji jetëdhënëse në katër qoshet e planetit. Poshtë saj qëndronte Genadi Lazarevi, i veshur me një kostum italian.

- Mirë se vjen në shtëpinë tënde të re, - thirri ai duke i shtrënguar dorën Mikailit. - Apo duhet të them në shtëpinë tënde *të vërtetë?*

- T'i marrim gjërat shtruar, Genadi.

Lazarevi ia shtrëngoi edhe më fort dorën Mikailit, sikur t'i thoshte se ashtu do të ndodhte medoemos dhe paskëtaj e udhëhoqi për te një ashensor privat, i cili i çoi në katin e fundit të godinës. Në hollin e tij ishte një pankartë ku shkruhej: "Mirë se vjen, Nikolai!". Lazarevi u ndal një çast atje për ta adhuruar, a thua se ishte lodhur shumë për ta bërë, para se ta drejtonte Mikailin për te një zyrë e madhe që i tha se mund ta përdorte sa herë të vinte në Moskë. Ajo ishte me pamje nga Kremlini dhe kishte edhe një sekretare shumë të bukur për të qenë e vërtetë, e cila quhej Nina.

- Hë, si të duket? - e pyeti Lazarevi gjithë zell.

- E këndshme, - tha Mikaili.

- Eja, - i tha Lazarevi, duke e kapur nga bërryli. - Të gjithë po presin me padurim të të njohin.

Doli se Lazarevi e kishte pasur seriozisht kur tha "të gjithë" sepse gjatë dy orëve e gjysmë që pasuan, Mikailit iu duk se shtrëngoi duart e të gjithë eprorëve të kompanisë e ndoshta edhe ndonjë tjetri. Kishte disa dhjetëra zëvendësdrejtorë të formave, përmasave dhe përgjegjësive të ndryshme, si edhe një figurë si kufomë që quhej Mentov, i cili tha se merrej me analizat e riskut, por Mikaili nuk mori vesh asgjë nga ato që tha ai. Pastaj u prezantua me ekipin shkencor të Volgatekut, gjeologët, të cilët ishin në kërkim të burimeve të reja të gazit dhe të naftës nëpër botë. Po ashtu, takoi edhe inxhinierët që do të siguronin planet për t'i nxjerrë ato nga toka. Më pas shkuan një kat më poshtë për t'u takuar me "më të vegjlit", financierët e rinj që ëndërronin të bënin karrierë, kufomat e gjalla që qëndronin në tavolinat e punës me nga një filxhan kafeje me logon e kompanisë. Mikaili nuk mund të mos mendonte se çfarë ndodhte me një punonjës që punonte në një kompani që zotërohej dhe drejtohej nga pasuesit e KGB-së. Ndoshta u jepnin ndonjë orë floriri dhe pension, por Mikaili as këtë nuk e besonte.

Më në fund, u kthyen sërish në katin e fundit dhe hynë në zyrën madhështore të Lazarevit ku ai foli gjatë për vizionin e Volgatekut për të ardhmen dhe rolin që do të luante Mikaili në të. Ai do të hynte fillimisht në kompani si drejtor i Volgatekut në Britaninë e Madhe dhe do

të drejtonte projektet për Ishujt Perëndimorë. Sapo të fillonin të nxirrnin naftë, Mikaili do të emërohej në poste më të larta, kryesisht në Europën Perëndimore dhe në Amerikën e Veriut.

- A je i kënaqur me kaq? - pyeti Lazarevi.

- Ndoshta.

- Çfarë do që të bindesh për ta lënë Viktorin dhe të punosh për mua?

- Dua para, Genadi. Dua shumë para.

- Nikolai, të siguroj që paratë nuk janë asnjëherë problem për ne.

- Atëherë jam në dispozicionin tuaj.

Lazarevi hapi një çantë dore lëkure prej nga nxori një fletë.

- Si kompensim do të kesh edhe apartamente në Aberdin, Londër dhe Moskë, - nisi ai. - Pa dyshim që do të udhëtosh me avionë privatë dhe do të përdorësh një vilë të Volgatekut në jug të Francës. Përveç rrogës bazë do të marrësh bonuse dhe stimuj, të cilat do ta çojnë pagesën tënde totale në përafërsisht këtë shumë.

Lazarevi e mbajti fletën para fytyrës së Mikailit dhe tregoi me gisht një shifër në fund të saj. Mikaili e pa për një çast, kroi kokën e tij qerose dhe u ngrys.

- Atëherë, si thua? - e pyeti Lazarevi.

- Kjo shifër është e papërfillshme për mua.

Lazarevi vuri buzën në gaz.

- E prisja këtë përgjigje, - tha ai duke marrë sërish çantën, - kështu që kam përgatitur edhe një ofertë tjetër, - shtoi duke i treguar fletën e dytë. - Po kjo si të duket?

- Kjo sikur më ngroh pak më shumë, - tha Mikaili duke i kthyer buzëqeshjen Lazarevit. - Pa dyshim që më ngroh më shumë.

49

SHESHI I KUQ, MOSKË

Në orën katër të asaj pasditeje ata thuajse e kishin mbyllur marrëveshjen. Lazarevi përgatiti një kontratë njëfaqëshe, rezervoi një sallë private në "Cafe Pushkin" për të festuar dhe e dërgoi prapë Mikailin në hotelin "Ritz" që të pushonte për disa orë. Ai e bëri rrugën e kthimit vetëm në shoqërinë e Gabrielit, i cili shkonte si hije në anën tjetër të trotuarit, me jakën e palltos të ngritur deri te veshët dhe kapelën të ulur deri te sytë. Ai e pa Mikailin teksa hyri në hollin e hotelit dhe pastaj vazhdoi përgjatë rrugës "Tverskaja", për në sheshin "Revolucioni". Atje pushoi pak për të parë një sozi të Leninit që shoqëronte një grup turistësh japonezë që e ndiqnin si të habitur. Pastaj kaloi poshtë harqeve të "Portës së Ringjalljes" dhe hyri në Sheshin e Kuq.

Në atë kohë ishte errur dhe era më në fund e ndau mendjen ta linte qytetin të qetë atë natë. Kokulur dhe me shpatulla të mbledhura, Gabrieli nuk ndryshonte asnjë grimë nga moskovitët e tjerë teksa nxitonte përgjatë murit verior të Kremlinit dhe ndanë vështrimit të pajetë të rojave të ngrira jashtë mauzoleut të Leninit. Përpara, përkundër një drite të bardhë, ngrihej kubeja në formë kaushi e katedrales së Shën Vasilit. Gabrieli pa orën në Kullën e Shpëtimtarit dhe pastaj vazhdoi

drejt vendit në murin e Kremlinit ku Stalini, njeriu që vrau miliona, qëndronte qetësisht në një vend nderi. Eli Lavoni iu bashkua një çast më pas.

- Si mendon? - e pyeti Gabrieli gjermanisht.

- Them se duhej ta kishin varrosur në një varr pa emër në ndonjë fushë të humbur, - u përgjigj Lavoni, - por fundja, ky është vetëm mendimi im.

- Jemi të sigurt këtu?

- Aq të sigurt sa mund të jemi në një vend si Moska.

Gabrieli u kthye pa thënë asnjë fjalë dhe e udhëhoqi Lavonin përmes sheshit, drejt hyrjes së GUM-it. Para shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, ajo kishte qenë mapoja e vetme në vend ku rusët mund të blinin një pallto të mirë dimri apo një palë këpucë të mira. Tani ishte kthyer në një qendër tregtare perëndimore dhe ishte mbushur me vogëlina të kota që ofronte kapitalizmi. Çatia e saj e xhamtë gumëzhinte nga blerësit mbrëmësorë. Lavoni hodhi sytë nga celulari i tij *BlackBerry* teksa ecte në krah të Gabrielit. Së fundmi, ky ishte një nga veprimet tipike të rusëve.

- Sekretari i Genadi Lazarevit sapo i dërgoi shefit të tij një

"e-mail" ku e informon për darkën e sotme në "Cafe Pushkin", - tha Lavoni. - Në listën e të ftuarve është edhe Pavel Zhirovi.

- Atij nuk ia dëgjova zërin sot kur Mikaili ishte në Volgatek.

- Sepse nuk ishte i pranishëm, - ia ktheu Lavoni pa i hequr sytë nga *BlackBerry*. - Pasi u largua nga apartamenti i tij në *Sparrow Hills*, u nis direkt për në Jasenevo.

- Përse shkoi pikërisht sot atje? Përse nuk shkoi në Volgatek që të takonte njeriun e tyre më të ri?

- Ndoshta ka pasur ndonjë punë tjetër.

- Çfarë pune?

- Ndoshta i është dashur të rrëmbente ndonjë tjetër.

- Pikërisht kjo më shqetëson.

Gabrieli u ndal para vitrinës së një dyqani bizhuterish dhe ia nguli sytë një ore të bukur të markës *Swiss*. Pas tij ishte një kafene e stilit sovjetik ku gra topolake me përparëse të bardha shpërndanin gjithë gëzim ushqim rus nëpër tabaka ngjyrë gri të kohës së Brezhnjevit. Edhe atë natë, kur kishin kaluar më shumë se njëzet vjet nga rënia e

komunizmit, kishte ende rusë nostalgjikë për të kaluarën e tyre totalitare.

- Nuk besoj se do të ftohesh tani nga kjo punë, apo jo? - e pyeti Lavoni.

- Është dhjetor dhe jemi në Moskë, Eli. Nuk ka si të ndodhë ndryshe.

- Çfarë ke ndër mend të bësh?

- Do të doja që ata të hotelit t'i jepnin Nikolas Avedonit kënaqësinë e veçantë që të largohej pak kohë para planifikimit.

- Kënaqësi të tilla nuk para i kanë qejf në "Cafe Pushkin".

- Atje nuk ka këmbë robi të paarmatosur, Eli.

- Kjo që po thua është me rrezik.

- Jo edhe aq, po ta mendosh mirë.

- Unë them të mos hamë fare darkë dhe të kalojmë drejt e te ëmbëlsira. Si thua?

- Nuk e ke idenë se sa do të doja, - tha Gabrieli, - por nuk besoj të na e lejojë trafiku. Jemi të detyruar të presim pas orës dhjetë. Në të kundërt, nuk e nxjerrim dot jashtë qytetit. Do të jemi të vdekur.

- Nuk gjeje dot ndonjë fjalë tjetër?

- Dërgoje mesazhin, Eli.

Lavoni shtypi disa shkronja në *BlackBerry*-n e tij dhe e drejtoi Gabrielin drejt daljes, në rrugën "Il'inka". Era kishte nisur të frynte sërish dhe temperaturat kishin marrë tatëpjetën. Gabrielit i dolën lot nga sytë teksa ecnin përgjatë fasadave me vezë Pashke të godinave perandorake. Në kufjen që e mbante vazhdimisht në vesh dëgjonte Nikolas Avedonin të këndonte nën zë teksa bënte dush në dhomën e tij në hotelin "Ritz".

- Dua ta vëzhgoni njëzet e katër orë në njëzet e katër, - tha Gabrieli. - Do ta shoqërojmë për te darka, do të ulemi pranë tij në restorant dhe pastaj do ta shoqërojmë prapë në hotel. Pikërisht aty nis pjesa më e bukur.

- Gjithnjë nëse Paveli pranon të shoqërojë Mikailin.

- Ai është shefi i sigurisë në Volgatek. Nëse një prej drejtuesve më të rinj të kompanisë dyshon se jeta e tij është në rrezik, Paveli do të pranojë me vrap. Atëherë ne do ta bëjmë të pendohet që pranoi.

- Unë do të isha më i sigurt nëse e nxjerrim jashtë Rusisë.

- Po ku ta çojmë, Eli? Në Ukrainë, Bjellorusi? Apo në Kazakistan?

- Jo, unë po mendoja për Mongolinë, në fakt.

- Atje jo, se nuk ka ushqim të mirë.

- Ushqimi atje është i tmerrshëm, - pranoi Lavoni, - por të paktën nuk është në Rusi.

Në fund të rrugës, ata u kthyen majtas dhe u nisën tatëpjetë kodrës drejt sheshit "Lubjanka".

- A thua ta ketë bërë ndonjë tjetër më parë diçka të tillë?

- Çfarë?

- Po ja, të kenë rrëmbyer një oficer të KGB-së *brenda* territorit të Rusisë.

- Nuk ka KGB, Eli. Hiqeni këtë ide nga koka. KGB-ja i përket së shkuarës.

- Jo, nuk është ashtu. Ajo ekziston, vetëm se tani quhet FSB dhe i ka zyrat qendrore në atë godinën e shëmtuar që të zë syri para nesh. Ta dish që do të nxehen keq kur të mësojnë se u mungon një nga të tyret.

- Nëse bëjmë rrëmbim të pastër, ata nuk do të kenë kohë të lëvizin as gishtin.

- Nëse arrijmë, ama.

Gabrieli heshti.

- Gabriel, të lutem, më bëj një nder sonte. Nëse nuk je i sigurt, e lëmë për një ditë tjetër, - tha Lavoni, heshti pak dhe pastaj shtoi: - Të betohem që nuk dua ta humbas rastin për të punuar me një drejtor si ty.

Kishin mbërritur në krye të kodrës. Lavoni frenoi ngadalë dhe ia nguli sytë ndërtesës së verdhë madhështore në anën e kundërt të sheshit "Lubjanka".

- Pse mendon se e mbajnë akoma? - pyeti ai me seriozitet. - Pse nuk e kanë shembur dhe të ngrinin një monument për viktimat në vend të kësaj?

- Për të njëjtën arsye përse nuk hoqën kockat e Stalinit nga muret e Kremlinit, - u përgjigj Gabrieli.

Lavoni heshti për një çast.

- E urrej këtë vend, - tha ai më në fund, - por në të njëjtën kohë e adhuroj. A thua të jem çmendur vallë?

- Ti je me kartelë, - tha Gabrieli, - por ky është vetëm mendimi im.

- Gjithsesi, vazhdoj të jem i mendimit se do të isha më i qetë sikur ta çonim në një shtet tjetër.

- Edhe unë, Eli, por kjo është e pamundur.

- Sa larg është Mongolia që këtu?

- Shumë larg për të shkuar me makinë, - tha Gabrieli. - Pastaj, mos harro që ushqimi atje është i tmerrshëm.

Pesë minuta më pas, teksa Gabrieli hyri në hollin e ngrohur mirë të hotelit "Metropol", Josi Gavishi zbriti nga dhoma e tij në katin e katërt të hotelit "Ritz-Carlton" me një kostum bankieri në ngjyrë gri dhe një kravatë të argjendtë. Në dorën e majtë mbante një etiketë ngjyrë ari ku shkruhej Aleksandër - student i historisë. Josi e kishte zgjedhur vetë atë emër. Në dorën e djathtë mbante një çantë dhuratash ngjyrë blu me logon e hotelit. Çanta ishte më e rëndë nga sa e shfaqte Josi, sepse në të ndodhej një pistoletë nëntëmilimetërshe e tipit Makarov, një nga ato armë që ambasada në Moskë kishte arritur të siguronte nga burime të paligjshme para se aty të mbërrinte skuadra e Gabrielit. Për tri ditë ajo armë kishte qëndruar e fshehur poshtë dyshekut në dhomën e Josit. Atë çast ai ndihej i lehtësuar që më në fund po e hiqte qafe.

Josi priti të sigurohej deri sa korridori të ishte bosh para se të vendoste etiketën me emrin e tij. Pastaj doli nga dera e dhomës me numrin 421. Nga dhoma përballë dëgjohej qartazi dikush që këndonte këngën "Penny Lane". Ai trokiti dy herë, ngadalë, por me vendosmëri, si një portier hoteli. Pastaj, pasi nuk u përgjigj njeri, trokiti edhe një herë, më fort. Këtë herë u përgjigj një burrë me peshqir rreth trupit. Ai ishte i gjatë, dukej shumë në formë dhe trupi dhe fytyra i ishin skuqur nga uji i nxehtë i dushit.

- Jam i zënë! - ia priti ai.

- Më falni që ju ndërpres, zoti Avedon, - ia ktheu Josi me një theks neutral kozmopolitan, - por hoteli dëshiron t'ju japë një dhuratë të vogël në shenjë vlerësimi.

- Falënderoji eprorët e tu nga ana ime, por nuk mund ta pranoj.

- Ata do të zhgënjeheshin shumë.

- Mos më thuaj që është ai dreq havjari, të paktën.

- Më vjen keq, por nuk më thanë se çfarë është.

Njeriu i përskuqur nga dushi e rrëmbeu çantën e dhuratës dhe ia përplasi derën në fytyrë Josit që mbante ende buzëqeshjen e shtirur të punonjësit të hotelit. Josi u kthye dhe pasi hoqi etiketën me emrin e tij nga xhaketa, u kthye në dhomën e tij. Atje hoqi shpejt e shpejt kostumin dhe veshi një palë xhinse dhe një triko leshi të trashë. Valixhen e kishte te këmbët e krevatit. Nëse gjithçka shkonte sipas planit, një korrier i ambasadës së Izraelit në Moskë do të vinte ta merrte pas disa orësh dhe do të shkatërronte gjithçka që kishte në të. Josi futi edhe kostumin në një nga xhepat anësorë të valixhes dhe mbylli zinxhirin. Pastaj fshiu mirë çdo objekt të dhomës që kishte prekur dhe shpresoi ta bënte për herë të fundit këtë.

Poshtë, në holl, pa Dinën që shfletonte skeptike një gazetë moskovite në gjuhën angleze. Ai i kaloi pranë sikur të mos e kishte parë kurrë në jetë dhe pastaj doli jashtë. Te kthesa e priste një *Range Rover*, marmitat e të cilit nxirrnin shtëllunga të zeza tymi, por që i falnin sadopak ngrohtësi asaj nate të hidhur e të ftohtë. Në timonin e tij ishte Kristofer Keleri. Ai hyri në pikun e trafikut të mbrëmjes në rrugën "Tverskaja" pa e mbyllur mirë derën. Para tyre ngrihej Kulla e Arsenalit të Kremlinit, me yllin e kuq që shndriste si dritë paralajmëruese. Keleri fërshëllente më kot teksa i jepte makinës.

- E di rrugën? - e pyeti Josi.

- Do të kthehem majtas në rrugën "Okhotnyy", prapë majtas në rrugën "Bol'shaja Dmitrovka" dhe pastaj sërish majtas në unazën e bulevardit.

- Paske ndenjur gjatë në Moskë, më duket.

- Nuk kam pasur kurrë kënaqësinë.

- Nuk mundesh të paktën të shtiresh sikur je nervoz?

- Përse të jem nervoz?

- E po, sepse do të rrëmbejmë një oficer të KGB-së në mes të Moskës, ja pse.

Keleri buzëqeshi teksa merrte kthesën e parë majtas.

- Do të mbarojmë punë shpejt e shpejt, pa merak.

Kelerit dhe Josit iu deshën afro njëzet minuta për të bërë rrugën e shkurtër deri në vendtakimin e tyre në unazën e bulevardit. Kur mbërritën atje, Josi i dërgoi Gabrielit një mesazh të koduar, të cilin Gabrieli e kaloi menjëherë në "Bulevardin Mbreti Saul". Mesazhi u shfaq sakaq në ekranin e një kompjuteri në qendrën operative. Si zakonisht, Uzi qëndronte i ulur në karrigen e tij. Ia kishte ngulur sytë një videoje të imazheve të drejtpërdrejta nga holli i hotelit "Ritz-Carlton", mundësuar nga një transmetues në miniaturë i fshehur në çantën e Dinës. Ora në Moskë ishte 7:36, ndërsa në Tel Aviv 6:36. Në orën 6:38 ra zilja e telefonit pranë bërrylit të Navotit. Ai afroi menjëherë receptorin në vesh, hungëriu diçka që u duk si emri i tij dhe dëgjoi zërin e Oritit, sekretares së tij personale. Brenda "Bulevardit Mbreti Saul" ajo njihej si "kubeja e hekurt" për shkak të aftësive të jashtëzakonshme për të bërë gjithçka për shefin e saj.

- Në asnjë mënyrë! - u përgjigj Navoti. - As që bëhet fjalë!

- Ai e ka bërë të qartë që nuk do të ikë.

Navoti psherëtiu thellë.

- Dakord, - tha ai. - Lejojeni, nëse duhet patjetër.

Navoti uli receptorin dhe ia nguli sytë imazhit të hollit të hotelit. Dy minuta më pas dëgjoi të hapej dera e qendrës operative dhe të mbyllej pas tij. Pastaj, me bisht të syrit pa një dorë të vendoste dy paketa cigaresh turke mbi tavolinë, bashkë me një çakmak të vjetër *Zippo*. Çakmaku u ndez dhe një re tymi cigareje mbushi ekranin.

- Mendoj se bëra gjithçka që deshe, - tha Navoti me qetësi pa ia hequr sytë ekranit.

- Po, - ia ktheu Shamroni.

- Si hyre në ndërtesë?

- Hapa një tunel.

Shamroni nisi të luante me majat e gishtave me çakmakun, dy herë djathtas, dy herë majtas.

- Je shumë i guximshëm që vjen këtu, - tha Navoti.

- Uzi, nuk është as koha dhe as vendi për këto biseda.

- E di, - tha Navoti, - por prapë mendoj se je shumë i guximshëm.

Dy herë djathtas, dy herë majtas...

- A mund ta ngresh pak zërin e audios në telefonin e Mikailit? - pyeti Shamroni. - Nuk dëgjoj më si më parë.

- Ti nuk ke probleme vetëm me dëgjimin.

Navotit i kapi syri një nga teknikët dhe i bëri shenjë të ngrinte zërin.

- Çfarë kënge po këndon ai? - pyeti Shamroni.

- Ç'rëndësi ka kjo?

- Përgjigju, Uzi.

- Titullohet "Penny Lane".

- Bitëllsat e këndojnë?

- Po, ata.

- Pse mendon se po këndon pikërisht atë këngë?

- Ndoshta sepse i pëlqen.

- Ndoshta, - tha Shamroni.

Navoti pa orën. Shënonte 7:42 në Moskë dhe 6:42 në Tel Aviv. Shamroni shtypi bishtin e cigares dhe ndezi menjëherë një tjetër.

Dy herë djathtas, dy herë majtas...

Mikaili ishte ende duke kënduar kur doli nga dhoma e hotelit, i veshur për darkë. Kur hyri në ashensor, çantën e dhuratave e mbante në dorën e djathtë, por nuk e kishte më kur doli nga tualeti i burrave të hollit, tri minuta më pas. Skuadra në qendrën operative e pa për herë të parë në orën 7:51, kur kaloi pranë kamerës së Dinës dhe mori për nga dalja e hotelit. Atje, me krahun ngritur sikur të ishte duke sinjalizuar një avion në qiell, e priste Genadi Lazarev. Dora e tij e kapi Mikailin nga shpatulla dhe e drejtoi te limuzina *Maybach*, që i priste para hotelit.

- Uroj të kesh pushuar mirë, - tha Lazarevi kur makina mori kthesën, - sepse sonte do të njohësh Rusinë e vërtetë.

50

"CAFE PUSHKIN", MOSKË

Paskëtaj, kur ata po rregullonin dosjet dhe po përgatisnin raportet, plasi një debat i nxehtë për kuptimin e vërtetë të fjalëve të Genadi Lazarevit. Njëri kamp i mori ato fjalë thjesht si një shprehje të vullnetit të mirë, ndërsa tjetri si një paralajmërim që Gabrieli, drejtori i ardhshëm i Shërbimit Sekret Rus, duhej ta kishte kuptuar mirë. Si zakonisht, ishte Shamroni ai që i dha fund debatit. Ai tha se fjalët e Lazarevit nuk kishin asnjë nënkuptim, sepse fati i Mikailit ishte vulosur në çastin kur ai hipi në atë makinë.

Skena e asaj që ndodhi më pas në "Cafe Pushkin"-in e Moskës nuk mund të ishte më e bukur, veçanërisht në një mbrëmje dhjetori, me ajrin e akullt dhe flokët e dëborës që vallëzonin nën erën siberiane. Restoranti ndodhej në qendër të rrugës "Tverskaja" dhe unazës së bulevardit, një ndërtesë e vjetër e shekullit 18, që dukej sikur ishte importuar nga Italia e periudhës së Rilindjes. Përtej dyerve të bukura franceze të zinte syri një rrugë me tre korsi dhe më tej trafikut një shesh i vogël ku dikur kishin ngritur tendat ushtarët e Napoleonit. Moskovitët nguteshin nëpër rruginat e shtruara me kalldrëm, ndërsa disa nëna të guximshme ishin ulur në stolat poshtë dritave të rrugës dhe shihnin fëmijët e tyre teksa luanin në rrugët e mbuluara nga bora. Mordekai dhe Rimona ishin ulur

në heshtje mes tyre; Mordekai ia kishte ngulur sytë "Cafe Pushkin"-it, ndërsa Rimona fëmijëve. Keleri dhe Josi kishin gjetur një parking rreth pesëdhjetë metra larg restorantit. Jakovi dhe Odeda, gjithashtu në një *Land Rover*, qëndronin pesëdhjetë metra më pas.

Darka ishte caktuar për në orën tetë, por për shkak të trafikut të rënduar të asaj mbrëmjeje, Lazarevi dhe Mikaili mbërritën në orën 8:12. Mordekai shënoi orën. Të njëjtën gjë bënë edhe anëtarët e skuadrës që ishin në makinat *Land Rover*. Po ashtu, edhe Gabrieli, i cili dërgoi menjëherë një mesazh në qendrën operative në "Bulevardin Mbreti Saul". Natyrisht që nuk ishte nevoja që ai ta dërgonte atë mesazh, sepse Navoti dhe Shamroni po e ndiqnin të gjithë skenën drejtpërsëdrejti nga aparati përgjues në celularin e Mikailit. Ata i dëgjuan hapat e rëndë mbi dysheme e ashpër të "Pushkin"-it. Dëgjuan edhe krakëllimën e ashensorit të vjetër që e çoi në katin e dytë. Po ashtu, edhe duartrokitjen e fortë ruse që e priti kur hyri në dhomën private që ishte rezervuar në nder të kurorëzimit të tij.

Mikailit i kishin lënë vendin e kreut në tavolinë, me Lazarevin në të djathtë dhe Pavel Zhirovin, shefin e sigurisë së Volgatekut, në të majtë. Vetëm Zhirovi dukej se nuk ishte shumë i lumtur me ardhjen e të përkëdhelurit të Viktor Orlovit. Gjatë gjithë mbrëmjes, ai qëndroi i ngrysur si një kumarxhi i regjur kur humbet keqas në rulet. Vështrimi i tij, i picërruar dhe i errët, nuk binte gjatë mbi fytyrën e Mikailit. Kinse po llogariste sa kishte humbur dhe po mendonte nëse ia mbante shpirti ta rrotullonte edhe një herë rrotën.

Edhe nëse e bezdiste shprehia e Zhirovit, Nikolai nuk e dha asnjë grimë veten. Madje të gjithë ata që e dëgjuan fjalimin e Mikailit atë mbrëmje, do ta përshkruanin atë si më të mirin që u kishin zënë veshët. Ai ishte Nikolas Avedoni me të cilin kishin rënë në dashuri për së largu. Ishte Nikolasi i zgjuar, i mprehtë, më mendjendrituri ndër të gjithë në atë sallë, përveç Genadi Lazarevit, natyrisht. Ai ishte ndoshta njeriu më i zgjuar në botë. Teksa mbrëmjes i vinte fundi, ai foli më pak anglisht e më shumë rusisht, derisa në fund, nuk foli më fare anglisht. Tani ishte një prej tyre, ishte Nikolai Avdonin. Njeriu i Volgatekut, njeriu i së ardhmes së Rusisë, por edhe i së kaluarës së saj.

Shndërrimi mori trajtë të plotë pak pasi ora shënoi dhjetë, kur ai improvizoi një imitim të Viktor Orlovit, përfshi edhe dridhjen e syrit të tij të majtë, që e shkundi restorantin nga të qeshurat. Vetëm Pavel Zhirovit nuk u duk se i pëlqeu. Ai nuk iu bashkua as ovacioneve që pasuan bekimin e Genadi Lazarevit. Paskëtaj, dolën në rrugë ku i prisnin një rresht limuzinash të Volgatekut. Lazarevi i tha Mikailit të kalonte nga zyrat të nesërmen në mëngjes, para se të largohej, për të diskutuar disa detaje të fundit të marrëveshjes. Paskëtaj e drejtoi për nga dera e hapur e *Mercedes*-it që i priste.

- Nëse nuk të vjen keq, - i tha ai pa e hequr buzagazin prej matematikani, - dua të të shoqërojë Paveli në hotel. Ai do të të bëjë disa pyetje gjatë rrugës.

- Pa problem, Genad, - tha Mikaili me një zë që edhe vetë me zor e dëgjoi dhe hyri pa ngurruar në makinë. Pavel Zhirovi, i humburi i vetëm i asaj mbrëmjeje, ishte ulur përballë tij dhe shihte nga dritarja. Ai nuk tha asnjë fjalë teksa makina hyri në rrugë. Mikaili nisi të trokiste me gisht në mbështetësen e sediljes, por pastaj e detyroi veten të ndalej.

- Genadi tha se doje të më bëje disa pyetje.

- Në fakt, - ia priti Zhirovi, - kam vetëm një.

- Cila është ajo?

Zhirovi u kthye për herë të parë nga Mikaili dhe e pyeti duke e parë drejt e në sy:

- Kush dreqin je ti?

- Më duket se Zhirovi nisi lojën pa doreza, - tha Navoti.

Shamroni u ngrys. Ai mendonte se përdorimi i metaforave nuk kishte vend në botën e egër të spiunazhit. Ngriti sytë nga videot sipër kokës së tij dhe pa dritat që lëviznin me shpejtësi nëpër hartën e Moskës. Drita që përfaqësonte pozicionin e Mikailit ishte e kuqe. Krahas saj lëviznin edhe katër drita blu, dy para dhe dy mbrapa.

- Unë them se e kemi gozhduar mirë, - tha Shamroni.

- Shumë mirë, do të thosha unë. Por puna është se mos ka edhe Paveli përforcime.

- Kam përshtypjen se tani kjo nuk ka më rëndësi.

- Ke ndonjë sugjerim ti?

- Të nisë operacioni, - tha Shamroni duke ndezur një cigare. - Menjëherë!

Ata kaluan me shpejtësi nëpër rrugën "Tverskaja" dhe vazhduan përgjatë unazës së bulevardit.

- Hoteli im është andej, - tha Mikaili duke treguar me gisht.

- E njohke mirë Moskën, - ia ktheu Zhirovi dhe pa dyshim, jo si kompliment.

- E kam zakon, - tha Mikaili.

- Çfarë?

- Të përpiqem të njoh çdo qytet ku shkoj. E kam zët të pyes për rrugën. Nuk ma ka qejfi të jem si turist.

- Të pëlqen të bëhesh një me banorët e një vendi?

- Dëgjo, Pavel, se nuk po të marr vesh mirë...

- Ose ke qenë edhe më parë në Moskë, - tha Zhirovi.

- Jo, asnjëherë.

- Po kohët e fundit?

- Jo.

- As kur ke qenë i vogël?

- Kur them që nuk kam qenë kurrë, do të thotë që nuk kam qenë kurrë, Pavel! Tani, nëse nuk të vjen keq, do të doja të kthehesha në hotelin tim.

Zhirovi kishte kthyer sërish kokën nga dritarja. Apo po shihte tinëz nga pasqyra anësore e shoferit? Mikaili nuk ishte i sigurt.

- Nuk i je përgjigjur ende pyetjes sime, - tha më në fund Zhirovi.

- Sepse ishte një pyetje që nuk meriton përgjigje, - ia priti Mikaili.

- Kush je ti?

- Unë jam Nikolas Avedoni, - tha Mikaili qetësisht. - Punoj për kompaninë "Investimet Viktor Orlov", në Londër dhe falë kësaj shfaqjes që po jep ti tani, do të vazhdoj të punoj për ta.

Zhirovi nuk u bind.

- Kush je ti? - e pyeti sërish.

- Quhem Nikolas. Jam rritur në Angli. Kam studiuar në Kembrixh dhe Harvard. Kam punuar në kompaninë e naftës "Aberdeen" për disa kohë dhe pastaj fillova të punoja për Viktorin.

- Pse?

- Pse u rrita në Angli apo pse studiova në Harvard?

- Përse nise punë për një armik të shpallur të Kremlinit si Viktor Orlovi?

- Sepse atij i duhej dikush që mund të kujdesej për kompaninë e tij të naftës. Tani, po pendohem që e tradhtova.

- I njihje ti politikat e tij kur nise të punoje për të?

- Mua nuk më interesojnë politikat e tij. Madje, të askujt.

- Mendon se je shpirt i lirë?

- Jo, Pavel. Unë jam biznesmen.

- Ti je agjent.

- Agjent? Pavel, mos nuk i ke pirë ilaçet sot?

- Për kë punon ti?

- Më ktheni në hotelin tim.

- Për britanikët?

- Më ktheni në hotel, Pavel!

- Për amerikanët?

- Pavel, harrove që ju erdhët vetë tek unë? Ndodhi në Kopenhagen, në forumin për kompanitë e naftës. U takuam edhe në atë shtëpinë në mes të hiçit. Me siguri që ti ke qenë atje.

- Për kë punon ti? - e pyeti sërish Zhirovi, si një mësues që pyet për të disatën herë një nxënës kokëgdhe.

- Ndale makinën! Më lini të dal!

- Për kë punon?

- Ndale makinën, thashë!

Makina u ndal, por jo sepse i tha Zhirovi shoferit, por sepse kishin mbërritur në rrugën "Petrovka". Ndodheshin në një kryqëzim të madh, me rrugë që të çonin në disa drejtime të ndryshme. Semafori sapo u bë i kuq. Para tyre ishte një *Land Rover*, ku dalloheshin qartë dy burra. Mikaili hodhi një sy mbrapa dhe pa edhe një Land Rover të dytë. Pastaj ndjeu që t'i dridhej tri herë telefoni në xhep.

- Ç'ishte kjo? - e pyeti Zhirovi.

- Celulari im.

- Fike dhe hiqja baterinë.

- Ti kujdesesh për gjithçka, apo jo, Pavel?

- Fike! - bërtiti Zhirovi.

Mikaili futi dorën në xhep, nxori pistoletën e tij të tipit "Makarov" dhe e zhyti tytën e saj thellë në brinjët e Zhirovit. Sytë e rusit u përçartën, por nuk tha asnjë fjalë. E pa Mikailin për disa sekonda, pastaj shikimi i tij rrëshqiti te Jakovi, i cili po dilte nga *Land Rover*-i para tyre. Ndërkohë, Keleri kishte zbritur nga *Land Rover*-i i dytë dhe po i afrohej *Mercedes*-it nga pas.

- Thuaji shoferit ta fusë makinën në park, - i tha Maikaili me qetësi. - Përndryshe, ta çava zemrën! Thuaji, Pavel, në mos do të vdesësh tani, këtu!

Pasi Zhirovi nuk u përgjigj, ai tërhoqi këmbëzën e pistoletës. Keleri qëndronte te dritarja e Zhirovit.

- Thuaji, Pavel!

Drita e semaforit u bë jeshile dhe diku u dëgjua një bori. Pastaj edhe një tjetër.

- Thuaji! - thirri Mikaili rusisht.

Zhirovi hodhi sytë nga pasqyra që sheh mbrapa, shikimi i tij takoi atë të shoferit dhe ai tundi kokën një herë. Shoferi e futi makinën në park dhe i vuri duart mbi timon.

- Thuaji të dalë nga makina dhe të bëjë si do t'i thonë.

Një tjetër vështrim nga pasqyra dhe pastaj një tundje tjetër koke. Shoferi u përgjigj duke hapur derën e limuzinës dhe duke dalë ngadalë prej saj. Jashtë e priste Jakovi për ta marrë në dorëzim. Pasi i pështpëriti disa fjalë në vesh, ai e drejtoi për nga *Land Rover*-i, e futi në ndenjësen e pasme dhe hyri edhe vetë pas tij. Ndërkohë, Keleri kishte zënë vendin e shoferit në limuzinën e tyre të tipit *Mercedes*. Kur *Land Rover*-i u largua, ai ndezi motorin dhe i shkoi pas. Mikaili nuk e kishte hequr ende pistoletën nga brinjët e Zhirovit.

- Kush je ti? - e pyeti Zhirovi.

- Nikolas Avedoni, - u përgjigj Mikaili.

- Kush je? - përsëriti pyetjen Zhirovi.

- Jam makthi yt më i keq! - tha Mikaili. - Dhe po nuk e qepe gojën, t'i hapa trutë këtu!

Në qendrën operative në "Bulevardin Mbreti Saul", dritat e skuadrës po lëviznin vertikalisht nëpër Moskë. Të gjitha, përveç njërës, e cila qëndronte pa lëvizur në "Teatranly Prospekt", poshtë sheshit "Lubjanka". Nuk pati festime dhe as përgëzime për një punë të kryer me sukses. Vetë vendi i ngjarjes nuk të lejonte të gëzoheshe. Moska kishte shpirt luftarak dhe kundërpërgjigjej.

- Tridhjetë sekonda nga nisja në finish, - tha Navoti pa ia hequr sytë ekranit. - Jo keq.

- Tridhjetë e tre, - tha Shamroni, - po fundja, kush i numëroi?

- Ti.

Shamroni i dha një nga buzëqeshjet e tij të shtirura; në fakt, ai *i kishte* numëruar gjithë jetën. Numrin e familjeve të humbura në zjarret e Holokaustit, numrin e atyre që ua kishin marrë jetën plumbat dhe bombat dhe numrin e herëve që e kishin mashtruar për vdekje.

- Sa larg është vendstrehimi ynë?

- Dyqind e tridhjetë e gjashtë kilometra nga unaza e madhe.

- Si është parashikimi i motit?

- Për faqe të zezë, - ia ktheu Navoti, - por gjithsesi, besoj se ata do t'ia dalin.

Shamroni nuk foli. Navoti nuk ia ndante sytë dritave që lëviznin nëpër Moskë.

- Tridhjetë e tre sekonda, - përsëriti ai. - Jo keq.

- Tridhjetë e tre, - tha edhe Shamroni. - Shpresojmë të mos i ketë parë edhe ndonjë tjetër.

Shamroni nuk e dinte, por pikërisht ky mendim kaloi edhe në trurin e njeriut që qëndronte në dritaren e dhomës së katit të katërt në hotelin "Metropol". Ai po shihte nga lart kthesën e "Teatralny Prospekt", drejt kështjellës së verdhë që ngrihej mbi sheshin "Lubjanka". Mendonte nëse do të mund të pikaste ndonjë reagim, ndonjë dritë nga katet e sipërme, zhurmë gomash makinash në garazh, por në fund mendoi se asgjë nga këto nuk kish ngjarë. "Lubjanka" gjithmonë kishte ditur të ruante sekrete, ashtu si Rusia dinte të ruante të vdekurit.

U largua nga dritarja, fiku kompjuterin dhe e futi në xhepin anësor të valixhes. Pastaj mori ashensorin dhe zbriti në holl i shoqëruar nga disa prostituta nga shtatëmbëdhjetë deri në dyzet e pesë vjeçe.

Jashtë, në një kthesë, priste në heshtje një *Volvo SUV*, për të cilin po kujdesej një rojë, në dukje mjeran. Ai i dha atij një bakshish të majmë, hipi në timon dhe u largua. Njëzet minuta më pas, pasi kishte bërë xhiro rreth mureve të Kremlinit, iu bashkua vargut të dritave të makinave që rendnin të dilnin nga Moska.

Megjithëkëtë, në qendrën operative "Bulevardi Mbreti Saul", ai nuk ishte veçse një dritë e kuqe, e shkëputur, një engjëll hakmarrjeje, i vetëm në qytetin e heretikëve.

51

RAJONI TVER, RUSI

Dikur ajo kishte qenë *dacha* e një njeriu të pushtetshëm - një anëtari të Komitetit Qendror, ndoshta edhe të Byrosë Politike. Askush nuk e ndante dot këtë, sepse përgjatë ditëve kaotike pas prishjes së Bashkimit Sovjetik ishte bërë një katrahurë e vërtetë. Fabrikat që deri më atëherë ishin në pronësi të shtetit kishin mbetur të mbyllura, pasi nuk gjendeshin më çelësat; kompjuterët e qeverisë nuk hapeshin pasi askush nuk mbante mend fjalëkalimet. Rusia kishte kërcyer në mijëvjeçarin e ri pa hartë dhe pa memorie. Pati nga ata që thanë se ajo nuk kishte pasur asnjëherë memorie, paçka se tani amnezia ishte ashiqare. Për disa vjet, ajo *dacha* e harruar kishte mbetur bosh si një relikte, derisa një biznesmen moskovit me emrin Blosh e bleu për dy kacidhe dhe e ndërtoi nga e para. Në fund, si shumë borgjezë të rinj rusë, Boshi pati konflikte me Kremlinin dhe vendosi të largohej nga vendi sa ishte ende në kohë. U vendos në Izrael, pjesërisht sepse i ishte shkrepur se ishte paksa hebraik dhe kryesisht sepse nuk e pranoi asnjë vend tjetër. Pak nga pak, i shiti të gjitha pronat në Rusi, përveç *dacha*-s në rajonin *Tver*. Atë ia fali Ari Shamronit dhe i tha ta përdorte për qëllime të mira.

Shtëpia ishte ngritur buzë një liqeni pa emër dhe atje shkohej nga një rrugë që nuk figuronte në asnjë hartë. Ajo në të vërtetë nuk ishte

një rrugë. Më shumë përngjante si një brazdë toke në mes të një pylli mështeknash, e cila kishte qenë aty shumë kohë para se njerëzimi të dinte se ekzistonte një komb i quajtur Rusi. Porta origjinale e *dacha*-s ishte ende aty, ashtu si dhe tabela e vjetër e kohës së Bashkimit Sovjetik, ku shkruhej "Ndalim kalimi". Bloshit, si fëmijë i epokës së Stalinit, nuk ia kishte mbajtur ta hiqte. Gabrielit ia kapi syri kalimthi teksa kalonte në rrugën me gunga të mbuluar nga bora. Pastaj u shfaq *dacha*: hijerëndë, prej druri, me çati me majë dhe një verandë të madhe rreth e rrotull. Jashtë saj ishin parkuar disa automjete, përfshi edhe një *Mercedes S-Class* në pronësi të kompanisë "Volgatek". Kur doli nga *Volvo SUV*-i, në errësirë, Gabrieli shqoi dritën e një cigareje.

- Mirë se vjen në Shangri La, - i tha Kristofer Keleri. Kishte veshur një parka të trashë dhe në dorë mbante një pistoletë Makarov.

- Si është zona? - e pyeti Gabrieli?

- E ftohtë sa më s'ka, por e sigurt.

- Sa kohë mund të qëndrosh këtu?

- Unë kam bërë ushtri, harrove? - tha Keleri duke buzëqeshur.

Gabrieli kaloi pranë Kelerit dhe hyri në *dacha*. Pjesa tjetër e skuadrës ishte shpërndarë në cepa të ndryshëm të sallonit të mobiluar në stilin rustik. Mikaili ishte ende me veshjen e darkës në "Cafe Pushkin" dhe kishte futur dorën e djathtë në një tas me ujë të ftohtë.

- Çfarë ndodhi? - pyeti Gabrieli.

- E përplasa.

- Ku?

- Në fytyrën e njërit.

Gabrieli i tha t'i tregonte dorën. Ishte ënjtur keq dhe tre nga nyjet nuk kishin më lëkurë.

- Sa herë e përplase? - e pyeti Gabrieli.

- Një ose dy herë. Ose dhjetë a dymbëdhjetë herë.

- Si e ka fytyrën ai?

- Shko shikoje vetë.

- Ku është?

Mikaili tregoi me dorë në dysheme.

Ndër lukset e *dacha*-s ishte edhe një strehim nga sulmet bërthamore. Dikur ai mbushej me ushqime, ujë dhe pajisje të tjera, me të cilat një njeri mund të jetonte për një vit, ndërsa tani në të ndodheshin vetëm dy burra: të dy të lidhur fort me shirit ngjitës nga duart, këmbët, gjunjët dhe sytë. Megjithatë, dukej se fytyra e burrit më të madh në moshë kishte pësuar dëmtime të rënda si pasojë e grushtimeve të njëpasnjëshme të dorës së djathtë e të rrezikshme të Mikailit. Ai ishte hedhur pas një muri, me këmbët të hapura në dysheme. Kur dëgjoi derën të hapej, filloi të tundte kokën sa majtas-djathtas, si një radar në kërkim të një avioni pushtues. Gabrieli u përkul para tij dhe i hoqi fluturimthi ngjitësin e syve, i cili mori me vete edhe një pjesë të njërës vetull. Në njërën faqe kishte një të çarë të thellë dhe rreth flegrave të hundës së tij tanimë të thyer kishte gjak të tharë. Gabrieli vuri buzën në gaz dhe i hoqi edhe ngjitësin e gojës.

- Ç'kemi, Pavel? - i tha. - Apo do të të thërras Pol?

Zhirovi nuk bëri zë. Gabrieli i pa hundën e thyer.

- Besoj se të dhemb shumë, por kjo është normale në Rusi, apo jo?

- Me zor po pres të ta kthej nderin, Alon.

- Domethënë, ti *më* njeh?

- Pa dyshim! - tha Zhirovi me gojën plot. - Të kemi vëzhguar qëkurse vure këmbë në Rusi.

- Kush më ka vëzhguar? - pyeti Gabrieli. - Volgateku? SVR-ja? FSB-ja? Apo t'i lëmë formalitetet dhe ta quajmë KGB, me emrin e saj të vërtetë?

- Je i vdekur, Alon. Ti bashkë me shokët e tu. Nuk keni për të dalë kurrë të gjallë nga Rusia.

Buzëqeshja e Gabrielit nuk ishte shuar ende teksa i tha:

- Pavel, unë nuk para i kam qejf kërcënimet e kota.

- Unë ca më shumë se ti!

- Atëherë lëri këto pallavra që gjoja e dije se unë isha në Moskë apo që e dije se Nikolas Avedonin e shpika unë. Ti nuk do të guxoje të ngrije as gishtin kundër tij sonte pa mbështetjen e FSB-së sikur ta dije se është agjenti im.

- Kush të tha që nuk kam mbështetje?

- Unë po e them.

- Gabohesh rëndë, Alon. Por nejse, ti je mësuar të gabosh. FSB-ja thjesht po sigurohet për identifikimin e anëtarëve të skuadrës tënde. Maksimumi i kohës që keni, janë disa orë. Pastaj do ta shihni veten ju nëpër qeli dhe me hundë të thyera.

- Atëherë them se duhet të fillojmë.

- Çfarë?

- Rrëfimin tënd, - i tha Gabrieli. - Do t'i thuash gjithë botës se rrëmbeve një vajzë me emrin Madalena Hart që kompania e gazit dhe e naftës Volgatek të kishte akses në Detin e Veriut.

Zhirovi u shtir si i habitur.

- Për vajzën angleze? Për atë e bëtë ju gjithë këtë?

Gabrieli tundi kokën ngadalë, si i zhgënjyer nga përgjigjja e Zhirovit.

- Lëri këto, Pavel. Ti je më i zgjuar se kaq. Ti e rrëmbeve atë në një rruginë pranë Kalvit disa orë pasi drekuat bashkë në restorantin "Les Palmiers". Një kriminel marsejez që quhej Marsel Lakrua të largoi nga Korsika dhe të dorëzoi te një kriminel tjetër marsejez, Rëne Brosardi. Pastaj, pasi more dhjetë milionë eurot e shpërblimit nga kryeministri anglez, e le në një makinë në plazhin e *Audresselles*-it dhe i vure flakën.

- Jo keq, Alon.

- Të them të drejtën nuk qe shumë vështirë sepse ti le shumë gjurmë. Jam i bindur se kjo ka qenë e qëllimshme. Doje që rrëmbimi dhe vrasja e Madalenës t'i faturoheshin dy palo kriminelëve francezë, por bëre një gabim, Pavel. Duhej të ma kishe vënë veshin kur të thashë të mos i bëje keq asaj vajze. Unë isha i qartë. Të thashë që po t'i prekje një fije floku, do të të gjeja dhe do të të vrisja.

- Pse nuk më vrave atëherë? Pse i mundove dhe rrezikove kot shokët e tu duke më rrëmbyer dhe duke më sjellë këtu?

- Ne nuk të rrëmbyem, Pavel. Ne të kapëm. Këtu të sollëm sepse pavarësisht nga rrethanat në të cilat ndodhesh, kjo është dita jote me fat. Do të të bëj një ofertë nga ato që s'para t'i zë as veshi në punën tonë. Do të të jap një mundësi të dytë.

- Si duhet ta fitoj unë atë?

- Duke iu përgjigjur disa pyetjeve, që unë të sqaroj disa gjëra.
- Vetëm kaq?
Gabrieli pohoi me kokë.
- Po pastaj?
- Pastaj je i lirë të shkosh.
- Ku të shkoj? - e pyeti Zhirovi me seriozitet.
- Kthehu në Volgatek. Te SVR-ja. Kthehu në rrugën ku e nise nga hiçi.
Zhirovi buzëqeshi me sarkazëm dhe tha:
- Çfarë mendon se do të ndodhë me mua kur të kthehem në Jasenevo pasi të të jap ty përgjigjet që do?
- Ndoshta do të të japin një *vysshaya mera*, - i tha Gabrieli. - Masën më të lartë të ndëshkimit: dënim me vdekje.
Zhirovi pohoi me kokë si me adhurim dhe tha:
- Ditke shumë për agjencinë për të cilën punoj unë.
- Jo nga dëshira, - ia ktheu Gabrieli. - Dhe që të jem i sinqertë, Pavel, as që dua t'ia di se ç'do të të bëjë agjencia jote.
- E po, bën mirë të të interesojë, - i tha Zhirovi duke nënqeshur. - Alon, ti po më thua të zgjedh mes vdekjes dhe vdekjes.
- Po të them ta shohësh edhe një herë agimin rus, Pavel. Mos u shqetëso, të garantoj se do të kesh kohë boll për t'u menduar në një vend të qetë se ç'do t'u thuash shefave të tu në SVR. Seç kam një parandjenjë se do të të vijë ndonjë ide e ndritur, në fund.
- Po sikur të refuzoj?
- Atëherë do të ta jap vetë plumbin në ballë që vrave Madalenën.
- Më duhet pak kohë që të mendohem.
Gabrieli i vuri sërish ngjitësin në sy dhe gojë dhe i tha:
- Ke pesë minuta kohë.

Doli se do të kalonin dhjetë minuta para se Mikaili, Jakovi dhe Odedi ta nxirrnin Zhirovin nga bodrumi dhe ta çonin në dhomën e ngrënies, ku e lidhën mirë pas një karrigeje të rëndë. Gabreli u ul përballë tij. Pas tij qëndronte Josi, i cili ia kishte ngulur sytë ekranit të një video kamere. Pasi i

rregulloi këndin Josi ia bëri me kokë Mikailit, i cili ia hoqi ngjitësin nga goja Zhirovit. Rusi u shtrëngua nga dhimbja, pastaj, sytë e tij u endën ngadalë nëpër dhomë duke regjistruar çdo fytyrë, çdo detaj, para se të binin mbi fotografinë që mbante në duar Gabrieli. Atje ishte Zhirovi (me një pamje shumë ndryshe nga ajo e atij çasti), duke drekuar me Madalena Hartin në restorantin "Les Palmiers", në Kalvi.
- Si e takove? - e pyeti Gabrieli.
- Kë?
Gabrieli e vendosi fotografinë mbi tavolinë dhe i tha Josit të fikte kamerën.

E zgjidhën nga karrigia, i lidhën duart me litar dhe e nxorën në breg të liqenit. Në errësirë shtrihej një dok rreth pesëdhjetë metra i gjatë, në fund të të cilit ishte një vijë uji që nuk kishte ngrirë ende. Zhirovi hyri në të pa bërë zë, ashtu si i ka hije një burri të rrethuar nga tri burra të tjerë të tërbuar nga inati.
- E di sa kohë mund të mbijetojë njeriu në ujë kaq të ftohtë? - e pyeti Keleri.
- Pas dy minutash nuk do të ndiejë më asgjë dhe as nuk do të mund të lëvizë. Me gjasë, pas pesëmbëdhjetë minutash do të humbasë ndjenjat.
- Nëse nuk është mbytur më parë.
- Gjithmonë nëse nuk është mbytur më parë, - tha Gabrieli.
Keleri pa një çast në heshtje figurën që kridhej në ujë.
- Nga do ta kuptosh që duhet ta nxjerrim që aty? - pyeti më në fund.
- Kur të fillojë të fundoset.
- Më kujto të mos bëhem kurrë armiku yt.
- Gjëra që ndodhin në Rusi.

52

RAJONI TVER, RUSI

U deshën vetëm dy minuta në liqen. Më pas morën fund protesta për pafajësi dhe kërcënimet se shumë shpejt atë do të vinte ta shpëtonte FSB-ja. Pasi iu dorëzua fatit të tij, ai u kthye në një të burgosur model. Si shumica e agjentëve sekretë, edhe ai kishte bërë karrierë duke u përpjekur t'u bënte bisht kamerave dhe nuk donte të kishte një fund të hidhur.

Ka një të vërtetë të trishtë për Shërbimin Sekret: ndryshe nga sa mendojnë të gjithë, shumica e agjentëve sekretë kanë qejf të flasin, sidomos kur përballen me situata që vënë në rrezik karrierën e tyre. Veçanërisht në atë pikë, ata i nxjerrin të gjitha sekretet, qoftë edhe për t'i vërtetuar vetes se nuk kishin qenë veçse hallka e një makinacioni të fshehtë, por se kishin pasur njëfarë rëndësie, paçka nëse kjo mund të mos ishte e vërtetë.

Kësisoj, Gabrieli nuk u habit aspak që Pavel Zhirovi, pasi e mori veten nga kredhja në liqen, nisi të "këndonte". Pasi veshi rroba të thata, u ngroh me një çaj dhe pak konjak, ai filloi të tregonte fije e për pe, por nuk e nisi tregimin nga Madalena Harti, por nga vetja. Ai kishte qenë fëmijë i nomenklaturës, elitës komuniste të Bashkimit Sovjetik. Babai i tij kishte qenë zyrtar i lartë në Ministrinë e Jashtme, në qeverinë e Andrei

Gromykos. Kjo tregonte se Zhirovi ishte arsimuar në shkolla apostafat për fëmijët e elitës dhe kishte bërë pazar në dyqanet e hapura vetëm për Partinë, të cilat tregtonin mallra luksoze, nga ato që shumica e qytetarëve sovjetikë mund t'i shihnin vetëm në ëndërr. Pastaj foli për udhëtimet e tij luksoze jashtë shtetit. Zhirovi e kishte kaluar pjesën më të madhe të fëmijërisë jashtë Bashkimit Sovjetik. Kryesisht në shtetet vasale sovjetike në Europën Lindore, që ishin edhe fusha e ekspertizës së të atit. Kishte kaluar edhe gjashtë muaj në Nju Jork kur babai i tij kishte punuar për Kombet e Bashkuara. Ai e urrente Nju Jorkun, sepse, si fëmijë besnik i Partisë, ishte mbrujtur me idenë për ta përçmuar atë.

- Për ne, pasuria dhe makutëria e Shteteve të Bashkuara nuk ishin diçka për t'u pasur zili, - tha ai, - por një vegël që mund ta përdornim kundër amerikanëve për t'i shkatërruar ata.

Pavarësisht se kishte qenë një student indiferent dhe shpesh edhe problematik, Zhirovi ia kishte dalë të pranohej në Universitetin prestigjioz të Moskës, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Pas diplomimit, u tha se mund të punonte në ministrinë e Punëve të Jashtme, por një ditë në derën e Zhirovit u shfaq një rekrutues i Komitetit për Sigurinë e Shtetit, thënë ndryshe, KGB-ja. Ai i tha se KGB-ja e kishte vëzhguar qëkurse ishte fëmijë dhe kishte bindjen se ai gëzonte atributet e duhura për t'u bërë një agjent sekret i suksesshëm.

- Pa dyshim, mua m'u bë shumë qejfi, - rrëfeu Zhirovi. - Ishte viti 1975. Fordi dhe Brezhnjevi po ia dilnin mirë në Helsinki, por pas fasadës së tyre zhvillohej ende lufta mes Lindjes dhe Perëndimit, kapitalizmit dhe socializmit, dhe unë do të isha pjesë e këtyre.

Por fillimisht, duhej të kryente edhe një shkollë tjetër: Institutin "Flamuri i Kuq", qendrën e trajnimit të KGB-së në Moskë. Atje mori bazat e punës në Shërbimin Sekret. Megjithëkëtë, kryesisht u specializua në rekrutimin e agjentëve, që, për KGB-në, ishte një proces tejet i zvarritur dhe i kontrolluar, i cili zgjaste një vit ose diçka më shumë. Pas përfundimit të trajnimit e kishin emëruar në Departamentin e Pestë të Direktoratit të Parë dhe e hodhën në Bruksel. Më pas, edhe në disa vende të tjera të Europës Perëndimore, derisa eprorët e Zhirovit në Moskë kuptuan se ai kishte prirje për punë më të errëta të Shërbimit

Sekret. Kështu, e transferuan në Departamentin S, njësinë që vigjilonte agjentët sovjetikë që jetonin "ilegalisht" jashtë shtetit. Më pas punoi për Departamentin V, divizionin e KGB-së që merrej me *mokriye dela*-n.

- Sektori i vrasjeve, - tha Gabrieli.

Zhirovi pohoi me kokë.

- Unë nuk kam qenë vrasës, si ti, Alon. Isha organizator dhe planifikues.

- Ke kryer operacione "flamuri i rremë" kur ishe në Departamentin V?

- Ne bëjmë gjatë gjithë kohës operacione të tilla, - rrëfeu Zhirovi. - Madje, janë procedurë standarde. Nuk i afrohemi kurrë një objektivi nëse nuk kemi gati një plan për t'ia lënë në derë dikujt tjetër përgjegjësinë.

- Sa kohë punove për Departamentin V?

- Deri në fund.

Me këtë fjalë, nënkuptonte fundin e Bashkimit Sovjetik, i cili erdhi në dhjetor të vitit 1991. Brenda një nate, superfuqia e deriatëhershme u kthye në pesëmbëdhjetë kombe të ndara. KGB-ja u nda në dy shërbime. Nuk kaloi shumë dhe Qendra e Moskës, dikur një katedrale e inteligjencës, ra në vështirësi. Në muret e jashtme të ndërtesës nisën të shfaqeshin të çarat e para dhe holli i saj u mbush me mbeturina. Nëpër korridoret e saj nisën të qarkullonin oficerë të parruar, me rroba të zhubravitura, të dalldisur nga alkooli.

- As letër higjienike në tualet nuk gjeje më, - tha Zhirovi me neveri. - Qendra e Moskës u bë si një stallë derrash dhe në krye të saj nuk ishte më askush.

Por e gjitha kjo do të ndryshonte kur Boris Jelcini më në fund do të dilte nga skena dhe kontrollin e Kremlinit ta merrnin *siloviki*-t, agjentët e Shërbimit Sekret. Pothuajse menjëherë, ata urdhëruan SVR-në të shtonte operacionet kundër Shteteve të Bashkuara dhe Britanisë së Madhe, dy aleatëve zyrtarë të Federatës së re Ruse. Zhirovi u emërua ambasador i SVR-së në Uashington, një nga postet më të rëndësishme në SVR. Por ditën kur do të nisej për në Uashington, e thirrën në Kremlin. Dukej se presidenti, një koleg i vjetër i OKB-së, donte të fliste me të.

- Mendova se do të më jepte ndonjë këshillë për punën time në Uashington, - tha Zhirovi, - por doli se kishte plane të tjera për mua.

- Volgatekun, - tha Gabrieli.

Zhirovi pohoi me kokë dhe tha:

- Po, Volgatekun.

Zhirovi tha se për të kuptuar atë që ndodhi më vonë, fillimisht duhej kuptuar rëndësia që ka nafta për Rusinë. Ai u kujtoi të pranishmëve se për dekada me radhë Bashkimi Sovjetik kishte qenë prodhuesi i dytë në rang botëror i naftës, duke lënë pas vetëm Arabinë Saudite dhe Emiratet e Bashkuara. Kriza e naftës në vitet 1970 dhe 1980 i dha një dorë të mirë ekonomisë së lëkundur sovjetike.

- Ajo shërbeu si oksigjen për ne, - tha Zhirovi. - Na zgjati jetën në një kohë kur truri ynë kishte reshtur së funksionuari. Presidenti i ri rus kuptoi atë që nuk kishte kuptuar dot Boris Jelcini: që nafta mund ta rikthente Rusinë në një superfuqi. Kështu, ai u tregoi derën oligarkëve si Viktor Orlovi dhe ia kaloi Kremlinit kontrollin e sektorit të energjetikës. Pastaj krijoi edhe kompaninë e tij të naftës.

- Nafta dhe Gazi KGB, - tha Gabrieli.

- Pak a shumë, - pohoi Zhirovi duke pohuar ngadalë me kokë. - Vetëm se kompania jonë ishte ndryshe. Na u kërkua të siguronim licenca për të marrë naftë *jashtë* Rusisë. Të gjithë ishim anëtarë të KGB-së. Madje, një përqindje e lartë e fitimeve tona tani, kalon direkt e në llogaritë në Jasenevo.

- Po pjesa tjetër?

- Po ja, si thua ti?

- Në xhepat e presidentit rus?

- E po, ai nuk u bë një nga njerëzit më të pasur të Europës vetëm me pensionin e tij. Presidenti ynë vlen afro katër miliardë dollarë dhe pjesën më të madhe të pasurisë e ka vënë nga Volgateku.

- Kujt i lindi ideja për të marrë naftë në Detin e Veriut?

- Atij, - u përgjigj Zhirovi. - Madje e mori si personale. Tha se donte që Volgateku të zgjaste kthetrat edhe në ujërat e territorit britanik dhe t'i thithte ato deri në pikën e fundit. Që ta dini, - shtoi ai, - unë isha kundër që në fillim.

- Pse?

- Pjesë e punës sime si shef i sigurimit dhe operacioneve ishte të vëzhgoja territorin objektiv para se të bënim ndonjë lëvizje për të marrë licencën. Vlerësimi im për situatën në Britani nuk ishte pozitiv. Parashikova që tensionet politike mes Londrës dhe Moskës do të bënin që ata ta refuzonin kërkesën tonë për të nxjerrë naftë në Ishujt Perëndimorë. Mjerisht, doli se kisha pasur të drejtë.

- Besoj se presidenti mbeti i zhgënjyer.

- Nuk e kisha parë ndonjëherë aq të zemëruar, - tha Zhirovi. - Kryesisht sepse dyshonte se në atë punë kishte gisht Viktor Orlovi. Më thirri në zyrën e tij në Kremlin dhe më tha të përdorja çdo mënyrë të mundshme për ta shtënë në orë atë kontratë.

- Ti ia vure syrin Xheremi Falonit.

Zhirovi ngurroi një çast, para se të përgjigjej:

- Duket që paske burime të sigurta në Londër.

- I dërgove pesë milionë euro në një llogari bankare në Zvicër, - i tha Gabrieli. - Ky ishte shpërblimi yt për Falonin që të ta siguronte atë kontratë.

- Ama, edhe ai nuk na e bëri të lehtë. Nuk besoj se është nevoja ta them, - shtoi ai, - por u zhgënjyem shumë nga ai. Tha se nuk kishte ç'të bënte, sepse Lankasteri dhe ministri i Energjetikës e kishin ndarë mendjen për jo. Duhej të bënim diçka për të ndryshuar dinamikën e çështjes.

- Atëherë rrëmbyet të dashurën e kryeministrit.

Zhirovi nuk u përgjigj.

- Thuaje, mos ki frikë, - i tha Gabrieli, - përndryshe, uji i liqenit aty është, nuk ikën.

- Po, - tha Zhirovi duke parë nga kamera. - Unë e rrëmbeva të dashurën e kryeministrit.

- Si e more vesh që Lankasteri ishte i lidhur me të?

- Rezidentura e Londrës kishte dëgjuar prej kohësh të flitej se një vajzë e re e partisë së tyre shkonte mbrëmjeve vonë në *Downing Street*. U thashë ta shikonin mirë atë punë dhe nuk kaloi shumë kohë derisa u mor vesh se kush ishte në të vërtetë.

- E dinte Faloni që ti do ta rrëmbeje vajzën?

Zhirovi tundi kokën.

- Prita derisa mora rrëfimin e Madalenës për t'i thënë Falonit që ajo punë ishte vepra jonë. I thashë ta përdorte atë mundësi për të mbyllur marrëveshjen, përndryshe, do ta fundosja edhe atë.

- Do të përdorje faktin që kishte marrë një ryshfet prej pesë milionë euro nga një kompani nafte ruse në pronësi të Kremlinit?

Zhirovi pohoi me kokë.

- Kur u lidhe me të?

- Shkova në Londër kur ti dhe shoku yt nga Korsika po i binit Francës kryq e tërthor për ta gjetur. Lankasteri ishte aq i dëshpëruar sa i tha Falonit të bënte ç'të donte. Kështu, Faloni e aprovoi marrëveshjen pavarësisht nga kundërshtimet e ministrit të Energjetikës. Pastaj unë shkrova finalen e dramës.

- Kërkesën për paratë? - tha Gabrieli. - "Dhjetë milionë euro, në të kundërt, vajza është e vdekur". Faloni e paska ditur gjatë gjithë kohës që kjo ishte një maskaradë për të fshirë gjurmët e rolit të Volgatekut në zhdukjen e Madalenës.

- Edhe rolit të tij, - shtoi Zhirovi.

- Sa dijeni kishte Lankasteri për këtë?

- Ai nuk ka ditur asgjë, - ia ktheu Zhirovi. - Ai mendon ende se ka paguar dhjetë milionë për të shpëtuar të dashurën dhe karrierën e tij politike.

- Përse këmbëngule që t'i dorëzoja unë paratë?

- Donim të talleshim pak me ty.

- Duke vrarë Madalenën para syve të mi?

Zhirovi heshti.

- Thuaje për kamerat, Pavel! Pranoje që e vrave ti Madalenën!

- Unë e vrava Madalena Hartin - tha ai sikur po recitonte.

- Si e vrave?

- E futa në bagazhin e *Citroën*-it dhe i vura flakën makinës.

- Pse? - e pyeti Gabrieli. - Pse e vrave?

- Ajo duhej të vdiste, - tha Zhirovi. - Nuk mund ta lejonim të kthehej në Angli.

- Po mua përse nuk më vratë?

- Më beso, Alon, nuk e ke idenë sesa donim të të vrisnim edhe ty, por

menduam se na bëje më shumë punë i gjallë sesa i vdekur. Kush më mirë se i madhi Gabriel Alon do ta vërtetonte se Madalena ishte vrarë si pjesë e një skeme rrëmbimi?

- Ku janë dhjetë milionë eurot?

- Ato ia dhurova presidentit të Rusisë.

- Do të doja të m'i kthenit.

- Të uroj t'i marrësh.

Gabrieli e vendosi sërish mbi tryezë fotografinë e drekës në restorantin "Les Palmiers".

- Çfarë po ndodh këtu? - e pyeti.

- Besoj se këtë mund ta quash fazën e fundit të një "rekrutimi romantik".

Gabrieli u ngrys dhe e pa me dyshim.

- Pse një bukuroshe si Madalena do t'ia varte një plehre si ti?

- Unë jam i aftë në punën time, Alon. Si ti. Pastaj, - shtoi Zhirovi, - ajo ishte një vajzë e vetmuar, ishte pre e lehtë.

- Shikoje veten, Pavel, - i tha Gabrieli duke e parë fotografinë më me vëmendje. - Është e çuditshme, - shtoi pas pak, - por shumë të rehatuar dukeni.

- Aty jemi në mbledhjen tonë të tretë.

- Mbledhjen?

- Takimin, desha të them, - tha ai. - Ndonjëherë ngatërrohem në anglisht.

- Mua nuk më duket sikur po ia kaloni shumë mirë, - tha Gabrieli pa ia hequr sytë fotografisë. - Madje, po të mos e dija se si është puna, mund të thosha që po ziheni.

- Nuk po ziheshim, - tha Zhirovi aty për aty.

- Je i sigurt?

- Po, jam.

Gabrieli e hoqi fotografinë mënjanë pa folur.

- Ke ndonjë pyetje tjetër? - e pyeti Zhirovi.

- Vetëm një, - tha Gabrieli. - Si e more vesh që Madalena ishte e dashura e Lankasterit?

- Ta kam dhënë përgjigjen për këtë pyetje.

- E di, - tha Gabrieli, - por këtë herë dua të më thuash të vërtetën.

Ai nisi të tregonte sërish të njëjtën histori: se e kishin vënë në dijeni nga rezidentura e tyre në Londër, por Gabrieli nuk dëgjonte nga ai vesh. I dha Zhirovit edhe një mundësi të fundit dhe, pasi dëgjoi të njëjtën gënjeshtër, e çoi rusin prapë në fund të dokut dhe i vuri tytën e pistoletës Makarov pas qafe. Atje, në buzë të liqenit të ngrirë, pa emër, doli e vërteta. Një pjesë të saj Gabrieli e kishte dyshuar gjatë gjithë kohës, megjithatë, nuk mund ta besonte historinë e Zhirovit. Por, duhej të ishte e vërtetë, mendoi. Madje, ishte shpjegimi i vetëm për të gjitha ato që kishin ndodhur.

Kur u kthyen brenda *dacha*-s Zhirovi e tregoi të gjithë historinë edhe një herë nga e para me qëllimin që të regjistrohej, para se ta lidhnin dhe ta kthenin sërish në tunel. Operacionit pothuajse i kishte ardhur fundi. Kishin provat që Volgateku e kishte hapur me ryshfet dhe mashtrim rrugën për në tregun joshës të naftës së Detit të Veriut. Tani duhej vetëm të shkonin në aeroport dhe të niseshin me avionë të ndryshëm për në shtëpi. Ose, sugjeroi Gabrieli, mund ta shtynin pak nisjen për të bërë edhe një punë të fundit. Ky ishte një vendim që nuk mund ta merrte i vetëm dhe si rrallëherë, e hodhi në votë. Nuk pati asnjë kundërshtim.

53

SHËN PETERBURG, RUSI

Gabrieli tha se ishte më e sigurt të udhëtonin me tren. Në qytetin e Okulovkës kishte një stacion treni. Mund të kapte trenin e parë në mëngjes dhe të mbërrinte në Shën Peterburg pradite. Me vete, u lehtësua që Eli Lavoni këmbënguli ta shoqëronte. Kishte nevojë për sytë e tij. Po ashtu, i duhej edhe rusi i tij.

Rruga deri në Okulovka zgjaste vetëm 70 kilometra, por rrugët e tmerrshme dhe moti i keq bënë që udhëtimi për atje të zgjaste pothuajse dy orë. *Volvo Suv*-in e lanë në një parking të vogël, të rrahur nga era, dhe nxituan për në stacionin e sapongritur. Ai ishte i tëri me tulla të kuqe, si fabrikë. Kur Lavoni arriti t'i rrëmbente dy bileta të klasit të parë dy sportelistëve pas xhamit të kabinës së mbyllur, treni ishte gati për t'u nisur.

Ata zunë vend në një kabinë ku ndodheshin dy vajza ruse, të cilave nuk u mbyllej goja dhe një biznesmen i veshur me elegancë, i cili nuk e ngriti për asnjë çast kokën nga celulari. Lavoni e kaloi kohën duke lexuar gazetat e mëngjesit të Moskës, në të cilat nuk kishte asnjë artikull për zhdukjen e një zyrtari të një kompanie nafte. Tej dritares së ngrirë Gabrieli pa fushat e pafundme të mbuluara nga bora, derisa sikur e koti gjumi.

Kur treni frenoi në stacionin "Moskovski" të Shën Peterburgut, ai kërceu në këmbë. Stacioni dukej i trazuar. Treni i pasdites për në Moskë ishte

vonuar për shkak të një kërcënimi për bombë nga çeçenët. I udhëhequr nga Lavoni, Gabrieli çau rrugën mes fëmijëve që qanin dhe çifteve që ziheshin dhe mori për nga sheshi "Vostanija". Obelisku i Heroit të Qytetit ngrihej drejt qiellit në qendër të sheshit të mbytur nga trafiku, me një yll të artë që dëbora ia kishte marrë shkëlqimin. Dritat e rrugës përshkonin gjithë bulevardin "Nevsky". Ishte vetëm ora dy e pasdites, por dritë dielli nuk të zinte syri kurrkund.

Gabrieli ecte nëpër shesh me Lavonin, i cili nuk i ndahej, vigjilent. *Tani nuk jam më në Rusi*, mendoi. *Ndodhem në një tokë ëndrrash cariste, të importuar nga perëndimi dhe të ndërtuar nga fshatarë të terrorizuar. Nga fasadat e pallateve baroke, më thërret Firence*. Teksa kalonte lumin Mojka, ëndërroi për Venecian. Mendoi se sa trupa fshiheshin poshtë akullit të tij. Me mijëra. Dhjetëra mijëra. Asnjë qytet tjetër në botë nuk dinte t'i fshihte më bukur se Shën Peterburgu tmerret e së kaluarës.

Kur po i afrohej fundit të shëtitores, sikur iu vranë sytë: godina e vjetër e Flotës Ajrore, një monstruozitet i kobshëm i frymëzuar nga Pallati i Doxhit në Venecia, edhe me një dozë të Fiorentine Mediçit për të qenë më të sigurt. Gabrieli u kthye në rrugën "Bolshaja Morskaja", të cilën e ndoqi për të kaluar nga Harku i Triumfit deri në sheshin "Pallati". Kur po i afrohej Kolonës së Aleksandrit, Lavoni iu afrua dhe i tha se nuk po i ndiqte kush. Gabrieli pa orën e dorës, që dukej sikur kishte ngrirë. Ajo shënonte 14:20. *Ndodh çdo ditë njësoj,* kishte thënë Zhirovi. *Të gjithë bëhen si të çmendur kur kthehen në shtëpi pasi kanë ndenjur gjatë në të ftohtë.*

Ngjitur me sheshin "Pallati" ishte një park i vogël, i cili gjatë verës kishte gjelbërim, por në dimër ishte i tëri i mbuluar nga bora. Lavoni priti atje, në një stol të akullt, teksa Gabrieli ecte i vetëm në rrugë. Lumi Neva ishte ndalur nga akulli. Ai pa edhe njëherë orën, për herë të fundit. Pastaj qëndroi i vetëm në breg të tij, pa lëvizur, si lumi gjigant, teksa priste një vajzë të panjohur.

Atë e pa në orën 15:05, teksa kalonte urën. Kishte veshur një pallto të trashë dhe çizme të gjata deri te gjunjët. Flokët biond ia mbulonte një kapele e leshtë, ndërsa gjysmën e fytyrës një shall i trashë. Megjithëkëtë, Gabrieli e njohu në çast. Ishte ajo. E tradhtuan sytë. Sytë dhe ngjyra e faqeve. Ishte sikur vajza me vëthin prej perle e Vermerit të kishte dalë

nga kanavaca dhe të kishte nisur të ecte përgjatë bregut të lumit në Shën Peterburg. Ajo kaloi pranë tij sikur ai të ishte i padukshëm dhe vazhdoi drejt *Hermitage*-s. Gabrieli priti derisa u sigurua që nuk po e ndiqnin, pastaj i shkoi pas dhe kur ai hyri në muze, ajo ishte zhdukur. Por nuk kishte rëndësi, ai e dinte për ku ishte nisur. *Është gjithmonë e njëjta pikturë*, kishte thënë Zhirovi. *Asnjë nuk e di përse*. Ai bleu një biletë dhe eci përgjatë korridoreve dhe lozhave pa fund derisa mbërriti në sallën 67, sallën e Monetit. Atje, ajo qëndronte ulur e vetme, me sytë të ngulur te *The Pond at Montgeron*. Kur Gabrieli u ul pranë saj, ajo i hodhi një shikim përciptazi dhe iu rikthye studimit të pikturës. Maskimi i tij ishte më i mirë se i saji. Ai nuk i bëri asnjë përshtypje asaj. Në fakt, ai mendoi se nuk i kishte bërë asnjëherë përshtypje.

Pasi kaloi edhe një minutë dhe ai nuk kishte luajtur vendit, ajo u kthye dhe e pa për herë të dytë. Atëherë vuri re se ai kishte një kopje të librit "Mos e lufto pranverën" në prehër.

- Kam përshtypjen se ky të përket ty, - i tha ai dhe ia vendosi librin ngadalë në dorën që nisi t'i dridhej.

54

SHESHI "LUBJANKA", MOSKË

Në katin e katërt të zyrave qendrore të FSB-së ndodhen disa zyra në të cilat punon njësia më e vogël dhe më e fshehtë e asaj organizate. E njohur me emrin Departamenti i Koordinimit, ajo merret vetëm me çështjet me ndjeshmëri të lartë politike, zakonisht me urdhër të vetë presidentit rus. Atë çast, shefi i saj prej shumë kohësh, koloneli Leonid Milçenko, ishte ulur në tryezën e tij madhështore të prodhuar në Finlandë, me telefonin në vesh dhe sytë nga sheshi "Lubjanka". Vadim Strelkini, zëvendësi i tij, qëndronte te dera në ankth. Nga mënyra sesi Milçenko kishte përplasur derën, ai e kishte kuptuar se i priste një natë e gjatë.

- Kush ishte? - pyeti Strelkini.

Milçenko nuk u përgjigj.

- Dreqin! - tha Strelkini.

- Jo dreqin, Vadim. Naftë!

- Çfarë donte?

- Të flasim privatisht.

- Ku?

- Në zyrën e tij.

- Kur?

- Para pesë minutash.

- Përse mendon se të kërkon?

- Gjithçka mund të jetë, - tha Milçenko. - Por nëse ka lidhje me Volgatekun, nuk mund të jetë diçka e mirë.

- Po bëj gati makinën, atëherë.

- Mirë do të bësh, Vadim.

Më shumë kohë iu desh të çanin trafikun e sheshit "Lubjanka" sesa të përshkonin rrugën nga zyrat qendrore të Volgatekut për në rrugën "Tverskaja". Dimitri Bershov, zyrtari i dytë më i rëndësishëm i firmës, po priste i tensionuar në holl kur hyri Milçenko dhe Strelkini. Edhe kjo nuk ishte shenjë e mirë. Ai nuk foli asnjë fjalë teksa i udhëhoqi për te ashensori privat që të çonte drejt e te një zyrë në katin e fundit të godinës. Milçenko nuk kishte parë kurrë zyrë më të madhe në Moskë. Iu deshën disa sekonda për të vënë re Genadi Lazarevin, i cili kishte zënë vend në fund të një divani të gjatë. Milçenko vendosi të qëndronte në këmbë teksa presidenti i Volgatekut i shpjegoi se Pavel Zhirovi, kreu i sigurisë së kompanisë së tij, ishte zhdukur pa lënë gjurmë që nga ora njëmbëdhjetë e mbrëmjes së kaluar. Milçenko e njihte mirë atë. Ai dhe Zhirovi kishin punuar bashkë në KGB. Hodhi një bllok shënimesh me kapak lëkure mbi tavolinën prej xhami dhe u ul.

- Çfarë ndodhi mbrëmë në orën njëmbëdhjetë?

- Po festonim në "Cafe Pushkin" marrjen në punë të një punonjësi të ri. Meqë ra fjala, - shtoi Lazarevi, - është zhdukur edhe punonjësi i ri. Po ashtu, edhe shoferi.

- Këtë të kishit thënë që në fillim.

- Do ta thosha.

- Si quhet i punësuari i ri?

Lazarevi u përgjigj.

- Është rus?

- Jo plotësisht.

- Si "jo plotësisht"?

- Është me prejardhje ruse, por ka pasaportë britanike.

- Atëherë, qenka britanik.

- Po.

- Ka ndonjë gjë tjetër që duhet ta di për të?

- Aktualisht është punonjës i Viktor Orlovit në Londër.

Milçenko shkëmbeu një vështrim të gjatë me Strelkinin para se të shikonte pa folur bllokun e tij të shënimeve. Nuk kishte mbajtur ende asnjë shënim dhe ndoshta më mirë kështu. Ishin zhdukur një ish-oficer i KGB-së dhe një punonjës i kundërshtarit më të ashpër të Kremlinit. Milçenko po fillonte të mendonte se duhej të mos kishte ardhur fare në punë atë ditë.

- Besoj se janë larguar bashkë nga "Cafe Pushkin"-i, - tha ai më në fund.

Lazarevi pohoi me kokë.

- Pse?

- Paveli donte t'i bënte disa pyetje.

- Përse nuk më habit kjo?

Lazarevi nuk foli.

- Çfarë pyetjesh donte t'i bënte? - e pyeti Milçenko.

- Paveli kishte dyshime për të.

- Çfarë dyshimesh?

- Mendonte se mund të ishte ndonjë agjent i huaj sekret.

- Përmendi ndonjë shtet në veçanti?

- Për arsye që besoj se ti i di, - tha Lazarevi me kujdes, - dyshimet e tij përqendroheshin kryesisht te britanikët.

- E si kishte planifikuar ta merrte në pyetje? Siç di ai?

- Ai do t'i bënte vetëm disa pyetje, - tha Lazarevi.

- Po nëse nuk i pëlqenin përgjigjet e tij?

- *Atëherë* besoj se do t'ia tregonte vendin.

- Më vjen mirë që e sqaruam këtë.

Telefoni pranë bërrylit të Lazarevit, ra. Ai ngriti receptorin, e afroi pranë veshit, dëgjoi në qetësi dhe pastaj tha "Menjëherë" dhe e uli.

- Kush ishte? - pyeti Milçenko.

- Presidenti.

- Mos e lër të presë.

- Në fakt, - tha Lazarevi, - të kërkonte ty, jo mua.

55

SHËN PETERBURG, RUSI

A të çast, njeriu që mbante përgjegjësi për thirrjen e Milçenkos në Kremlin, po ecte përgjatë "Admiralty Prospekt" në Shën Peterburg. Të ftohtin nuk e ndiente më përveçse në pjesën e krahut të tij që kishte prekur dora e saj para se të ndaheshin. Zemra sa nuk po i dilte nga kraharori. Me siguri që atë e mbanin në vëzhgim. Nisi t'i thoshte vetes lloj-lloj gënjeshtrash për të larguar frikën. Mendoi se nuk ishte në Rusi, por në Venecia, Romë, Firence ose Paris. Mendoi se ishte i sigurt, po ashtu, edhe ajo.

Para tij u shfaq katedralja e Shën Isakut, kisha kolosale prej mermeri që sovjetikët e kishin kthyer në muzeun e ateizmit. Hyri dhe eci deri te shkallarja e ngushtë që të çonte te kupola e rrethuar nga një kube e vetme, e artë. Ishte ashtu si e kishte parashikuar ai: ajo ishte bosh. Qyteti i përrallave shtrihej poshtë këmbëve të tij, me trafikun që bënte përpara ngadalë nëpër rrugë. Në njërën prej tyre gjendej një grua, e cila ecte e vetme, me kapelën që i mbulonte flokët biondë dhe shallin që i mbulonte gjysmën e fytyrës. Disa çaste më pas, ai ndjeu hapat e saj nëpër shkallare dhe më pas, ishin ballë për ballë. Në kupolë nuk kishte drita dhe ajo mezi dallohej.

- Si më gjete?

Tingulli i zërit të saj dukej thuajse i pavërtetë. Theksi anglez... Pastaj Gabrieli kujtoi se ai ishte theksi i vetëm që ajo njihte.

- Nuk ka rëndësi sesi të gjeta, - ia ktheu ai.

- Si më gjete? - këmbënguli ajo, por këtë herë Gabrieli nuk i ktheu fare përgjigje, por u afrua edhe një hap për ta parë më mirë.

- Më mban mend tani, Madalena? Jam njeriu që rrezikoi gjithçka për të të shpëtuar jetën ty. Asokohe as që ma mori mendja se ti kishe luajtur që në fillim. Luajte me mua, Madalena. Luajte me të gjithë ne.

- Unë nuk *luajta*, - ia ktheu ajo. - Unë thjesht zbatoja urdhrat.

- E di, - tha ai pas pak. - Përndryshe nuk do të kisha ardhur këtu.

- Kush je ti?

- Në fakt, - tha Gabrieli, - këtë pyetje do të ta bëja unë ty.

- Unë jam Madalena, - tha ajo. - Madalena Harti nga Basildoni, i Anglisë. Kam qenë vajzë e rregullt. Kam qenë gjithnjë e shkëlqyer në mësime, fillova punë në selinë qendrore të partisë. Më priste një e ardhme e ndritur. Një ditë mund të bëhesha edhe ministre... - aty heshti për pak, pastaj shtoi: - Të paktën kështu thoshin të tjerët për mua.

- Si e ke emrin e vërtetë?

- Unë nuk e di emrin tim të vërtetë, - u përgjigj ajo. - Edhe rusisht mezi flas. Unë *nuk* jam ruse. Unë jam Madalena, jam angleze.

Ajo nxori kopjen e librit "Mos e lufto pranverën" nga xhepi dhe ia ngriti atij para fytyrës:

- Po këtë ku e gjete? - e pyeti.

- Në dhomën tënde.

- Çfarë doje ti në dhomën time?

- Doja të mësoja pse nëna jote u largua nga Basildoni pa i thënë askujt.

- Ajo nuk është nëna ime.

- Tani e di këtë. Madje, - shtoi ai, - kam përshtypjen se e kuptova qëkur pashë një fotografi tënden dhe të prindërve të tu. Ata dukeshin si...

- Fshatarë, - tha ajo me përçmim. - Sa i urreja!

- Ku janë nëna dhe vëllai yt tani?

- Në një qendër të vjetër trajnimi të KGB-së, në mes të hiçit. Duhej të shkoja edhe unë atje, por nuk pranova. U thashë të më lejonin të jetoja në Shën Peterburg, përndryshe do t'i kallëzoja në Perëndim.

- Je me fat që nuk të kanë vrarë.

- Më kërcënuan, në fakt, - tha ajo dhe ia nguli sytë për një çast. - Sa di ti për mua tani?

- Di që babai yt ka qenë një gjeneral në Direktoratin e Parë të KGB-së, ndoshta edhe vetë shefi i madh. Nëna jote ishte një prej daktilografeve të tij. Ajo mori mbidozë qetësuesish dhe vodke pak pas lindjes tënde, ose të paktën kështu thonë. Pastaj, ti u rrite në një jetimore.

- Në jetimoren e KGB-së, - ia priti ajo aty për aty. - Më kanë rritur ujqërit, me plot kuptimin e fjalës.

- Dikur, - nisi ta plotësonte Gabrieli, - filluan të të mos flisnin më rusisht në jetimore. Madje, nuk flisnin fare në praninë tënde. Ti u rrite në heshtje të plotë deri në moshën trevjeçare. Pastaj nisën të të flisnin anglisht.

- Anglishten e KGB-së, - tha ajo. - Për pak kohë unë flisja si folësit rusë të lajmeve në anglisht.

- Kur i njohe për herë të parë prindërit e tu të rinj?

- Rreth moshës pesëvjeçare. Jetuam bashkë në një kamp të KGB-së për ndonja një vit, që të afroheshim me njëri-tjetrin. Pastaj u vendosëm në Poloni. Kur nisi emigrimi i polakëve për në Londër, u bashkuam me ta. Prindërit e mi të KGB-së tanimë flisnin shumë mirë anglisht. U pajisën me identitete të reja dhe filluan të merreshin me spiunazh të nivelit të ulët. Kryesisht, merreshin me rritjen dhe kujdesin tim. Nuk flisnim kurrë rusisht në shtëpi. Vetëm anglisht. Nuk kaloi shumë dhe thuajse e harrova që isha ruse. Lexoja libra që të bëhesha si të gjitha vajzat angleze. Lexoja *Jane Austen*-in, *Dickens*-in, *Lawrence*-in dhe *Forster*-in.

- "Mos e lufto pranverën".

- Po, edhe unë, ashtu si Lusi, doja një dhomë me pamje.

- Përse vendosët të jetonit në shtëpitë shtetërore në Basildon?

- Asokohe isha rreth nëntëmbëdhjetë vjeçe, - tha ajo. - Rusia ishte trokë. SVR-ja po rrënohej. Nuk kishte buxhet për të mbajtur një familje ilegalësh në Londër dhe na dërguan në Basildon. Qeveria britanike e futi vetë gjarprin në gji.

- Çfarë ndodhi me babanë tënd?

- E zuri sëmundja e marrëzisë.

- Deshi të hiqte dorë?

Ajo pohoi me kokë.

- U tha atyre të Qendrës së Moskës ta linin të lirë, përndryshe do të shkonte te MI5-a. Qendra e thirri në Rusi dhe Zoti e di se ç'u bë me të.

- *Vysshaya mera*.

- Çfarë do të thotë kjo?

- Nuk ka rëndësi.

Tani rëndësi ka vetëm kjo vajzë, mendoi ai dhe picërroi sytë në sheshin e kredhur në errësirë, ku pa Eli Lavonin duke përplasur këmbët nga i ftohti. E pikasi edhe Madalena.

- Kush është ai?

- Një shok.

- Vëzhgues është?

- Më i miri.

- Bën mirë të jetë, - tha ajo dhe u kthye e nisi të ecte ngadalë.

- Kur të aktivizuan ty? - e pyeti Gabrieli duke parë nga pas siluetën e saj të gjatë dhe elegante.

- Kur isha në universitet, - ia ktheu ajo. - Më thanë se do të më përgatitnin për karrierë qeveritare. Unë studioja Shkenca Politike dhe Punë Sociale dhe shumë shpejt e gjeta veten duke punuar në selinë qendrore të partisë. Ata të Qendrës së Moskës u ngazëllyen. Pastaj më mori në patronazh Xheremi Faloni. Për Qendrën nuk kishte më mirë se kaq.

- Shkove në shtrat me të?

Ajo u kthye dhe vuri buzën në gaz për herë të parë.

- E ke parë ndonjëherë Xheremi Falonin ti?

- Po.

- Atëherë me siguri do të më besosh kur të të them: "Jo, nuk kam shkuar në shtrat me Xheremi Falonin". Natyrisht që atij ia kishte qejfi sa më s'ka, por unë e mbaja me shpresa, sa për të më plotësuar çdo tekë.

- Çfarë teke, për shembull?

- Për shembull, një takim të shkurtër vetëm për vetëm me kryeministrin.

- E kujt qe kjo ide?

- E Qendrës së Moskës, natyrisht, - ia ktheu ajo. - Unë nuk hidhja asnjë hap pa aprovimin e tyre.

- Ata mendonin se Lankasteri ishte aq i dobët sa të binte pre e një afrimi të tillë?

- Të gjithë *janë* të dobët, - u përgjigj ajo. - Mjerisht, edhe Xhonatani ra pre e tundimit. Pasi bëri dashuri për herë të parë me mua, ra brenda kokë e këmbë.

- Urime! - i tha Gabrieli. - Duhet të jesh shumë krenare për veten.

Ajo u kthye vrik dhe e pa në sy për një çast, pa folur, pastaj tha:

- Nuk jam aspak krenare për ato që kam bërë. Xhonatani më hyri në zemër. Nuk doja t'i ndodhte asgjë e keqe.

- Atëherë përse nuk i the të gjithë të vërtetën?

- Nuk është se s'më shkoi mendja.

- Po çfarë ndodhi?

- Shkova me pushime në Korsikë, - tha duke buzëqeshur e trishtuar, - dhe pastaj vdiqa. Kaq.

Por, natyrisht që nuk ishte vetëm kaq. Duke filluar nga mesazhi që i kishte ardhur asaj nga Qendra e Moskës, ku e udhëzonin të takohej me një koleg, oficer të SVR-së, në restorantin "Les Palmiers" në Kalvi. Oficeri i tha se misioni i saj në Angli kishte përfunduar, ajo duhej të kthehej në Rusi dhe duhej të inskenonin një rrëmbim për të humbur gjurmët e Shërbimit Sekret Britanik.

- Aty u zutë, - i tha Gabrieli.

- Ishte një debat i zhvilluar në qetësi, por i ashpër, - tha ajo. - Unë i thashë se doja të jetoja në Angli deri në fund të jetës dhe të jetoja si Madalena Harti. Më tha se kjo ishte e pamundur, se nëse nuk bëja ashtu si thoshte ai, rrëmbimi nuk do të qe më një inskenim, por një ngjarje e vërtetë.

- Dhe ti u largove nga vila me motorin tënd dhe bëre aksident.

- Jam me fat që nuk më vranë fare. I kam ende shenjat nga ai aksident.

- Sa kohë kalove në duart e kriminelëve francezë?

- Shumë, - u përgjigj ajo. - Por shumicën e kohës isha me një skuadër të SVR-së.

- Po atë natë që erdha të të takoja unë?

- Të gjithë ata që ishin në atë shtëpi, ishin të SVR-së. Edhe vajza që erdhi të numëronte paratë.

- Aktrove shumë mirë atë natë, Madalena.

- Nuk ishte e gjitha aktrim, - tha ajo, pushoi pak dhe pastaj shtoi: - Unë doja vërtet që të më merrje.

- Unë u përpoqa, - tha Gabrieli, - por gjithçka ishte kundër meje.

- Duhet të ketë qenë e tmerrshme.

- Sidomos për vajzën që i morën jetën në bagazhin e asaj makine.

Ajo nuk foli.

- Kush ishte ajo?

- Njëra që e morën nga rrugët e Moskës. Shpërndanë ADN-në e saj nëpër apartamentin tim në Londër dhe pastaj... - aty Madalenës iu shua zëri.

- Pastaj i vunë shkrepësen.

Ajo u nxi në fytyrë, ktheu kokën mënjanë dhe ia nguli sytë qytetit të ngrirë në errësirë.

- E di që nuk është keq edhe këtu? Më kanë dhënë një apartament të shkëlqyer. Dhomën e kam me pamje. Mund ta ngrys jetën këtu dhe të shtirem sikur po jetoj në Romë, Venecia ose Paris.

- Ose në Firence, - tha Gabrieli.

- Po, ose në Firence. - tha ajo. - Si Lusi dhe Sharlota.

- Këtë doje ti?

Ajo u kthye dhe e pa sërish në sy.

- Pse, kam ndonjë zgjedhje tjetër?

- Mund të vish me mua.

- E pamundur! - tha ajo duke tundur kokën ngadalë. - Rrezikojmë të vritemi të dy.

- Madalena, nëse të gjeta në Shën Peterburg, mund edhe të të largoj që këtu.

- *Si* më gjete? - e pyeti ajo për herë të dytë.

- Këtë nuk ta them dot ende.

- Kush je ti?

- As këtë nuk ta them dot.

- Ku do të më çosh?

- Në shtëpi, - ia ktheu ai. - Vetëm se do të na duhet të bëjmë një ndalesë tjetër.

Ajo jetonte në një pallat të vjetër kaba në anën tjetër të lumit Neva. Përtej dritares, të zinte syri Pallatin Dimëror. Eli Lavon e shoqëroi tinëz deri te dera e apartamentit, ndërkohë që Gabrieli regjistrohej në hotelin "Astoria". Kur u ngjit në dhomën e tij, dërgoi një mesazh të rëndësishëm në "Bulevardin Mbreti Saul". Kopja e tij iu dorëzua në dorë Uzi Navotit, që e priti me sy të zgurdulluar. Në Tel Aviv, ora shënonte 5:47 e pasdites. Navoti e lexoi në qetësi dhe pastaj hodhi sytë nga Shamroni.

- Çfarë ka, Uzi?

- Do që të mos niset më nga Moska, por nga Shën Peterburgu.

- Pse?

- Po të ta them, nuk do ta besosh.

Navoti i dorëzoi kopjen e mesazhit Shamronit, i cili e lexoi përmes tymit të cigares. Kur ai mbaroi së lexuari, Navotit i sollën një mesazh tjetër.

- Do të na dërgojë disa video.

- Ç'përmbajtje kanë?

Para se Navoti të përgjigjej, në njërin prej monitorëve u shfaq fytyra e ënjtur e Zhirovit.

- Më duket se ky paska rënë keq nga shkallët, - tha Shamroni.

- Ka rënë disa herë, - tha Navoti.

- Çfarë thotë?

Navoti u bëri shenjë teknikëve që të ngrinin zërin e videos.

"*Na u kërkua të siguronim licenca për të marrë naftë jashtë Rusisë. Të gjithë ishim anëtarë të KGB-së. Madje, një përqindje e lartë e fitimeve tona tani, kalon direkt e në llogaritë në Jasenevo.*

– Po pjesa tjetër?

– Po ja, si thua ti?

– Në xhepat e presidentit rus?

– E po, ai nuk u bë një nga njerëzit më të pasur të Europës vetëm me pensionin e tij...

Shamroni vuri buzën në gaz.

- Tani po që i kemi në dorë, - tha ai.

- Që ç'ke me të!

- Kur niset avioni i radhës i kompanisë "El Al" për në Shën Peterburg?

Navoti shtypi disa taste në kompjuterin që kishte përpara.

- Avioni 625 niset nga aeroporti "Ben Gurion" në orën tetë të paradites. Ekuipazhi do të pushojë pak atje, në një hotel në qendër të qytetit. Në mbrëmje, kthehen sërish në Tel Aviv.

- Telefonoji kreut të linjës "El Al", - tha Shamroni. - Thuaji që ai avion na duhet ne.

Navoti iu afrua telefonit, teksa Shamroni ia nguli sytë sërish ekranit të monitorit.

– Thuaje për kamerat, Pavel! Pranoje që e vrave ti Madalenën!

– Unë e vrava Madalena Hartin.

– Si e vrave?

– E futa në bagazhin e Citroën-it dhe i vura flakën makinës.

– Pse? Pse e vrave?

– Ajo duhej të vdiste. Nuk mund ta lejonim të kthehej në Angli...

56

SHESHI "LUBJANKA", MOSKË

Pikërisht në kohë si kjo, mendoi koloneli Leonid Milçenko, përmasat gjigante të Rusisë ishin më shumë një mallkim sesa një bekim. Ai qëndronte përpara një harte në zyrën e tij në sheshin "Lubjanka", me Vadim Strelkinin në krah. Sapo ishin kthyer nga Kremlini, ku presidenti, cari dora vetë, i kishte urdhëruar të përdornin çdo mjet të mundshëm për gjetjen e tre të personave të zhdukur. Cari nuk u kishte shpjeguar pse gjetja e tyre kishte kaq rëndësi, por ishte mjaftuar duke u thënë se kjo prekte drejtpërsëdrejti interesat e federatës dhe marrëdhënien e saj me Mbretërinë e Bashkuar. Gjatë rrugës së kthimit për në Lubjanka, Strelkini i kishte kujtuar Milçenkos se Volgateku sapo kishte siguruar të drejtën për të nxjerrë naftë në Detin e Veriut.

- Mendon se Volgateku ka përdorur ndonjë marifet për ta marrë atë licencë? - pyeti Milçenko atë çast, pa ia hequr sytë hartës.

- Nuk më pëlqen të flas pa fakte, - ia ktheu Strelkini me maturi.

- Vadim, ne punojmë për FSB-në. Kur na kanë interesuar faktet?

- Ti e di si e thërrasin Volgatekun, apo jo, shef?

- Kompania e naftës dhe e gazit të KGB-së.

- Le ta zëmë se Volgateku nuk ka bërë lojë të pastër për ta marrë atë licencë, - tha Milçenko.

- Ata rrallë bëjnë lojë të pastër. Të paktën kështu flitet korridoreve.

- Le ta zëmë se kanë dhënë ndonjë ryshfet.

- Ose më keq akoma.

- Dakord, ta zëmë se Shërbimi Sekret Britanik reagoi duke infiltruar një agjent të tyrin në kompani.

- Le ta zëmë, - tha Strelkini duke pohuar me kokë.

- Ta zëmë gjithashtu se britanikët kanë qenë duke përgjuar kur Zhirovi e mori njeriun e tyre në makinë dhe filloi ta bombardonte me pyetje.

- Ndoshta.

- Ata menduan se njeriu i tyre ishte në rrezik.

- Ai ishte, në fakt.

- Ata reaguan duke e larguar njeriun e tyre.

- Duke marrë masa ekstreme.

- Kështu, rrëmbyen edhe Zhirovin dhe shoferin e tij.

- Ndoshta kanë qenë të detyruar.

Milçenko ra në mendime.

- Ku është Zhirovi tani? - pyeti më në fund.

- Them se ai do të dalë një ditë.

- I gjallë apo i vdekur?

- Britanikët nuk para e përdorin *mokriye dela*-n.

- Ku e ke dëgjuar këtë ti? - tha Milçenko dhe u afrua edhe një hap pranë hartës. - Çfarë do të përpiqeshe të bëje ti tani sikur të ishe britanik?

- Do ta nxirrja një orë e më parë njeriun tim nga ky vend.

- Po si?

- Them se do ta çoja në ndonjë nga pikat e kufirit me perëndimin. I bie që pika më e afërt të jetë "Sheremetyevo".

- Me siguri që do të përdorë një pasaportë tjetër.

- Edhe fytyrën do ta ndryshojë, - shtoi Strelkini.

- Shko te "Ritz"-i, - tha Milçenko. - Merr fotografitë e tij nga sigurimi i hotelit. Shpërndaja çdo oficeri të kontrollit të pasaportave dhe polici në aeroportin Sheremetyevo.

Strelkini mori të ikte.

- Edhe diçka, Vadim.

Strelkini u ndal.

- Të njëjtën gjë bëj edhe në Shën Peterburg, - tha Milçenko. - Që të jemi të sigurt.

Njeriu në fjalë atë çast po pushonte i qetë në një *dacha* të izoluar në *Tver,* bashkë me anëtarët e tjerë të skuadrës izraelite. Pak pasi ora kishte shkuar pesë e mëngjesit dhe kishin kaluar edhe një natë tjetër pa gjumë, ata dolën nga *dacha* në grupe prej dy a tri vetash dhe morën për nga stacioni i Okulovkës. Dolën të gjithë përveç Kristofer Kelerit, i cili qëndroi te *dacha* për të vëzhguar Zhirovin dhe shoferin.

Treni nga Okulovka u nis me vonesë, gjë që nuk mund të thuhej për avionin 625 të linjës "El Al". Ai u nis nga aeroporti "Ben Guron" në orën 1:10 pas mesnate dhe u ul në Shën Peterburg dy minuta para kohe, në orën 8:03 të mëngjesit. Në avion kishte vetëm dymbëdhjetë pasagjerë. Ekuipazhi i kabinës së pilotit nuk doli nga kabina pa zbritur të gjithë. Pastaj, pasi kaluan doganën, ata hipën në një furgon të "El Al"-it, me të cilin udhëtuan për njëzet minuta derisa mbërritën në hotelin "Astoria", ku kishin rezervuar dhoma për një ditë. Njëra nga stjuardesat ishte e gjatë, me flokë të zinj dhe sy ngjyrë karamele. Pasi la valixhen e vogël me rrota te këmbët e krevatit, ajo shkoi te një dhomë në fund të korridorit dhe trokiti lehtë në derë, pavarësisht se në të ishte varur tabela "Mos shqetësoni". Pasi nuk u përgjigj njeri, trokiti edhe një herë. Këtë herë dera u hap disa centimetra, sa për të kaluar dhe ajo rrëshqiti brenda.

- Ç'do ti këtu? - pyeti Gabrieli.

Kiara ngriti sytë në tavan, si për t'i kujtuar të shoqit, drejtorit të ardhshëm të Shërbimit Sekret Izraelit, se ishin në një dhomë hoteli rus dhe mund t'i përgjonin. Ai i bëri me shenjë se nuk kishte përgjues, pastaj i përsëriti pyetjen. Duart i mbante mbi kofshë dhe sytë e gjelbër i ishin picërruar. Kiara kishte kohë që nuk e shihte atë zemërim në sytë e tij.

- Sa budallaqe që jam, - tha ajo. - Mendova se do të gëzoheshe kur të më shihje.

- Si ia bëre që erdhe?

- Duheshin vajza për stjuardesa dhe unë dola vullnetare.

- Nuk mund të gjente ndonjë tjetër veç gruas sime Uzi?

- Në fakt, Uzi nuk ishte dakord.

- Po si ia dole?

- Fola me Shamronin, - tha ajo. - I thashë se doja të merrja pjesë në operacion dhe nëse nuk më jepte atë që doja, unë nuk do t'i jepja atij atë që do *ai*.

- Mua?

Ajo buzëqeshi.

- Sa vajzë e zgjuar!

- Kam pasur mësuesin më të mirë.

- Ti sikur kishe thënë që nuk doje të vije në Rusi, se nuk e përballoje dot.

- E po, ndërrova mendje.

- Pse?

- Sepse doja ta shijoja këtë me ty, - tha Kiara, u afrua te dritarja dhe hodhi sytë në errësirën që kishte pllakosur në sheshin "Shën Isaku". - A ka ndonjëherë dritë këtu?

- Ka, aq sa ka tani.

Kiara mbylli grilat dhe u kthye. Me fundin blu dhe këmishën e bardhë, dukej e parezistueshme. Gabrielit iu shua në çast inati që ajo kishte ardhur në Rusi pa lejen e tij. Madje, ishte i lumtur që ajo ishte aty, me të. Kështu do t'i kalonte më shpejt ato pak orë që kishin mbetur.

- Si është ajo? - pyeti Kiara.

- Madalena?

- Kështu do ta thërrasim akoma?

- Ajo nuk di të ketë emër tjetër, - tha Gabrieli. - Ajo është...

- Çfarë?

- Është rritur nga ujqërit.

- Ndoshta është edhe ajo ujkonjë.

- Jo, nuk është.

- Je i sigurt?

- Po, Kiara, jam.

- Jo, se njëherë ta hodhi, jo për gjë.

Gabrieli nuk foli.

- Gabriel, më fal, por duhet të mendosh që ajo ndoshta vazhdon t'u qëndrojë besnike njerëzve të cilëve u shërben.

- Duhet, - tha Gabrieli pa mundur të fshihte acarimin, - por nëse ajo nuk do të ketë përgjues me vete kur të dalë nga apartamenti i saj sot pasdite, unë do ta marr me vete dhe do ta kthej në shtëpi.

- Ku?

- Në Angli.

- Kthimi i saj ka për të shkaktuar shumë trazira.

- Shumë, - pohoi Gabrieli.

- Çfarë do të bësh me të?

- Do ta përdor për të shlyer një borxh të vogël dhe pastaj do ta lë në duart e sigurta të Graham Sejmurit.

- I gjori Graham, - tha Kiara dhe u ul në një cep të krevatit dhe hoqi këpucët me taka.

- Si shkoi rruga? - e pyeti Gabrieli.

- Ia dola të mos dëmtoja asnjë pasagjer kur u shërbeva ushqimin.

- Të lumtë!

- Ishte një foshnjë në klasin e parë që qau nga Ankaraja në Minsk. Disa nga pasagjerët u shqetësuan. Nëna e fëmijës u vu shumë në siklet, - tha ajo, pushoi një çast dhe pastaj shtoi: - Por unë mendoja se ajo ishte gruaja më me fat në botë.

- Ndoshta do të qe më mirë sikur të mos kishe ardhur, - i tha Gabrieli pas një heshtjeje.

- *Duhej* të vija, - ia ktheu Kiara. - Do ta shijoj këtë eksperiencë.

Ajo zbërtheu fundin, e hoqi, e vendosi me rregull mbi shtrat dhe nisi të zbërthente edhe bluzën.

- Çfarë bën? - e pyeti Gabrieli.

- Si thua ti, çfarë po bëj?

- Mua më duket se një stjuardesë e bukur po zhvishet në dhomën time të hotelit.

- E po, duhet të pushoj pak. Edhe ti, - tha ajo duke u zhveshur. - Gabriel, mos më keqkupto, por dukesh për faqe të zezë. Fli ndonjë orë që të marrësh pak veten.

- Nuk mund të fle tani.

- Po çfarë do të bësh? Do të rrish gjithë ditën në dritare dhe do të vdesësh nga ankthi?

- Këtë kisha ndër mend.

- Do të kemi kohë për këto kur të bëhesh drejtor. Eja, shtrihu tani, - tha ajo. - Të premtoj që nuk do të të bëj gjë.

Gabrieli u ul, hoqi këpucët dhe xhinset dhe hyri në shtrat pranë saj. Trupi i saj fërgëllonte. Buzët e saj kishin shije mjalti. Ai kaloi majën e gishtit nëpër hundën e saj.

- Kiara...

- Çfarë ke, zemër? - e pyeti ajo duke e puthur sërish.

- Jam në detyrë.

- Ti je gjithmonë në detyrë dhe në detyrë do të jesh deri në fund të jetës, - tha ajo dhe e puthi sërish me epsh. Në buzë, në qafë, në kraharor...

- Ajo paska pasur të drejtë, - tha dikur.

- Kush? - pëshpëriti Gabrieli.

- Ajo plaka e Korsikës. Të tha se do ta mësoje të vërtetën vetëm pasi Madalena të vdiste. Në njëfarë mënyre, ajo vdiq atë mëngjes në Francë. Tani ti e di të vërtetën.

- Plaka gaboi për diçka, gjithsesi. Ajo më paralajmëroi të mos shkoja në qytetin e heretikëve. Tha se do të vdisja atje.

Kiara reshti së e puthuri dhe e pa në sy.

- Ti sikur the se ajo të kishte thënë që nuk do të ndodhte asgjë në atë qytet.

- Po, ashtu të thashë.

- Domethënë, më ke gënjyer.

- Më fal, Kiara. Nuk duhej të të kisha gënjyer.

Ajo e puthi sërish.

- Unë e dija që më gënjeve, - i tha.

- Vërtet?

- Unë të dalloj kur më gënjen, Gabriel.

- Po unë jam profesionist.

- E po, me mua nuk të pi ujë profesionalizmi, - tha ajo duke i hequr bluzën nga koka dhe duke u ulur mes kofshëve të tij. - Por ka ende mundësi.

- Për çfarë?

- Që të vdesësh në qytetin e heretikëve.

- Ajo e kishte fjalën për Moskën. Tani besoj se jam i sigurt.

- Në të vërtetë, - ia ktheu Kiara duke kaluar duart mbi trupin e tij, - tani je në rrezik të madh.

- Më duket se po e kuptoj këtë.

Ajo e mori në përqafimin e saj të ngrohtë. *Nuk jam më në Rusi,* mendoi ai. *Jam në dhomën në Venecia ku bëra dashuri për herë të parë me të, në një shtrat me çarçafë të bardhë. Jam i sigurt. Edhe ajo është e sigurt.*

- Ndoshta ajo nuk vjen, - tha ajo më pas, kur Gabrielin po e zinte gjumi.

- Do të vijë, - tha ai. - Pastaj do ta çojmë në shtëpi.

- Edhe unë dua të shkoj në shtëpi.

- Do të shkosh, shumë shpejt.

- A do të zbardhë ndonjëherë jashtë?

- Jo, Kiara. Jo sot.

57

SHËN PETERBURG, RUSI

Ekishin bërë dhjetëra herë më parë, në dhjetëra beteja sekrete e, kësisoj, pas disa minutash vrojtimi të një harte në dhomën e Gabrielit në hotelin "Astoria", u planifikua gjithçka: rruga, pozicionet statike, hedhjet, parashutat.

Gabrieli e quajti mundësinë e fundit të Qendrës së Moskës. Do ta shëtisnin edhe një herë nëpër rrugët e Shën Peterburgut, për të qenë të sigurt. Pastaj do ta merrnin dhe do ta zhduknin. Sërish.

Kështu, pak pas orës dy të asaj pasditeje të vrenjtur, në Shën Peterburg, gjashtë oficerë të Shërbimit Sekret Izraelit dolën nga hoteli "Astoria" dhe kaluan përgjatë kishave dhe pallateve përrallore për të zënë vendet e tyre. Eli Lavonit i duhej të ecte më gjatë, për të pritur Madalenën poshtë pallatit. Ajo duhej të dilte në orën 2:52 të pasdrekes, pikërisht në kohën kur Gabrieli i kishte thënë të dukej nëse donte të dezertonte. Ajo e kaloi Urën e Pallatit në këmbë, eci përgjatë hyrjes së muzeut "Hermitage" dhe shkoi drejt e te salla e Monetit, ku u ul në stolin e përhershëm. Ishte ora tre e shtatë minuta. Lavoni u ul pranë saj vetëm dy minuta më pas.

- Deri tani jemi mirë, - i tha ai qetësisht në anglisht. - Tani më dëgjo me vëmendje dhe bëj si të them.

Ata i thanë të kalonte përmes sheshit "Pallati", poshtë Harkut të

Triumfit dhe, më pas, të merrte për nga bulevardi "Nevsky". Ajo piu kafe të shoqëruar me kek rus në kafenenë letrare, eci përgjatë kolonadës romake të katedrales "Zonja jonë e Kazanës" dhe bëri ca psonisje te "Zara". Kudo ku ndalonte, e priste një nga anëtarët e skuadrës. Secili prej tyre raportoi se gjithçka po shkonte mbroth. Kur doli nga dyqani i "Zarës" ajo u nis drejt lumit Mojka, përgjatë këmbësores veneciane për në sheshin "Shën Isaku" ku e priste Dina, me celularin në veshin e djathtë. Po ta kishte mbajtur në të majtin, do të ishte një shenjë që Madalena të vazhdonte të ecte. Pra, ajo mund të hynte në hollin e hotelit "Astoria" dhe kështu bëri, hyri në hotel në orën 3:48 të pasdites. Eli Lavoni iu bashkua në ashensor dhe u ngjit me të deri në katin e tretë. Madalena nuk ua ndante sytë çizmeve të borës që mbante veshur, ndërsa Lavoni ia kishte ngulur sytë tavanit. Kur u hapën dyert e ashensorit, ai nxori dorën dhe i tha:

- Pas jush.

Madelana kaloi pranë tij pa thënë asnjë fjalë dhe mori për nga fundi i korridorit. Kur ajo iu afrua një dhome, dera e saj u hap dhe Gabrieli e tërhoqi brenda.

- Kush je ti? - e pyeti ajo.

- Nuk ta them dot akoma.

- Ku do të shkoj unë?

- Do ta marrësh vesh shpejt.

Të dhënat u shfaqën në ekranet e qendrës operative në "Bulevardin Mbreti Saul" dy minuta më pas. Uzi Navoti i pa për një çast, thuajse me mosbesim dhe pastaj hodhi sytë nga Shamroni e i tha:

- Ia dolën, Ari. E kanë marrë vajzën.

- Mirë, - ia ktheu Shamroni me gëzim, - tani të shohin a do të mund ta mbajnë dot, - dhe ndezi një cigare tjetër.

Dy rrotullime djathtas, dy majtas...

Ata i lyen flokët dhe vetullat në ngjyrë të zezë dhe u dhanë një nuancë Mesdheu faqeve të saj baltike. Mordekai e nxori në fotografi, më pas e mori atë dhe e futi në pasaportën që do të përdorej për ta nxjerrë nga

Rusia. Tani ajo ishte Ilana Shavit. Kishte lindur në tetor të vitit 1985 dhe jetonte në lagjen "Rishon LeZion" në Tel Aviv, që ishte një nga vendbanimet e para hebraike në Palestinë. Para se të hynte në "El Al" ajo kishte punuar për IDF-në. Ishte e martuar, pa fëmijë. Vëllanë ia kishin vrarë në luftën në Liban, ndërsa motra i ishte vrarë gjatë një sulmi kamikaz të Hamasit gjatë Intifadës së Dytë. Gabrieli i tha se kjo nuk ishte një histori e sajuar, por jeta e vërtetë në Izrael, e cila pas disa orësh do të ishte edhe jeta e Madalenës.

Nëse do të flasim për probleme, problemi i saj ishte se dinte vetëm pak fjalë në hebraisht. Por kishte edhe avantazhe, një prej të cilëve ishte që anglishtja e saj nuk kishte asnjë gjurmë rusishteje. Kështu, ndoshta e kalonte më shpejt kontrollin te pasaportat. Gabrieli kishte besim se Madalena do t'i rezistonte impulsit për t'iu përgjigjur një pyetjeje rusisht. Fundja, ajo e kishte shmangur gjithë jetën këtë. Tani i duhej të thoshte edhe një gënjeshtër, të bënte edhe një aktrim të fundit dhe do të ishte e lirë përgjithmonë.

Kështu, pak minuta pas orës pesë të pasdites, vajzat i hoqën Madalenës rrobat e fundit ruse, e veshën me uniformën e rregullt të kompanisë ajrore "El Al" dhe i krehën flokët e reja. Pastaj ia treguan Gabrielit, i cili e studioi një copë herë, sikur të ishte pikturë në vaj.

- Si quhesh? - e pyeti ai me seriozitet.

- Ilana Shavit.

- Kur ke lindur?

- Më 12 tetor, 1985.

- Ku jeton?

- Në lagjen "Rishon LeZion".

- Ç'do të thotë kjo në hebraisht?

- Të parët në Zion.

- Si quhej yt vëlla?

- Moshe.

- Ku është vrarë?

- Në Liban.

- Po motra si quhej?

- Dalia.

- Ku është vrarë ajo?
- Në diskotekën "Dolphinarium".
- Sa veta të tjerë u vranë atë ditë?
- Njëzet.
- Si quhesh ti?
- Ilana Shavit.
- Ku jeton?
- Në lagjen "Rishon LeZion".
- Në cilën rrugë të asaj lagjeje?
- Në rrugën "Sokolow".

Gabrieli nuk kishte më pyetje. Vuri njërën dorë në mjekër dhe ktheu kokën mënjanë.

- Atëherë? - e pyeti ajo.
- Pesë minuta dhe do të nisemi, - tha ai.

Eli Lavoni po pinte kafe në hollin e trishtë. Gabrieli u ul pranë tij.

- Kam një parandjenjë të çuditshme, - tha Lavoni.
- Sa të çuditshme?
- Dy janë jashtë derës, dy në kafene dhe një vjen vërdallë te sporteli.
- Ndoshta është rastësi, - tha Gabrieli.
- Ndoshta, - tha Lavoni i pasigurt.
- Mos ruajnë ndonjë klient të hotelit.
- Pikërisht kësaj ia kam frikën.
- E kisha fjalën për klientë *të tjerë*, Eli.

Lavoni nuk bëri zë.

- Je i sigurt që nuk e ndoqi njeri kur erdhi?
- Po.
- Atëherë jemi në rregull tani, - tha Gabrieli.
- Po pse është mbushur holli me oficerë të FSB-së?
- Ndoshta është rastësi.
- Ndoshta, - përsëriti Lavoni.

Gabrieli hodhi sytë nga furgoni i kompanisë së fluturimit që priste jashtë hotelit.

- Çfarë do të bëjmë? - pyeti.
- Do të nisemi, sipas planit.

- Do t'ia thuash asaj?
- As mos e mendo!

Lavoni rrufiti kafenë.

- Dakord, - tha.

Do të kalonin tri minuta të gjata para se anëtarët e parë të ekuipazhit të kompanisë ajrore "El Al" të dilnin nga ashensorët në holl. Dy vajza të reja, elegante, të cilat ishin vërtet stjuardesa të avionit dhe katër vajza dhe dy djem të tjerë pas tyre, të cilit ishin gjithçka, përveçse punonjës avioni. Pas tyre dolën kapiteni dhe inxhinieri i fluturimit, të ndjekur nga Mikaili i maskuar për mrekulli si oficer i parë i kabinës së pilotit. Njeriu i FSB-së që ndodhej te sporteli ktheu kokën dhe ua nguli sytë pa iu dridhur qerpiku. Kur e pa atë skenë nga ana tjetër e hollit, Gabrieli vuri buzën në gaz. Sikur njeriu i FSB-së të kishte kohë të kontrollonte talentet e Izraelit, me gjasë nuk do kërkonte një ilegale ruse. Më në fund, në orën 5:10 të pasdites, u shfaqën Kiara dhe Madalena duke tërhequr valixhet me rrota pas tyre. Kiara po i fliste shpejt në hebraisht dhe Madalena qeshte sikur të ishte duke dëgjuar anekdotën më të fortë të të gjitha kohëve. Pjesëtarët e tjerë të ekuipazhit u bashkuan me to e pastaj dolën jashtë të gjithë bashkë për të hipur në furgonin që po i priste. Pasi dyert e tij u mbyllën ata u zhdukën.

- Si mendon? - pyeti Gabrieli.
- Mendoj se ajo është shumë e zonja, - ia ktheu Lavoni.
- A thua jemi të sigurt?
- Pa dyshim.

Pa thënë asnjë fjalë tjetër, Gabrieli u ngrit, mori valixhen dhe u nis jashtë, në errësirën e përbotshme.

Jashtë hotelit e priste një makinë, e cila do ta çonte edhe në një vend të fundit. Kaluan pas statujës së Leninit që e çoi popullin e tij në shtatëdhjetë vjet stagnacion dhe vrasje, monumente të një lufte që nuk e mban mend askush, një varg një kilometër me pallate të rrënuara derisa më në fund mbërritën në terminalin ndërkombëtar të aeroportit "Pulkovo". Ai u regjistrua për fluturimin e Tel Avivit, kaloi pa mundim në kontrollin e

pasaportave, si Xhonatan Ollbrajti i kompanisë "Markham Capital" dhe pastaj mori për nga porta e fortifikuar e kompanisë "El Al". Pala ruse tha se kjo ishte një masë më shumë për sigurinë e pasagjerëve izraelitë, megjithatë, Gabrielit iu duk sikur po hynte në geton e fundit të Europës.

Zuri vend në një ndenjëse bosh në qoshe të avionit, pranë një familjeje të madhe. Askush nuk fliste rusisht, vetëm hebraisht. Të mos ishte maskuar në atë mënyrë, me siguri do ta kishin njohur, por tani ai qëndronte i ulur mes tyre si një i panjohur, si engjëlli i tyre mbrojtës. Shumë shpejt ai do të ishte drejtori i Shërbimeve Sekrete të tyre.

Apo jo? *Me siguri që kjo ishte mënyra e duhur për t'i dhënë fund karrierës*, mendoi ai. Kishte siguruar provat se një kompani nafte në zotërim të rusëve dhe e drejtuar nga Shërbimi Sekret Rus kishte destabilizuar qeverinë britanike për të siguruar akses në naftën e Detit të Veriut dhe se gjithçka ishte bërë me urdhër të presidentit rus. Pas kësaj nuk do të kishte më pritje, as fjalë të bukura për Rusinë mike të Perëndimit. Ai do të vërtetonte njëherë e mirë se ish-anëtarët e KGB-së, të cilët tani drejtonin Rusinë, janë të pamëshirshëm dhe të pabesë. Ata duhen mënjanuar dhe mbajtur larg, si në kohën e Luftës Civile.

Por gjithçka do të ishte e kotë sikur të humbiste vajzën, mendoi. Pa orën e dorës dhe pastaj ngriti kokën për të parë nëse Josi dhe Rimona hynë në sallën e pritjes. Pastaj ishin dhe Jakovi dhe Dina e më pas, në fund, Eli Lavoni që dukej sikur kishte ardhur gabimisht në aeroport. Ai endi një copë herë sytë nëpër sallë, duke inspektuar çdo karrige bosh, me vigjilencën e dikujt që ka jetuar me frikën nga mikrobet, para se të ulej përballë Gabrielit. E panë njëri-tjetrin në sy pa thënë asnjë fjalë, si dy roja në një natë të gjatë. Tani duhej të prisnin. *Pritja e jetës sime*, mendoi Gabrieli. Pritja e përhershme e tij: pritja për informatorin, pritja për lindjen e diellit pas natës kur kishte vrarë dikë dhe pritja që gruaja e tij të kthente një të vdekur në mes të të gjallëve.

Pa sërish orën dhe pastaj Lavonin.

- Ku janë? - pyeti ai.

Lavoni i ktheu përgjigje pa i hequr sytë nga gazeta.

- Sapo kaluan kontrollin e pasaportave. Tani po u kontrollojnë bagazhet në doganë.

- Pse?

- Nga ta di unë?

- Më thuaj që nuk ka asnjë problem me bagazhet.

- Nuk ka asnjë problem.

- Atëherë përse po i kontrollojnë?

- Ndoshta sepse nuk kanë pasur punë tjetër. Ose sepse u pëlqen të prekin të brendshme femrash. Rusë janë, aman!

- Edhe sa kohë duhet, Eli?

- Dy minuta, ndoshta më pak.

Kaluan dy minutat e Lavonit dhe ata nuk po dukeshin askund. Kaloi edhe një minutë tjetër. Pastaj edhe një tjetër që u duk se zgjati sa një përjetësi. Gabrieli ia nguli sytë orës, pastaj dyshemesë së pistë, pastaj fëmijës që ishte ulur pranë tij... Shikonte gjithçka përveç hyrjes së sallës së pritjes. Pastaj, më në fund, i kapi me bishtin e syrit: një hije bardhë e blu. Mikaili po ecte në krah të kapitenit dhe Madalena në krah të Kiarës. Ajo buzëqeshte si në siklet dhe dukej sikur mbahej te krahu i Kiarës që të mos binte. Ai i pa teksa morën për nga porta dhe u zhdukën në të. Pastaj hodhi sytë nga Lavoni.

- Të thashë që gjithçka do të shkonte mirë, - i tha ai.

- Ti nuk pate frikë për asnjë çast?

- Unë po vdisja nga frika.

- Po pse nuk më the?

Lavoni nuk u përgjigj, por vazhdoi të lexonte gazetën derisa u bë thirrja për pasagjerët e fluturimit të tyre. Pastaj u ngrit në këmbë dhe ndoqi Gabrielin për në avion. Bëri edhe një kontroll të fundit me sy, për të qenë i sigurt.

Asaj i kishin lënë një vend në rreshtin e tretë pranë dritares dhe atë çast ia kishte ngulur sytë errësirës së aeroportit "Pulkovo", si për të parë për herë të fundit Rusinë që nuk e njohu dot kurrë. E veshur me uniformën bardhë e blu, dukej si një angleze kolegji. I hodhi një sy Gabrielit kur u ul pranë saj, pastaj ktheu kokën nga ana tjetër. Gabrieli nisi edhe

një mesazh të fundit në "Bulevardin Mbreti Saul" me *BlackBerry*-n e tij të sigurt, pastaj pa të shoqen që bëhej gati të hynte në kabinën e pilotit. Kur avioni u nis nëpër pistë, Madalenës i shkëlqyen sytë, ndërsa kur rrotat e tij u ngritën nga toka ruse, një lot i rrëshqiti në faqe. Kapi dorën e Gabrielit dhe e shtrëngoi fort.

- Nuk di si të të falënderoj, - tha me një anglishte të kulluar.

- Atëherë mos më falëndero, - ia ktheu ai.

- Sa zgjat fluturimi?

- Pesë orë.

- Bën ngrohtë në Izrael?

- Vetëm në jug të tij.

- Do të më çosh atje?

- Do të të çoj ku të duash.

Atë çast u shfaq Kiara, e cila u shërbeu nga një gotë shampanjë. Gabrieli ngriti të tijën drejt Madalenës, si për të ngritur një dolli të heshtur dhe pastaj e vendosi mbi banak, pa vënë asnjë pikë në buzë.

- Nuk të pëlqen shampanja? - e pyeti ajo.

- Më jep shumë dhembje koke.

- Edhe mua.

Ajo piu pak dhe pastaj hodhi vështrimin në errësirën poshtë tyre.

- Si më gjete këtu? - e pyeti.

- Nuk ka rëndësi.

- A do të ma thuash ndonjëherë kush je ti?

- Do ta mësosh shumë shpejt.

PJESA E TRETË

SKANDALI

58

LONDËR - JERUSALEM

Mëngjesin tjetër, në Britani zhvilloheshin zgjedhjet. Xhonatan Lankasteri votoi herët, i shoqëruar nga e shoqja, Diana, dhe tre fëmijët e tyre fotozhenikë, para se të kthehej në *Downing Street* për të pritur verdiktin e sovranit. Dita kaloi në tension: një sondazh i fundit kishte parashikuar se partia e Lankasterit do ta rriste numrin e deputetëve të saj në parlament pas këtyre zgjedhjeve. Aty nga dreka *Whitehall*-i gëlonte nga fjalët për masakër elektorale dhe në prag të mbrëmjes në selinë e partisë në *Millbank*, u hapën shishet e shampanjës. Megjithëkëtë, Lankasteri u shfaq i ngrysur teksa ngjitej në skenën e "Royal Festival Hall", për të mbajtur fjalimin e fitores. Mes gazetarëve politikë, të cilët e pikasën sakaq qëndrimin e tij serioz, ishte edhe Samanta Kuk, gazetarja e *Daily Telegraph*-it. Ajo shkroi se kryeministri kishte marrë pamjen e një njeriu që e di se mandati i tij i dytë nuk do të jetë aq i suksesshëm sa i pari. *Por fundja*, shtoi ajo me vete, gjithmonë *kështu ndodh*. Andrallat e Lankasterit nisën më vonë atë javë, kur ai bëri ndryshimin e kabinetit dhe të stafit personal. Sikundër edhe ishte parashikuar, Xheremi Faloni, tanimë anëtar i parlamentit të Bristolit, u emërua ministër i Thesarit, që do të thoshte se njeriu që drejtonte Lankasterin tani do të ishte edhe fqinji i tij në *Downing Street*. Njeriu që shtypi dikur e kishte karakterizuar

si zëvendësministër të pashpallur, tani u shfaq haptazi në *Whitehall* si kryeministri i radhës. Faloni mblodhi shpejt e shpejt anëtarët e mbetur të stafit të tij të vjetër në *Downing Street* - të paktën ata që pranonin ende të punonin me të - dhe përdori pushtetin e tij në parti për të mbushur vendet kryesore politike me besnikët e tij. Skena për luftën shekspiriane për pushtet ishte gati, shkroi Samanta Kuk. Sipas saj, shumë shpejt Faloni do të trokiste në portën e Numrit 10 për të kërkuar çelësat e saj. Xheremi Faloni kishte krijuar Lankasterin dhe ajo parashikonte se po ai do ta shkatërronte atë.

Emri i Madalena Hartit nuk u përmend asnjëherë nga shtypi gjatë periudhës së manovrave politike pas zgjedhjeve, as kur kryetari i partisë vendosi se kishte ardhur koha të zihej vendi i saj. Një nëpunës i selisë qendrore u kujdes të hiqte edhe gjërat nga tryeza e saj e punës. Nuk është se kishte shumëçka, gjithsesi: disa dosje të pluhurosura, kalendari, stilolapsat, kapësja e letrave dhe një kopje e vjetër e librit "Krenari dhe paragjykime", të cilin e shfletonte kur kishte ndonjë çast të lirë. I njëjti nëpunës ia dorëzoi në dorë sendet e saj kryetarit të partisë, i cili ia dha sekretares së tij duke e udhëzuar t'i largonte prej aty "me sa më shumë dinjitet të mundej". Kështu u fshinë nga selia qendrore edhe gjurmët e fundit të një jete të papërfunduar. Madalena Harti u largua përfundimisht. Ose të paktën kështu kujtonin ata.

Fillimisht, u duk sikur ajo kishte kaluar nga një skenë syrgjynosjeje në një tjetër. Këtë herë, apartamenti që shërbente si qeli burgu nuk ishte me pamje nga lumi, si ai në Shën Peterburg, por me pamje nga deti Mesdhe dhe ndodhej në "Netanya". Administratorit të pallatit iu tha se vajza ishte në konvaleshencë pas një sëmundjeje të gjatë, gjë që nuk ishte shumë larg së vërtetës, gjithsesi.

Për një javë ajo nuk doli nga apartamenti. Ditët i vriste duke ndenjur kot. Çdo ditë vinte dhe e vizitonte një mjek. Në ditën e shtatë, kur ai e pyeti nëse kishte ndonjë shqetësim, ajo i tha se vuante nga një mërzi e përjetshme.

- Më mirë të vdesësh nga mërzia, sesa nga helmi i rusëve, - ia pat ai.

- Nuk jam shumë e sigurt për këtë, - ia ktheu ajo me anglishte të pastër.

Mjeku i dha fjalën se do t'ia përcillte shqetësimin e saj autoriteteve më të larta dhe ditën e tetë, autoritetet e larta e lejuan të bënte një shëtitje të shkurtër në bregun e ftohtë ranor që shtrihej poshtë pallatit të saj. Ditën tjetër e lanë të shkonte ca më tej, ndërsa ditën e dhjetë shkoi thuajse deri në Tel Aviv, por shoqëruesit i kujtuan se duhej të kthehej, e morën me makinë dhe e kthyen në apartament. Kur hyri atje, gjeti kopjen e pikturës "Liqeni Montgeron" të varur në murin e dhomës. I mungonte vetëm autografi i piktorit. Ai i telefonoi disa minuta më pas dhe u prezantua si duhej, për herë të parë.

- Ti je *ai* Gabriel Aloni që mendoj unë?

- Kam frikë se po, - u përgjigj ai.

- Po ajo gruaja që më ndihmoi në avion, kush ishte?

- Do ta marrësh vesh shpejt.

Gabrieli dhe Kiara mbërritën në "Netanya" pasditen e ditës tjetër, pasi Madalena ishte kthyer nga shëtitja e mëngjesit në plazh. E nxorën për drekë dhe e shëtitën nëpër rrënojat romake dhe ato të kryqtarëve, pastaj shkuan në breg, pranë Libanit, për të parë shpellat detare të *Rosh HaNikra*-s. Prej atje vazhduan më në lindje, përgjatë kufirit, kaluan qytete të vogla, të boshatisura pas luftës së fundit me Hezbollahun dhe më pas mbërritën në *Kiryat Shmona*. Gabrieli kishte rezervuar dy dhoma në hotelin e një kooperative të vjetër. Dhoma e Madalenës kishte një pamje të këndshme të *Upper Galilee*. Një punonjës sigurimi i Byrosë e kaloi natën jashtë derës së saj, ndërsa një tjetër i ulur në kopsht.

Mëngjesin tjetër, pasi hëngrën mëngjes në restorantin e kooperativës, u nisën për në *Golan Heights*. Atje i prisnin Forcat Ushtarake Izraelite. Ndër ta ishte një kolonel i ri, i cili i çoi në një vend përgjatë kufirit sirian ku mund të shikoje pozicionet e forcave rebele. Pastaj bënë një vizitë të shkurtër në kështjellën Nimrod, bastionin e lashtë të kryqtarëve me pamje nga rrafshnaltat e Galileut, para se të kalonin në qytetin e lashtë hebraik të Safedit. Atje, drekuan në shtëpinë e një gruaje me emrin Tziona Levin. Paçka se Gabrieli e quante teto, ajo ishte një nga njerëzit më të afërt të tij.

Nuk u habit aspak kur ai iu dha në derë i shoqëruar nga një vajzë e bukur, të cilën gjithë bota e dinte për të vdekur. Ajo e dinte që Gabrieli e kishte zakon të kthehej në Izrael me objekte të humbura.

-Si të shkon puna? - e pyeti ajo teksa pinin kafe në kopshtin e ndriçuar nga dielli.

- Më mirë nuk ka ku të shkojë, - ia ktheu Gabrieli duke hedhur sytë nga Madalena.

- E kisha fjalën për punën artistike, Gabriel.

- Sapo përfundova restaurimin e një punimi fantastik të Basanos.

- Duhet t'i kushtosh më shumë rëndësi punës, - i tha ajo me qortim.

- Po, - ia ktheu ai i vagullt dhe Tzonia nuk e ngacmoi më.

Pasi mbaruan kafenë, ajo i çoi në studio që të shihnin pikturat e saj të reja. Pastaj, me kërkesën e Gabrielit, hapi dhomën magazinë. Në të kishte qindra piktura dhe skica të nënës së Gabrielit, përfshi edhe disa ku paraqitej një burrë i gjatë me uniformën e SS-ve.

- Sikur të kisha thënë t'i digjje këto, - i tha ai.

- Po, - tha Tziona, - por nuk i dogja dot.

- Kush është ai? - pyeti Madalena pa ua hequr sytë pikturave.

- Ai quhet Erik Radek, - u përgjigj Gabrieli. - Ka drejtuar një program të fshehtë nazist të quajtur "Aktion 1005". Qëllimi i tij ishte të fshihte të gjitha provat për ekzistencën e Holokaustit.

- Përse e ka pikturuar atë nëna jote?

- Sepse ai për pak e vrau në marshimin e vdekjes nga Aushvici në janar të vitit 1945.

Madalena ngriti njërën vetull me mosbesim.

- Ti po flet për Radekun që u kap në Vjenë para disa vitesh dhe u soll për gjykim në Izrael? - pyeti ajo.

- Që ta dish, - ia ktheu Gabrieli, - Erik Radeku *erdhi me dëshirë* në Izrael.

- Po, - tha Madalena me dyshim, - ashtu si më rrëmbyen mua kriminelët marsejezë.

Ditën tjetër shkuan në Eilat. Byroja kishte marrë atje një vilë të madhe me qira, jo shumë larg kufirit me Jordaninë. Madalena i kalonte ditët duke marrë rreze dielli pranë pishinës ose duke rilexuar një roman të letërsisë

klasike angleze. Gabrieli kuptoi se ajo po e përgatiste veten për t'u rikthyer në vendin që në të vërtetë nuk ishte atdheu i saj. *Ajo ishte një njeri pa komb*, mendoi ai. Nuk ishte një njeri i vërtetë. Për të disatën herë mendoi se ndoshta ishte më mirë që ajo të jetonte në Izrael, sesa në Mbretërinë e Bashkuar. Këtë pyetje ia bëri edhe asaj ditën e fundit të qëndrimit të saj në jug. Ishin ulur në majën e një shkëmbi në Negev dhe po kundronin diellin teksa tërhiqej në djerrinat tej Sinait.

- Po më tundon, - ia ktheu ajo.

- Por?

- Por ky vend nuk është shtëpia ime. Të qëndroj këtu do të ishte njësoj sikur të qëndroja në Rusi. Do të ndihesha e huaj.

- Do të jetë e vështirë, Madalena. Më e vështirë nga sa mendon ti. Britanikët do të të shtrydhin derisa të sigurohen për besnikërinë tënde. Pastaj do të të mbyllin në ndonjë vend ku të mos gjejnë dot rusët. Nuk është se ti do të shkosh në Angli dhe do t'i rikthehesh jetës së mëparshme atje. Atë jetë nuk do ta kesh më kurrë. Kurrë, - përsëriti ai. - Do të ndihesh shumë keq.

- E di, - tha ajo si e përhumbur.

Në të vërtetë ajo as që e ka idenë, mendoi Gabrieli, *por ndoshta më mirë kështu.* Dielli dukej ende në horizont. Ajri i shkretëtirës u ftoh papritur dhe ajo u drodh.

- Do të kthehemi? - e pyeti ai.

- Jo, rrimë edhe pak, - tha ajo.

Ai hoqi xhaketën dhe ia hodhi asaj supeve.

- Tani do të të them diçka që ndoshta nuk duhej ta thosha, - i tha ai. - Së shpejti unë do të bëhem drejtor i Shërbimit Sekret Izraelit.

- Urime!

- Në fakt, më mirë do të ishte të më thoshe "Ngushëllime", - ia ktheu Gabrieli. - Por, ta thashë që ta dish se kështu do të mund të kujdesem për ty. Do të të jap një shtëpi të rehatshme. Një familje. Jo se është ndonjë familje e rregullt, - shtoi aty për aty, - por është e vetmja që kam. Ne do të të japim një atdhe, një shtëpi. Këtë bëjmë ne në Izrael. U japim njerëzve një shtëpi.

- Po unë e kam shtëpinë, - tha ajo dhe ra në heshtje.

Dielli tashmë nuk dukej më dhe ajo humbi në errësirë.

- Mos ik, - i tha Gabrieli. - Qëndro këtu me ne.

- Nuk mundem, - ia ktheu ajo. - Unë jam Madalena. Jam një vajzë angleze.

Të nesërmen ishte mbrëmja gala e hapjes së ekspozitës "Kolonat e Solomonit" në Muzeun e Izraelit, në Jerusalem. Ndër të pranishmit ishin presidenti, kryeministri, shumë deputetë, shkrimtarë dhe artistë. Mes atyre që mbajtën fjalën në hollin e ri të ekspozitës, ishte edhe Kiara. Ajo natyrisht që nuk e përmendi faktin se ato kolona i kishte zbuluar i shoqi i saj, oficeri legjendar i Shërbimit Sekret Izraelit dhe as që vajza brune bukuroshe që ishte ulur në krah të tij, ishte një vajzë angleze që e dinin për të vdekur dhe që quhej Madalena Hart. Ata ndenjën vetëm pak minuta në koktejin pas fjalimit dhe pastaj i ranë mespërmes Jerusalemit për të mbërritur në një restorant të qetë në zonën e vjetër të Akademisë së Arteve "Bazalel". Pastaj, teksa po ecnin në rrugën "Ben Yehuda", Gabrieli e pyeti sërish Madalenën nëse kishte dëshirë të jetonte në Izrael, por përgjigja e saj nuk ndryshoi. Ajo e kaloi natën e saj të fundit në Izrael në dhomën bosh të apartamentit të Gabrielit në rrugën "Narkiss", në atë dhomë që ai dhe Kiara e quanin dhoma e fëmijëve. Mëngjesin tjetër, që herët, u nisën për në aeroportin "Ben Gurion" dhe morën avionin për në Londër.

59

LONDËR

Gabrieli e kishte vrarë mendjen për disa ditë nëse duhej ta njoftonte Graham Sejmurin se do t'i kthente një dezertore të pazakontë të Rusisë. Në fund, vendosi të mos e njoftonte, më shumë për arsye personale, sesa operative. Thjesht donte t'ia bënte surprizë.

Si rezultat, skuadra që e priti në aeroportin "Heathrow" atë paradite përbëhej kryesisht nga oficerë dhe jo anëtarë të MI5-s. Ata i morën, Gabrielin dhe Madalenën, në fshehtësi nëpër aeroport dhe i nisën me ngut në një apartament të sigurimit në "Pimlico". Pastaj, Gabrieli i telefonoi Sejmurit në zyrën e tij dhe i tha se kishte ardhur prapë me surpriza në Mbretërinë e Bashkuar.

- Më habite, - i tha Sejmuri thatë.

- Surprizat nuk kanë mbaruar, Graham.

- Ku je?

Gabrieli i dha adresën.

Sejmuri kishte takim me një delegacion të Shërbimit Sekret Australian, të cilin nuk mund ta shtynte, kështu që kaloi një orë para se makina e tij të shfaqej në rrugën jashtë pallatit ku u vendosën Gabrieli dhe Madalena.

Kur hyri brenda, Sejmuri pa vetëm Gabrielin të ulur në dhomën e ndenjjes. Mbi tavolinën e mesit ndodhej një kompjuter "notebook", i hapur, të cilin Gabrieli e përdori për të vendosur videon e rrëfimit të Pavel Zhirovit. Në të, Zhirovi rrëfeu mëkatet e shumta të kompanisë së naftës dhe gazit "Volgatek", e cila ishte në pronësi të Kremlinit. Kur mbaroi transmetimi, Sejmuri kishte ngrirë në vend. *Ari Shamroni do të më jepte pikë maksimale për këtë*, mendoi Gabrieli. Në Shërbimet Sekrete, ashtu si edhe në jetën e përditshme, ndonjëherë është më mirë të mos i dish ca gjëra.

- Ky është ai që kishte drekuar me Madalenën në Korsikë? - pyeti më në fund Sejmuri pa ia hequr sytë ekranit të kompjuterit.

Gabrieli pohoi me kokë ngadalë.

- Ti më the ta gjeja dhe unë ta gjeta, - i tha ai.

- Ç'i ka ndodhur fytyrës së tij?

- I tha Mikailit diçka të pavend, ndaj.

- Ku është ai tani?

- Nuk është më, - ia ktheu Gabrieli.

- Çfarë do të thuash me "nuk është më"?

Shprehia e qartë në fytyrën e Gabrielit e bëri Sejmurin të kuptonte se Pavel Zhirovi kishte ikur për të mos u kthyer më.

- E dinë rusët këtë? - pyeti ai.

- Ende jo.

- Kur do ta mësojnë?

- Andej nga pranvera, besoj.

- Kush e vrau?

- Kjo është histori tjetër dhe do të ta tregoj një ditë tjetër.

Gabrieli hoqi diskun nga kompjuteri dhe ia zgjati Sejmurit. Ai e mori duke marrë frymë ngadalë, a thua se po përpiqej të mbante në kontroll tensionin e gjakut.

- Dëgjo, Gabriel. Unë kam vite në këtë punë, - foli ai më në fund, - dhe mund ta them me plot gojën se ajo video është më keq se një bombë me sahat.

- Graham, prit se nuk ke parë ende asgjë.

- Nuk e di nëse e ke marrë vesh, - tha Sejmuri sikur të mos e kishte dëgjuar paralajmërimin e Gabrielit, - por së fundmi këtu u zhvilluan zgjedhjet. Xhonatan Lankasteri sapo shënoi një nga fitoret më të thella në historinë e Britanisë. Xheremi Faloni u emërua ministër i Thesarit.

- Post që nuk do ta gëzojë edhe për shumë kohë, - ia priti Gabrieli.

Sejmuri nuk foli.

- Graham, mos më thuaj që ke ndër mend ta lejosh t'ia hedhë paq.

- Jo, por kam frikë se ka për të shkuar gjaku deri në gju.

- Ti e di që kështu ndodh gjithmonë.

- Po, por shpresoja që të mos spërkatesha vetë nga ai gjak, - tha ai dhe ra në një heshtje të rëndë.

- Graham, mos vallë ke ndonjë gjë për të thënë?

- Kryeministri sapo më ka thënë se do të më promovojë, - tha ai pasi ngurroi njëherë.

- Çfarë pozicioni të ka ofruar?

- Një nga ato që nuk mund të refuzohen.

- Drejtor i përgjithshëm?

Sejmuri pohoi me kokë.

- Por jo i MI5-s, - shtoi në çast. - Ke para syve kreun e Shërbimit Sekret të Madhërisë së Saj. Ne të dy do të sundojmë botën, në fshehtësi, pa dyshim.

- Gjithnjë nëse ti nuk rrëzon qeverinë e Lankasterit.

- Pikërisht, - ia ktheu Sejmuri. - Nëse e bëj këtë, me gjasë zhdukem edhe unë nga faqja e dheut bashkë me ata, - aty ai uli zërin dhe shtoi: - Unë them se një njeriu si ti i duhet gjithnjë një mik si unë. Ne nuk gjendemi lehtë ditët e sotme.

- Por, nuk mund të lejosh që një kompani nafte e KGB-së të nxjerrë naftë në ujërat tuaja detare.

- Kjo do të ishte një shkelje e rëndë e detyrës, - pranoi Sejmuri.

- Gjithashtu, nuk mund të lejosh që një agjent i paguar i Kremlinit të vazhdojë të shërbejë si ministër. Përndryshe, - shtoi Gabrieli, - nesër ai të bëhet edhe kryeministër.

- Më dridhet trupi vetëm kur e mendoj këtë.

- Atëherë duhet ta shkatërrosh atë njeri, Graham! Po deshe, e bëj unë në vendin tënd.

Sejmuri heshti një hop, pastaj tha:

- Pse do ta bëje ti?

- Për të të kërkuar një nder më pas.

- Po Lankasteri?

- Ai është fajtor vetëm për tradhti bashkëshortore. Me siguri që popullin i Anglisë do ta falë, sidomos pasi të mësojnë se Xheremi Faloni ka pesë milionë euro në një llogari bankare në Zvicër, - tha Gabrieli, heshti pak dhe pastaj shtoi: - Pastaj, kam edhe diçka tjetër që nuk ta kam treguar ende.

- Çfarë është?

Gabrieli vuri buzën në gaz dhe u ngrit në këmbë.

Hyri në dhomën e gjumit prej nga u kthye një çast më pas me një bukuroshe në krah. Ajo i kishte flokët të zinj pisë dhe lëkura e saj dikur e zbehtë, kishte marrë ngjyrë gruri nga Dielli i Kuq. Sejmuri u ngrit në këmbë si një zotëri i vërtetë dhe i zgjati dorën buzagaz. Gjatë kësaj kohe, fytyra i mori një shprehi të çuditshme, pastaj e kuptoi, hodhi sytë nga Gabrieli dhe pëshpëriti:

- O Zot i madh!

Ajo i tregoi Sejmurit nga fillimi të njëjtën histori që i kishte thënë edhe Gabrielit atë pasdite të acartë në Shën Peterburg, në kupolën e katedrales "Shën Isaku". Pastaj, shkurt dhe me qetësi, i tha se donte të dezertonte në Mbretërinë e Bashkuar dhe, nëse ishte e mundur, t'i rikthehej jetës së dikurshme.

Si zëvendësdrejtor i MI5-s, Graham Sejmuri nuk kishte autoritet për t'i dhënë statusin e dezertores një agjenteje ruse. I vetmi që mund ta bënte këtë ishte ish-i dashuri i Madalenës, Xhonatan Lankasteri. Për këtë arsye, në orën dy e një çerek të po asaj dite, Sejmuri u paraqit pa lajmëruar në Numrin 10 dhe kërkoi të takohej vetëm për vetëm me kryeministrin. Si për rastësi, takimi u zhvillua në studion e tij. Atje, poshtë shkëlqimit të baroneshës Theçer, Sejmuri i tha kryeministrit gjithçka që kishte mësuar: se presidenti i Rusisë kishte urdhëruar Volgatekun të përdorte çdo mjet të mundshëm për të arritur të siguronte licencën për të nxjerrë naftë në

Detin e Veriut; se Xheremi Faloni, krahu i djathtë dhe njeriu më i besuar i tij, e kishte tradhtuar për pesë milionë euro dhe se Madalena Harti, ish-e dashura e tij, ishte një agjente ruse, ishte gjallë dhe shëndoshë e mirë dhe kërkonte azil në Britani. Ndonëse u trondit sa më s'ka, Lankasteri nuk hezitoi të përgjigjej. Faloni duhej të shkatërrohej, Madalena do të fitonte azilin dhe le të bëhej ç'të bëhej më pas. Ai kishte vetëm një kërkesë: që t'ia thoshte vetë të gjitha këto bashkëshortes së tij.

- Të isha në vendin tuaj, nuk do të prisja gjatë për këtë, kryeministër, - i tha Sejmuri.

Lankasteri zgjati dorën ngadalë për të marrë telefonin. Sejmuri u ngrit në këmbë dhe doli nga studioja qetësisht.

Tani mbetej vetëm të zgjidhej gazetari ose gazetarja që do të kishte luksin e ekskluzivitetit të këtij lajmi historik për politikën e Britanisë. Sejmuri sugjeroi Toni Riçmondin e "Times"-it ose Sju Gibonsin e "Indipendent", por Gabrieli nuk pranoi. I tha se i kishte dhënë fjalën dikujt dhe duhej ta mbante. Bëri një telefonatë nga celulari i tij. Nga ana tjetër, i doli sekretaria telefonike dhe ai la një mesazh të shkurtër. Ajo i telefonoi vetëm një çast më pas. E lanë të takoheshin në orën katër të asaj pasditeje në lokalin "Cafe Nero".

- Këtë herë mos eja me vonesë, - tha ai.

Për habinë e Graham Sejmurit, Gabrieli dhe Madalena ngulën këmbë të bënin edhe një shëtitje të fundit së bashku. U nisën përgjatë *Millbank*-ut të rrahur nga një erë e azdisur, kaluan *Victoria Tower Gardens, Westminster Abbey* dhe parlamentin dhe në orën katër pa pesë hynë në lokal. Gabrieli porositi kafe turke, ndërsa Madalena çaj jeshil të shoqëruar me biskota. Nxori një pasqyrë nga çanta dhe u pa në të.

- Si dukem? - e pyeti.

- Si izraelite.

- Duhet ta marr si kompliment këtë?

- Hiqe atë, - i tha Gabrieli.

Ajo bëri si i thanë, pastaj hodhi sytë nga dritarja dhe pa turmat e njerëzve që lëviznin përgjatë këmbësores në rrugën "Bridge". *Sikur nuk i ka parë ndonjëherë ose nuk ka për t'i parë më kurrë*, mendoi Gabrieli dhe hodhi sytë nëpër lokal. Askush nuk e njohu atë. Po fundja përse duhej ta njihnin? Ajo kishte vdekur dhe prehej në oborrin e një kishe në Basildon, një qytet pa shpirt për një vajzë pa emër dhe pa një të kaluar.

- Nuk ke përse e bën këtë, - i tha ai.

- Përse jo?

- Sepse kam materiale të mjaftueshme edhe pa dëshminë tënde. Kam videon e Zhirovit.

- Kremlini mund ta mohojë Zhirovin, por mua jo, - u përgjigj ajo, pa i hequr sytë nga dritarja.

- Shiko me vëmendje, - tha Gabrieli, - sepse nëse e çon deri në fund këtë që ke nisur, do të kalojë shumë kohë pa e parë më me sy Londrën.

- Ku mendon se do të më çojnë?

- Në ndonjë vend në mes të hiçit, ma do mendja. Ndoshta në ndonjë bazë ushtarake, derisa të qetësohen ujërat.

- Nuk tingëllon shumë tunduese, apo jo?

- Ke gjithmonë mundësinë të kthehesh me mua në Izrael.

Ajo nuk u përgjigj. Gabrieli zgjati dorën përtej tavolinës dhe kapi të sajën që dridhej lehtë.

- Kam një shtëpizë në Kornuell, - i tha ai qetësisht. - Nuk është ndonjë qytet kushedi, por është buzë detit. Mund të qëndrosh atje nëse do.

- Ka pamje nga deti shtëpia? - pyeti ajo.

- Ka një pamje përrallore, - iu përgjigj ai.

- Atëherë mund të më pëlqejë, - tha ajo dhe vuri buzën në gaz. Tej rrugës, Big Beni shënoi orën katër.

- U vonua ajo, - tha Gabrieli me mosbesim. - Nuk mundem ta besoj që u vonua.

- Ajo e ka zakon të vonohet, - tha Madalena.

- Meqë ra fjala, ti i kishe bërë shumë përshtypje.

- Nuk është e vetmja.

Madalena qeshi edhe vetë me atë që tha dhe piu pak çaj. Gabrieli pa orën e dorës dhe qeshi. Pastaj e ngriti kokën në kohë për të parë Samanta Kukun që hyri me nxitim. Ajo u gjend sakaq në tavolinën e tyre, thuajse pa frymë. Pa një çast nga Gabrieli para se t'i hidhte sytë nga bukuroshja brune e ulur përballë tij, të shastisej e të pëshpëriste:

- O Zot i madh!

- Të të porosisim ndonjë gjë për të pirë? - e pyeti Madalena me theksin e saj britanik.

- Në fakt, - mezi arriti të fliste Samanta Kuk, - unë them të ecim pak, më mirë.

60

LONDËR

Trembëdhjetë orë më pas, një funksionar i ri i *Downing Street*, dorëzoi një tufë me gazeta në derën e një shtëpie me tulla të kuqe në zonën *Hampstead* të Londrës. Ajo shtëpi i përkiste Simon Hjuitit, zëdhënësit të shtypit të kryeministrit Xhonatan Lankaster. Zhurma e hedhjes së tufës me gazeta para derës së shtëpisë e zgjuan nga një gjumë i thellë i pazakontë. Kishte parë në ëndërr një incident të fëmijërisë kur një nga të fortët e shkollës e kishte gjuajtur me grusht dhe i kishte nxirë syrin. Njëfarësoj, ajo ëndërr mund të konsiderohej si një përmirësim i lehtë nga nata e kaluar kur kishte parë në ëndërr sikur e kishin shqyer ujqërit, apo para dy netësh kur kishte parë në ëndërr sikur i ishte turrur keqas një luzmë grerëzash. Diç po i ngjante dhe nuk po e merrte dot vesh. Pavarësisht nga triumfi i Lankasterit në sondazhe, Hjuitin e kishte kapluar një ndjesi plogështie krejtësisht e pazakontë, ndryshe nga gjithçka tjetër që kishte përjetuar qëkurse kishte shkuar në *Downing Street*. Ishte i bindur se kjo heshtje e shtypit ishte një iluzion. Ishte i bindur se do të çahej korja e tokës dhe do të ndodhte një katastrofë.

Me këto pështjellime, Hjuiti u ngrit serbes-serbes nga shtrati dhe e hapi derën e shtëpisë atë mëngjes të ftohtë londinez. Kur u ul të merrte tufën me gazeta ndjeu një spazmë që i kujtoi dëmin që i kishte shkaktuar

puna në shëndetin e tij. I mori gazetat në kuzhinë ku zhurma e makinerisë së kafesë i kujtoi se ciklit të tij po i vinte fundi. Pasi mbushi një filxhan plot me kafe dhe shkumë të bardhë, hoqi mbështjellësen dhe nxori gazetat. Si zakonisht, në krye ishte gazeta ku Hjuiti kishte punuar fillimisht, "The Times". I hodhi një sy shpejt e shpejt dhe pasi nuk vuri re ndonjë artikull me interes, kaloi te "The Guardian". Më pas ishte "The Indipendent" dhe në fund "Daily Telegraph".

- Mos, - tha ai nën zë, - mos, mos, mos!

Fillimisht shtypi nuk dinte ç'emër t'i vinte asaj ngjarjeje. Tentuan ta titullonin "Çështja e Madalena Hartit", por dukej si titull shumë i ngushtë. Kështu ishte titulluar edhe fiaskoja e Falonit, e cila qarkulloi për vetëm disa orë, po ashtu edhe "Lidhja e Kremlinit", e cila arriti të rrëmbente vetëm një mbulim të shkurtër nga stacioni televiziv ITV. Aty nga paraditja, BBC-ja vendosi të dilte me titullin "Çështja e *Downing Street*", një titull i thatë por që përfshinte shumë mëkate. Nuk kaloi shumë dhe ngjarja u shfaq në të gjitha mediet dhe kështu plasi skandali.

Gjatë pjesës më të madhe të asaj dite, njeriu në qendër të çështjes, kryeministri Xhonatan Lankaster, çuditërisht ndenji në heshtje. Më në fund, në orën gjashtë të mbrëmjes, dera e zezë e Numrit 10 u hap dhe Lankasteri doli i vetëm për t'u përballur me kombin e tij. Toni i zërit ishte i mbushur me keqardhje, por ai u shfaq i qetë dhe i patundur. Pranoi që kishte pasur një lidhje të shkurtër dhe të pavend me një vajzë të re që kishte punuar në partinë e tij. Pranoi edhe se kishte përdorur agjentët e një Shërbimi Sekret të huaj për gjetjen e saj dhe që nuk kishte bërë mirë që kishte vepruar pa vënë në dijeni autoritetet britanike përkatëse, dhe gjithashtu që kishte paguar dhjetë milionë euro haraç. Megjithatë, këmbënguli se nuk kishte dyshuar kurrë se ajo vajzë ishte agjente ruse. As që zhdukja e saj kishte qenë pjesë e një komploti të mirëmenduar nga një kompani energjetike në pronësi të Kremlinit për të marrë licencën për të nxjerrë naftë në Detin e Veriut. Ai tha se ia kishte dhënë Volgatekut atë licencë me sugjerimin e krahut të tij të djathtë prej shumë vitesh dhe

kreut të stafit të tij, Xheremi Falonit. Ajo marrëveshje, theksoi ai, tani nuk ishte më e vlefshme. Faloni u tregua i mençur dhe e lëshoi me shkrim deklaratën e tij të parë, sepse edhe tani që ishte në kohën e tij të artë, ai dukej si një njeri fajtor për diçka. Ai pranoi që e kishte ndihmuar kryeministrin të përballej me pasojat e "sjelljes së tij të pakujdesshme", por mohoi në mënyrë kategorike të kishte marrë ryshfet nga ndonjë njeri që kishte lidhje me kompaninë e naftës dhe të gazit "Volgatek". Gazetarët mbajtën shënim gjithçka të shprehur prej tij. Ata thanë se ishte e qartë që Xheremi Faloni mendonte se Lankasteri nuk do t'i mbijetonte kësaj stuhie dhe se do ta humbiste qeverinë. Gjithashtu, thanë se kjo do të ishte një luftë për mbijetesë, ndoshta edhe një luftë për vdekje.

Deklarata e radhës nuk erdhi në Londër, por në Moskë, ku presidenti rus i quajti hamendësimet kundër Kremlinit dhe kompanisë së tij energjetike një gënjeshtër perëndimore dashakeqe. Duke lënë të nënkuptohej qartazi se kjo çështje do të merrte përmasa gjeopolitike, ai akuzoi Shërbimin Sekret Britanik për zhdukjen e Pavel Zhirovit, njeriut mbi bazën e fjalëve të të cilit ngriheshin të gjitha ato hamendësime. Pastaj, pa dhënë asnjë fakt, ai tha se Viktor Orlovi, oligarku rus i naftës që banonte në Mbretërinë e Bashkuar, kishte gisht në këtë çështje. Orlovi lëshoi një deklaratë të fortë kundërshtuese nga zyrat e tij në "Mayfair", ku e quante presidentin rus një gënjeshtar të pandreqshëm dhe një kleptokrat, i cili më në fund e nxori fytyrën e tij të vërtetë.

Por kush ishte operativi misterioz i shërbimit të huaj sekret që kishte përdorur Lankasteri për të gjetur Madalena Hartin pas zhdukjes së saj në Korsikë? Lankasteri u shpreh se për arsye të sigurisë kombëtare nuk do ta bënte me dije emrin e tij. As Xheremi Faloni nuk hodhi dritë mbi atë çështje. Fillimisht, spekulimet u hodhën mbi amerikanët, pasi dihej se Lankasteri kishte lidhje shumë të afërta me ta. Por, ky spekulim ra poshtë sapo "The Times" raportoi se operativi i Shërbimit Sekret Izraelit me emrin Gabriel Alon qe parë të shkonte në dy raste në *Downing Street* gjatë periudhës në fjalë. Më pas "The Daily Mail" raportoi se një deputet

i njohur e kishte parë Gabriel Alonin të pinte kafe me një vajzë të re në lokalin "Cafe Nero" një ditë para se të plaste skandali. Artikulli i "Daily Mail" nuk u mor seriozisht me pretendimin se i madhi Gabriel Alon nuk do të ishte aq budalla sa të dilte hapur në një kafene të njohur londineze, por artikulli i "The Times" nuk mund të kundërshtohej kaq lehtë. Ndryshe nga sa vepronte zakonisht, Byroja lëshoi një deklaratë të ashpër me anë të së cilës i hidhte poshtë të dy artikujt. Shtypi britanik këtë e quajti si deklaratën që në të vërtetë vuloste përfshirjen e Gabriel Alonit në çështjen në fjalë.

Paskëtaj, skandali kaloi një cikël të parashikuar deklaratash, kundërdeklaratash dhe lufte të hapur politike. Lideri i opozitës shprehu neverinë e tij ndaj gjithë kësaj dhe kërkoi dorëheqjen e Lankasterit. Edhe Xheremi Faloni dukej se e kishte kaluar stuhinë. Fundja-fundit, nuk kishte asnjë provë që ai kishte marrë ryshfet nga Volgateku, përveç fjalës së një ekzekutivi të kompanisë së naftës, të cilin dukej sikur e kishte përpirë dheu.

Ndoshta gjithçka do të qe mbyllur me kaq. Marrëdhënia Lankaster-Falon do të ishte dëmtuar shumë, por jo përgjithmonë, nëse në "Daily Telegraph" nuk do të ishte shfaqur artikulli i kobshëm, të cilin Simon Hjuiti e lexoi atë të martë të dytë janari. Në faqen e parë të gazetës, pranë një artikulli nga gazetarja Samanta Kuk, ishte një fotografi e Xheremi Falonit duke hyrë në një bankë të vogël private në Zyrih. Disa orë më pas Lankasteri doli prapë i vetëm nga dera e zezë e famshme e "Numrit 10" në *Downing Street*, këtë herë për të bërë të ditur shkarkimin nga detyra të ministrit të Thesarit. Pas disa minutash "Scotland Yard" u shpreh se Faloni do të hetohej për ryshfet dhe mashtrim. Faloni deklaroi edhe një herë se ishte i pafajshëm. Asnjë në *Whitehall* nuk e besoi.

Ai u largua për herë të fundit nga *Downing Street* atë pasdite dhe u kthye në apartamentin e tij të beqarit në "Notting Hill", që dukej se ishte i rrethuar nga gjithë gazetarët dhe kameramanët e Londrës.

Nuk u mor vesh ndonjëherë sesi ai arriti t'i shmangte ata, por një kamera e televizionit CCTV shfaqi imazhin e fytyrës së tij në orën 2:23 të mëngjesit teksa endej nëpër një rrugë bosh të "Park Lane", me një litar në qafë. Litarin e kishte lidhur me një mënyrë që i kishte mësuar i ati, dhe

ishte varur në një nga shtyllat elektrike në qendër të urës "Westminster". Askush nuk e kishte parë Falonin teksa përpëlitej në majë të shtyllës dhe ai ndenji atje gjithë natën, derisa më në fund dielli shkëlqeu mbi trupin e tij që lëkundej ngadalë. Kjo vërtetonte më së miri një proverb të vjetër korsikan: Kush jeton si imoral, vdes si imoral.

61

KORSIKË

Por, cili ishte burimi i asaj dreq fotografie që e çoi Xheremi Falonin nga zyra e tij drejt e në shtyllën e urës "Westminster"? Kjo ishte pyetja që do të mbizotëronte në qarqet politike britanike për muaj të tërë, por në ishullin e magjepsur ku e pati zanafillën skandali, vetëm disa veriorë të sofistikuar e vranë mendjen për të. Disa prej tyre bënë fotografi në restorantin "Las Palmiers" duke pozuar si Madalena dhe Pavel Zhirovi në pasditen e drekës që do të vuloste fatin e tyre, por pjesa më e madhe e banorëve të ishullit bënë ç'bënë dhe e harruan rolin e vogël që kishin luajtur në vdekjen e një shtetari të lartë britanik. Me mbërritjen e dimrit, korsikanët iu kthyen jetës së tyre të përditshme.

Nisën të digjnin *macchia* për t'u ngrohur. U tundnin gishtin të panjohurve për të larguar syrin e keq. Kur kishin ndonjë hall të madh, i kërkonin ndihmë don Anton Orsatit, i cili jetonte në një luginë të izoluar pranë bregut jugperëndimor.

Në një pasdite me erë në mes të shkurtit, teksa qëndronte i ulur në tavolinën prej dru lisi të studios së tij të madhe, ai mori një telefonatë të pazakontë. Njeriu në anën tjetër të telefonit nuk donte të hiqte qafe ndonjë, gjë që nuk e habiti aspak donin, sepse ai nuk kishte nevojë për ndihmë për të hequr qafe ndonjë. Në fakt, ai donte një vilë ku të qëndronte

disa javë në qetësi me të shoqen. Vila duhej të ishte në një vend ku nuk e njihte askush dhe ku të mos kishte nevojë për truproja. Doni pa dyshim që e kishte zgjidhjen për këtë, por kishte një problem. Për të shkuar në atë vend, kishte vetëm një rrugë, e cila kalonte ndanë tre ullinjve të moçëm dhe aty shpesh kishte qejf të qëndronte kryelartë një dhi plakë.

- Nuk mund të pësojë ndonjë aksident tragjik para se të vijmë ne ajo? - e pyeti burri në anën tjetër të receptorit.

- Më vjen keq, - ia ktheu don Orsati, - por këtu në Korsikë disa gjëra nuk mund të ndryshohen.

Ata mbërritën në ishull tri ditë më pas, pasi fluturuan nga Tel Avivi në Paris dhe nga Parisi në Ajacio. Don Orsati u kishte dërguar një makinë në aeroport: një *Peugeot Sedan* akull të re, të cilën Gabrieli e ngau furishëm përmes jugut të shkretë korsikan, fillimisht rrugës së bregut, e më pas në luginat që gëlonin nga *macchia*. Kur mbërritën te tre ullinjtë e moçëm, dhia u ngrit kryelartë nga vendi ku po qëndronte dhe u zuri rrugën. Megjithatë, u bë mënjanë menjëherë kur Kiara i pëshpëriti diçka të ëmbël në vesh.

- Çfarë i the? - e pyeti Gabrieli kur rimorën rrugën.

- I thashë se ishe penduar që ishe sjellë keq me të.

- Kush të tha ty që jam penduar? Ajo më ngacmoi vetë e para.

- Zemër, ajo është vetëm një dhi.

- Ajo është terroriste.

- Nuk e di se si do ta drejtosh ti Byronë, kur nuk bën dot për vete as një dhi.

- Kjo është fjalë me vend, - tha ai i ngrysur.

Vila ndodhej afro dy kilometra pas vendit ku qëndronte dhia. Ishte e vogël dhe e mobiluar thjesht. Dyshemetë i kishte të shtruara me gurë gëlqerorë dhe tarracën me granit. Mëngjeseve oborri mbushej me hala

pishe, por pasditeve gurët e saj shkëlqenin nga rrezet e diellit. Ditët ishin të freskëta dhe të binte shpirti rehat. Natën era fishkëllente mes degëve të pishave. Ata pinin verë të kuqe korsikane pranë zjarrit dhe kundronin përkundjen e lehtë të pemëve. Zjarri kishte ngjyrë blu në të gjelbër prej drurit të *macchia*-s dhe lëshonte aromë rozmarine dhe trumze. Gabrieli dhe Kiara e ndien shpejt aromën e tyre. Punë nuk kishin, kështu që flinin deri paradite vonë. Kafenë e mëngjesit e pinin në sheshin e fshatit. Për drekë hanin peshk buzë detit. Pasdite, nëse bënte ngrohtë merrnin rreze dielli në tarracën prej graniti dhe nëse ishte shumë freskët, mbylleshin në dhomën e gjumit dhe bënin dashuri derisa rraskapiteshin dhe i zinte gjumi. Shamroni kishte lënë dhjetëra mesazhe ku ankohej që ai nuk i kthente përgjigje, por Gabrielin kjo e argëtonte dhe vazhdonte ta injoronte. Pas një viti ai do të ishte aq i mbytur në punë duke mbrojtur Izraelin nga ata që donin ta shkatërronin, saqë për momentin nuk donte t'ia dinte për askënd veç Kiarës, diellit, detit dhe aromës së pishave dhe të *macchia*-s.

Gjatë ditëve të para ata shmangën leximin e gazetave, internetin dhe nuk e ndezën fare televizorin, por dalëngadalë Gabrieli u rilidh me botën problematike pjesë e së cilës do të bëhej shumë shpejt. Kreu i IAEA-së, agjencisë së armëve nukleare britanike, parashikonte se Irani do të kthehej në fuqi nukleare brenda vitit. Ditën tjetër pa një raport ku thuhej se regjimi sirian i kishte çuar armë kimike Hezbollahut, ndërsa një ditë më pas mësoi se Vëllai Mysliman që tanimë sundonte Egjiptin ishte regjistruar duke folur për një luftë të re me Izraelin. Lajmi i vetëm i mirë që pa më në fund ishte se në Londër, Xhonatan Lankasteri, pasi i kishte mbijetuar "Çështjes së *Downing Street*"-it, kishte emëruar Graham Sejmurin shef të MI6-s. Gabrieli i telefonoi atij atë mbrëmje për ta uruar, por qëllimi i vërtetë ishte që ta pyeste për Madalenën.

- Është më mirë nga sa e prisja, - i tha Sejmuri.

- Ku ndodhet?

- Një mik i saj i kishte ofruar një shtëpizë buzë detit.

- Vërtet?

- Është pak e habitshme, - tha Sejmuri, - por menduam që kjo nuk përbënte problem.

- Mos ia kthe shpinën asaj vajze, Graham. SVR-ja i ka duart të gjata.

Pikërisht për shkak të duarve të gjata të SVR-së, Gabrieli dhe Kiara kishin vendosur të mos binin shumë në sy në ishull. Rrallë dilnin nga vila pasi errësohej dhe disa herë gjatë natës Gabrieli dilte në tarracë dhe dëgjonte çdo zhurmë nga lugina. Një javë pas mbërritjes së tyre atje, dëgjoi zhurmën e njohur të një *Renault*-i, e një çast më pas pa të ndizeshin dritat për herë të parë në vilën e Kelerit. Ai priti deri pasditen e nesërme për t'ia behur atje pa e njoftuar. Keleri kishte veshur një palë pantallona të bardha të gjera dhe pulovër të bardhë. Ai hapi një shishe verë *Sancerre*, të cilën e pinë jashtë, nën rrezet e diellit. *Sancerre* pasdite, verë të kuqe korsikane në mbrëmje... Gabrieli mendoi se do të mësohej keq me këto, por tani nuk kishte më kthim pas. Populli i tij kishte nevojë për të. Kishte takim me historinë.

- Ajo vepër e Cezanesë ka nevojë për një dorë punë, - i tha ai Kelerit. - Përse nuk ma sjell ta rregulloj meqë jam këtu?

- Mua ajo vepër më pëlqen ashtu siç është. Pastaj, - shtoi Keleri, - ti ke ardhur për të pushuar dhe jo për të punuar.

- Ti nuk ke nevojë?

- Përse?

- Që të pushosh, pra, - u përgjigj Gabrieli.

Keleri nuk foli.

- Ku ishe, Kristofer?

- Në një udhëtim pune.

- Për vaj ulliri apo për gjak?

Kur Keleri ngriti njërën vetull për të treguar se bëhej fjalë për atë të dytën, Gabrieli tundi kokën qortueshëm.

- E po, paratë nuk vijnë duke kënduar, - i tha Keleri qetësisht.

- Ti e di që ka edhe mënyra të tjera për të bërë para.

- Por, jo kur quhesh Kristofer Keler dhe të gjithë të dinë të vdekur.

Gabrieli piu edhe pak nga vera e tij.

- Unë nuk të përfshiva në skuadër sepse kisha nevojë për ndihmën tënde, - i tha ai pas pak. - E bëra që të të tregoja se jeta nuk është vetëm të vrasësh njerëz për para.

- Mos doje të më restauroje edhe mua? Këtë po thua?

- Kjo më vjen instinktivisht.

- Disa gjëra nuk ndreqen kurrë, - tha Keleri, pushoi pak dhe pastaj shtoi: - Është e pamundur.

- Sa njerëz ke vrarë ti?

- Nuk e di, - ia ktheu Keleri. - Sa ke vrarë ti?

- Puna ime është ndryshe. Unë jam ushtar. Ushtar i fshehtë, por gjithsesi mbetem ushtar, - tha Gabrieli me seriozitet. - Mund të bëhesh edhe ti si unë.

- Ti po më ofron punë?

- Që të punosh për Byronë duhet të marrësh nënshtetësi izraelite dhe të flasësh hebraisht.

- Unë jam ndier gjithmonë pak hebraik.

- Po, - tha Gabrieli, - ma ke thënë edhe më parë këtë.

Keleri vuri buzën në gaz dhe mes tyre pllakosi heshtja. Era e pasdites sapo kishte nisur të ngrihej në ajër.

- Por ka edhe një mundësi tjetër, Kristofer.

- Cila është ajo?

- E ke marrë vesh kush është emëruar në krye të MI6-s?

Keleri nuk u përgjigj.

- Mund të ndërmjetësoj unë për ty te Grahami. Ai mund të të japë një jetë dhe identitet të ri.

Keleri ngriti gotën në drejtim të luginës dhe tha:

- Unë e kam një jetë, madje një jetë shumë të bukur.

- Një jetë si vrasës me pagesë. Jetë krimineli.

- Unë jam bandit me honorarë. Ndryshon puna.

- Quaje si të duash, - shtoi Gabrieli dhe hodhi edhe pak verë në gotë.

- Prandaj ke ardhur në Korsikë ti? Për të më bindur të kthehem në Angli?

- Po.

- Premton të më lësh të qetë nëse të lejoj ta restaurosh Cezanenë?

- Jo, - u përgjigj Gabrieli.

- Atëherë le ta shijojmë verën në qetësi.

62

KORSIKË

Tri ditë më pas doni e ftoi Gabrielin të bisedonin në studion e tij. Në fakt, nuk ishte tamam një ftesë se ftesat mund edhe të refuzohen. Ishte më shumë si një urdhër alla Shamronian, me ton të prerë e të pakundërshtueshëm.

- Takohemi për drekë? - e pyeti Gabrieli duke e ditur që në atë kohë të ditës Orsati ishte në humor të mirë.

- Dakord, - u përgjigj doni dhe lëshoi predhën: - Por më mirë eja vetëm.

Gabrieli doli nga vila pak pas dreke. Dhia ia hapi rrugën pa bërë rezistencë sepse e njohu që ishte shoku i italianes së bukur. Edhe rojat në pragun e pronës së Orsatit e lejuan të hynte pa problem, sepse doni u kishte thënë se po priste izraelitin. Donin e gjeti të ulur në studion e tij të madhe, mbi regjistra.

- Si të shkojnë punët? - e pyeti Gabrieli.

- Nuk ka më mirë, - ia ktheu Orsati. - Kam aq shumë porosi, sa kam frikë se do të më duhet të refuzoj ndonjë.

Doni nuk e shprehte asnjëherë qartë nëse e kishte fjalën për vajin apo

për vrasjet. Ai e udhëhoqi Gabrielin në dhomën e ngrënies ku tavolina ishte mbushur plot e përplot me ushqime korsikane nga më të mirat. Me muret e bardha dhe mobiliet e thjeshta, ajo dhomë i kujtoi Gabrielit dhomën private të ngrënies së papës në Pallatin Apostolik. Madje kishte edhe një kryq të madh prej druri të varur në murin pas karriges së donit.

- Të shqetëson? - pyeti Orsati.

- Aspak, - ia ktheu Gabrieli.

- Kristoferi më tha se i njeh mirë kishat katolike.

- Çfarë të ka thënë tjetër?

Orsati u ngrys dhe nuk foli më teksa mbushte pjatën e Gabrielit me ushqim dhe më pas mbushi edhe gotën e tij me verë.

- Të pëlqen vila? - e pyeti ai më në fund.

- Është e mrekullueshme, don Orsat.

- Po gruaja a është e lumtur atje?

- Po, shumë.

- Sa kohë mendoni të qëndroni?

- Sa të na lejoni ju.

Papritmas, doni ra në heshtje.

- Don, më thoni që nuk e meritoj mikpritjen tuaj.

- Jo, në ishull mund të qëndrosh sa të duash, - tha doni, heshti për një çast dhe pastaj shtoi: - Vetëm mos i përfshi çështjet e tua personale në biznesin tim që të mos më prishësh punë.

- Me siguri e ke fjalën për Kelerin.

- Patjetër që për atë e kam.

- Don Orsati, qëllimi im nuk ishte aspak t'ju fyeja ju, por...

- Mos u ngatërro me punë që nuk të përkasin, këtë bëj ti.

Telefoni i donit u drodh, por ai nuk i kushtoi rëndësi.

- A nuk të ndihmova kur erdhe në ishull dhe doje të gjeje atë vajzën angleze?

- Po, më ndihmove, - i tha Gabrieli.

- A nuk ta dhashë Kelerin pa asnjë pagesë për të të ndihmuar ta gjeje?

- Pa të nuk do t'ia kisha dalë dot.

- A nuk e anashkalova faktin që nuk mora asnjë qindarkë nga paratë e haraçit që me siguri ti i rimore?

- Ato para janë në llogarinë bankare të presidentit të Rusisë.

- Ashtu thua ti.

- Don Orsati...

Doni ngriti dorën në ajër për ta ndërprerë, por Gabrieli vazhdoi.

- Për para po e bëni këtë bisedë?

- Jo, - tha doni. - E kam për Kelerin.

Një shkulm ere rrahu dyert franceze që të çonin në kopshtin e don Orsatit. Ishte *libeccio*, era e juglindjes. Zakonisht, në dimër ajo sillte me vete shi, por tani qielli ishte i pastër.

- Këtu në Korsikë, - tha doni pas një heshtjeje të shkurtër, - ne kemi tradita të lashta. Për shembull, një djalosh nuk mundet as ta ëndërrojë që t'i propozojë vetë për martesë një vajze, pa kërkuar më parë dorën e saj tek i ati. Gabriel, e kupton se çfarë dua të them?

- Kam përshtypjen se po, don Orsati.

- Pra, duhej të kishe folur me mua para se t'i kërkoje Kristoferit të kthehej në Angli.

- Kam gabuar, e pranoj.

Shprehia në fytyrën e Orsatit u zbut. Jashtë, në kopshtin e donit, *libeccio* ktheu përmbys një tavolinë dhe një karrige. Ai ngriti sytë nga tavani dhe thirri diçka në dialektin korsikan dhe disa sekonda më pas u shfaq një burrë me mustaqe me një automatik në shpatull, i cili shkoi në kopsht dhe vuri menjëherë në rregull gjithçka.

- Ti as që e ke idenë se si ishte shoku yt, Kristoferi, kur erdhi këtu nga Iraku, - po thoshte Orsati. - Ishte për faqe të zezë. Unë i dhashë një shtëpi, familje, grua.

- Pastaj i dhe edhe një punë, - tha Gabrieli. - Shumë punë, madje.

- Një punë që ai e bën shumë mirë.

- Po, e di.

- Më mirë se ti madje!

- Kush e tha këtë?

Doni buzëqeshi. Mes tyre ra heshtje dhe Gabrieli nuk foli, por vendosi t'i zgjidhte më me kujdes fjalët që pasuan.

- Nuk besoj se kjo është mënyra e duhur për të fituar jetesën, për një djalë si Kristoferi, - tha ai më në fund.

- Njerëzit në shtëpi prej xhami, Alon.

- Nuk e dija këtë proverb korsikan.

- Të gjitha thëniet e zgjuara e kanë prejardhjen në Korsikë, - tha doni, shtyu pjatën që kishte përpara dhe i vendosi krahët mbi tavolinë. - Por, ka diçka që ti nuk po e kupton. Kristoferi nuk është vetëm *taddunaghi*-u im. Unë atë e dua si të ishte djali im dhe nëse më ikën... - aty donit iu shua zëri, por e mblodhi veten dhe tha: - ... do të më thyhej zemra.

- Babai i tij i vërtetë kujton se i biri ka vdekur.

- E po, nuk kishte rrugë tjetër.

- Si do të ndiheshe ti po të ishe në vendin e tij?

Orsati nuk kishte një përgjigje për këtë pyetje dhe ndërroi temë.

- Vërtet mendon se ai miku yt në Shërbimin Sekret Britanik mund të jetë i interesuar për ta rikthyer Kristoferin në Angli?

- Vetëm po të ishte budalla nuk do të pranonte.

- Por mund të thotë jo, - tha doni, - dhe pasi ai ta marrë vesh, rrezikohet pozita e Kristoferit këtu në Korsikë.

- Unë do të veproj në një mënyrë që pozita e tij të mos rrezikohet.

- Ky miku yt është njeri i besuar?

- Atij i besoj jetën time. Madje, ia kam besuar shumë herë më parë.

Doni mori frymë thellë i dorëzuar. Ishte gati t'i jepte bekimin propozimit të pazakontë të Gabrielit, kur i ra prapë telefoni. Këtë herë, u përgjigj. Dëgjoi në heshtje për një çast, pastaj foli disa fjalë italisht dhe e rivendosi telefonin mbi tavolinë.

- Kush ishte? - e pyeti Gabrieli.

- Gruaja jote, - ia ktheu doni.

- Ka ndonjë problem?

- Do të dalë në fshat.

Gabrieli mori të ngrihej.

- Qëndro, mbaroje drekën, - i tha Orsati. - Do të dërgoj disa nga djemtë e mi që të kujdesen për të.

Gabrieli u ul sërish. *Libeccio* po bënte namin në kopshtin e Orsatit. Doni e vështroi atë skenë me trishtim për një çast.

- Nejse, jam ende i kënaqur që ai nuk të vrau ty, Alon.

- Don Orsati, ju siguroj se kjo ndjesi është reciproke.

Era i rrihte fytyrën teksa kalonte teposhtë rruginës, ndanë shtëpizave të rrënuara dhe maceve të tyre, derisa më në fund Kiara ndaloi në sheshin kryesor ku u end nëpër arkadat përgjatë dyqaneve. Shkoi në supermarket dhe mbushi shportën me disa gjëra për darkë. Pastaj zuri një tavolinë në një kafene dhe porositi kafe. Në qendër të sheshit, disa plaka po luanin *boules* nën pluhurin e rrugës, ndërsa në shkallët e kishës qëndronte një plakë e veshur me të zeza dhe po i zgjaste një shirit letre blu një djaloshi. Djaloshi kishte flokë të zinj kaçurrelë dhe ishte shumë simpatik. Kur e pa, Kiara vuri buzën në gaz e pështjelluar. Mendoi se edhe Dani, djali i Gabrielit, do të dukej si ai djalosh po të kishte jetuar dhe tani do të ishte dhjetë vjeç. Plaka zbriti shkallët e kishës dhe u zhduk pas portës së një shtëpize të vogël e të vjetër. Djali mori për nga sheshi me shiritin blu prej letre në dorë. Kiara u habit kur ai hyri në lokal, u ul pranë saj dhe i la shiritin e letrës mbi tavolinë pa thënë asnjë fjalë. Ajo priti derisa djali u largua dhe lexoi rreshtin e vetëm të shkruar në të. *Duhet të të takoj patjetër...*

Signadora plakë po e priste te porta e shtëpisë së saj. Ajo i buzëqeshi Kiarës, e përkëdheli lehtë në faqe dhe e tërhoqi brenda.

- E di ti se kush jam unë? - e pyeti.

- E kam një ide, - u përgjigj Kiara.

- Të ka folur yt shoq për mua?

Kiara pohoi me kokë.

- E paralajmërova të mos shkelte në qytetin e heretikëve, - tha *signadora*, - por nuk ma vuri veshin. Është me fat që është ende gjallë.

- Nuk është e lehtë ta vrasësh atë.

- Ndoshta është vërtet engjëll, - tha plaka duke e përkëdhelur sërish Kiarën në faqe. - Shkove edhe ti atje, apo jo?

- Kush ju tha se kam qenë në Rusi?

- Shkove, madje pa i thënë burrit, - vazhdoi *signadora* sikur të mos e kishte dëgjuar pyetjen e Kiarës. - Ndenjët bashkë në një hotel të atij qyteti

për disa orë. E mban mend? - pyeti plaka pa e hequr dorën nga faqja e Kiarës. Pastaj i përkëdheli flokët dhe tha: - A do që të vazhdoj?

- Unë nuk besoj që ti sheh në të kaluarën e njerëzve.

- Burri yt ka qenë i martuar me një grua tjetër përpara teje, - tha plaka si për t'i treguar Kiarës se e kishte gabim. - Pati edhe një fëmijë me të. Pastaj pati një shpërthim. Gruaja mbijetoi, por djali jo. Ajo është ende gjallë.

Kiara u tërhoq pas fluturimthi.

- Ti kishe kohë që e dashuroje, - vazhdoi plaka, - por ai nuk mund të martohej me ty sepse ishte në zi. Të largoi njëherë, por pastaj erdhi të të shpëtonte në qytetin e ujit.

- Nga i dini ju këto?

- Ai bëri një pikturë ku shfaqeshe ti e mbështjellë me çarçafë të bardhë.

- Ishte vetëm një skicë, - tha Kiara.

Gruaja ngriti supet, sikur kjo të mos përbënte asnjë ndryshim. Pastaj i bëri me kokë nga tavolina e saj, ku pranë disa qirinjve të ndezur ndodheshin një pjatë me ujë dhe një enë me vaj ulliri.

- Nuk do të ulesh? - e pyeti ajo.

- Më mirë jo.

- Të lutem, - i tha gruaja. - Nuk do të të mbaj gjatë. Vetëm kështu mund të flas me siguri.

- Përse?

- Të lutem.

Kiara u ul dhe plaka zuri vend përballë saj.

- Zhyte gishtin e parë në vaj, bijë. Pastaj lësho tri pika vaji mbi ujë.

Kiara bëri si i thanë. Kur pikat e vajit ranë në ujë, u mblodhën në një pikë të vetme. Plaka hapi gojën me habi dhe një pikë lot i rrodhi mbi faqen e rrudhur.

- Çfarë shikoni? - e pyeti Kiara.

Plaka mori dorën e Kiarës në të sajën dhe i tha:

- Yt shoq po të pret te vila. Shko dhe thuaji që do të bëhet sërish baba.

- Është vajzë apo djalë?

Plaka buzëqeshi me dashuri dhe ia ktheu:

- Një nga të dyja.

SHËNIM I AUTORIT

Libri "Vajza angleze" është një histori e trilluar për të argëtuar lexuesit dhe si i tillë duhet parë. Emrat, personazhet, vendet apo incidentet e portretizuara në të janë fryt i imagjinatës së autorit ose janë përdorur në mënyrë fiktive. Çdo ngjashmëri me persona të vërtetë, qofshin të gjallë apo të vdekur, kompani, ngjarje apo vendndodhje është e rastësishme.

Versioni i "*Susanna and the Elders*" i Xhakapo Vasanos, që shfaqet në këtë libër, nuk ekziston. Sikur të ekzistonte, do të përngjante me atë që ndodhet në Muzeun e Arteve të Bukura në Reims.

Në rrugën "Narkiss", në Jerusalem, ndodhet vërtet një shtëpi e vogël me gurë gëlqerorë, në fakt ka disa të tilla, por në to nuk ka jetuar asnjëherë ndonjë agjent i Shërbimit Sekret Izraelit me emrin Gabriel Alon. Zyrat qendrore të Shërbimit Sekret Izraelit nuk ndodhen më në bulevardin "Mbreti Saul" në Tel Aviv; unë zgjodha që zyrat e shërbimit sekret në librin tim imagjinar të ishin atje sepse më ka pëlqyer gjithmonë emri i asaj rruge. Bombardimi i hotelit "Mbreti David" në vitin 1946 është një fakt historik, ndonëse Artur Sejmuri, babai i personazhit të trilluar prej meje, Graham Sejmurit, nuk ka qenë dështmitar i asaj ngjarjeje. Nuk është zhvilluar kurrë në Jerusalem ndonjë ekspozitë për "Kolonat e tempullit të Solomonit", sepse në të vërtetë nuk janë zbuluar rrënoja të tij.

Në *Quai Adolphe Landry*, në Kalvi, ekziston vërtet një restorant me emrin "Les Palmiers", por me sa jam në dijeni, ai nuk ka shërbyer kurrë si vendtakim për dy agjentë rusë. Kompania e vajit të ullirit "Orsati" është e sajuar nga autori, po ashtu edhe aksidenti që bëri Kristofer Keleri, personazhi që shfaqet për herë të parë në librin "Vrasësi anglez", të dezertonte Forcat Ajrore Speciale për t'u bërë vrasës me pagesë dhe të jetonte në

Korsikë. Të gjithë ata që e njohin atë ishull dhe traditat e tij, me siguri e dinë se unë i kam dhënë *singadora*-s sime fuqi që shumë nga koleget e saj as që thonë se i kanë. Kompania energjetike ruse e njohur me emrin Volgatek, nuk ekziston. Po ashtu, nuk ekziston asnjë grup tregtar me emrin "Shoqata Ndërkombëtare e Prodhuesve të Naftës", edhe pse ka shumë shoqata të ngjashme. Fluturimet e kompanisë ajrore "El Al" për të shkuar nga Tel Avivi në Shën Peterburg i përdora për të zbukuruar librin. Të gjithë ata që duan të shkojnë në Shën Peterburg në mes të dimrit, bëjnë mirë të mos i ngjisin shkallët për në të famshmen katedralen "Shën Isak", sepse ajo është e mbyllur në dimër. Lokalin "Cafe Nero" në rrugën "Ura e Londrës" e kam shumë për zemër. I kërkoj ndjesë të thellë hotelit "Metropol", hotelit "Astoria" dhe hotelit "Ritz Carlton" që shkrova për qëndrimin e agjentëve të fshehtë në ta, por me siguri nuk jam as i pari dhe as i fundit që e bëj këtë.

Kam bërë çmos për të përshkruar si duhej atmosferën në *Downing Street*, ndonëse më duhet ta pranoj se, ndryshe nga Gabriel Aloni, unë nuk kam shkelur kurrë përtej barrierave të sigurisë në *Whitehall*. Kur krijova personazhin e Xheremi Falonit, i dhashë atij autoritetin e plotë që kryeministri Toni Bler i ka dhënë Xhonatan Pauëllit, kreut të tij të kabinetit qeveritar. Jam i bindur se, sikur në krah të Xhonatan Lankasterit të kishte qenë Pauëlli, ai njeri brilant dhe skrupuloz, çështja e "Vajzës angleze" nuk do të ekzistonte kurrë.

Rritja e spiunazhit nga Shërbimi Sekret Rus ndaj objektivave perëndimore është dokumentuar mirë. Dezertori i KGB-së, Oleg Gordijevski ka thënë së fundmi për gazetën "Guardian" se përmasat e rezidenturës së SVR-së në Londër kanë kapur ato të kohës së Luftës së Ftohtë. Gordijevski është në pozita unike për të dhënë një deklaratë të tillë sepse ai ka punuar për KGB-në në Londër prej vitit 1982 deri në vitin 1985. Për më tepër, ai nuk është i vetëm në ato që thotë; MI5-a ka arritur në të njëjtin përfundim me të. "Jam shumë i zhgënjyer", është shprehur drejtori i përgjithshëm Xhonatan Evans, "që duhet t'i kushtoj ende shumë pajisje, para dhe staf, një kërcënimi të tillë. Këto burime do të parapëlqeja t'ia kushtoja kërcënimit nga terrorizmi ndërkombëtar".

Ndërkohë që Londra është qartazi një qendër e rëndësishme e aktivitetit të Shërbimit Sekret Rus, Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbeten

fokus primar i Qendrës së Moskës. FBI-ja siguroi prova të mjaftueshme për këtë në qershor të vitit 2010, kur arrestoi dhjetë agjentë rusë, të cilët jetonin ilegalisht prej disa vitesh në Shtetet e Bashkuara. Nga frika se mos kjo rrezikonte të shumëpriturën rivendosje të marrëdhënieve të mira mes Shteteve të Bashkuara dhe Kremlinit, administrata e Obamës pranoi menjëherë t'i kthente të gjithë agjentët në Rusi në kuadrin e një programi për shkëmbim të burgosurish, më i madhi mes Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë që pas Luftës së Ftohtë. Agjentja më e famshme mes tyre ishte Ana Çapman, një femër tipike fatale e cila kishte jetuar për disa vjet në Londër para se të vendosej në Nju Jork, ku do të jetonte si agjente pasurish të paluajtshme dhe vajzë që e donte jetën e natës. Pasi u kthye në Rusi, Çapmani drejton një program televiziv, shkruan në gazetë dhe ka pozuar për një kopertinë reviste për të brendshme franceze. Ajo është emëruar edhe në këshillin "Young Guard of United Russia", një organizatë pro Kremlinit. Kritikët e kësaj organizate shpesh e kanë quajtur atë "Putin Youth". Pjesa më e madhe e spiunazhit rus ndaj Shteteve të Bashkuara ka natyrë industriale dhe ekonomike. Arsyet janë më se të qarta. Pothuajse çerek shekulli pas rënies së Bashkimit Sovjetik, Rusia vazhdon të jetë një vend me ekonomi të dobët, që varet shumë nga materiale të lëndës së parë dhe pa dyshim, edhe nga nafta dhe nga gazi. Presidenti Vladimir Putin nuk e ka mbajtur asnjëherë të fshehtë rëndësinë që ka energjia për Rusinë e re. Madje, Kremlini e nxori hapur në vitin 2003 strategjinë që deklaronte se "roli i vendit në tregun global energjetik përcakton gjerësisht ndikimin e tij gjeopolitik". Me zgjuarsi, Kremlini i zbuti tonet kur foli për rëndësinë e sektorit energjetik të Rusisë, por qëllimi mbetet po ai. Tani, Rusia ka ndër mend ta përdorë pushtetin e saj në skenën botërore me naftë dhe gaz dhe jo me armë nukleare të ideologjisë marksiste-leniniste. Madje, gjigantët energjetikë në pronësi të Kremlinit nuk janë më të kënaqur duke operuar brenda kufijve të Rusisë, ku prodhimi i naftës dhe gazit ka rënë. Tani, ata synojnë të marrin fuqi në nivel global. Thënë shkurt, Federata Ruse po përpiqet të bëhet një Arabi Saudite Euro-Aziatike. *Gazprom*-i, mostra shtetërore ruse, është kompania më e madhe e naftës në botë dhe të ardhurat e saj janë burimi kryesor i buxhetit federal vjetor të Kremlinit. Disa ish-republika sovjetike e marrin *të gjithë* gazin natyror nga Rusia, si për

shembull Finlanda e vogël. Austria merr më shumë se 80 për qind të gazit nga Rusia, ndërsa Gjermania merr prej saj rreth 40 për qind. Ndërkohë që përparimet në teknologjinë për nxjerrjen e naftës po shtojnë gazin në tregun ndërkombëtar, tubacionet e naftës që lidhin Europën me Azinë do t'i sigurojnë *Gazprom*-it një vend dominues për vitet në vijim. Shumë nga klientët e saj europianë duhet të kenë parasysh se *Gazprom*-i ka operuar si një mjet për represion politik në vitin 2001, kur bleu NTV-në, televizionin e vetëm të pavarur dhe kritik të ashpër të Kremlinit dhe partisë së tij Rusia e Bashkuar. Sot, përmbajtja informative e NTV-së është pro Kremlinit.

Pas një kufizimi të shkurtër si kryeministër, Putini u zgjodh për një mandat të tretë si president i Rusisë në mars të vitit 2012. Një ish-oficer i KGB-së, tani ai do të sundojë të paktën deri në vitin 2024, më gjatë se Leonid Brezhnjevi dhe pothuajse aq gjatë sa Jozef Stalini. Nuk është nevoja ta them se jo të gjithë rusët janë pro pushtetit diktatorial të Putinit, po zërat kundër tij shuhen shumë shpejt, ndonjëherë edhe shumë ashpër. Në nëntor të vitit 2009, Sergei Magnistsky, një avokat dhe financier moskovit, i cili akuzoi zyrtarët e drejtorisë së tatimeve dhe oficerët e policisë për përvetësim, gjeti vdekjen papritur në një burg rus në moshën tridhjeteshtatëvjeçare, gjë që provokoi skandal ndërkombëtar dhe solli sanksione nga Shtetet e Bashkuara. Tani, duket se Kremlini ia ka vënë syrin Aleksei Navalnit, disidentit më të famshëm të Rusisë dhe udhëheqësit të protestave që përfshinë vendin pas rizgjedhjes së Putinit si president. Gjatë kohës që shkruhej ky libër, Navalni priste të gjykohej për akuzën për përvetësim, akuzë që ai dhe mbështetësit e tij e cilësuan si akuzë me motive politike. Nëse dënohet, ai do të kalojë dhjetë vjet në burg, prej nga nuk mund të përbëjë kërcënim për Putinin dhe miqtë e tij të Kremlinit.

Nuk ndodh rrallë që një dënim i çfarëdoshëm me burgim në Rusinë e re të Vladimir Putinit të përfundojë me vdekje të papritura. Sipas zyrtarëve rusë, 4.121 njerëz vdiqën gjatë periudhës së arrestit vetëm në vitin 2012, ndonëse mbrojtësit e prodemokracisë thonë se shifrat janë më të larta se kaq. Kjo mund të shpjegojë edhe më tej pse Aleksandër Dolmatovi, një aktivist i prodemokracisë, zgjodhi t'i jepte fund jetës në Roterdam në janar të vitit 2013. Nga frika se mos arrestohej dhe persekutohej në Rusi, Dolmatovi ishte arratisur në Holandë për të kërkuar azil politik dhe kur

azili politik iu mohua, ai u var në qelinë e tij. Qeveria holandeze tha se mohimi i azilit politik nuk kishte lidhje me faktin që Dolmatovi vari veten, por shokët e tij të lëvizjes opozitare mendojnë ndryshe.

Magnistki, Navalni, Dolmatovi... emrat e tyre janë të njohur në perëndim, por ka edhe shumë të tjerë, të cilët dergjen në qelitë e burgjeve ruse sepse guxuan të ngrinin zërin ose të shkruanin në ndonjë blog në internet kritika për Vladimir Putinin. Në Rusi, vazhdon të ketë autoritarizëm pas të cilit fshihen gjigantët e naftës dhe të gazit.

FALËNDERIME

Ky libër, ashtu si edhe vëllimet e tjera të serive të Gabriel Alonit, nuk do ta kishte parë dot dritën e botimit pa ndihmën e *David Bull,* i cili është ndër restauruesit më të mirë në botë. Çdo vit, Davidi lë punën e tij për orë të tëra, për të më këshilluar mua mbi teknikat e restaurimit. Njohuritë e tij mbi historinë e artit dhe kënaqësia e shoqërisë së tij, kanë bërë që marrëdhënia jonë tanimë të jetë më shumë se miqësore, edhe familjare.

Kam folur me shumë oficerë të Shërbimit Sekret Izraelit dhe atij amerikan, po ashtu edhe me politikanë të ndryshëm teksa shkruaja këtë libër. Sot dua t'i falënderoj ata në mënyrë anonime, duke respektuar kërkesën e tyre. Miku im i dashur, Gerald Malone, ish-anëtar i parlamentit dhe ministër i Shëndetësisë, më ndihmoi shumë me të dhënat për politikat britanike dhe më tregoi shumë histori në lidhje me atmosferën e vërtetë në *Downing Street*.

U këshillova me qindra libra, artikuj gazetash dhe revistash, po ashtu hyra edhe në shumë faqe interneti. Janë aq shumë sa nuk mund t'i përmend një e nga një tani. Nuk mund të lë pa përmendur ndihmën e pashlyeshme të *Daniel Yergin, Edward Lucas, Pete Earley, Allan S. Cowell, William Prochnau* dhe *Clint Van Zandt*. Gjithashtu, kujtimet e ish-kryeministrave *Tony Blair, John Major* dhe *Margaret Thatcher* ishin burime të shkëlqyera informacioni.

Louis Toscano, miku im i dashur dhe redaktori im prej shumë kohësh, i cili solli përmirësime të ndjeshme në tekst dhe asistentja e tij, *Kathy Crosby*. Pa dyshim, përgjegjësinë për ndonjë gabim drejtshkrimor që shfaqet edhe në kopjen e shtypur të librit, e mbaj unë dhe jo ata. Ne jemi të bekuar me shumë miq të cilët na e mbushin jetën me dashuri

dhe të qeshura gjatë gjithë kohës, por në veçanti do të falënderoja *Daniel Yergin, Edward Lucas, Pete Earley, Allan S. Cowell, William Prochnau, dhe Clint Van Zandt*. Dua të shpreh mirënjohjen më të thellë për fëmijët e mi, Nikolasin dhe Lilin. Ata jo vetëm që më ndihmojnë për ta rishikuar të gjithë librin në fund, por më bëjnë edhe shoqëri gjatë kërkimeve dhe më falin shumë dashuri kur jam duke punuar. Në fund, duhet të falënderoj bashkëshorten time, gazetaren e shkëlqyer të *NBC News, Jamie Gangel,* e cila më ka dëgjuar me një durim të pashoq sa herë që i flisja për punën time me librin dhe më pas më korrektonte çdo faqe. Të mos ishte për durimin dhe vëmendjen e saj ndaj çdo detaji, "Vajza angleze" nuk do të kishte dalë në kohë në treg. I jam borxhli asaj deri në fund dhe gjithashtu, do ta dua deri në fund.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Silva, Daniel
Vajza angleze / Daniel Silva;
Përkth. Etleva Çepele; Red. Bledar Çepele.
– Tiranë: Living, 2016
422 f.; 15,5 x 23,4 cm.
Tit. origj.: The English Girl
ISBN 978-9928-216-02-1

1.Letërsia amerikane 2.Romane

821.111(73) -312.4